



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË BASHKINË VLORE

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR
NË
BASHKINË VLORE

MAJ 2022

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-22
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-18
3.	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	18-22
II.	HYRJA	23-26
1.	Objekti i auditimit	23
2.	Qëllimi i auditimit	23
3.	Identifikimi i çështjes	23
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	23
5.	Përgjegjësitë e audituesve	23
6.	Kriteret e vlerësimit	24
7.	Standardet e auditimit	25
8.	Metodat e auditimit	25
9.	Dokumentimi i auditimit	26
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	27-343
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	27-28
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	28-343
2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	28-124
2.2	Opinionimi mbi pasqyrat financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020	124-144
2.3	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	144-232
2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 për Prokurimin Publikë i ndryshuar.	232-260
2.5	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	260-270
2.6	Mbi auditimin e brendshëm	270-272
2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	272-276
2.8	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	276-282
2.9	Mbi menaxhimin e ndërmarrjes	282-343
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMET	344-427

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 731/1 Prot., datë 02.07.2021, i ndryshuar me shkresat nr. 731/2 datë 21.07.2021 dhe nr. 731/4 datë 28.10.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Vlorë nga data 02.07.2021 deri në datën 12.11.2021, u krye *Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë*, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 30.06.2021.

1.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit.

Projekti i auditimit, për auditimin e përputhshmërisë në Bashkinë Vlorë, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit.

Auditimi në Bashkinë Vlorë u planifikua të zhvillohej nga data 02.07.2021 deri në datën 12.11.2021, periudha e audituar është 01.01.2018 deri 30.06.2021.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi Projektraportin, hartoi Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1.2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Bashkia Vlorë nuk ka likuiduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor, duke krijuar detyrime të prapambetura. Vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të secilit vit buxhetor ka vlerat si vijon: për vitin 2018 vlera 380,681 mijë lekë, për vitin 2019 vlera 285,741 mijë lekë, për vitin 2020 vlera 246,662 mijë lekë, për periudhën janar-qershor 2021, vlera 148,941 mijë lekë.			-Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Gjatë vitit buxhetor të mos merren angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të shmangët akumulimi i borxhit të ri. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe plani për likuidimin e tyre.
	Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara është shumë i ulët krahasuar me planifikimin.			Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së të ardhurave dhe Drejtorisë së Buxhetit

2	<p>Për vitin 2018 investimet janë realizuar në masën 49 %, për vitin 2019, janë realizuar 67 %, për vitin 2020 investimet janë realizuar 86%, ndërsa për periudhën janar - qershor 2021, investimet janë realizuar në masën 44%.</p>			<p>dhe Financës, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiara dhe realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve.</p>
3	<p>Njësia e Auditit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, duke mos audituar drejtoritë që mbartin risk të lartë.</p> <p>Për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka bërë kontrollin e cilësisë për çdo auditim, duke mos realizuar plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p>			<p>Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Vlorë të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.</p>
4	<p>Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin e parë të</p>			<p>Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet</p>

	<p>vitit 2021, janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 550 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, mbi bazë kontratash, akt-marrëveshesh dhe kërkesash të depozituara pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe të Menaxhimit të Aseteve dhe të aplikimit në sistemin elektronik të ngritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në paketat fiskale të miratuara me VKB.</p> <p>duke mos lidhur kontrata sipas dispozitave ligjore në 93 raste, ku nga këto në 8 raste subjekteve në vlerën prej 710,000 lekë në Radhimë – Orikum dhe në 3 raste në plazhin Zvërnec në vlerën 162,400 lekë nuk kanë paguar tarifën e qirasë për sipërfaqet e plazhit që kanë shfrytëzuar, të cilat në mungesë të kontratave, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.</p> <p>Gjithashtu rezultoise në 2 raste është bërë kontraktim i gabuar për sipërfaqe më të vogël se sipërfaqja sipas plan-rilevimit të paraqitur, duke sjellë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 778,000 lekë.</p> <p>Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera. Në një pjesë të madhe kontratat nuk janë shoqëruar me planvendosje, por edhe kur ishin nuk evidentoheshin përmasat e parcelës dhe përcaktimet e largësive,</p>		<p>Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 3,145,400 lekë, nga subjektet e individ privatë.</p>
--	--	--	--

	nga vija e bregdetit,mes cadrave hapësira publike.			
5	<p>Nga auditimi i procedurave të faturimit dhe arkëtimit të taksës së tokës rezulton se nga specialistët e terrenit të DTTV që operojnë në NJA dhe nga specialistja e Sektorit të Menaxhimit të Tokës janë bërë faturime dhe janë kryer arkëtime vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë apo NJA. Pra nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat e NJA-ve apo të Sektorit të Menaxhimit të Tokës, sipërfaqja e tokës bujqësore pronë private plus sipërfaqja e dhënë në përdorim sipas të dhënave të shkresës është më e lartë se baza e taksueshme e planifikuar në buxhetin e miratuar, me një sipërfaqe prej 1039 ha e shumëzuar me taksën për kategorinë VIII të tokës prej 1800 lekë/ha, është shkaktuar <i>e ardhur e munguar në vlerën 7,480,800lekë</i> për buxhetin e Bashkisë Vlorë.</p> <p>- Debitorë për taksën e tokës <i>përvitin 2018</i> rezultojnë 6571 familje fermere në vlerën <i>26,107,191 lekë, për vitin 2019,</i> 6928 familje fermere në vlerën <i>30,625,468 lekë, për vitin 2020,</i> 7872 familje fermere në vlerën <i>27,162,120 lekë dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021</i> janë 8627 familje fermere në vlerën <i>25,391,616 lekë, vlerë e cilapërbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë</i></p>			<p>-Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ZVRPP dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 1039 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujori 2021, për vlerën 7,480,800 lekë.</p> <p>-Strukturat drejtuese të Bashkisë dheDrejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për ndjekjen e debitorëve,të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar nga familjet fermere dhe për mos kryerjen e pagesave të ndiqen procedurat e tjera administrative dhe ligjore</p>

	<p>Vlorë. Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.</p>			
6	<p>Referuar aktrakordimeve të Bashkisë me UK-Vlorë, rezulton se për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit, rezulton në vlerën 148,587,530 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë ndarë në taksë ndërtese në vlerën 81,598,130 lekë dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi në vlerën 66,989,400 lekë.</p> <p>-Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën 148,587,530 lekë dhe vlera e pa tarifuar prej 196,996,337 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.</p>			<p>-Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të analizojë situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga UK SHA, Vlorë (në rolin e Agjentit tatimor), për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi nga abonentët familjarë dhe të nënshkruajnë një akt-marrëveshje me këtë shoqëri, me qëllim marrjen e përgjegjësisive ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.</p> <p>-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet</p>

			<p>regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.</p> <p>-Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, të marrin masa duke bashkëpunuar me UK-Vlorë si dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 148,587,530 lekë.</p> <p>- Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të bashkëpunojë me UK sha, për evidentimin e vlerës së patarifuar prej 196,996,337 lekë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative ndaj agentit tatimor UK.sh.a.</p>
7	<p>Për periudhën objekt auditimi, për zbatimin e vendimeve gjyqësore Bashkia Vlorë ka shpenzuar vlerën 144,177,487 lekë, nga e cila vlera 3,816,764 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve.</p>		<p>-Kryetari i Bashkisë Vlorë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve</p>

				negative financiare në buxhet.
8	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Subjekteve të liçencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezultoi se në 17 raste të subjekteve, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë nuk janë rinovuar licencat, pavarësisht kryerjes së kontroleve, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e liçencimit në vlerën prej 17,000,000 lekë. Po kështu në 19 raste të lëshimit të autorizimit të liçencimit nuk është bërë aplikimi i saktë i tarifës me një diferencë në vlerë prej 15,200,000 lekë, e cila ka ardhur si pasojë e mosaplikimit të tarifës së miratuar të liçencimit prej 1,000,000 lekë. Vlera prej 32,200,000 lekë e pa arkëtuar, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë.</p>			<p>Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë 17 subjektet me liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, duke arkëtuar shumën prej 17,000,000 lekë si edhe të arkëtojë duke aplikuar tarifën e plotë për 19 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për diferencën debitore prej 15,200,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për liçencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.</p>
9	<p>Për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga auditimi i korespondencës shkresore të Bashkisë Vlorë me ALUIZNI-in Drejtoria Vlorë dhe databaze-s për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) , u konstatua se janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m2 ndërtim me vlerë investimi</p>			<p>Bashkia Vlorë nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ALUIZNI-t Drejtoria Vlorë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës</p>

	<p>10,222,341,500 lekë, <i>pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.</i></p> <p>Gjithashtu Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka faturuar 1961 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107lekë, nga këto është likuajduar vlera prej 88,073,725 lekë, <i>duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.</i></p>			<p>së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi, veprim i cili ka sjellë të ardhura të munguara në vlerën 51,111,707 lekë.</p> <p>-Bashkia Vlorë nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ALUIZNI-t Drejtoria Vlorë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi, veprim i cili ka sjellë të ardhura të munguara në vlerën 51,111,707 lekë.</p> <p>-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet si dhe të vijoje me masa shtërnguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët me status òdebitorë në shumën 3,385,382 lekë, bazuar në legjislacionin tatimor.</p>
10	<p>Nga auditimi i praktikave për dhënie me qira subjekteve apo individëve privat për zënien e hapësirave publike në zonën e plazhit dhe pagesave të kryera, u</p>			<p>Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë Kontabilitetit, të marrë masa për kryerjen e</p>

	<p>konstatuan se: Informacioni në dispozicion nuk plotësonte kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkruara në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve.</p> <p>-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezulton se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin <i>në shumën 6,783,200 lekë</i>. Sipas listave bashkëlidhur.</p> <p>-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk</p>			<p>rakordimeve në lidhje me subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat për shfrytëzimin e hapësirave të plazheve dhe kanë shfrytëzuar këto hapësira për vitet 2018-2021, duke kryer arkëtimin e vlerës prej <i>14,903,440 lekë</i>.</p>
--	---	--	--	---

	<p>kanë paguar detyrimin <i>në shumën 8,120,240 lekë.</i> Sipas listave bashkëlidhur. Nga Drejtoria e aseteve nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, nuk janë mbajtur aktrakordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet.</p>			
11	<p>Në hartimin dhe zbatimin e aneks kontratës të datës 03.07.2013 si amendim e i kontratës fillestare nr.2496 rep.,nr.154kol, datë 04.06.2002 të dhënies me qira të objektit <i>oParku i lojërave të qytetit Vlorë</i>, e lidhur nga ish-METE me subjektin qiramarrës <i>Shoqërinë "I.1" shpk, Vlorë</i>, u konstatuan shkelje ligjore, me pasojë përcaktim të gabuar të tarifës së qirasë në vlerën 360,060 lekë/muaji. Është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, <i>shuma 10,198,440 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS,</i> sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 oPër disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014ö. -Nuk është marrë parasysh</p>			<p>Strukturat drejtuese të Bashkisë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me MZHETT-s referuar VKB nr. 60, datë 27.10. 2016 të rishikojë dhe të amendojë kontratën e datës 04.06.2002 dhe aneks-kontratën e datës 03.07.2013, duke bërë ndryshimet përkatëse në objektin e kontratës dhe në përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren prej 14,932 m² janë sipërfaqe truall funksional dhe 28 m² sipërfaqe ndërtese, e konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të aplikohen ndryshimet e tarifës së qirasë/m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe</p>

	<p>ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, me ndryshime.</p> <p>-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës.</p> <p>-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 të Zgjidhja e kontratës pika 7.2 germa të përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë.</p>			<p>periudhën e fillimit të detyrimit.</p> <p>Strukturat drejtuese, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar në shumën 10,198,440 lekë, për mospërcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren si edhe mosaplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin ÕI. Iõ Shpk.</p>
12	<p>Bashkia Vlorë, rezulton se ka kryer një shpenzim prej afro 1,000,000 Euro, për gjyqin në Arbitrazh në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë, ku rezulton e paditur nga subjekti ÕT. Põ Shpk, në lidhje me prishjen e kontratës koncesionare <i>“Për shërbimin e sistemimit dhe menaxhimin të parkimit në qytetin e Vlorës”</i> Në përfundim të gjykimit, Trupa e Arbitrazhit ka njoftuar Bashkinë Vlorë se Gjykata ka vendosur rrëzimin e gjithë kërkesës së subjektit T. P Shpk kundër tyre, si dhe ka vendosur pagesën e kostove për Bashkinë në shumën 511,395 Euro dhe</p>			<p>Bashkia Vlorë, të marrë gjitha masat për të bërë të mundur arkëtimin e shumë prej afro 700,000 Euro nga T. P në zbatim të vendimit të arbitrazhit. Të merret informacion nga pala e autorizuar S.B.M.K për ecurinë e deritanishme të procedurave të ndjekura për arkëtimin e këtij detyrimi.</p>

	<p>124,200 USD. Gjithashtu është vendosur edhe dëmshpërblimi për kundërpadinë e bërë nga Bashkia Vlorë, në shumën 10,000,000 lekë. Në total, Bashkia Vlorë mund të përfitojë rreth 700,000 Euro nga T. P për gjykimin në arbitrazh.</p>			
13	<p>Nga auditimi i lejes së ndërtimit nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin D.ëshpk me nr. Lic NZ. 5296/1 me objekt Godinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen “Dëshmorët Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/91 dhe nr. 2/92, date 28.09.2011 të ish-K.Rr.T Bashkia Vlorë. Edhe pse është një faturë e prerë më 30.04.2014 sipas vendimit të Gjykatës fatura është likuajduar 15.10.2014 pra rreth 5 muaj me vones. Nga mos llogaritja e penalitetit për pagesat vonuara të taksave ndikimit në infrastrukturë buxhetit të bashkisë ju ka shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerën 1,517,789 lekë.</p>			<p>Nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit në do të rast për rrapa nxejrrjes së mandate pagesat për subjektet e interesuara të p rlllogariten sakt sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju për rmbajtur legjislacionit detyrimet e subjekteve privat qofshin këto për leje të ndërtimit apo fardo lloj takes apo tatimi tjetër.</p> <p>Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, për rrapa dhe nisjes së certifikatave sipas rrdorimit të rlllogariten taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.</p> <p>Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si penalitet në vlerën 1,517,789 lekë për pagesë me vonesë subjektit “D.”shpk.</p>

14	<p>Nga auditimi i Lejes së ndërtimi nr. Prot. 3667/1 datë 11.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin òB.òshpk me nr. Lic NZ. 6313 me objekt òBanesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntok në lagjen “10 korriku” Vlorë me afat zbatimi deri më 11.05.2022 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/49 dhe nr. 2/50, date 28.09.2011 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlogarisnin taksën e ndikimit në infrastrukturën në momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën të vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe jo sipas taksave dhe tarifave vendore të vitit 2011 kur sht marr leja e ndërtimit; Nga ana ark. A. B dhe dr. E. A, taksa e llogaritur për këto dy objekte kap vlerën prej 19,916,497.79 lekë, me një diferencë negative prej 99,061,938 lekë - 19,916,497 lekë = 79,145,441 lekë Vlerë e cila përbën efekt financiar negative për buxhetin e bashkisë dhe duhet rillogaritur dhe mbajtur subjektit</p>			<p>Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast përpara nxejrrjes së mandate pages për subjektet e interesuara të përlogariten saktë detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve private qofshin këto për leje e ndërtimit apo fardo lloj takes apo tatimi tjetër.</p> <p>Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, përpara dhënies së certifikatës së përlogarimit të rillogariten taksat për të verifikuar dhe saktësuat detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.</p> <p>Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën 79,145,441 lekë subjektit “B.”shpk.</p>
----	---	--	--	--

	ndërtues.			
15	<p>Nga auditimi i Lejes së ndërtimit nr. Prot. 4026/1 datë 22.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvillues subjektin ÒB.ò shpk me nr. Lic NZ. 6313 me objekt òGodinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen pavarësia Vlorë Vlorë me afat zbatimi deri më 22.05.2022 u konstatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 3/66 dhe nr. 3/87, date 07.06.2010 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi Drejtoria e Planifikimit të Territorit duhet të përllogarësin taksën ndikimi në infrastrukturën në momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën e vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe jo sipas taksave dhe tarifave vendore të vitit 2011 kur sht marr leja e ndërtimit:</p> <p>Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit duhet të rillogarisin diferencën e krijuar në taksën e ndikimit në infrastrukture në vlerën prej 49,813,766 lekë ó 13,275,477 lekë = 36,538,289 lekë, Vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë dhe duhet rillogaritur dhe mbajtur subjektit</p>			<p>Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast përpara nxjerrjes së mandatit pagesës për subjektet e interesuara të përllogarësit saktë detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve privatë qofshin këto për leje e ndërtimit apo fardo lloj take apo tatumit tjetër.</p> <p>Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit për do subjekt, përpara dhënies së certifikatës së përdorimit të rillogaritës taksat për të verifikuar dhe saktësuat detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.</p> <p>Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të rillogaritur si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën 36,538,289lekë subjektit “B.”shpk.</p>

16	<p>ndërtues.</p> <p>Bashkia Vlorë ka zbardhur lejen e ndërtimit nr. 95 datë 19.02.2020 për zhvilluesin T.Z.B òLeje për ndryshimin e subjektit zhvillues: òGodinë Banimi dhe shërbime 5 kate me 1 kat nëntokë, në lagjen uji i ftohtë, miratuar me vendimin e KRRT të Bashkisë Vlorë nr. 5/95 datë 17.08.2010, me zhvillues subjektin òI.ò shpk me nr. Lic NZ. 4691/1, me afat zbatimi deri më 31.01.2014, por nuk ka filluar ndërtimin deri shkurt 2019. Për zgjatjen e afatit të punimeve Shoqëria òI.ò shpk ka aplikuar në portalin e-leje për shtyrje afati punimesh, kërkesë për të cilën është marrë vendimi nr. 753 datë 17.08.2019 dhe shtyrë afatin e përfundimit të ndërtimit deri në datë 10.12.2022, si dhe aplikuar në portalin e-leje për ndryshim subjekti zhvillimor, kërkesë miratuar me vendimin nr. 95 datë 19.02.2020 duke u ndryshuar subjekti zhvillues nga òI.ò shpk në òT. Z.Bò Shpk.</p> <p>Subjekti aktual òT.Z.Bò Shpk, rezulton se ka vepruar në shkelje të lejes ndërtimore duke u penalizuar nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Vlorë, referuar procesverbalit nr. 10 datë 28.06.2021, konkretisht për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit pasi kati nëntok është ndërtuar mbi tokë, si</p>			<p>-Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107 datë 31.07.2014 <i>“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”</i> të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues òT.Z.Bò shpk, dhe mbikqyrësin òA.Mò dhe trajtimin e ndërtimit të kundraligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.</p> <p>-Referuar shkeljeve, parregullsive dhe zhvillimit të ndërtimit në mungesë të</p>
----	---	--	--	--

	<p>dhe bërë referuar çështja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. 10224 prot. datë 02.07.2021 (Kallzim Penal). IMTV rezulton se me vendimin nr. 337 datë 07.07.2021, ka vendosur për dënim me gjobë të subjektit òT.Z.Bò, në vlerën prej 1,000,000 lekë, si dhe njoftuar zyrtarisht me shkresën nr. 10487 datë 09.07.2021, është bërë njoftimi i subjektit për dënimin me gjobë.</p> <p>Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit ka marrë vendimin nr. 386 datë 13.08.2021 òPër prishje e objektit të kundraligjshëmò dhe me shkresën nr. 12340 datë 03.09.2021 ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë òLëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës nr. 337, date 07.07.2021 të I.M.T Bashkia Vlorë ndaj Subjekti òT.Z.Bò, si dhe bërë me dije subjekti për pezullimin e punimeve.</p>		<p>dokumentacionit tekniko-ligjor, Bashkia Vlorë, të paraqesë kopje të plotë të gjithë dosjes të subjektit (òI.ò shpk dhe òT.Z.Bò shpk) dhe akteve të mbajtuara nga strukturat përgjegjegjëse, të cilat do jenë objekt shqyrtimi dhe verifikimi pas vënies në dispozicion të tyre.</p>
--	--	--	--

1.3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit

Opinionin i auditimit mbi pasqyrat financiare të periudhës raportuese ushtrimore 2020.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Vlorë (Aparati), për vitin ushtrimor 2018, 2019 dhe 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinionin i modifikuar, i kundërt:¹

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705², dhe ISSAI 1200³, pasqyrat financiare, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Vlorë në datën 31

¹ **Opinionin i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

dhjetor 2020, referuar ligjit Nr. 25/2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, ***pasimbartin gabime materiale dhe të përhapura, të cilat janë trajtuar në Bazën për opinionin e kundërt.***

Baza për opinionin e modifikuar, të kundërt:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Vlorë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 51,881 mijë lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2020 (materialiteti 51,881 mijë lekë), dhe janë gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve:

Llogaria nr. 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”*, është pasqyruar më pak për vlerën 80,188,890 lekë;

Llogaria nr. 212 *“Ndërtesa, konstruksione”*, është pasqyruar më pak për vlerën 56,276,416 lekë;

Llogaria nr. 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”*, është pasqyruar më pak për vlerën 11,594,723 lekë;

Llogaria nr. 215 *“Mjete Transporti”*, është pasqyruar më pak për vlerën 9,983,799 lekë;

Llogaria nr. 202 *“Studime dhe kërkime”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 7,776,000 lekë;

Llogaria nr. 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 11,086,490 lekë;

Llogaria nr. 85 *“Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 90,697,230 lekë;

Llogaria nr. 26 *“Pjesëmarrje në kapitalin e vet”*, është pasqyruar më pak për vlerën 635,787,414 lekë;

Llogaria nr. 468 *“Debitorë të ndryshëm”*, është pasqyruar më pak për vlerën 75,218,827 lekë;

Llogaria nr. 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”*, është pasqyruar më pak për vlerën 130,042,284 lekë;

Llogaria nr. 467 *“Kreditorë të ndryshëm”*, është pasqyruar më pak për vlerën 130,042,284 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vlorë.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Vlorë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës

² Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raport të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

³ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2018 - 30.06.2021

Konkluzion i Përgjithshëm:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2018 ó 31.06.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit *Bashkinë Vlorë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë*, bazuar në analizën e riskut⁴, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë të plotësuar, materiale të përhapura që janë baza për dhënien e *një opinionit të kundërt*⁵, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë 854,109 mijë lekë.

Për drejtimin e Bashkisë Vlorë

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara, si dhe zbatimin e kontratave të realizuara, gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2018 - 30.06.2021, në Bashkinë Vlorë dhe në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike të Bashkisë Vlorë.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, si dhe çdo dokument të ndodhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE). Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.

***Opinion i modifikuar, i Kundërt*⁶:**

⁴ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

⁵ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

⁶ **Opinion i modifikuar, i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale dhe të përhapura.**

Sipas mendimit tonë, ne kemi marrë siguri të arsyeshme, për të dhënë opinion se veprimtaria e subjektit të audituar, në këtë rast *Autoriteti Kontraktorë Bashkia Vlorë dhe NSHP*, në prokurimin e fondeve publike, nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative të fushës së prokurimeve), si dhe gabimet dhe shkeljet e evidentuara, janë të përhapura dhe materiale (kryesisht përsa i përket materialitetit cilësor).

Baza për opinionin e modifikuar, të Kundërt:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Projektraportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Vlorë dhe NSHP, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Përshkrimi i çështjeve:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se *është konstatuar dëm ekonomik*, në subjektin e audituar Bashkia Vlorë dhe NSHP, për:

- Moslogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit/certifikatat e përdorimit në vlerën 21,258 mijë lekë;
- Moslogaritjen e saktë të detyrimit për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe biletave turistike në vlerën 3,175 mijë lekë;
- Shpenzime të pajustificuara në karburant në vlerën 3,007 mijë lekë;
- Shpalljen fitues të OE në mënyrë të padrejtë në vlerën 2,956 mijë lekë;
- Moszbatimin e punimeve sipas afatit të kontratës dhe për punime të pakryera në vlerën 1,497 mijë lekë;
- Shpenzime për paga në vlerën 285 mijë lekë, etj.

Është konstatuar përdorim i fondeve publike jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit, për:

- Moslogaritjen e saktë të taksës për tokën bujqësore, ndërtesës, ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit, tarifës së gjelbërimit, pastrimit, ndriçimit, ushtrimit të aktivitetit të shpërndarjes së karburantit, në vlerën 388,650 mijë lekë;
- Moslogaritjen dhe mosarkëtimin e saktë të tarifës së qirave për hapësirat e plazhit, thertore dhe parkun e lojrave, në vlerën 26,522 mijë lekë;
- Për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve fituese jo në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator të prokurimeve publike, në vlerën 91,258 mijë lekë;
- Për moslogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe të penaliteteve për rastet kur kjo taksë është paguar jashtë afatit, në vlerën 117,201 mijë lekë;
- Për pagesën e vendimeve gjyqësore me objekt shpërblim page, për largime të padrejta nga puna, në vlerën 144,177 mijë lekë, etj.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale dhe të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vlorë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave

financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme⁷, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin e skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 731/1 Prot., datë 02.07.2021, i ndryshuar me shkresat nr. 731/2 datë 21.07.2021 dhe nr. 731/4 datë 28.10.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Vlorë nga data 02.07.2021 deri në datën 12.11.2021, u krye *Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë*, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 30.06.2021, nga

Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.M. B., Auditues, Përgjegjës Grupi.
- 2.R. Xh., Auditues, Anëtar.
- 3.A. T., Auditues, Anëtar.
- 4.B. M., Auditues, Anëtar.
- 5.S. H., Auditues, Anëtar.
- 6.K. K., Auditues, Anëtar.

1. Objekti i auditimit.

- Objekti i auditimit është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6 mujori 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve e investimeve.

2. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

- Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të

⁷ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vlorë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Vlorë (Kryetari i Bashkisë, në rolin edhe të Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtorët e Drejtorive pranë Bashkisë Vlorë), kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

5.Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Vlorë, në mënyrë që të planifikoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore
Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC; Ligji nr.154/2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Rregullore òMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së, e ndryshuar; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë; Manuali i Auditimit Financiar.
Ligje mbi të cilat mbështetet subjekti në aktivitetin e tij:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm publikò; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò;

	<p>Ligji nr. 25/2018 òPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò;</p> <p>Ligji nr. 48/2014 òPer pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuarò;</p> <p>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Lokaleò, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, òPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar;</p> <p>Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, òPër kundravajtjet administrativeò;</p> <p>Ligji nr. 107/2014, òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò;</p> <p>Ligji nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò.</p>
Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)	<p>VKM nr.914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuarò;</p> <p>VKM nr.83, datë 03.02.2016 òPër Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.</p> <p>VKM nr.170, datë 25.4.2002 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyreò, e ndryshuar;</p> <p>VKM nr.391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò, e ndryshuar;</p> <p>VKM nr.629, datë 15.7.2015, òPër miratimin e manualeve të ndërtimitò;</p> <p>VKM nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuarò;</p> <p>VKM nr.894, datë 4.11.2015 òPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreò.</p>
Akte të tjera nën ligjore:	<p>Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 òPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmò;</p> <p>UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitò, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò;</p> <p>Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 òPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraò dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore;</p> <p>Udhëzimi i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 òPër procedurën e prokurimit me vlera të voglaò, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 òMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitet publikeò;</p> <p>Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publikò, i ndryshuar;</p> <p>Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatuesò;</p> <p>Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 òPër përgatitjen e buxhetit vendorò;</p>

	<p>Urdhëri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 për miratimin e manualit të MFKö; Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017. Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë; Vendime të Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale 2018-2021.</p>
--	--

7. Standardet e auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, 400, Manualit të Auditimit të Financiar dhe të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar.

8. Metodat e auditimit.

- Kontrolli aritmetik.
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
- Kontrolli i vlerësimeve.
- Konfirmimi nga të tretët.
- Kontrolli sipas një treguesi.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

9. Dokumentimi i auditimit. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt-konstatimeve, akt-verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti i Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të

përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vlorës.

Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e re e Vlorës përfshin të gjithë zonën bregdetare nga Lumi i Vjosës në veri deri në Qafën e Llogarasë në jug, duke përfshirë nominalisht gadishullin e Karaburunit dhe Ishullin e Sazanit. Në këtë territor shtrihen tre qendra të rëndësishme të turizmit detar, Vlora, Radhima dhe Orikumi, ndërsa bashkisë i shtohen edhe zonat rurale blegtorale të Tragjasit. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detaro-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë.



Me miratimin e ligjit 115/2014 *“Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e Qarkut të Vlorës.

Bashkia Vlorë, Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njërive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Vlorë	Qyteti Vlorë
Orikum	Qyteti: Orikum, Fshatrat: Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
Qendër Vlorë	Fshatrat: Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërrovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan.
Novoselë	Fshatrat: Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë, Fitore, Akërnë.
Shushicë	Fshatrat: Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çepirat, Risili.

Organizimi i Bashkisë Vlorë:

Bashkia Vlorë ka nën varësi njësitë shpenzuese si: Teatri Petro Marko, Qendra Kulturore, Klubi Shumësportësh Flamurtari, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Shtëpia e Foshnjës, Qendra e Zhvillimit PAK Vlorë dhe Mbetjet e Ngurta.

Administratae Bashkisë Vlorë përbëhet nga:

Këshilli Bashkiak, Kryetari, Nënkryetari; Administratori i Qytetit; Njësitë Administrative; Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, e cila përbëhet nga Sektori i Buxhetit dhe Qendra Ekonomike; Drejtoria Juridike, e cila përbëhet nga Njësia e Prokurimit Publik dhe ajo e Auditit të Brendshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, e cila përbëhet nga Sektori i Protokoll-Arkivës; Drejtoria e Regjistrimit, Vlerësimit Tatimor, Mbledhjes së Taksave dhe Tarifave, e cila përbëhet nga Sektori i Pranimit dhe Kontabilitetit Tatimor, Sektori i Kontabilitet-Statistikës, Menaxhimit të Borxhit dhe Koordinimit Ndërskretorial dhe Sektori i Tregjeve Publike, Taksave dhe Tarifave Familjare;

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila përbëhet nga Sektori i Planifikimit të Territorit, Sektori i Administrimit të Regjistrimit Elektronik dhe Sistemi GIS, Sektori i Kontrollit të Zhvillimit, Sektori i Arkivës Elektronike dhe Sektori i Projektimit;

Drejtoria e Pronave Publike dhe menaxhimit të Aseteve, e cila përbëhet nga Sektori i Shpronësimeve, Zyra e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave;

Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, e cila përbëhet nga Sektori i Ndriçimit Publik;

Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik, e cila përbëhet nga Agjencia e Veterinarisë, Sektori i Shëndetit Publik, Sektori i Mbrojtjes Konsumatore;

Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social, e cila përbëhet nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Njësia për Dhunën në Familje dhe Barazinë Gjinore;

Drejtoria e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun;

Drejtoria e Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja;

Drejtoria e Emergjencave Civile;

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit; Seksioni i Gjëndjes Civile; Policia Bashkiake.

III.2.Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1.Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6-mujori parë i vitit 2021.

1.1. Programimi i PBA 2018-2020 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018 ó 2021;

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde vetë çelura;

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF)

1.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHS, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1.1. Programimi i PBA 2018-2021 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018 - 2021.

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2018-2020, PBA 2019-2021 dhe 2020-2022, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e taveve të shpenzimeve sipas programeve.

- Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjes, garantimin e cilësisë në tregje publike dhe rritjen e sigurisë në rrugë, përmisimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin e shërbimeve sociale, meremetimin të infrastrukturës rrugore, përmirësim të transportit publik dhe turizmi. Është bërë analiza e për pagat dhe janë llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.

- Fushat me prioritet në shpenzimet për investime konkretisht:

a- Përmisimi i infrastrukturës dhe transportit;

b- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;

c- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;

d-Ndërtimi i veprave të mëdha publike;

e- Përmisimi i kushteve për një turizëm bashkohorë, si arteria kryesore e kësaj bashkie në realizimin e të ardhurave.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të ÷Buxhetit me pjesëmarrje.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga drejtoritë dhe njësitë vartëse.

PBA dhe buxhetet e 3 viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht:

PBA 2018-2020 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2018, miratuar me VKB nr. 60, datë 27/07/2018.

PBA 2019-2021 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2019, miratuar me VKB nr. 88, datë 06/09/2019

PBA 2020-2022 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2020, miratuar me VKB nr. 113, datë 30/12/2019.

Buxhetet vjetore të 3 viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarku Vlorë.

PBA 2021-2023 bashkë me buxhetin vjetor koherent 2020, miratuar me VKB nr.95, datë 28.12.2020

Buxhetet vjetore të 4 viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarku Vlorë.

Për vitin 2018, miratuar me VKB nr. 107, datë 28/12/2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën nr. 148 date 16/01/2018.

Për vitin 2019, miratuar me VKB nr. 141, datë 27/12/2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën nr. 2601/1 date 08/01/2019.

Për vitin 2020, miratuar me VKB nr. 114, datë 26/12/2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën nr. 2021/1 date 09/01/2020.

Për vitin 2021, miratuar me VKB nr.94, datë 28.12.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën nr.1242 date 11.01.2021

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2018		Plani i vitit 2019		Plani i vitit 2020		Plani i vitit 2021 (si 6-mujor)	
		Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	74,828		128,509		83,428		85,504	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	70,252		77,474		37,744		51,690	
3	Trashëguar nga Transferta specifike	107,923		107,350		54,110		67,147	
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	1,116,782		1,266,151		1,248,027		944,033	
	Granti	503,332		529,833		543,546		301,526	
5	Transferta specifike	384,318		385,451		390,071		226,868	
6	Paga (600)		602,603		635,707		704,355		467,421
7	Sigurime shoqërore (601)		100,158		105,939		117,127		80,388
8	Shpenzime operative (602)		1,047,060		1,129,639		1,039,719		496,095
9	Transferta (604) Fondi Rezervë		26,200		25,500		26,500		80,165
10	Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez		318,774		407,979		362,280		453,676
11	Investime nga FZHSH e M. Linjës		66,194		54,173		5,775		
	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)		96,446		135,831		101,170		55,337
Totali i buxhetit		2,257,435	2,257,435	2,494,768	2,494,768	2,356,926	2,356,926	1,676,768	1,676,768

Burimi: Nga Drejtoria Ekonomike.

Në PBA nuk përfshihet pika 1, 2, 3 për vitin 2018, shuma prej 253,003 mijë lekë, për vitin 2019, shuma prej 313,333 mijë lekë dhe për vitin 2020 shuma prej 175,282 mijë lekë dhe shuma 204,341 per vitin 2021, pasi PBA dhe Buxheti vjetor miratohen ne muajin Nëntor -Dhjetor dhe

këto shuma janë shuma të trashëguara nga viti paraardhës të cilat miratohen në buxhetin vjetor pasardhës.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2018-2020 me planin buxhetor 2018, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan përfundim 2018	Sipas PBA 2018-2020	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	683,062	683,062	0
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	1,050,557	1,050,557	0
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	270,813	270,813	0
4	Investime nga FZSHH	242,171	0	242,171
	Total I planit fillestar	2,246,603	2,004,432	242,171
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	342,256	342,256	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	43,367	43,367	0
7	Shpenzime (602.604.609)	644,591	644,591	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)	342,256	342,256	0
	Gjithsej	1,030,214	1,030,214	0

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Në planin faktit të buxhetit 2018 në krahasim me PBA 2018-2020, ka diferencë në shumën 242,171 mijë lekë, të cilat janë fonde të specifike të deleguara nga FZSHH të miratuara në PBA e shtetit, por që nuk janë miratuar në planin e buxhetit viti 2018, pasi shkresat e Pushtetit Qendror janë pjese e PBA-se se shtetit.

PBA 2019-2021 me planin buxhetor 2019, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan përfundim 2019	Sipas PBA 2019-2021	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	712,894	712,894	0
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	1,149,911	1,149,911	0
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	318,630	318,630	0
4	Investime nga FZSHH	26,868	0	26,868
	Total I planit fillestar	2,208,303	2,181,435	26,868
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	91,181	91,181	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	45,559	45,559	0
7	Shpenzime (602.604.609)	614,710	614,710	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)	91,181	91,181	0
	Gjithsej	751,450	751,450	0

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Në planin faktit të buxhetit 2019 në krahasim me PBA 2019-2021, ka diferencë për shumën 26,868 mijë lekë, të cilat janë fonde specifike të deleguara nga FZSHH si fonde te miratuara në PBA e shtetit dhe nuk janë miratuar në planin e buxhetit viti 2018, pasi shkresat e Pushtetit Qendror janë pjese e PBA-se se shtetit

PBA 2020-2021 me planin buxhetor 2020, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plan përfundim 2020	Sipas PBA 2020	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	790,269	743,961	46,308
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	1,063,718	1,037,534	26,184
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	327,657	458,144	-130,487
4	Investime nga FZSH	0	0	0
	Total I planit fillestar	2,181,644	2,239,639	-57,995
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar	190,031	190,031	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	21,992	21,992	0
7	Shpenzime (602.604.609)	412,263	412,263	0
	Grant i kushtëzuar (230-231)	190,031	190,031	0
	Gjithsej	624,286	624,286	0

Burimi: Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	858,242	858,242	0
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	1,144,658	1,144,658	0
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	368,473	368,473	0
4	Investime nga FZSH			
	Total I planit fillestar	2,371,373	2,371,373	0
	Shtesat nga Pushteti Qendror	1,079,736	1,079,736	0
5	Investime grant i kushtëzuar	300,712	300,712	0
6	Shpenzime për pagat (600+601)	55,433	55,433	0
7	Shpenzime (602.604.609)	723,591	723,921	0
	Gjithsej	3,451,109	3,451,109	0

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në

periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga sa më sipër konstatohet se janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, në vitin 2018 kanë ndodhur 5 ndryshime me vlerë 394,971 mijë lekë, në vitin 2019 kanë ndodhur 6 ndryshime me vlerë 430,570 mijë lekë dhe në vitin 2020 kanë ndodhur 13 ndryshime me vlerë 425,215 mijë lekë, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Tabela e ndryshimeve në buxhet paraqitet në aneksin nr. 1, bashkangjitur aktit të konstatimit.

1.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Vlorë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2018, 2019, 2020 dhe periudha janar ó qershor 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2018				2019			
		Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	605,116	565,790	94	111,693	631,792	601,530	95	115,624
2	Sigurime shoqërore 601	121,313	93,734	77	19,470	126,661	100,317	79	21,319
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	948,054	789,096	83	431,476	895,125	785,944	88	390,362
4	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603	61,600	23,767	39	23,767	140,815	138,564	98	48,068
4	K. Q Emergj Civile 604	6,378	6,352	100	5,165	9,194	9,175	100	9,176
5	Nd/Ekonom invalid 606	636,875	634,793	100	3,148	599,580	595,175	99	1,487
6	Mjete ne ruajtje 466	24,825	10,334	42	10,335	100,304	18,335	18	18,355
7	Investime 230-231	855,240	420,982	49	51,092	436,679	290,634	67	128,211
8	Shpenzime 605					3,000	3,000	100	3,000
9	Interesa kredia 166	2,454	2,281	93	11,211	1,641	1,109	68	11,211
10	Principali 651	14,962	14,961	100	1,167	14,962	14,961	100	647
	Totali	3,276,817	2,562,098	78	668,524	2,959,753	2,558,744	88	547,460

Nr.	Emërtimi	2020				Periudha janar-qershor 2021			
		Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta
1	Paga 600	665,876	629,634	95	143,427	424,019	348,084	82	54,656
2	Sigurime shoqërore 601	109,965	104,174	95	24,654	71,292	56,797	80	9,519
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	738,019	688,925	93	380,277	427,262	308,103	72	176,664
4	Subvencion Ujësjiellësi, etj. 603	59,950	59,637	99	59,638	20,200	20,200	100	20,200
4	K. Q Emergj Civile 604	3,865	3,827	99	3,827	4,000	3,962	99	3,962
5	Nd/Ekonom invalid 606	3,530	1,925	55	1,925	1,900	617	32	617
6	Mjete ne ruajtje 466	65,474	25,873	40	25,873	49,716	1,440	3	1,440
7	Investime 230-231	187,015	160,343	86	111,616	220,078	97,675	44	91,876
8	Shpenzime 605					0	0	0	0

Nr.	Emërtimi	2020				Periudha janar-qershor 2021			
		Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta	Plan	Fakt	Real.%	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta
9	Interesa kredia 166	14,962	14,961	100	3,530	8,060	6,625	82	3,478
10	Principali 651	808	752	93	561				
	Totali	1,849,464	1,690,051	91	755,328	1,226,527	843,503	69%	362,412

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varjon: Për vitin 2018 realizimi në vlerën 78%, për vitin 2019 në masën 88%, për vitin 2020 në masën 91% dhe për periudhën janar ó qershor 2021 në masën 69%. Pra realizimi i shpenzimeve varion nga 69% deri më 91%. Për tre vitet e plota buxhetore, realizimi i buxhetit ka një mesatare 86%, ndërsa për të gjithë periudhën e audituar ka një mesatare prej 82%, gjë që tregon se zbatimi i buxhetit nuk ndjek si duhet fazën e planifikimit. Shpjegimet nga Drejtoria Ekonomike për këtë diferencë midis planifikimit dhe realizimit jepen me mungesën e realizimit të të të ardhurave. Nga ana tjetër konstatohet se nuk ka korrigjim të planit vjetor të buxhetit, në varësi të pritshmërisë dhe realizimit faktik gjatë vitit buxhetor, në mënyrë që të ngushtohet diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Bazuar në nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ku thuhet: ò Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetorò, gjykojmë se duke parë trendin e realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, buxhetet e planifikuar mund të ishin korrigjuar, duke ju përshtatur realizimit faktik si të viteve të mëparshme, ashtu edhe të periudhës së vitit buxhetor. Në këtë mënyrë realizimi faktik i shpenzimeve do të ishte si vlerë më afër planifikimit.

Gjithashtu në nenin 5 i ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, përcaktohet se në hartimin e buxhetit vjetor duhet bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet faktike të viteve të mëparshëm.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë shpenzimet operative.

Titulli gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime., shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.

Situata: Nga auditimi konstatohet se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara është shumë i ulët, ku për vitin 2018 paraqitet në masën 49 %, nga vlera planifikuar prej 855,240 mijë lekë është realizuar vlera prej 420,982 mijë lekë, në vitin 2019 në masën 67 %, nga vlera planifikuar prej 436,679 mijë lekë është realizuar vlera prej 290,634 mijë lekë, në vitin 2020 86%, planifikuar 187,015 mijë lekë, realizuar 160,343 mijë lekë dhe në periudhën janar ó qershor 2021 në masën 44%, planifikuar 220,078 mijë lekë, realizuar 97,675 mijë lekë.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedurat të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore, ku për vitin 2018 ato janë në shumën 330,920 mijë lekë, në fund të vitit 2019 në shumën 250,491 mijë lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 246,662 mijë lekë dhe më 31.06.2021 në vlerën 148,41 mijë lekë.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. D. L me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, z. T. Z me detyrë Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe z. V. Z me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Regjistrimit të të ardhurave.

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 òPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikimi i procedurave të prokurimeve për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin, ku sipas ë dhënave të Drejtorisë së Taksave realizimi i të ardhurave për asnjërën nga periudhat nuk paraqitet me realizim.

Efekti: Si rezultat i planifikimit të procedurave pa siguruar burimin e tyre, i cili vjen ngatë ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhura kur ky plan nuk realizohet dhe mos parashikimi i faturave të palikujduara, çojnë në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtorja e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Planifikimi i procedurave për investime/ shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Vlorë.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Miratimi i buxheteve faktik

Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Vlorë janë miratuar buxhetet faktik, ku për vitin 2018 është miratuar me Vendim të KB nr. 12, datë 28/02/2019 dhe për vitin 2019 me vendim të KB nr. 19, datë 27/02/2020. Në relacionet përfundimtare të zbatimit të buxhetit janë hartuar vetëm realizimin e treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk shoqërohen me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2018 është planifikuar në masën 26,200 mijë lekë, nga e cila: përdorur vlera 2,405 mijë lekë për dëme të shkaktuara nga djegia e banesave, në zbatim të VKM nr. 329, datë 16/05/2020 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare. Ndërsa shuma 4,998 mijë lekë e planifikuar për zgjerimin e varrezave të Qytetit Vlorë, sipas Vendimit të KB nr. 72, datë 28/06/2018, nuk është përdorur. Diferenca e papërdorur paraqitet në shumën 23,795 mijë lekë nuk është përdorur.

Për vitin 2019, është miratuar në vlerën 25,500 mijë lekë, nga e cila: përdorur vlera 6,757 mijë lekë, ku vlera prej 3,757 mijë lekë janë përdorur për dëme të shkaktuara nga djegia e banesave,

në zbatim të VKM nr. 329, datë 16/05/2020 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiareò dhe vlera prej 3,000 mijë lekë janë përdorur për ndihme ne lidhje me tërmetin në Korçë. Pa përdorur paraqitet vlera prej 15,743 mijë lekë.

Për vitin 2020 është miratuar në vlerën 18,000 mijë lekë dhe janë përdorur 1,135 mijë lekë. Për periudhën janar-qershor 2021 është miratuar ne vleren 89,099, dhe jane perdorur 2,147 mije leke.

Fondi kryesisht është përdorur për dëme të shkaktuara nga djegia e banesave, në zbatim të VKM nr. 329, datë 16/05/2012 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiareò.

U audituan me zgjedhje praktikat për financimin e dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesave dhe rezultojë se ato janë në përputhje me dispozitat ligjore të VKM nr. 329, datë 16/05/2012 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiareò, mbi procedurën e ndjekur.

Subvencionet.

Titulli gjetjes: Kryerja e subvencioneve në kundërshtim me kuadrin rregullator.

Situata: Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Vlorë nuk ka marrë asnjë subvencionet për periudhën objekt auditim. Ndërsa nga ana e saj gjatë kësaj periudhe janë kryer subvencione, si vijon:

Për vitin 2018, është subvencionuar shuma 61,600 mijë lekë, nga e cila: òKlub Sport Futbollio në shumën 9,000 mijë lekë, òParku Urbanò në shumën 8,600 mijë lekë dhe òUjësjiellës Kanalizim Vlorao në shumën 44,000 mijë lekë.

Për vitin 2019, është subvencionuar shuma 140,815 mijë lekë, nga e cila: òKlub Sport Futbollio në shumën 14,000 mijë lekë, òParku Urbanò në shumën 13,700 mijë lekë dhe òUjësjiellës Kanalizim Vlorao në shumën 32,000 mijë lekë.

Për vitin 2020 eshte subvencionuar shuma 59,638 mije leke, nga e cila: òKlubi Shumesportesh Futbollio ne shumen 13,600 mije leke, òUjesjellesio ne shumen 36,833 dhe òParku Urbanò ne shumen 9,204 mije leke.

Për periudhën Janar ó Qershor 2021eshte subvencionuar shuma 20,200 mije leke nga e cila: òKlubi shumesportesh Futbollio ne shumen 7,000 mije leke, dhe òUjesjellesio ne shumen 13,200 mije leke.

Sipas të dhënave të mësipërme, Bashkia Vlorë (Drejtoria e Finance dhe Buxhetit), planifikon çdo vit në buxhet fonde për òNdërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizimò SHA. Sipas z. T. Z, këto fonde delegohen për subvencionim për paga e punëtorëve të òkanalizimeveò, pasi fondi i pagave nuk mbulohet me tarifën mujore të planifikuar dhe arkëtuar për këtë shërbim dhe për mbulimin e këtij fondi kryhet ky subvencionim. Nisur nga fakti se kjo ndërmarrje është SHA, Bashkia Vlorë nuk ka bazë ligjore për financim e fondit të pagave, por vetëm të detyrimeve ndaj të tretëve nëse ato nuk paguhen në kohë, apo të investimeve (kjo e fundit në zbatim të udhëzimit nr. 138, datë 30.01.2018 òPër miratimin e treguesve dhe kriterëve të përfshira në kontratën e performancës për ofruesit e shërbimeve në sektorin e Ujësjiellës Kanalizimeveò).

Ujësjiellës Kanalizime është shoqëri aksionere e cila funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.4.2008, òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, e cila ka politikat e saj tregtare, si dhe planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit i shoqërisë dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10340, datë 28.10.2010 òPër pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe SHA në pronësi të pushtetit vendorò, nenin 2 dhe 3 ku thuhet:

Neni 2: Në rastet kur ndërmarrjet publike dhe/ose SHA-të, në pronësi të pushtetit vendor, nuk paguajnë në kohë detyrimet e tyre ndaj të tretëve, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për pagimin e tyre.

Neni 3: Për rastet e përcaktuara sipas nenit 2 të këtij ligji dhe kur ndërmarrjet dhe/ose SHA-të subvencionohen nga pushteti qendror dhe/ose vendor, Ministri i Financave, nëpërmjet strukturave të tij, verifikon arsyet e mos pagesës së detyrimit ndaj të tretëve vetëm për çështjet

që lidhen me interesat jetikë dhe bazë të komunitetit (furnizimin me ujë të pijshëm, pastrimin e mbeturinave, kanalizimet etj.)...

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. D. L me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. T. Z me detyrë Drejtor Ekonomik, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe z. V. Z me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Regjistrimit të të ardhurave.

Shkaku: Mos njohja e kuadrit ligjorë nga strukturat përgjegjëse.

Efekti: Financimi i institucioneve jo në varësit të Bashkisë Vlorë, janë veprime të cilat direkt ndikojnë në uljen e fondeve buxhetore dhe mos realizimin e programit të sajë ekonomik.

Rëndësia: I mesëm

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, në miratimin e buxhetit të viteve në vijim të mos planifikojë fonde për subvencionet për pagat në ÷Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizimë SHA, pasi klasifikimi për të cilat destinohen fondet është në kundërshtim me akte ligjore.

Raportet e Monitorimit.

Për vitet 2018 dhe vitin 2019 dhe periudhën Janar ó Qershor 2020, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

Për vitin 2018: 4 mujori i parë ó nr. 7909, dt. 14/09/2018

4 mujori i dytë ó nr. 8415, dt. 01/10/2018 miratuar ne KB

Raporti vjetor ó nr. 1484/1, dt. 01/03/2019 miratuar ne KB

Për vitin 2019: 4 mujori i parë- nr. 4482, dt. 24/05/2019 miratuar ne KB

4 mujori i dytë- nr. 8737 prot. dt. 08/10/2019 miratuar ne KB

Raporti vjetor- nr.1843/1, dt. 02/03/2020 miratuar ne KB

Për vitin 2020: 4 mujori i parë- Nr.5193 prot. dt. 29/06/2020 miratuar ne KB

mujori i dytë- Nr.8010 prot. dt. 21/09/020 miratuar ne KB.

1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave.

Planifikimi në buxhetin vjetor i detyrimeve të prapambetura

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr./datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2018	380,681,121	242,173,000	Nr.107, dt.28/12/2017	160,438,000	81,735,000
Viti 2019	285,741,507	254,406,000	Nr.141, dt.27/12/2018	154,000,000	100,406,000
Viti 2020	211,386,301	217,727,000	Nr.114, dt.26.12.2020	114,520,000	103,207,000
Deri ne 30.06.2021	148,941,083	148,941,083	Nr. 94, dt. 28.12.2020	115,243,808	33,697,275

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Vlorë.

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se në fund të periudhave ushtrimore (2018, 2019 dhe 2020), vlera e detyrimeve te planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin Nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha.

Në shumën e paplanifikuar përfshihen dhe vendimet gjyqësore dhe detyrimet qe rrjedhin nga energjia elektrike, te mbartura ndër vite.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës ÷Detyrimet e prapambetura÷, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr. 1. Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 31/12/2018:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2017/lekë	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2018 - 31/12/2018 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2018/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31/12/2018/lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	888,164,688	427,570,353	1,315,735,041	1,306,334,241	9,400,800
Investime nga FZSHH					
Mallra dhe shërbime	858,767,673	731,692,828	1,590,460,501	1,351,450,239	239,010,262
Vendime gjyqësore	117,273,134	0	117,273,134	34,764,098	82,509,036
Të tjera...	94,644,255	0	94,644,255	44,883,232	49,761,023
Totali	1,958,849,750	1,559,263,181	3,118,112,931	2,737,431,810	380,681,121

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Vlorë.

Tabela nr. 2. Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 31/12/2019

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2018 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2019 31/12/2019 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2019 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31/12/2019 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH					
b. Investime nga Bashkia					
INVESTIME	9,400,800	1,595,997,504	1,605,398,304	1,588,318,546	17,079,758
Mallra dhe shërbime	239,010,262	2,203,770,627	2,442,780,889	2,212,619,298	230,161,591
Vendime gjyqësore	82,509,036	34,764,098	117,273,134	114,023,135	3,249,999
Tjera...	49,761,023	44,883,232	94,644,255	59,394,096	35,250,159
Totali	380,681,121	3,879,415,461	4,260,096,582	3,974,355,075	285,741,507

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Vlorë.

Tabela nr. 3. Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 31/12/2020

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2019 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2020 - 30/06/2020 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2020 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31/12/2020 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH					
b. Investime nga Bashkia					
INVESTIME	17,079,758	289,946,673	307,026,431	254,537,188	52,489,243
Mallra dhe shërbime	230,161,051	503,314,663	733,475,714	560,191,603	166,123,216
Vendime gjyqësore	19,178,175	11,246,112	30,424,287	23,263,437	7,161,390
Tjera ...	35,250,159		35,250,159	14,361,132	20,888,927
Totali	285,741,507	4,323,961,008	4,609,702,515	4,398,316,214	246,662,821

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Tabela nr. 4. Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 30/06/2021

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2020 (lekë)	Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2021 - 30/06/2021 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve janar-qershor 2021 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 30/06/2021 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës e FZSHH					
b. Investime nga Bashkia					
INVESTIME	52,489,243	98,100,302	150,589,545	116,892,270	33,697,275
Mallra dhe shërbime	166,123,241	181,418,249	347,541,510	259,461,526	88,079,984
Vendime gjyqësore	7,161,390	4,571,904	11,733,294	5,458,397	6,274,897
Tjera ...	20,888,927		20,888,927		20,888,927
Totali	246,662,821	284,090,455	530,753,276	381,812,193	148,941,083

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:

Për vitin 2018, detyrimet e raportuara janë vlerën 380,681,121 lekë, në PF të vitit 2018 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 300,634,247 lekë, pra me një diferencë prej 80,046,874 lekë më pak në pasqyrat financiare.

Për vitin 2019, detyrimet e raportuara janë vlerën 285,741,507 lekë, në PF të vitit 2019 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 251,976,918 lekë, pra me një diferencë prej 33,764,589 lekë më pak në pasqyrat financiare.

Për vitin 2020, detyrimet e raportuara janë vlerën 246,662,821 lekë, në PF të vitit 2020 gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve (pasiv bilancit) janë në vlerën 246,662,821 lekë, pra pa diferencë.

Për periudhën janar - qershor 2021, detyrimet e raportuara kanë vlerën 148,941,083 lekë, sipas ditarit të bankës dhe urdhër-shpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike, rezultoi se gjendja e detyrimeve të palikujduara për këtë periudhë është në vlerën 148,941,083 lekë, pra pa diferencë.

Gjithashtu është i paargumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të viteve 2018, 2019 dhe 2020, megjithëse në llog. 520- kemi gjendje monetarë të papërdorur, përsëri Bashkia Vlorë ka detyrime kreditore të papaguara dhe në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2018 në llog. 520, fondet e trashëguara për përdorim në vitin 2019 sipas rakordimit me thesarin kanë vlerën 320,006,233 lekë, fondet e trashëguara në 31.12.2019 për përdorim në vitin 2020 sipas rakordimit me thesarin kanë vlerën 178,186,296 lekë dhe fondet e trashëguara në 31.12.2020 për përdorim në vitin 2021 sipas rakordimit me thesarin kanë vlerën 186,775,278 lekë.

Nga auditimi i urdhër prokurimeve për procedurat e prokurimit u konstatua se nuk janë paraqitur dhe rregjistruar në Degën e Thesarit në fillim të procedurës, por në momentin e likuidimit të këstit të parë të faturës. Regjistri i procedurave është dërguar sipas afateve ligjore në fillim të vitit dhe ai i ndryshuari gjatë vitit. Nga auditimi nuk evidentohen raste të regjistrimit të urdhër prokurimit disa herë (copëzuar);

Titulli gjetjes:Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit 30-ditor të paraqitjes në Degën e Thesarit Vlorë të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01/01/2018 ó 30/06/2021, shpenzimet operative (llog. 602) janë gjithsej 414 fatura me vlerë 1,276,543 mijë lekë, të paguara jashtë afatit 30 ditor, ndërsa për investimet janë gjithsej 24 fatura me vlerë 105,089 mijë lekë. Në total për periudhën janar 2018 deri më 30 qershor 2021, janë gjithsej 438 fatura në vlerën 1,381,632 mijë lekë, të paguara jashtë afatit 30 ditor, nga e cila: për vitin 2018 janë 89 fatura me vlerë 330,920 mijë lekë, për vitin 2019 janë 104 fatura me vlerë 250,490 mijë lekë, për vitin 2020 janë 67 fatura në vlerën 246,662 mijë lekë, për periudhën e janar ó qershor 2021 janë 47 fatura me vlerë 148,941 mijë lekë.

Të dhënat sipas periudhave paraqitet në tabelën në vijim:

Periudha Ushtrimore	Llog. 602		Llog. 230-231		Shuma	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Viti 2017	131	404,619			131	404,619
Viti 2018	86	329,096	3	1,824	89	330,920
Viti 2019	97	233,411	7	17,079	104	250,490
Viti 2020	59	194,173	8	52,489	67	246,662
Janar - qershor 2021	41	115,244	6	33,697	47	148,941
Totali	414	1,276,543	24	105,089	438	1,381,632

Në mënyre analitike faturat e likuiduara jashtë afatit 30 ditor, paraqiten në pasqyrën aneksi 1/1, bashkëlidhur aktit të konstatimit.

Gjithashtu nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka edhe fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre, e cila ka si shkak mungesën e fondeve nga realizmi i të ardhurave vendore. Për periudhën 01/01/2018 ó 30/06/2021, paraqiten gjithsej 20 fatura me vlerë 199,436 mijë lekë, nga e cila: për vitin 2018 paraqiten 9 fatura me vlerë 85,508 mijë lekë, për vitin 2019 paraqiten 3 fatura me vlerë 5,436 mijë lekë, për vitin 2020 paraqiten 5 fatura në vlerën 88,561 mijë lekë dhe për periudhën janar ó qershor 2021 paraqiten 3 fatura me vlerë 19,929 mijë lekë., sipas aneksit nr.1/2, bashkangjitur aktit të konstatimit.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. D. L me funksion Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Nënpunësit Autorizues dhe z. T. Z me funksion Drejtor Financë/ Buxhet, në cilësinë e Nënpunësit Zbatues.

Kriteri: UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ðPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaö, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 ðPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreö neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 ðPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar, neni 52.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh. Ndërsa një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likuidim nga MFE në fund të viteve ushtrimore 2018-2019, duke shtyrë radhën e likuidimeve.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përfshijë kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

- Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për periudhën janar 2018-qershor 2021, Bashkia Vlorë ka shpenzuar vlerën 3,816,764 lekë, për 8 vendime gjykate, nga të cilat vlera 144,900 lekë për një rast në vitin 2018, vlera 272,600 lekë për 2 raste në vitin 2019, vlera 533,520 lekë për 2 raste në vitin 2020 dhe vlera 2,865,744 lekë për 3 raste për periudhën janar ó qershor 2021. Vlera 3,816,764 lekë e shpenzuar për zbatimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna, konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Lista e pagesave të kryera nga Bashkia Vlorë për zbatimin e vendimeve të gjykatës për dëmshpërblim page për punonjësit e larguar nga puna: (Në lekë)

Nr	Kreditori	Vlera e likujduarnga Bashkia	Viti buxhetor
1	L. B	144,900	2018
2	Shuma viti 2018	144,900	
3	F. D	221,600	2019
4	J. H	51,000	
5	Shuma viti 2019	272,600	2020
6	A. H	385,920	
7	I. D	147,600	
8	Shuma viti 2020	533,520	Janar-qershor 2021
9	V. I	912,531	
10	A. S	375,000	
11	J. B	1,578,213	
12	Shuma janar-qershor 2021	2,865,744	
13	Total janar 2018 ó qershor 2021	3,816,764	

Për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt për çështje të tjera të ndryshme, Bashkia Vlorë për të gjithë periudhën janar 2018 ó qershor 2021 ka shpenzuar vlerën 140,360,723 lekë e cila konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet, nga e cila vlera 96,802,862 lekë i përket vitit 2018, vlera 18,235,291 lekë vitit 2019, vlera 22,729,917 lekë vitit 2020 dhe vlera 2,592,653 lekë periudhës janr ó qershor 2021, sipas të dhënave në tabelën në vijim (në lekë):

Nr	Numri i kreditorve të paguar	Vlera e paguar	Viti buxhetor
1	11	96,802,862	2018
2	19	18,235,291	2019
3	17	22,729,917	2020
4	3	2,592,653	Janar ó qershor 2021
5	Total	140,360,723	

Sipas të dhënave nga Drejtoria Juridike, konstatohet se me vendimin nr.138, date 20.12.2018 Këshilli i Bashkisë Vlore, ka vendosur ndërprerjen e shërbimit të transportit urban publik nga Ndërmarrja e Parkut të Udhetareve Vlorë. Duke qene se kjo ndërmarrje ka përfunduar së funksionuar, punonjësit e saj i janë drejtuar gjykatës dhe kanë kundërshtuar mënyrën e zgjidhjes së kontratës së punës duke paditur Bashkinë Vlore. Janë 36 punonjës të cilët kanë hapur proces gjyqësor, prej të cilëve një çështje ka përfunduar, 20 çështje janë pushuar. Ndërsa çështjet e tjera janë të ankimuar nga Bashkia Vlorë në Gjykatën e Apelit.

Gjithashtu janë në proces gjykimi 17 procese të tjera gjyqësore, objekti i të cilave ka qene i ndryshëm, si shpërblim demi, pagim shume, etj.

Të gjitha proceset e mësipërme gjyqësore të pa përfunduara, kanë një rrisht në të ardhmen për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Fakti që ish punonjësit e larguar nga puna kanë fituar proceset gjyqësore, tregon se procesi i largimit të punonjësve ka qenë i pa rregullt dhe nga Bashkia Vlorë nuk janë zbatuar kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për këtë proces. Gjithashtu edhe humbja e proceseve të tjera gjyqësore me natyrë të ndryshme nga marrëdhëniet e punës, tregon se veprimet e kryera nga strukturat përkatëse të Bashkisë Vlorë, të cilat kanë shkaktuar hapjen e çështjes gjyqësore, nuk kanë qenë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhetin e shtetit, që sjell humbja e çdo vendimi gjyqësor.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, ku thuhet: ò...Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative...ò.

Titulli i Gjetjes: Efekte negative në buxhet si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Situata:Për periudhën objekt auditimi, për zbatimin e vendimeve gjyqësore Bashkia Vlorë ka shpenzuar vlerën 144,177,487 lekë, nga e cila vlera 3,816,764 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për 8 raste, ndërsa vlera 140,360,723 lekë i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore, nga e cila vlera 96,802,862 lekë i përket vitit 2018, vlera 18,235,291 lekë vitit 2019, vlera 22,729,917 lekë vitit 2020 dhe vlera 2,592,653 lekë periudhës janr ó qershor 2021.

Vlera 144,177,487 lekë e shpenzuar për periudhën jana 2018 ó qershor 2021 nga Baskia Vlorë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Kriteri: Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Proceset gjyqësore dhe humbja e çështjes së tyre nga njësia vendore, krijojnë efekte negative në buxhet.

Shkaku: Mos zbatimi i kriterëve ligjore në procesin e largimeve nga puna të punonjësve, si dhe shkelje e kuadrin rregullator në fuqi, gjë e cila sjellë hapjen e proceseve gjyqësore.

Rëndësia: Elartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Shpronësimet:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe deklarimeve verbale të kryera gjatë takimeve me strukturat përkatëse, u konstatua se bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22/12/1999 òPër shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publikò, Bashkia Vlorë, në cilësinë e subjektit në favor të të cilit bëhet shpronësimi për interes publik, për periudhën Janar 2016 ó Qershor 2020, konstatohet se:

Janë njohur gjithsej 143 qytetarë me vlerë 514,387 mijë lekë. Janë përcjell për konfirmim MEF për 131 qytetarë për vlerën 367,038 mijë lekë dhe janë konfirmuar nga MEF për 138 qytetarë për vlerën 389,074 mijë lekë.

Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financës dhe Buxhetit), nga ana e saj nuk ka informacion në lidhje me pagesat që janë kryer nga MEF ndaj qytetarëve përfitues të këtyre shpronësimeve.

Nga deklarimi verbal i punonjësve të DPPMA Bashkia Vlorë, konstatohet se për asnjë rast dokumentacioni nuk është përcjellë në ASHK (ish-ZVRPP) Vlorë, për ndryshimin e pronësisë të parcelave dhe regjistrimin në pronësitë të Bashkisë Vlorë (nga poseduesi përfitues i vlerës së shpronësuar tek Bashkia Vlorë), si vlerë Aseti dhe më pas në librat e llogarive përkatëse për rritjen e vlerës së Aseteve të kësaj bashkie (pasqyrimi në kontabilitet dhe aktiv të pasqyrat financiare), minimalisht për vlerën e shpronësimeve të miratuara me KVM përkatëse në vlerën 514,387 mijë lekë, veprime të cilat tregojnë se pasqyrat financiare nuk japin gjendjen reale të Aktivit, në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09/03/2018 òPër procedurat e përgatitje dhe paraqitjes së pasqyrave financiare në NJVQV-veò dhe nenin 25 të ligjit nr. 8561, datë 22/12/1999 òPër shpronësimin dhe marrjen në përdorim të pasurive pronë private për interes publikò (pasqyra sipas aneksi 3.4.1, bashkëlidhur aktit).

Një pjesë e kërkesa për shpronësim janë përballuar nga fondet e Bashkisë Vlorë, gjithsej në shumën 51,942,957 lekë, sipas pasqyrës në aneksin 1/4, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit.

Realizmi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre.

Nga auditim i evidencave të marra në Drejtorinë e Financës/Buxhetit dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë, përdorimi i të ardhurave, u konstatua se:

Për vitin 2018, me të ardhurat e veta Bashkia Vlorë mbulon 12% të vlerës së investimeve, 19% të fondit të pagave, 20% të fondit të sigurimeve shoqërore, 57% të shpenzimeve operative, për vitin 2019, me të ardhurat e veta Bashkia Vlorë mbulon 46% të vlerës së investimeve, 15% të fondit të pagave, 16% të fondit të sigurimeve shoqërore dhe 51% të shpenzimeve operative dhe për periudhën Janar ó Qershor 2020, me të ardhurat e veta Bashkia Vlorë mbulon 23% të vlerës

së investimeve, 10% të fondit të pagave, 12% të fondit të sigurimeve shoqërore dhe 66% të shpenzimeve operative, të dhëna të cilat paraqiten në pasqyrën si vijon:
Për periudhën e viti 2018 kemi këtë situatë.

Tabela nr. 1. Të ardhurat e vitit 2018

EMERTIMI	Plan 2018	Fakt 2018
Të ardhurave të veta të trashëguara viti 2017	74,828	74,828
Të trashëguara nga Transferta specifike 2017	107,923	107,923
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2017	70,252	70,252
Të ardhurat e veta të vitit 2018	732,201	732,201
Grande të pakushtëzuara viti 2018	503,332	503,332
Grandë të specifike të vitit 2018, te detajuara:	1,396,891	1,396,891
- Nga FZSH		
- Nga ministrinë e linjë	1,396,891	1,396,891
- DONATORET TE NDRYSHEM		
- Transferta buxheti. Invalid. Ndhma etj. (606)		
- Nga huate		
TOTALI	2,885,427	2,885,427

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Tabela nr. 2. Përdorimi i të ardhurave viti 2018

Emërtimi	Fakt 2018				% nga përdorimi I të ardhurave veta
	Gjithsej	Tr.Pakushtezuar	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar dhe specifike (ose me destinacion)	
230-Projekte	0				
231-Investime	420,986	25,148	51,092	344,746	12
600-Paga	580,204	154,691	111,692	313,821	19
601-Sigurime Shoqërore	96,089	24,537	19,469	52,083	20
602-Shpenzime Operative	848,136	309,844	483,123	55,169	57
604-Transferta Institucioneve	0				
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	634,793		3,147	631,646	0.50
Kuotë Qarku	0				
Tjera	0				
SHUMAI	2,580,208	514,220	668,523	1,397,465	26

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Për periudhën e viti 2019 kemi këtë situatë

Tabela nr. 3. Të ardhurat e vitit 2019

EMERTIMI	Plan 2019	Fakt 2019
Të ardhurave të veta të trashëguara viti 2018	128,509	128,509
Të trashëguara nga Transferta specifike 2018	107,350	107,350
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2018	77,474	77,474
Të ardhurat e veta të vitit 2019	683,601	683,601
Grande të pakushtëzuara viti 2019	539,532	539,532
Grandë të specifike të vitit 2019 te detajuara:	1,179,751	1,179,751
- Nga FZSH		
- Nga ministrinë e linjë	1,179,751	1,179,751
- DONATORET TE NDRYSHEM		
- Transferta buxheti. Invalid. Ndhma etj. (606)		
- Nga huate		
TOTALI	2,716,217	2,716,217

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Tabela nr. 4. Përdorimi i të ardhurave viti 2019

Emërtimi	Fakt 2019				% nga përdorimi I të ardhurave veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtezuar	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar dhe specifike (ose me destinacion)	
230-Projekte	0				
231-Investime	272,824	59,383	125,150	88,291	46
600-Paga	572,409	173,550	84,475	314,384	15

Emërtimi	Fakt 2019				% nga përdorimi I të ardhurave veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar dhe specifike (ose me destinacion)	
601-Sigurime Shoqërore	92,080	25,578	14,973	51,529	16
602-Shpenzime Operative	807,025	327,392	414,453	65,180	51
604-Transferta Institucioneve	0				
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	593,688		0	593,688	0
Kuotë Qarku	0				
Tjera	0				
SHUMAI	2,338,026	585,903	639,051	1,113,072	48

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Për periudhën e Janar ó Qershor 2020, kemi këtë situatë
Tabela nr. 5. Të ardhurat e vitit 2020

EMERTIMI	Plan 2020	Fakt 2020
Të ardhurave të veta të trashëguara viti 2019	83,428	83,428
Të trashëguara nga Transferta specifike 2019	54,110	54,110
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2019	37,744	37,744
Të ardhurat e veta të vitit 2020	1,241,495	733,484
Grande të pakushtëzuara viti 2020	543,546	543,546
Grandë të specifike të vitit 2019 te detajuara:		
- Nga FZSHH	29,442	5,437
- Nga ministrinë e linjë	929,739	917,188
- DONATORET TE NDRYSHEM	6,532	6,532
- Transferta buxheti. Invalid. Ndhima etj. (606)	743,556	736,500
- Nga huatë		
TOTALI	3,669,592	3,117,969

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Tabela nr. 6. Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020

Emërtimi	Fakt 2020				% nga përdorimi I të ardhurave veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar	Te ardhurat e Veta	Transferta e Kushtëzuar dhe specifike (ose me destinacion)	
230-Projekte					
231-Investime	258,097	45,896	111,616	100,585	43%
600-Paga	667,022	196,961	143,427	326,633	22%
601-Sigurime Shoqërore	110,378	31,656	24,654	54,068	22%
602-Shpenzime Operative	704,381	271,154	380,277	52,950	54%
604-Transferta Institucioneve	3,827		3,827		100%
603. Subvencione	90,487		59,638	30,849	66%
606-Transferta Buxh.Fam.Ind	736,500		1,925	734,575	1%
Kuotë Qarku					
Tjera	41,585	3,931	37,655		91%
SHUMAI	2,612,276	549,598	763,019	1,299,660	29%

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Për periudhën e Janar ó Qershor 2021 kemi këtë situatë

Tabela nr. 7. Të ardhurat e periudhës Janar ó Qershor 2021

EMERTIMI	Plan 6/muaj/2021	Fakt 6/muaj/2021
Të ardhurave të veta të trashëguara viti 2020	85,504	85,504
Të trashëguara nga Transferta specifike 2020	67,147	67,147
Të trashëguara nga trans. Pakushtëzuara 2020	51,690	51,690
Të ardhurat e veta të vitit 2021	844,160	503,035
Grande të pakushtëzuara viti 2021	399,847	309,165
Granti specifik viti 2021	276,829	172,076
Grandë të specifike të vitit 2021 te detajuara:		

EMERTIMI	Plan 6/muaj/2021	Fakt 6/muaj/2021
- Nga FZSH		
- Nga ministritë e linjë	811,165	397,847
- DONATORET TE NDRYSHEM	241	0
- Transfera buxheti. Invalid. Ndhma etj. (606)	486,977	347,481
- Nga huate		
TOTALI	3,023,560	1,933,945

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

Tabela nr. 8. Përdorimi i të ardhurave periudha Janar ó Qershor 2021

Emërtimi	Fakt 6/mujori/2021				% nga përdorimi i të ardhurave veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar	Te ardhurat e Veta	Transfera e Kushtëzuar dhe specifike (ose me destinacion)	
230-Projekte					
231-Investime	123,706	5,565	91,877	26,264	74%
600-Paga	368,784	146,358	54,656	167,770	15%
601-Sigurime Shoqërore	58,797	22,983	9,519	26,295	16%
602-Shpenzime Operative	309,739	130,961	176,665	2,113	57%
604-Transfera Institucioneve/ Kuotë Qarku	3,962		3,962		100%
606-Transfera Buxh.Fam.Ind	348,097		616	347,481	1%
603- Subvencion	20,200		20,200		100%
Tjera 651, 605, 166, 466, 609	8,885	2,479	5,586	820	63%
SHUMA	1,242,170	308,346	363,081	570,743	29%

Burimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Vlorë

1.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Titulli i gjetjes: Mos likujdim në afat i kontratave për investime të financuara nga me fondet e FZHR, fondet e buxhetit të Shtetit (Ministritë së linjës), dhe të ardhurat e veta.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në një pjesë të konsiderueshme të kontratave të lidhura për investimet publike midis Bashkisë Vlorë dhe kontraktorve të ndryshëm, nuk është zbatuar afati i përcaktuar në kontratë për likuidimin e vlerës së kontratës.

Ky fenomen vërehet si te kontratat me burim financimi FZHR dhe ministritë e linjës, ashtu edhe te kontratat që financohen nga të ardhurat e veta, në të cilat është konstatuar mos depozitimi i urdhrave të prokurimit në degën e thesarit për bllokim të fondeve. Mos alokimi në kohë i burimeve të financimit nga donatorët, dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për shkak të mos realizimit të të ardhurave, është shkak kryesor i mos likuidimit në kohë të kontratave të investimeve, duke shkelur detyrimet kontraktuale. midis autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, e duke krijuar një rrisht të lartë për pagesa mbi vlerën reale të kontratës, për shkak të interesave që mund të kërkojnë kontraktorët, apo proceseve gjyqësore që mund të hapin për shkelje të afatit të pagesës të parashikuar në kontratë.

Për financimet nga FZHR, për vitin 2017 janë lidhur 9 kontrata në vlerën 424,684 mijë lekë. Nga vlera e mësipërme është financuar me vonesë vlera 287,251 mijë lekë, nga e cila financuar në vitin 2018 vlera 259,251 mijë lekë dhe në vitin 2019 vlera 27,842 mijë lekë;

Për vitin 2019 është lidhur një kontratë në vlerën 97,319 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2019 shuma 19,517 mijë lekë dhe për vitin 2020 shuma 58,635 mijë lekë. Mbetet akoma për financim vlera 19,167 mijë lekë, jashtë afateve kontraktuale.

Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donatorë të tjerë, janë lidhur për vitin 2017 gjithsej 4 kontrata në vlerën 104,277 mijë lekë. Financuar me vonesë vlera 104,274 mijë lekë, nga e cila:

financuar në vitin 2018 vlera 92,249 mijë lekë, në vitin 2019 vlera 4,765 mijë lekë dhe viti 2020 vlera 7258 mijë lekë.

Për vitin 2018 është lidhur një kontratë në vlerën 8,892 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2019 vlera prej 2,560 mijë lekë, mbetet për financim vlera prej 6,332 mijë lekë, jashtë afateve kontraktuale.

Për vitin 2019 janë lidhur 4 kontrata në vlerën 55,322 mijë lekë. Financuar në vitin 2019 vlera prej 48,261 mijë lekë, financuar me vonesë në vitin 2020 vlera prej 6,404 mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 656 mijë lekë, jashtë afateve kontraktuale;

Për financimet nga buxheti Bashkisë Vlorë dhe Grande. Për vitin 2017 janë lidhur gjithsej 3 kontrata në vlerën 61,906 mijë lekë. Financuar me vonesë nga mos realizimi i të ardhurave vlera 31,791 mijë lekë dhe mbetet akoma për likuidim vlera 30,115 mijë lekë;

Për vitin 2018 janë lidhur 17 kontrata në vlerën 115,050 mijë lekë, nga e cila gjatë vitit 2018 është likuajduar vlera 21,702 mijë lekë. Financuar me vonesë vlera prej 77,327 mijë lekë, nga e cila: në vitin 2019 vlera prej 67,252 mijë lekë dhe në vitin 2020 vlera prej 10,075 mijë lekë. Mbetet akoma e pa likuajduar jashtë afatit të kontratës vlera 16,021 mijë lekë;

Për vitin 2019 janë lidhur 9 kontrata me vlerë 126,289 mijë lekë, nga e cila është likuajduar gjatë vitit 2019 vlera 120,820 mijë lekë. Financuar me vonesë në vitin 2020 vlera prej 8,472 mijë lekë.

Për vitin 2020, janë lidhur 6 kontrata në vlerën 130,436 mijë lekë, nga e cila është likuajduar gjatë vitit 2020 vlera 50,982 mijë lekë, likuiduar me vonesë gjatë viti 2021 vlera 1,580 mijë lekë, mbetet pa likuiduar, jashtë afatit të kontratës vlera 77,874 mijë lekë.

Për periudhën janar-qershor 2021, janë lidhur 10 kontrata në vlerën 138,737 mijë lekë, nga e cila është likuiduar gjatë vitit 2021 vlera 12,128 mijë lekë, mbetet pa likuiduar jashtë afatit të kontratës vlera 126,608 mijë lekë.

Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se nuk janë zbatuar afatet kontraktuale në një pjesë të konsiderueshme të investimeve. Ky fenomen vërehet si të kontratat me burim financimi FZHR dhe ministritë e linjës, ashtu edhe të kontratat që financohen nga të ardhurat e veta, në të cilat është konstatuar mos depozitimi i urdhrave të prokurimit në degën e thesarit për bllokim të fondeve. Mos alokimi në kohë i burimeve të financimit nga donatorët, dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për shkak të mos realizimit të të ardhurave, është shkak kryesor i mos likuidimit në kohë të kontratave të investimeve, duke shkelur detyrimet kontraktuale. midis autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, e duke krijuar një rrisht të lartë për pagesa mbi vlerën reale të kontratës, për shkak të interesave që mund të kërkojnë kontraktorët, apo proceseve gjyqësore që mund të hapin për shkelje të afatit të pagesës të parashikuar në kontratë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis palëve, si dhe nenet 50-51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 për Financat e Vetëqeverisjes Vendore; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar (Të dhënat e mësipërme paraqiten në pasqyrën Aneksin nr. 1/3, bashkëlidhur akt-konstatimit)

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se fondet e akorduara nga FZSH dhe Ministritë e linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha, ku për vitin e parë është respektuar kufiri 20% i vlerës së fondit limit. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Vlorë dhe grandeve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite e financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë.

Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese nga Bashkia Vlorë (Drejtoria e Financës/ Buxhetit), nuk merret në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 85%, nuk ka në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të konsiderueshme, mos depozitohet në Degën e Thesarit të urdhër prokurimeve përpara fillimit të procedurës për bllokim të fondeve, mos planifikimi i procedurave më të domosdoshme, duke planifikuar dhe realizuar procedura pa fonde, duke rritur kështu vlerën e detyrimeve të faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. D. L me funksion Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, z. T. Z me funksion Drejtor i Drejtorisë Financë/ Buxhet, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe z. V. Z me funksion Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *oPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 *oPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit* me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 *oPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore*; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 *oPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit* me ndryshime, si dhe pika 1 e neni 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *oPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, i ndryshuar.

Shkaku: Mos përcaktim të saktë të detyrimeve dhe mos planifikimi në radhë të parë i fondeve për shlyerjen e tyre, çon në rritjen e detyrimeve kreditore në fund të periudhave.

Efekti: Mungesa e monitorimit të fondeve në fillim të procedurës, ndikon në mos marrjen e masave për përmirësimin e planifikimit përdorimin e fondeve me efektivitet, ndërsa mos evidentimi i saktë i detyrimeve dhe mos likuidim i tyre sjell rritjen e borxhit që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria Financë/ Buxhet Bashkia Vlorë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

- Investime, për të cilën Bashkia Vlorë nuk është pjesëmarrës si në financim me buxhet edhe në zbatimin e procedurave, paraqiten në aneksin 1/5, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Në **Bashkinë Vlorë, për vitin 2018** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr 99, datë 22.12.2017, me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.2, datë 18.01.2018 *oPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2018*, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e 3 Sektorëve të të ardhurave në varësi të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, si: Sektori i përpunimit të të dhënave dhe pranimit me 6 punonjës, nga të cilët 4 janë specialistë dhe 2 operatorë. Sektori i kontrollit në terren me 16 punonjës, nga të cilët 12 janë specialistë

përfshirë edhe NJA, 3 faturistë dhe 1 punonjës transporti.

Për vitin 2019, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 133, datë 20.12.2018, me ndryshime dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.132 datë 31.12.2018 òPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2019ò, në të cilën përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e përbërë nga 3 sektorë si:

-Sektori i përpunimit të të dhënave dhe pranimit me 8 punonjës, nga të cilët 4 specialistë pranimi, 1 specialist kontabiliteti dhe 2 operatorë.

-Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren me 19 punonjës, nga të cilët 1 është përgjegjës sektori, 13 specialistë të kontrollit në terren përfshirë dhe NJA, 2 faturistë tregu, 1 inspektor borxhi, 1 specialist borxhi si edhe 1 punonjës transporti.

Për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 133, datë 20.12.2018, me ndryshime, dhe Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.62 datë 31.12.2019 òPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2019ò, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 2 sektorë si:

-Sektori i përpunimit të të dhënave dhe pranimit me 8 punonjës, nga të cilët 4 specialistë pranimi, 1 specialist kontabiliteti dhe 3 operatorë.

-Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren me 18 punonjës, nga të cilët 11 punonjës janë specialistë të kontrollit në terren përfshirë dhe NJA, 2 faturistë tregu, 1 inspektor borxhi, 1 specialist borxhi si dhe 1 punonjës transporti.

Për vitin 2021, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 85, datë 24.12.2020, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 2 sektorë si:

-Sektori i përpunimit të të dhënave dhe pranimit me 9 punonjës, nga të cilët 5 specialistë pranimi, 1 specialist kontabiliteti dhe 3 operatorë.

-Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren me 17 punonjës, nga të cilët 11 punonjës janë specialistë të kontrollit në terren përfshirë dhe NJA, 3 faturistë tregu, 1 inspektor borxhi, 1 specialist borxhi si dhe 1 punonjës transporti.

Nga struktura e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, vërehet se në strukturë nuk ka specialist kontabiliteti.

Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren:

Ky sektor është i paplotësuar me inspektorë terreni në çdo rajon, sikurse konstatohet se rajoni 3 ka më shumë se 1 inspektor terreni dhe rajonet e tjera apo njësitë administrative kanë 1 inspektor. Procedura e kryerjes së kontroleve në terren nuk duhet të ushtrohet vetëm me 1 person, pasi ky veprim le hapësirë dhe mundësi abuzimi dhe akti i kontrollit duhet të nënshkruhet nga të paktën dy persona. Ky sektor duhet të ketë edhe 1 përgjegjës për menaxhimin e punës në një bashki të madhe si Bashkia e Vlorës ku numri i subjekteve është relativisht i lartë dhe niveli i borxhit është i lartë.

-Në një drejtori të rëndësishme sikurse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore (e cila luan rol të rëndësishëm në mbledhjen e të ardhurave) ka mungesë personeli në sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit. Kjo strukturë duhet të ketë domosdoshmërisht specialistë të kontabilitetit tatimor dhe specialistë borxhi, për arsye se ka një numër të lartë subjektsh debitorë dhe mangësi në kryerjen e detyrës.

Pra, nëse analizojmë strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, konstatohen mangësi në **Sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit, kryesisht me specialistë kontabilitetit tatimor, ndërsa Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren ka mangësi për inspektorë terreni.**

Për periudhën e auditimit, konstatohet se për 6-mujorin e I të vitit 2021, është shtuar Sektori i Taksës së Pasurisë me 16 persona.

Për këtë sektor nuk ka të përcaktuar me rregullore detyrat që do të kryejnë sipas emërtesës së vendit të punës dhe nuk evidentohet të jetë kryer punë konkrete për taksën e pasurisë për familjarët. Ndërkohë këta punonjës kanë punuar në terren si inspektorë terreni sipas planeve

të punës miratuar nga kryetari i bashkisë për çdo muaj për DAV dhe urdhërat e dhëna nga drejtori i drejtorisë, në bazë të domosdoshmërisë për punonjës në mbarëvjetjen e punës për realizimin e të ardhurave, pra pa u përcaktuar detyrat funksionale të këtij sektori me rregullore.

Titulli i gjetjes: Mangësi në plotësimin e strukturës me specialistë të fushës dhe rregulloren e funksionimit të administratës së Bashkisë.

Situata: Struktura e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, vërehet se Sektori i përpunimit të të dhënave dhe pranimit, nuk ka specialist kontabiliteti.

-Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren, një drejtori e rëndësishme sikurse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore (e cila luan rol të rëndësishëm në mbledhjen e të ardhurave) ka mungesë personeli në sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit. Kjo strukturë duhet të ketë domosdoshmërisht specialistë të kontabilitetit tatimor dhe specialistë borxhi, për arsye se ka një numër të lartë subjektesh debitorë dhe mangësi në kryerjen e detyrës.

Pra, nëse analizojmë strukturën e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, konstatohen mangësi në ***Sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit, kryesisht me specialistë kontabiliteti tatimor, ndërsa Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren ka mangësi për inspektorë terreni.***

-Për periudhën e auditimit, konstatohet se për 6-mujorin e I të vitit 2021, është shtuar Sektori i Taksës së Pasurisë me 16 persona.

Për këtë sektor nuk ka të përcaktuar me rregullore detyrat që do të kryejnë sipas emërtesës së vendit të punës dhe nuk evidentohet të jetë kryer punë konkrete për taksën e pasurisë për familjarët. Ndërkohë këta punonjës kanë punuar në terren si inspektorë terreni sipas planeve të punës miratuar nga kryetari i bashkisë për çdo muaj për DAV dhe urdhërat e dhëna nga drejtori i drejtorisë, në bazë të domosdoshmërisë për punonjës në mbarëvjetjen e punës për realizimin e të ardhurave, pra pa u përcaktuar detyrat funksionale të këtij sektori me rregullore.

Kriteri: Struktura e miratuar dhe rregullorja e bashkisë

Ndikimi/Efekti: Moskryerje e detyrave funksionale dhe ulje e nivelit të të ardhurave dhe keqmenaxhim në ndjekjen e borxhit tatimor.

Shkaku: Keqmenaxhim i burimeve njerëzore

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Strukturat Drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e strukturës së Drejtorisë së të Ardhurave Vendore me specialistë të fushës në Sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit, kryesisht me specialistë kontabiliteti tatimor si edhe për Sektorin e borxhit dhe kontrollit në terren me inspektorë terreni.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Strukturat Drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndryshimin e Rregullores së organizimit, funksionimit detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, përshtatjen e strukturës me detyrat që do të kryejnë punonjësit sipas emërtesës së vendit të punës, vënien në koherencë të rregullores (e vitit 2018) me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturë me qëllim mbarëvjetjen e mirë të punës, realizimin e të ardhurave dhe përcaktimin e saktë të detyrave funksionale të çdo punonjësi dhe pozicioni pune.

-Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2018, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë është miratuar me VKB nr.100, datë 22.12.2017, òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë

Për vitin 2019, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë është miratuar me VKB nr.100, datë 22.12.2017, òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë

Për vitin 2020, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë është miratuar me VKB nr. 109, datë 27.11.2019, òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në

territorin e bashkisë Vlorë

Për 6-mujorin e I të vitit 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë është miratuar me VKB nr. 88, datë 24.12.2020. Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI	Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020			6-mujori i parë vitit 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	Te ardhura nga taksat vendore												
1	Takse për kalim e se drejtës se pronës(AKSH)	32,450	27,422	85	26,300	36,212	138	30,000	29,159	97	20,000	13,637	68
2	Takse e automjeteve te përdorura(DRRSTH)	52,900	55,972	106	57,000	66,018	116	65,400	65,964	101	45,000	29,388	65
3	Taksa e bizn vogël (Tatim i Tjeshituar)(DRT)	12,960	15,409	119	17,000	16,004	94	18,000	13,321	74	12,000	9,947	83
4	Takse e pasuri paluajt (ndërtesat+toka bujq.)												
4.1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	144,523	125,255	87	244,888	179,757	73	244,045	116,645	48	165,000	104,914	64
4.2	Takse pasurie e paluajtshme toke bujqësore	42,455	15,355	36	42,455	11,118	26	42,455	13,175	31	28,000	4,792	17
5	Takse trualli	8,500	12,325	145	10,000	10,808	108	10,000	11,156	112	11,566	6,368	55
6	Takse e fjetjes ne hotel	10,164	9,021	89	14,639	6,534	45	19,721	5,469	28	6,860	623	9
7	Taksa e ndikim ne infrastr nga ndërtim e reja												
7.1	Takse ndikim infrastr (Dr. e Kontr Zhvill Terr)	394,310	102,609	26	394,310	73,107	12.84	301,161	205,336	68	160,000	110,131	69
7.2	Takse e ndikimit në infrastrukturë (ALUIZNI)	35,767	46,012	120	24,224	22,462	91.82						
8	Takse tablele + reklame	12,465	9,728	78	9,875	5,524	56	6,382	5,413	85	6,300	5,114	81
9	Takse parkimi	10,000	1,935	19	3,000	1,655	55	3,000	1,339	45	800	1,199	150
10	Taksa mbi te ardhurat Personale	7,470			10,000		0	10,000	24,270	243	5,000	10,437	209
II	Te ardhurat nga tarifat vendore												
1	Tarife për zëmin e hapësirave publike												
1.1	Tarife tregu	9422	9456	100	9422	24393	259	9,422	16,567	176	2,480	1,842	74
1.2	Tarife e zëms se hapësirave publike	55440	40763	74	71280	29026	41	72,380	28,064	39	41,000	27,547	67
2	Tarife vjet pastrim urban+ndriçim+gjelbërim	152,395	132,764	87	154,835	133,149	86	223,326	107,756	48	135,023	103,751	77
3	Tarife shërbimi për subjekt aktiviteti ndërtimi	21,616		0	21,616		0	18,690		0	12,000		0
4	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	1,115	1,710	153	1,807	1,488	82	1,800	19	1	900		0
5	Tarife për shërb të tjera nga pushteti vendor	6,074	5,156	85	6,074	4,655	77	7,164	4,650	65	5,300	2,247	29
6	Tarife për leje dhe certifikata transporti	11,202	3,799	34	13,262	6,128	46	9,795	3,933	40	8,000	3,542	44
7	Tarifa e Ujitjes	3,610		0	3,610		0	3,610		0	2,600		0
III	Te ardhura te tjera												
1	Te ardhura nga qiratë (mjete+godine+toke)	41,703	2,816	7	41,703	2,594	6	41,325	1,533	4	27,000	806	3
2	Te ardhura nga aplikimi i gjobave e debitorë	28,500	77,426	272	63,500	59,995	94	65,000	70,331	108	98,000	60,025	61
3	Te ardhura nga kopshitet, çerdhet dhe shkollat	20,826	14,594	70	20,826	13,683	66	20,826	7,796	37	13,900	6,146	44
4	Te ardhura nga institucionet vartëse												
4.1	Te ardhura nga teatri ePetro Markoë	1,200	1,221	102	1,200	781	65	1,200	375	31	367	60	16
4.2	Te ardhura nga Qendra Kulturore	1,700	835	49	1,700	973	57	1,700	876	52	1,000	278	28
4.3	Te ardhura nga Shumesportet	595		0	595		0	595		0	397		0
4.4	Te ardhura nga ndërmarrja Shërbime Publike	300		0	300		0	300		0	200		0
4.5	Te ardhura nga pullat	730			730	498	68	730		0	467		0
	Projekte							20,000			33	35,000	0
5	Te ardhura te trashëguara												
IV	TOTALI TE ARDHURAVE (Taksa Tarifa)	1,116,782	711,580	63.71	1,266,151	684,100	54	1,248,027	740,016	59	844,160	502,794	60
	Te ardhura te pa planifikuar -mjete ne ruajtje												
	-4665100	19,632	20,621										
	-Sponsorizime	699										241	
	-te tjera	167											
	-financimi i kom europian	123							6,532				
	-takse pulle si e ardhur e planifikuar					498			337				
	Te ardhura te rakordura me Degen e Thesarit		732,201			683,602		1,248,027	740,016	59	844,160	503,035	60

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, Bashkia Vlorë

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitin 2018, të ardhurat nga 1,116,782 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 711,580 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 405,202 mijë lekë, ose realizuar në masën 63.7%. Për vitin 2019, të ardhurat nga 1,266,151 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 684,100 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 582,051 mijë lekë, ose realizuar në masën 54%, për vitin 2020, të ardhurat nga 1,248,027 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 740,016 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 508,011 mijë lekë, ose realizuar në masën 59% dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 të ardhurat nga 844,160 mijë lekë planifikuara, janë realizuar 503,035 mijë lekë, pra ka një mosrealizim në shumën 341,125 mijë lekë, ose realizuar në masën 60%.

Referuar tabelës ku paraqitet niveli i realizimit të të ardhurave konstatohet se në 6-mujorin e I të vitit 2021, niveli i realizimit paraqitet i kënaqshëm krahasuar me vitet 2020, 2019 dhe 2018, ku të ardhurat vjetore janë realizuar përkatësisht 59%, 54% dhe 63.7%.

Po kështu, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në nivele realizimi mbi planin, fakt i cili tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, dhe për pasojë kjo jep ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave.

Nga të dhënat e paraqitura nga DTTV, Bashkia Vlorë në lidhje me strukturën e planifikimit dhe

mblehdhjes së taksave dhe tarifave vendore u konstatua se DTTV, planifikon dhe mbledh taksa dhe tarifa në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me agjentë tatimorë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, kryen procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për 6 taksa dhe 2 tarifa për biznesin. Për këto të ardhura akt-rakordimet janë kryer nga specialistja e kontabilitetit të DTTV z. B. H me specialisten z.K. Q që evidenton dhe kryen aktrakordimet me degën e Thesarit Vlorë, për të ardhurat në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në Aparatin e Bashkisë Vlorë.

Sipas akt rakordimeve të DAV planifikimi dhe realizimi i të ardhurave që menaxhon kjo Drejtori për periudhën 2018-2019-2020 dhe 6-mujori i I-rë i vitit 2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji i takses	Viti 2018			Viti 2019			Viti 2020			6-mujori i vitit 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	Te ardhura nga taksat												
	Taksa e pasurisë	100,340	68,360	68	107,887	70,165	65	107,043	60,980	57	77,318	54,699	71
	Takse tabelë	4,500	5,916	131	1,100	2,401	218	2,175	2,447	113	2,800	2,564	92
	Takse fjetje ne hotel	10,164	5,307	52	14,639	6,513	44	19,721	5,350	27	6,860	623	9
	Takse reklame	7,965	2,732	34	8,775	3,119	36	4,207	2,910	69	3,500	2,549	73
	Takse tregu	8,500	7,214	85	10,000	10,756	108	10,000	11,341	111	11,566	6,367	55
II	Te ardhura nga tarifat												
	Tarifë pastrim,ndricim,ngelberim nga biznesi	69,718	60,711	87	72,193	69,094	96	77,173	65,201	84	65,000	62,656	97
	Tarifë e zënies së hapësirave publike (qo plazhe) nga biznesi	33,900	16,869	50	40,440	21,060	52	39,840	14,016	35	15,300	8,254	54
	Tarifë veterinarie	1,115	1,260	113	1,807	1,946	108	1,800	667	37	900	11	1
	Tarifë pastrim,ndricim,ngelberim nga Tregu Vlore	7,862	7,601	97	7,862	6,386	81	7,862	4,118	52	3,734	1,948	52
	Tarifë e zënies së hapësirave publike nga Tregu Vlore	2,040	2,105	103	2,040	1,801	88	2,040	1,290	62	1,360	596	44
	Tarifë e zënies së hapësirave publike nga Tregu Novosele				1,560	1,305	84	1,560	1,163	75	1,120	587	52
III	Te ardhura te tjera												
	Te ardhura nga kamate,sonesat nga biznesi(gjoha)	500	2,943	589	500	2,553	511	500	2,315	463			
	Te ardhura nga debia	25,000	54,110	216	60,000	51,491	86	61,500	58,009	94	48,000	56,453	118
	Total te ardhura nga njesite administrative		39,436										
	GJITHSEJ (I+II+III)	271,604	274,564	101	328,803	248,590	76	335,421	229,577	68	237,458	197,307	83

Tarifë e zënies së hapësirave publike për vitin 2018 është realizuar në shumën 40,763 mijë lekë nga 55,440 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 74%, për vitin 2019 është realizuar në shumën 29,026 mijë lekë nga 71,280 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 41%, për vitin 2020 është realizuar në shumën 17.616 mijë lekë nga 43,440 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 40.5 % dhe 6-mujori i parë i vitit 2021 është realizuar në shumën 9,436 mijë lekë.

Kjo tarifë lidhur me tregjet është faturuar dhe arkëtuar pa u lidhur marrëveshjeve ndërmjet subjekteve dhe Bashkisë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 22.12.2017, VKB nr.109 datë 23.11.2019 dhe VKB nr. 88, datë 24.12.2020 të miratimit të paketave fiskale, pika 1 òTarifa për zënien e hapësirave publikeò nën-pika b òTarifa për tregjet e bashkisë Vlorëò⁸

Duke krahasuar 2 tabelat rezulton se këto tabela nuk rakordojnë për disa zëra si psh:

1.Takse tabelë dhe reklame realizimi në fakt është

Viti 2018, sipas DTTV është 8,648 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 9,728 mijë lekë

Viti 2019, sipas DTTV është 5,520 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 5,524 mijë lekë

Viti 2020, sipas DTTV është 5,357 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 5.412 mijë lekë

Për 6-mujorin e parë të vitit 2021 sipas DAV është 5,111 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin është 5,113 mijë lekë.

2.Takse e fjetjes në hotel realizimi në fakt është:

Viti 2018, sipas DTTV është 5,307 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 9,021 mijë lekë

Viti 2019, sipas DTTV është 6,513 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 6,534mijë lekë

Viti 2020, sipas DTTV është 5,350 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin është 5,350 mijë lekë

6-mujori i vitit 2021, sipas DAV është 619 mijë lekë dhe sipas akt rakordimit me Thesarin është 623 mijë lekë

8Kjo tarifë do të paguhet sipas marrëveshjes së lidhur me Bashkinë Vlore (1 mujore, tre mujore, gjashte mujore, vjetore). Në rastin e pagesës së kësaj tarife do të aplikohen këto ulje.....

3. Takse trualli realizimi në fakt është

Viti 2018 sipas DTTV është 7,214 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 12,325 mijë lekë

Viti 2019 sipas DTTV është 10,756 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 10,808 mijë lekë

Viti 2020 sipas DTTV është 11,116 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 11.141 mijë lekë

6-mujori i vitit 2021 sipas DAV është 6,380 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 6,367 mijë lekë

4. Tarifë Tregu + Tarifë pastrim-gjellbërim-ndricim Tregu realizimi në fakt është

Viti 2018, sipas DTTV është 9,706 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 9,456 mijë lekë

Viti 2019, sipas DTTV është 9,492 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 24,393 mijë lekë

Viti 2020, sipas DTTV është 4,118 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është 4,118 mijë lekë përfshirë në totalin e vlerës së arkëtimit në tarifën e pastrimit.

6-mujori i vitit 2021, sipas DAV është 1,948 mijë lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është përfshirë në totalin e vlerës së arkëtimit në tarifën e pastrimit.

Për vitin 2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, ka diferenca të vogla në rakordim kjo për arsye se pagesat e vitit 2020 e më parë bankat i listojnë me zëra kur kryhen pagesat ndërkohë që këto zëra duhet të klasifikohen në debi.

Të ardhurat në DTTV mbahen ekstra-kontabël, thjesht në një program excel, referuar ditarit të të ardhurave të mbajtur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe bëhet rakordimi mujor me dy drejtoritë. Evidentohen vetëm arkëtimet për çdo debitor në Sistemin TAIS, dhe më pas Sistemi TAIS gjeneron debitorët, por për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë në kontabilitet, megjithëse nga specialistja e Kontabilitetit në DTTV është bërë relacion Drejtorit të DTTV në fund të vitit ushtrimor, ku ky i fundit nuk ia ka dërguar Qendrës Ekonomike për kontabilizim edhe përfshirjen e vlerës së debitorëve të shoqëruara me analizën e tyre në Pasqyrat Financiare të viteve 2018-2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a,b.

Për debitorët progresiv në vite deri në datën 31.12.2020 nga DTTV, janë dërguar me shkresën nr. 2791 prot., datë 24.02.2021 lista e debisë progresive deri në datën 31.12.2020 Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. O. B me detyrë Drejtor i DTTV(2018 -2020), zj.K. Q me detyrë specialiste e marrëdhënieve me Degën e Thesarit në Sektorin e Buxhetit Regjistrimit të të Ardhurave në Drejtorinë Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Titulli i gjetjes: Mangësi në programimin e të ardhurave dhe veprimet e kontabilizimit.

Situata: Paketat fiskale për vitet 2018-2019-2020-2021, janë miratuar me VKB nr. 100, datë 22.12.2017, VKB nr. 109, datë 27.11.2019 dhe VKB nr. 88, datë 24.12.2020 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë, me ndryshime.

Referuar aktrakordimeve me Thesarin konstatohet se për vitin 2018, të ardhurat nga 1,116,782 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 711,580 mijë lekë, ose në masën 63.7%. Për vitin 2019, të ardhurat nga 1,266,151 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 684,100 mijë lekë, ose në masën 54%, për vitin 2020, të ardhurat nga 1,248,027 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 740,016 mijë lekë, ose në masën 59% dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 të ardhurat nga 844,160 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 502,794 mijë lekë, ose janë realizuar në masën 60%.

Nga analiza e të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në nivele tejet të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, rezultat i cili paraqet se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva si në planifikim ashtu edhe në punën për mbledhjen e të ardhurave, duke ndikuar negativisht në realizimin e tyre. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave.

Taksë truall për vitin 2018 realizuar në masën 145%, në vitin 2019 në masën 108% , për vitin 2020 në masën 112% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 55%.

Tarifë tregu për vitin 2018 realizuar në masën 100%, në vitin 2019 në masën 259% , për vitin 2020 në masën 176% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 74%.

Taksë table reklame për vitin 2018 realizuar në masën 19%, në vitin 2019 në masën 56%, për vitin 2020 në masën 85% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 81%.

Taksë parkimi për vitin 2018 realizuar në masën 78%, në vitin 2019 në masën 56%, për vitin 2020 në masën 85% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 81%.

Taksë bujqësore për vitin 2018 realizuar në masën 36%, në vitin 2019 në masën 26%, për vitin 2020 në masën 31% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 17%.

Taksë e fjetjes në hotel për vitin 2018 realizuar në masën 89%, në vitin 2019 në masën 45% për vitin 2020 në masën 28% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 9 %.

Për këtë taksë nuk ka një metodologji llogaritjeje. Nivele tejet të ulta realizimi.

Taksë e zënies së hapësirave publike për vitin 2018 realizuar në masën 74%, në vitin 2019 në masën 41%, për vitin 2020 në masën 39% dhe në 6-mujorin e I të vitit 2021 në masën 67 %.

Nga krahasimi i të dhënave të akt-rakordimit të DDTV me DBKF dhe aktrakordimin me Degën e Thesarit rezulton se për disa taksa dhe tarifa si Taksë table dhe reklame, Taksë e fjetjes në hotel, Taksë truall dhe Tarifë Tregu, nuk rakordojnë, pasi të dhënat nga DDTV nuk janë të sakta sepse evidentimi i taksave dhe tarifave vendore është mbajtur ekstra-kontabël.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore* i ndryshuar, neni 5 *ËParime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*, neni 54/c *ËRaportimi financiar*, Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018, Kreu IV *ËProcedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave* pika 200, udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër Sistemin e Taksave Lokale*, i ndryshuar dhe ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*, me ndryshime.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave si dhe mbajtja e një pjesë të taksave dhe tarifave që menaxhohen nga DDTV jashtë kontabilitetit.

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mos njohje e situatës nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë hartimit të projektplanit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale duke analizuar rezultatet dhe pritshmëritë, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë ndjekjen dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Drejtorisë së Buxhetit, Kontabilitetit dhe Financës.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. O. B me detyrë Drejtor i DDTV dhe znj. K. Q me detyrë specialiste e marrëdhënieve me Degën e Thesarit për Regjistrimin e të Ardhurave në Sektorin e Buxhetit, në Drejtorinë Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar:

-**Niveli i lartë i debitorëve.** Në bazë të punimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, rezultoi se ka një sasi të konsiderueshme debitorësh nga biznesi, (aktualisht 3984) të cilët nuk mund të paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, por do të bashkëlidhen materialit në formë dixhitale, me CD.

Niveli i lartë i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, truall, reklame, zënie hapësirë publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarife veterinarie e kamatëvonesë), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitet 2018** numri i debitorëve është 4455 subjekte në vlerën prej **287,771,902 lekë**, në fund të **vitet**

2019 numri i debitorëve është 4783 subjekte në vlerën prej 324,901,227 lekë në fund të vitit 2020 numri i debitorëve është 5142 subjekte në vlerën prej 376,873,175 lekë dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2021, numri i debitorëve është 3984 në vlerën 315,203,292 lekë.

Vlera progresive në fund të 6-mujorit të I të vitit 2021, prej 315,203,292 lekë, përfaqëson taksat dhe tarifatat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Vihet re se ka një numër në rënie të subjekteve debitore nga viti 2020 dhe arkëtimi në vlerën 61,670 mijë lekë nga debia, por nga strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Taksave duhet të vazhdojë puna për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve.

Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelën e mëposhtme:

LLOJI I BIZNESIT	Në datën 31.12.2018		Në datën 31.12.2019		Në datën 31.12.2020		Në datën 31.06.2021	
	NR	VLERE	NR	VLERE	NR	VLERE	NR	VLERE
Biznes i Madh	676	107,195,197	693	123,833,774	719	127,062,325	546	98,264,586
Biznes i Vogel	3,680	173,396,593	3,966	189,701,743	4218	232,943,588	3277	204,394,223
Individ	99	7,180,112	124	11,365,710	205	16,867,262	161	12,544,483
TOTALI	4,455	287,771,902	4,783	324,901,227	5142	376,873,175	3984	315,203,292

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë

Vlera e debitorëve e paraqitur e ndarë në vlerë principali plus kamatëvonesë e përllogaritur (0,06 % për çdo ditë vonesë) dhe numrit të subjekteve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NE VITE	NR TOTAL	PRINCIPAL	KAMATE/VONESE	TOTALI DEBI
TOTAL DEBI 31.12.2018	4455	280,057,711	7,714,191	287,771,902
TOTAL DEBI 31.12.2019	4783	317,486,422	10,276,422	324,901,227
TOTAL DEBI 30.12.2020	5142	352,337,569	24,535,606	376,873,175
TOTAL DEBI 30.06.2021	3984	296,096,081	19,107,211	315,203,292

Numri i subjekteve dhe vlera e debitorëve gjendje në fund të vitit ushtrimor e ndarë sipas NJA paraqitet në tabelën e mëposhtme:

SIPAS NJESIVE ADMIN.	Deri me 31.12. 2018		Deri me 31.12. 2019		Deri me 31.12. 2020		Deri me 30.06. 2021	
	NR Subjektev e debitore	VLERE	NR Subjekte ve debitore	VLERE	NR Subjekteve debitore	VLERE	NR Subjekte ve debitore	VLERE
QYTETI VLORE	3952	259,042,646	4295	286,037,724	4652	328,566,564	3626	274,067,579
NOVOSELE	155	7,802,119	113	14,810,032	110	16,679,892	73	14,532,880
ORIKUM	226	16,952,186	236	19,471,735	221	22,222,476	169	18,390,266
QENDER	79	2,281,092	89	2,707,182	116	7,196,788	82	6,456,927
SHUSHICE	43	1,693,859	50	1,874,554	43	2,207,455	34	1,755,640
BASHKIA VLORE	4455	287,771,902	4783	324,901,227	5142	376,873,175	3984	315,203,292

Debitorët të rezultuar brenda vitit ushtrimor të ndarë sipas llojeve të taksave të mësipërme për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6-mujori i parë i vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

EMERTIMI I ZERIT	Brenda vitit 2018		Brenda vitit 2019		Brenda vitit 2020		Brenda 6-mujorit te pare viti 2021	
	NR	VLERE (leke)	NR	VLERE (leke)	NR	VLERE (leke)	NR	VLERE (leke)
TAKSE PASURIE (Ndërtese)	1950	24,258,170	754	18,839,001	747	12,976,257	1309	26,771,155
TAKSE TABELLE	23	487,122	7	168,000	5	231,000	50	1,155,675
TARIFE PASTRIM,NDRICIM,GJELBERIM	1151	15,181,598	888	12,117,558	1065	13,072,792	1773	25,021,999
TAKSE FJ.HOTEL	180	4,384,100	60	6,075,300	33	2,299,570	50	5,709,060

TAKSE TRUALLI	71	1,614,460	63	1,256,599	62	923,637	122	3,229,622
TAKSE REKLAME	8	187,500	4	140,625	5	343,311	48	19,268,625
TARIFE ZENIE HAPESIRE PUBLIKE	159	16,937,060	95	7,735,500	76	5,260,880	277	21,020,685
TARIFE VETERINARIE	29	262,083	66	891,366	1	195,450	3	174,850
KAMATEVONESE	1664	6,662,492	1,358	5,816,741	1217	12,539,899	1343	4,029,187
TOKE BUJQESORE NGA BIZNESI (faturim per taksim mbi pasuritë e sekuestruara të pavjelura nga Bankat)					0	-	1	240
TARIFË KARABURUN-SAZAN					11	4,929,800	9	598,350
Debi brenda vitit ushtrimor	2598	69,974,586	2,103	53,040,691		52,772,596		106,979,448
Debi ne exel				271,860,536				
Debi para vitit ushtrimor që nga viti 2011		217,797,316				324,100,579		208,223,844
TOTAL DEBI	4455	287,771,902	4783	324,901,227	5142	376,873,175	3984	315,203,292

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë

Referuar tabelës së mësipërme dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV, konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në momentin e krijimit të tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018 duke filluar nga viti 2011, janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektsh debitorë me shumë progresive të debisë deri në fund të 2017, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Kjo listë megjithëse është mbajtur në programin excel nuk përbën dokument vërtetues, sipas përcaktimeve në UMF 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre në njësitë e sektorit publikò. Megjithëse e mbajtur jashtë kontabilitetit lista e detyrimeve debitorë nuk është e printuar, e nënshkruar nga personat përgjegjës dhe e volusor, e inventarizuar dhe arkivuar, duke lenë shteg për abuzim.

Në lidhje me këtë veprim, referuar edhe materialeve të KLSH-së, specialistja e kontabilitetit tatimor me shkresën nr. 646 prot., datë 05.02.2020 për listën e debitorëve i është drejtuar specialisteve të pranimit dhe shkresën nr. 338 prot., datë 18.08.2020, ka dërguar listën e debitorëve prej vitit 2011-2018 specialistit të IT-së për tu hedhur në sistemin TAIS.

Për kryerjen e këtyre veprimeve si nga specialistet e pranimit ashtu edhe nga specialisti i IT, nuk është marrë asnjë masë dhe konstatohet se kjo listë nuk është azhurnuar ende në sistemin TAIS.

Gjatë periudhës 6-mujori i I, i vitit 2021, shihet qartë se është reflektuar ulje e numrit të subjekteve debitorë dhe është ulur edhe vlera e debisë për debitorët e kontabilizuar deri në datën 31.12.2020.

-Menaxhimi borxhit nga taksat e tarifave vendore. Auditimi i rasteve në lidhje me zbatimin e masave shtrënguese për arkëtimin e borxhit ndaj subjekteve debitorë.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, dhe nga përpunimi i tyre, rezultoi se:

Për vitin 2018, janë bërë 1195 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 1107 njoftime për vendosje të masave siguroese, si dhe me nga 1084 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 186 masa ekzekutuese (kalim gjendje llog, bankare në llog. Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit prej 71,930,608 lekë nga 262,915,098 lekë vlera e debisë në fund të vitit 2017 për 4247 subjekte. Nga këto janë kryer procedurat ligjore për 3473 subjekte me vlerë totale të debisë prej 256,717,956 leke (subjekte me vlerë deri në 1000), duke lenë pa u kryer procedura për 774 subjekte me vlerë totale të debisë 6,197,142 lekë (subjekte me vlerë nën1000 lekë)

Për vitin 2019, janë bërë 1192 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 968 njoftime për vendosje të masave siguroese, si dhe me nga 968 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 119 masa ekzekutuese (kalim gjendje llog, bankare në llog. Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit prej 55.803.000 lekë nga 287.771.902 lekë vlera e debisë në fund

të vitit 2018 për 4458 subjekte. Nga këto janë kryer procedurat ligjore për 3668 subjekte me vlerë totale të debisë prej 281,588,283 leke (subjekte me vlere deri ne1000), duke lenë pa u kryer procedura për790 subjekte me vlere totale të debisë 6,183,619 lekë (subjekte me vlere nen 1000 leke)

Për vitin 2020, janë bërë 872 njoftim kërkesë për pagese të debisë dhe 587 njoftime për vendosje të masave siguroese, $873 + 437 + 452 + 587 = 2319$ masa shtrënguese ne Banke, Zvrpp, Ksha dhe Qkb, si dhe 163 masa ekzekutuese (kalim shume nga gj.llog. se biznesit në llog. të Bashkisë) me efekt në mbledhjen e borxhit në shumën prej 62,129,000 lekë nga 324,901,227 lekë vlere totale e debisë ne fund te vitit 2019, për 4783 subjekte debitore.

Nga 4783 subjekte janë kryer procedurat ligjore për 3025 subjekte me vlerë totale të debisë prej 318,410,247 lekë (janë subjekte debitore me vlerë deri ne 1000 lekë), ndërsa për 1167 subjekte me vlerë totale të debisë prej 6,490,980 lekë, nuk janë kryer procedurat e borxhit (subjekte me vlerë nën 1000 lekë)

Per vitin 6 - mujorin e I të vitit 2021 janë bërë 1172 njoftim kërkesë për pagesë te debisë dhe 630 njoftime për vendosje te masave siguroese, $680 + 630 = 1310$ masa shtrënguese në Bankë dhe Qkb, si dhe 79 masa ekzekutuese (kalim shume nga gj. llog. se biznesit në llog. të Bashkisë), procedura që kanë dhënë efekt në mbledhjen e borxhit në shumën prej 61,669,883lekë nga 376,873,175 lekë vlere totale e debisë në fund të vitit 2020, për 5142 subjekte debitore.

Nga 5142 subjekte janë kryer procedurat ligjore për 4119 subjekte me vlerë totale të debisë prej 369,891,553 lekë (janë subjekte debitore me vlerë deri në 3000 lekë, procedure që është programuar për tu ndjekur me tej deri në shumën 1000 lekë) ndërsa për 819 subjekte me vlerë totale të debisë prej 6,385,824 lekë nuk janë kryer procedurat e borxhit (janë subjekte me vlerë nen 1000 lekë).

-Praktika e vendosjes se masave shtrënguese në **Ashk (Zrpp)** dhe **Rbs** (ne vend te Ksha) për vitin 2020 dhe 2021 nuk është realizuar për shkak të mos ofrimit të shërbimit pa pagesë nga ana e këtyre institucioneve, për çdo masë siguroese të kërkuar nga Bashkia Vlorë. Për këtë problem është kërkuar nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore për planifikimin e një fondi për te mbuluar tarifat e shërbimit për vendosje te barreve siguroese nga ana e **Ashk** dhe **Rbs**.

Duke vlerësuar riskun e praktikave të menaxhimit të borxhit u përzgjedhën disa raste për auditimin e procedurave që janë kryer, për ndjekjen dhe procedurat e arkëtimit të borxhit në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në RSHò, me ndryshime, nga ku rezultoi se:

- Për Institucionet shtetërore, të identifikuar si debitorë është ndjekur vetëm procedura e nxjerrjes së Njoftimit për Pagesë të DetyrimeveTatimore dhe nuk është vazhduar me asnjë procedurë tjetër.

- Nga dosjet e zgjedhura për auditim, nuk gjen zbatim ndryshimi ligjor i nenit 89 i ligjit të procedurave tatimore, ku thuhet se; ò *Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesitò.*

-Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore strukturat e DTTV Bashkia Vlorë, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, me ndryshime, Kreut XI òMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguaraò neni 93 dhe 94 Gjithashtu nga DTTV për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlere të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal**bazuar në nenin 181 òMos pagimi i taksave dhe tatimeveò, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i

ndryshuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. Ligj nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 òPër sistemin e taksave vendoreò,

Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z.O. B me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Titulli i gjetjes: Evidentimi i nivelit të detyrimeve debitore dhe kontabilizimet.

Situata:Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV, konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në momentin e krijimit të tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018 duke filluar nga viti 2011, janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektsh debitore me shumë progresive të debisë deri në fund të 2017, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Kjo listë megjithëse është mbajtur në programin excel nuk përbën dokument vërtetues, sipas përcaktimeve në UMF 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre në njësitë e sektorit publikò. Megjithëse e mbajtur jashtë kontabilitetit lista e detyrimeve debitore nuk është e printuar, e nënshkruar nga personat përgjegjës dhe e volusor, e inventarizuar dhe arkivuar, duke lenë shteg për abuzim.

Në lidhje me këtë veprim, referuar edhe materialeve të KLSH-së, specialistja e kontabilitetit tatimor me shkresën nr. 646 prot., datë 05.02.2020 për listën e debitorëve i është drejtuar specialisteve të pranimit dhe shkresën nr. 338 prot., datë 18.08.2020, ka dërguar listën e debitorëve prej vitit 2011-2018 specialistit të IT-së për tu hedhur në sistemin TAIS.

Për kryerjen e këtyre veprimeve si nga specialistët e pranimit ashtu edhe nga specialisti i IT, nuk është marrë asnjë masë dhe konstatohet se kjo listë nuk është azhurnuar ende në sistemin TAIS.

Gjatë periudhës 6-mujori i I, i vitit 2021, shihet qartë se është reflektuar ulje e numrit të subjekteve debitorë dhe është ulur edhe vlera e debisë për debitorët e kontabilizuar deri në datën 31.12.2020.

Kriteri:UMF 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre në njësitë e sektorit publikò.

Ndikimi/Efekti:Mos evidentim i saktë i detyrimeve debitore

Shkaku: Mos marrja e masave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim:Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me specialistin e IT, specialistet e pranimit dhe kontabilitetit, të marrë masa për evidentimin, pasqyrimin dhe azhurnimin në sistemin TAIS të subjekteve debitore për vitet 2011-2018.

Titulli i gjetjes: Evidentimi dhe vlerësimi i nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor.

Situata:Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, rezultoi se ka një sasi të konsiderueshme debitorësh nga biznesi, (aktualisht 3984).

Niveli i lartë i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësirë publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarife veterinarie e kamatëvonesë), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitit 2018 numri i debitorëve është 4455 subjekte në vlerën prej 287,771,902 lekë, në fund të vitit 2019 numri i debitorëve është 4783 subjekte në vlerën prej 324,901,227 lekë në fund të vitit 2020 numri i debitorëve është 5142 subjekte në vlerën prej 376,873,175 lekë dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2021, numri i debitorëve është 3984 në vlerën 315,203,292 lekë.

Vlera progresive në fund të 6-mujorit të I të vitit 2021, prej 315,203,292 lekë, përfaqëson

taksat dhe tarifate vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Vihet re se ka një numër në rënie të subjekteve debitore nga viti 2020 dhe arkëtimi në vlerën 61,670 mijë lekë nga debia, por nga strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Taksave duhet të vazhdojë puna për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve.

Nga Sektori i Borxhit **për vitin 2018** janë bërë 1195 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 1107 njoftime për vendosje të masave siguruese, 1084 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 186 masa ekzekutuese (kalim gjendje llog, bankare në llog. Bashkisë). **Për vitin 2019** janë bërë 1192 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 968 njoftime për vendosje të masave siguruese, 968 masa shtrënguese e 119 masa ekzekutuese. **Për vitin 2020** janë bërë 872 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 587 njoftime për vendosje të masave siguruese, 2319 masa shtrënguese në Banke, Zvrpp, Ksha dhe Qkb, si dhe 163 masa ekzekutuese. **Për 6 - mujorin e I të vitit 2021** janë bërë 1172 njoftim kërkesë për pagesë të debisë dhe 630 njoftime për vendosje të masave siguruese, 1310 masa shtrënguese në Bankë dhe Qkb, si edhe 79 masa ekzekutuese.

Nga DTTV për subjektet debitore në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50% e qarkullimit të realizuar ditore si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk ka Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite.

Kriteri: Ligji nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore* i ndryshuar neni 9, pika 1. 3, neni 35, ligji nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimore*, me ndryshime, Kreu XI, *ËMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara* në nenin 93 dhe 94, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme

Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara nga subjektet fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **3984 subjekteve në vlerën 315,203,292 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 *ËE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *ËPër Procedurat tatimore* me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *ËPër procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë* me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, DPTTV të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana DTTV dhe Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, *ËMospagimi i taksave dhe tatimeve*.

Prendimi i subjektit: *Me observacionin e datës 02.02.2022, specialistët e borxhit z. F. Ll. dhe znj. Xh. K. pretendojnë se nuk mund të kryejnë procedurën e mbledhjes së borxhit referuar nenin 89, pika 2 të ligjit për procedurat tatimore, pasi mbledhja e borxhit përbëhet nga 12 kategori, nga të cilat vetëm 3 nuk janë kryer si: monitorimi i biznesit në terren për konfiskim të xhiros në masën 50%, urdhër sekuestro ndaj pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe konfiskim të pasurive. Për përmbushjen e detyrimeve ligjore unë si inspektor borxhi kam paraqitur disa herë*

kërkesë drejtorit O. B., për shtim numër punonjësish të paktën me 3 punonjës dhe kjo nuk është bërë e mundur.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa i takon zbatimin të masave të mbledhjes me forcë të taksave dhe tarifave të debitorëve është detyrim ligjor, po ashtu edhe të gjithë tatimpaguesit që nuk paguajnë detyrimet janë objekt i kallëzimit penal, pavarësisht nëse kanë aftësi paguese apo jo përderisa nuk ka një klasifikim të tillë në bazë verifikimi. Ndërsa çështja e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore për përballimin e punës mbledhjene borxhit është çështje e organizimit të brendshëm të DTTV dhe e menaxhimit të lartë të Bashkisë.

-Analiza e disa zërave kryesore të detyrimeve fiskale (taksa/ tarifa vendore):

Taksa e ndërtesës për vitin 2018 është realizuar në shumën 125,255 mijë lekë nga 144,523 mijë lekë të planifikuara ose në masën 87%, për vitin 2019 është realizuar në shumën 179,757 mijë lekë nga 244,888 mijë lekë të planifikuara ose në masën 73%, për vitin 2020 është realizuar 116.645 mijë lekë nga 244,045 mijë lekë të planifikuara ose 48% dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 është realizuar në shumën 104,914 mijë lekë nga 165,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 64%,

Nga subjektet private për vitin 2018 është realizuar në shumën 68,360 mijë lekë nga 100,340 mijë lekë të planifikuara ose në masën 68%, për vitin 2019 është realizuar në shumën 70,165 mijë lekë nga 107,887 mijë lekë të planifikuara ose në masën 65%, për vitin 2020 është realizuar në shumën 60,980 mijë lekë nga 107,043 mijë lekë të planifikuara ose në masën 57% dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 është realizuar në shumën 54,699 mijë lekë nga 77,318 mijë lekë të planifikuara ose në masën 71%.

-Për një pjesë të subjekteve konstatohet se dokumentacioni mbështetës mbi llogaritjen e kësaj takse nuk është i saktë, kjo pasi është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve, të sipërfaqeve të ndërtesave, duke mos marrë informacion nga ish- ZVRP Vlorë (sot ASHK) dhe/ ose kryerjen e verifikimeve në terren me grup pune, në lidhje me sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, për të mundur taksimin e saktë të kësaj takse dhe afër realitetit. Kështu psh: Rajoni nr.5 ka 73 subjekte me vetëdeklarime apo Rajoni nr. 4 ka 69 subjekte me vetë-deklarime. Në këto raste nuk janë kryer verifikime në terren nëse vetëdeklarimi është real për përcaktimin e saktë të sipërfaqeve si bazë e taksueshme për ngarkesën me taksën e ndërtesës, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 132, datë 7.3.2018 òPër metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme òndërtesaö, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksësö neni 2, neni 3.

Për taksën e ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët

Bashkia Vlorë, mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet Agjentit Tatimor që në rastin konkret është UK Sha Vlorë, më të cilin nuk ka lidhur akt-marrëveshje me këtë Shoqëri në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreö, i ndryshuar neni 35 pika 2 e cila përcakton: òTarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcakton nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga një agjent. Në rastin e agjentit, këshilli vendos rregullat bazë kufizuese në raport me agjentin, ndërsa kryetari i bashkisë bën përzgjedhjen e agjentit, si dhe lidh kontratë me të ò

Në bazë të VKB nr. 100, datë 22.12.2017, Kreu V òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorëöpika 2 òTaksa mbi pasurinë e paluajtshmeö, në të cilën përcaktohet se: ò Për pikat a/1, a/2, a/5 (taksat mbi ndërtesat e banimit), do të arkëtohen nga Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sha, Vlorë, duke e vendosur në faturën e ujit të ndare ne

mënyre te barabarte për çdo muaj te vitit ushtrimor. Në mbledhjen e kësaj takse, kjo ndërmarrje do të luaj rolin e agjentit tatimor duke përfituar 1% të shumës së arkëtuar.

- Ne Njësitë Administrative, për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do te faturohet dhe do te mblidhet nga Shoqëria "Ujësjellës - Kanalizime" sha Vlorë

- Administratoret e Njësive Administrative, se bashku me Kryetarin e Fshatit te evidentojnë familjet qe nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjellësit. Listat e përditësuara do te dorëzohen pranë Drejtorisë se Menaxhimit Financiar, Bashkia Vlore".

Në zbatim të VKB-së nr. 88, datë 24.12.2020 oPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë, i ndryshuar është miratuar:

Taksa e ndërtesës: Për ndërtesat e banimit, mbas krijimit të regjistrave apo datebaze për këtë zë, llogaritja e detyrimit do të kryhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, e cila do përcillet me shkresë përcjellëse në SHA oUjësjellës Kanalizime Vlorë për faturim dhe arkëtim të vlerave, kjo e fundit në rolin e Agjentit Tatimorë, duke përfituar 3% të shumës së arkëtuar. Mënyra e mbledhjes së kësaj takse do të bëhet, duke vendosur detyrimin në faturën e ujit te ndare ne mënyre te barabarte për çdo muaj te vitit kalendarik.

Deri në momentin e krijimit të një regjistri nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me të dhënat për objektet që shfrytëzohen për banim, faturimi dhe arkëtimi i kësaj takse, do vijojë të bëhet nga Shoqëria oUjësjellës - Kanalizimeo sh.a, Vlorë, në bazë të një Akt-marrëveshje të lidhur mes kryetarit të bashkisë Vlorë dhe drejtorit të oUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë.

Për Njësitë Administrative të bashkisë, Administratorët e Njësive së bashku me Kryetarin e Fshatit, të evidentojnë familjet qe nuk janë te lidhur me rrjetin eUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë. Për banesat te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës do të faturohet dhe do të mblidhet nga Shoqëria oUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë, në rolin e agjentit tatimor, duke përfituar 3% të shumës së arkëtuar, mënyra të cilat do përcaktohen në akt-marrëveshjen e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe SHA oUjësjellës kanalizimö Vlorë.

Listat e përditësuara për objektet që shfrytëzohen për banim, do të dorëzohen pranë Drejtorisë se Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë, me qëllim krijimin e regjistrit për rakordim në lidhje me arkëtimin e kësaj takse.

Tarifa e pastrimit: Ngarkohet për faturimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, Shoqëria oUjësjellës ó Kanalizimeo sha Vlorë, duke e vendosur ne faturën e ujit dhe te ndare ne mënyre te barabarte për çdo muaj te vitit kalendarik. Kjo ndërmarrje do të luaje rolin e agjentit tatimor, duke përfituar 3% të shumës së arkëtuar.

Mënyra e mbledhjes së kësaj takse do të bëhet, duke vendosur detyrimin në faturën e ujit të ndarë në mënyrë të barabartë për çdo muaj të vitit kalendarik.

Deri në momentin e krijimit të një regjistri nga DTTV me të dhënat për objektet që shfrytëzohen për banim, faturimi dhe arkëtimi i kësaj takse, do vijojë të bëhet nga Shoqëria oUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë, në bazë të një Akt-marrëveshje të lidhur mes kryetarit të bashkisë Vlorë dhe drejtorit të oUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë.

Për njësitë Administrative të bashkisë, Administratorët e Njësive së bashku me Kryetarin e Fshatit, të evidentojnë familjet qe nuk janë te lidhur me rrjetin eUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë. Për familjet te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, kjo tarifë do të faturohet dhe do të mblidhet nga Shoqëria oUjësjellës ó Kanalizimeo sh.a, Vlorë, në rolin e agjentit tatimor, duke përfituar 3% të shumës së arkëtuar, modalitet të cilat do përcaktohen në akt-marrëveshjen e lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe SHA oUjësjellës kanalizimö Vlorë.

Listat e përditësuara për objektet që shfrytëzohen për banim, do të dorëzohen pranë Drejtorisë se Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë, me qëllim krijimin e regjistrit për rakordim në lidhje me arkëtimin e kësaj takse.

-Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Vlorë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se cilat viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe numrin e familjeve që janë të përjashtuara nga pagesa e këtyre taksave, nuk

plotësohet njoftim detyrimi për familje, taksës së ndërtesës, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi. Në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore është ngritur Sektori i Taksës së Pasurisë, i cili do të merret me krijimin e regjistrit të familjeve. Faturimi dhe realizimi i taksës së ndërtesës dhe tarifës pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët për periudhën 2018-2019-2020 dhe 6-mujori i vitit 2021 sipas akt-rakordimeve mes Bashkisë Vlorë dhe Agjentit Tatimor UK sha Vlorë paraqitet në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Referuar akt-rakordimeve të Bashkisë Vlorë me UK sha Vlorë, rezulton se **për vitin 2018**, është arkëtuar nga UK sha Vlorë më tepër në vlerën 5,886,279 lekë për efekt derdhje 2 herë të të njëjtit muaj, po kështu dhe **për vitin 2019**, në vlerën 2,916,792 lekë, për vitin 2020 është arkëtuar nga UK sha vlera 92,710,549 lekë, ndërsa në fund të **6-mujorit të I, të vitit 2021** nga UK sha Vlorë është arkëtuar vlera 87,926,447 lekë.

Debitorë përtaksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit

Përvitin 2018, janë debitorë 13 096 familje në vlerën 63,216,781 lekë e ndarë për taksë ndërtesë në vlerën 43,270,922 lekë dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim në vlerën 19,945,859 lekë.

Për vitin 2019, janë debitorë 13649 familje në vlerën 41,211,599 lekë e ndarë për taksë ndërtesë në vlerën 25,070,808 lekë dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim në vlerën 16,140,791 lekë.

Për vitin 2020, janë debitorë 10 096 familje në vlerën 56,671,371 lekë, e ndarë për taksë ndërtesë në vlerën 23, 592, 844 lekë dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim në vlerën 33, 078, 527 lekë.

Për 6- mujorin I 2021, janë debitorë 14 363 familje në vlerën 35, 896, 586 lekë e ndarë për taksë ndërtesë në vlerën 17, 947, 963 lekë dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim në vlerën 17, 948,623 lekë.

-Numri i banesave familjare për Bashkinë e Vlorës së bashku me Njësitë Administrative nga të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Vlorë dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë faturuar si dhe numri i familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Vlorë, paraqiten në pasqyrën si mëposhtë:

Zona	Viti 2018				Viti 2019				Viti 2020				6-mujori I parë vitit 2021			
	Nr familje sipas Gj.Civil e	Nr kontratete perja shtuar nga taksat	Nr kontratete faturuar	Mbetja pa kontratete edhe pa faturuar	Nr familje sipas Gj.Civil e	Nr kontratete perja shtuar nga taksat	Nr I kontratete faturuar	Mbetja pa kontratete edhe pa faturuar	Nr I familje sipas Gj.Civil e	Nr kontratete perja shtuar nga taksat	Nr kontratete faturuar	Mbetja pa kontratete edhe pa faturuar	Nr familje sipas Gj.Civil e	Nr kontratete perja shtuar nga taksat	Nr kontratete faturuar	Mbetja pa kontratete edhe pa faturuar
Bashki Vlore	46370	6514	38837	1019	46370	8708	37049	613	48751	8709	37518	2524	49769	10072	36638	3059
Orikum	3506	239	1391	1876	3506	282	1354	1870	3654	256	1386	2012	3720	326	1424	1970
Novosel e	4669	93	1994	2582	4669	243	1847	2579	4868	241	1854	2773	4928	301	1795	2832
Qender	5073	52	823	4198	5073	100	785	4188	5294	89	795	4410	5317	131	753	4433
Shushice	2748	37	444	2267	2748	84	404	2260	2917	80	411	2426	2974	103	389	2482
Shuma	62366	6935	43489	11942	62366	9417	41439	11510	65484	9375	41964	14145	66708	10933	40999	14776

Shume nga familjet ne Njesite Administrative nuk kane kontrate me SHA UK Vlore pasi nuk ka lidhje me rrjetin e SHA UK Vlore dhe furnizohen me puse.

Sipas miratimeve të buxheteve për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga **Taksa e ndërtesës dhe Tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit** për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësite Administrative së bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjetellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Vlera e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët pa kontratë me UK sha sipas paketave fiskale të përcaktuara për njësitë administrative dhe familjet pa kontratë, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NJA	Periudha 01.04.2018-31.12.2018	Viti 2019	Viti 2020 VKB 109/2019	Viti 2021 per 6 muaj sipas VKB nr.88, date 24.12.2020
-----	--------------------------------	-----------	------------------------	---

	Taksat e ndërtës sipas VKB nr.84	Tarifet e pastrimit sipas VKB nr.100	Shuma	Shuma	Nr familje pa kontratë	Vlera	ndërt + pastrimi	Nr familje pa kontratë	Vlera	ndërt + pastrimi	Nr familje pa kontratë	Vlera	Taksat e ndërtës	Tarifet e pastrimit ndërtës	Nr familje pa kontratë	Vlera	
			Ndërt + pastrimi	ndërtës pastrimi për 8 muaj													
Vlore	3,100	1,800	4,900	3,266			4,900	3801	18,624,900	6,400	2,524	16,153,600	3,100	3,300	5,500	1,750	9,625,000
Orikum	2,200	1,800	4,000	2,667	1490	3,973,830	4,000	1817	7,268,000	4,600	2,012	9,255,200	2,200	2,400	4,000	985	3,940,000
Novoselle	1,500	1,200	2,700	1,800	2441	4,393,800	2,700	2459	6,639,300	2,700	2,773	7,487,100	1,500	1,200	2,700	1,420	3,834,000
Qendër	1,500	1,200	2,700	1,800	4126	7,426,800	2,700	4135	11,164,500	2,700	4,410	11,907,000	1,500	1,200	2,700	2,216	5,983,200
Shushicë	1500	1200	2700	1800	2212	3981600	2700	2260	6102000	2700	2426	6,550,200	1500	1200	2700	1241	3,350,700
					10269	19776030		14472	49798700		14145	51,353,100				7612	26,732,900
Tarifet e pastrimit+gjelbërimit+ndërtës 4muaj Orikum					1490	894000											
Tarifet e pastrimit+gjelbërimit+ndërtës 4muaj 3NJA etj					8779	3511600											
				Shuma	10269	24181630		14472	49798700		14145	51,353,100				7612	26,732,900
Taksat e ndërtës						10,964,830			29,061,500			26,664,300					14,907,500
Tarifet e pastrimit+gjelbërimit+ndërtës						13,216,800			20,737,200			24,688,800					11,825,400
TOTAL									148,587,530								
Taksat e ndërtës									14,598,130								
Tarifet e pastrimit+gjelbërimit+ndërtës									66,989,400								

Nga përllogaritjet për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, **detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtësës dhe tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës**, rezulton **në vlerën 148,587,530 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë** ndarë në taksë ndërtës në vlerën **81,598,130 lekë** dhe tarifë pastrimit-gjelbërimit-ndërtës në vlerën **66,989,400 lekë**.

Sipas viteve familje pa kontratë që nuk kanë kryer pagesa:

Për vitin 2018, nuk kanë paguar **10 269** familje pa kontratë në vlerën **24,181,630 lekë** e ndarë për taksë ndërtës vlera prej 10,964,830 lekë dhe **tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës** në vlerën **13,216,800 lekë**.

Për vitin 2019, nuk kanë paguar **14 472** familje pa kontratë në vlerën **49,798,700 lekë** e ndarë për taksë ndërtës vlera prej 29,061,500 lekë dhe **tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës** në vlerën prej 20,737,200 lekë.

Për vitin 2020, nuk kanë paguar **14 145** familje pa kontratë në vlerën **51,353,100 lekë** e ndarë për taksë ndërtës vlera prej 26,664,300 lekë dhe **tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës** në vlerën 24,688,800 lekë.

Për 6-mujorin e I-rë viti 2021, nuk kanë paguar **7612** familje pa kontratë në vlerën **26,732,900 lekë**, e ndarë për taksë ndërtës vlera prej 14,907,500 lekë dhe **tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës** në vlerën 11,825,400 lekë.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për Sistemin e Taksave Vendore të ndryshuar, neni 4, pika 7 dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 70, me VKB nr.100, datë 22.12.2017 i ndryshuar, VKB nr. 45, datë 26.04.2018 pikat 6 dhe 8 dhe VKB nr.109, datë 23.11.2019 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë pika 2 nën pika 7.

Titulli i gjetjes: Procedurat për arkëtimin e taksës së ndërtësës dhe tarifës së pastrimit-gjelbërimit-ndërtës nga abonentët familjar, mosndjekja nga Agjenti tatimor UK dhe debitorët nga lënia jashtë skemës së taksimit të abonentëve familjar pa kontrata me ujësjellës.

Situata: Nga përllogaritjet për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, **detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar për taksën e ndërtësës dhe tarifën e pastrimit-gjelbërimit-ndërtës**, rezulton **në vlerën 148,587,530 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë** ndarë në taksë ndërtës në

vlerën **81,598,130 lekë** dhe tarifë pastrim-gjellërim-ndriçimi në vlerën **66,989,400 lekë**.

Sipas viteve familje pa kontratë që nuk kanë kryer pagesa:

Për vitin 2018, nuk kanë paguar **10 269** familje pa kontratë në vlerën **24,181,630 lekë** e ndarë për taksë ndërtese vlera 10,964,830 lekë dhe tarifën e pastrim-gjellërim-ndriçimit në vlerën **13,216,800 lekë**.

Për vitin 2019, nuk kanë paguar **14 472** familje pa kontratë në vlerën **49,798,700 lekë** e ndarë për taksë ndërtese vlera prej 29,061,500 lekë dhe tarifën e pastrim-gjellërim-ndriçimit në vlerën prej 20,737,200 lekë.

Për vitin 2020, nuk kanë paguar **14 145** familje pa kontratë në vlerën **51,353,100 lekë** e ndarë për taksë ndërtese vlera 26,664,300 lekë dhe tarifën e pastrim-gjellërim-ndriçimit në vlerën 24,688,800 lekë.

Për 6-mujorin e I-rë viti 2021, nuk kanë paguar **7612** familje pa kontratë në vlerën **26,732,900 lekë**, e ndarë për taksë ndërtese vlera prej 14,907,500 lekë dhe tarifën e pastrim-gjellërim-ndriçimit në vlerën 11,825,400 lekë.

Debitorë përtaksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit

Përvitin 2018, janë debitorë 13 096 familje në vlerën **63,216,781 lekë** e ndarë për taksë ndërtese në vlerën **43,270,922 lekë** dhe tarifë pastrim-gjellërim-ndriçim në vlerën 19,945,859 lekë.

Për vitin 2019, janë debitorë 13649 familje në vlerën **41,211,599 lekë** e ndarë për taksë ndërtese në vlerën **25,070,808 lekë** dhe tarifë pastrim-gjellërim-ndriçim në vlerën 16,140,791 lekë.

Për vitin 2020, janë debitorë 10 096 familje në vlerën **56,671,371 lekë**, e ndarë për taksë ndërtese në vlerën **23, 592, 844 lekë** dhe tarifë pastrim-gjellërim-ndriçim në vlerën 33, 078, 527 lekë.

Për 6- mujorin I 2021, janë debitorë 14 363 familje në vlerën **35, 896, 586 lekë** e ndarë për taksë ndërtese në vlerën **17, 947, 963 lekë** dhe tarifë pastrim-gjellërim-ndriçim në vlerën 17, 948,623 lekë.

-Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Vlorë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe sa viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe numrin e familjeve që janë të përjashtuara nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, taksës së ndërtesës, tarifë pastrim-gjellërim-ndriçimi.

-Në lidhje me mosrealizimet e taksës e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjellërim-ndriçimit nga agjenti tatimor UK sha, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura

-Nga krahasimi i numrit të banesave familjare për Bashkinë e Vlorës së bashku me NJA sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke hequr numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë faturuar si dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjellërim-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësisve Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjiellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar, neni 4 pika 7, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 70 dhe 117, VKB nr. 100 datë 22.12.2017 i ndryshuar me VKB nr. 45, datë 26.04.2018 pika 6 dhe 8 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, pika 2 nën-pika 7.

Ndikimi/Efekti: Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Shkaku: Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore si dhe nga Bashkia Vlorë nuk është marrë masë për gjobitjen në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agjentit tatimor UK sha. Mungesa e të dhënave nga Administratorët e Rajoneve dhe Njësive Administrative, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të analizojë situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga UK SHA, Vlorë (në rolin e Agjentit tatimor), për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi nga abonentët familjarë dhe të nënshkruajnë një akt- marrëveshje me këtë shoqëri, me qëllim marrjen e përgjegjësisë ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, të marrin masa si dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **148,587,530 lekë**.

- Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të bashkëpunojë me UK sha, për arkëtimin e vlerës debitore prej **196,996,337 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor UK.sh.a.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Administratorët e Rajonit nr. 1 z. P. B. (vitet 2018-2019) dhe A. C. (viti 2020), Administratorët e Rajonit nr. 2 z. I. A. (viti 2018) dhe z. S. K. (viti 2019), z. A. L. me detyrë Administrator Rajoni nr. 3, znj. A. L. me detyrë Administrator Rajoni nr. 4, znj. B. C. me detyrë Administrator Rajoni nr. 5, znj. M. S. me detyrë Administratore në NJA Orikum (per vitet 2018-2019) dhe z. S. H. me detyrë Administrator në NJA Orikum(viti 2020), znj. M. K. me detyrë Administratore në NJA Qendër, z. K. SH. me detyrë Administrator në NJA Novoselë, z. B. A. me detyrë Administrator në NJA Shushicë dhe z. T. Z. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

-Mbi planifikimin, realizimin dhe procedurat e ndjekura për vjeljen taksës së tokës bujqësore.

Taksa e tokës bujqësore për vitin 2018 është realizuar në shumën 15,355 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 36%, për vitin 2019 është realizuar në shumën 11,118 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 26%, për vitin 2020 është realizuar në shumën 13,175 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 31% dhe për 6 mujorin I të vitit 2021, është realizuar në shumën 4,792 mijë lekë nga 28,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 17%.

Sipas të dhënave të Njesisë të Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike&Menaxhimi Aseteve rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 11070 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 15764 ha, të cilat të ndara sipas kategorisë së tokës dhe Njësive Administrative paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Numri i familjeve të trajtuara me tokë

Nr	Emërtimi	Nr. i fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë	Sipërfaqja e tokës së dhënë me qira	Nr. i familjeve të trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
1	Bashkia Vlore	3	434	-	1100
2	Nj. Adm. Shushice	9	2375	212.966	1960
3	Nj. Adm Qendër	11	5290	40.05	2886
4	Nj. Adm Orikum	5	2712	-	1896
5	Nj. Adm Novosel	12	4950	211.662	3228
	Shuma	40	15764	464,678	11070

Burimi: Drejtoria e Pronave Publike/Njësia e Menaxhimit të Tokës, Bashkia Vlorë

Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme, sipërfaqet e tokave bujqësore familjeve në disponim të familjeve fermere nga Sektori i Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, informacion i cili i dërgohet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se në mes të Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe NJA ka mosrakordime. Planifikimi për vitet 2018-2020 dhe 6-mujori parë i viti 2021 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Kategoria e tokës	Sip/HA Bashkia Vlorë	Sip/HA Nj.A. Qendër	Sip/HA Nj.A. Shushicë	Sip/HA Nj.A. Orikum	Sip/HA Nj.A. Novoselë	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II	-	-	-	-	-	-	-
Kategoria III	94	-	-	839	-	3600	3,358,800
Kategoria IV	-	-	2375	-	980	3200	10,736,000
Kategoria V	-	1226	-	-	1599	3000	8,475,000
Kategoria VI	-	3667	-	1873	1650	2400	17,256,000
Kategoria VII	340	397	-	-	-	1800	1,326,600
Kategoria VIII	-	-	-	-	724	1800	1,303,200
e.Totali sip.15764 ha sipas planifikimit	434	5290	2375	2712	4953	15764 ha	42,455,600
Sipas shkresës nr.1438/1 dt.12.03.2018 drejtuar Këshillit Qarkut Vlorë							
1. Fondi gjithsej i tokës	1176	5270	2845	2932.38	6524	18747.38	
a. Toke në pronësi shtetërore	200	357		88	654	1299	
b. Toke pronësi private	397.851	4004	2383	2089	5785	14658.851	
c. Tokë e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhënë në përdorim familjeve bujqësore	330.753	909	150	755.38		2145.133	
d.Siperf, e llogaritur qe duhet te ishte baze e taksës se tokës b+c	728.604	4913	2533	2844	5785	16803.984	
Diferenca e siperfaqes e pataksuar d-e	294	-377	158	132	832	1039	1,870,200

Burimi: Drejtoria e Pronave Publike/Njësia e Menaxhimit të Tokës, Bashkia Vlorë

Referuar korrespondencës zyrtare të Bashkisë Vlorë për sipërfaqet e tokave bujqësore dërguar Këshillit Qarkut Vlorë me shkresënr.1438/1, dt.12.03.2018, të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se, sipërfaqja e tokës bujqësore pronë private plus sipërfaqja e dhënë në përdorim sipas të dhënave të shkresës është më e lartë se baza e taksueshme e planifikuar me një sipërfaqe prej 1039 ha e shumëzuar me taksën për kategorinë VIII të tokës prej 1800 lekë/ha dhe me 4 vite, ka shkaktuar **të ardhur të munguar në vlerën (724x1800) 7,480,800 lekë**, për Bashkinë Vlorë. Këto veprime janë në pajtueshmëri me VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë.

Për vitet 2018, 2019,2020 dhe viti 2021 menaxhimi i taksës së tokës, ndjekja e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermerë të Qytetit Vlorë është kryer nga Specialistja e M. T. në Sektorin e Menaxhimit të Tokës, ndërsa për 4 Njësitë Administrative Orikum, Shushicë, Qendër dhe Novoselë procedurat e faturimit dhe arkëtimin i kanë kryer specialistët e kontrollit të terrenit në NJA në vartësi të DTTV.

Nga auditimi i procedurave të faturimit dhe arkëtimin të taksës së tokës rezulton se nga specialistët e terrenit të DTTV që operojnë në NJA dhe nga specialistja e Sektorit të Menaxhimit të Tokës janë bërë faturime dhe janë kryer arkëtime vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë apo NJA. Pra nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat e NJA-ve apo të Sektorit të Menaxhimit të Tokës, gjithmonë nëse ka evidentim të plotë të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të tyre, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 69 òNjoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor.

Regjistrat e familjeve fermere, duhet të ishin azhurnuar dhe përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga ZVRPP Vlorë për numrin e familjeve që kanë përfutur tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 23 dhe 24.

-Debitorë për taksën e tokës për **vitin 2018** rezultojnë 6571 familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, për vitin **2019**, 6928 familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë**, për vitin **2020**, 7872 familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për **6-mujorin e I të vitit 2021** janë 8627 familje fermere në vlerën **25,391,616 lekë**.

Debitorët sipas viteve, numrit të familjeve, NJA dhe në vlerë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NJA.	Taksa e Tokës	Debitorë 31.12.2018		Debitorë 31.12.2019		Debitorë 31.12.2020	
		Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke	Nr. Familjeve	Leke
Bashkia	Toke Bujqësore	508	457,328	516	749,270	440	950,400
Novosele	Toke Bujqësore	2271	8,804,226	2446	10,066,604	3305	12,274,210
Shushice	Toke Bujqësore	860	3,810,650	910	4,556,000	830	2,834,350
Njesia Qender	Toke Bujqësore	1400	7,271,915	1520	9,468,665	2135	8,025,300
Orikum	Toke Bujqësore	1532	5,763,072	1536	5,784,929	1162	3,077,860
TOTALI	Toke Bujqësore	6571	26,107,191	6928	30,625,468	7872	27,162,120

Burimi: Drejtoria e Pronave Publike/Njësia e Menaxhimit të Tokës e Njësiti Administrative, Bashkia Vlorë.

NJA.	Taksa e Tokës	Debitorë 30.06.2021	
		Nr. Familjeve	Leke
Bashkia	Toke Bujqësore	504	913,400
Novosele	Toke Bujqësore	3128	10,692,458
Shushice	Toke Bujqësore	970	2,953,760
Njesia Qender	Toke Bujqësore	2220	4,106,868
Orikum	Toke Bujqësore	1805	6,725,130
TOTALI	Toke Bujqësore	8627	25,391,616

Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme rezulton se debitorët e taksës së tokës kanë ardhur duke u rritur, çka tregon se puna e Sektorit të Menaxhimit të Tokës dhe e NJA-ve nuk është në nivelet e duhura, pasi ka munguar përgjegjësia dhe vëmendja e duhur për vjeljen e taksës së tokës, gjë të cilën e tregon niveli i lartë i debitorëve nga viti në vit. Vlera e detyrimit për debitorët e tokës bujqësore në asnjë nga Njësiti Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) "Taksa mbi tokën bujqësore" të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Në Bashkinë Vlorë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë, pasi në VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 pika 2/b përcaktohet se: "Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse b/1-7, Specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve për qytetin e Vlorës."

Pra, nuk përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NJA nga DTTV-ja apo nga Sektori i Menaxhimit të Tokës për NJA në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Ndërsa sipas Rregullores së Brendshme neni 170 "Specialisti i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në pikën (f) përcaktohet: "Përpilon listat e fermerëve që kanë tokë bujqësore dhe dërgon dokumentacionin pranë DTTV së Bashkisë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore." Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat.

Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: z. D. L., z.O. B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore, zj. M. T. me detyrë specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, zj. H. G. specialiste e kontrollit në terren NJA Orikum në DTTV, z. M. L. me detyrë specialist i kontrollit në terren NJA Shushice në

DTTV dhe zj.E. P. me detyrë specialiste e kontrollit në terren NJA Novoselë në DTTV.

Titulli i Gjetjes:Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata:Referuar akt-rakordimeve me Thesarin **Taksa e tokës bujqësore për vitin 2018** është realizuar në shumën 15,355 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 36%, për **vitin 2019** është realizuar në shumën 11,118 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 26%, për **vitin 2020** është realizuar në shumën 13,175 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 31% dhe për 6 mujorin I të **vitit 2021**, është realizuar në shumën 4,792 mijë lekë nga 28,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 17%.

Referuar korrespondencës zyrtare të Bashkisë Vlorë, për sipërfaqet tokave bujqësore dërguar Këshillit Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1438/1 dt.12.03.2018 të paraqitura në tabelën e mësipërme rezulton se, sipërfaqja e tokës bujqësore pronë private plus sipërfaqja e dhënë në përdorim sipas të dhënave të shkresës është më e lartë se baza e taksueshme e planifikuar me një sipërfaqe prej 1039 ha e shumëzuar me taksën për kategorinë VIII të tokës prej 1800 lekë/ha dhe me 4 vite, ka shkaktuar **të ardhur të munguar në vlerën 7,480,800 lekë** për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermere që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës, duke u evidentuar një numri i madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore.

Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastër për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë apo NJA.

Kanë ndikuar negativisht në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **debitorët** për taksën e tokës, ku në fund të vitit **2018** janë 6571 familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, në fund të vitit **2019** janë 6928 familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë** dhe në fund të **vitit 2020** janë 7872 familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për **6-mujorin e I të vitit 2021** janë **8627 familje fermere në vlerën 25,391,616 lekë**, vlerë e cila **përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Kriteri:Pika 2 nënpika (b) *o*Taksa mbi tokën bujqësore të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 *o*Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 24, ligji nr. 139/2015 *o*Për vetëqeverisjen vendore i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 *o*Për financat e vetëqeverisjes vendore i ndryshuar, neni 3, pikat 9 dhe 10.

Ndikimi/Efekti:Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 7,480,800 lekë** nga ulja me të padrejtë në planifikimin të sipërfaqes së tokës si bazë e taksueshme për taksën e tokës bujqësore dhe vlerës debitore prej **25,391,616 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Shkaku:Keqmenaxhim dhe mos marrja e masave për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrejë një

grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ZVRPP dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 1039 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujori 2021, **për vlerën 7,480,800 lekë**.

Rekomandim:Strukturat drejtuese të Bashkisë dheDrejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për ndjekjen e debitorëve,të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar nga familjet fermere dhe për mos kryerjen e pagesave të ndiqen procedurat e tjera administrative dhe ligjore.

Agjentët tatimorë

Në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në Republikën e Shqipërisë.

a. UK sha Vlorë është përcaktuar si Agjent Tatimor sipas VKB nr.100, datë 22.12.2017, i ndryshuar, VKB nr.109 datë 23.11.2019 *oPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore* dhe VKB-së nr.88, datë 24.12.2020 *oPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore*, ku Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit është e ngarkuar për rakordimin e arkëtimeve për taksat e kategorisë *ofamiljarë* për *otaksën e ndërtesës* dhe *otarifën e pastrim-gjelbërim-ndricimit*.Nga Bashkia Vlorë nuk është lidhur kontratë me këtë Agjent Tatimor në mospërputhje me VKB për miratimet e paketave fiskale.Taksa e banesës për banim është përcaktuar sipas VKM nr.132, date 07.03.2018, *oPër metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa*, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

Duhet theksuar se Bashkia Vlorë, nuk ka krijuar një bazë të dhënash për banesat, (qoftë edhe duke përdorur bazën e të dhënave të UKsha Vlorë) apo edhe duke detyruar ZVRPP-në për vënien në dispozicion të regjistrit elektronik të pasurive të paluajtshme sipas dispozitave të Nenit 20 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *oPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar,nga ku të evidentoheshin personat/familjet të cilët zotërojnë 1 banesë ose më shumë se një ndërtesë banimi, pasi niveli i taksës së ndërtesave të banimit është dyfishi i nivelit të taksës për kategorinë e cila ka vetëm një banesë.

b. Për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nga Agjenti Tatimor *oDrejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor (DRTRR)*.

Nga rakordimet e bëra me këtë drejtori, realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura për vitin 2018 është 55,972 mijë lekë, ose 106 % e planit, për vitin 2019 është 66,018 mijë lekë ose 116 % e planit, për vitin 2020 është 65.964 mijë lekë ose 101 % e planit dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 është 29,388 mijë lekë ose 65 % e planit, e paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2018	52,900	55,972	106
2019	57,000	66,018	116
2020	65.400	65.964	101
6-mujori i I-rë 2021	45.000	29.388	65

c. Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nga Agjenti Tatimor *oDrejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë (DRT)*, në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 *oPër disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"* dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 *oPër tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël*.

Sektori i Agjentëve Tatimorë kryen rakordimin e të ardhurave të realizuara. Parashikimi dhe realizimi në vlerë dhe në përqindje për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 6-mujorin e I-rë të vitit 2021 paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
------	-------------	-------	----------------

2018	12,960	15,409	119
2019	17,000	16,004	94
2020	18,000	13,321	74
6-mujori i I-rë 2021	12,000	9,947	83

d. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, nga *Agjenti Tatimor "Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Vlorë" (ASHK) ose ish-ZVRPP Vlorë*, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreë i ndryshuar dhe VKB nr.100, datë 22.12.2017, i ndryshuar dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 òPër sistemin e taksave dhe tarifave vendoreë. Nga rakordimet e bëra nga Sektori i Agjentëve Tatimorë me ZVRPP-në Vlorë, realizimi i të ardhurave nga taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2018, është 27,422 mijë lekë ose 65% e planit, për vitin 2019 është 36,212 mijë lekë ose 138%, për vitin 2020 është 29,159 mijë lekë ose 97% e planit dhe për për 6-mujorin e I të vitit 2021 është 13,637 mijë lekë ose 68 % e planit 6 mujor, të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Viti	Parashikimi	Fakti	Realizimi në %
2018	32,450	27,422	85
2019	26,300	36,212	138
2020	30,000	29,159	97
6-mujori i I-rë 2021	20,000	13,637	68

e. Për rentën minerare, nga Agjenti Tatimor òDrejtoria e Financave Vendoreë në MFE Derdhja nga Drejtoria e Financave Vendoreë në MFE e pjesës takuese të taksës kombëtare òrentë minerareë që rezulton nga veprimtaria e guroreve në territorin e Bashkisë Vlorë në bazë të nenit 4 pika 4 të ligjit 9975 datë 28.07.2008 òPër taksat kombëtare të ndrshuar, të Udhezimit nr.26, datë 04.09.2008 òPër taksat kombëtareë. Realizimi i të ardhurave nga renta minerare për vitin 2018 është 4 mijë lekë, për vitin 2019 është 398 mijë lekë, për vitin 2020 është 128 mijë lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 është 2 mijë lekë.

Nga Bashkia Vlorë, janë ndjekur procedurat ligjore për të njoftuar subjektet/individët debitorë dhe për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara.

Në lidhje me procedurën e mbajtjes së akteve të rakordimit me agjentët tatimorë, u konstatuan sa më poshtë:

-Akt-rakordimet janë mbajtur vetëm me UKsha Vlorë sipas formatit të miratuar, por nuk janë protokolluar. Rakordimet japin informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve dhe përqindjen përkatëse, pa pasur asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave.

-Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agjentët tatimorë është Ujësjellës-Kanalizime, i cili vjel taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

-Bashkia Vlorë nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Vlorë, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të Ligjit 9920, dt. 19.5.2008, òPër Procedurat Tatimoreë, ku parashikohet se òDënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifaveë.

Ndërsa me asnjë nga agjentët e tjerë tatimorë nuk janë mbajtur akte rakordimi, pasi derdhjet nga këto institucione bëhen nëpërmjet Degës së Thesarit.

-Nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe kontabilitetit, Bashkisë Vlorë, nuk disponohet asnjë e dhënë statistikore për nr e subjekteve tatimpaguese dhe detaje të tjera në lidhje me kategoritë e

tatimpaguesve, në mënyrë që jo vetëm të llogariten detyrimet në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, por këto të dhëna të përdoren për planifikimin real të këtyre të ardhurave si edhe për llogaritjen dhe evidentimin e detyrimeve të tjera respektive për subjektet/individët tatimpagues të shmangur nga agjentët tatimorë. Mungesa e të dhënave ka sjellë pamundësinë e kontrollit të taksave/tarifave të cilat mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, rrjedhimisht mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

-Nga Bashkia Vlorë, nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të njoftuar subjektet/individët debitorë dhe për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, kryesisht për periudhën 2018 - 2020. Kjo situatë ka ardhur si mungesë e bashkërendimit të punës ndërmjet institucioneve dhe Bashkisë Vlorë.

Auditimi i procedurave të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga biletat e vizitorëve turistë në Parkun Kombëtar Sazan Karaburun.

Për procedurat e ndjekura për të ardhurat nga biletat e vizitorëve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Evidencat e Qendrës Ekonomike për periudhën 2018 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, mbi lëvizjen e biletave për në Parkun Kombëtar Detar Sazan-Karaburun (hyrje-dalje dhe gjendje në magazinë) si dhe arkëtimet e realizuara nga shitja e tyre turistëve.

- Korespondenca zyrtare e Bashkisë Vlorë në kuadër të bashkëpunimit me Kapitenerinë e Portit Vlorë nën varësi e Drejtorisë së Përgjithshme Detare në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi të dhënat e operatorëve turistikë që kanë operuara në Gjirin e Vlorës për periudhën 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021.

- Vendimet e Këshillit të Bashkisë Vlorë për taksat dhe tarifave vendore

- Evidencat e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave vendore për menaxhimin e dhe arkëtimin e tarifës së biletës nga vizitorët në Gjirin e Vlorës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Këshilli i Bashkisë Vlorë ka miratuar me Vendimin nr.100 datë 22.12.2017 paketën fiskale ecila ka qenë në zbatim për vitin 2018-2019 në pikën 6 nën-pika 11 të VKB nr.100 datë 22.12.2017 *parashikon: “nivele e tarifës Bilete Hyrje për vizite në ishullin e Sazanit në vlerën 200lekë/personi. Çdo Drejtori kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij”.*

Për vitin 2018 në bazë të dokumentacionit financiar hyrje-dalje dhe gjendje magazine të vënë në dispozicion nga Qendra Ekonomike të dhënat për lëvizjet e biletave turistike rezultojnë se për periudhën 11.07.2018 - 14.08.2018 (1 muaj) nga 23000 bileta në dispozicion nga furnizimi, janë bërë dalje 6700 bileta, janë arkëtuar 4607 bileta dhe janë kthyer në magazinë 2093 bileta.

Janë tërhequr bileta për tu shitur nga 2 punonjës të Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe 1 punonjës i DTTV. Referuar tërheqjeve, shitjeve dhe kthimeve në magazinë të biletave turistike, vihet re se z.R.C ka tërhequr në korrik-gusht 4093 bileta, ka shitur 2000 bileta dhe ka kthyer në magazinë 1945 bileta, ndërkohë që në këtë sezon ka patur numër të konsiderueshëm vizitorësh në bazë të dhënave të Kapitenerisë së Portit Vlorë. Ndërsa 148 bileta mungojnë nga biletat e tërhequra nga ky punonjës, pra janë të pa arkëtuar dhe të pakthyera në magazinë, **duke mos justifikuar vlerën prej 29,600 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik**, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar, pika 89.

Këshilli Bashkiak me VKB nr. 84 datë 26.07.2018 “Për një ndryshim në VKB nr 100 datë 22.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”, ka vendosur:

1. *Të ndryshojë pikën 6/19 në kreun 2 “Tarifat” “Biletë Hyrje për vizitë në ishullin e Sazanit” duke e riformuluar në “Biletë Hyrje për vizitë në “ Parkun Kombëtar Detar” Karaburun-Sazan” me vlerë 200 lekë.*

2. *Biletat e hyrjes do të shpërndahen nga përfaqësuesit (të punësuarit) e subjekteve të mjeteve transportuese për çdo pasagjer. Procedura e pasjjes me bileta të subjekteve transportues dhe e arkëtimin të të ardhurave do të rregullohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ose*

marrëveshje mes palëve.

3. Në rast të konstatimit të mos lëshimit të biletës sipas pikës 1 dhe 2, ose mosdeklarimit të saktë të numrit të vizitorëve në “Parkun Kombëtar Detar” Karaburun-Sazan”, Policia Bashkiake Vlorë autorizohet të vendosë penalitetete në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.”

Sipas këtij Vendimi rezultoi se për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e biletës nga vizitat në Gjiun e Vlorës ngarkohen operatorët turistikë. Nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë një Urdhër për përcaktimin e procedurave të pasjjes me bileta të subjekteve transportues dhe e arkëtimin të të ardhurave si dhe mungon një marrëveshje mes palëve. Nga Drejtoria e Tatim, Taksave Vendore Vlorë nuk është faturuar apo nxjerrë njoftim vlerësimi si dhe ndjekja e arkëtimin të kësaj tarife për periudhen 2018-2019 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt edhe i taksave dhe tarifave të tjera vendore.

Për vitin 2018

a. Referuar përgjigjes së Kapitenerisë të Portit Vlorë kundrejt kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Vlorë përcjellë me shkresën nr.132 datë 22.06.2020 për sezonin turistik në periudhen 3-mujore 01.06.2018-01.09.2018 konfirmohen se kanë vizituar Gjiun e Vlorës 19347 turistë, për të cilët nuk është prerë biletë (200 lekë/personi) dhe pranë Bashkisë Vlorë ***nuk është arkëtuar vlera prej 3,869,400 lekë*** nga 10 Operatorët Turistikë që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë, ***vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

b. Referuar përgjigjes së Kapitenerisë të Portit Vlorë kundrejt kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Vlorë përcjellë me shkresën nr.124 datë 29.10.2018 për sezonin turistik në periudhen 15-ditore 01.09.2018-15.09.2018 konfirmohen se kanë vizituar Gjiun e Vlorës 3386 turistë, për të cilët nuk është prerë biletë dhe ***nuk është arkëtuar*** pranë Bashkisë Vlorë nga 10 Operatorët Turistikë që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë, ***duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën prej 677,200 lekë.*** Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Për vitin 2019, Referuar përgjigjes së Kapitenerisë të Portit Vlorë kundrejt kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Vlorë përcjellë me shkresën nr.132 datë 22.06.2020 për sezonin turistik në periudhen 3-mujore 01.06.2019-01.09.2019 konfirmohen se kanë vizituar Gjirin e Vlorës 29684 turistë, për të cilët nuk është prerë biletë dhe ***nuk është arkëtuar*** pranë Bashkisë Vlorë nga 10 Operatorët Turistikë që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë ***vleraprej 5,936,800 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.*** Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Për vitin 2020, Referuar përgjigjes së Kapitenerisë të Portit Vlorë kundrejt kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Vlorë përcjellë me shkresën nr. 203 prot., datë 28.09.2020 òKthim përgjigje për kërkesën me nr.8000 prot., datë 21.09.2020 për sezonin turistik 01.06.2020-20.09.2020 konfirmohen se kanë vizituar Gjirin e Vlorës 23038 turistë, për të cilët në zbatim të vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 100, datë 22.12.2017, i ndryshuar është kryer vlerësimi për zërin e biletave sipas tarifës së miratuar, por ***nuk është arkëtuar*** pranë Bashkisë Vlorë nga Operatorët Turistikë që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë ***vleraprej 4,587,800lekë, e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Për 6-mujorin e vitit 2021, Referuar përgjigjes së Kapitenerisë të Portit Vlorë kundrejt kërkesës për bashkëpunim nga Bashkia Vlorë përcjellë me shkresën nr.88 prot., datë 22.06.2020 për sezonin turistik në periudhen 01.06.2021-30.06.2021 konfirmohen se kanë vizituar Gjirin e Vlorës 3932 turistë. Me vendimin e K.B-së nr. 88, datë 24.12.2020 òPër taksat dhe tarifatat vendore është miratuar procedura e arkëtimin të tarifës së biletës turistike për turistët që vizitojnë Gjirin e Vlorës. Nga ana e bashkisë është bërë njoftimi zyrtar për cdo operator që të paraqitet pranë Qendrës Ekonomike për tërheqjen e tyre, por nga subjektet e raportuara nga Kapiteneria e Portit Vlorë, nuk kanë tërhequr asnjë prej tyre bileta, duke bërë që inspektorët e bashkisë të kryejnë vlerësimin tatimor sipas të dhënave të dërguara nga institucioni përgjegjës. Për vlerën e tarifës së biletës për turistë ***nuk është arkëtuar*** pranë Bashkisë Vlorë nga

Operatorët Turistikë që operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë **vleraprej 589,800lekë, e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Për 6-mujorin e I të 2021, nga ana e Bashkisë Vlorë janë prodhuar blloqe biletash për anijet turistike sikurse e parashikon Vendimi i Këshillit të Bashkisë, nr. 88, datë 24.12.2020 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendoreò.

Gjithashtu janë njoftuar zyrtarisht operatorët turistikë si për procedurën e vlerësimit tatimor në zbatim të V.K.B-së nr. 88, datë 24.12.2020 dhe për tërheqjen e biletave pranë Qendrës Ekonomike, por asnjë nga operatorët nuk i është përgjigjur bashkëpunimit të bashkisë me biznesin.

Nga administrata e Bashkisë, për vitin 2021, janë kryer procedurat e bllokimit të llogarive të operatorëve turistik të cilët rezultojnë debitorë.

Në kohën e sezonit turistik për vitet 2018-2019 nga Kapiteneria e Portit Vlorë për 11 operatorët Turistikë që operojnë me mjete lundruese janë raportuar hyrje të 22733 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,546,600 lekë dhe për vitin 2019 janë raportuar hyrje të 29684 turistëve me tarifë bilete të pavjelur në vlerën 5,936,800 lekë, për vitin 2020 janë raportuar hyrje të 22939 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,587,800 lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 janë raportuar hyrje të 3932 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 589,800 lekë, **duke sjellë në total të ardhura të munguara me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, të VKB nr. 100, datë 28.12.2017 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorëò Kreu II pika 6 nënpika 19, i ndryshuar me VKB nr. 84 datë 26.07.2018, ndryshuar me V.KB-në nr. 88, datë 24.12.2020.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi, z. D. L. , z. R. Ç. dhe z. O. B. me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Titulli i Gjetjes:Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga biletat e vizitorëve turistë në Parkun Kombëtar Sazan-Karaburun.

Situata:Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 100 datë 22.12.2017 i miratimit të paketës fiskale pika 6 nënpika 11 ka përcaktuar nivelin e tarifës Bilete Hyrje per vizite në Parkun Kombëtar Sazan-Karaburun në vlerën 200 lekë/personi, ku për periudhën 7-mujore viti 2018 biletat menaxhoheshin nga vetë Bashkia, ndërsa me ndryshimin me VKB nr. 84 datë 26.07.2018 menaxhimi i biletave dhe arkëtimi i vlerës së tyre do të kryhej nga mjetet transportuese të operatorëve ekonomikë turistikë që operojnë në Portin e Vlorës.

Referuar VKB nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë një Urdhër për përcaktimin e procedurave të pajisjes me bileta të subjekteve transportues dhe e arkëtimin të të ardhurave si dhe mungon një marrëveshje mes palëve. Nga Drejtoria e Tatim-Taksave Vendore Vlorë nuk është ndjekur arkëtimi i kësaj tarife për periudhën 2018-2019 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt edhe i taksave dhe tarifave të tjera vendore.

Në kohën e sezonit turistik për vitet 2018-2019 nga Kapiteneria e Portit Vlorë për 11 operatorët Turistikë që operojnë me mjete lundruese janë raportuar hyrje të 22733 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,546,600 lekë dhe për vitin 2019 janë raportuar hyrje të 29684 turistëve me tarifë bilete të pavjelur në vlerën 5,936,800 lekë, për vitin 2020 janë raportuar hyrje të 22939 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,587,800 lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 janë raportuar hyrje të 3932 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 589,800 lekë,**duke sjellë në total të ardhura të munguara me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë.**

Për vitin 2018 nga të dhënat për lëvizjet e biletave turistike e dokumentacionit financiar hyrje-dalje dhe gjendje magazine të vënë në dispozicion nga Qendra Ekonomike rezulton se për periudhën 11.07.2018 - 14.08.2018 (1 mujore) nga 23000 bileta ne dispozicion nga furnizimi, janë bërë dalje 6700 bileta, janë arkëtuar 4607 bileta dhe janë kthyer në magazinë 2093 bileta. Referuar tërheqjeve, shitjeve dhe kthimeve në magazinë të biletave turistike, vihet re se z. R.C ka tërhequr në korrik-gusht 4093 bileta, ka shitur 2000 bileta dhe ka kthyer në datën 24.12.2019 në magazinë 1945 bileta, ndërkohë që në këtë sezon ka patur numër të konsiderueshëm

vizitorësh në bazë të dhënave të Kapitenerisë së Portit Vlorë. Ndërsa 148 biletamungojnë nga biletat e tërhequra nga ky punonjës, pra janë të pa arkëtuara dhe të pakthyera në magazinë, **duke mos justifikuar vlerën prej 29,600 lekë të këtyre biletave, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore* i ndryshuar, Kreu VII, nenit 35, të VKB nr. 100, datë 28.12.2017 *ËPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë*, Kreu II pika 6, nënpika 19, i ndryshuar me VKB nr. 84 datë 26.07.2018 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, i ndryshuar, pika 89.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 15,661,000 lekë** nga mos arkëtimi i tarifës së biletave të vizitorëve turistikë në Parkun Kombëtar Sazan-Karaburun.

Shkaku: Keqmenaxhim dhe mosorganizim i mirë i punës, mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Vlorë nëpërmjet DTTV të përcaktojë procedurën e menaxhimit të ardhurave të gjeneruara nga vizitorët turistikë në Parkun Kombëtar Sazan-Karaburun, duke përcaktuar agjentin tatimor për shpërndarjen e biletave dhe arkëtimin e vlerës së tyre nga operatorët turistikë nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes mes palëve.

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë nxjerrjen njoftim-vlerësimin e detyrimeve si dhe ndjekjen e arkëtimin të kësaj tarife për periudhën 2018-2019-2020 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt i taksave dhe tarifave të tjera vendore. Nga z. R.C të arkëtohet vlera prej **29,600 lekë**, vlerë e 148 biletave (çmim 200lekë/personi) të pa shitura dhe të pa arkëtuara apo të pa kthyera në magazinë.

-Auditimi i procedurave të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lelesh ndërtimi dhe investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë.

Për këto procedura, shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Evidencat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Vlorë për lejet e zhvillimit të miratuara për periudhën 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021.
- Evidencat e Drejtorisë së Financës, Kontabilitetit dhe Buxhetit dhe Njësisë së Prokurimit për procedurat e prokurimit të zhvilluara në Bashkinë Vlorë për periudhën 2018-2019-2020, 6 mujorin e parë të vitit 2021 dhe lidhjet e kontratave me operatorët ekonomik që kanë kryer punime ndërtimi për realizimin e investimeve.
- Vendimet e Këshillit të Bashkisë Vlorë për taksat dhe tarifave vendore
- Programi TAIS i Drejtorisë Taksave dhe tarifave Vendore Bashkia Vlorë, për rregjistrimin e subjekteve dhe ngarkesat e kryera me tarifave përkatëse.
- Dosjet e subjekteve dhe njoftim-vlerësimet për taksat dhe tarifave.

Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit konstatohet se për periudhën 2018-2019- 2020 dhe 6-mujorin 2021 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Vlorë 181 subjekte.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimim-gjelbërim-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet e ndërtimit që janë pajisur me *ËLeje Ndërtimi* mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme e cila përfshin të dhëna si: emri dhe mbiemri i zhvilluesit, numri dhe data e lejes së ndërtimit, vendndodhja e objektit ku janë kryer punime ndërtimi, subjekti i ndërtimit, sipërfaqja e truallit dhe sipërfaqja e ndërtimit dhe tarifa detyrim për arkëtim, në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Rezulton se nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjellbërim-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me ÷Leje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit ***por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.*** Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

-Për periudhën objekt auditimi vitet 2018-2019-2020 dhe dhe 6-mujori i parë i vitit 2021 bazuar në dokumentet dhe evidencat e paraqitura nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, rezulton se janë kryer investime, ku operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit janë subjekte me aktivitet ndërtimi, të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të zhvillimit të rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë nuk është vepruar, që për subjektet që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimi për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjellbërimit në masën prej 30,000 lekë/vit.

Rastet e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë për periudhën e viteve 2018, 2019 dhe 2020, të cilët selinë kryesore administrative të tyre e kanë jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe që nuk janë faturuar apo nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit. Të dhënat paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Rezulton se nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjellbërim-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar Kreut VII, nenit 35, dhe me VKB nr. 100, datë 28.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 27.11.2019 ÷Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë pika 3 ÷Tarifa e shërbimit të ndriçimit, pastrimit dhe gjellbërimit, germa ÷cö nënpika 4 dhe 5.

Me shkresën nr.514 prot., datë 17.11.2020, nga drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është hartuar plani i punës për muajin nëntor me objekt azhurnimin e listave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet ndërtimi për ngarkesën e tarifën e pastrimit/ndriçim/gjellbërim të konstatuara me detyrime debitore nga auditimi i KLSH-së. Kjo listë përfshin subjektet e ndërtimit që janë pajisur me leje dhe operatorët privatë të cilët kanë përfituar punë me fondet publike nga Bashkia Vlorë.

Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me ÷Leje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjellbërim-ndriçimit, ***por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.*** Rastet paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Subjektet të cilët kanë përfituar punë publike gjatë vitit 2020 dhe 6-mujorit të parë të vitit 2021, janë vlerësuar më detyrimet tatimore sipas afatit të kontratës për kohën e punimeve. Të dhënat për këto subjekte paraqiten në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Rezulton se nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Gjatë periudhës korrik 2020 deri në 31.06.2021, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, janë ndjekur subjektet me aktivitet ndërtimi, të cilët janë pajisur me leje ndërtimi gjatë kësaj periudhe. Konstatohet se janë ndjekur listat e lëna nga audituesit e KLSH-së për periudhën 01.01.2018 - 30.06.2020, ku disa prej subjekteve janë ngarkuar me detyrimet tatimore.

Gjithashtu, me urdhërin e brendshëm nr. 35, datë 05.02.2021 òPër verifikimin e subjekteve me aktivitet ndërtimi, që kanë kantier ndërtimi në territorin e bashkisë Vlorë është ngritur grupi i punës sipas çdo rajoni dhe njësie administrative për zbatimin e tij. Nga verifikimi në terren nga inspektorët e DAV-së, situata e firmave të ndërtimit paraqitet në tabelën bashkëlidhur anekseve. Edhe pse me V.K.B-në nr. 88, datë 24.12.2020 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Vlorë, në kreun II- Tarifave vendore është miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vlorë. Konstatohet gjithashtu mos bashkëveprim midis drejtorive dhe sektorëve në Bashkinë Vlorë.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit z. E.A (periudha 2015-2019), z.F.D (periudha 2019-2020), z. J. C (periudha 2020-e në vazhdim) dhe Njësinë e Prokurimit z. P.Th.

Gjatë vitit 2021, janë vlerësuar me detyrime subjektet e ndërtimit të cilat janë dërguar me shkresë nga Drejtoria e Urbanistikës, në tabelën bashkëlidhur anekseve.

-Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë nuk është vepruar për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 40,000 lekë/vit për 106 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Njësi administrative në vartësi dhe janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, dhe 25 subjekte ndërtimi që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të cilët janë operator fitues të tenderave në Bashkinë Vlorë për kryerje punimesh ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime me këto tarifa në masën 30,000 lekë/vit, në shkëlqje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të VKB nr. 100, datë 28.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 27.11.2019 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë pika 3 germa òcò nënpika 4 dhe 5, me pasojë **të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 2,850,000 lekë. Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:**

z. O.B me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

z. I.M me detyrë me detyrë specialist pranim-vlerësimi-terren

z. E.P me detyrë specialist kontrolli në terren.

z.L.M me detyrë specialist kontrolli në terren

z. K. M me detyrë specialist kontrolli në terren

z.D.K me detyrë specialist kontrolli në terren (periudha 01.01.2018- 16.09.2019 larguar)

z.D.I me detyrë specialist kontrolli në terren

z.F.B me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Orikum

zj.H.G me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Orikum

z.P.L me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Qendër

z.M.L me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Shushicë

z.V.P me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Shushicë (01.01.2018 -31.12.2019 larguar)

zj.O.A me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Novoselë (periudha 01.01.2018 deri 05.02.2020 larguar)

z. A.L me detyrë specialist kontrolli në terren.

z. E.A, z. F.D, z. J.Ç dhe z. P.Th

Titulli i Gjetjes: Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë lejesh ndërtimi dhe investime me

fonde publike në territorin e Bashkisë Vlorë.

Situata: Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit konstatohet se për periudhen 2018-2019-2020 dhe 6 mujorin e I të vitit 2021, kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj, për llogari të subjekteve private të pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Vlorë 107 subjekte.

Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistem TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për **58 subjektet** e ndërtimit mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private të pajisur me Leje Ndërtimi duke **mos u arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 58 subjekte me vlerën prej 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me Leje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit, **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë.**

-Bazuar në dokumentet dhe evidencat të paraqitura nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, rezulton se janë kryer investime, ku operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit janë subjekte me aktivitet ndërtimi, të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të Zhvillimit të Rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë nuk është vepruar, që për subjektet që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimi për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 30,000 lekë/vit. Si pasojë nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë.**

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, Kreu VII, neni 35, VKB nr. 100, datë 28.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 27.11.2019 *“Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë”* pika 3 *“Tarifa e shërbimit të ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit”*, germa 4 dhe 5.

Ndikimi/Efekti: Në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **vlera prej 2,850,000 lekë** nga mos faturimi dhe arkëtimi i tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit si dhe vlera debitore për këtë tarifë prej **2,320,000 lekë (e pa arkëtuar).**

Shkaku: Mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Njësine Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruar për vitet 2018-2019-2020-2021, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,890,000 lekë** si edhe marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **2,280,000 lekë.**

Pretendimi i subjektit: nga z. O.B, z. E.P, znj. R.P, znj. O.G (A.), I.M me observacionet e dërguara me email-et e datës 25.01.2021 dhe shkresat me nr. prot. 744, 744/1, nr.744/2,

nr.744/3, datë 25.01.2022, ku pretendohet se sektori i pranimit kryen vlerësimin tatimor në bazë të dokumenteve justifikues dhe regjistrin gjeografik dhe se në sistemin TAIS për periudhën 01.01.2018-30.06.2020 është kryer rivlerësimi tatimor pa shmangur kamatëvonesat në vlerën 0.6% të shumës së faturuar e cila gjenerohet automatikisht pas shlyerjes së detyrimeve, si rrjedhojë pa shmangur arkëtimet ndaj Bashkisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: për këtë pikë sqarojmë se, mosbashkëpunimi i plotë dhe mosrakhordimi i punës mes DTTV dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për faturimin e arkëtimin e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit firmave të ndertimit është pjesë e mosfunksionimit të strukturave dhe papërgjegjshmërisë e menaxherëve të këtyre strukturave, brenda Bashkisë Vlorë. Shkresa nr. prot.3308 e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore drejtuar Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit me me lëndë: “Kërkesë për informacion për lejet e ndërtimit të miratuara gjatë periudhës 2016-2020” është e datës 04.05.2020, afat i cili është jashtë çdo afati ligjor për llogaritjen, faturimin dhe njoftimin e detyrimeve për firmat e ndërtimit, që kanë kryer punime ndërtimi si rezultat i marres së lejeve të ndertimit nga subjekte private apo i fitimit të tenderave për vitet 2018-2019 e më përpara, kur afati i pagesës së taksave dhe tarifave është deri me 20 prill të vitit ushtrimor, në këtë rast edhe për detyrimet e lindura të vitit paraardhës. Fakti që çdo subjekt për marrjen e lejes së ndërtimit duhet të pajiset me vërtetim se nuk ka detyrime nga DTTV duhet të ndihmonte për identifikimin nga DTTV e subjekteve që kanë marrë leje ndërtimi, por si duket nuk ka funksionuar.

Gjithashtu për pretendimin se: “Përgjegjësia e mos faturimit të firmave dhe shesheve të ndërtimit nuk është e specialistëve të pranimit” sqarojmë se, sipas nenit 106 “detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin” të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë, detyra e marrjes së informacionit nga drejtoritë apo institucionet e tjera, llogaritja e detyrimit dhe lëshimi i faturës për arkëtim është detyrë e specialistëve të vlerësim detyrimit. Për për këto arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

Për **komentet dhe sqarimet** e bëra në lidhje me këtë pikë janë të karakterit justifikues, që nuk kemi patur dijeni, nuk është sjellë informacioni i duhur për kryerjen e ngarkesave dhe evidentimin e bizneseve të ndërtimit në terren. Për pjesën e pretenduar se, janë ngarkuar dhe janë mbajtur akt-kontrolle, në dokumentacionin e paraqitur nuk disponohen akt-kontrolle përveçse shkresa këmbim formacioni dhe muk sqarohet për çfarë periudhe jane kryer ngarkesat, për seli kryesore apo seli dytësore, si dhe listimet e biznese të pretenduara se jane ngarkuar nuk janë gjeneruara nga sistemi TAIS. Pra observacionet nuk janë të mbështetura me prova ligjore dhe për këto arsye nuk merren në konsideratë.

Për **komentet dhe sqarimet** e bëra lidhur me ngarkesën me përgjegjësi për problematiken e trajtuar më lart sqarojmë se, sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë në nenin 108 “Detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit në terren” nën pikat c,d,e,i,j,l, përcaktohet puna që duhet kryer për verifikimin e çdo lloj biznesi apo aktiviteti që hapet apo mbyllet në Rajonet përkatëse, ku operon çdo Inspektor, duke e dokumentuar dhe krijuar dhe regjistrin e përkohshëm krahas regjistrin fillestar të bizneseve, për përditesimin e tij gjatë raportimit të tij ditor.

Sa i takon ngarkesave në sistem për periudhën 2018-2020, sqarojmë se këto subjekte janë ngarkuar jashtë afateve dhe do te sjellin rritje të debitorëve pasi ende nuk janë shlyer detyrimet. Pra këto observacione janë të karakterit justifikues dhe nuk janë të mbështetura ligjërisht, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Vlorë.

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre dhe referuar evidencave të mbajtura në lidhje me arkëtimin e tarifave vendore, konstatohet se në territorin e Bashkisë Vlorë operojnë 17 stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në mungesë të

autorizimit të liçencimit për ushtrim aktiviteti. Këto subjekte nuk kanë aplikuar në Bashki për paisjen dhe përsëritjen e liçencave nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht ***nuk është bërë pagesa e detyrimit ligjor prej 17,000,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Nga të dhënat konstatohet se nga Bashkia Vlorë nuk është aplikuar saktë taksa për rinovim të lejes së autorizimit në masën 1,000,000 lekë në 20 raste të liçencimit të pikave të shitjes me pakicë të karburanteve dhe nënproduktet e tyre, pasi nga Bashkia Vlorë janë lëshuar autorizime për liçencim apo rinovim liçence kundrejt pagesave nga subjektet të tarifës në vlerën 200,000 lekë, pra në masën prej 1/5 e tarifës së miratuar për liçencim prej 1,000,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara në shumën **15,200,000 lekë.**

Titulli i Gjetjes: Menaxhimi i të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Subjekteve të liçencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezultoi se në 16 raste të subjekteve, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë nuk janë rinovuar licencat, pavarësisht kryerjes së kontrolleve, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e liçencimit në vlerën prej 17,000,000 lekë. Po kështu në 19 raste të lëshimit të autorizimit të liçencimit nuk është bërë aplikimi i saktë i tarifës me një diferencë në vlerë prej 15,200,000 lekë, e cila ka ardhur si pasojë e mosaplikimit të tarifës së miratuar të liçencimit prej 1,000,000 lekë. Vlera ***prej 32,200,000 lekë e pa arkëtuar, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Nga Bashkia Vlorë nuk është vazhduar ndjekja e procedurave në Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe në Institucionet e tjera përkatëse deri në bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa liçencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve

Kriteri: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë”* i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa òbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2

Ndikimi/Efekti: Në uljen e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **prej 32,200,000 lekë.**

Shkaku: Mos kryerja e një pune të mjaftueshme dhe mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë subjektet me liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifën e plotë për 16 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për diferencën debitorë prej 16,000,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për liçencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

Auditimi i procedurave të kryera për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë

Për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Dokumentet e korrespondencës shkresore midis Bashkisë Vlorë dhe Drejtorisë Rajonale të Aluiznit Vlorë, për listat e personave që është miratuar Leja e Legalizimit për objektet e ndërhuara pa leje ndërtimi.

Taksa e ndikimit në Infrastrukturë për vitin 2018 është realizuar në shumën 148,621 mijë lekë nga 430,077 mijë lekë të planifikuara ose në masën 34,6%, për vitin 2019 është realizuar në shumën 95,569 mijë lekë nga 418,534 mijë lekë të planifikuara ose në masën 22.8%, për vitin 2020 është realizuar në shumën 205,336 mijë lekë nga 301,161 mijë lekë të planifikuara, ose në

masën 68 % dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 është realizuar në shumën 110,131 mijë lekë nga 160,000 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 69 %.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, u auditua korespondenca shkresore e Bashkisë Vlorë me ALUIZNI-it Drejtoria Vlorë dhe databaze për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), referuara listave me të dhënat plotësuese të dërguara me shkresa nga ALUIZNI sipas kërkesave të Bashkisë. Nga verifikimi i listave për faturimet e kryera nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe arkëtimet e videtuara nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit rezultoi se ka një numër të konsiderueshëm individësh apo subjektësh private që kanë marrë lejet e legalizimit dhe nuk kanë paguar. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Vlorë. Kështu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m2 ndërtim me vlerë investimi prej **10,222,341,500 lekë pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.**

NR	Viti	Nr i lejeve te legalizimit	Perqindja e taksës	Sip. totale e ndërtimit (m2)	KOSTO (LEKE /m2)	Vlera e investimit (LEKEx m2)	Shuma që arkëtohet (leke)
1	2016	258	0,50%	39.558	32508	1.285.954.715	6.429.774
2	2017	454	0,50%	99.536	32508	3.235.728.641	16.178.643
3	2018	298	0,50%	53.043	32508	1.724.308.841	8.621.544
4	2019	175	0,50%	29.415	32508	956.226.071	4.781.130
5	2020	263	0,50%	49.781	32508	1.618.280.748	8.091.404
6	6/2021	260	0,50%	43.123	32508	1.401.842.484	7.009.212
	Shuma	1766		344543		10,222,341,500	51,111,707

Tabela e mësipërme në mënyrë të detajuar sipas personave, të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, dhe nuk kanë paguar do të paraqitet bashkëlidhur materialit.

Gjithashtu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 2916 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107 lekë, nga këto është likujduar vlera prej 88,038,725 lekë, **duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Subjekte qe jane pajisur me leje dhe kanë kryer veprimet

NR	Viti	Nr i lejeve te legalizimit	Perqindja e taksës	Sip. totale e ndërtimit (m2)	Detyrimi (leke)	Paguar në lekë	Debi në lekë
1	2016	46	0,50%	5873,1	971,680	971,680	-
2	2017	202	0,50%	36723,5	7,277,647	7,277,647	-
3	2018	1360	0,50%	247765	43,579,298	43,290,139	289,159
4	2019	622	0,50%	100091	18,534,037	18,177,750	356,287
5	2020	463	0,50%	78,704	12,792,548	11,822,022	970, 526
6	6m/2021	223	0,50%	50,873	8,268,897	6,499,487	1,769,410
	Shuma	2916		520,030	91,424,107	88,038,725	3,385,382

Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit janë evidentuar disa shkaqe për mos realizimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe konkretisht:

a -Aluizni nis praktikën për objektet e legalizuara në hipotekë pa u bërë konfirmimi nga Bashkia për taksën e ndikimit në infrastukturë;

b -Hipoteka nuk bëhet pengesë për rregjistrimin e objektit dhe për dhënien e Certifikatës së pronësisë, pasi ligjërisht subjektet apo individët kanë të drejtën të pajisen me certifikatën e pronësisë në të cilën shënohet mospagesa.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit që nga viti 2017, nuk ka zhvilluar korespondencë zyrtare dhe nuk ka patur komunikim me ZVRPP Vlorë sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës Rajonale Vlorë (perfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi

hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ti propozuar për lidhjen e një aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe ASHK Rajonale Vlorë, me qëllim që ky institucion të bëhet barrikadë për mosdhënie të legalizimeve dhe certifikatave të pronësisë subjekteve private pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, *oPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeo i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: "Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"*

- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *oPër sistemin e taksave vendoreo të ndryshuar,*

- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 *oPër përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimö i ndryshuar ,*

- VKB nr.100, datë 22.12.2017, *oPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorëo*

- VKB nr. 109, datë 27.11.2019, *oPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorëo.*

-Për periudhen 2016-2020 deri 30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m2 ndërtim me vlerë investimi 10,222,341,500 lekë, ***pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.***

Gjithashtu për periudhen 2016-2020 deri 30.06.2021 nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 1961 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej ***91,424,107***lekë, nga këto është likujduar vlera prej ***88,073,725*** lekë, ***duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z.E.Ame detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, për periudhën vitet 2018-2019.

z.F.D, për periudhën 2019-2020.

z.J.Ç, për periudhën 2020- e në vazhdim.

Titulli i Gjetjes:Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e infrastrukturës të ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë.

Situata:Nga verifikimi i listave për faturimet e kryera nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe arkëtimet e evidentuara nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit rezultoi se ka një numër të konsiderueshëm individësh apo subjektsh private që kanë marrë lejet e legalizimit dhe nuk kanë paguar. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Vlorë. Kështu për periudhen 2016-2020-30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m2 ndërtim me vlerë investimi prej 10,222,341,500 lekë ***pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.***

Gjithashtu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 2916 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107 lekë, nga këto është likujduar vlera prej 88,038,725 lekë, ***duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

Kriteri: ligji nr. 9482 datë 03.04.2016, *oPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeo i ndryshuar, neni 23, VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109, datë 27.11.2019 oPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorëo pika 4 oTaksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e rejao nënpika 4*

Ndikimi/Efekti:Në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore *në vlerën 51,111,707 lekë*nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Shkaku:Mos bashkëpunim me ALUIZNI-in Vlorë dhe mosmarrja e masave për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:Bashkia Vlorë nëpërmjet bashkëpunimit institucional t^o kërkojë ALUIZNI-t Drejtoria Vlorë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi.

Rekomandim:Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet si dhe të vijojë me masa shtërnguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët me status odebitorëo bazuar në legjislacionin tatimor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Z. E. A, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, për periudhën vitet 2018- tetor 2019.

Z. F. D, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, për periudhën tetor 2019-30.06.2020

Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga qiradhënia e aseteve nga Bashkia Vlorë.

Për këtë çështje, u shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë për miratimin e paketave fiskale të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021.
- Dosjet e subjekteve me dokumentacionin shoqërues të kontratave.
- Kontrata, aktmarrëveshje dhe databaze te kontratave të qirave të administruara nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësitë Administrative.
- Dosjet e subjekteve me dokumentacionin shoqërues të kontratave dhe evidenca për monitorimin kontratave
- Dokumentacion i likuidimeve i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për arkëtimin e tarifave të qirave nga kontratat e lidhura për qiradhënien të aseteve te Bashkisë Vlorë.

-Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të objektit "Thertore" në Njësinë administrative Novoselë.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, rezultoi se nga ish Komuna Novoselë, aktualisht Njësia administrative Novoselë është lidhur kontrata nr. 63, datë 26.03.2015 ndërmjet Qiradhënësit Komuna Novoselë e përfaqësuar nga ish-Kryetari K. SH. dhe Qiramarrësit N. S., për dhënien me qira të objektit Thertore me sipërfaqe 193.5 m², për një periudhë vlefshmërie nga data 26.03.2015 - 26.03.2018(afat 3-vjecar) dhe vlerë kontrate prej 30,000 lekë/muaj. Për periudhën 3-mujore deri në mbarimin e kontratës 26.12.2017-26.03.2018 është paguar vlera prej 90,500 lekë në datën 12.04.2018, që i përket tarifës së qirasë prej 300 lekë/muaj sipas kontratës fillestare (3 vjecare) të pa ndryshuar.

Objekti i quajtur oThertoreo me truallin funksional të tij shtrihet në pronën tokë arë prej 5200m² në pronësi të ish-Komunës Novoselë, aktualisht pjesë e pronave të Bashkisë Vlorë, ku sipas dokumentit të pronësisë rezulton të jetë regjistruar në favor të ish-Komunës prej vitit 2005, për pasurinë nr. 5/34 dhe 5/35, në volum 1 faqe 69. Në këtë tokë arë, sip prej 0,385 ha ose 3850 m² , është objekt i një kontrate qiraje të lidhur në mënyrë të paligjshme me datë 22.04.2011, e cila është në proces gjyqësor. Ndërsa pjesa tjetër e tokës arë prej 1313 m² i takon Thertores, e cila përcaktohet në VKB nr. 86 datë 26.07.2018 me nr.prot.6509/1 oPër shfuqizimin e VKB 43,datë 26.04.2018 oPër rinovimin e kontratës së qirasë për objektin me sipërfaqe 231 m² dhe truallit me sipërfaqe 1082m², pjesë e pasurisë nr 5/34 në ZK 2813, në pronësi të NJA Novoselë Vlorë me subjektin oN.So shpk në cilësinë e qiramarrësit dhe lidhjen e kontratës së qirasë me

subjektin òl.Aò. Në bazë të kësaj VKB-je është lidhur kontrata me nr.prot. 7185 datë 15.08.2018 deri me 15.08.2019 (me afat 1vit) ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit òl. Aò për dhënien me qira të objektit me sipërfaqe $231m^2 \times 200 \text{ lekë}/m^2 = 46,200 \text{ lekë}/\text{muaj}$ dhe dhe për truallin funksional me sipërfaqe $1082m^2 \times 20 \text{ lekë}/m^2 = 21,640 \text{ lekë}$. Totali i tarifës mujore të qirasë është në vlerën 67,840 lekë neni 3 òQirajaò. Kjo përlllogaritje është bërë në bazë të plan-vendosjes dhe plan-rilevimit të punuar nga punonjësi i bashkisë inxh. K.A, pas verifikimit në terren të objektit dhe sipërfaqes funksionale të Thertores. Nga verifikimi i pagesave rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467, 840 lekë nga 814, 080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likujduar vlera prej 347,040 lekë**, në kundërshtim me nenin 3 òQirajaò të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**, në tabelën bashkëlidhur anekseve.

Në VKB dhe në kontratë në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarin e imët të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëmdhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjeçare të lidhjes së kontratës 15.08.2018 deri më 15.8.2019, duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe të ishte arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit)**, **shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshtëpërbim**. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, òTarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozëò, pikat 5⁹,

Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2 në të cilën përcaktohet se: *Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të enfiteozës kryen këto detyra: nënpika c) Ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse. Nënpika d) Për çdo kontratë të lidhur, në fund të 6-mujorit të parë, brenda datës 15 korrik, dhe në fund të vitit, brenda datës 20 janar, njësia monitoruese dërgon në degën e shoqërive publike, pranë prefekturës përkatëse, një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës.*”

Gjithashtu nuk është plotësuar pika 7 e kontratës, ku përcaktohet se: *òQiramarrësi kur nuk paguan qiranë sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 3 të kasaj kontrate për cdo ditë vonesë është i detyruar të paguajë 2% të vlerës së papaguar*. Nga Bashkia Vlorë nuk është marrë asnjë hap ligjor për mospërbushje të kushteve të kontratës të përcaktuar në nenin 9 òNë rast mosmarrëveshjesh midis tyre, palët do t'i zgjidhin ato me konsensus dhe marrëveshje dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Me VKB nr.101 datë 03.10.2019 òPër miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselëò është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të të objektit òThertoreò, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44740 lekë e përbërë nga: $231m^2 \text{ ndërtesë} \times 100 \text{ lekë}/m^2 = 23100 \text{ lekë}$ dhe $1082m^2 \text{ truall funksional} \times 20 \text{ lekë}/m^2 = 21,640 \text{ lekë}$. Kjo VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënien me qira të objektit. Si rrjedhojë $44,740 \text{ lekë}/\text{muaj} \times 24 \text{ muaj} = 1,073,760 \text{ lekë}$, **shumë e cila përbën të ardhura të munguara**.

⁹5.Për përcaktimin e vlerës së detyrimit mujor të qirasë, për pasuritë e luajtshme (makineritë, pajisjet, linjat teknologjike, makineritë e pajisjet në galeritë minerare etj.), që jepen me qira, institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, përcakton vlerën e qirasë vjetore, që është sa 1/10 e VAM-it (vlerës aktuale minimale), të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në vendimin nr. 401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime), shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës, të publikuar nga INSTAT-i

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në hartimin dhe realizimin e kontratës së qiradhënies ngarkohet me përgjegjësi: z. D.L me detyrë Kryetar i Bashkisë Vlorë në cilësinë e nëshkruesit të kontratës, zj.S.H me detyrë Drejtorë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe zj.O.B me detyrë juriste në Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në cilësinë e hartueses së kontratave.

Pretendimi i subjektit: Sipas observacionit të paraqitur nga zj.S.H nr.984, datë 01.02.2022, pretendohet se linja e përpunim/prodhimit në thertoren e Novoselës (dhënë me qira) nuk ka qenë pjesë e inventarit dhe duke qenë se kontrata e lidhur me subjektin N.S, nuk përmbante përcaktimin se çdo investim i kryer do të mbetet pjesë e objektit të thertores edhe mbas përfundimit të kontratës, ish subjekti e çmontoi linjën e imët. Për këtë arsye vlera e përcaktuar si fitim i munguar duhet të hiqet në Raport nga ana juaj.Po kështu nga KLSH do kërkonim të shpreheni për një vlerë të pranueshme qiraje në mënyrë që të merret parasysh nga Bashkia Vlorë për ta zbatuar në procedurat e dhënies me qira.

Qëndrimi i grupit të auditimit:Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se sa i takon linjës së përpunim/prodhimit ajo ka qenë pjesë e inventarit pasi thertorja është ndërtuar nga një projekt i huaj dhe ka qenë e kompletuar për tu vendë në punë nga komuna. Përveç kësaj nuk na keni paraqitur asnjë dokument ku të provohet se linja është blerë dhe vendosur nga subjekti N. S. Në këto kushte observacioni nuk merret në konsideratë nuk ka dokumentacion justifikues dhe situata qenka edhe më e rëndë pasi ju konfirmoni se linja është çmontuar dhe nuk është më pjesë e inventarit të thertores.

Sa i takon pretendimit se KLSH duhet të shprehet në Raport për një vlerë qiraje mujore më të ulët se 44,740 lekë, sqarojmë se KLSH nuk përcakton vlerat e qirave të zhvillimit të aktivitetit të Bashkisë, por i auditon nëse janë ose jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të objektit “Parku i lojërave të qytetit Vlorë”.

Kontrata fillestare është lidhur midis palëve, Ministria e Ekonomisë, përfaqësuar nga z. G. Gj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministri, bazuar në autorizimin e Ministrit nr. 1568/1 datë 28.5.2002, cilësuar si *Qiradhënës* dhe z. B.B, administrator i shoqërisë *o.l.ö SHPK*, të cilësuar si *Qiramarrës*, në prani të noteres zyrës së noterisë Tiranë, E.K me nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002. Sipas kësaj kontrate (neni 1), sipërfaqja e dhënë me qira përcaktohet 16112 m², nga e cila 28 m² nën objekt, me kohëzgjatje (neni 3), për një periudhë 10 vjet, duke hyrë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj. Detyrimi mujor (neni 6, pika 1) është në vlerën prej 107,413 lekë/muaj dhe për objektin 28 USD në muaj.

Me datë 3.7.2013 është lidhur Aneks Kontratë, me palët kontraktuese METE përfaqësuar nga z. G. M, Drejtor i Përgjithshëm i Ofrimit të Shërbimeve në Ministri, sipas autorizimit të Ministrit nr. 5033/1 datë 1.7.2013, në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqëria *o.l. 1ö shpk*, me seli në Vlorë, përfaqësuar nga znj. N.L në cilësinë e Qiramarrësit. Në të cilën thuhet se:

-me kërkesë të Bashkisë Vlorë nr 1381/1 të datës 21.05.2013 “për rillogaritjen e sipërfaqes së objektit të kontratës së qirasë nr.2496rep.,nr.154kol, datë 04.06.2002 dhe

- mbështetur në VKM nr.529 datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”

Në kontratën e qirasë nr.2496rep.,nr.154kol, datë 04.06.2002 dhe anekset e saj, të lidhur me Shoqërinë “I. 1” shpk, Vlorë, për objektin “Parku i Lojrave të Qytetit Vlorë” në administrim të bashkisë Vlorë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1 “Objekti i kontratës” të ndryshohet si vijon:

“Qiradhënësi jep me qira pasurinë “Parku i Lojrave i Qytetit Vlorë” me sipërfaqe totale 11.890m², prej nga 28m² janë sipërfaqe ndërtese dhe 11.862m² janë sipërfaqe funksionale, sipas genplanit të bashkëlidhur kësaj kontrate”

Neni 3 “Kohëzgjatja” riformulohet si vijon:

“Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet duke filluar nga data e nënshkrimit të saj”, duke zgjatur afatin e vlefshmërisë se kontratës nga 10 vjet në 20 vjet.

Neni 6 òPagesa e qirasëo riformulohet si vijon:

6.1 “Qiramarrësi” detyrohet ti paguaj “Qiradhënësit” detyrimin mujor në vlerën 360,060 lekë/muaj. Vlera e detyrimit mujor të qirasë do të ndryshojë kur Qiramarrësi plotëson kushtet për treguesit e investimit dhe punësimin të tërealizuar në nivelet që parashikohen në Kapitullin IV të VKM nr.529 datë 08.06.2011. Pra është ulur sipërfaqja në përdorim nga 16112 m² në 11890 m², si pasojë e zbritjes së sipërfaqeve në matje, sipërfaqeve të rrugëve dhe lulishteve brenda objektit, duke e parcelizuar padrejtësisht atë. Vlera e qirasë është përlllogaritur nga 11.890m²sip. totale në përdorim 11.862m²janë sipërfaqe trualli funksional x 30lekë/m²= 355,360 lekë/muaj dhe 28m² sipërfaqe ndërtesë x 150lekë/m² = 4,200 lekë/muaj, në total tarifa e qirasë mujore duhet të ishte 360,060 lekë/muaj.

Me VKB nr. 60, datë 27.10.2016, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 3002, datë 10.11.2016, si i ligjshëm është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, të kontratës nr. 2964 rpe/450kol, datë 4.6.2002. Ky ndryshim është bërë referuar matjeve të kryera në terren nga grupi i punës, nga ku ka rezultuar se subjekti òI. 1ò në fakt ka në përdorim sipërfaqen prej **14 960 m²**, kjo e evidentuar në procesverbalin e datës 27.01.2016 bashkë me plan vendosje, të nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i subjektit zj. N.L, (sip. për të cilën ka rënë dakord). Vendimi i Këshillit Bashkiak, nuk është shprehur për periudhën e shtrirjes së efekteve, siç thuhet në projekt-vendim nga data 03.07.2013.

Nisur nga kontrata fillestare bazë e datës 4 Qershor 2002, rezulton se, në nenin 6 òPagesa e qirasëo në pikën 6.2 përcaktohet: òNdryshimet në legjislacion të vlerës truallit do të pasqyrohen në këtë kontratë në vlerën e qirasë mujore për sipërfaqe funksionale”. Gjithashtu sipas pikës 6.5 të Aneks Kontratës, datë 1 Korrik 2005 me përmbajtje: òPas datës 4.6.2012 (datë e përfundimit të kontratës fillestare me afat 10vjet) tarifa e qirasë do të aplikohet sipas akteve ligjore në fuqi” Pra vlera e kontratës duhet të ndryshonte gjatë gjithë periudhës, për çdo rast të ndryshimit legjislacionit. Kështu sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroë, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, òTarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetëroë që jepen me qira ose enfitëozë, pikat 1/b¹⁰, vlera e qirasë për truallin funksional është 40 lekë/m² e cila rezulton nga shumëzimi i vlerës dysheme e tarifës së qirasë mujore 200lekë/m² të ndërtesës për qytetin e Vlorës x 20/100 e kësaj vlere. Pra, tarifa e qirasë mujore për m² truall funksional ka ndryshuar dhe është 40lekë/m² dhe jo më 30 lekë/m². Gjithashtu tarifa e qirasë mujore për m² ndërtesë në qytetin e Vlorës ka ndryshuar dhe është 200lekë/m² dhe jo më 150 lekë/m².

Referuar VKB nr. 60, datë 27.10.2016, nga Bashkia Vlorë në bashkëpunim me MZHETTS deri me datë 30.10.2020 nuk është amenduar kontrata e datës 04.06.2002, për të bërë të mundur ndryshimin e kushteve të kontratës për pagesën e qirasë sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të ndryshimeve të tarifës së qirasë për m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit.

Sipas VKB nr. 60 datë31.10.2016, për periudhën 01.06.2012 deri më 31.12.2017 detyrimi shtesë i lindur për subjektin òI.1ò për sipërfaqen e marrë me qira të objekti; òP. e L.ò prej 14690 m², referuar edhe të dhënave të procesverbalit të komisionit datë 27.01.2016, është llogaritur nga KLSH në vlerën 6,983,486 lekë, i cili është kërkuar për arkëtim në auditimet e mëparshme.

*Me ndryshimin e sipërfaqes faktike **14960 m²**, që subjekti ka në përdorim (me qira), çmimi përlllogaritet në vlerën 453,027 lekë/muaj (sipas vlerave të përlllogaritur nga MZHETT), **tarifë të cilën subjekti duhej të paguaj pas matjeve faktike të kryera në terren mbi sipërfaqen e shfrytëzueshme (Tetor 2016).***

Ndërsa detyrimi shtesë për tu arkëtuar për periudhën objekt auditimi 01.01.2018-30.06.2019 është në vlerën 7,284,600lekë, e cila ka rezultuar nga aplikimi i detyrimit mujor i përlllogaritur

¹⁰b) për sipërfaqen funksionale, tarifa dysheme e qirasë mujore është 20 për qind e tarifës dysheme të detyrimit mujor, të përcaktuar për ndërtesat. Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës

nisur nga ndryshimi i sipërfaqes dhe ndryshimet me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 të tarifave të qirasë. Kështu nga 14.960m² sip totale në përdorim 14.932m² janë sipërfaqe trualli funksional x 40lekë/m²= 597,280 lekë/muaj dhe 28m² sipërfaqe ndërtese x 200lekë/m² = 5,600 lekë/muaj, në total tarifa e qirasë mujore duhet të ishte 602,880 lekë/muaj. Perlllogaritja referuar pagesave dhe detyrimit real më hollësisht paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Muajt	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		6-mujori pate Viti 2021		Shuma		Diferenca per tu arketuar
	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	Detyrimi	Paguar	
JANAR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
SHKURT	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
MARS	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
PRILL	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
MAJ	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
QERSHOR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060	2,411,520	1,440,240	971,280
KORRIK	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
GUSHT	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
SHTATOR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
TETOR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
NENTOR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
DHJETOR	602,880	360,060	602,880	360,060	602,880	360,060			1,808,640	1,080,180	728,460
Shuma	7,234,560	4,320,720	7,234,560	4,320,720	7,234,560	4,320,720	3,617,280	2,160,360	25,320,960	15,122,520	10,198,440

Konkluzion: Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit *oP. i l. të qytetit Vlorë*, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:

-Është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, **shuma 10,198,440 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS**, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 *oPër disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014*o.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *oPër përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, me ndryshime*.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës.

-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 *oZgjidhja e kontratës*o pika 7.2 germa *oçö përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë*.

-Mbi të ardhurat e krijuara nga kontratat e dhënies me qira të tokave të pa ndara nga ish-Komunat aktualisht Njësitë Administrative Qendër, Shushicë dhe Novoselë.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA, Bashkia Vlorë administron 266 kontrata të dhënies me qira për 464.678 ha të tokave të panadara të lidhura që para reformës territoriale nga Ish-Komunat Qendër Shushicë dhe Novoselë. Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA Qendër nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse subjektet përfituese të tyre kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj.

Për rastet e subjekteve debitore nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezulton se për një pjesë të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë, si dhe nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Nga ish-Komuna Qendër për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjecar dhe 1 kontrate me afat 50 vite. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **7,670,532 lekëgjithsej**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2 të kontratës dhe me kërkesat ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” VKM nr. 531, datë 21.08.1998 òPër tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për tokat bujqësore të pandara”.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. S.H me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, zj. M.K me detyrë Administrator i NJA Qendër.

Nga ish-Komuna Shushicëpër periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjecar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekëgjithsej**.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi z. S.H me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, zj.B.A me detyrë Administrator i NJA Shushicë.

Nga ish-Komuna Novoselëpër periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën prej **49,621,292 lekëgjithsej**.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi z. S.H me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, zj.K.Sh me detyrë Administrator i NJA Novoselë.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kontratave dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

-Nga Bashkia Vlorë për periudhën objekt auditimi ka lidhur kontrata për qiradhënie sezonale të parcelave nga fondi kullor llogaritur mbi bazë sipërfaqe dhe numër krerësh si dhe tarifë për nr.krerësh. Nga arkëtimi i tarifave të këtyre kontratave në momentin e lidhjes së tyre janë realizuar të ardhura, ku për **vitin 2018** nga 48 kontrata të lidhura vlera prej **747,100 lekë**, për **vitin 2019** nga 41 kontratatë lidhura vlera prej **në vlerën 682,200 lekë dhe vitin 2020** nuk ka lidhje kontratash për shkak të pandemisë.

-Me VKM nr.433 datë 08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkiveò.

Për menaxhimin e këtyre pasurive nga Bashkia Vlorë nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, në kundërshtim me kërkesat të ligjit nr. 9585, datë 4.5.2005

oPër pyjet dhe shërbimin pyjorë, i ndryshuar, neni 22 pika 4¹¹, neni 23 pika 1¹² e nenit 5, pika 5 ku përcaktohet: "... planet e mbarështimit hartohen nga persona me licencë dhe miratohen në Këshillin e Bashkisë .."

Për periudhën 2018-2019-2020 për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, nuk ka raste të bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe shoqatat e pyjeve dhe atyre mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e pika 5/dh të VKM nr. 396 datë 21.6.2006 oPër kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore.

Sipërfaqe në përdorim. Ngaish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, aktualisht strukturë e Bashkisë Vlorë (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) në këtë fond pyjor janë në fuqi 2 kontrata të dhënies me qira të fondit pyjor e kullor, të ndodhura në Njësinë Administrative Shushicë me afat 10 vjet. Kontratat janë lidhur me subjektin V. N dhe subjektin oB.S shpkö. Subjekti oB.S shpköme administrator K.B, **nuk ka paguar detyrimet kontraktore në vlerën 694,000 lekë** për vitet 2018-2021, në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 5 opagesaö dhe me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 oPër përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotaveö, pika 5/1. Të dhënat për kontratat e lidhura dhe pagesat e kryera paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti	Ekonomia Pyjore	Data e Kontrates	Nr Parcele	Sip. Ha	Vlera e Qerese vjetore	Likuiduar				Debitor deri me 2020	Aktiviteti	Shenime
							2018	2019	2020	2021			
1	N.	Kume Shashic	12.09.2012	18/d	1	105,000	po	po	jo	jo	210,000	rekreacion	12.09.2020
2	B.S	Kume Shashic	05.07.2013	10b;11b	1,1	162,000	Jo	po	Jo	jo	484,000	pushim,arretim	Pa adresë
	Shuma										694,000		

Lidhur me secilën kontratë rezulton se Bashkia nuk ka mbajtur një akt inspektimi lidhur me sipërfaqen që subjekti ka vendosur në shfrytëzim me qëllim dokumentimin e saj.

Po ashtu nga momenti i kalimit të saj për ndjekje e zbatim, Bashkia Vlorë nuk ka bërë rinovimin e saj me të njëjtat kushte e përcaktime të kontratës bazë, kjo për faktin se tashmë subjekti juridik, i cili duhet ti ndjekë ato nuk ka qenë përcaktuar në kontratën fillestare. Sa sipër duke qenë se subjekti juridik DSHP Vlorë i ka kaluar kontratat subjektit Bashkia Vlorë, është e drejtë e detyrim i kësaj të fundit për zëvendësimin e palëve kontraktore.

Për periudhën 2018-2020 dhe 6 mujori i I-rë viti 2021 nga Bashkia Vlorë nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me 5 subjektet private, të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullor, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, duke bërë që buxhetit të Bashkisë Vlorë **t'ju mungojnë të ardhurat që gjenerojnë nga kryerja e këtij aktiviteti**, në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 oPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveö, lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 9.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e kontratave dhe administrimit e aseteve ngarkohet me përgjegjësi z. D.L në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, zj. S.H me detyrë Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, z. S.H me detyrë Administrator NJA Oriku, zj.M.K me detyrë Administratore e Nja Qendër, z.K.Sh me detyrë Administrator i NJA Novoselë dhe z.B.A me detyrë Administrator i NJA Shushicë.

Titulli i Gjetjes: Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënie me qira të objektit oThertoreö në Njësinë Administrative Novoselë.

Situata: Bazuar në VKB nr. 86, datë 26.07.2018 është lidhur kontrata me nr. prot. 7185, datë 15.08.2018 deri më 15.08.2019 (me afat 1 vit) ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit oL.Aö për

¹¹Fondi pyjor publik, vendor a privat, administrohet e trajtohet sipas planeve të mbarështimit, të inventarizimit dhe të funksioneve të këtij fondi

¹²Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve vendore apo i pjesëve të tyre, bëhen sipas planeve të mbarështimit dhe të dispozitave të këtij ligji

dhënien me qira të objektit me sipërfaqe $231\text{m}^2 \times 200 \text{ lekë/m}^2 = 46,200 \text{ lekë/në muaj}$ dhe dhe për truallin funksional me sipërfaqe $1082\text{m}^2 \times 20 \text{ lekë/m}^2 = 21,640 \text{ lekë}$. Totali i tarifës mujore të qirasë është në vlerën 67,840 lekë neni 3 òQirajaö. Kjo përlllogaritje është bërë në bazë të plan-vendosjes dhe plan-rilevimit të punuar nga punonjësi i bashkisë inxh. K.A, pas verifikimit në terren të objektit dhe sipërfaqes funksionale të Thertores. Nga verifikimi i pagesave rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467,840 lekë nga 814,080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likuiduar vlera prej 347,040 lekë** në kundërshtim me nenin 3 òQirajaö të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ**.

-Në VKB dhe në kontratën e nënshkruar, në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarit të imët, të cilat janë pjesë inventarin të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëm dhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjeçare (15.08.2018 - 15.8.2019), duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ**për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit të pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshtim.

Nga Bashkia Vlorë nuk është aplikuar penalitet në masën 2% të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë, sipas nenit 7 të kontratës si dhe nuk është marrë asnjë hap ligjor për mospërbushje të kushteve të kontratës të përcaktuar në nenin 9 të kontratës.

-Me VKB nr.101, datë 03.10.2019 òPër miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të të objektit òThertoreö, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44,740 lekë e përbërë nga: $231\text{m}^2 \text{ ndërtesë} \times 100 \text{ lekë/m}^2 = 23100 \text{ lekë}$ dhe $1082\text{m}^2 \text{ truall funksional} \times 20 \text{ lekë/m}^2 = 21,640 \text{ lekë}$. Ky VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënien me qira të objektit. Si rrjedhojë $44,740 \text{ lekë/muaj} \times 24 \text{ muaj} = 1,073,760 \text{ lekë}$, **shumë e cila përbën të ardhura të munguara**.

Kriteri: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreö, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitulli III, òTarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozëö, pikat 5 Kreut VI pika 2 dhe me nenin 3,7 dhe 9 të kontratës.

Ndikimi/Efekti: Në nivelin e të ardhurave vleraprej 1,067,040 lekë nga mospagesa e tarifës së qirasë.

Shkaku: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nga qiramarrësi si dhe mospenalizimi dhe mosndjekja e hapave ligjor nga Bashkia Vlorë ndaj qiramarrësit sipas parashikimeve të kontratës

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të ndjekin procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit prej **347,040 lekë**, tarifë qiraje e pa paguar nga subjekti qiramarrës òl. Aö.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorëtë analizojnë situatën e krijuar dhe të marrin masa për vënien në zbatim të VKB nr.101, datë 03.10.2019 “Për miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë”, miratuar me afat 5 vjet dhe vlerë qiraje 44,740 lekë/muaj, me qëllim shfrytëzimin e këtij ambienti dhe rritjen e të ardhurave të Bashkisë, pasi vetëm për periudhën 2 vjeçare është shkaktuar një e ardhur e munguar në shumën **1,073,760 lekë**.

Titulli i Gjetjes: Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të objektit òP. i l. të qytetit Vlorëö.

Situata: Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit òP. i l. të qytetit Vlorëö, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:

-Është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, **shuma 10,198,440 lekë**,

përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHETTS, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 òPër disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014ò.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, me ndryshime.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratësò.

-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 òZgjidhja e kontratësò pika 7.2 germa òcò përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë.

Kriteri: VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitulli III, òTarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozëò, pikat 5 Kreu VI pika 2 dhe 6 aneks-kontrata e datës 04.06. 2002, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 òPër Kodin Civil të Republikës së Shqipërisëò Pjesa V, Kreu I, neni 678.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave në vlerën 10,198,440 lekë, *paguar më pak nga qiramarrësi òI. Iò Shpk.*

Shkaku: Eshtë ulur tarifa e qirasë në objektin e aneks kontratës së datës 03.07.2013, si pasojë e zbritjes së sipërfaqes së dhënë me qira nga sipërfaqja që shfrytëzohet në fakt dhe mosaplikimi i ndryshimit ligjor të tarifave të qirasë për truall funksional dhe sipërfaqe objekti.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me MZHETT-s referuar VKB nr. 60, datë 27.10.2016 të rishikojë dhe të amendojë kontratën e datës 04.06.2002 dhe aneks-kontratën e datës 03.07.2013, duke bërë ndryshimet përkatëse në objektin e kontratës dhe në përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren prej 14,932 m² janë sipërfaqe trualli funksional dhe 28 m² sipërfaqe ndërtese, e konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të aplikohen ndryshimet e tarifës së qirasë/m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit.

Rekomandim: Strukturat drejtuese, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar *në shumën 10,198,440 lekë*, për mospërcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren si edhe mosaplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin òI. Iò Shpk.

Titulli i Gjetjes: Mbi të ardhurat e krijuara nga kontrata për dhënien me qira të tokës bujqësore.

Situata: Nga të dhënat e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA, nga Bashkia Vlorë administrohen 266 kontrata të dhënies me qira të 464.678 ha të tokave të panadara të lidhura që para reformës territoriale nga Ish-Komunat Qendër, Shushicë dhe Novoselë. Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Për rastet e subjekteve debitore nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë. Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezulton se në 97 raste të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë dhe kamatëvonesave *në vlerën 64,290,775 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë, si:*

Nga ish-Komuna Qendër për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjecar dhe 1 kontrate me afat 50 vite, të dhënat e të cilave janë të paraqitur në tabelën bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **7,670,532 lekëgjithsej**.

Nga ish-Komuna Shushicë për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjecar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë. Të dhënat e këtyre kontratave janë të paraqitur në tabelën në bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekëgjithsej**.

Nga ish-Komuna Novoselë, për periudhën vitet 2008 ó 2015 janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën **prej 49,621,292 lekë gjithsej**.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kontratave dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

Kriteri: pikat 2 dhe 5 të kontratave, ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 òPër tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për tokat bujqësore të pandara”.

Ndikimi/Efekti: Ulje në nivelin e të ardhurave.

Shkaku: Mos menaxhimi dhe mosmonitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturat NJA.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrë masa për monitorimin dhe rishikimin e kontratave për subjektet private që janë debitorë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për anulimin e kontratave që nuk janë aktive si dhe ndjekjen e arkëtimit e detyrimeve debitorë.

Titulli i Gjetjes: Mbi menaxhimin e fondit pyjor dhe në vecanti të mirëmbajtjes dhe mbarështimit të òPyllit të Sodës.ò

Situata: Me VKM nr. 433 datë 08.0.2016 òPër transferimin në pronësi të të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkiveò i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Vlorë pyjet dhe kullota që shtrihen në territorin e saj.

Për menaxhimin e këtyre pasurive nga Bashkia Vlorë nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri mbarështimit të pyjeve e kullotave e për pasojë mungojnë dhe planet operacionale vjetore. Sipas Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave shkaqet janë:

a. Transferimi i pyjeve dhe kullotave nuk është realizuar në masën 100% si fond kadastral me VKM nr. 433 datë 08.0.2016, pasi ngastrat nga nr. 59 deri nr. 65, të ekonomisë pyjore Tragjas-Shëngjergj, kanë mbetur jashtë shtojcës nr. 61 të kësaj VKM-je.

b. Gjithashtu procesi i transferimit shoqëruar me problematiken e konflikteve midis komunave apo bashkive në lidhje me grup ngastrash pyjore/kullorë që shtriheshin në kufi të tyre, ka

kushtëzuar dhe penguar regjistrimin e kësaj pasurie pranë ZRPP. Kështu duke mos qenë pronarë të këtyre pasurive pengohet edhe përgatitja e planeve të mbarështrimit të pyjeve në bazë të ligjit të ri nr. 57/2020 datë 30.4.2020 *oPër Pyjet*.

Ngaish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, aktualisht strukturë e Bashkisë Vlorë (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) në këtë fond pyjor janë në fuqi 2 kontrata të dhënies me qira të fondit pyjor e kullor, të ndodhura në Njësinë Administrative Shushicë me afat 10 vjet. Kontratat janë lidhur me subjektin V. N dhe subjektin oB. S. shpk. Subjekti oB. S. shpk me administrator K. B, ***nuk ka paguar detyrimet kontraktore në vlerën 484,000 lekë*** për vitet 2019-2021.

Kriteri: ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 *oPër pyjet dhe shërbimin pyjorë* i ndryshuar, neni 11/ç, neni 20, ligjin nr. 5/2016 datë 04.02.2016 *oPër shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë* neni 3 pika 1/a, c, VKM nr. 438, datë 08.06.2016 *oPër kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pjore e jo pjore* Kreu II, Kreu III pika 16 dhe 18, Kreu VIII pika 36, me nenin 5 të kontratës të datës 05.07.2013 të lidhur me subjektin oB. S.ö Shpk, VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 *oPër përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave*, pika 5/1.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e ndërhyrjeve rigjeneruese në Pyllin e Sodës, dhe ulja e nivelit të të ardhurave në vlerën ***694,000 lekë***.

Shkaku: Mos zhvillimi i procedurave për ndërhyrje rigjeneruese në Pyllin e Sodës dhe mos menaxhimi i kontratave të qiradhënies së parcelave të fondit pyjor deri në marrjen e masave administrative dhe ligjore për debitorët nga menaxhimi i Bashkisë Vlorë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë në mbështetje të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave të fillojnë procedurat për hartimin e planeve në mbrojtje të pyjeve, në zhvillimin e ankandeve për pastrimin e Pyllit të Sodës nga drurët e rrëzuar, thyer apo shkukur nga era apo prerja e drurëve si edhe ndërhyrje rigjeneruese higjeno-sanitare.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej ***484,000 lekë***, nga subjekti oB. S.ö Shpk qiramarrës i parcelës pyjore 10b;11b me sipërfaqe 1.1 ha dhe nëse nuk plotësohen kushtet e kontratës për pagesën e tarifës së qirasë të merren masa deri në anulimin e kësaj kontrate.

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej ***210,000 lekë***, nga subjekti oN.ö Shpk.

-Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga qiradhënia e hapësirave të plazhit nga Bashkia Vlorë

U shqyrtua dokumentacioni si mëposhtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë për miratimin e paketave fiskale të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021.
- Dosjet e subjekteve me dokumentacionin e aplikimit për lidhje kontrata.
- Kontrata, aktmarrëveshje dhe databaze të kontratave të qirave të administruara nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
- Evidenca dhe dokumentacioni financiar për arkëtimin e të ardhurave nga qiradhëniet e hapësirave të plazheve.
- Dokumentacioni i likuidimeve i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për arkëtimin e tarifave të qirave nga kontratat e lidhura.

-Mbi të ardhurat e realizuara nga zbatimi i kontratave të lidhura për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pagesa e detyrimeve të subjekteve.

Për vitet 2018-2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 550 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, mbi bazë kontratash, aktmarrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe të

Menaxhimit të Aseteve dhe të aplikimit në sistemin elektronik të ngritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në paketat fiskale të miratuara me VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109, datë 27.11.2019, në VKM nr. 369, datë 18.05.2016, òPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò dhe vendim nr. 171, datë 27.3.2019 òPër miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò.

Për vitin 2018 janë faturuar tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit nga 178 subjekte për një sipërfaqe prej 61534m², në bazë kontratash, aktmarrëveshjesh dhe kërkesash për shfrytëzim hapësira plazhi, **duke mos lidhur kontrata sipas dispozitave ligjore në 93 raste**, në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, òPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò neni 4 pika 8¹³, ku nga këto në **8 raste subjektet nuk kanë paguar tarifën e qirasë** për sipërfaqet e plazhit që kanë shfrytëzuar **në vlerën prej 710,000 lekë**, të cilat në mungesë të kontratave, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, duke mos u klasifikuar në detyrime kontraktore për tu ndjekur ligjërisht për arkëtim. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dosjeve rezultoi së në 2 raste është bërë kontraktim i gabuar në lidhje me sipërfaqen sipas plan-rilevimit të paraqitur, duke sjellë **mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 778,000 lekë, sipas kontratave të subjekteve**: M. Mnë vlerën 768,000 lekë dhe V. N në vlerën 10,000 lekë, për mospagesë në vlerë të plotë të kontratës dhe kontraktim të gabuar në lidhje me sipërfaqen sipas plan-rilevimit të paraqitur.

a.Plazhi i Vjetër-Plazhi i Ri-Jonufër për sipërfaqen prej 27154 m² që shfrytëzohet nga 70 subjekte, persona juridik e fizik është faturuar detyrimi në vlerën 12,800,000 lekë nga ku është arkëtuar vlera prej 12,750,000 lekë. Nga këto me 31 subjekte nuk janë lidhur **kontrata**, të cilët kanë kryer pagesat, përvec rastit të subjektit F. C me vlerë debitore pjesore prej 50,000 lekë. Në 2 raste sipërfaqet e paguara referuar kontratës apo plan-rilevimit ndryshojnë nga sipërfaqja e faturuar dhe pagesa e kryer për to, **duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në vlerën 778,000 lekë**.

1. Kontrata nr.prot 3884, datë 17.05.2018 e lidhur nga palët për Bashkinë Vlorë z. D. L (Kryetar bashkie) dhe komisioni me kryetar S. H (kryetar), O. B (anetar), A. Xh(anëtar) dhe subjekti òM. Mò. Kjo kontratë në nenin 1 òObjekti i kontratësò përcakton: *“Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit të ndodhur në “Plazhin e vjetër” me sipërfaqe prej 4920m², në administrimin e qiradhënësit, sipas hartës bashkëngjitur.”* Gjithashtu në nenin 6 òPagesa e qirasëò përcaktohet se:

Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit qiranë për 4 muaj e gjysëm sezon turistik në vlerën prej 4920m² x 400lekë/m² sezon turistik =1,968,000 lekë.....” Kjo kontratë është lidhur në bazë të kërkesës së subjektit, administratores së shoqërisë òL. 2011ò, e protokolluar me nr.4700, datë 11.06.2018, pas lidhjes së kontratës, në të cilën sipërfaqja e kërkuar është 4920m². Ndërsa pagesa është kryer për 3000 m² x 400lekë/m² sezoni turistik=1,200,000 lekë, pra **më pak 768,000 lekë**.

2. Kontrata nr.prot 5595, datë 02.07.2018 e lidhur nga palët për Bashkinë Vlorë z. D. L (Kryetar bashkie) dhe komisioni S. H(kryetar),O. B (anetar),A. Xh(anëtar) dhe subjekti **“V. N”**. Kjo kontratë në nenin nenin 1 òObjekti i kontratësò përcakton: *“Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit të ndodhur në “Plazhin e vjetër” me sipërfaqe prej 400m², në administrimin e qiradhënësit, sipas hartës bashkëngjitur.”* Gjithashtu në nenin 6 òPagesa e qirasëò përcaktohet se: *Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit qiranë për 4 muaj e gjysëm sezon turistik në vlerën prej 300m²x 400lekë/m² sezon turistik=120,000 lekë.....”* sipas paraqitjes grafike të stacionit të plazhit(parcelës) përmasat janë 50m x 6.5m = 325m², pra me një shtesë sipërfaqe prej 25m² nga ajo e kontraktuar. Atëherë kjo sipërfaqe prej 325m² x 400lekë/m² sezoni turistik=130,000 lekë, pra **me një diferencë prej 10,000 lekë**.

¹³Subjektet e interesuara pasi përzgjidhen, regjistrohen si subjekte tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, nëse nuk janë të regjistruara që në fazën e aplikimit, dhe nënshkruajnë me njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse kontratën e qirasë për përdorimin e hapësirës së plazhit për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit, sipas modelit të kontratës të parashikuar në shtojcën 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

b.Plazhi Radhimë – Oriku për sipërfaqen prej 22140m² që shfrytëzohet nga 80 subjekte, persona juridik e fizik është faturuar detyrimi në vlerën 11,008,500 lekë, nga ku është arkëtuar vlera prej 10,298,500 lekë. Nga këto për 43 subjekte nuk janë lidhur kontrata, por kanë kryer pagesat. Ndërsa debitorë janë **8 subjekte** të cilët kanë ushtruar aktivitetet pa lidhur kontratë me Bashkinë Vlorë dhe për pasojë nuk kanë paguar tarifën e qirasë për sipërfaqen që ato shfrytëzojnë në **vlerën 710,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë. Rastet debitore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emer	Mbiemer	Adresa	Sip ne M2	Tarifa lekë/m2 sipas zones	Vlera	paguar	Debitor Viti 2018	Nr dhe data e kontratës
1	B.	Gj.	Radhime	220	500	110000		110000	Pa kontrate
2	D.	B.	Radhime	200	500	100000	50000	50000	Pa kontrate
3	F.	M.	Orikum	200	500	100000	Dok.parregullt	100000	Pa kontrate
4	G.	H.	Radhime	200	500	100000		100000	Pa kontrate
5	J.	A.	Orikum	150	500	25000		25000	Pa kontrate
6	K.	S.	Radhime	500	500	250000		250000	Pa kontrate
7	M.	P.	Radhime	150	500	75000	50000	25000	Pa kontrate
8	M.	B.	Radhime	100	500	50000		50000	Akt 16.8.2018
		Shuma				810,000	100000	710,000	

c. Plazhi Zvërnec për sipërfaqen prej 12240 m² që shfrytëzohet nga 28 subjekte, persona juridik e fizik është faturuar detyrimi në vlerën 4.336.400 lekë nga ku është arkëtuar vlera prej 4.174.400 lekë. Nga këto me 19 subjekte nuk janë lidhur kontrata, por të cilët kanë kryer pagesat. Ndërsa debitorë janë 3 subjekte, të cilat kanë ushtruar aktivitetet pa lidhur kontratë me Bashkinë Vlorë dhe nuk kanë paguar tarifën e qirasë për sipërfaqen që ato shfrytëzojnë në **vlerën 162,400 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë. Rastet debitore paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	EMER	MBIEMER	Sip në m2	Tarifa lekë/m2 sipas zones	DETYRIM	ARKETUAR	DATE	Debitorë	Nr dhe data e kontratës
1	A.	G.	285	400	114.000	57000	20.07.2018	57.000	Pa kontrate
1	F.	A.	250	400	100.000	50.000	26.07.2018	50.000	Pa kontrate
3	E.	K.	277	400	110.800	55.400	31.07.2018	55.400	nr.6913, date 06.08.2018
		Shuma	12240					162,400	

Për vitin 2019 janë faturuar tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit 212 subjekte për një sipërfaqe prej 63648m², në bazë kontratash, aktmarrë veshjesh, ku nga këto 2 subjekte praqiten **debitorë në vlerën 70,000 lekë**. Ndërsa nga shqyrtimi i dosjeve rezultuan diferenca në sipërfaqe nga ajo e kontraktuar referuar plan-rilevimeve si dhe faturime detyrimesh në vlera më të vogla se detyrimet kontraktore mbi bazën e të cilave janë kryer dhe pagesat më pak se vlera e kontratave, **duke sjellë dëm ekonomik në të ardhura në vlerën 744,000 lekë për 4 raste kontratash sipas subjekteve:** A. Xh. në vlerën 20,000 lekë, F. M. në vlerën 194,000 lekë, L. F. në vlerën 50,000 lekë, A. Z. në vlerën 480,000 lekë

a.Plazhi i Vjetër-Plazhi i Ri-Jonufer nga 74 subjekte, persona juridik e fizik, për zënie e hapësirës publike të plazhit me sipërfaqe prej 25858 m² me vlerë tarife qiraje prej 12,189,000 lekë, ku është arkëtuar vlera prej 12.169,000 lekë, duke mbetur **debitorë 1 subjekt A. K. në vlerën 20,000 lekë**. Kontratat janë lidhur në korrik të vitit 2019.

b.Radhimë - Oriku për sipërfaqen prej 25026 m² që shfrytëzohet nga 100 subjekte, persona juridik e fizik është faturuar detyrimi në vlerën 12,245,000 lekë në fakt është arkëtuar vlera prej 12,195,000 lekë, duke mbetur **debitor 1 subjekt në vlerën 50,000 lekë**. Në 4 raste kontratash sipërfaqet referuar kontratës apo plan-rilevimit ndryshojnë nga sipërfaqja e faturuar dhe pagesa e kryer për to, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 744,000 lekë**.

1. Akt-Marrëveshja 6397 datë 24.07.2019 e lidhur për Bashkinë Vlorë nga S. H dhe subjekti òA. Xhò. Në këtë marrëveshje është përcaktuar vlera e qirasë 75000 lekë që i takon sip prej 150 m² në Oriku, ndërkohë që është faturuar dhe paguar në vlerën 50,000 lekë, **pra më pak 20,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik**.

2. Kontrata nr.prot 6411 datë 26.07.2019 e lidhur nga palët për Bashkinë Vlorë z. D. L (Kryetar Bashkie) dhe komisioni S. H (kryetar), K. A (anetar), V. Z (anetar) dhe subjekti òF. Mò. Kjo

kontratë në nenin 1 òObjekti i kontratësò citohet: “Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e hapësirës së plazhit të ndodhur në “Radhimë” me sipërfaqe prej 200m2, në administrimin e qiradhënësit, sipas hartës së bashkëngjitur.” Gjithashtu në nenin 6 òPagesa e qirasëòpërcaktohet se: “1. Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë qiradhënësit qiranë për 4 muaj e gjysëm sezon turistik në vlerën prej 200m2x 500lekë/m2 sezon turistik=100,000 lekë.....” sipas paraqitjes grafike të stacionit të plazhit(parcelës) sipërfaqja është 588m2, pra me një shtesë sipërfaqe prej 350m2 nga ajo e kontraktuar. Atëherë kjo sipërfaqe prej 588 m2 x 500lekë/m2 sezoni turistik = 294,000 lekë, pra me një diferencë prej 194,000 lekë, që përbën dëm ekonomik.

3. Kontrata nr.prot 6404 datë 24.07.2019 e lidhur nga palët për Bashkinë Vlorë z. D. L (Kryetar Bashkie) dhe komisioni S. H (kryetar), K. A dhe subjekti òL.Fö. Sipas QKB të lëshura në datë 08.5.2019 ky subjekt figuron i pezulluar.mungon plan-vendosja. Kjo kontratë në nenin 6 òPagesa e qirasëòpërcaktohet se: “1. Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë qiradhënësit qiranë për 4 muaj e gjysëm sezon turistik në vlerën prej 300m2x 500lekë/m2 sezon turistik =150,000 lekë.....” ndërsa faturuar nga S. H është bërë në vlerën 100,000 lekë dhe pagesa është bërë në këtë vlerë, pra me një diferencë prej 50,000 lekë, që përbën dëm ekonomik.

4. Kontrata nr.prot 3108 datë 10.04.2019 e lidhur nga palët për Bashkinë Vlorë z. D. L (Kryetar Bashkie) dhe komisioni S. H (kryetar) dhe K. A (anetar) dhe subjekti òA. Zö. Kjo kontratë në nenin 6 òPagesa e qirasëòpërcaktohet se: “1. Qiramarrësi detyrohet t’i paguajë qiradhënësit qiranë për 4 muaj e gjysëm sezon turistik në vlerën prej 1600m2x 200lekë/m2 sezon turistik=320,000 lekë.....” faturuar nga S. H në këtë vlerë mbi bazën e së cilës është kryer dhe pagesa.Ndërkohë që në këtë zonë plazhi tarifa e qirasë është 500 lekë/m2/sezoni turistik dhe jo 200lekë/m2, pra me një diferencë prej 480,000 lekë (1600x500lekë/m2 =800000lekë), që përbën dëm ekonomik. Rastet e debitorëve dhe të diferencave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	EMER	MBIEMER	VENDODHJA	Sip sipas fat	Sip. m2 sipas databazes se dhënë	Çmimi ne lek	Vlera e faturuar	Pagesa	Vlera e llogaritur	Diferenc debitore
			Radhime-Orikum							
1	A.	Xh.	Orikum	sipas Akt-marrv detyrimi është 75000	100	500	50000	50000	75000	20000
2	F.	M.	Radhime	sipas planvendosjes sip.është 588m2	200	500	100000	100000	294000	194000
3	L.	F.	Orikum	sipas kontrates sip.është 300m2	200	500	100000	100000	150000	50000
4	Sh.	G.	Radhime	Paguar me pak detyrimin kontraktor	200	500	100000	50000	50000	50000
5	A.	Z.	Radhime	Tarif 500lek/m2 sezoni dhe jo 200lek/m2	1600	200	320000	320000	800000	480000
							670000	620000	1319000	794000

c. **Zvërnec** për sipërfaqen prej 12764 m2 që shfrytëzohet nga 38 subjekte, persona juridik e fizik është faturuar detyrimi në vlerën4,930,080 lekë, nga ku është arkëtuar vlera prej 4,930,080 lekë, nuk ka debitorë.

-Mbi zbatimin dhe rregullshmërinë e procedurave për lidhjen e kontratave për zënie e hapësirave të zonave të plazhit

Në auditimin e ushtruar në dokumentacionin bashkëshoqërues të kontratave të dhënies me qera të hapësirave të plazhit u krye kampionimi i 37 dosjeve për vitin 2018 dhe 46 dosjeve për vitin 2019 dhe nga testimi i tyre u konstatuan mangësi si:

- Ka 93 raste moslidhje kontratash me subjektet që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit në vitin 2018. Ndërsa kontratat që janë bërë janë lidhur kryesisht në muajt korrik dhe gusht, pra jo në fillim sezoni në maj.
- Në disa raste subjektet nuk kanë paraqitur vërtetimet për detyrimet që kanë ndaj ose në DPTR Vlorë dhe DTTV Bashkia Vlorë ose në disa raste të tjera sipas vërtetimeve të paraqitura ato figurojnë debitorë ndaj strukturave tatimore.
- Në një pjesë të rasteve mungojnë ekstrakti i QKB apo Plan-bizneset
- Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera, pra dokumenti bankar mbi arkëtimin e detyrimeve kontraktuale
- Pothuajse në të gjitha rastet e dhënies në përdorim të hapësirës së plazhit, u konstatua se në një pjesë të madhe të kontratave nuk shoqëroheshin me planvendosje. Ndërsa në rastet kur planvendosjet apo plan-rilevimet ekzistonin, në to nuk evidentoheshin përmasat e parcelës, mbi

bazën e secilës është përlllogaritur sipërfaqja e përcaktuar në kontratë. Në planvendosje nuk ka të dhëna për largësinë e parcelës nga vija bregdetare nëse është respektuar apo jo distanca të paktën prej 7.5 m nga vija e bregut të detit, si dhe nëse është lënë e lirë hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave për t'u shfrytëzuar nga publiku. Gjithashtu në planvendosje nuk evidentohet shpërndarja e çadrave për të parë nëse është respektuar hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) e cila duhet të jetë minimumi 2.5 m.

-Mungojnë vërtetimet e pagesave të detyrimeve të tjera lokale si tarifë pastrimi, tarifë gjelbërimi dhe tarifë ndriçimi,

-Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar

-Mungojnë dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar.

-Në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik. Mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit. Pra ky dokumentacion mungonte, edhe pse qiramarrës ishin po të njëjtët subjekte në të njëjtat zona të plazhit, të cilët e kanë detyrim ligjor paraqitjen e akteve të Monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës në momentin e rinovimit të kontratave. Po kështu edhe komisionet e ngritura me urdhër të Titullarit për çdo vit për verifikime në terren nuk kanë funksionuar.

- Në disa raste, pagesa e qirasë është kryer shumë me vonesë deri disa muaj pas mbarimit të sezonit.

Për vitin 2018 rastet e testuara me të dhënat e mangësive paraqiten në tabelën e mëposhtme:

nIPT	#NAM E?	MBIEM ER	Sipërfaqe m2	cmimi ne lek	Vlera	Dok QKB	Veret tatimor	Dr.TT V		veret Gjyqes	Plan biznes	fatura	
			Plazh I vjeter- plazh I ri- Jonufer					DPTTR Vlore	B. Vlore				
5133 dt.19.06.2018 mung	A.	T.	200	400	80000	po	jo	jo	po	po	jo	po	
.6992 dt.04.07.08	A.	H.	300	400	120000	QKB pezullu	jo	jo	jo	po	jo	po	
6673, dt 27.07.2018	A.	A.	150	400	60000	po	jo	jo	po	po	po	po	
Pa kontrate	A.	S.	100	500	50000	jo	po	jo	po	jo	jo	po	
nr.6997,date.07.08.2018	A.	Z.	720	500	360000	nuk ka	po	jo	jo	po	jo		
7236 dt 16.08.2018	A.	B.	300	400	120000	jo	jo	po	jo	po	jo		
7254 dt16.08.2018	A.	V.	600	500	300000	jo	jo	po	po	po	jo	pa fatur	
7240 dt 16.08.2018	B.	T.	450	400	180000	po	jo	po	jo	po	po		
7251 dt 16.08.2018	B.	G.	500	400	200000	po	jo	po	po	po	po		
nr.6996,date.07.08.2018	D.	H.	200	500	100000	ka	jo	po	jo	jo	po		
Pa kontrate	D.	D.	700	500	350000	po	po	jo	jo	po	jo	pa fature	
Pa kontrate	H.	Z.	800	500	400000	jo	jo	jo	po	jo	jo		
nr.6991, date 07.08.2018	E.	Sh.	200	400	80000	po	jo	jo	po	po	po	po	
Pa kontrate	F.	C.	200	500	100000	po	jo	jo	jo	po		po	
nr.5592 date.02.07.2018	F.	S.	500	500	250000	po	po	po	po	po	po	po	
nr.6999, date.07.08.2018	G.	I.	100	500	50000	jo	po	jo	jo	po	po	po	
nr.6993,07.08.2018	I.	B.	300	400	120000	po	debi 38777 lek	jo	po	po	jo	po	
7258 dt16.08.2018	K.	M.	300	500	150000	jo	jo	jo	jo	jo	jo		
Pa kontrate	K.	T.	400	400	160000	po	jo	jo	jo	po	jo	pa fature	
7235 dt 16.08.2018	L.	I.	220	400	88000	jo	jo	jo	jo	jo	jo		
nr.6994, date 07.08.2018	M.	L.	200	400	80000	po	jo	jo	po	po	jo	po	
Pa kontrate	M.	H.	100	500	50000	po		po		po	po	pa fature	
3884 dt.17.06.2018 per 4920 m2	M.	M.	3000	400	1200000	po	po	po	po	po	jo	po	
Pa kontrate	M.	T.	780	500	390000		jo	jo	jo	jo	jo	fat kest I	
nr.6899, date.06.08.2018	O.	B.	300	500	150000	po	jo	jo	po	po	po	po	
Ka aplikuar olsi dhe jo Mondit qe ka niptin	O.	V.	800	500	400000	po	po	jo	po	po	po	po	
nr.6998,date.12.06.2018	O.	H.	300	500	150000	po	jo	jo	po	po	jo	po	
5175 dt.22.06.2018 mung	R.	D.	600	400	240000	po	jo	jo	po	po	jo	po	
nr.6995, date.07.08.2018	S.	S.	500	500	250000	po	po	po	po	po	jo		
Pa kontrate	S.	M.	50	500	25000	po	po	po	po	po	jo	po	
Pa kontrate	V.	H.	400	500	200000	po	po	jo	po	po	po	pa fature	
Pa kontrate	V.	D.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo		
nr.5595,date.02.07.2018 sipas plavendos 325m2	V.	N.	300	400	120000	jo	debi 254264lek	jo	po	po	po	po	
pa kontrate	E.	N.	50	400	20000	po	jo	jo	jo	jo	jo	po	
7249 dt16.08.2018	K.	K.	400	400	160000	po	jo	po	jo	po	jo		
Pa kontrate	A.	K.	50	400	20000	po	jo	jo	jo	po	jo	po	
nr.7203 dt.15.08.2018	B.	L.	1000	500	500000	po	po	po	po	po	po		

Për vitin 2019 rastet e testuara me të dhënat e mangësive paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Nr.date kontrate	EMER	MBIEMER	Sip. m2	Çmimi ne lek	Vlera	Dok QKB	DPTR Vlore	DRTTV B.Vlore	Plan rilevim	vert Gjyq	Plan biznes	fature
1	6414	A.	N.	200	500	100000	po	jo	jo	po	po	po	pa fature
4	akt-marrv 6640dt26.07.19	M.	S.	100	500	50000	po	jo	jo	jo	jo	jo	jo
5	6397dt.24.07.2019	A.	Xh.	100	500	50000	po	jo	po	jo	jo	jo	po
7	6564dt25.072019	E.	H.	200	500	100000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
10	6415dt 24.07.2019	A.	R.	288	500	144000	jo	jo	po	po	po	po	po
13	6642dt26.07.2019	A.	H.	400	500	200000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
15	6373dt24.07.2019	A.	L.	200	500	100000	po	po			po	po	pa fature
17	6643dt26.07.2019	A.	M.	200	500	100000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	jo
23	6401dt24.07.2019	B.	D.	200	500	100000	po	debi 53465	jo	po	po	jo	po
24	akt-marrv 6567dt25.07.19	B.	L.	150	500	75000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
25	6399dt24.07.2019	B.	B.	2500	500	1250000	jo	po	po	jo	po	jo	po
26	6652dt26.07.2019	D.	A.	250	500	125000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
27	6398dt24.07.2019	D.	N.	200	500	100000	jo		po	po	po	po	fat 50000
30	6552dt25.07.2019	E.	K.	200	500	100000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
33	6405dt24.07.2019	E.	G.	200	500	100000	po	jo	jo	po	po	jo	po
34	6406 dt24.07.2019	E.	M.	635	500	317500	jo	po	jo	po	po	po	po
35	akt-marrv 6396dt24.07.19	E.	B.	100	500	50000	po			po			
	akt-marrv 6563dt25.07.19	E.	M.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	jo
38		E.	Z.	100	500	50000	po	jo	jo	po	po	jo	po
39	6644 dt 26.07.2019	E.	Gj.	210	500	105000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
40	Akt-marrv6400dt24.7.2019	E.	Sh.	100	500	50000	po	po		po	po	jo	jo
44	6650dt 26.07.2019	F.	M.	200	500	100000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
45	6416	F.	Gj.	200	500	100000	jo	po	jo	po	po	jo	pa fature
46	6411	F.	M.	200	500	100000	jo	jo	jo	po	jo	jo	pa fature
48	6565 dt 25.07.2019	G.	N.	200	500	100000							
49	6409 dt.24.07.2019	G.	B.	400	500	200000	po	po	po	jo	po	jo	fat 200m
52	akt-marrv 6576dt25.07.19	G.	L.	100	500	50000	po	jo	jo	jo	jo	jo	po
55	akt-marrv6564dt 25.07.2019	K.	S.	100	500	50000	QKB	jo	jo	jo	jo	jo	jo
57	akt-marrv6633dt 26.07.2019	K.	C.	150	500	75000	jo	C.	jo	jo	jo	jo	jo
58	6407dt24.07.2019	K.	Xh.	200	500	100000	po	jo	jo	po	jo	jo	po
60	6404dt24.07.2019	L.	F.	200	500	100000	QKB pezullu 8.5.19	po		jo	po	jo	po fat 200m2
62	6553dt25.07.2019	L.	B.	100	500	50000	jo	jo	po	jo	po	jo	po
65	6413	L.	B.	200	500	100000	po	jo	po	po	po	jo	po
69	Akt-marrv6566dt25.07.2019	M.	Ll.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
71	Akt-marrv6638dt26.07.2019	M.	P.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	jo
74	6412	M.	M.	200	500	100000	po	po	jo	jo	po	jo	po
76	Akt-marrv6634dt26.07.2019	N.	H.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
81	6417	R.	D.	200	500	100000	po	po	po	jo	po	po	po
84	6590	S.	D.	200	500	100000	po	jo	po	po	po	po	po
85	6410dt24.07.2019	Sh.	G.	200	500	100000	po	po	po		po	po	fat 50000
87	6635 dt 26.07.2019	T.	L.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	jo
88	6645dt26.07.2019	V.	B.	400	500	200000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	jo
89	Akt-marrv6568dt 25.07.2019	Xh.	M.	100	500	50000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
90	akt-marrv 6395dt24.07.19	Xh.	S.	100	500	50000	po	jo	jo	po	jo	jo	po
91	akt-marrv 6580dt25.07.19	Z.	H.	70	500	35000	jo	jo	jo	jo	jo	jo	po
95	6419 dt24.07.2019	M.	C.	100	500	50000	po	po	po	po	po	jo	po
96	akt-marrv 6402dt24.07.19	I.	Sh.	150	500	75000	jo	po	po	jo	po	jo	po

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, òPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò neni 4 pika 3¹⁴, neni 5 pika 1¹⁵, me VKM nr.321 datë datë 28.05.2014 òPër sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujoreoi ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, Kreu III pika 9¹⁶,Kreu IV pika 1¹⁷shtojca B-3¹⁸ me VKB nr.100, datë 22.12.2017, òPër

¹⁴Në aplikimin për marrjenë përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit subjektet e interesuara paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:-Kërkesën e subjektit për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;-Planin e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, duke përfshirë parashikimin e vlerës së investimit, të ardhurave dhe shpenzimeve;-Dokumentacion për të vërtetuar eksperiencë të mëparshme pozitive në ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit;-Ekstraktin e regjistrimit të subjektit të lëshuar nga organet përkatëse, nëse ka;-Vërtetim nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore;-Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është nëndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

¹⁵Kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi në plazhet e tipit A, janë si më poshtë:a) Për çadrat dhe ndenjset e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 7.5 m nga vija e bregut të detit, liqenit, lumit.b) Hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;c) Hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 m në linjë vertikale me vijën e ujit;

¹⁶Njësitë e Qeverisjes Vendoreduhet të përgatitin dhe të mbajnë inventar për lejet e dhëna, datat e inspektimit për kontrollin e përmbushjes së kushteve dhe përcaktimin e qartë të vendndodhjes së veprimtarive të lejuara sipas këtij vendimi

¹⁷Cdo njësi të qeverisjes vendore, që kanë përgjegjësi administrimi dhe që është subjekt autorizimi për përdorim, të lërë në dispozicion për "plazh publik"20% të territorit të përgjithshëm të plazhit. Plazhi publik të menaxhohet dhe

miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë. Kreu II të Tarifave vendore, me kontratë tip të miratuar të lidhur ndërmjet palëve nëni 6-pagesa e qirasë nëni 5 të detyrimet qiramarrësitöpika¹⁹.

Për vitin 2020 Procedura mbi dhënien në përdorim të hapësirave të plazhit në sezonin turistik ka ndryshuar referuar VKM nr. 424 datë 27.05.2020 dhe për një shtesë në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 dhe për miratimin e rregullores dhe kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST), organ i ngritur sipas kësaj VKM-je, i cili ka miratuar hartën së përgjithshme për plazhet e lejuara sipas koordinatave të përcaktuara. Subjektet e interesuar kanë aplikuar në sistem elektronik të krijuar nga Ministria Turizmit dhe Mjedisit, ku aplikimet janë shqyrtuar nga Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA). Subjektet e kualifikuara kanë lidhur kontrata me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, duke u pajisur me certifikatat e përdorimit të stacioneve të plazheve, ku sipas pikës 12²⁰ të nenit të 14 të ndryshuar me VKM nr.424 datë 27.05.2020 përcaktohet se përfitues i tarifës së qirasë nga kontrata e lidhura janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve mbi bazën e informacionit që ka marrë në rrugë zyrtare për kontratat e lidhura, për vitin 2020 janë 168 subjekte që u është dhënë e drejta për shfrytëzimin e hapësirave publike në zonën e plazhit prej 58752 m² kundrejt pagesës së tarifës së qirasë të miratuar në paketën fiskale në zonat: Plazh i Vjetër dhe Plazh i Ri- Jonufër dhe Radhime-Orikum dhe Zvërnec.

Detyrimi i evidentuar është në vlerën 28,619,600 lekë dhe pagesat e kryera janë në vlerën prej 28,619,600 lekë, pasi një nga kushtet për finalizimin e kërkesave të aplikuesve për qiramarrje në lidhje kontrate është që pas njoftimit paraprak për kualifikim nga procesi i shqyrtimit të kontratave, aplikuesi duhet të kryejë pagesën në bazë të faturimit nga njësia vendore si dhe gjenerimin në sistem *on-line* nga subjekti të konfirmës bankare për likuidimin e kryer.

Sipas tabelës së kontratave rezulton se në 1 rast subjekti P.ö ka një sipërfaqe prej 3405m² në shfrytëzim hapësirë plazhi në Zvërnec, i cili është faturuar me tarifën e qirasë prej 200 lekë/m² /sezoni dhe jo me 400 lekë/m², tarifë e përcaktuar në paketën fiskale për këtë zonë plazhi, **duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 681,000 lekë** [1,362,000 lekë detyrimi real (3405m² x 400 lekë/m²/sezoni)- 681,000 lekë e faturuar (3405m² x 200 lekë/m²/sezoni) = 681,000 lekë].

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr.424 datë 27.05.2020 dhe për një shtesë në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 dhe për miratimin e rregullores dhe kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit VKM nr. 171, datë 27.3.2019 dhe për miratimin e rregullores dhe kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit nëni 14 pika 10, nën-pika b në të cilën përcaktohet: *“b) Në rast subjekti plotëson kriteret sipas pikës 6, të këtij neni, dhe dokumentacioni rezulton i plotë, grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) njofton menjëherë subjektin dhe njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për kualifikimin paraprak, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme, brenda 5 (pesë) ditëve, si më poshtë vijon: i. Negociimi ndërmjet subjektit dhe njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore mbi sipërfaqen konkrete që do t'i jepet në përdorim subjektit të kualifikuar për përdorimin si stacion plazhi; ii. Gjenerimi i faturës nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore për kryerjen e pagesës së tarifës për sipërfaqen konkrete të negociuar më sipër; iii. Kryerja dhe ngarkimi në*

të jetë në administrim të njërive të qeverisjes vendore. Shpërbardja për stacionet e plazhit publik dhe privat të bëhet në mënyrë proporcionale

¹⁸Në rast të mosrespektimit të kërkesave dhe kushteve të lejes/autorizimit nga subjekte private për menaxhimin e hapësirave dhe ushtrimit të veprimtarisë në zonat e plazhit, njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin sanksione përkatëse sipas dispozitave në fuqi. Këto sanksione përcaktohen dhe në kontratën e lidhur midis njësisë të qeverisjes vendore dhe subjektit përkatës.

¹⁹Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te qira-dhënësi dokumentacionin e monitorimit nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve minimale për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.

²⁰12. Kontrata për dhënien në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, me përfitues njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, sipas modelit tip, të përcaktuar në shtojcën 8, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dhe kanë afat 1-vjeçar, të vlefshme vetëm për sezonin turistik 202

sistemin on-line nga subjekti i vërtetimit të pagesës, i kryer në llogari të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me tarifën e miratuara, për sipërfaqen e negociuar si më sipër dhe pika c në të cilën përcaktohet: c) Njoftimi i subjektit nga grupi teknik i shqyrtimit të aplikimeve (GTSHA) për lidhjen e kontratës së përdorimit të stacionit të plazhit, brenda 2 (dy) ditëve, me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (AKB), duke e pajisur me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit, sipas kodit përkatës identifikues. Miratimi i modelit të certifikatës së përdorimit të stacioneve të plazhit bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”

-Nga kjo drejtori grupi i auditimit ka hasur vështirësi në marrjen e dokumentacionit për kontratat e plazheve, listën e subjekteve edhe pasi janë rikërkuar disa herë. Mungon informacioni dhe dokumentacioni e akte të mbajtura me Agjencinë e Bregdetit për numrin e kontratave të. Për vënien në dispozicion të dokumentacionit për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe arkëtimin e të ardhurave nga ky burim të ardhurash për periudhën 2020-2021, pas disa kërkesave drejtuar drejtores së drejtorisë së aseteve zj. S. H. dhe pengesave të hasura në këtë drejtim i jemi drejtuar me email, si më poshtë:

On Monday, November 8, 2021, 12:33:15 PM GMT+1, M. B.<m.....b.....@yahoo.com> wrote:

Përshëndetje!

Bazuar në programin e Auditimit nr.731/1, datë 10.09.2020, i ndryshuar, pika 1, Ju kërkohet (në mënyrë të ripërsëritur) venien në dispozicion të dokumentacionit në lidhje me:

- pagesat për hapsirat e plazheve për vitin 2020 dhe 2021 numrin e përfituesve, shuma e paguar.
 - kontratat për secilin subjekt, akt kontrollet e kryera,si edhe problematikat që mund të jenë hasur në lidhje me përdorimin e hapsirave.
 - akt rakordimet me Degën e Financës për pagesat e kryera sa i takon detyrimeve dhe listën e personave të cilët nuk kanë kryer pagesat.
 - listat e rakorduara me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (2020-2021)
 - Dokumente të tjera të disponueshme nga Drejtoria juaj për këtë qëllim.
- Ju kujtoj se na keni vene në dispozicion vetëm listat e subjekteve për shfrytëzimin e plazheve të vitit 2021. Ju lutem na plotësoni me dokumentet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi. Për informacionin e kërkuar është kthyer përgjigje si më poshtë:

From: S. H.<si í í í h.....@yahoo.com>

To: M. B.<mí í ..b.....@yahoo.com>

Sent: Monday, November 8, 2021, 03:24:26 PM GMT+1

Subject: Re: KLSH

Në përgjigje të emailit po ju sqarojmë se: Bashkia Vlore nuk ka firmosur kontratat për shfrytëzimin e hapësirës publike plazh për vitin 2020 dhe 2021 pasi në zbatim të VKM-së Nr. 424, datë 27.5.2020 për një shtesë në vendimin nr.171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit/aplikimi për marrjen në përdorim të hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi bëhet nëpërmjet sistemit on-line e-Albania, nga adresa si biznes në e-albania e cdo personi fizik/juridik të cilat si dhe cdo kërkesë /ankesë në lidhje me ushtrimin e aktivitetit si stacion plazhi shqyrtohen nga Autoriteti për shqyrtimin e aplikimeve për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi (GTSHA) pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe më pas është Agjencia Kombëtare e Bregdetit subjekti kontraktues kryesor për lidhjen e kontratave të plazheve.

Bashkia Vlore i pajis subjektet aplikues të kualifikuar në fazën e miratimit paraprak me faturen për arketim për sipërfaqen të cilin ata përdorin me planvendosjen për parcelën pasi këta subjekte kryejnë aplikimin.

Pasi subjektet ngarkojnë këto dy dokumente në fazën e dytë, subjektet pajisen me miratimin përfundimtar dhe pas kësaj faze është AKB që përgatit procesverbalin e dorëzimit të hapsirës publike plazh së bashku me kontratën .

Për këtë arsye po ju vendosim në dispozicion listën e subjekteve të cilët kanë paguar detyrimin për këtë hapsirë.

-Duke qenë se informacioni i kërkuar nuk plotëson kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkruara nga zj. S. H., në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e

Aseteve.

-Nga Drejtoria ekonomike dhe sipas aktrakordimeve me thesarin të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,063,700 lekë

Viti 2021 në shumën 32,269,660 lekë

-Nga Drejtoria e Aseteve të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,619,600 lekë

Viti 2021 në shumën 31,659,580 lekë

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezulton se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 6,783,200 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

Emërtimi	Nr	Vlera
Subjekte që kanë lidhur kontratë në vitin 2020	168	28,395,800
Subjekte që kanë paguar plotësisht detyrimin në vitin 2020	130	21,372,600
Subjekte që kanë paguar pjesërisht detyrimin në vitin 2020	5	240,000
Subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për kontrata të lidhura në vitin 2020	33	6,783,200

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 8,120,240 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

Emërtimi	Nr	Vlera
Subjekte që kanë lidhur kontratë në vitin 2021	181	31,360,780
Subjekte që kanë paguar plotësisht detyrimin në vitin 2021	138	23,240,540
Subjekte që nuk kanë paguar detyrimin për kontrata të lidhura në vitin 2021	43	8,120,240

Nga Drejtoria e asetëve nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, nuk janë mbajtur aktrakordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, òDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 òPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë.

-Nga auditimi dhe verifikimi i listave të subjekteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, pranë Drejtorisë së Taksave Vendore në lidhje me pajisjen e subjekteve që kanë aplikuar për pajisjen me leje për shfrytëzimin e veprimtarisë së hapësirave të plazhit, u konstatua se nga Bashkia Vlorë janë pajisur me kuponin për të nënshkruar kontrata 17 subjekte që rezultojnë me detyrime të papaguara në shumën 3,298,091 lekë për vitin 2020 dhe 17 subjekte në shumën 2,337, 534 lekë për 2021.

Referuar emrave të subjekteve konstatohet se janë pothuajse të njëjtët subjekte të pajisur me kuponin e pagesës për të 2 vitet, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.171, datë 27.03.2019 òPër miratimin e rregullores òPër kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, neni 5 òKriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhitò pika3/d.

Pra, nga Drejtoria e mësipërme e ngarkuar për mbledhjen e të ardhurave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, dokumentacioni i mbajtur nuk jep mundësinë për të gjeneruar situatën për detyrimet e subjekteve, kontratat e nënshkruara dhe dokumente të tjera të cilat përcaktojnë gjurmën për auditim.

Ngarkohen me përgjegjësi: z. D. L. në funksionin e Kryetarit të Bashkisë dhe në cilësinë e palës kontraktore për Bashkinë Vlorë,zj. S. H. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe në cilësinë e kryetares së komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit për lidhjen e kontratave e konfirmimin e tyre, në cilësinë e faturimit të detyrimit dhe ndjekjes e

monitorimit të kontratave, zj.A. Xh. me detyrë specialiste inxh. ndërtimi në Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit për lidhjen e kontratave e konfirmimin e tyre dhe z. K. A. me detyrë Topograf në Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit për lidhjen e kontratave e konfirmimin e tyre.

Pretendimi i subjektit: Meobservacionin nr.984, datë 01.02.2022, nga zj.S. H., janë paraqitur objeksionet në lidhje me pagesat e kryera nga subjektet:

-M. M. sip. e zënies së hapësirës publike është përcaktuar 4920 m² dhe jo 3000 m², duke mos ndarë pjesën e sip. plazhit me çadra dhe pjesën e sip. të bar-restorantit prej 1920 m²

-V. N. në paraqitjen grafike nuk përcaktohet se kush sipërfaqe është e barit dhe cila sipërfaqe i përket plazhit me çadra.

-B. Gj., G. H., F. M., J. A., K. S. dhe M. B., këto subjekte nuk kanë ushtruar aktivitet si stacione plazhi për sezonin turistik 15 maj-30 shtator 2018, por janë mbartur gabimisht në evidencë.

-D. B. dhe M. P., kanë paguar detyrimet në vitin 2019 për llogari të vitit 2018

-L. F., për sezonin 2019 ka shfrytëzuar 200 m² dhe jo 300 m² sipas kontratës, pasi është gabim material.

- F. M., ky subjekt planvendosjen me sip. prej 588 m² e ka depozituar për marrjen me qira të vendparkimit të mjeteve të camping dhe jo sipërfaqe plazhi dhe ka 5 vjet që shfrytëzon vetëm 200 m² për sip stacion plazhi.

- A. Z. është tarifuar me 200 lekë/m² ky subjekt pasi nuk ka ushtruar aktivitet si stacion plazhi po si qendër trajnimi zhytje.

- I. P. sipërfaqen e aplikuar për stacion plazhi e ka në pronësi.

-Për vitet 2020 -2021, citoni se janë lidhur kontrata 168 dhe 33 subjekte janë debitore ju duhet ti citoni emrat e debitorëve plotësisht dhe tërësisht siç keni bërë me vitet 2018 dhe 2019. Bashkia Vlorë me statusin e vetëm subjekt përfitues prej vitit që prej vitit 2020 nuk ka debitorë pasi fatura dhe gjenerimi i saj në sistem është kusht i domosdoshëm dhe pengues për të gjitha subjektet të cilat janë kualifikuar paraprakisht. Nëse AKB si organ kompetent ka lidhur kontratat pa kryer pagesën tërësisht ose pjesërisht përbën shkelje të detyrimit ligjor të VKM 424. Pra, si ka mundësi që AKB paska lidh kontratat për 33 subjekte debitore kur këto nuk kanë ngarkuar pagesën dhe planvendosjendalim në konkluzionin se AKB si autoriteti kryesor për lidhjen e kontratave ka lidhur kontrata në kundërshtim me ligjin dhe dëmi prej 6,783,200 lekë dhe 8,120,240 lekë, duhet ti faturohet AKB dhe jo Bashkisë Vlorë.

Gjithashtu, si ka mundësi që Bashkia Vlorë, nga rakordimet me thesarin ka grumbulluar 32,269,660 lekë dhe ju në të dhënat tuaja citoni vlerën 31,360,780 lekë, ku jeni bazuar për nxjerrjen e kësaj vlere cili ka qenë dokumentacioni dhe burimi i kësaj vlere.

Gjithashtu, nëse ju vërtetoni se debia e vitit 2020 dhe 2021 është reale dhe e identifikueshme, ju duhet ti drejtoheni AKB si struktura përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj Bashkisë Vlorë.

Si përfundim ju theksojmë se Bashkia Vlorë ka tejkuluar parashikimin vjetor të parashikuar në paketat fiskale për vitet 2020 dhe 2021 ku për 2020 janë parashikuar të mblidhen 25 milionë lekë dhe janë mbledhur 28.6 milionë lekë, ndërsa për vitin 2021 parashikuar 30 milionë lekë dhe janë realizuar 32.2 milionë lekë. Pra, shihet qartë se niveli i të ardhurave jo vetëm është realizuar por edhe tejkuluar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me kontratat për qiradhënie për subjektet:

-M. M. përderisa në kontratë sip. e zënies së hapësirës publike është përcaktuar 4920 m² dhe jo 3000 m², duke mos ndarë pjesën e sip. plazhit me çadra dhe pjesën e sip. të bar-restorantit prej 1920 m² siç pretendohet në koment, pra ky pretendim nuk qëndron.

-V. N. në paraqitjen grafike nuk përcaktohet se kush sipërfaqe është e barit dhe cila sipërfaqe i përket plazhit me çadra, pra në planvendosje është paraqitur një parcelë e tërë me sipërfaqe 325 m² që i bashkëlidhet kontratës, pra ky pretendim nuk qëndron.

-B. Gj., G. H., F. M., J. A., K. S. dhe M. B., këto subjekte pretendohet se nuk kanë ushtruar aktivitet si stacione plazhi për sezonin turistik 15 maj-30 shtator 2018, por janë mbartur

gabimisht në evidencë, ndërkohë në evidencën e paraqitur dhe të konfirmuar nga Drejtoresha, këto subjekte janë përfshirë në listën e subjekteve që kanë ushtruar aktivitetet për vitin 2018 si dhe në dosjet e kontratave paraqiten aplikime nga këto subjekte, ku në rastin e M. B. është lidhur edhe akt-marrëveshja e datës 16.08.2018. Për këtë nuk ka asnjë dokument verifikimi që nuk kanë ushtruar aktivitetet, kur për çdo vit kanë aplikuar në të njëjtat sipërfaqe.

-D. B. dhe M. P., pretendimit se këto kanë paguar detyrimet në vitin 2019 për llogari të vitit 2018 nuk i është bashkëlidhur observacionit asnjë dokument financiar që të vërtetojë kryerjen e pagesave.

- L. F. pretendimi që për sezonin 2019 ka zhfrytëzuar 200 m² dhe jo 300 m² sipas kontratës, pasi është gabim material përcaktimi prej 300 m² në kontratë, nuk mund të merret parasysh pasi kontrata është dokument ligjor.

- F. M. pretendimi se ky subjekt planvendosjen me sip. prej 588 m² e ka depozituar për marrjen me qira të vendparkim të mjeteve të camping dhe jo sipërfaqe plazhi dhe ka 5 vjet që shfrytëzon vetëm 200 m² për sip stacion plazhi, nuk vërtetohet një gjë e tillë as në të dhënat e mangëta të planvendosjes ku nuk ka përcaktime dhe ndarje të sipërfaqes, as në kontratë e cila është hartuar në bazë të kësaj planvendosje, pra ky pretendim nuk qëndron.

- A. Z. pretendimi se është tarifuar me 200 lekë/m² ky subjekt pasi nuk ka ushtruar aktivitetet si stacion plazhi po si qendër trajnimit zhytje, duke vendosur paisje të caktuara, nuk e justifikon mos aplikimin nga Bashkia Vlorë dhe mospagesën e tarifës së vendosur në paketën fiskale prej 500 lekë/m² pasi në fakt është zënë hapësisë publike e plazhit pavarësisht se me cadra apo me mjete zhytjeje dhe vepruar me kontratë zënie hapësire plazhi, pra ky pretendim nuk qëndron.

-I. P. pretendimi se sipërfaqen e aplikuar për stacion plazhi e ka në pronësi, nuk qëndron ose duhet të mos lidhte kontratë dhe të taksohej sipas tarifave për taksë trualli DTTV, por meqenëse është aplikuar dhe miratuar për stacion plazhi, atëherë duhen zbatuar tarifatat e miratuara në paketën fiskale prej 400 lekë/m² për plazhin eZvërnecit dhe jo 200 lekë/m², sic ka ndodhur në fakt, pasi pjesa e rërës është hapësirë publike, pra ky pretendim nuk qëndron.

Për moskryerjen e pagesave nga moslidhja e kontratave nuk ka justifikime dhe argumentim ligjor, pasi pagesat kryhen bazuar mbi dokumentacion ligjor, vërtetues, verifikues, etj. Për këto arsye ky observacion nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

-Sa i takon pretendimit që për vitet 2020 -2021, se duhet ti citoni emrat e debitorëve plotësisht dhe tërësisht siç keni bërë me vitet 2018 dhe 2019, sqarojmë se listat e debitorëve janë bashkëlidhur materialit të auditimit. Po kështu edhe për vitet 2018 dhe 2019 numri i subjekteve debitore rezulton nga listat që ju keni paraqitur vetë të nënshkruara, për të cilat nuk ka asnjë konfirmim se në cilën bankë është kryer pagesa. Sa i takon listave të viteve 2020 dhe 2021 listat janë ato të cilat na keni vënë në dispozicion me shumë vështirësi duke u kërkuar disa herë nga grupi auditimit që na i sillni të nënshkruara.

Subjekteve iu jemi drejtuar me identitetet dhe vlerat përkatëse. Burimi i kësaj vlere është rezultat i veprimeve financiare të kryera nga subjektet dhe verifikimit në degën e financë kontabilitetit.

Sa i takon pretendimit se Bashkia Vlorë nuk ka subjekte debitore, sqarojmë se verifikimi është kryer bazuar në dokumentacionin financiar dhe grupi i auditimit sipas programit ka audituar Bashkinë Vlorë dhe jo AKB të cilës i referoheni për shkaktimin e dëmit.

-Sa i takon përcaktimit të vlerës sqarojmë se vlera 32,269,660 lekë, është sipas listave dhe dokumenteve të financës, ndërsa vlera 31,659,580 lekë, është rezultat i evidencës së paraqitur nga Drejtoria e Aseteve dhe e nënshkruar.

-Pretendimi se Bashkia Vlorë ka tejkalar parashikimin vjetor të parashikuar në paketat fiskale për vitet 2020 dhe 2021 ku për 2020 janë parashikuar të mblidhen 25 milionë lekë dhe janë mbledhur 28.6 milionë lekë, ndërsa për vitin 2021 parashikuar 30 milionë lekë dhe janë realizuar 32.2 milionë lekë. Pra, shihet qartë se niveli i të ardhurave jo vetëm është realizuar por edhe tejkalar, nuk qëndron pasi nuk kemi trajtuar realizimin e planit të të ardhurave por ligjshmërinë në arkëtime dhe procedurat financiare të ndjekura nga subjektet që kanë përfutur hapësira plazhi, përfshirë edhe nëse duhet të përfitonin hapësira plazhi pa shlyer detyrimet e taksave sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më lart sqarojmë se observacioni nuk ka mbështetje ligjore dhe nuk është paraqitur për asnjë rast, dokumentacion justifikues.

Titulli i Gjetjes: Hartimi, ndjekja e kontratave dhe menaxhimi i të ardhurave nga qiradhënia e hapësirave të plazhit.

Situata: Për vitet 2018-2019 -2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 550 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe të Menaxhimit të Aseteve dhe të aplikimit në sistemin elektronik të ngritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në paketat fiskale të miratuara me VKB. Nga auditimi i praktikave ku konstatua se:

Për vitin 2018 janë faturuar për tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit 178 subjekte për një sipërfaqe prej 61534m², në bazë kontratash, aktmarrëveshjesh dhe kërkesash për shfrytëzim hapësira plazhi, duke mos lidhur kontrata sipas dispozitave ligjore në 93 raste, ku nga këto në 8 raste subjekteve në vlerën prej 710,000 lekë në Radhimë – Orikum dhe në 3 raste në plazhin Zvërnec në vlerën 162,400 lekë nuk kanë paguar tarifën e qirasë për sipërfaqet e plazhit që kanë shfrytëzuar, të cilat në mungesë të kontratave, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, duke mos u klasifikuar në detyrime kontraktore për tu ndjekur ligjërisht për arkëtim. Gjithashtu nga shqyrtimi i dosjeve rezultoisë në 2 raste është bërë kontraktim i gabuar për sipërfaqe më të vogël se sipërfaqja sipas plan-rilevimit të paraqitur, duke sjellë **mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 778,000 lekë sipas kontratave të subjekteve:** M. M. për sip më në vlerën 768,000 lekë dhe V. N. në vlerën 10,000 lekë, për mospagesë në vlerë të plotë.

Për vitin 2019 janë faturuar për tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit 212 subjekte për një sipërfaqe prej 63,648 m², në bazë kontratash, aktmarrë veshjesh, ku nga këto 2 subjekte paraqiten debitorë: A. K. në vlerën 20,000 lekë dhe Sh. G. në vlerën 50,000 lekë. Ndërsa nga shqyrtimi i dosjeve rezultuan diferenca në sipërfaqe nga ajo e kontraktuar referuar plan-rilevimeve si dhe faturime detyrimesh në vlera më të vogla se detyrimet kontraktore mbi bazën e të cilave janë kryer dhe pagesat më pak se vlera e kontratave, në vlerën 744,000 lekë për 4 raste kontratash sipas subjekteve: A. Xh. në vlerën 20,000 lekë, F. M. në vlerën 194,000 lekë, L. F. në vlerën 50,000 lekë, A. Z. në vlerën 480,000 lekë, **pra në total duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në vlerën 814,000 lekë.**

Për vitin 2020 nga autorizimet e miratuara për stacione plazhi rezulton se në 1 rast subjekti ÕI. P.ö ka një sipërfaqe prej 3405m² në shfrytëzim hapësirë plazhi në Zvërnec, i cili është faturuar me tarifën e qirasë prej 200 lekë/m² /sezoni dhe jo me 400 lekë/m², tarifë e përcaktuar në paketën fiskale për këtë zonë plazhi, **duke sjellë të ardhur të munguar me efekt negativ në vlerën 681,000 lekë.**

-Mbi zbatimin dhe rregullshmërinë e procedurave për lidhjen e kontratave për zënie e hapësirave të zonave të plazhit

Në auditimin e ushtruar në dokumentacionin bashkëshoqërues të kontratave të dhënies me qera të hapësirave të plazhit u krye kampionimi i 37 dosjeve për vitin 2018 dhe 46 dosjeve për vitin 2019 dhe nga testimi i tyre u konstatuan mangësi si:

- Ka 93 raste moslidhje kontratash me subjektet që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit në vitin 2018. Ndërsa kontratat që janë bërë janë lidhur kryesisht në muajt korrik dhe gusht, pra jo në fillim sezoni në maj.
- Në disa raste subjektet nuk kanë paraqitur vërtetimet për detyrimet që kanë ndaj ose në DPTR Vlorë dhe DTTV Bashkia Vlorë ose në disa raste të tjera sipas vërtetimeve të paraqitura ato figurojnë debitorë ndaj strukturave tatimore.
- Në një pjesë të rasteve mungojnë ekstrakti i QKB apo Plan-bizneset
- Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera, pra dokumenti bankar mbi arkëtimin e detyrimeve kontraktuale

- Pothuajse në të gjitha rastet e dhënies në përdorim të hapësirës së plazhit, u konstatua se në një pjesë të madhe të kontratave nuk shoqëroheshin me planvendosje. Ndërsa në rastet kur planvendosjet apo plan-rilevimet ekzistonin, në to nuk evidentoheshin përmasat e parcelës, mbi bazën e secilës është përlogaritur sipërfaqja e përcaktuar në kontratë. Në planvendosje nuk ka të dhëna për largësinë e parcelës nga vija bregdetare nëse është respektuar apo jo distanca të paktën prej 7.5 m nga vija e bregut të detit, si dhe nëse është lënë e lirë hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave për t'u shfrytëzuar nga publiku. Gjithashtu në planvendosje nuk evidentohet shpërndarja e çadrave për të parë nëse është respektuar hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) e cila duhet të jetë minimumi 2.5 m.

-Mungojnë vërtetimet e pagesave të detyrimeve të tjera lokale si tarifë pastrimi, tarifë gjelberimi dhe tarifë ndricimi,

-Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar

-Mungojnë dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar.

-Në asnjë rast, pjesë e dosjes nuk ishin aktet e kontrollit për verifikimin në terren nëse sipërfaqet që shfrytëzohen janë në përputhje me sipërfaqet e kontraktuara, si dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20% sipërfaqe në përdorim publik. Mungonin procesverbalet e monitorimit të kontratave për plotësimin e kushteve të kontratave si dhe kriteret ligjore që duhet të plotësojnë stacionet e plazhit. Pra ky dokumentacion mungonte, edhe pse qiramarrës ishin po të njëjtët subjekte në të njëjtat zona të plazhit, të cilët e kanë detyrim ligjor paraqitjen e akteve të Monitorimit të kryera nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati përgjegjës në momentin e rinovimit të kontratave. Po kështu edhe komisionet e ngritura me urdher të Titullarit për çdo vit për verifikime në terren nuk kanë funksionuar.

- Në disa raste, pagesa e qirasë është kryer shumë me vonesë deri disa muaj pas mbarimit të sezonit.

Kriteri: VKM nr. 171, datë 27.3.2019 *“Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”* i ndryshuar me VKM nr. 424 datë 27.05.2020 neni 14 pika 10, nënpika b. me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, *“Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”* neni 4, pika 3, neni 5, pika 1, neni 4, pika 8, VKM nr. 321 datë 28.05.2014 *“Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”* i ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, Kreu III, pika 9, Kreu IV pika 1 shtojca B-3, me VKB nr. 100, datë 22.12.2017, *“Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë”* Kreu II *“Tarifat vendore”*, me kontratë tip të miratuar të lidhur ndërmjet palëve neni 6 *“Pagesa e qirasë”* neni 5, *“Detyrimet e qiramarrësitë”*.

Ndikimi/Efekti: Ulja e nivelit të të ardhurave nga mos arkëtimi i tarifës së qirasë në vlerë të plotë ose të pjesshëm për sezon turistik në 19 raste subjekte private në vlerën **prej 3,145,400 lekë**, e ndarë: **për vitin 2018** për 13 raste në vlerën 1,650,400 lekë, për **vitin 2019** në 6 raste në vlerën 814,000 lekë dhe për **vitin 2020** në 1 rast në vlerën 681,000 lekë.

Shkaku: Shkelje ligjore nga strukturat përgjegjëse në lidhjen e kontratave dhe ndjekjen e tyre.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore prej **3,145,400 lekë**, nga subjektet e individ privatë.

Titulli i Gjetjes: **Mangësi në dokumentacion dhe rakordimin e arkëtimeve me degën e financës.**

Situata: Nga kjo drejtori grupi i auditimit ka hasur vështirësi në marrjen e dokumentacionit për kontratat e plazheve, listën e subjekteve edhe pasi janë rikërkuar disa herë. Mungon

informacioni dhe dokumentacioni e akte të mbajtura me Agjencinë e Bregdetit për numrin e kontratave, etj.

Për vënien në dispozicion të dokumentacionit për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe arkëtimin e të ardhurave nga ky burim të ardhurash për periudhën 2020-2021, pas disa kërkesave drejtuar drejtores së drejtorisë së aseteve zj. S. H. dhe pengesave të hasura në këtë drejtim i jemi drejtuar me email.

-Duke qenë se informacioni i kërkuar nuk plotësonte kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkruara nga zj. S. H., në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve.

-Nga Drejtoria ekonomike dhe sipas aktrakordimeve me thesarin të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,063,700 lekë

Viti 2021 në shumën 32,269,660 lekë

-Nga Drejtoria e Aseteve të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,619,600 lekë

Viti 2021 në shumën 31,659,580 lekë

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezulton se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 6,783,200 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 8,120,240 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

Nga Drejtoria e aseteve nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, nuk janë mbajtur aktrakordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 për Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë.

Ndikimi/Efekti: Ulje e nivelit të të ardhurave nga mos arkëtimi i tarifës së qirasë për sezon turistik në vlerën **14,903,440 lekë**.

Shkaku: Mos rakordim i Drejtorisë së Aseteve me Degën e Financë Kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë Kontabilitetit, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve në lidhje me subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat për shfrytëzimin e hapësirave të plazheve dhe kanë shfrytëzuar këto hapësira për vitet 2018-2021, duke kryer arkëtimin e vlerës prej **14,903,440 lekë** (sipas listave bashkëlidhur).

Titulli i Gjetjes: Mangësi në dokumentacion dhe pajisjen e subjekteve me leje për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit pa paguar detyrimet e taksave vendore.

Situata: Nga verifikimi i listave të subjekteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, pranë Drejtorisë së Taksave Vendore në lidhje me pajisjen e subjekteve që kanë aplikuar me leje për shfrytëzimin e veprimtarisë së hapësirave të plazhit, u konstatua se nga Bashkia Vlorë janë pajisur me kuponin për të nënshkruar kontrata 17

subjekte që rezultojnë me detyrime të papaguara në shumën 3,298,091 lekë për vitin 2020 dhe 17 subjekte në shumën 2,337, 534 lekë për 2021.

Referuar emrave të subjekteve konstatohet se janë pothuajse të njëjtët subjekte të pajisur me kuponin e pagesës për të 2 vitet. Pra, nga Drejtoria e mësipërme e ngarkuar për mbledhjen e të ardhurave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, dokumentacioni i mbajtur nuk jep mundësinë për të gjeneruar situatën për detyrimet e subjekteve, kontratat e nënshkruara dhe dokumente të tjera të cilat përcaktojnë gjurmën për auditim.

Kriteri: VKM nr.171, datë 27.03.2019 ÷Për miratimin e rregullores ÷Për kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitë, neni 5 ÷Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhitë pika3/d.

Ndikimi/Efekti: Ulje e nivelit të të ardhurave

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve me Drejtorinë e Taksave Vendore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave Vendore duke kryer verifikimet për çdo subjekt që aplikon për tu pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pasi të jetë marrë konfirmimi me shkrim të vazhdojë procedurat për kryerjen e pagesës dhe lidhjen e kontratës.

-Auditimi mbi zbatimin dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera në sistemin TAIS nga punonjësit e DTTV-së për regjistrimin e tatimpaguesve, si dhe analizimi i ngarkesave të kryera për taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se:

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë për miratimin e paketave fiskale të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

-Dokumentacioni i Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi TAIS i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues.

-Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranifaturimit dhe specialistët e kontrollit në terren sipas Rajoneve.

-Akt-rakordimet për realizimin e të ardhurave në mes Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorisë së Tatimeve dhe Tarifave Vendore si dhe listat e debitorëve të gjeneruara nga sistemi TAIS nga kontabiliteti tatimor në DTTV.

-Grupi i auditimit mbledhi informacione, zhvilloi intervista mbi Sistemin e Administrimit të Taksave (TAIS) në Bashkinë Vlorë duke verifikuar disa konstatime dhe veprime mbi informacionin e mbledhur (Database) edhe nga auditimi i mëparshëm për të reflektuar ndryshimet gjatë vitit 2020 dhe 6-mujorit 2021.

I.Mbi Administrimin e Sistemit TAIS

Bashkia Vlorë ka në përdorim sistemin e administrimit të taksave TAIS, ndërtuar nga kompania I. B. S. sh.p.k dhe financuar nga USAID. Sistemi është ndërtuar mbi Microsoft Dynamic NAV.

TAIS administron proceset e taksave lokale në Bashkisë Vlorë dhe bën të mundur regjistrimin e të gjithë taksapaguesve në qytetin e Vlorë, gjenerimin e detyrimeve për çdo taksapagues, llogaritjen e kamat vonesave, ndryshimet e domosdoshme për bizneset etj.

Serveri i TAIS është në godinën taksave vendore të Bashkisë. Nga ana kompanisë prodhuese dhe mirëmbajtëse dhe zhvilluese janë hartuar dhe vënë në dispozicion të përdoruesve dhe administratorëve Manuali i Përdorimit Taksa1.5 Iö, e ÷Metodika e Filtrimit dhe Personalizimiö si dhe Bllok-skemat e sistemit dhe Diagramat e qarkullimit.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

- Rregulloret dhe manualet e Aplikacionin TAIS nuk janë të miratuara nga titullari i

institucionit.

Në kontratën e vitit 2018 janë përcaktuar përfaqësuesit e palëve për mbarëvajtjen e kontratës por nuk ka urdhër të titullarit për caktimin e personave të autorizuar për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Mungojnë raportet periodike të marrjes në dorëzim të shërbimit, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 (ndryshuar), Neni 77, Pika 3. Mbikëqyrja e kontratës.

Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se Marrëveshjet e Nivel Shërbimit (Kontrata e datës 20.05.2019 prot nr 4382 ÷Mirëmbajtje e sistemit elektronik te menaxhimit të taksave vendore Bashkia Vlorë dhe atë të datës 14.05.2018 prot nr 3733 ÷Mirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit te taksave vendore), janë lidhur me afat 1(një) vjeçar, në kundërshtim respektivisht me pikën 3 (“Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”) dhe pika 4 (për sistemet e ekzistuese të lidhet jo me pak se 2 vjet) të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit (i ndryshuar).

Nga auditimi u konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*, kjo në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 Për Hartimin E Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit e cila citon:

Të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit Ky seksion duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet që ofruesi i shërbimit ka ndaj institucionit, në lidhje me ofrimin e shërbimit. Për sa u përket detyrimeve, duhet të përcaktohen metodologjitë dhe specifikat e suportit të ofruesit të shërbimit të MNSH-së; për sa i përket ndërmarrjes së të gjitha veprimeve në kohën e duhur. Në lidhje me shërbimet që do të përcaktohen në marrëveshje, ofruesi i shërbimeve duhet t’u përgjigjet dhe të zgjidhë kërkesat ose incidentet e paraqitura nga institucioni. Gjithashtu, ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dokumentacionin e plotë për komponentët e shërbimit; të garantojë personel të kualifikuar dhe në numër të mjaftueshëm për realizimin e shërbimit; të ofrojë sigurimin e pjesëve të këmbimit (kur është e aplikueshme) dhe në sasinë që do të duhen për t’u ndërruar brenda harqeve kohore të përcaktuara.

Lista e përdoruesve të sistemit TAIS

ROLI	FUNKSIONI/te drejta ne rolin përkatës	SISTEMI/Ndërmarrja	STATUSI	USER_NAME
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\D.N.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\L.M.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\A.RR.
TAX2	Pranimi transport	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\M.P.
BORXHI	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\F.LL.
Admin	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\A.RR.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\L.Y.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\O.B.
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\B.H.
Admin	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\ADMINISTRATOR
BORXHI	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\XH.K.
Suport	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\IBS.SUPPORT
TAX	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\E.P.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\X.K.
Admin	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\A.NJ.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\K.M.
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\E.SH.
TAX	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\E.M.
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\H.K.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\D.K.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\E.P.

TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\I.M.
TAX2	Super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\I.I.
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\R.P.
TAX2	Pranimi R5 Llakatund Novosel Qendër	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\E.Ç.
TAX2	Super	VLORE	Aktiv	VLORA-SRV\O.M.
TAX2	super	VLORE	Jo Aktiv	VLORA-SRV\S.I.

-Nuk ka rregulla të shkruara për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin TAIS.

Nga auditimi rezulton se Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Taksave Vendore Bashkia Vlorë është në funksionon në një rrjet Lan me firewall, switch dhe mikrotik të pa konfiguruar.

Firewall dhe mikrotiku ishin risetuar me konfigurimin e fabrikës pasi kredencialet i kishte një punonjës i larguar.

- Përdorimi i user Administrator në db e TAIS-it dhe mos konfigurimi i pajisjeve mbart riskun e hyrjes së pa autorizuar dhe gjetjen e passëordeve me skripte të automatizuara.

Përdorimi i pajisjeve të risetuara me konfigurimin e fabrikës mbartin riskun e aksesit të lehtë pasi rëndom prodhuesit dhe rrjetet sociale japin kredencialet e hyrjes në to.

- Nuk ka raporte të problemeve/ incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.

- Nuk ka Politika dhe Rregulla të shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit

- Konfigurimi i sistemit nuk dokumentohet

- Nuk ka Procedura formale për menaxhimin e risqeve dhe Regjistër të risqeve.

Politikat e ruajtjes së dokumenteve, politikat e vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike.

- Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është konfiguruar back-up i DB periodik, çdo 1 muaj.

- Sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (*ambienti i serverëve*).

- *Gjurma e auditimit për sistemin TAIS*

Bazuar në nenin 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ÷Gjurma e auditimit ÷përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

-Nga auditimi rezulton se nga Bashkia Vlorë, nuk është dokumentuar gjurma e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së çdo procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë, jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për të verifikuar këto transaksione dhe operacione.

-Bazuar në nenin 16, pika 2 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, janë titullarët e njësive publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

-Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësive.

-Kërkesa për gjurmën audituese vlerësohet shumë e rëndësishme nga grupi i auditimit nisur nga fakti që në këtë institucion përpunohen të dhëna personale, për të cilat mbrojtja dhe keqpërdorimi i tyre nuk mund të garantohet sa kohë institucioni nuk ka dokumentuar as mënyrën se si këto të dhëna qarkullojnë.

Procedurat e rishikimit të regjistrimeve bëhen jashtë sistemit TAIS (duke u shoqëruar me dokumentacion në dosjen fizike të subjektit) le hapësirë për abuzime nuk rruan gjurmët e auditimit Grupi i Auditimit kreu kontrollin e dosjeve fizike të stornimeve nga sa rezultuan pasaktësi.

Për veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar”, ngarkohet me përgjegjësi z. D. L.

-Siguria e infrastrukturës network në Sistemin e administrimit të taksave TAIS të bashkisë Vlorë është e kompromentuar si rezultat i mungesës së Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, paisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet e praktikave më të mira të fushës.

-Ambiente të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikave më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe evidencës në administrimin e automatizuar të proceseve të regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve taksapaguesve në qytetin e Vlorë, sistemi TAIS ndërvepron me ëbservise me QKB dhe gjendjen Civile.

Ky ndërveprim është realizuar me qëllim që ndryshimet e të dhënave në lidhje me subjektet në këto sisteme të mund të merren me shpejt nga bashkia dhe të ngarkohen në sistemin e taksave të bashkisë.

-Mbi verifikimin në sistemin e taksave dhe tarifave vendore (TAIS) të veprimeve të krijuara në lidhje me stornimet (Credit Note).

1.Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2018 deri 30.06.2020 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me procesverbalet e mbajtura për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se nga **1418** stornime në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **1213 stornime**. (stornimet në total në mënyrë të detajuar paraqiten në CD)

Për **205** stornime të mbajtura me procesverbale u konstatuan parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsye të veprimeve.

Të dhënat në mënyrë të përmbledhur sipas specialistëve të pranimit dhe numrit të veprimeve të stornimit paraqiten në tabela si më poshtë:

Nr.	ID.Përdoruesi	Nr.Credit Note (stornim)	Stornime me procesverbal	Stornime pa procesverbal
1	VLORA-SRV\D.N.	346	43	303
2	VLORA-SRV\E.Ç.	40	25	15
3	VLORA-SRV\E.M.	139	36	103
4	VLORA-SRV\E.P.	266	19	247
5	VLORA-SRV\E.P.	104		104
6	VLORA-SRV\H.K.	14	4	10

7	VLORA-SRV\I.M.	66		66
8	VLORA-SRV\M.P.	10	1	9
9	VLORA-SRV\O.B.	3		3
10	VLORA-SRV\O.M.	38	22	16
11	VLORA-SRV\R.P.	76	30	46
12	VLORA-SRV\S.I.	112	24	88
13	VLORA-SRV\X.K.	204	1	203
Shuma		1418	205	1213

Tabela e përpunuar nga audituesi bazuar mbi të dhënat e sistemit TAIS

Gjithashtu krahas stornimeve të specialistëve u konstatau ndërhyrje edhe nga vetë user-i i Drejtuesit të DTTV-së z.O. B. për llogari të subjekteve që mbulohen nga vetë specialistët e rajoneve të ndryshme. Veprim i kryer arbitrarisht pasi mungojnë dokumentet shkresorë me argumentat dhe bashkëpunimi me specialistin përkatës.

Për periudhën 01.07.2020 deri në 30.06.2021 janë kryer këto stornime (credit note) nga specialistët e pranimit në lidhje me rivlerësimin tatimor të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në sistemin TAIS:

Përmbledhëse për secilin specialist (stornime nga 01.07.2020 - 30.06.2021)

Nr.	ID.Përdoruesi	Nr.Credit Note (stornim)	Stornime me procesverbal	Stornime pa procesverbal
1	VLORA-SRV\D.N.	45	45	0
2	VLORA-SRV\E.Ç.	31	30	1
3	VLORA-SRV\H.K.	9	3	6
4	VLORA-SRV\O.M.	25	24	1
5	VLORA-SRV\R.P.	30	30	0
6	VLORA-SRV\E.SH.	13	13	0
Shuma		153	145	8

Këto veprime financiare janë kryer pa dokumente mbështetës në kundërshtim me **Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011** “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **pika 35 gërma** òcò: **Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhës ose rregjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj) të cdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.pika 36:** “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numerim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve”, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4/26, në kundërshtim me Ligjin nr.10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, neni 3: “Dokumente elektronik” është çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, idërguar, imarrëose iruajturnë formë elektronikënga një sistem kompjuterikaponganjëmekanizëm ingjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, në përputhje me nenet 5-9 të këtij ligji. Përmbajtja e dokumentit elektronik përfshin të gjitha format e të dhënave, pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zëdhe imazhò

-Mbi verifikimin e subjekteve të pa regjistruara në sistemin TAIS

-Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga DTTV Bashkia Vlorë, në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2018** janë 5058 subjekte biznesi, nga të cilat 4100 subjekte të biznesit të vogël dhe 958 subjekte të biznesit të madh, **në vitin 2019** janë 5579 subjekte biznesi, nga të cilat 4581 subjekte

të biznesit të vogël dhe 990 subjekte të biznesit të madh, në vitin 2020 janë 5500 subjekte biznesi, nga të cilat 4520 subjekte të biznesit të vogël dhe 980 subjekte të biznesit të madh.

Biznesi	Gjendja në fillim			Regjistrime të reja			Mbyllur gjatë vitit			Gjendja në fund		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
I vogël	3.628	4.100	4.581	460	389	75	1112	777	200	4.100	4.581	4.520
I madh	907	958	990	22	22	1	90	67	18	958	990	980
Totali	4.535	5.058	5.579	482	411	76	1202	844	218	5.058	5.579	5.500

Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave të mësipërme me të dhënat e siguruar nga website zyrtar i QKB-së rezulton se:

Ka një diferencë të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të subjekteve aktiv të regjistruar nga DTTV e Bashkisë Vlorë në sistemin TAIS krahasuar me numrin e përgjithshëm të regjistruar në QKB.

Sipas të dhënave të QKB-së, në territorin e Bashkisë Vlorë deri në 30.06.2020 rezultojnë 5937 subjekte ndërsa sipas sistemit TAIS rezultojnë aktiv 5210 subjekte, pra me një diferencë prej rreth **1054 subjekte** të pa regjistruara në sistemin TAIS, si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifatat vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal. Kjo vërteton mungesën e bashkëpunimit me institucionet, mungesën e përgjegjshmërisë dhe punën e pamjaftueshme të menaxhimit dhe punonjësve të DTTV-së Bashkia Vlorë. (Në mënyrë të detajuar paraqiten në CD).

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Vlorë viti 2020 dhe 6-mujori I 2021

Biznes	Gjendja në fillim		Regjistrime të reja		Mbyllur gjatë vitit		Gjendja në fund	
	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2020	deri 6-mujori pare 2021	Viti 2020	deri 6-mujori pare 2021	Viti 2020	deri 6-mujori pare 2021
I vogël	4213	4235	519	347	329	310	4403	4272
I madh	1047	1089	29	20	4	9	1072	1100
Totali	5260	5324	548	367	333	319	5475	5372

Gjithashtu ka një diskordancë mes të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV-ja me raportet e gjeneruara nga sistemit TAIS në fund të periudhave ushtrimore 2018, 2019 dhe 6 mujori 2020.

Për periudhën e auditimit deri në 30.06.2020 janë konstatuar 1054 subjekte të parregjistruara në sistemin TAIS. Ky informacion ka dalë mbas informacionit të marrë nga Q.K.B.

Për 6-mujorin e I të vitit 2021, nga administrata e tatimeve të Bashkisë Vlorë është punuar për këto subjekte dhe situata paraqitet si më poshtë:

Nr	Kategorite e subjekteve që faturohen	Numer subjektesh
1	Subjekte të faturuara	330
2	Subjekte Aktiv në Oriku të cilët pritet përgjigje nga terreni	32
3	Subjekte Aktive për të cilat pritet përgjigje nga DPPD	18
4	Subjekte aktiv që nuk janë ngarkuar	153
	Total	533
Nr	Kategorite e subjekteve që faturohen	Numer subjektesh
1	Subjekte që kanë aplikuar për rregjistrim	53
2	Subjekte që kanë aplikuar për pezullim	25
3	Subjekte që kanë kalur në statusin pasiv	48
4	DRTRR nuk ka informacion	16
5	Subjekte që nuk u gjenden në punë nga inspektorët e terrenit	321
6	Fermer nuk faturohet	3
7	Subjekte që nuk ushtrojnë aktivitet në qytetin e Vlorës	55
	Total	521
	Total subjekte	1054

Subjektet që rezultojnë aktiv në Q.K.B janë subjekte të hapur në vitet 2000, e më pas të cilët nuk

ushtrojnë më aktivitet. Në këtë listë janë kryer kontrole mbi të gjitha subjektet, është kryer koresponenca me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, ku rezultoi se asnjë nga këta taksapagues të jenë deklarues të sigurimeve shoqërore-shëndetësore dhe deklarues të kasës aktive. Në përfundim të kësaj korrespondence, nga ana e DAV janë kryer edhe verifikime në terren ku rezultoi se asnjë subjekt nuk ushtron aktivitet, kjo është edhe arsyeja pse nuk janë shoqëruar me akt-kontrolli.

Vlen për tu theksuar se në këtë listë disa nga këta taksapagues nuk kishin dijeni për statusin aktiv të niptit të tyre pasi pas aplikimit për çregjistrim për herë të parë këtyre subjekteve u është refuzuar aplikimi, gjë e cila sjell mos ndryshimin e statusit në ekstraktin e Q.K.B. Këto subjekte janë njoftuar për ndjekjen e procedurave për riaplikim për çregjistrim.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 4 Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 41 Identifikimi i personave që ushtrjnë veprimtari tregare pa u regjistruar, neni 43 Përditësimi i të dhënave të regjistrimit.

Veprimet ose mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor, neni 106 Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin.

-Mbi konstatimin e subjekteve të pa ngarkuara në periudhat ushtrimore objekt auditimit, dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01.01.2018-30.06.2020

Nga verifikimi dhe analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi TAIS për periudhat ushtrimore 2018 dhe 2019 u konstatua se: Ka subjekte të cilat rezultojnë të ngarkuara me taksa dhe tarifa vendore gjatë vitit ushtrimor 2018 ndërsa në vitin 2019 edhe pse vazhdojnë të jenë aktive sipas sistemi TAIS nuk janë taksuar dhe tarifuar nga punonjësit e pranimit që kanë akses në sistem.

Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë si pasojë e keqmenaxhimit dhe punës së pa përgjegjeshme të specialistëve pranimit/vlerësimit dhe specialistëve të kontrollit në terren. Nga përpunimi i këtyre të dhënave Grupi i Auditimit konstatoi se janë **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020.(për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).
(Në mënyrë të detajuar paraqiten në CD)

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 4 Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 41 Identifikimi i personave që ushtrjnë veprimtari tregare pa u regjistruar, neni 43 Përditësimi i të dhënave të regjistrimit.

Veprimet ose mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor, neni 106 Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin.

-Mbi konstatimin e parregullisve në veprimet e krijuara nga specialistët e pranimit në sistemin TAIS

Subjektet të cilat janë konstatuar se ju është bërë vlerësimi tatimor jo në momentin e duhur apo për disa vite bashkë, ka rezultuar për arsye të mungesës së dokumentacionit për këto subjekte, po në asnjë rast nuk është shmangur kamatvonesa për detyrimet që arkëtoheshin me vonesë, pasi

mbas pagesës sistemi gjeneron edhe kamat vonesat ndër vite. Nga auditimi rezulton se ka subjekte të cilëve njoftim vlerësimi për detyrimet ju ka shkuar jashtë afatit të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë. Kjo pasojë ka ardhur si shkak i mospasjes së dokumentacionit ligjor edhe pse ju është dërguar njoftim zyrtar me email apo janë kontaktuar edhe nga inspektorët e terrenit të gjitha këto subjekte. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni nr.4 òZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 68 òVlerësimi tatimor, neni 69 òNjoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor, neni 114 òMospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit.

Veprimet ose mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me òRregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 òDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 òSektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor, neni 106 òDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin

Nga auditimi i dosjeve fizike (2018- 30.06.2020) u konstatuan mangësi si më poshtë:

- 1.Në pjesën më të madhe nuk paraqiteshin të gjitha veprimet që janë kryer me subjektin që në momentin e regjistrimit të tij si taksapagues.
- 2.Në pjesë më të madhe mungonin mandat pagesat e kryera nga subjekti.
- 3.Në dosjet fizike mungonin akt kontrollit e mbajtura nga specialistët e terrenit, sidomos në rastet kur kishtë pezullim të aktivitetit ose ri aktivizim, si dhe ndryshimet e adresave.
- 4.Kishte raste të cilat subjektet edhe pse rezultonin aktive ishin të pa ngarkuara për periudhat ushtrimore objekt auditimi, pra mungonin njoftim vlerësimet për ngarkesat.

Nr	Kodi	Emri i Subjektit	NIPT	Pershkrimi	Pershkrimi i aktivitetit	Statusi	Rajoni	Shenime
1	C01192	A.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	e pa updatuar nga inspektorët në TAIS
2	C01301	B.		Tregti karburanti	Tregti Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	e pa ngarkuar 2019 sepse statusi në qkb është pezulluar
3	C01318	V.K.		INDIVID	Individ	Aktiv	E_P_R.3	
4	C02095	H.-O. sh.p.k		Tregti materiale ndertimi	Tregti Biznes i madh	Aktiv	OM_R4	sipas qkb-se në 2019 është shtuar adresa e ushtrimit të aktivitetit. Duhet të tarifohet për vitin 2019 sepse është aktiv. Nuk akt kontrolli të terrenit
5	C02737	B.G.		Tregti materiale ndertimi	Tregti Biznes i madh	Aktiv	EC_R5	
6	C03934	F.		Hotel	Sherbim Biznes i vogël	Aktiv	RP_R2	
7	C04140	S.-AL		Prodhim mobilje	Prodhim Biznes i madh	Aktiv	OM_R4	
8	C05776	I.K.		Furrë buke	Prodhim Biznes i vogël	Aktiv	EC_R5	e pa ngarkuar 2019
9	C05891	M.R.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i vogël	Aktiv	E_P_R.3	e pa updatuar nga inspektorët në TAIS
10	C05921	B&A.D.C.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	e pa updatuar nga inspektorët në TAIS
11	C05936	C.R. 2008		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	
12	C06038	M.H.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i vogël	Aktiv	RP_R2	
13	C06294	K.& 2010		Sherbime Ndertimi	Sherbim Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	e pa tarifuar për 2019 dhe 2020. Dosja paraqitet e pa plote pasi nuk ka akt kontrolli. Në qkb statusi është aktiv
14	C06451	I.L.		Bar-Restorant	Tregti Biznes i vogël	Aktiv	E_P_R.3	e pa tarifuar për 2019 dhe 2020. Dosja paraqitet e pa plote pasi nuk ka akt kontrolli. Në qkb statusi është aktiv
15	C07304	B.B.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i vogël	Aktiv	RP_R2	Ka dy mandat pagesa në sistem. Nuk është tarifuar për 2019 dhe 2020 tarifave vendore
16	C07818	M.O.		Port Jatesh	Sherbim Biznes i vogël	Aktiv	H_K	e pa ngarkuar 2019
17	C07928	M.K.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	H_K	e pa updatuar nga inspektorët në TAIS dhe mungojnë verifikimet në terren
18	C09365	LL.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	EC_R5	adresa dytesore sipas qkb është vënë në 2020 në vlore
19	C09375	F.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	RP_R2	
20	C09537	T.S.		Bar-Hotel	Tregti Biznes i madh	Aktiv	OM_R4	
21	C07827	K.K.		Prodhime betoni	Prodhim Biznes i madh	Aktiv	H_K	e pa updatuar nga inspektorët në TAIS
22	C09427	M.LL.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i vogël	Aktiv	DN_N	ka gene e pezulluar në 2019
23	C04017	D.A.		Punime mermeri	Prodhim Biznes i madh	Aktiv	DN_Q	nuk është tarifuar për 2019 për adresën dytesore
24	C07878	P.		Prodhim Uji	Prodhim Biznes i madh	Aktiv	H_K	
25	C04445	D.		Tregti Elektroshtepiake	Tregti Biznes i madh	Aktiv	OM_R4	
26	C04467	K.Z.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i madh	Aktiv	OM_R1	
27	C05417	H.O. sh.p.k		Tregti Fruta Perime	Tregti Biznes i madh	Aktiv	E_P_R.3	
28	C06062	S.P.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	RP_R2	
29	C07873	H.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	H_K	Mungon akt kontrollit nga specialistet e terrenit. Dosja e pa plote me dokumentacion. Është e pa ngarkuar me tarifë e tjera takse ndertese dhe takse truallë për shkak se ka mungesë dokumentacioni
30	C09265	E.Ç.		Bar-Kafe	Tregti Biznes i madh	Aktiv	RP_R2	1.Mungon mandat pagesa. 2.Nuk I është faturuar taksa e shfrytëzimit të hapësirës publike
31	C09405	E.		Firme Ndertimi	Ndertim Biznes i madh	Aktiv	H_K	Mungon akt kontrollit nga specialistet e terrenit. Dosja e pa plote me dokumentacion. Është e pa ngarkuar me tarifë e tjera takse ndertese dhe takse truallë për shkak se ka

Nga auditimi i dosjeve fizike 30.06.2020 - 30.06.2021 u konstatua se dosjet e rajonit 1 dhe 4 kanë përmirësim përsa i takon inventarizimit dhe plotësimin me dokumentacion, ndërsa për rajonët e tjera vihen re mangësi në dokumentacion dhe inventarizimi jo sipas kërkesave ligjore.

Personat përgjegjës sipas rajoneve, të cilat u konstatuan me mangësi janë specialistët e pranim-vlerësimit: E. C. Rajoni 3, R.P. Rajoni 2, E. Sh. Rajoni 5, D. N. njësitë administrative dhe R.L. Njësia Oriku.

Nga auditimi u konstatua se administrata tatimore e Bashkisë Vlorë nuk ka zhvilluar asnjë program, procedurë apo teknikë për evidentimin në terren dhe regjistrimin e mjeteve të transportit, mjeteve lundruese, apartamenteve të cilët lëshohen për fjetje nëpërmjet internetit, etj., duke favorizuar evazionin dhe konkurrencën e pandershme për hotelet, motelet, bujtinat, etj. Nga një verifikim i thjeshtë në internet, në faqet që paraqesin hotele, motele, bujtina, vila apo apartamente, figurojnë me qindra të tilla, të cilat janë krejt informale dhe zhvillojnë aktivitetin duke mos paguar asnjë lloj detyrimi vendor, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, etj.

Përsa i përket subjekteve të cilët ushtrojnë veprimtari transporti (pasagjerësh dhe mallrash), nga ana Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, gjatë vitit 2021 është kërkuar informacion në institucionet përkatëse sipas korrespondencave të dërguara:

1. Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
2. Rregjistrin Detar Shqiptar Durrës
3. Drejtorisë së Përgjithshme Detare

Nisur sa më lart përmendur, kërkesës për informacion i është përgjigjur Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, prej të cilave është bërë i mundur vlerësimi i 53 subjekteve, për periudhën 6-mujore të vitit 2021. Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka kthyer përgjigje.

Nr	Shkresa të dërguara	Institucionit ku i dërgohet	Kthim përgjigje	Subjekte të faturuar
1	Nr.5734.prot, datë 16.04.2021 Kërkesë për informacion për 17 mjete.	Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor	Nr.5734/1.prot datë 23.04.2021 Kthim përgjigje 10 subjekte	Faturuar 10 subjekte
2	Nr.8205.prot, date 21.05.2021 Kërkesë për informacion për 62 automjete.	Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor	Nr.8205/1.prot, datë 01.6.2021 Kthim përgjigje për 45 automjete	Faturuar 43 subjekte
3	Nr.8204.prot, datë 21.05.2021 Kërkesë për informacion për 48 anije peshkimi.	Rregjistrin Detar Shqipëtar Durrës	Pa përgjigje	

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

z.D. L., në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Vlorë, z. O. B. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore (2018-nentor 2020 transferuar), z. I. M. me detyrë specialist pranim-vlerësimi, zj. R. P. me detyrë specialiste pranim-vlerësimi (shtator 2019 e në vazhdim), z. E. P. me detyrë specialist pranim-vlerësimi (shtator 2018 - tetor 2020), zj. O. M. me detyrë specialiste pranim-vlerësimi (janar 2020 e në vazhdim), zj.D. N. me detyrë specialiste pranim-vlerësimi (janar-shtator 2019 dhe prill 2020 e në vazhdim), zj. E. C. me detyrë specialiste pranim-vlerësimi (janar 2020 e në vazhdim), z.Ll. M. me detyrë specialist kontrolli në terren, z.K. M. me detyrë specialist kontrolli në terren, z.D. I. me detyrë specialist kontrolli në terren, z.F. B. me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Oriku, zj.H. G. me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Oriku, z.P. L. me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Qendër, z.M. L. me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Shushicë, dhe z. A. L. me detyrë specialist kontrolli në terren.

Titulli i gjetjes: Sistemi TAIS i taksave vendore është i pa regjistruar si aset.

Situata: Aplikacioni TAIS dhe kodi në burim i tij nuk janë regjistruar si aset. Kodi në burim òT. V.S. C. F.ò dhe òT. V. S. C. T.ò ju dha Bashkisë nga OE pas kërkesës grupit të auditimit për informacion.

Kriteri: Politikat e sigurisë së informacionit mbulojnë të gjithë risqet operacionale dhe kanë mundësi të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit. (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe politika të tjera të brendshme, procedura ose rregulla të aplikueshme).

Mbajtja e pronësisë së proceseve të biznesit.

Ndikimi/Efekti: Mos menaxhimin e Aktiveve, shkelje të sigurisë, humbje të informacionit

Shkaku: Mos zbatim i Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 *ËPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë* i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa për vlerësimin dhe regjistrimin si aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.

Titulli i gjetjes: Rregulloret dhe manualët e Aplikacionin TAIS nuk janë të miratuara dhe përditësuara.

Situata: Prodhuesi i sistemit TAIS ka shoqëruar sistemin me rregullore dhe manuale për përdoruesit dhe administratorët të cilat nuk janë të miratuara nga ana e Bashkisë Vlorë. Në mbështetje të kërkesave kryen ndryshime të sistemit dhe zhvillime në përputhje edhe me ndryshimet e legjislacionit në fuqi ndryshimet nuk janë pasqyruar në këto manuale.

Kriteri: Bashkia dokumenton, miraton, dhe komunikon politikën dhe procedurat e duhura për të udhëzuar operacionet IT, me qëllim arritjen e objektivave.

Ndikimi/Efekti: Mos efektivitet, shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos zbatim ligjit nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore* (i ndryshuar), neni 64, *ËKompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*, pika j.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për miratimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të Rregulloreve dhe manualeve të Aplikacionit TAIS.

Titulli i gjetjes: Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH) të lidhura nga Bashkia Vlorë me kompaninë I. B. S. shpk të datës 14.05.2018 prot nr. 3733 dhe ajo e datës 20.05.2019 prot nr. 4382 nuk janë hartuar dhe nuk zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Situata: Në kontratën e vitit 2018 janë përcaktuar përfaqësuesit e palëve për mbarëvajtjen e kontratës por nuk ka urdhër të titullarit për caktimin e personave të autorizuar për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Nuk ka raporte periodike të marrjes në dorëzim të shërbimit, Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH) me kompaninë I. B. S. sh.pk të datës 14.05.2018 prot nr. 3733 dhe ajo e datës 20.05.2019 prot nr. 4382 nuk janë caktuar tregues të matshëm të shërbimit.

Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se Marrëveshjet e Nivel Shërbimit (Kontrata e datës 20.05.2019 prot nr. 4382 *ËMirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit të taksave vendore Bashkia Vlorë* dhe atë të datës 14.05.2018 prot nr. 3733 *ËMirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit të taksave vendore*), janë lidhur me afat 1 (një) vjeçar, në kundërshtim respektivisht me pikën 3 (*“Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”*) dhe pika 4 (për sistemet e ekzistuese të lidhet jo me pak se 2 vjet) të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 *ËPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi*

Kjo në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 *ËPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*, i ndryshuar.

Kriteri: MNSH e implementuar, e monitoruar dhe e ndryshuar në varësi të nevojave. Arritja e matjeve të performancës që janë në lidhje me nevojat dhe qëllimet e biznesit

Ndikimi/Efekti: Risk në mos efektivitet e ekonomikitet, shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos zbatim i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 (ndryshuar), Neni 77, *oMbikëqyrja e kontratës*, Pika 3dhe Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 *oPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore në vijimësi të marrë masa për përfshirjen në kontratat e mirëmbajtjes së sistemit elementët e listuar në Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014 *oPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*, i ndryshuar, si dhe të dokumentojë shërbimin e marrë nëpërmjet raporteve periodike.

Siguria e Informacionit të sistemit TAIS

Lista e përdoruesve të sistemit TAIS

Roli	Funksioni/Te Drejta Ne Rolin Përkatës	Sistemi/ Ndërmarrja	Statusi	User_Name
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\D.N.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\L.M.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\A.RR.
TAX2	Pranimi transport	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\M.P.
BORXHI	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\F.LL.
Admin	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\A.RR.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\L.Y.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\O.B.
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\B.H.
Admin	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\Administrator
BORXHI	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\XH.K.
Suport	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\I.S.
TAX	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\E.P.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\X.K.
Admin	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\A.NJ.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\K.M.
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\E.SH.
TAX	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\E.M.J
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\H.K.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\D.K.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\E.P.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\I.M.
TAX2	Super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\I.I.
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\R.P.
TAX2	Pranimi R5 Llakatund	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\E.Ç.
TAX2	Super	Vlorë	Aktiv	VLORA-SRV\O.M.
TAX2	super	Vlorë	Jo Aktiv	VLORA-SRV\S.I.

Titulli i gjetjes: Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Taksave Vendore Bashkia Vlorë është i pasigurt dhe i ekspozuar ndaj humbjes e modifikimit të informacionit.

Situata: TAIS funksionon në një rrjet Lan me firewall, switch dhe mikrotik të pa konfiguruar. firewall dhe mikrotiku ishin risetuar me konfigurimin e fabrikës pasi kredencialet i kishte një punonjës i larguar.

Nga auditimi u konstatua se Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Taksave Vendore të Bashkisë Vlorë nuk ka rregulla të shkruara për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin TAIS

- Përdorimi i user Administrator në db e TAIS-it dhe mos konfigurimi i pajisjeve mbart riskun e hyrjes së pa autorizuar dhe gjetjen e passwordeve me skripte të automatizuara.

Përdorimi i pajisjeve të risetuara me konfigurimin e fabrikës mbartin riskun e aksesit të lehtë pasi rëndom prodhuesit e dhe rrjetet sociale japin kredencialet e hyrjes në to.

- Nuk ka raporte të problemeve/incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.

- Nuk ka Politikat dhe Rregullat e shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit

- Konfigurimi i sistemit nuk dokumentohet

- Nuk ka Procedura formale për menaxhimin e risqeve dhe Regjistër të risqeve.

- Infrastruktura network në Sistemin e administrimit të taksave TAIS të bashkisë Vlorë funksionon pa *Active Directory* dhe *Domain Controller* për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet e praktikave të mira të fushës.

Kriteri:Garantimi se ndërhyrjet zbulohen dhe trajtohen (Politika të brendshme të sigurisë). Janë vendosur nivelet e autorizimit të transaksioneve; ekziston ndarje e saktë e detyrave për futjen e të dhënave; ekzistojnë kontrolle kompensues për rastet në të cilat ndarja e detyrave nuk është e mundur. Funkzioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve.

Ndikimi/Efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit prishje të imazhit.

Shkaku:Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit). Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT). ISO 9001 menaxhim, identifikimi i riskut mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime:Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) duke vlerësuar burimet te marrë masa për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt, kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe të ngrejë mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masat e nevojshme për hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për inicimin, rishikimin dhe miratimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore te marrë masa për konfigurimin firewall, sëitch dhe mikrotik të sistemit TAIS (dhe rruajtjen e konfigurimeve) në përputhje me rekomandimet e prodhuesve e standardet e praktikat më të mira të fushës.

Politikat e ruajtjes së dokumenteve dhe vazhdimësia e punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike në sistemin TAIS

Titulli i gjetjes:Sistemi i administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (ambienti i serverëve).

Situata:Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është konfiguruar backup i DB periodik, çdo 1 muaj.

Kriteri:Politikat mbi vazhdimësinë e biznesit, planet backup, mbulimi i të gjitha fushave kritike Gatishmëria dhe saktësia e planit të vazhdueshmërisë së biznesit dhe të rimëkëmbjes nga katastrofat.

Ndikimi/Efekti:Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku:Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit). Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e ISACA-s), COBIT). ISO 9001 menaxhim, identifikimi i riskut mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim:Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme të marrë masa për hartimin e Planit të Vazhdimësisë dhe Planit të Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Gjurma e auditimit për sistemin TAIS

Titulli i gjetjes: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) nuk ka miratuar gjurma e auditimit si dhe nuk ka asnjë dokumentim të rrjedhës së informacionit *workflow* për hapat që kryhen nëpërmjet sistemit informatik TAIS.

Situata: Bashkia Vlorë, nuk ka dokumentuar gjurmën e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së çdo procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë, jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për të verifikuar këto transaksione dhe operacione.

-Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

-Kërkesa për gjurmën audituese vlerësohet shumë e rëndësishme nga grupi i auditimit nisur nga fakti që në këtë institucion përpunohen të dhëna personale, për të cilat mbrojtja dhe keqpërdorimi i tyre nuk mund të garantohet sa kohë institucioni nuk ka dokumentuar as mënyrën se si këto të dhëna qarkullojnë.

-Procedurat e rishikimit të regjistrimeve bëhet jashtë sistemit TAIS (duke u shoqëruar me dokumentacion në dosjen fizike të subjektit) le hapësirë për abuzime nuk ruan gjurmët e auditimit Grupi i Auditimit kreu kontrollin e dosjeve fizike të stornimeve nga sa rezultuan pasaktësi.

Kriteri: Neni 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Gjurma e auditimit”*, Neni 16, pika 2 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, janë titullarët e njësisve publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Neni 16, pika 2 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, janë titullarët e njësisve publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuar për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Ndikimi/Efekti: Në menaxhimin dhe Ecurinë e proceseve; Objektivat e proceseve; Strukturat brenda njësisë që përfshihen në proces; Strukturat jashtë njësisë që përfshihen në proces.

Shkaku: Ekzistojnë gjurmë të mjaftueshme auditimit që kapin redaktimet, regjistrimet e autorizuara të transaksioneve kritike; gjurmët e auditimit rishikohen periodikisht për të monitoruar aktivitetet jonormale; gjurma e auditimit mirëmbahet dhe ruhet në mënyrën e duhur; numra unikë dhe sekuencialë, ose identifikues janë përcaktuar për çdo transaksion.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore), të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit të sistemit TAIS, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që ndjek sistemi me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike

Titulli i gjetjes: Siguria sistemit të administrimit të taksave TAIS të bashkisë Vlorë është e kompromentuar si rezultat i mungesës së Ambienteve të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Situata:a. Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit) përkatësisht:

d. Pika 4.3. Parandalimi i zjarrit.

Dhoma duhet të jetë e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit

Dhoma duhet të jetë rezistente ndaj zjarrit nëse kabllo dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dysheme

e. Pika 4.5. Sistemi Elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm.

f. Pika 4.6. Sistemi i Alarmit. Mungon sistemi i alarmit.

Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.



Ambientet e dhomës së serverave

Kriteri: Garantimi i sigurisë fizike dhe ambientale është në përputhje me kërkesat për siguri dhe me klasifikimin e sensitivitetit të aseteve IT.

Ndikimi/Efekti: Shkelje të sigurisë, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos krijimi i ambientit fizik në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në udhëzimet e AKSHI-t. Mos zbatim i standardeve e praktikave më të mira të fushës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikën më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 *“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.*

- Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe evidencës në administrimin e automatizuar të proceseve të regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve taksapaguesve në qytetin e Vlorë, sistemi TAIS ndërvepron me webservise me QKB dhe gjendjen Civile.

Ky ndërveprim është realizuar me qëllim që ndryshimet e të dhënave në lidhje me subjektet në këto sisteme të mund të merren me shpejt nga bashkia dhe të ngarkohen në sistemin e taksave të bashkisë.

Auditimi mbi zbatimin dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera në sistemin TAIS nga punonjësit e DTTV-së për regjistrimin e tatimpaguesve, si dhe analizimi i ngarkesave të kryera për taksat dhe tarifave vendore.

Titulli i gjetjes:Mbi problematikat e paraqitura në sistemin e taksave dhe tarifave vendore nga veprimet e krijuara (stornimet).

Situata:Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2018 deri 30.06.2020 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me procesverbalet e mbajtura për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se nga **1302** stornime në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **1097 stornime**. (stornimet në total në mënyrë të detajuar paraqiten në CD, folder-i pika 1)

Për periudhën **01.07.2020 deri në 30.06.2021**, janë kryer **153 stornime** (credit note) nga specialistët e pranimit në lidhje me rivlerësimin tatimor të subjekteve fizik/juridik të rregjistruara në sistemin TAIS, nga të cilat **8 stornime janë kryer pa procesverbal**.

Për **205** stornime të mbajtura me procesverbale u konstatuan parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsyet e veprimeve.

- Gjithashtu krahas stornimeve të specialistëve u konstatua ndërhyrje edhe nga vetë user-i i ish Drejtuesit të DTTV-së për llogari të subjekteve që mbulohen nga vetë specialistët e rajoneve të ndryshme.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin* neni nr. 4/26; Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 *“Për dokumentin elektronik*, neni nr. 3; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, pika 35 *“Dokumente të kontabilitetit*, pika nr. 36.

Ndikimi/Efekti: Deformim i detyrimeve financiare pa lënë gjurmë nëpërmjet procesverbaleve.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për mbajtjen e dokumentave elektornike, gjurmës së auditimit, mungesa e një rregullore të brendshme për mbajtjen e procesverbaleve.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Strukturat Drejtuese të Bashkisë të marrin masa për të ngritur një komision për hartimin e një rregulloreje të brendshme ku të specifikohet mënyra e mbajtjes së dokumentave elektronikë dhe gjurma e auditimit të tyre për DTTV-në.

-të ngrihet një komision për verifikimin e stornimeve për secilin punonjës së DTTV-së dhe nxjerrjen e përgjegjësive për rastet ku ndryshimi i detyrimit financiar (stornimi) është i pa mbështetur në dokumentacion shkresor.

-Nga Titullari i Institucionit, të bëhet i mundur trajnimi i punonjësve të DTTV-së, gjatë vitit ushtrimor ekzistues me qëllim për të arritur përdorim korrekt, eficient dhe profesional të sistemit TAIS.

-Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, të merren masa që për rastet kur për ndryshimin e vlerës financiare (stornim), mungon dokumentacioni shkresor, të nxirren përgjegjësitë dhe të analizohet vlera financiare dhe dëmi i shkaktuar.

Prendimi i subjektit: *Nga Z. E. P. sqaron se Procesi i anullim-krijimeve (Credit Note) ka lindur si nevojë e punës së përditshme të drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore ku më kryesorët paraqiten si më poshtë: Pikënisjen ky proces e ka ne implementimin e këtij sistemi (TAIS) në vitin 2018 i cili perkon edhe me periudhen e auditimit të KLSH, ku për pasojë të mungesës së trajnimit të nevojshëm kanë sjell anullimin dhe krijimin e disa veprimeve gjatë ushtrimit të detyrës. Këto veprime nuk janë të lidhura vetëm me uljen e detyrimit tatimor por dhe me shtesa të detyrimit, në varësi të situatës që paraqet subjekti. Procedurat e ndryshme tatimore që lidhen kryesisht me aplikime në QKB, vendime të ndryshme të Këshillit Bashkiak, VKM. Të gjitha veprimet e kryera nga ana ime janë të shpjeguara për çdo Credit Note.*

1. *Nga Inspektore Znj. H. K., mbi stornimet për 8 subjekte me kod (C04568, C04585, C04714, C04602, C07737, C07813, C07848, C07869, C04517) janë aplikuar për aryse se kanë qënë të pezulluara dhe me mbyllje, ose janë hedhur gabim kodet e taksave, për anullime etj.*

2. *Nga ish- Inspektore e vlerësimit Znj. Xh. K., sqarohet se natyra e veprimeve të stornimit kryhet gjatë momentit të punë të linduar: nga gabime teknike, subjektit i është ngarkuar në faturë si detyrim taksa e pasurisë por e refuzon duke kërkuar që kjo taksë ti ngarkohet pronarit sipas ligjit, refuzimi nga ana e subjektit të detyrimit vjetor, stornim i tarifës së pastrim, ndriçim, gjelbërim.*

3. *Nga Inspektore Znj. R. P., përsa i përket stornimeve pa procesverbal janë 16 nga të cilat 2 credit note të cilat i përkasin subjektit C09310 të cilit i është shtuar detyrimi tatimor dhe 14 janë credit note pa procesverbal të cilat i përkasin periudhës 25.09.2019-17.12.2019 ku pas kësaj periudhe hyri në zbatim shkresa me nr. prot 568 datë 17.12.2019 “Për çdo stornim të ngarkesës*

tatimore në sistemin TAIS do të mbahet një procesverbal”.

4. Nga Inspektore Znj. O. M., sqaron se nga data 23.01.2020-30.06.2020 janë kryer 25 veprime për të cilat ka dorëzuar një kopje të procesverbaleve. Përsa i përket 13 stornimeve pa procesverbale janë veprim pas datës 30.06.2020.

5. Nga Inspektore Znj. D. N., sqaron se për vitin 2019 nuk ka patur një regullore të brendshme për mbajtjen e procesverbaleve. Për 20 stornimeve pa procesverbal janë veprime pas datës 30.06.2020.

6. Nga Inspektore Znj. E. C., sqaron se nga data 13.01.2020-30.06.2020 ka kryer 25 veprime. Pjesa tjetër 15 veprime pa procesverbal i përkasin listës pas datë 30.06.2020.

7. Nga Inspektorët Z. Ll. M. dhe Z. K. M., sqarohet se ne si inspektor kontrollit në terren nuk e gjejmë vetn, nuk kemi njohuri për sistemin dhe nuk kemi kryer ndonjë veprim për subjektet nga viti 2018 dhe në vazhdim, veprime me sistemin apo përditësim të veprimeve të subjekteve janë kryer per operatorëve të emëruar pranë DTTV-së Bashkia Vlorë.

8. Nga ish-Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Z. O. B., sqaron se për 3 stornimet që ka kryer, një stornim është bërë nga User-i O/B. për një ngarkesë që ishte bërë nga specialistja e pranimit të rajonit nr. 2 pa asnjë bazë ligjore, në kushtë të tilla dhe duke qënë se specialistja e pranimit mungonte atë ditë e pashë të arsyeshme të vendosja shumën e ngarkesës në shifrën fillestare, pra të vitit të kaluar, pasi nuk kishtë ndryhuar asnjë gjë nga viti i kaluar. Përsa i përket dy stornimeve të tjera janë kryer nga User-i O/B., por nga ana e specialistëve të I. B. S. nëpërmjet programit anydesk.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me pretendimin se ku kanë ardhur si rezultat i mungesës së trajnimit, Grupi i Auditimit nuk e mer në konsideratë.

2. Në lidhje me pretendimin për stornimet e kryera para daljes për zbatim të shkresës me nr. prot 568 datë 17.12.2019 (“Për çdo stornim të ngarkesës tatimore në sistemin TAIS do të mbahet një procesverbal”) nga ana e ish-Drejtorit të DTTV-së, Grupi i Auditimit e merr pjesërisht në konsideratë (sepse përgjegjësia bie mbi drejtuesit) por secili nga Inspektorët me User në TAIS, duhet të përpilonte dokumente shkresorë (procesverbale) të cilat të faktonin arsyet dhe shkaqet e ndërhyrjeve të mësipërme, në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë, 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35 dhe pika 36.

3. Për rastet kur stornimet janë pas datës 30.06.2020 merret në konsideratë. (reflektuar në PRA).

4. Në lidhje me pretendimin e dhënë nga Inspektorët e terrenit, (pika 8), grupi i Auditimit pas verifikimit konstatoi se nga llogaritë e tyre gjatë vitit 2018 janë kryer veprime stornimi në sistemin TAIS. Për rrjedhojë pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.

5. Në lidhje me pretendimi nga ish-Drejtori i DTTV-së Z. O. B., Grupi i Auditimi sqaron se nuk përbën argument, që stornim është bërë nga User-i O/B. për një ngarkesë që ishte bërë nga specialistja e pranimit të rajonit nr. 2 pa asnjë bazë ligjore, në kushtë të tilla dhe duke qënë se specialistja e pranimit mungonte atë ditë e pashë të arsyeshme të vendosja shumën e ngarkesës në shifrën fillestare. Për këtë pretendimi nuk merret në konsideratë.

Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga DTTV Bashkia Vlorë, në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2018** janë 5058 subjekte biznesi, nga të cilat 4100 subjekte të biznesit të vogël dhe 958 subjekte të biznesit të madh, **në vitin 2019** janë 5579 subjekte biznesi, nga të cilat 4581 subjekte të biznesit të vogël dhe 990 subjekte të biznesit të madh, **në vitin 2020** janë 5500 subjekte biznesi, nga të cilat 4520 subjekte të biznesit të vogël dhe 980 subjekte të biznesit të madh.

Titulli i gjetjes: Mbi mos regjistrimin e subjekteve në sistemin TAIS, dhe mungesa e kryqëzimit të të dhënave me QKB.

Situata: Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave të DTTV-së Vlorë me të dhënat e siguruara nga website zyrtar i QKB-së rezulton se:

Ka një diferencë të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të subjekteve aktive të regjistruar nga DTTV e Bashkisë Vlorë me sistemin TAIS krahasuar me numrin e përgjithshëm të regjistruar në QKB.

Sipas të dhënave të QKB-së, në territorin e Bashkisë Vlorë deri në 30.06.2020 rezultojnë 6,000 subjekte ndërsa sipas sistemit TAIS rezultojnë aktiv 5210 subjekte, pra me një diferencë prej rreth **800 subjekte** të pa regjistruara në sistemin TAIS, si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal. Kjo vërteton mungesën e bashkëpunimit me institucionet, mungesën e përgjegjshmërisë dhe punën e pamjaftueshme të menaxhimit dhe punonjësve të DTTV-së Bashkia Vlorë.

Kriteri: Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”,* i ndryshuar, neni nr. 4 *“Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”,* Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”,* i ndryshuar, neni 41 *“Identifikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregare pa u regjistruar”,* neni nr. 43 *“Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”,* *“Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë”,* neni 104 *“Drejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore”,* neni 105 *“Sektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor”,* neni 106 *“Detyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin”*

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kontrollit në terren nga DTTV-ja Vlorë, mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

Shkaku: Mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për të ardhurat vendore, mos zbatim i rregullores së bashkisë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, sektori i kontrollit në terren të marrë masa për evidentimin dhe regjistrimin e të gjithë subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Vlorë, për evidentimin e subjekteve që deklarojnë mbyllje nëse është i saktë ose jo, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe pa regjistruar në QKB.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, në fund të periudhave ushtrimore të marrë informacion zyrtar nga QKB dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e saktë të subjekteve fizik/juridik që janë aktiv dhe mbi bazën e xhiros të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. D. L., Titullari i Institucionit, z. O. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Inspektorët e pranimit/vlerësimit në DTTV, Inspektorët e terrenit në DTTV.

Pretendimi i subjektit: Nga Z. E. P. sqaron se në formatin e dërguar me CD nga grupi i auditimit, (folder pika 2) është lista emërore e 1058 subjekteve të pa regjistruar në sistemin TAIS, në këtë listë ndodhen edhe disa subjekte që nuk janë në territorin e Bashkisë Vlorë. Mbështetur në të dhënat e sistemit TAIS rezulton se një numër prej 161 ju janë nënshtruar procedurave tatimore, në drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Vlorë.

1. Nga Znj. R. P. sqaron se Subjektet me statusin aktiv në QKB nuk përputhet me numrin e subjekteve reale aktive, pasi shumë subjekte kanë aplikuar për pezullim ose ç’regjistrim, të cilëve nuk i është miratuar veprimi pasi kanë detyrime tatimore në DPT ose/dhe D.T.T.V, Bashkia Vlorë. Përsa i përket subjekteve të Rajonit Nr. 2 , të paraqitur në tabelën e subjekteve të pa regjistruar në sistemin TAIS (CD) pas verifikimit të detajur të subjekteve në sistemin TAIS rezultoj që nga kjo listë janë të regjistruar në sistemin TAIS 36 subjekte.

2. Nga Znj. O. M. sqaron se: se diferenca midissubjekteve aktive sipas QKB-së (5,937) dhe subjekteve aktive në sisteme TAIS (5,210) është 727 subjekte dhe jo 1,058 (në tabelën e nisur prej jush ka dublikime, subjekte me adresë në Tiranë, dhe në Bashkinë Selenicë (Fshati Peshkëpi, Kotë dhe Lubonjë)). Gjithashtu subjektet me statusin aktiv në QKB nuk përputhet me numrin esubj O. B.ekteve reale aktive, pasi shumë subjekte kanë aplikuar për pezullim ose ç'regjistrim, të cilëve nuk i është miratuar veprimi pasi kanë detyrime tatimore në DPT ose/dhe D.T.T.V, Bashkia Vlorë.

3. Nga Znj. E. C. sqaron se: se diferenca midissubjekteve aktive sipas QKB-së (5,937) dhe subjekteve aktive në sisteme TAIS (5,210) është 727 subjekte dhe jo 1,058 (në tabelën e nisur prej jush ka dublikime, subjekte me adresë në Tiranë, dhe në Bashkinë Selenicë (Fshati Peshkëpi, Kotë dhe Lubonjë)). Gjithashtu subjektet me statusin aktiv në QKB nuk përputhet me numrin esubjekteve reale aktive, pasi shumë subjekte kanë aplikuar për pezullim ose ç'regjistrim, të cilëve nuk i është miratuar veprimi pasi kanë detyrime tatimore në DPT ose/dhe D.T.T.V, Bashkia Vlorë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Përsa i përket subjekteve të cilat nuk operojnë në territorin e Bashkisë Vlorë, grupi i auditimit mer në konsideratë pretendimin tuaj (reflektuar në PRA). Në lidhje me subjektet të cilat janë regjistruar në sistemin TAIS, pas datë 30.06.2020 (objekti i auditimit), Grupi i Auditimit merr pjesërisht në konsideratë pretendimin tuaj, për shkak sepse nga vetë sistemi duhej të gjenerohej një listë nga ana juaj e përditësuar me taksapaguesit. Përsa i përket subjekteve të cilat nuk rezultojnë të c'regjistruar ose pezullim duhet të ishin me kodin përkatës në sistemin TAIS por nuk rezultojnë, për rrjedhojë nuk merret në konsideratë pretendimi.

Titulli i gjetjes: Mbi problematikat e konstatuara në sistemin TAIS të subjekteve të pa ngarkuara me detyrime verifikuar me raportin e gjeneruar nga sistemi për periudhën 01.01.2018-30.06.2020.

Situata: Nga verifikimi dhe analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi TAIS për periudhat ushtrimore 2018 dhe 2019 u konstatua se: Ka subjekte të cilat rezultojnë të ngarkuara me taksa dhe tarifa vendore gjatë vitit ushtrimor 2018 ndërsa në vitin 2019 edhe pse vazhdojnë të jenë aktive sipas sistemi TAIS nuk janë taksuar dhe tarifuar nga punonjësit e pranimit që kanë akses në sistem.

Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë si pasojë e keqmenaxhimit dhe punës së pa përgjegjësme të specialistëve pranimit/vlerësimit dhe specialistëve të kontrollit në terren. Nga përpunimi i këtyre të dhënave Grupi i Auditimit konstatoi se janë **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

Kriteri: Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 *ËPër sitemin e taksave vendore*, i ndryshuar, neni nr. 4 *ËZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë*, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni nr. 41 *ËI denfitikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregare pa u regjistruar*, neni nr. 43 *ËPërditësimi i të dhënave të regjistrimit*, *ËRregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë*, neni 104 *ËDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore*, neni 105 *ËSektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor*, neni 106 *ËDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin*.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal

Shkaku: Mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për të ardhurat vendore, mos zbatim i rregullores së bashkisë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim:Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, sektori i vlerësimit të marrë masa për tarifimin me taksat dhe tarifave vendore, për të gjithë subjektet e pa ngarkuar për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: z. O. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taskave dhe Tarifave Vendore, Inspektorët e pranimit/vlerësimit në DTTV.

Pretendimi i subjektit: Nga Z. E. P. për këtë pikë vlen për tu theksuar se problematika është e lidhur vetëm me mos konfigurimin në sistemin TAIS, të statusit të subjektit, shumë prej këtyre subjekteve rezultojnë në ekstraktin e QKB me status të pezulluar apo cregjistruar. Audituesve të KLSH do tju vihet në dispozicion një listë e subjekteve të pa ngarkuar në 2019 me shpjegimet përkatëse.

1. Nga Znj. R. P. sqaron se: në mbështetje të pika 3 e Kreut II të Akt Konstatimit Nr. 24 "Mbi konstatime subjekteve të pa ngarkuara në periudhat ushtrimore objekt auditimit, dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01.01.2018-30.06.2020", ju informoj se kam filluar punë në datën 25.09.2019 si Operatore, edhe jam emëruar Specialiste Pranimi në datën 13.01.2020, kodi i inspektorit të rajonit (RP_R.2) janë hapur në sistemin TAIS në Janar 2020 dhe në mbështetje të shkresës Nr. 640 prot., datë 05.02.2020 "Organika e detyrave të drejtorisë" jam caktuar si specialiste pranimi për Rajonin Nr. 2. Në vitin 2020, për shkak të COVID-19, afati i pagesës dhe faturimit të subjekteve u ndryshua, nga data 20 Prill, u shty deri në datën 20.09.2020. Pjesa e subjekteve të pafaturuar deri në datën 30.06.2020, janë faturuar në vazhdim.

2. Nga Znj. O. M. sqaron se: Në mbështetje të pikës 3 të Kreut II të Akt Konstatimit Nr. 24 "Mbi konstatime subjekteve të pa ngarkuara në periudhat ushtrimore objekt auditimit, dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01.01.2018-30.06.2020", ju informoj se kam filluar punë në datën 23.01.2020 (edhe pse data e emërimit është 13.01.2020), kredencialet më janë nisur me e-mail në datën 03.02.2020 dhe në mbështetje të shkresës Nr. 640 prot., datë 05.02.2020 "Organika e detyrave të drejtorisë" jam caktuar si specialiste pranimi për Rajonin Nr. 1 dhe Nr. 4. Në vitin 2020, për shkak të COVID-19, afati i pagesës dhe faturimit të subjekteve u ndryshua, nga data 20 Prill, u shty deri në datën 20.09.2020. Pjesa e subjekteve të pafaturuar deri në datën 30.06.2020, janë faturuar në vazhdim.

3. Nga Znj. E. C. sqaron se: Në mbështetje të pika 3 e Kreut II të Akt Konstatimit Nr. 24 "Mbi konstatime subjekteve të pa ngarkuara në periudhat ushtrimore objekt auditimit, dhe problematikat e shumta mbi kartelat e paraqitura në sistemin TAIS, të verifikuara nga raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi për periudhën 01.01.2018-30.06.2020", jam caktuar si specialiste pranimi për Rajonin Nr. 5 në mbështetje të shkresës Nr. 640 prot, datë 05.02.2020 "Organika e detyrave të drejtorisë". Gjatë vitit 2020, për shkak të COVID-19, afati i pagesës dhe faturimit të subjekteve u ndryshua, nga data 20 Prill, u shty deri në datën 20.09.2020. Për këtë arsye, subjektet janë faturuar gjatë gjithë vitit ushtrimor 2020, duke u verifikuar edhe nga terreni.

4. Nga Znj. Xh. K. sqaron se: Deri në periudhën nëntor 2019 nuk më është paraqitur nga sektori i kontrollit, regjistri i subjekteve që ushtronin aktivitet në terren, për të bërë një inventarizim të subjekteve pa ngarkesë. Lëvizja e Inspektorëve nga një sektor në tjetrin humb historikun e vazhdimësisë së subjektit si dhe mos mbajtja e një dosje të vetme fizike të subjektit.

5. Nga Znj. D. N. sqaron se: Për vitin 2019 nga analiza e listës së subjekteve të dërguar nga ana juaj si të pa tarifuar në rajonin 1,4 dhe 5 rezulton se janë 36 subjekte prej të cilëve, 13 subjekte në vitin 2019 kanë qënë të mbyllur ose nuk kanë ushtruar aktivitet në rajonet 1,4 dhe 5 sipas ekstraktit të QKB dhe 23 subjekte në vitin 2019 janë lënë për verifikim nga terreni pasi rezultonin se ishin debitorë të vjetër dhe u mungonte dokumentacioni pronësor.

6. Znj. H. K. sqaron se: subjektet të pa ngarkuara janë të pezulluara por nuk është hedhur pezullimi në sistem.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit:*Përsa i përket subjekteve të cilat rezultojnë të pa ngarkuara në sistemin TAIS për vitet 2019 dhe 2020, Grupi i Auditimit i ka nxjerrë këto të dhëna nga përpunimi i sistemit, ku vihet re fenomeni që subjektet sipas pretendimeve më sipër që kanë qënë të pezulluara në vitin 2019 ose 2020 rezultojnë në sistemin TAIS me status aktiv (për shkak sepse nuk keni kryer përditësimet në sistem dhe përditësimet e kartelave për secilin subjekt). Për rrjedhojë pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.*

Titulli i gjetjes:Mbi konstatimin e parregullisve të veprimet e krijuara nga specialistët e pranimit në sistemin TAIS

Situata:Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimet/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale duhet të kryheshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, përgjegjësi direkte e specialistëve dhe drejtorit të DTTV-së.

Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mërpashme për shkak sepse janë shkelur të gjitha afatet ligjore për rrjedhojë dhe pagesat e këtyre taksave dhe tarifave vendore.

Kriteri:Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 *ËPër sitemin e taksave vendore*, i ndryshuar, neni nr. 4 *ËZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë*, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni nr. 68 *ËVlerësimi tatimor*, neni nr. 69 *ËNjoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor*, neni nr. 114 *ËMospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit*, *ËRregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë*, neni 104 *ËDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore*, neni 105 *ËSektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimor*, neni 106 *ËDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin*.

Ndikimi/Efekti:Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Vlorë, shmangie të detyrimeve financiare duke mos u aplikuar kamatvonesat.

Shkaku:Mos aplikimi nëpërmjet sistemit TAIS të kamatvonesave sipas periudhës duke shkelur afatet kohore, mos njohje e plotë e legjislacionit të taksave dhe mos veprim i drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit, i ligjit për të ardhurat vendore, mos zbatim i rregullores së bashkisë.

Rëndësia:E Lartë

Rekomandim:Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ngrihet një grup pune për të përlllogaritur efektin e dëmit të shkaktuar nga mos aplikimi i kamatëvonesave gjatë periudhës objekt auditimi si rrjedhojë e veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifa vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë nga specialistët e vlerësimit.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa të kërkojë në formë shkresore shoqërisë që ka implementuar sistemin TAIS, të gjitha kamatvonesat e gjeneruara nga sistemi për vitet objekt auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. O. B., ish-Drejtor i Drejtorisë së Taskave dhe Tarifave Vendore, Inspektorët e pranimit/vlerësimit në DTTV.

III.2.2. Mbi mbi raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2018, 2019 dhe 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe

fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (i shfuqizuar), ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019 dhe 2020, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2018, 2019 dhe 2020.

▪ Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2018, 2019 dhe 2020 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019 dhe 2020;
- Centralizatori/Libri i madh;
- Ditari i Bankës;
- Ditari i Arkës;
- Ditari i Magazinës;
- Ditari i Pagesave;
- Ditari i Veprimeve të ndryshme;
- Aktrakordimet me Degën e Thesarit Vlorë;
- Inventarët etj.

▪ **Kriteret e vlerësimit:**

- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" , i shfuqizuar, në fuqi për periudhën e përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2018;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Bashkia Vlorë ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2018, 2019 dhe 2020, mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Vlorë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2018-2020 janë:**
 - Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
 - Pasyra e performancës financiare (F2);
 - Pasqyra e flukseve monetare (F3);
 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
 - Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë dhënë informacion mbi:
 - Emrin e njesisë ekonomike raportuese, Bashkia Vlorë me NIPT K567032010;
 - Nëse pasqyrat financiare mbulojnë një njësi ekonomike raportuese individuale apo grup njësisish;
 - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2020-31.12.2020;

- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 24.03.2021;
- Përgatitur nga z.H. H.,
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Vlorë me shkresën nr.4529, datë 24.03.2021, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë z. D. L.
- Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Vlorë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Vlorë, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Korçë.

▪ **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara:**

Bashkia Vlorë për vitet 2018-2020 ka hartuar Pasqyra Financiare të konsoliduara, ku njësitë shpenzuese që ka në varësi të saj janë si më poshtë:

- Teatri Petro Marko
- Qendra Kulturore
- Klubi Shumësportësh Flamurtari
- Ndërmarrja e Shërbimeve
- Shtëpia e Foshnjës
- Qendra e Zhvillimit PAK Vlorë
- Mbetjet e Ngurta

-Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, u konstatua se:

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2020 është në vlerën 602,496,120 lekë.

Situata:Nga verifikimi i paraqitjes analitike të llogarisë nr.468 òDebitorë të ndryshëm, rezultoi se në Bashkinë Vlorë debitorët e kontabilizuar në 31.12.2020 paraqiten në vlerën 577,398,400 lekë si dhe debitorët e kontabilizuar për njësitë administrative janë në vlerën 25,097,720 lekë (vlerë kjo e pa ndryshuar në vite).

Në fund të vitit 2020 sipas është në vlerën 602,496,120 lekë, ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në të dhënat e vendosura nga Bashkia Vlorë, lëvizjet debitore dhe kreditore të llogarive përkatëse, rezultoi se vlera e llogarisë 468 në fund të vitit **është 601,764,120 lekë, ose 732,000 lekë më pak.**

Bashkia dhe NJA	Përshkrimi	Dhjetor 2019	Viti 2020		
		Mbetja	Debi	Kredi	Mbetja
B. Vlore	Debitorë të ndryshëm	2,495,699	-	-	2,495,699
	Pulla	2,843,000	4,581,000	6,453,000	971,000
	Nga KLSH	8,680,526	-	-	8,680,526
	Gjoba Insp.Ndertimit	114,932,000	73,350,000	600,000	187,682,000
	Taksa dhe Tatime				376,837,175
Total B.Vlore					576,666,400
NJA Novoselë	Debitorë të ndryshëm	7,238,201	-	-	7,238,201
NJA Shushicë	Debitorë të ndryshëm	1,041,663	-	-	1,041,663
NJA Orikum	Debitorë të ndryshëm	15,922,745	-	-	15,922,745
NJA Qendër	Debitorë të ndryshëm	895,111	-	-	895,111
Total NJA		25,097,720			25,097,720
Total I+II					601,764,120

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

Duke analizuar analitikun e paraqitur nga Drejtoria e Financës për llogarinë nr.468 òDebitorë të ndryshëm, rezulton se, peshën më të madhe e zënë debitorët nga taksat dhe tatimet në vlerën **376,837,175 lekë** ose rreth 65% të totalit.

-Në analizë Gjobat e Inspektoriatit të mbrojtjes së Territorit (IMT):

Në vitin 2018 debitorët (393 fizik/juridik) që rrjedhin nga gjobat e Inspektoriatit të mbrojtjes së Territorit rezulton se janë trashëguar nga vitet e mëparshme në vlerën 61,682,000 lekë si dhe ka

patur shtesa gjatë vitit 2018 (debi të llogarisë) në vlerën 53,250,000 lekë, pra në total gjatë vitit 2018 debitorët nga këto gjoba paraqiten analitikisht në vlerën 114,932,000 lekë. **Ajo c'ka vihet re është fakti që nuk kemi asnjë arkëtim nga këto gjoba përgjatë vitit 2018 si dhe nuk janë kontabilizuar gjobat e vendosura nga IMT Vlorë nga muaji korrik deri në fund të vitit ushtrimor për 45 debitorë (fizik/juridik) në vlerën prej 6,050,000 lekë.**

-Në vitin 2019 debitorët që rrjedhin nga gjobat e IMT-së rezultojnë se nuk kanë ndryshuar pra nuk ka patur shtesa ose pakësime në analitikun e llog.468 ÷ Debitorë të ndryshëm, duke mos patur asnjë arkëtim nga gjobat e viteve të mëparshme. **Nga verifikimi rezultojnë gjithashtu se gjatë vitit 2019 nuk kemi asnjë kontabilizim të gjobave të vendosura në këtë periudhë ushtrimore nga Inspektoriati i Ndërtimit, përkatësisht për 168 debitorë (fizik/juridik) në vlerën prej 34,050,000 lekë.**

-Në vitin 2020 është bërë kontabilizimi i gjobave të vendosura nga Inspektoriati i ndërtimit, ku janë përfshirë gjoba të vendosura deri në vitin 2020.

-Përgjatë vitit 2020 nga gjobat e vendosura janë arkëtuar vetëm 600,000 lekë.

Nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit nuk janë paraqitur gjobat e vitit 2019 dhe 6 mujorit të dytë të vitit 2018 si dhe nuk i është drejtuar Drejtorisë së Financës me shkresë përcjellëse në fund të periudhave ushtrimore 2018 dhe 2019.

-Lidhur me vitin 2020 gjobat e vendosura i janë përcjellë Drejtorisë së Financës, për efekt kontabilizimi të tyre.

-Nga analizimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë konstatohet se vlera e debitorëve (vetëm për taksat dhe tarifatat që mbliken nga Drejtoria e Taksave) për vitin **2019** për **4783** subjekte është në shumën prej **324,901,227 lekë** dhe për vitin **2018** për **4455** subjekte është në shumën prej **287,771,902 lekë**. Pra shihet qartë se sipas të dhënave nga sistemi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vlorë nuk janë kontabilizuar debitorët e ndryshëm si dhe nuk ka rakordim midis Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për të kryer kontabilizimin e tyre dhe paraqitjen reale të llogarisë nr.486 ÷ Debitorë të ndryshëm.

Nga verifikimi i të dhënave për vitin 2018, specialistja e kontabilitetit dhe borxhit pranë DTTV-së Vlorë znj.B. H. ka dërguar Drejtorit të Taksave dhe Tarifave Vendore z.O. B. me shkresë përcjellëse nr.47, datë 02.03.2020, listën e debitorëve të cilët kanë detyrime pranë DTTV-së, përkatësisht **4783 debitorë në vlerën totale 324,901,227 lekë**.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është dërguar me shkresë përcjellëse Drejtorisë së Financës lista e subjekteve debitorë në Bashkinë Vlorë për vitet 2018 dhe 2019, duke mos e debituar këtë llogari në për vitin 2018 në shumën prej **287,771,902 lekë** dhe në vitin 2019 në shumën prej **324,901,227 lekë**.

-Për vitin 2020 nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore i janë përcjellë me shkresë debitorët për 8 lloje taksash dhe tarifash (pasurie, tabele, fjetje në hotel, reklame, truall, pastrim, zënie e hapësirës publike, veterinarie), të cilat mbliken prej kësaj drejtorie, në vlerën **376,837,175 lekë**.

-Konstatohet se **nuk janë kontabilizuar kamat-vonesat** për gjobat e vendosura nga IMT, si një detyrim ligjor që krijohet ndaj subjektit, i cili ka kryer kundërvajtje administrative, dhe që ndaj tij vendoset masë administrative ÷ gjobë, masë e cila përbën titull ekzekutiv. Pra sipas shkronjës ÷ ÷ të pikës 1 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ÷ Për kundërvajtjet administrative, nëse brenda 10 ditësh, nuk është paguar gjoba që përbën titull ekzekutiv²¹, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë 2 për qind në muaj të masës së gjobës. Për ta ilustruar kemi bërë përlllogaritje për disa gjoba të vendosura në muajin Shkurt të vitit 2018, data e mbajtjes së procesverbalit në subjekt + 10 ditë për të marrë vendimin përfundimtar + 10 ditë afat për ekzekutimin vullnetar të gjobës:

Subjekti	Data e Pv.verb.	Vlera e gjobës (Lek)	Kamat-vonesa deri më 31.12.2020	Vlera për t'u paguar	Pj. e Bashkisë (20%)	Pj. e Buxhetit të Shtetit (80%)
----------	-----------------	----------------------	---------------------------------	----------------------	----------------------	---------------------------------

²¹Neni 22, pika 1, Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 ÷ Për kundërvajtjet administrative.

T. sh.p.k	05.02.2018	100,000	75,143	175,142.86	35,028.57	140,114.29
H.P.	05.02.2018	500,000	340,714	840,714.29	168,142.86	672,571.43
Z. C.	08.02.2018	500,000	340,000	840,000.00	168,000.00	672,000.00
M. A.	09.02.2018	500,000	339,677	839,677.42	167,935.48	671,741.94
V. Gj.	10.02.2018	500,000	339,355	839,354.84	167,870.97	671,483.87
A. M.	16.02.2018	50,000	33,710	83,709.68	16,741.94	66,967.74
A. Gj.	26.02.2018	500,000	334,194	834,193.55	166,838.71	667,354.84
Total		2,650,000	1,802,793	4,452,792	890,558	3,562,234

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi.

▪ Konstatohet se në fund të vitit 2020 nuk janë kontabilizuar debitorët **që rezultojnë nga:**

-Taksa e tokës bujqësore në vlerën 64,290,775 lekë (NJA Novoselë, Shushicë dhe Qendër), pasi nuk nga Njësitë Administrative të mësipërme nuk i është përcjellë informacioni Drejtorisë së Taksave dhe Tarifa Vendore, si dhe Drejtorisë së Aseteve dhe Pronave Publike, ku nga këto të fundit të përcillej informacioni pranë zyrës së kontabilitetit.

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,615,972 lekë, pasi nuk i janë përcjellë zyrës së kontabilitetit nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

-Tarifa e hapësirës së plazhit për kontrata të lidhura në vitin 2020, në vlerën 6,783,200 lekë, pasi nuk i janë përcjellë nga Drejtoria e Aseteve dhe Pronave Publike ó zyrës së kontabilitetit.

(Pasqyruar në Kapitullin “Anekse – nr.2.2 – Tabela nr.2.2.3”)

-Parku i lojrave në vlerën 2,913,840 lekë, trajtuar më hollësisht në pikën e programit të auditimit mbi të ardhurat e realizuara nga B.Vlorë;

-Thertore, pronë e dhënë me qera në vlerën 347,040 lekë, trajtuar më hollësisht në pikën e programit të auditimit mbi të ardhurat e realizuara nga B.Vlorë, pasi nuk i janë përcjellë nga Drejtoria e Aseteve dhe Pronave Publike ó zyrës së kontabilitetit.

Për sa më sipër arrihet në konkluzionin që: Llogaria nr.468 óDebitorë të ndryshëm pasqyruar në formatin e pozicionit financiar për vitin 2018 në vlerën 152,680,445 lekë, në vitin 2019 në vlerën 152,615,945 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 602,496,120 lekë, të analizuara tek analitikët përkatës të kësaj llogarie, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së llogarisë duke mos evidentuar dhe kontabilizuar listën e subjekteve debitorë për:

- Vitin 2018 në vlerën **287,771,902 lekë (taksa dhe tarifa që mbliidhen nga DTTV) + gjobat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 6,050,000 lekë;**
- Vitin 2019 në vlerën **324,901,227 lekë, (taksa dhe tarifa që mbliidhen nga DTTV) + gjobat e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në vlerën 34,050,000 lekë;**
- Vitin 2020 për kamatvonesat si rrjedhojë e gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të cilat nuk janë likuiduar nga subjektet përkatëse + Taksa e tokës bujqësore në vlerën **64,290,775 lekë** + Taksa e hapësirës së plazhit për kontrata të lidhura në vitin 2020 në vlerën **6,783,200 lekë** + Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,615,972 lekë** + Parku i lojrave në vlerën **2,913,840 lekë** + Thertore, pronë e dhënë me qera në vlerën **347,040 lekë**, si dhe pasqyrimi i pullave në vlerën **1,103,000 lekë**, ndërkohë që mbetja e saj (debitim dhe kreditim gjatë vitit 2020) është **971,000 lekë, ose 132,000 lekë më pak** dhe mungesa e kontabilizimit të saktë të gjobave të IMT në fund të vitit 2020, në vlerën 188,282,000 lekë, ndërkohë që gjatë vitit 2020 janë **arkëtuar 600,000 lekë** nga gjobat e vendosura, për rrjedhojë vlera e gjobave në fund të vitit 2020 është **187,682,000 lekë.**

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 óPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, shkronja öë, pika 3, neni 12;

-Ligji nr.25/2018 óPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, pika 1, neni 11

-Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë;

-Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 óPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, kreu 3.1, pika 42.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.468 óDebitorë të ndryshëm, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Vlorë në fund të vitit 2020.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia:E Mesme

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 ÷Debitorë të ndryshëm.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-z.K. Sh. Administrator i NJA Novosel, z.B. A. Administrator i NJA Shushicë dhe zj.M. K. Administrator i NJA Qendër, të cilët nuk kanë përcjellë debitorët për taksën e tokës bujqësore;

-z.J. C., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për periudhën e raportimit dhe përgatitjes së pasqyrave financiare, në fund të vitit 2020, i cili nuk ka përcjellë debitorët për taksën e ndikimit në infrastrukturë;

-zj.S. H., Drejtore e kësaj Drejtorie, që ndjek procesin e arkëtimit të taksës përkatëse (pasqyruar në aneks);

-zj.S. H., Drejtore e Drejtorisë së Aseteve dhe Pronave Publike, e cila nuk ka përcjellë debitorët e hapësirës së plazhit dhe objektit ÷thertoreë dhënë me qera.

-z.Z. S. ish Kryeinspektori i IMT-së Vlorë, i cili nuk ka përcjellë debitorët që rezultojnë nga gjobat e vendosura nga IMT për periudhën 2018-2019.

-z.O. B. ish Drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, i cili nuk ka përcjellë debitorët për vitin 2018 dhe 2019, që rezultojnë nga taksat dhe tarifat vendore që mblihen nga DTTV.

-z.T. Z., Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe z.H. H. përgjegjësi i financës-kontabilitetit, nga të cilët nuk është kryer kontabilizimi i plotë dhe i saktë i vlerës totale të llogarisë 468 (diferenca prej 732,000 lekë, ndërmjet vlerës së pasqyruar në PF viti 2020), si dhe i kamat-vonesave që rezultojnë nga gjobat e vendosura prej IMT-së.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2019 dhe 2018 paraqitet në vlerën 0 lekë, si dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 246,662,821 lekë.

Situata:Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime, për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera. **Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”** në pasiv të bilancit në vitin 2018 në vlerën prej 278,668,913 lekë, në vitin 2019 në vlerën prej 228,391,796 lekë, dhe në vitin 2020 në vlerën 235,395,470 lekë.

Nga verifikimi i analitikut të llogarisë nr.486 për vitin 2020, situacioneve mujore të shpenzimeve, konstatohet se në vitin 2020 në këtë llogari nuk janë përfshirë detyrimet e Bashkisë Vlorë për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerën 52,428,965 lekë ndaj 7 subjekteve (F. M. -5,446,720 lekë, S. T. -1,809,469 lekë, J. -53,000 lekë, N. H. -38,937,384 lekë, H. K. -4,282,393 lekë, D. A. -1,499,999 lekë, D. H. -400,000 lekë).

-Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.486, nuk janë përfshirë detyrimet e Bashkisë Vlorë, ndaj subjekteve për punime/investime të kryera por të pafinancuara:

1.OE L. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **5,331,899 lekë**;

2.OE B. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **4,301,763 lekë**;

3.OE Sh. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **656,118lekë**;

4.OE I. Sh.p.k, ÷Rikualifikimi i bllokut të banimit që kufizohet nga rrugët Pelivan Leskaj, Ibrahim Avdullai, Camëria, Pirro Savao, likujduar deri më datë 31.12.2020, mbetur pa u likujduar në vlerën **11,577 lekë**;

5.OE Sh. shpk ÷Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa akseve rrugore ne qytetin e Vloresë në vlerën 59,400,008 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-fatura nr.1, sipas ditarit të bankës,

janë bërë 2 pagesa (14,820,000 + 13,680,000 = 28,500,000 lekë), fatura nr.2-situacioni përfundimtar datë 24.12.2020 në vlerën 27,820,472 lekë ó (5% * 27,820,472) = 26,429,448 lekë detyrim në fund të vitit 2020 ndaj OE, kontabilizuar 17,904,208 lekë, pra **8,525,240 lekë më pak**;

6.OE A. Sh.p.k òRikonstruksion i banesave egjiptianeò në vlerën 12,356,145 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-faturat nr.39 dhe 44 në vlerën 5,086,563 lekë + 5,360,752 lekë = 10,447,315 lekë, sipas ditarit të bankës, janë bërë 2 pagesa (2,900,903 lekë + 5,537,313 lekë = 8,438,216 lekë), pra pa u likujduar 2,009,099 lekë + 1,291,023 lekë sipas faturës nr.48/1 = 3,300,122 lekë detyrimi në fund të vitit 2020 ndaj OE A., ndërkohë në kontabilitet pasqyrohet detyrimi në vlerën 2,114,841 lekë, ose **1,185,281 lekë më pak**;

7.OE K. Sh.p.k “Rikonstruksion i disa rrugëve në territorin e NjA Novoselëo 8,407,980 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-faturat nr.35 dhe 43 (situacionet me -5%) në vlerën 7,987,581 lekë, sipas ditarit të bankës, është bërë 1 pagesë 4,408,000 lekë, pra pa u likujduar 2,251,745 lekë + 1,095,836 lekë sipas faturës 43 = 3,347,581 lekë, ndërkohë kontabilizuar 2,614,468 lekë, ose **965,113 lekë më pak**.

Kriteri:Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Kreu III, pika 42.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò, detyrime ndaj të tretëve, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të Bashkisë Vlorë në fund të vitit 2020.

Shkaku:Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia:E Mesme

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr.486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 62,350,726 lekë në fund të vitit 2019 e pa ndryshuar dhe në vitin 2018, si dhe në vitin 2020 në vlerën 76,162,778 lekë.

Situata: Sipas formatit 7/b òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò në fund të vitit ushtrimor 2019 llogaria nr.202 òStudime dhe kërkimeò paraqitet në vlerën 62,350,726 lekë.

Në vitin 2020 sipas formatit 7/b òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò llogaria nr.202 òStudime dhe kërkimeò paraqitet në vlerën 115,857,512 lekë, pasi ka patur shtesa gjatë vitit në vlerën 13,812,052 lekë.

Referuar formatit të mësipërm vihet re së për llogarinë nr.202 òStudime dhe kërkimeò, kemi patur shtesa në vlerën 13,812,052 lekë, ku kosto historike paraqitet në vlerën 102,045,460 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 39,694,734 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 62,350,726 lekë në celje të vitit ushtrimor, si dhe **76,162,778 lekë** në fund të vitit ushtrimor 2020.

-Konstatohet se, në bilancin e vitit 2020 është kontabilizuar si shtesë gjatë vitit 1 projekt, òProjekti Gjeohapësinorò në vlerën 12,960,000 lekë, projekt i cili nuk i përket shtesave të vitit 2020 këtij viti, pasi ky projekt është marrë në dorëzim nga Bashkia Vlorë më datë 28.12.2016, dhe duhej të kontabilizohej në këtë vit.

-Gjithashtu si rrjedhojë e këtij veprimi, për këtë projekt nuk është përlllogaritur vlera e amortizimit në masën 15%, nga data e marrjes në dorëzim deri më 31.12.2020 (4 vite-7,776,000 lekë), efektet e të cilit ndikojnë në pasqyrimin e saktë të vlerës së llogarisë nr.202, përkatësisht 68,386,778 lekë në pasqyrën F1.

-Nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 òStudime dhe kërkimeò.

-Nga auditimi i kontratave të lidhura për investimet në Bashkinë Vlorë, për vitet 2018 dhe 2019 rezultuan se, për dy kontrata punimesh të lidhura nga Bashkia Vlorë, projekti është kryer nga operatorë ekonomikë privat si më poshtë:

1.Kontrata ÷Vazhdim punimesh, rikonstruksioni i shkollës së mesme Halim Xhelo, Vlorë, lidhur në datën 11.03.2019 në vlerën 14,666,122, hartuesi i projektit është Operatori D. C. P., projekt i cili nga të dhënat e mara nga Bashkia Vlorë rezulton të jetë dhuratë. **Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë** dhe të paraqitet te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llogarinë nr.202 ÷Studime dhe Kërkimeö.

2.Kontrata ÷Rehabilitim lere betoniö, lidhur në datën 21.10.2019 në vlerën 2,613,851, hartuesi i projektit është Ll.Gj., projekt i cili nga të dhënat e mara nga Bashkia Vlorë është dhuratë. **Ky projekt nuk është bërë hyrje në magazinë** dhe të paraqitet te pasqyra e pozicionit financiar me vlerën kontabël të vlerësuar në llogarinë nr.202 ÷Studime dhe Kërkimeö.

Kriteri:Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, i ndryshuar, pika 26, 30 dhe 34.

-Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö, shkronja öbë e pikës 18 dhe pika 36.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.202 ÷Studime dhe kërkimeö, në detyrime ndaj të tretëve, **Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”**, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të Bashkisë Vlorë në fund të vitit 2020.

Shkaku:Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia:E Mesme

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet regjistrimi në kontabilitet i projekteve të dhuruara në llogarinë nr. 202 ÷Studime dhe Kërkimeö duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (marrëveshja/akti i dhurimit), si dhe përlllogaritjen e amortizimit të tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë neto 0 lekë, në vitet ushtrimore 2018, 2019 dhe 2020 dhe **Llogaria nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”** paraqitet me vlerë neto 272 lekë, në vitet ushtrimore 2018, 2019 dhe 2020.

Situata: Në Bashkinë Vlorë, në vitet 2018, 2019 dhe 2020 për llogaritë, 210 ÷Toka, troje, terreneö, 211 ÷Pyje Plantacioneö, 212 ÷Ndërtesa e Konstruksioneö, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Kriteri:Ligji nr.139/2015 ÷Për Vetëqeverisjen Vendoreö i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2;

-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74;

-Udhëzimi nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö. Kap III, pika 30.

Ndikimi/Efekti:Mungesa e informacionit në mënyrë analitike për secilin aktiv si dhe mungesa e një regjistri kontabël për çdo llogari të aktiveve sjell një pasqyrim jo të saktë të këtyre vlerave kontabël.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të krijohet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes

në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejnë dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes: Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën neto 1,020,832,930 lekë, në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën neto 803,577,884 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën prej 845,871,457 lekë.

Situata: Referuar formatit 7/a të Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2018 paraqitet në koston historike prej 1,028,719,077 lekë, gjendje e pa ndryshuar në mbyllje të vitit 2019, pra nuk ka patur shtesa ose pakësime, në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,028,719,077 lekë dhe në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,286,153,017 lekë, si rrjedhojë e shtesave në vlerën **257,433,940 lekë.**

Analitiku i llogarisë nr.212 të Ndërtesa dhe Konstruksioneve përbëhet nga 189 ndërtesa dhe konstruksione, ku për Bashkinë Vlorë janë 70 në vlerën 716,828,555 lekë, për NJA Novoselë janë 27 aktive në vlerën 69,370,100 lekë, për NJA Orikum 36 aktive në vlerën 105,442,964 lekë, NJA Shushicë 31 aktive në vlerën 60,759,646 lekë dhe NJA Qendër 23 aktive në vlerën prej 76,317,812 lekë.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi marrjen në dorëzim të investimeve të kryera (shkolla, terren sportiv, palestra), që kontabilizohen në llogarinë 212, si dhe analitikut të llogarisë 212, konstatohet se gjatë vitit 2020 janë marrë në dorëzim objekte, **të cilat nuk janë kontabilizuar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”,** si vijon:

- 1.Palestër Sportive për Shkollën Ismail Qemali - vlera përfundimtare 25,053,876 lekë;
- 2.Rikonstruksioni i Shkollës të Balil Pelariu - vlera përfundimtare 20,323,662 lekë;
- 3.Rikualifikimi i Qendrës së fshatit Dukat - vlera përfundimtare 10,898,878 lekë.

-Konstatohet se për aktivet që paraqiten në llogarinë 212, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv.

-Konstatohet se një pjesë e aktiveve të kësaj llogarie nuk paraqesin vlerën reale të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Vlorë nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas cmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë, për 39 objekte, variojnë nga 0 lekë në 200,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e këtyre aktiveve të jetë e nënvlerësuar.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, pika 105 në Kapitullin IV.

-Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, pika 26 dhe 30.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.212 të Ndërtimeve dhe konstruksioneve në fund të vitit 2020, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet regjistrimi në kontabilitet i objekteve të marra në dorëzim në llogarinë nr. 212 të Ndërtimeve dhe konstruksioneve duke u bazuar në dokumentacion shoqëruar (certifikata përfundimtare e marrjes në dorëzim të objektit), si dhe rivlerësimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejnë dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes: Llogaria nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën neto 2,987,207,303 lekë, në vitin 2019 paraqitet në vlerën neto 2,038,562,653 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën neto prej 2,145,855,424 lekë.

Situata: Referuar formatit 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2018 paraqitet në koston historike prej 2,924,536,615 lekë, gjendje e pa ndryshuar në mbyllje të vitit 2019, pra nuk ka patur shtesa ose pakësime. Në mbyllje të vitit 2020 aktivet e kontabilizuara në llogarinë nr.213 paraqiten në vlerën 3,975,110,398 lekë, si rrjedhojë e shtesave të bëra përgjatë vitit 2020, kryesisht rikostruksione të rrugëve dhe ujësjellës.Përmbledhëse e llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò(Vlera Historike)

Emertimi	llog.213	
	2020	
	Nr. Aktiveve	Vlera
Bashkia Vlorë	123	2,173,272,944
Njësia Novoselë	58	454,758,251
Njësia Orikum	43	569,857,382
Njësia Shushicë	36	383,352,697
Njësia Qender	35	393,869,125
Shuma	295	3,975,110,399

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

-Analitiku i llogarisë nr.213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò përbëhet nga 295 objekte, ku për Bashkinë Vlorë janë në vlerën 2,173,272,944 lekë, për NJA Novoselë janë 58 objekte në vlerën 454,758,251 lekë, për NJA Orikum 43 objekte në vlerën 569,857,382 lekë, NJA Shushicë 36 objekte në vlerën 383,352,697 lekë dhe NJA Qender 35 objekte në vlerën prej 393,869,125 lekë.

-Nga verifikimi i amortizimit të përlllogaritur për aktivet e llogarisë nr.213, konstatohet se për shtesat në aktive të bëra gjatë vitit 2020, **nuk është përlllogaritur amortizimi për pjesën e mbetur nga data e marrjes në dorëzim të investimit deri në fund të vitit 2020.** Përlllogaritur si më poshtë vijon.

Amortizimi për shtesat e bëra në llogarinë nr.213

Aktivi i marrjes në dorëzim	Data e marrjes në dorëzim	Kontabilizua2020	Vlera përfundimtare	Amortizimi i llogaritur për pjesën e mbetur (norma 5% *kohën nga marrja në dorëzim deri në fund të vitit 2020)
Riasfaltime në qytet	15.12.2019	Po	108,224,716	5,411,235
Blloku Pelivan Leskaj	26.02.2020	Po	58,799,527	2,175,582
Varreza-Risili	26.02.2020	Po	70,385,523	2,604,264
Ura e Zverneçit	13.05.2020	Po	33,048,818	958,415
Rruga Llakatund	29.06.2020	Po	12,600,000	302,400
Prishja e ish Frigoriferit	15.10.2020	Po	17,853,456	142,827
Total				11,594,723

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

-Gjithashtu, për këto aktive nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv.

Kriteri:Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 36.

-Udhëzimi nr.30,datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 26 dhe 30.

Ndikimi/Efekti:Llogaria nr.213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreò në fund të vitit 2020, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi:Titullari iBashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të krijohet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën neto 63,230,727 lekë, në vitin 2019 paraqitet në vlerën neto 66,558,660 lekë dhe në mbyllje të vitit 2018 në vlerën neto 70,944,520 lekë.

Situata: Referuar formatit 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò, në fund të vitit 2018 paraqitet në koston historike prej 105,276,824 lekë dhe në fund të vitit 2019 në vlerën 104,438,190 lekë. Në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 104,438,190 lekë, pra nuk ka patur shtesa/pakësime përgjatë vitit.

Analitiku i llogarisë nr.215 òMjete transportiò përbëhet nga 44 mjete, ku për Bashkinë Vlorë janë 31 mjete në vlerën 86,340,466 lekë, për NJA Shushicë është 1 mjet në vlerën 100,000 lekë, për NJA Qendër janë 4 mjete në vlerën 2,786,200 lekë, NJA Orikum janë 2 mjete në vlerën 9,513,524 lekë dhe NJA Novoselë janë 7 mjete në vlerën prej 5,698,000 lekë

Gjatë vitit 2019 është shtuar pa pagesë automjeti mercedes-benz 1..... AF, në vlerën 1,285,366 lekë, si dhe është transferuar pa pagesë mjeti transportit tip kamion Ndërmarrjes së Shërbimeve në vlerën 2,124,000 lekë.

Gjatë vitit 2020 nuk ka patur lëvizje në këtë llogari.

-Nga verifikimi i analitikut të llogarisë nr.215, **mbi përlllogaritjen e amortizimit**, konstatohet se norma e amortizimit përdorur nga B.Vlorë për aktivet e llogarisë nr.215, **është 5%**, normë e cila, sipas përcaktimit të bërë në pikën 36 të Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, përdoret për: òP r aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e t prodhimin, dhe makinerit e pajisjet me afat t gjat sh rbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbeturò, **ndërkohë që për aktive të tjera afatgjatapërdoret norma 20%**, për rrjedhojë vlera e amortizimit për llogarinë nr.215 prej 3,327,933 lekë, nuk është vlera reale.

-Konstatohet se për këto aktive administrohet një tabelë në formatin EXEL, pra jo regjistër kontabël.

Kriteri:Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 36.

-Udhëzimi nr.30,datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 26.

Ndikimi/Efekti:Llogaria nr.215 òMjete transportiò në fund të vitit 2020, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi:Titullari iBashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të krijohet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, etj, si dhe përlllogaritjen e amortizimit të tyre me normën **20%**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.1013 “Nga konsumi i AAGJ”(formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”).

Situata: Referuar tabelës formati 7/b òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera netoò, totali i amortizimit për vitin 2020 për klasat e aktiveve është përlllogaritur në vlerën prej

(159,625,483) lekë, ndërkohë që është debituar llogaria nr.1013 ònga konsumi i AAGJò (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), në vlerën **(148,538,993)**, ose **11,086,490** lekë më pak. (Pasqyruar në Kapitullin “Anekse – nr.2.2 – Tabela nr.2.2.4”)

Kriteri:Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, shkronja òcò, pika 1.1.1, Aneksi 1.

Ndikimi/Efekti:Llogaria nr.101 òFonde të vetaò në fund të vitit 2020, nuk pasqyrojnë vlerën e drejtë dhe reale të saj.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia:E Lartë

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël, duke debituar saktë llogarinë nr.1013 ònga konsumi i AAGJò (formati 4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”), duke korresponduar me vlerën e amortizimit vjetor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë Vlorë për vitin ushtrimor 2020.

Situata:Lidhur me inventarizimin e aktiveve të institucionit, **konstatohet se**, para hartimit dhe raportimit të pasqyrave financiare nuk është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit, si një dokument kontabël që shërben për pasqyrimin real dhe të saktë të vlerave të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar F1. Theksojmë se nga titullari i B.Vlorë është nxjerrë urdhri nr.400/1 prot., datë 19.03.2021 për kryerjen e inventarizimit të aktiveve, i cili duhet të përfundonte brenda datës 30.04.2021.

Nga kërkesa e grupit të auditimit për raportin e inventarizimit dhe procesverbalin e vlerësimit të aktiveve të institucionit, rezultoi se nuk ka përfunduar por është në proces.

Kriteri:Pika 73 dhe 74 në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:Në këto kushte mungesa e raportit të inventarizimit dhe procesverbalit të mbajtur për vlerësimin e aktiveve, si një dokument kontabël bazë, ndikon në pasqyrimin me vërtetësi dhe të dhënave të plota lidhur me gjandjen në fund të vitit të aktiveve afatgjata dhe inventarit në magazinë.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia:E Lartë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Titullari i B.Vlorë/Nëpunësi Autorizues, z.D. L., si dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit z.T. Z., të cilët nuk kanë marrë masat për fillimin dhe përfundimin e këtij procesi përpara raportimit të pasqyrave financiare për vitin 2020.

-Komisionet e inventarizimit, që nuk kanë respektuar afatin, 30.04.2021, të vendosur në urdhrin nr.400/1 prot., datë 19.03.2021 për përfundimin e procesit të inventarizimit, V. Z., R. S., E. B., A. H., M. M., A. M., F. C., L. L., A. K., A. M., L. M., A. H., Sh. K., I. I., O. B., E. F., A. S., E. M., F.D., S. A., A. L., J. J., I. H., S. B., D. D., K. C., R. H., M. P., D. A., J. H., M. L., D. Rr., F. B., T. Z., P. M., F. D.

Titulli i gjetjes:Nxjerrja jashtë përdorimit të materialeve të ndryshme, për vitin 2019 dhe 2020 (2 procedura).

Situata:Për vitin 2019 është nxjerrë urdhri me nr.9432/1 datë 31.10.2019, òPër nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune, inventar ekonomikò. Urdhri është për daljen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabilitetit për inventarët si më poshtë:

Viti 2019	Inventar i imët llogaria 327-1	Inventar llogaria 214	Inventar ekonomik llogaria 218	Materiale llogaria 312

Arsimi	2,093,570	5,050,829	984,320	-
Cerdhet	144,135	232,700	-	-
Gjendja Civile	12,285	254,236	-	-
Konviktet	283,993	143,416	-	-
Administrata	1,775,721	6,939,242	90,000	-
NJA. Qender	18,594	73,239	250,295	-
NJA.Orikum	176,886	136,253	535,546	-
NJA. Shushicë	7,725	-	111,700	-
NJA.Novoselë	172,754	926,586	371,508	-
Llogaria 327/0	34,469	-	-	-
Materiale	-	-	-	4,564
Totali	4,720,132	13,756,501	2,343,369	4,564

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

Janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si dhe këto procesverbale janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Vlorë.

Tek përshkrimi i dhënë në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për t'ua rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjesimit fizik.

Nga verifikimi i listës së materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit duke i asgjesuar fizikisht rezulton se ka një pjesë të konsiderueshme të materialeve me profil drusor dhe profil metalik të cilat duhet të ishin grumbulluar të ishin bërë hyrje në magazinë dhe më pas të shiteshin me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

Referuar tabelës më sipër konstatohet se:

-Për arsimin nga analiza e listave të materialeve të nxjerra jashtë përdorimi vlera prej 5,050,829 lekë të shkarkuara nga kontabiliteti (*llogaria nr.214 "Makineri dhe paisje"*) pjesa më e madhe janë materiale (banka, tavolina, karrige, rafte drusor) me profil druri për të cilat duhet të ishin grumbulluar dhe të shiteshin me ankand.

-Për administratën, nga analiza e listave të materialeve të nxjerra jashtë përdorimit vlera prej 6,939,242 lekë të shkarkuara nga kontabiliteti (*llogaria nr.214 "Makineri dhe paisje"*), janë materiale me profil druri dhe profil metalik, ku vihet re që pjesë të konsiderueshme të kjo llogari janë nxjerrja jashtë përdorimit të kontenierëve (kazan mbeturinash) me cmim **25,800 lekë janë nxjerrë jashtë përdorimit 200 njësi për vlerën totale 5,160,000 lekë.**

Komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Me urdhrin e brendshëm nr.246 datë 31.10.2019 dhe me nr.prot, 9432, janë ngritur nga Titullari komisionet për nxjerrjet jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune dhe inventar ekonomik. Komisionet kanë mbajtur procesverbalet ku kanë përshkruar se është bërë asgjesimi fizik i materialeve dhe gjatë asgjesimit u konstatuan se inventarët ishin të papërdorshëm, si dhe mbetjet e tyre smund të përdoren.

Nga ana e komisioneve në proces verbalet e mbajtura nuk paraqiten dokumenta mbështetës ku të përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për cdo aktiv dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve (në ndryshimin e formës fillestare, groposur ose djegur), si dhe për materialet me profil druri dhe metalik nuk janë përdorur si materiale të riciklueshme, të bëheshin hyrje në magazinë dhe të shiteshin në formë ankandi ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

-Për vitin 2020 është nxjerrë urdhri me nr.12042 datë 31.12.2020, òPër nxjerrjen jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune, inventar ekonomik. Urdhri është për daljen jashtë përdorimit dhe shkarkimin nga kontabiliteti për inventarët si më poshtë:

Viti 2020	Inventar i imët	Inventar	Inventar ekonomik	Materiale
	llogaria 327-1	llogaria 214	llogaria 218	llogaria 312
Arsimi	1,381,504	1,800,769	10,800	-
Cerdhet	189,742	128,200	-	-
Gjendja Civile	30,450	321,255	-	-
Konviktet	297,680	174,900	-	-
Administrata	1,881,409	5,903,099	-	-
NJA Qender	59,966	79,580	93,186	-

NJA Orikum	47,721	109,080	1,322,167	-
NJA Shushicë	567	-	-	-
NJA Novoselë	80,610	62,932	209,927	-
Magazina industriale	80,460	304,200	-	144,041
Materiale			-	
Totali	4,050,109	9,450,410	1,36,080	144,041

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

-Në këtë procedurë, nga titullari i institucionit **nuk duhet të ishte nxjerrë urdhër për daljen jashtë përdorimit të aktiveve të mësipërme**, pasi institucioni **nuk ka qenë as gjatë procesit të inventarizimit, si dhe as pas përfundimit të këtij procesi**, ku theksojmë se për vitin 2020 Bashkia Vlorë nuk ka kryer inventarizimin e aktiveve.

-Nuk administrohen procesverbalet dhe relacionet e vlerësimit për mallrat që janë nxjerrë jashtë përdorimit.

-Nuk administrohet lista e mallrave që do të kalojnë për vlerësim, e cila përgatitet nga Nëpunësi Zbatues i Institucionit;

-Nga verifikimi i listës së materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit duke i asgjësuar fizikisht rezulton se, **ka një pjesë të konsiderueshme të materialeve me profil drusor dhe metalik, të cilat duhet të ishin grumbulluar të ishin bërë hyrje në magazinë dhe më pas të shiteshin me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.**

Referuar tabelës më sipër konstatohet se:

-Një pjesë e konsiderueshme e mallrave të nxjerrë jashtë përdorimit, janë të natyrës që mund të shiteshin me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, si më poshtë vijon:

Kazan mbeturinash ó 120 cop * 25,800 lekë = 3,096,000 lekë

Zgarë hekuri ó 12 cop * 20,330 lekë = 243,960 lekë

Kazan inoksi ó 2 cop * 29,000 lekë = 58,000 lekë

Kazan inoksi ó 3 cop * 14,500 lekë = 43,500 lekë

Rafte metalik ó 8 cop * 4,000 lekë = 32,000 lekë

Kazan inoksi ó 36,000 lekë

Kazan - 2 cop * 8,600 lekë = 17,200 lekë

Kazan ó 8,000 lekë

Kazan i madh ó 7,000 lekë

Gjithësej **3,541,660 lekë.**

-Konstatohet se në listat e përgatitura për nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave, janë pasqyruar mallra për t'u nxjerrë jashtë përdorimit, **pa pasqyruar vlerën e tyre**, konkretisht për mallin òBanga metalikeó ó 30 cop gjithësej.

Komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit

Me urdhrin e brendshëm nr.280 datë 23.12.2020 dhe me nr.prot, 11795, janë ngritur nga Titullari i B.Vlorë, komisionet për nxjerrjet jashtë përdorimit të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune dhe inventar ekonomik. **Nga komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave të mësipërm, nuk është dokumentuar plotësisht procedura e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave të mësipërm**, pasi në dosjet përkatëse nuk administrohen dokumenta mbështetës të cilët, vërtetojnë nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimit/shkatërrimit si, dokumenti i transferimit të tyre për asgjësim/shkatërrim, mënyra e përdorur për asgjësimin/shkatërrim e tyre (djegje, grososje, etj), kontrata e shërbimit ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit/asgjësimit/transportimit të mallrave, si dhe foto të procesit asgjësimi të tyre.

-**Theksojmë se**, nuk ka qenë e mundur përlllogaritja e vlerës së shitjes së materialeve të mësipërme me profil metalik, të nxjerra jashtë përdorimit, për arsye të mungesës së peshës së secilit prej tyre.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikó pikat 95, 104, 106, 109 dhe 110.

-Pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 òPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeó, i ndryshuar.

-Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 òPër lendfillet e mbetjeve, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:Nxjerrja jashtë përdorimi të materialeve me profil metalik dhe mos respektimi i procedurave ligjore, ka efekt negativ në të ardhurat, që do të krijonte Bashkia Vlorë nga shitja e tyre me ankand, vlerë e cila nuk mund të matet.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia:E Lartë

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme që, të ngrëjë një grup pune, i cili të identifikojë institucionet ku janë nxjerrë jashtë përdorimit materialet me profil metalik (Administrata Bashkia Vlorë, Gjendje Civile, Qendra Ekonomike, Cerdhe, Kopshte, Njësi Administrative, etj), si dhe komisionet përkatëse, për vitet 2019-2020.

Në vijim nga grupi i punës të përllogaritet vlera e shitjes me ankand (pesha e materialit²² * vlera e tregut për 1 kg) të materialeve të mësipërme me profil metalik, që janë nxjerrë jashtë përdorimit në vitet 2019 dhe 2020.

Në përfundim të procesit të identifikimit dhe vlerësimit, Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin në mënyrë përpjestimore, të vlerës së shitjes me ankand të materialeve me profil metalik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

-Nëpunësi Autorizues i Bashkisë Vlorë Z. D. L. dhe Z. T. Z., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

-Komisionet respektive të nxjerrjes nga përdorimi të mallrave, S. H., Th. Q., A. A., M. T., L. K., Ll. M., K. M., F. Ll., E. P., E. P., A. S., A. T., E. F., B. Gj., R. M., E. B., A. S., E. Sh., E. B., J. J., I. H., S. B., S. B., K. C., R. H., F. M., D. D., A. A., J. H., M. P., D. A., Z. B., B. Sh., F. B., D. Rr., M. L., N. B.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”,sipas të dhënave të pasqyruara për vitet ushtrimor 2018, 2019 dhe 2020, vlera kontabël paraqitet në shumën 2,000,000 lekë.

Situata:

1. Bashkia Vlorë nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 10.07.2001 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Vlorë SHA me NUIS òK.....Aò e cila është shoqëri aksionere me objekt òShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 632,287,414 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 632,287,414 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Vlorë në òUjësjetllës Kanalizime Vlorë sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018, 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e veta.

2. Bashkia Vlorë nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 13.09.2011 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të F. F. C. SHA me NUIS òL.....Iò e cila është shoqëri aksionere me objekt òOrganizimi i aktiviteteve sportive të futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir dhe pjesëmarrja në garat sportive kombëtare e ndërkombëtare të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit si dhe organizatat ndërkombëtare të futbollit. Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit. Futja në tregun e lojtarëve për të blerë lojtarë sipas nevojave të ekipit. Aktivitete të tjera tregtare në fushën e futbollit. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Numri i aksioneve

²²Specifikimet teknike të materialit, përmasa dhe pesha.

është 100,00 me vlerë nominale 35,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Vlorë në òF. F. Cò sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018, 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò.

Në këtë mënyrë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) 635,787,414 lekë dhe investitori është Bashkia Vlorë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne pjesëmarrje me vlerë kontabël **635,787,414 lekë** përbën deformim të informacionit financiar.

Kriteri:Urdhri i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

-Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, Kreu 3.1, pika 31, shkronja òbò.

Ndikimi/Efekti:Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018, 2019 dhe 2020 të llogarisë 26 òPjesëmarrje në kapitalin e vetò.

Shkaku:Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi:Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 òPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes:Llogaria nr.231 “Investime në proces”,në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën prej 1,139,418,442 lekë, në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën prej 1,411,462,809 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 320,696,105 lekë.

Situata:Sipas analitikëve të paraqitur nga Drejtori e Ekonomisë për vitin 2018 paraqiten 51 Investime në proces me vlerë kontabël 1,139,418,442 lekë, për vitin 2019 paraqiten 69 Investime në proces me vlerë kontabël prej 1,411,462,809 lekë, pra me një shtesë prej 272,044,367 lekë, ndërsa për vitin 2020 paraqitet në vlerën 320,696,105 lekë, pra me një pakësim prej 1,090,766,704 lekë, vlerë e cila përfaqëson kapitalizimin e investimeve të përfunduara për AAGJM, duke kredituar llogarinë 231 dhe debituar llogaritë përkatëse të AAGJM nr.212, 213 dhe 214.

Nga analizimi i shpronësimeve dhe statusit të tyre në lidhje me projektet e ndërmarra nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht dhe detyrimet e prapambetura që lindin për shpronësimet u konstatua se:

A. Bazuar në VKM-në nr. 368, datë 20.06.2018 òPër shpronësimet, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit òRikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorëò, pika 4 e vendimit përcakton se: òVlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë òtruallò dhe òndërtesëò, prej 152,930,608 lekësh, **të përballohet në masën 50% nga Bashkia Vlorë dhe 50% nga llogaria e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisëò.**

A.1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve, pra 80,188,890 lekë e cila është likujduar deri në 31.12.2019 (duke e arritur masën 50% të totalit sipas pikës 4);

Likujdimet e kryera nga MIE, në vlerën 80,188,890 lekë , nga ana e Sektorit të Financës duhet të kontabilizoheshin te llogaria nr. 231 si ÷Investime në procesë, dhe në momentin e përfundimit të projektit duhet të kapitalizohen te klasa e aktiveve afatgjata materiale.

A.2. Bashkia Vlorë, referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve.

Deri në 31.12.2019, Bashkia Vlorë ka likujduar vlerën prej 24,505,471 lekë. Vlera kontabël është paraqitur tek llogaria nr. 231 ÷Investime në procesë, për vitin ushtrimor 2019.

Nga analizimi i shpronësimeve dhe statusit të tyre në lidhje me projektet e ndërmarra nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht dhe detyrimet e prapambetura që lindin për shpronësimet u konstatua se: Bazuar në VKM-në nr. 368, datë 20.06.2018 ÷Për shpronësimet, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ÷Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, pika 4 e vendimit përcakton se: ÷Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë ÷truallë dhe ÷ndërtësë, prej 152,930,608 lekësh, **të përballohet në masën 50% nga Bashkia Vlorë dhe 50% nga llogaria e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë.**

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve, pra **80,188,890 lekë** e cila është likujduar deri në 31.12.2019 (duke e arritur masën 50% të totalit sipas pikës 4);

-Likujdimet e kryera nga MIE, në vlerën **80,188,890 lekë** nuk janë kontabilizuar tek llogaria nr. 231 si ÷Investime në procesë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Kreu 2, Klasa 2.

Ndikimi/Efekti: Vlera jo e saktë e llogarisë nr. 231 ÷Investime në procesë në fund të vitit 2020, pasqyruar më pak për vlerën 80,188,890 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 ÷Investime në procesë dhe llogarive nr.213/212 sipas rastit, me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes: **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”,** paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 235,395,470 lekë, në vitin 2019 në vlerën prej 228,391,796 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 në vlerën prej 278,668,913 lekë, vlera që përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera dhe të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. **Kjo llogari ka si kundërparti llogarinë nr.486“Shpenzime të periudhave të ardhshme”.**

Situata: Nga analizimi i kontratave për investime publike për vitet 2018, 2019 dhe 2020; Vendimeve për shpronësimet (VKM nr. 368, datë 20.06.2018 Projekti ÷Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, dhe VKM nr. 277, datë 02.05.2019 ÷Për shpronësimin të pronës private që preket nga realizimi i projektit rikonstruksioni i oborrit të shkollës Ali Demi, Vlorë), Vendimet gjyqësore të formës së prerë, kemi përpunuar të dhënat, gjëndjen e detyrimeve të prapambetura nga shpenzimet kapitale. Nga përpunimi i të dhënave kemi realizuar testimin e saktësisë së llogarisë nr. 486 ÷Shpenzime të periudhave të ardhshme si llogari debitore dhe testimin e saktësisë së llogarisë nr. 467 ÷Kreditorë të ndryshëm si llogari kreditore të regjistrimit në kontabilitet të detyrimeve të prapambetura për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, vendimeve gjyqësore për shkak të mungesës së fondeve.

I.Verifikimi i detyrimeve që rrjedhin për shpenzimet për investimet (llog.230 dhe llog.231)

-Nuk janë përfshirë detyrimet e Bashkisë Vlorë, ndaj subjekteve për punime/investime të kryera por të pafinancuara:

1.OE L. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **5,331,899 lekë**;

2.OE B. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **4,301,763 lekë**;

3.OE Sh. Sh.p.k, mbetur pa u likujduar **656,118lekë**;

4.OE I. Sh.p.k, òRikualifikimi i bllokut të banimit që kufizohet nga rrugët Pelivan Leskaj, Ibrahim Avdullai, Camëria, Pirro Savaò, likujduar deri më datë 31.12.2020, mbetur pa u likujduar në vlerën **11,577 lekë**;

5.OE Sh. shpk òRehabilitimi dhe riasfaltimi i disa akseve rrugore ne qytetin e Vloresò në vlerën 59,400,008 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-fatura nr.1, sipas ditarit të bankës, janë bërë 2 pagesa (14,820,000 + 13,680,000 = 28,500,000 lekë), fatura nr.2-situacioni përfundimtar datë 24.12.2020 në vlerën 27,820,472 lekë ó (5% * 27,820,472) = 26,429,448 lekë detyrim në fund të vitit 2020 ndaj OE, kontabilizuar 17,904,208 lekë, pra **8,525,240 lekë më pak**;

6.OE A. Sh.p.k òRikonstruksion i banesave egjiptianeò në vlerën 12,356,145 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-faturat nr.39 dhe 44 në vlerën 5,086,563 lekë + 5,360,752 lekë = 10,447,315 lekë, sipas ditarit të bankës, janë bërë 2 pagesa (2,900,903 lekë + 5,537,313 lekë = 8,438,216 lekë), pra pa u likujduar 2,009,099 lekë + 1,291,023 lekë sipas faturës nr.48/1 = 3,300,122 lekë detyrimi në fund të vitit 2020 ndaj OE A., ndërkohë në kontabilitet pasqyrohet detyrimi në vlerën 2,114,841 lekë, ose **1,185,281 lekë më pak**;

7.OE K..K Sh.p.k “Rikonstruksion i disa rrugëve në territorin e NjA Novoselëò 8,407,980 lekë, deri më 31.12.2020 për punime të kryera-faturat nr.35 dhe 43 (situacionet me -5%) në vlerën 7,987,581 lekë, sipas ditarit të bankës, është bërë 1 pagesë 4,408,000 lekë, pra pa u likujduar 2,251,745 lekë + 1,095,836 lekë sipas faturës 43 = 3,347,581 lekë, ndërkohë kontabilizuar 2,614,468 lekë, ose **965,113 lekë më pak**.

II.Verifikim i detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

-Nga verifikimi i analitikut të llogarisë nr.467 për vitin 2020, situacioneve mujore të shpenzimeve, konstatohet se në vitin 2020 në këtë llogari nuk janë përfshirë detyrimet e Bashkisë Vlorë për likujdimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerën **52,428,965 lekë ndaj 7 subjekteve** (F. M. -5,446,720 lekë, S. T. -1,809,469 lekë, J. -53,000 lekë, N. H. -38,937,384 lekë, H. K. -4,282,393 lekë, D. A. -1,499,999 lekë, D. H. -400,000 lekë).

Gjatë vitit 2018 shpenzimet që rrjedhin nga Zyrat Përmbarimore për mos likujdim në afat të vendimeve gjyqësore janë në vlerën **3,142,737 lekë**, si rezultat i mos respektimit të Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 òPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò, pika 9 dhe 10. Kjo shumë përbën një detyrim shtesë për Bashkinë Vlorë, vetëm nga tarifat që aplikojnë zyrat përmbarimore nga urdhër sekuestro konservative.

Verifikim i detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga shpronësimet.

Nga analizimi i shpronësimeve dhe statusit të tyre në lidhje me projektet e ndërmarra nga Bashkia Vlorë, rrjedhimisht dhe detyrimet e prapambetura që lindin për shpronësimet rezultoi se:

A.Bazuar në VKM-në nr.368, datë 20.06.2018 òPër shpronësimet, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit òRikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorëò, pika 4 e vendimit përcakton se: òVlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë òtruallò dhe òndërtesëò, prej 152,930,608 lekësh, të përballohet në masën 50% nga Bashkia Vlorë dhe 50% nga llogaria e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisëò. (Pasqyruar në Kapitullin “Anekse – nr.2.2 – Tabela nr.2.2.5”)

Referuar tabelës së mësipërme në lidhje me shpronësimet nga VKM nr.368 datë 20.06.2018, u konstatua se:

A.1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve, pra 80,188,890 lekë e cila është likuajduar deri në 31.12.2019 (duke e arritur masën 50% të totalit sipas pikës 4);

Likuajdimet e kryera nga MIE, në vlerën 80,188,890 lekë nga ana e Sektorit të Financës duhet të kontabilizoheshin tek llogaria nr.231 si ÷Investime në proces, dhe në momentin e përfundimit të projektit duhet të kapitalizohen tek klasa e aktiveve afatgjata materiale.

A.2. Bashkia Vlorë, referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve.

Deri në 31.12.2019, Bashkia Vlorë ka likuajduar vlerën prej 24,505,471 lekë. Vlera kontabël është paraqitur tek llogaria nr.231 ÷Investime në proces, për vitin ushtrimor 2019.

Vlera e mbetur prej **49,839,678 lekë** e cila duhet të përballohet nga Bashkia Vlorë rezulton e pa likuajduar deri në datë 31.12.2020, vlerë kjo e cila nuk është evidentuar në llogarinë nr.467 ÷Kreditorë të ndryshëm, në fund të vitit 2020.

B. Bazuar në VKM-në nr.277, datë 02.05.2019 ÷Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së palujtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit Rikonstruksion i oborrit të shkollës Ali Demi, Vlorë, pika 3 e vendimit përcakton se: ÷Pronari i pasurisë të paluajtshme që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën përfundimtare, me të dhënat e pronarit që shpronësohet, për pasurinë ndërtesë, me vlerë 8,796,650 lekë, pika 4 e vendimit përcakton se: ÷Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasurinë ndërtesë prej **8,796,650 lekë**, të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Vlorë, për vitin 2019.

Nr.	Emër Mbiemër	Vlera totale e ndërtesë (lekë)
“Rikonstruksion i oborrit të shkollës ‘Ali Demi’”, Vlorë		
1	D. H.	8,796,650
Vlera totale e shpronësimit		8,796,650 lekë

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

Vlera e mbetur prej **8,796,650 lekë** e cila duhet të përballohet nga Bashkia Vlorë rezulton e pa likuajduar deri në datë 31.12.2019, vlerë kjo e cila nuk është evidentuar në llogarinë nr.467 ÷Kreditorë të ndryshëm, në fund të vitit 2019.

-Gjatë vitit 2020 ndaj subjektit D. H. është likuajduar 2,000,000 lekë, pra mbetur pa u likuajduar **6,796,650 lekë**, e cila nuk është e kontabilizuar në llogarinë nr.467, në fund të vitit 2020.

Nga Drejtoria e Aseteve dhe Pronave Publike nuk është dhënë informacion i plotë dhe të jetë kryer rakordimi me Drejtorinë Ekonomike, duke mos mbajtur një database të detajuar duke përcaktuar qartë të gjitha shpronësimet që duhet të kryen me vlerat përkatëse, fazat në të cilat ndodhen, sa prej tyre janë detyrim i pa likuajduar nga Bashkia Vlorë sipas përcaktimeve të bëra nga VKM-të përkatës.

Konkluzion: Gjendja e **llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** në mbyllje të vitit 2018 paraqitet në vlerën 278,668,913 lekë, në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 228,391,796 lekë, në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 235,395,470 lekë, ndërsa gjendja e llogarisë 401-404 ÷Furnitorë e llogari të lidhura me toë për vitin 2018 paraqitet në vlerën 21,965,334, në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 në vlerën 23,585,122 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 11,267,351 lekë. Sipas raporteve periodike për detyrimet e prapambetura të dërguar në Degën e Thesarit Vlorë në fund të vitit 2018, 2019 dhe 2020, rezultoi se në bilancin e vitit ushtrimor 2020 nuk janë përfshirë detyrimet në vlerën prej **130,042,284 lekë** e përmbledhur si më poshtë:

Nr	Detyrimet	Vlera që nuk është përfshirë tek llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në 31.12.2020
1	Detyrimet e prapambetura nga Investimet	20,976,991
2	Detyrimet nga Vendimet Gjyqësore	52,428,965
3	Detyrimet nga shpronësimet referuar VKM nr.368 datë 20.06.2018	49,839,678

4	Detyrimi nga shpronësimi referuar VKM nr.277 datë 29.05.2019	6,796,650
Totali		130,042,284

Burimi: Bashkia Vlorë, përpunuar nga audituesi

Për vitin ushtrimor 2020, gjendja e llogarisë nr.467 òKreditorë të ndryshëmò prej 235,395,470 lekë nuk rakordon me vlerën reale të detyrimeve që rrjedhin nga faturat e palikujduara për mallra, shërbime, investime, detyrime nga vendimet gjyqësore të pa paguara dhe detyrimet të pa paguara nga shpronësimet, duke mos u paraqitur në analitikun e llogarisë nr.467 òKreditorë të ndryshëmò, vlera prej **130,042,284 lekë**. Mos kryerja e veprimeve kontabël për këto detyrime e si rrjedhojë mospërfshirja e vlerës që lindin nga këto detyrime ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale në fund të vitit ushtrimor 2020, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real për detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve.

Kriteri: Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, Aneksi 1, Pika 3.3/c.d.

òRregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorëò, neni 167, shkronja òbò dhe ònò.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjëndjes kontabël të kreditorëve të Bashkisë Vlorë në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018, 2019 dhe 2020 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr. 486 òShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe kundërpatisë së saj 467 òKreditorë të ndryshëmò. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Z. T. Z., Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, Z. H. H., Përgjegjës i Qendrës Ekonomike, Znj. S. H., Drejtore e Drejtorisë së Aseteve dhe Pronave Publike, Z. D. Z., Drejtor i Drejtorisë Juridike.

Titulli i gjetjes: Llogaria nr.602 “Shpenzime Operative”, sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 338,088,794 lekë. (Pasqyruar në Kapitullin “Aneksë – nr.2.2 – Tabela nr.2.2.2”)

Situata: Vlera prej **338,088,794 lekë e shpenzimeve operative në fund të vitit 2020, konstatohet se, nuk rakordon me shumat e pasqyruar në centralizator (ditari i librit të madh), sipas destinacionit të përdorimit të tyre, si vijon:**

-Arka e shpenzimeve - 14,557,459 lekë;

-Shpenzime (prekur llogaritë 467-0 dhe 431-1) - 586,980,769 lekë;

-Hyrje në magazinë - 50,657,963 lekë

-Të ndryshme, sistemim të llogarive 467, 401 dhe 486 ó (-223,410,167)

Gjithësej shpenzimet operative (602) të Bashkisë Vlorë pa përfshirë njësitë vartëse janë **428,786,024 lekë, ose 90,697,230 lekë më tepër**, nga vlera e pasqyruar në fund të vitit 2020 në PF formati nr.2, llogaria 602, efektet e të cilës ndikojnë direkt në rezultatin e veprimtarisë ushtrimore të vitit 2020.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 4.1 òShpenzimet në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe operacionet që lidhen me toò, duke vijuar me paragrafin Llogaria 602 òBlerje mallrash e shërbimesh të tjeraò.

Ndikimi/Efekti: Shpenzimet operative nuk pasqyrojnë vlerën reale të tyre, me efekt në rezultatin e veprimtarisë ushtrimore për vlerën 90,697,230 më tepër.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nuk ka.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

Titulli i gjetjes: Llogaria nr.683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” në fund të vitit 2020 paraqitet në **vlerën 0 lekë**, ndërkohë që në këtë llogari përfshihen provizionet për shpenzime të njësisë publike, të cilat janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit.

Situata: Sa më sipër në analizë të vendimeve gjyqësore të Bashkisë Vlorë, të cilat kanë kaluar në shkallën e dytë të gjykimit, ku në shkallë të parë është vendosur detyrimi për likuidim monetar të palëve të treta, rezulton se në fund të vitit 2020, në llogarinë nr.683, duhet të ishte kontabilizuar si provizion për shpenzim, **vlera prej 143,859,240 lekë. (Pasqyruar në Kapitullin “Aneksë – nr.2.2 – Tabela nr.2.2.6”)**

-Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet të bëhen si më poshtë :

Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime: Debitohet llogaria 683 për shumën të parashikuar të shfrytëzimit; dhe Kreditohet llogaria 150 për shumën të parashikuar për rreziqe e shpenzime.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, pikën 3.1 për procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për të vijuar me pikën 34, shkronja ß.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.683 për shumën të parashikuar të shfrytëzimit, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të shpenzimeve për provizionet që ka Bashkia Vlorë në fund të vitit 2020.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 për shumën të parashikuar të shfrytëzimit duke debituar atë në momentin e njohjes dhe kredituar llogarinë nr. 150 për shumën të parashikuar për rreziqe e shpenzime. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas funksionit që kryejn dhe detyrat e tyre, mbajnë përgjegjësi:

-Drejtori i Drejtorisë Ekonomike z.T. Z. dhe përgjegjësi i financës-kontabilitetit z.H. H.

III.2.3. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit

2.3.1. Planifikimi i territorit.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ të Bashkisë Vlorë ka nisur procesin e hartimit në kuadër të prokurimit të shërbimit të konsulencës nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Shqipëri, për hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë...ö.

Përfundimisht nga kompetencat për të shqyrtuar kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi nga Bashkia Vlorë bëjnë zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe **brezi bregdetar**, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), **në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.**

Neni 45, i VKM Nr. 408 përcakton gjithashtu se:

2. Kërkesat për leje ndërtimi, që bazohen në instrumentet e planifikimit të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Planeve të Përgjithshme Vendore për territoret e reja administrative, do të shqyrtohen në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe **kushtet zhvillimore në fuqi në kohën e miratimit të tyre.**

Bazuar në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, kushtet zhvillimore janë kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Neni 3-15. “**Kushte zhvillimore**” janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, nga plani i përgjithshëm vendor dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.

Vendimi i KKT-së Nr. 9, datë 17.02.2016 “Për zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga Autoritetet Vendore të Zhvillimit të Territorit” bën një shtesë në pikën a) të nenit 45 të të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 *ËPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit* të ndryshuar, ku specifikon që autoritetet vendore të zhvillimit të territorit të vijnë me hartimin e planeve të detajuara vendore dhe shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi **sipas kushteve zhvillimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e miratimit të planeve të përgjithshme vendore mbi të cilat bazohen.**

Për pjesët e territorit administrativ të Bashkisë Vlorë për të cilat nuk ka patur dokumente të planifikimit të territorit në fuqi, vendimmarrja konform pikës b) të nenit 45, të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 *ËPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit* të ndryshuar përcaktohet përmes **Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit:**

Nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyet në funksion të zhvillimit urban” si dhe

Nr. 01, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”.

Me **Vendimin nr. 693, datë 2.10.2019** *ËPër disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë*

13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, *ËPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*, të ndryshuar, në nenin 1 të këtij vendimi përcaktohet se :

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.

Në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje: “ç) Objektet si dhe veprat e infrastrukturës brenda zonës së brezit bregdetar, të miratuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.”

Brezi Bregdetar është përcaktuar si zonë me përparësi turizmin me Vendimin nr.Nr. 1, datë 26.07.2018 *ËPër shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e Turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë*, vendim ky që shoqërohet me hartën përkatëse ku përcaktohet shumë qartë zona e brezit bregdetar, kufi ky që është përcaktuar më parë me Vendimin nr.1 datë 08.10.2013 të KKT. Ky kufi ka mbetur në fuqi edhe me miratimin e PINS Bregdeti.

Me Vendimin të KKT nr. 23 datë 28.02.2020 *ËPër përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda zonës së Bredit Bregdetar* u përcaktuan disa lloje punimesh brenda këtij brezi, të cilat mund të shqyrtoheshin nga njësitë vendore.

..... për këto raste përjashtimore:

a) objekte të reja me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m²;

- b) objekte të cilat kanë leje ndërtimi të miratuara nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit para hyrjes në fuqi të VKM Nr. 693, datë 02.10.2019, pavarësisht nga sipërfaqja e përgjithshme e tyre;
- c) rrjetet infrastrukturës publike vendore dhe objektet shtetërore në pronat shtetërore të transferuara tek njësitë e qeverisjes vendore;
- d) objektet e dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, infrastruktura publike dhe/ose kritike, si dhe ndërtimet e reja në zonat e ndëmtuara nga fatkeqësia natyrore, sipas përcaktimeve të VKM Nr.887, datë 24.12.2019.

Për gjithë sa më sipër nga auditimi rezulton se për periudhën e auditimit 2018-2021:

1. Në territorin e përfshirë në Bashkinë Vlorë kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi shqyrtohen konform Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe

akteve nënligjore në fuqi deri në miratimin e PPV me Vendimin nr.1 i KKT datë 16.10.2017 për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, i rishikuar me Vendimin nr.4 datë 17.05.2019 të KKT për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, i rishikuar me Vendimin nr.3 datë 03.12.2020 të KKT për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë.


2. Deri në miratimin e PPV Bashkia Vlorë me Vendimin nr.1 të KKT me datë 16.10.2017 shqyrtimet janë kryer në zbatim të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 5, datë 29.12.2014 dhe Nr.01, datë 30.07.2015.

Në këtë mënyrë rezulton se lejohen zhvillime sipas rasteve përjashtimore në zona të urbanizuara apo në prona me statusin truall për raste përjashtimore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara nga KKT.

Duhet të kihet në vëmendje Neni 45 i VKM 408/2015 i ndryshuar, sipas pikës 1.

Kontrolli dhe zhvillimi i territorit

Bashkia Vlorë, për periudhën 01.01.2018 deri në 30.06.2021, ka pasur 2468 aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi, përkatësisht 223 aplikime për leje Zhvillimi, 91 për leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250m², 53 aplikime për leje me siperfaqe deri 250m², 327 certifikata përdorimi, 222 shtyrje afati leje ndërtimi, 1009 deklarata paraprake per kryerje punimesh, 151 ndryshime funksioni, 30 aplikime për shtesë në



ndërtim ekzistues mbi 250m², 183 shtesë me sipërfaqe deri 250m², rikonstruksione 115 dhe 64 leje infrastrukture.

Nga sistemi elektronik e-lejet rezulton se për vitin 2017 janë konfirmuar 33 leje për ndërtime me madhësi mbi 250 m² dhe janë refuzuar 13 të tilla, për vitin 2018 janë konfirmuar 9 leje dhe refuzuar 12 leje mbi 250 m², për vitin 2019 janë miratuar 8 leje, për vitin 2020 është konfirmuar miratimi i 17 lejeve dhe janë refuzuar po 17, për vitin 2021 deri në Gusht 2021 janë miratuar 6 leje me sipërfaqe mbi 250m² dhe janë refuzuar 14 aplikime. Për periudhën e auditimit janë miratuar gjithsej 14 leje për shtesa në objekte ekzistuese me madhësi mbi 250m².

Nga sa më sipër janë përzgjedhur për t'u audituar disa nga procedurat e miratimit për leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m², si edhe shtesa në objekte me sipërfaqe më të madhe se 250 m² duke e bazuar kështu përzgjedhjen në madhësinë e objekteve, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë si edhe vendndodhjes së tyre, për të mbajtur në fokus veçanërisht lejet e dhëna në Bashkinë e Vlorë dhe në zonën e brezit bregdetar, si zona ku risku paraqitet më i lartë.

Lejet e ndërtimit të audituara janë:

- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin ÷Hotel 6 kate me 1 kat bodrumö, në adresën Lagjen "Uji i Ftohtëö, me zhvillues T. Z., projektuar nga A. D. C. me liçencë nr. A..
- Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.04.2019 për objektin ÷Hotel 6 kate me 1 kat bodrumö me zhvillues T. Z.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 665, datë 05/02/2018 për objektin ÷Strukture me funksion turistik 4-5 kate me 1 kat nën tokëö ne Radhimë Vlorë me zhvillues A. D. dhe Xh. F.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 718, datë 09/03/2018 për objektin ÷Magazine industriale 1 & 2 kateö me adresë Lagjia ÷28Nëntoriö, Bashkia Vlorë me zhvillues ÷T. C.ö shpk.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1129, datë 16/10/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 512, datë 26/10/2017 për objekt ÷Godine hoteleri 3 kate me një kat nëntokëö me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues ÷D.ösh.p.k.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 803, datë 03/05/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 471, datë 10/10/2017 për objekt ÷Kapanon Industrial 1 kat dhe zyra 2 kat (Shtesë anësore në kapanonin ekzistues 1 kat) me adresë Cerkovinë, Vlorë, me zhvillues ÷A.P.ö shpk.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1002, datë 16/08/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 535, datë 08/11/2017 për objekt ÷Hotel 3 dhe 4 kateö me adresë Lagjia ÷Uji i ftohtëö Vlorë, me zhvillues A., P. dhe V. V.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 981, datë 09/08/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 659, datë 31/01/2018 për ÷Kapanon 1 kat, për magazinimin e produkteve bujqësoreö me adresë Rr. ÷Ismail Qemaliö, Nj.A. Novoselë Vlorë, me zhvillues A. P.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 861, datë 05/06/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 674, datë 16/02/2018 për ÷Magazine industriale 1 katö me adresë Nartë, me zhvillues Ll. K.
- Leje ndërtimi miratuar me Nr. 862, datë 05/06/2018 për ÷Magazinë Industriale 2 kate dhe 1 kat zyraö me adresë Lagjia ÷Kushtrimiö Vlorë, me zhvillues R. C. 2007 sh.p.k
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlore me Nr.948, datë 30/07/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 660, datë 31/01/2018 për ÷Kapanon 1 kat, per vegla bujqesoreö me adresë Fshati Mifol, Vlorë, me zhvillues E. J.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 dhe leje zhvillimi Nr.196, datë 24/04/2019 për objekt ÷Godinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokëö me adresë Lagjia ÷Pavarësiaö Vlorë, me zhvillues ÷H.-P.ösh.p.k.

- Leje ndërtimi për shtesë me sipërfaqe më të madhe se 250m², miratuar me Nr. 470, datë 30/07/2019 për objekt òRikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anesore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katësheò me adresë Lagjia òUji i ftohtëò Vlorë, me zhvillues P. H.
- Leje ndërtimi miratuar me Nr. 748, datë 06/12/2019 dhe Leje Zhvillimi Nr. 682, datë 06/11/2019 për òObjekt 3 kate me 1 kat parkim me funksion hoteleriò me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues H. R.-G.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 108, datë 27/02/2020 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 651, datë 23/10/2019 për òObjekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifinitureò me adresë Nartë, Vlorë, me F. S. V.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 274, datë 16/05/2019 për òBanese 4 kate dhe 1 kat nen tokëò dhe me Leje Zhvillimi miratuar me Vendim Nr. 1206, datë 20/11/2018 me adresë Lagjia Uji i ftohtë, Vlorë, me zhvillues òHEL-PETò sh.p.k.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 dhe leje zhvillimi nr. 689, datë 14/11/2019 për objektin òGodinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokëò, në adresën Rruga òDhimitër Konomiò, me zhvillues òE. K.ò.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 770, datë 16/12/2019 për objektin òKapanon per rritje dhe mbareshtim shpendeshò, në adresën fshati Shushice, Njësia Administrative Bashkia Vlore, me zhvillues B. K.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin òGodinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokëò, në adresën rruga "Irakli Pylli", Bashkia Vlore, me zhvillues òM. C.Aò sh.p.k.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 583, datë 13/10/2020 për objektin òRindërtim i volumit 3 kate me shtim bodrumi, volumi anesor dhe shtese kati me funksion hoteleriò ne Lagjen "Uji i Ftohte", Vlorë me zhvillues S. A.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 23/07/2019 për objektin òKompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dytaò në Radhimë - Vlorë, me zhvillues òE.òshpk.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 175, datë 14/04/2020 për òObjekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokëò me adresë Rruga òDhimitër Konomiò, Vlorë, me zhvillues òH.- P.òshpk.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 584, datë 25/09/2019 për òGodinë banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me nje kat parkim nen tokëò me adresë Rruga "Mustafa Bello", Vlorë, me zhvillues òA.òshpk., në pronësi të K. C., V. C., E. C., Sh. M.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për òGodinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokëò me adresë Lagjia òPavarsiaò Rr."Gjergj Arianiti" dhe Rr."Faik Konica" Vlorë, me zhvillues H. M. dhe V. M.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për òKompleks shtepish të dyta me tre kate, dy kate nën tokëò me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues òH.-P.òsh.p.k.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 676, datë 05/11/2019 për objekt Objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime me adresë Lagjia òPavarësiaò Vlorë, me zhvillues N. L.
- Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin òObjekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumò, Lagjia Pavarësia, Vlorë me zhvillues òS.ò sh.p.k. Për secilën leje apo certifikatë përdorimi rezulton si vijon:

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin “Hotel 6 kate me 1 kat bodrum”, në adresën Lagjen “Uji i Ftohtë”, me zhvillues T. Z., projektuar nga A. D. C. me licencë nr. A. 1358. Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin “Hotel 6 kate me 1 kat bodrum” me zhvillues T. Z.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejeve të sipërcituara rezulton se:

- Në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Bashkia Vlorë ka tejkalluar kompetencat e vendimmarrjes pasi miratimi i lejes së ndërtimit në zonën e brezit bregdetar ku përfshihet pasuria nr. 38/88, Vol.60 Fq.184, ZK 8602, si një zonë e rëndësisë kombëtare është kompetencë e KKT-së, jo e Bashkisë Vlorë.

- Kjo leje është lëshuar në mungesë të aktit të kontrollit të konformitetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), në zbatim të Vendimit Nr. 17, date 07.06.2016 të KKT òPër shqyrtimin e kërkesave për Leje Zhvillimi dhe Ndërtimi brenda zonave të rëndësisë kombëtare sipas të cilit:

Deri në miratimin e dokumenteve të planifikimit për zonat e rëndësisë kombëtare, autoritetet e zhvillimit të territorit mund të vijojnë me procedurat administrative dhe ligjore për shqyrtimin dhe vendimmarrjen për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në zonat e rëndësisë kombëtare, si vijon:

b) për territoret ku nuk ka plane të përgjithshme vendore në fuqi, kërkesat për leje të merren në shqyrtim vetëm për kategoritë dhe zonat e percaktuara nga Vendimi Nr. 1, date 30.07.2015 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për percaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, i ndryshuar, dhe në cdo rast pas marrjes së pëputhshmërisë nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit.

- Kjo leje nuk ka zbatuar kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar, sipas së cilave kemi:

Neni 21, pika 6: Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

- Drejtoria e Planifikimit të Territorit Vlorë, nuk ka marrë përputhshmërinë nga AZHT kur kjo e fundit është shprehur në shkresën e saj me Nr. 2832 Prot. datë 09.11.2017 se: “duhet të rishikohet projekti arkitektonik si dhe një relacion mbi përputhshmërinë e këtij projekt-propozimim me kushtet dhe propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar në KKT me Vendimin Nr. 1, datë 16.10.2017”.

Nga ana e bashkisë Vlorë dhe e aplikuesit një gjë e tillë nuk është kryer, dhe për sa më sipër objekti është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e PPV Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, sipas të cilit përcaktimet për këtë njësi strukturore janë VL.IN.1675 me kategori infrastrukturë me K=0.

- Drejtoria e Planifikimit të Territorit Vlorë nuk ka marrë mendimin e AKM (Agjencisë Kombëtare të mjedisit) pasi objekti nuk është pajisur me Vlerësim Paraprak ndaj Mjedisit si edhe nuk është kërkuar mendimi i institucionit përgjegjës në këtë rast AKM, duke anashkalluar detyrimet ligjore, nuk ka marrë mendimin e AKM dhe përputhshmërinë nga AZHT në kundërshtim kjo me përcaktimet ligjore.

- Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Nenin 45 të Ligjit 107/2014, pasi nuk ka respektuar kushtin për infrastrukturën, duke propozuar aksesin në katin nëntokë në çënim të pasurisë 38/157, e cila nuk është në pronësi të zhvilluesit.

- Kjo leje është miratuar në kundërshtim me PPVtë Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi kategoria e përdorimit të njësisë strukturore ku propozohet zhvillimi është VL.IN.1675 me kategori infrastrukturë me K=0, me nënkategori përdorimi IN.9_Zona e pikave të karburantit me gaz. Përdorimi hoteleri i këtij objekti të miratuar është në mospërputhje me dokumentin e planifikimit të qytetit PPV Vlorë, për sa më

sipër e bën këtë leje ndërtimi absolutisht të pavlefshme në zbatim të pikës 4, neni 39 i Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 *oPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritë të ndryshuar.*

▪ Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *oPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri- tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të cfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është hartuar e miratuar pa asnjë informacion lidhur me çarjet në faqet e objekteve 1 katëshe në kufirin verior dhe jugor të pronës, nga ana tjetër pozicionimi 1 m nga kufiri i pronës, në zonat ku objekti i lejes nuk qëndron përballë një objekti tjetër, është totalisht i kundraligjshëm pasi nuk respekton përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 7m nga ky kufi.*

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të Lejes për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, me vendim nr.158 datë 11.04.2019 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, rezulton se në aplikimin me nr. AN060420190005 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit", nuk është paraqitur një relacion i mbikqyrësit mbi fazën e punimeve në të cilën ndodhej objekti në momentin e aplikimit. Nga imazheria e vitit 2019, objekti është plotësisht i përfunduar në fazë karabina dhe muraturë, duke përcaktuar kështu që miratimi i ndryshimeve në projekt është kryer pasi janë përfunduar ndryshimet në zbatim, në kundërshtim kjo me nenin 48 të ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe me Ligji nr. 8402, Datë 10.09.1998 *oPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitë të ndryshuar.*

Në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 *oPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeë, IMT Bashkia Vlorë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr. 453, datë 22.09.2017.*

▪ Kjo leje nuk ka zbatuar kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 *oPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, duke mos kërkuar mendimin e asnjë institucioni, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.*

Në aplikimin me nr. AN060420190005 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit" është parashikuar ndërtimi i një pishine në katin e sipërm, element ky i cili nuk përfshihet tek rastet e përcaktuara në Nenin 17 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 *oPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, duke kryer miratimin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.*

▪ Në formularin e lejes për ndryshime në projekt me Nr. 158, datë 11/04/2019, përdorimi i lejuar ka shënimin "*të tjera*", duke shmangur përmendjen e përdorimit të lejuar sipas PPV Bashkia Vlorë, pasi ky objekt është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e dokumentit të planifikimit të miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi kategoria e përdorimit të njësisë strukturore ku propozohet zhvillimi është VL.IN.1675, me përdorim të lejuar infrastrukturë, nënkategori pikë furnizimi me gaz e karburant.

▪ Nga terreni konstatohet se objekti ka përfunduar dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në kundërshtim të legjislacionit në fuqi, duke cënuar sigurinë e pushuesve dhe stafit punonjës të objektit hotelier, si dhe nuk ka zbatuar kondicionet urbane të përcaktuara në vendimmarrje (*ka hapur dritare në faqen ku kondicioni ishte faqe kallkan*).

Sa më sipër, përmes miratimit të Lejes për ndryshime në projekt me Vendim nr. 158, datë 11/04/2019 janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është zbatuar legjislacioni për inspektimin nga ndërtimet e paligjshme, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, për këtë çështje subjektet e audituara

punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H. të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit AN060420190005 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit":

1. Sipas nenit 14 të VKM 408/2015 e ndryshuar, subjekti i audituar pretendon se për një ndryshim në projekt gjatë ndërtimit, i cili i referohet Nenit 17 të VKM 408/2015 nuk duhet të kërkohet mendimi i institucioneve mendimdhënëse si UKVlorë, OSHEE etj., pasi sipas subjektit të audituar, nuk ndryshojnë pikat e lidhjeve KUB, KUZ dhe OSHEE. Madje edhe për MZSH, subjekti i audituar shprehet se institucioni nuk shprehet për projektin e zbatimit, tuba dhe rakorderi, por për piken e aksesit të zjarrëfikëses. Ndryshimi në projekt konsiston në ndryshimit e pozicionimit të shkallës, gjë që nuk dikton problematika në projektin e zjarrëfikëses.

2. Përsa i përket konstatimit të audituesit se në aplikimin me nr. AN060420190005 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit" është parashikuar ndërtimi i një pishine në katin e sipërm, element ky i cili nuk përfshihet tek rastet e përcaktuara në Nenin 17 të VKM nr. 408 datë 13.05.2015. Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë e ndryshuar, subjekti i audituar pretendon se pishina është një element utilitar arkitektonik, i cili shton elementët funksionalë të objektit, duke e kategorizuar atë tek pika d) e Nenit 17 të VKM 408/2015.

3. Përsa i përket përdorimit të objektit në kundërshtim me përcaktimet e njësisë strukturore VL.IN.1675, me përdorim të lejuar infrastrukturë, nënkategori pikë furnizimi me gaz e karburant, subjekti i audituar pretendon se aplikimi për ndryshime në projekt ka për qëllim ndryshimin e projektit gjatë zbatimit dhe jo ndryshimin e funksionit të objektit, të miratuar me leje ndërtimi Vendim nr.566 datë 07.12.2017, vendim ky i cili është bazuar në nenin 48 të Ligjit nr. 107/2014 i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 17 të VKM nr. 408/2015 e ndryshuar.

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit *Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017, janë paraqitur këto pretendime:*

1. Përsa i përket gjetjes se objekti është miratuar në mungesë të kompetencës dhe në mungesë të konformitetit nga AZHT si autoritet përgjegjës për zhvillimet e territorit në zonat me rëndësi kombëtare sic është brezi bregdetar, subjekti i audituar sqaron se Leja e zhvillimit miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Vendim nr.453 datë 22.09.2017, e cila i ka paraprirë miratimit të Lejes së ndërtimit, është e pajisur me mendimin e AZHT me nr.2406 prot. datë 21.09.2017, mendim në të cilin shprehet se: *Parcela e propozuar për zhvillim ndodhet brenda zonës së shpallur të urbanizuar, sipas Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban" dhe se përsa i përket faktit nëse parcela e propozuar për zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, do të AZHT do të shprehet në fazën e aplikimit të projekt-propozimit për Leje Ndërtimi.*

Për leje ndërtimi AZHT ka kërkuar përputhshmërinë me PPV-Vlorë të miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017. Sipas subjektit të audituar, është paraqitur ky relacion dhe projekti i ndryshuar me datë 17.11.2017 dhe pas ridërgimit për mendim, AZHT ka rikthyer përgjigje për mosreflektim të kërkesave me shkresën nr.2832 prot. datë 09.11.2017, më pas pas riplotësimit, nga ana e AZHT është lënë në heshtje kthim përgjigje. Duke u pranuar si miratim nga ana e bashkisë Vlorë, në zbatim të nenit 21, pika 4 e VKM nr. 408/2015 e ndryshuar.

2. Për gjetjen në pikën 4, mbi mungesën e Vlerësimit paraprak ndaj mjedisit, subjekti i audituar shprehet se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 objektet me funksion hoteleri nuk listohen si objekte që duhet të nënshtrohen këtij vlerësimi, gjithashtu shton me observacionin me shkresën nr.780 datë 26.01.2022 se në dokumentacionin e aplikuar gjendet Raporti i Vlerësimit në Mjedis i hartuar nga ekspert i licensuar (dokument ky i cili i është bashkëlidhur observacionit).

3. Për gjetjen në pikën 6, mbi miratimin e kësaj leje në kundërshtim me përcaktimet e PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, është paraqitur korespondenca me AKPT, shkresë e cila ka nr. 248/01 prot datë 27.02.2019, ku thuhet se botimi i PPV Bashkia Vlorë në RKPT është data 27.02.2018, datë që pretendohet hyrja në fuqi e PPV Bashkia Vlorë.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: *Përsa i përket observimeve të mbajtura për auditimin e aplikimit AN060420190005 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit":*

1. Qëndrimet të subjektit të audituar se në zbatim të nenit 14 të VKM 408/2015 e ndryshuar, lejet për ndryshime në projekt nuk kërkojnë më mendim nga institucione mendimdhënëse pasi nuk ndryshon pika e lidhjes së KUB dhe energjisë elektrike, sqarojmë se në zbatim të pikës 3 të nenit 14 të VKM/408 kemi shprehimisht: *Lejet e ndërtimit jepen vetëm pasi janë marrë lejet dhe autorizimet përkatëse për ndërtimin në fjalë, në zbatim të legjislacionit të posacëm në fuqi.*

Sqarojmë se një Leje për ndryshimin e projektit gjatë zbatimit është një Leje ndërtimi në vetvete dhe kërkon miratim me vendimmarrje, dhe gjithashtu institucione mendimdhënëse nuk është vetëm UKV dhe OSHEE, por edhe MZSH Vlorë, e cila në rast ndryshimesh të brendshme (në hapësira ndarëse) ndryshon edhe projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit, aq më tepër kur bëhet fjalë për ndryshim të kafazit të shkallës, pozicionimit të saj, e cila dikton në mënyrë drastike të gjithë planin e evakuimit në rast të rënies së zjarrit. Përvec institucioneve të përmendura prej jush, mendimdhënës është edhe ASHK (Ish ZVRPP) e cila në cdo rast duhet të shprehet mbi pasurinë e cila zhvillohet, pa llogaritur edhe propozimin për pishinë, që rrit kapacitetet e nevojave për ujë, e që kërkon mendimin e UKVlorë.

2. Sqarimit të subjektit të audituar se ndërtimi i një pishinë në katin e sipërm përfshihet në pikën d të nenit 17 të VKM408/2015 i ndryshuar, kjo pikë konkretisht specifikon: *d) për të shtuar elemente arkitektonike, për përdorim të barabartë e të pavarur të hapësirave të projektuara nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara;*

Sipas këtij përkufizimi, ndërtimi i një pishine nuk ka të bëjë as me element përdorimi të barabartë të hapësirave në objekt, por është një ndërtim i shtuar, dhe për më tepër nuk ka të bëjë me përfshirjen e personave PAK.

4. Përsa i përket pretendimit se përdorimi i objektit është vendosur para hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë, e për rrjedhim nuk plotëson përcaktimet e njësisë strukturore VL.IN.1675, me përdorim të lejuar infrastrukturë, nënkategori pikë furnizimi me gaz e karburant, sqarojmë se miratimi i Lejes së Ndërtimit është kryer me Vendim nr.566 datë 07.12.2017, ndërsa miratimi i PPV Vlorë është kryer me datë 16.10.2017, gjithashtu edhe në mendimin e AZHT si sekretariat teknik i KKT, autoritet që bën miratimin e PPV, me shkresën nr. 2832 datë 23.11.2017 është kërkuar një relacion mbi përputhshmërinë e këtij projekt-propozimim me kushtet dhe propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar në KKT me Vendimin Nr. 1, datë 16.10.2017. Pra, PPV Vlorë është një dokument i cili duhej të merrej parasysh gjatëmiratimit të kësaj leje ndërtimi, rrjedhimisht edhe gjatë ndryshimit në projekt.

Përsa i përket observimit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar për çështjen e Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017, konstatojmë se:

1. Subjekti i Audituar pretendon se konformiteti i AZHT është marrë në fazën e Lejes së Zhvillimit, por sikurse vihet re nga dokumentacioni në e-leje, në shkresën e AZHT nr.2406 prot. datë 21.09.2017, mendim në të cilin shprehet se: *Parcela e propozuar për zhvillim ndodhet brenda zonës së shpallur të urbanizuar, sipas Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të KKT "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urban" dhe se përsa i përket faktit nëse parcela e propozuar për zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, do të AZHT do të shprehet në fazën e aplikimit të projekt-propozimit për Leje Ndërtimi. Ndërsa në shkresën me nr. 2832 prot. datë 23.11.2017 është shprehur se: *bazuar në Vendimin e KKT-së Nr. 1 datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të**

Përgjithshme Vendore”, pasi ka verifikuar dokumentacionin ka konstatuar se duhet të rishikohet projekti arkitektonik si dhe një relacion mbi përputhshmërinë e këtij projekt-propozimim me kushtet dhe propozimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar në KKT me Vendimin Nr. 1, datë 16.10.2017.

Institucioni i AZHT ka kërkuar rishikim projekti arkitektonik dhe përgatitjen e një relacioni ku shprehet përputhshmëria me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, të miratuar me Vendimin nr.1 datë 16.10.2017, gjë e cila nuk është kryer, pasi objekti është miratuar me një përdorim të ndryshëm nga ai që parashikon njësi strukturore VL.IN.1675, me përdorim të lejuar infrastrukturë, nënkategori pikë furnizimi me gaz e karburant.

Konkretisht, është paraqitur dokumenti, te dosja òprojekti i ndryshuar, me emër *Z2.Relacion.pdf ku ark.A. C. D. shprehet se:

Relacion - Lenda: Shkresa e bashkise datë 13.11.2017 nr.9027/1: Per sa i perket pergjigjes se AZHT theksojme se ky projekt eshte aplikuar date 27.09.2017 dhe plani eshte miratuar me pas, ne date 16.10.2017 dhe nuk eshte zbardhur ende si vendim KKT-je. Kjo do te thote se ky projekt duhet te shqyrtohet ne baze te ligjeve ne fuqi ne daten e aplikimit mbi bazen e te cilit eshte kryer projekti arkitektonik.

Sa sipër, Znj. A. C. D., i thotë sekretariatit të KKT, se vendimi KKT nuk është zbardhur. Ky relacion, edhe pse nuk flet aspak për përputhshmëri me planin vendor, është marrë i mirëqenë, dhe është vlerësuar i mjaftueshëm për drejtorinë e planifikimit të territorit Bashkia Vlorë, për të miratuar një objekt hotelier, përdorim i palejuar nga PPV e miratuar e Bashkisë Vlorë në këtë njësi strukturore, ndonëse AZHT, si autoritet përgjegjës për të dhënë konfirmimin për miratimin e kësaj leje ndërtimi me shkresën Nr.2832/1 Prot. datë më 23.11.2017 është shprehur se:....*pasi ka riverifikuar projektin e ndryshuar ka konstatuar se nuk janë reflektuar komentet e cituar në shkresën Nr. 2832 Prot, datë 09.11.2017.*

Pra, AZHT ka shprehur në dy shkresa se duhet të paraqitet përputhshmëria me PPV miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017.

Objekti është miratuar në mungesë të kompetencës dhe në mungesë të akt-konformitetit të AZHT sic e kërkon edhe Vendimi nr.17 datë 07.06.2016 dhe Vendimi Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

2. Përsa i përket pretendimit se objektet me përdorim hotelier nuk i nënshtrohen Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) *Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë* ky projekt duhet detyrimisht t’i nënshtrohej këtij vlerësimi nga AKM. Paraqitja e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk përbën pajisje me Vlerësim paraprak ndaj mjedisit, pasi institucioni i AKM, i cili është përgjegjës për miratimin e këtij vlerësimi dhe nuk është pyetur nga bashkia Vlorë, nëpërmjet sistemit elektronik të e-lejeve.

3. Për sa i përket sqarimeve mbi përdorimin dhe kriteret e zhvillimit duke u mbështetur në qëndrimin se PPV Bashkia Vlorë ka hyrë në fuqi pas publikimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit me datë 27.02.2018, ky sqarim bie poshtë nga përgjigja e AZHT, sekretariat teknik i KKT, me nr. 2832 prot. datë 23.11.2017 ku kërkohet përputhshmëria me dokumentin e PPV Vlorë. Për më tepër shkresa ku është bazuar ky sqarim mban nr. 248/01 prot. datë 27.02.2019, pra një vit pas miratimit të kësaj leje. Sqarimi juaj nuk pranohet, pasi institucioni i cili jep konformitetin, pra AZHT, kërkon relacion dhe përshtatjen e projektit arkitektonik me PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr. 1 datë 16.10.2017.

Në lidhje me kompetencën e KKT, si zonë e rëndësisë kombëtare, referuar Nenit 45 të VKM 408/2015, qëndrimi ynë si auditues qëndron ende, pasi pasuria ku zhvillohet ky objekt, subjekt i kësaj leje ndërtimi, ndodhet në zonën e brezit bregdetar. Gjithashtu në zbatim të Vendimit nr.17 datë 07.06.2016 të KKT shprehimisht thuhet se *kërkesat për leje të merren në shqyrtim vetëm për kategoritë dhe zonat e percaktuara nga Vendimi Nr. 1, datë 30.07.2015 i Këshillit Kombëtar të Territorit "Për percaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore", i ndryshuar, dhe në cdo rast pas marrjes së përputhshmerisë nga*

Sekretariati Teknik i KKT. Ndërkohë që në aplikimin për leje zhvillimi kjo përputhshmëri nuk është dhënë, pasi AZHT do shprehej në fazën e aplikimit për leje ndërtimi (sipas shkresës me nr.2406 prot. datë 21.09.2017). Në aplikimin për leje ndërtimi AZHT ka kërkuar përputhshmërinë me PPV Bashkia Vlorë, miratuar me Vendim nr.01 datë 16.10.2017. Përputhshmëri e cila nuk është dhënë asnjëherë, pasi projekti i miratuar nuk plotëson asnjë nga kriteret e njësisë strukturore VL.IN.1675.

Për sa trajtuar, këto komente të subjektit të audituar nuk merren në konsideratë.

Për sa u sqarua më lart, për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 158, datë 11.04.2019 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.S. A., z.K. M. specialistë të çështjes, z. F. D. drejtues i DPKZHT, në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Vlorë.

Si dhe për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 453, datë 22.09.2017 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 665, datë 05/02/2018 për objektin “Strukture me funksion turistik 4-5 kate me 1 kat nën tokë” në Radhimë Vlorë me zhvillues A. D. dhe Xh. F.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN241220170011, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 665, datë 05/02/2018 për objekt ÷Strukturë me funksion turistik 4-5 kate me 1 kat nën tokë është konstatuar se në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Bashkia Vlorë ka tejkaluar kompetencat e vendimmarrjes pasi miratimi i lejes së ndërtimit në zonën e brezit bregdetar ku përfshihet pasuria nr. 38/88, Vol.60 Fq.184, ZK 8602, si një zonë e rëndësishme kombëtare është kompetencë e KKT-së, jo e Bashkisë Vlorë

▪ Kjo leje, është lëshuar në mungesë të Vlerësimit paraprak mjedisor, madje nuk i është kërkuar mendim institucionit të AKM nëpërmjet platformës elektronike të e-lejeve, aksi rrugor Vlorë-Orikum është aks nacional, e për rrjedhojë administrohet nga ARRSH, e duhej marrë mendimi i këtij institucioni, gjithashtu UKV nuk ka konfirmuar aplikimin, duke shkelur dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, si edhe kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

▪ Objekti i miratuar nuk është pajisur me Leje zhvillimi, në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

▪ Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor, lindor dhe verior duke mos përmbushur kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas së cilës distanca për volumin 4 kt. duhet të ruante distancën nga kufiri i pronës 5m ndërsa për volumin 5kt. duhet të ruajë distancën 6m nga kufiri i pronës.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet mjedisore, rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit:-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C. të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente mbi këtë leje, dhe të vetmet shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë janë dhënë me shkresën nr. 731/6 prot. datë 22.11.2021 :

1. Subjekti ka marrë akt konformiteti gjatë Lejes së Zhvillimit.
2. Distancat në Veri janë ruajtur në varësi të terrenit dhe faqeve kallkan.

3. Përsa i përket mungesës së VNM shpjegohet se sipas ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 neni 8 shtojca 2, objektet me funksion Hoteleri nuk përfshihen tek aktivitetet që duhet ti nënshtrohen VNM.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN241220170011 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për mungesa e marrjes së konformitetit nga AZHT, sqarimet pranohen,

2. Për mungesën e Lejes së Zhvillimit, nuk janë dhënë shpjegime nga ana e subjektit të audituar.

3. Përsa i përket pretendimit se objekti nuk i nënshtrohet Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë ky projekt duhet detyrimisht të nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM.

4. Në lidhje me distancat nga kufiri i pasurisë, shpjegimi nuk pranohet. Objekti nuk ka faqe kallkan, gjithashtu objekti në drejtimin jugor, lindor dhe verior duke mos përmbushur kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas së cilës distanca për volumin 4 kt. duhet të ruante distancën nga kufiri i pronës 5m ndërsa për volumin 5kt. duhet të ruajë distancën 6m nga kufiri i pronës.

5. Subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime mbi dakortësinë e UKVlorë dhe mos marrjen e mendimit nga ARRSH.

Për sa më sipër, për miratimin e kësaj leje me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 665, datë 05/02/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me lëndë: “Njoftim për vlerësim pozitiv të projektit dhe pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë”.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 718, datë 09/03/2018 për objektin “Magazine industriale 1 & 2 kate” me adresë Lagjia “28 Nëntori”, Bashkia Vlorë me zhvillues “T.C.” shpk.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN060120180002, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 718, datë 09/03/2018 për objekt “Magazine industriale 1 & 2 kate” është konstatuar se në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Bashkia Vlorë ka tejkalluar kompetencat e vendimmarrjes pasi miratimi i lejes së ndërtimit në zonën e brezit bregdetar ku përfshihet pasuria nr. 30/58, Vol.41 Fq.6, ZK 8605, si një zonë e rëndësishme kombëtare është kompetencë e KKT-së, jo e Bashkisë Vlorë.

▪ Objekti i miratuar nuk është pajisur me Leje zhvillimi, në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

▪ Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor, lindor dhe verior duke mos përmbushur kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas së cilës distanca për volumin 2 kt. duhet të ruante distancën nga kufiri i pronës 3m ndërsa për volumin 1kt. duhet të ruajë distancën 2m nga kufiri i pronës.

▪ Treguesit e distancave të përcaktuara në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është hartuar e miratuar me faqe kallkan për pjesën jugore dhe veriore të objektit, pa asnjë informacion lidhur me çarjet në faqet e objektit 2 katësh në kufirin verior të pronës, veprim ky totalisht i kundraligjshëm pasi nuk respekton përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 6m nga objekti ekzistues 2 kate.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore VL.UB.14.1089 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime, zonë tregtare dhe biznesi pasi koeficienti i shfrytëzimit të tokës Ksht=60% sipas përcaktimit të planit, ndërkohë propozimi i lejes së miratuar është tejkaluar me Ksht=77.7%.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet mjedisore, rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit:-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente mbi këtë leje, dhe të vetmet shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë janë dhënë me shkresën nr. 731/6 prot. datë 22.11.2021:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN060120180002, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 718, datë 09/03/2018 për objekt oMagazine industriale 1 & 2 kateo subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Për konstatimin se objekti nuk ka marrë aktin e konformitetit nga AZHT, subjekti i Audituar shpjegon se është pajisur me akt konformiteti gjatë procedurës së pajisjes me Leje zhvillimi me ceshtjen me nr.11517 prot. datë 18.12.2017.
2. Për Konstatimin se objekti nuk është pajisur me Leje Zhvillimi, bëhet sqarimi se ky objekt është pajisur me Leje Zhvillimi me Vendim nr.626 datë 17.01.2018.
3. Për konstatimet mbi distancat urbane, jepet shpjegimi se në drejtimin lindor objekti ekzistues është një kat me faqe kallkan në këtë drejtim, dhe për pasojë është ruajtur distanca 1m nga kufiri i pronës kallkan, ndërsa për distancën në Veri, sqarohet se është ruajtur distanca 1m pa carje, pasi objekti në këtë orientim nuk respekton distancat nga kufiri i pronës së tij.
4. Përsa i përket shpjegimeve mbi përputhshmërinë me PPV Bashkia Vlorë, subjekti i audituar sqaron se PPV ka hyrë në fuqi me datë 28.02.2018 dhe se Leja e zhvillimit është miratuar me datë 17.01.2018, dhe leja e ndërtimit është aplikuar me datë 06.01.2018 dhe është miratuar me datë 09.03.2018, duke e bazuar këtë vendimarrje në nenin 45 të VKM 408/2015 e ndryshuar oDispozita Tranzitoreo.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për ceshtjen e audituar me nr. AN060120180002 është si vijon:

1. Përsa i përket konstatimit tonë se objekti nuk është pajisur me Leje Zhvillimi, pas sqarimit të subjektit të audituar se Leja e Zhvillimit është lëshuar me Vendim nr. nr.626 datë 17.01.2018 në aplikimin me nr.11517 prot. datë 18.12.2017, ky shpjegim pranohet. Megjithatë duhet të vemë në dukje se një nga dokumentat e rëndësishëm që shoqëron një aplikim për Leje Ndërtimi është edhe Vendimi për miratimin e Lejes së Zhvillimit, dokument ky që mungon në këtë aplikim, kjo pasi aplikimi për leje ndërtimi mban datën 06.01.2018, pra 10 ditë para lëshimit të lejes së zhvillimit.
2. Përsa i përket shpjegimit se nuk është kërkuar konformiteti nga AZHT, shpjegimet tuaja të merren në konsideratë.
3. Përsa i përket distancave në lidhje me kufirin e pasurisë, sqarojmë se në zbatim të Nenit 34 pika 8 e VKM 408/2015 e ndryshuar, për objektet me karakter industrial, largimi 1m nga kufiri i pasurisë me faqe kallkan, nuk është i lejuar, për më tepër në zbatim të nenit 34 pika 3 kemi shprehimisht: *Në rast se ndërtimi përballet me një objekt ekzistues, të ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane të legjislacionit përkatës, atëherë ndërtimi i ri përjashtohet nga detyrimi për të respektuar distancat sipas pikës 2, të këtij neni, dhe mbart detyrimin e respektimit të distancës nga kufiri i pronës, sipas nenit 35.*

Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Pra, distanca nga drejtimi Verior duhej të ishte detyrimisht 2 kate + 1m=3m. Shpjegimet mbi treguesit e distancave nuk pranohen, pasi objekti është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore

4. Mbi shpjegimet që PPV Bashkia Vlorë ka hyrë në fuqi me datë 28.02.2018, objekti është miratuar me datë 09.03.2018. Pranohet gjykimi se çështja ka qenë në shqyrtim dhe e vlerësuar pozitivisht.

Për sa u kundërshtuan dhe pranuan më sipër, për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë Nr. 718, datë 09/03/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore si treguesit e distancave urbane, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1129, datë 16/10/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 512, datë 26/10/2017 për objekt “Godinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë” me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues “D.”sh.p.k.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN030820180030 òLeje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" dhe me nr.6927 prot. datë 03.08.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. 1129, datë 16/10/2018 për òGodinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë, u konstatua se:

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga objektet ekzistuese, në zbatim të Nenit 34 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në veri nga objekti 3 kt, distanca e miratuar është 7.1 duhej të ishte 8m.

- Nuk plotësohen distancat në jug nga rruga me gjerësi 7-15m duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar pasi sipas pikës 3b) të këtij neni për rrugë deri 15m gjerësi së bashku me trotualet, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit duhet të jetë minimalisht 3.0 m. Leja e miratuar këtë distancë e ka 1.62m duke shkelur kështu dispozitat ligjore për sigurinë rrugore dhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.01, datë 16.10.2017, pasi pasuria që merr pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore OR.UB.8.1188 me kategori kryesore S.2_Zone Hotelesh/Sherbime Turistike A.5 ó zonë me shtëpi të dyta, pasi është shkelur intensiteti i lejuar prej I=1.2, duke tejkaluar sipërfaqen e ndërtuar të lejueshme.

- Objekti i miratuar është pajisur me Leje zhvillimi me vendim Nr. 512, datë 26/10/2017, ku sipas pikës 5 të këtij vendimi, me miratimin e PPV Bashkia Vlorë me Vendimin nr.1 të KKT datë 16.10.2017 Leja e zhvillimit nuk është më e vlefshme. Për këtë projekt propozim nuk është aplikuar dhe miratuar vendim tjetër për pajisje me Leje Zhvillimi, në kundërshtim kjo me Nenin 39 të ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe për këtë çështje subjektet e audituara punonjës dhe ish punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D.

H., K. M., A. Ç., N. R., R. H. dhe nga ana e subjektit zhvillues òD.ò shpk, të cilët kanë bërë komente e ka dhënë shpjegime për këto gjetje si vijon:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN030820180030 òLeje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m²" dhe me nr.6927 prot. datë 03.08.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. 1129, datë 16/10/2018 për òGodinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokë, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Subjekti i audituar në lidhje me tejkalimin e kompetencës, për lëshimin e lejes së ndërtimit shprehet se sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore, harta me kodin 18i është përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit, subjekti i audituar shpjegon se me ka marrë konformitetin në aplikimin òPër leje zhvillimiò me nr.7496 prot. datë 29.08.2017, ku AZHT me shkresën nr. Nr. 2633 Prot. datë 17.10.2017 me lëndë: Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje Zhvillimi për objektin òGodinë hoteleri 3 kate, me një kat nëntokë, Radhimëò me vendndodhje në territorin e Bashkisë Vlorë, me zhvillues shoqëria òD.ò sh.p.k., ka dhënë konformitetin për zhvillimin sipas Vendimit Nr. 5, datë 29.12.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit òPër identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyhet në funksion të zhvillimit urbanò, *ndësa për faktin nëse parcela e propozuar për zhvillim bën pjesë në rastet përjashtimore sipas Vendimit Nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore", AZHT do të shprehet në fazën e aplikimit të projekt-propozimit për Leje Ndërtimi.*

3. Në lidhje me konstatimet nga auditimi se objekti nuk ka respektuar përcaktimet ligjore sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim 1 të KKT datë 16.10.2017 dhe që ka hyrë në fuqi me datë 27.02.2018, subjekti i audituar dhe zhvilluesi òD.ò ka shpjeguar se ku projekt propozim sipas Vendimit nr.1 datë 30.07.2015 të KKT òPër përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendoreò bën pjesë tek rastet përjashtimore konkretisht pika 2.dh) Struktura me funksion turistik, Gjithashtu edhe nga PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, ku njësia strukturore ku bën pjesë ky zhvillim OR.UB.8.1188 me kategori kryesore S.2_Zonë Hotelesh/Sherbime Turistike A.5 ó zonë me shtëpi të dyta, ka të njëjtin funksion me përputhshmërinë e marrë me shkresën nr. 2633 Prot. datë 17.10.2017 me lëndë: Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje Zhvillimi për objektin òGodinë hoteleri 3 kate, me një kat nëntokë, Radhimëò me vendndodhje në territorin e Bashkisë Vlorë, me zhvillues shoqëria òD.ò sh.p.k.

4. Përsa i përket pajisjes me VNM Paraprake, subjekti zhvillues shpjegon se ka kryer kërkesë tek AKM për pajisje me Vlerësim paraprak mjedisor, në zbatim Ligjit nr.10440. Kjo kërkesë mban datën 07.11.2017 nr.1089 prot. Deri më sot nuk ka marrë përgjigje nga ky institucion. Bashkëlidhur observimit është bashkëlidhur Raporti i Vlerësimit në mjedis.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN030820180030 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, sqarimi i bërë nga ana juaj merret parasys.

2. Në lidhje me konformitetin nga AZHT në zbatim të legjislacionit në fuqi, nga ky institucion është dhënë dakortësia për vijimin me shqyrtimit gjatë fazës së pajisjes me Leje Zhvillimi, me shkresën nr. 2633 Prot. datë 17.10.2017 me lëndë: Mbi kontrollin e konformitetit për pajisjen me Leje Zhvillimi për objektin òGodinë hoteleri 3 kate, me një kat nëntokë, Radhimëò me vendndodhje në territorin e Bashkisë Vlorë, me zhvillues shoqëria òD.ò sh.p.k, komenti pranohet.

3. Përsa i përket shpjegimit se subjekti ka aplikuar pranë AKM për pajisje me VNM, ky shpjegim merret në konsideratë, megjithatë duhet të kërkohet nëpërmjet e-lejeve, nga subjekti i audituar, bashkia Vlorë mendimi për pajisje me VNM.

Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 1129, datë 16/10/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, në kundërshtim e dokumentin e Planifikimit në fuqi PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 803, datë 03/05/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 471, datë 10/10/2017 për objekt “Kapanon Industrial 1 kat dhe zyra 2 kat (Shtesë anësore në kapanonin ekzistues 1 kat) me adresë Cerkovinë, Vlorë, me zhvillues “A.P.” shpk.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN300120180049 aplikuar nr.890 prot. me datë 30.01.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 803, datë 03/05/2018 për Kapanon Industrial 1 kat dhe zyra 2 kat (Shtesë anësore në kapanonin ekzistues 1 kat)ö, u konstatua se:

- Objekti i miratuar është pajisur me Leje zhvillimi (zona pa PPV) me vendim Nr. 471, datë 10/10/2017, ku sipas pikës 5 të këtij vendimi, me miratimin e PPV Bashkia Vlorë me Vendimin nr.1 të KKT datë 16.10.2017 Leja e zhvillimit nuk është më e vlefshme. Për këtë projekt propozim nuk është aplikuar dhe miratuar vendim tjetër për pajisje me Leje Zhvillimi, në kundërshtim kjo me Nenin 39 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të miratimit të aktit të kontrollit të konformitetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), pasi bashkërendimi me këtë institucion nuk është kryer. Duke marrë vendim pa akt konformiteti, Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö të ndryshuar, sipas së cilave kemi:

Neni 21 pika 6: Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

- Kjo leje është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuria me nr.15/4/2 me pronar K. H., me sip.240m2, që merr pjesë në zhvillim ndodhet në njësinë strukturore NO.B.157 me kategori kryesore B_Bujqësor, me përdorim të lejuar B.1_Tokë bujqësore primare fushore (kultivime me ara). Përdorimi Shërbime është i ndaluar. Koeficienti i shfrytëzimit për këtë njësi strukturore është 0%.

Sa më sipër, nuk është vepruar në zbatim të pikës 4 neni 39 i Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritö të ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar:-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021 (i cili nuk observon për këtë vendimmarrje në shkresën nr.890 prot. datë 30.01.2018) subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN300120180049 aplikuar nr.890 prot. me datë 30.01.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 803, datë 03/05/2018 për Kapanon Industrial 1 kat dhe zyra 2 kat (Shtesë anësore në kapanonin ekzistues 1 kat)ö, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Përsa i përket pavlefshmërisë së Lejes së zhvillimit miratuar me Vendim nr.471 datë 10.10.2017, subjekti i audituar i referohet nenit 45 të VKM 408/2015.
2. Në lidhje me mugesën e konformitetit nga AZHT, Subjekti shprehet se ka marrë konformitet në fazën e lejes së zhvillimit.
3. Duke qenë se Leja e ndërtimit nuk ka marrë parasysh PPV Vlorë, atëherë subjekti i audituar cmon të theksojë se nuk ka shkelur përcaktimet e tij.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN300120180049 është si vijon:

1. Përsa i përket marrjes së konformitetit nga AZHT subjekti i Audituar i referohet Konfirmimit që ka marrë nga ky institucion në fazën për leje zhvillimi, sqarimet se konformiteti i lejes së zhvillimit, vlen edhe për leje ndërtimi merret në konsideratë.
2. Objekti i miratuar është pajisur me Leje zhvillimi me vendim Nr. 471 datë 10.10.2017, ku sipas pikës 5 të këtij vendimi, me miratimin e PPV Bashkia Vlorë me Vendimin nr.1 të KKT datë 16.10.2017. Për këtë projekt propozim nuk është aplikuar dhe miratuar vendim tjetër për pajisje me Leje Zhvillimi, në kundërshtim kjo me Nenin 39 të ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar. Nuk shprehet me hyrjen në fuqi të PPV!
3. Sa u sqarua më sipër objekti duhej të plotësonte kriteret e Njësisë strukturore sipas PPV në fuqi. Objekti është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e PPV Bashkia Vlorë.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 803, datë 03/05/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1002, datë 16/08/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 535, datë 08/11/2017 për objekt “Hotel 3 dhe 4 kate” me adresë Lagjia “Uji i ftohtë” Vlorë, me zhvillues A., P. dhe V. V.

Situata -Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN200120180008 aplikuar nr.598 prot. me datë 20.01.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 1002, datë 16/08/2018 për ÷Hotel 3 dhe 4 kateö, u konstatua se:

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkëndimi me këtë institucion. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në Jug (objekti 4 kt) largësia e propozuar 4.28m nga kufiri i pronës ndërkohë që distanca minimale e përcaktuar në ligj është nr.kateve + 1m, pra duhej të ishte minimalisht 5m.

- Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në veri, pa dhënë informacion mbi objektin përballë tij, duke shkelur kështu përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 5 m nga kufiri i pronës.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga objektet kufitare, në zbatim të Nenit 34 të VKM 408/2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në Jug dhe në Veri, madje në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për hartimin e planvendosjes në fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, për objektet kufitare nuk është dhënë asnjë informacion, madje as numri i kateve të tyre, duke krijuar konfuzion dhe

duke penguar zhvillimin e drejtë të territorit dhe duke shmangur krijimin e kushteve optimale për diellëzim të objektit të miratuar si edhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

▪ Kjo leje ndërtimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit Nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 *ËPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.*

Sipas preventivit të punimeve, vlera totale e tyre është 29,758,859 lekë. Duke llogaritur vlerën 3% të taksës së ndikimit në infrastrukturë, shuma për tu paguar është 892,765 lekë.

Llogaritarja ka kërkuar nga subjekti kryerjen e pagesës në shumën 766,921 lekë. Diferenca prej 125,844 lekë, është e ardhur e munguar nga përlllogaritja gabim e taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 46 pika 1 *ËTaksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*, të ligjit nr. 107/2014 *ËPër Planifikimin e Territorit*, i ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente, por kanë dhënë shpjegime me observacionin me nr.731/6 datë 22.11.2021 si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me me AN200120180008 aplikuar nr.598 prot. me datë 20.01.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 1002, datë 16/08/2018 për *ËHotel 3 dhe 4 kate*, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Përsa i përket pozicionimit të këtij objekti në zonë me prioritet turizmin si zone e brezit bregdetar dhe kompetencës për vendimmarjen e kësaj leje, subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime dhe komente.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit nga AZHT, si objekt i ndodhur në zonë me prioritet turizmin (apo në rastin si zonë pa plan vendor në fuqi si e konsideron subjekti i audituar) subjekti i audituar nuk jep asnjë shpjegim.

3. Sipas shkresës së AKPT me nr. 248/01 prot. datë 27.02.2019, PPV ka hyrë në fuqi me datë 27.02.2018 dhe subjekti i audituar shprehet se shqyrimi i këtij aplikimi nuk është kryer bazuar në PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017.

4. Subjekti i audituar për shkeljen e distancave në drejtim të Jugut, shpjegon se ka respektuar distancën nga kufiri i pasurisë, pasi objekti kufitar ka shkelur distancat urbane.

5. Përsa i përket distancës në Veri, subjekti i audituar shprehet se ka ruajtur 1m pa marrëveshje.

6. Për mungesën e VNM paraprake, shprehet se sipas shtojcës 2 neni 8 i ligjit 10440, objektet hoteliere nuk futen tek shtojca e objekteve që i nënshtrohen vlerësimit Mjedisor paraprak.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për cështjen e audituar me nr. AN200120180008 është si vijon:

1. Përsa i përket pozicionimit të këtij objekti në zonë me prioritet turizmin si zone e brezit bregdetar dhe kompetencës për vendimmarjen e kësaj leje, subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime dhe komente, duke pranuar konstatimet e grupit të auditimit.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit nga AZHT, si objekt i ndodhur në zonë me prioritet turizmin (apo në rastin si zone pa plan vendor në fuqi si e konsideron subjekti i audituar) subjekti i audituar nuk jep asnjë shpjegim.

3. Përsa i përket moszbatimit të parcelës minimale sipas PPV Bashkia Vlorë i cili sipas shkresës së AKPT me nr. 248/01 prot. datë 27.02.2019, PPV ka hyrë në fuqi me datë 27.02.2018, nuk ka asnjë shpjegim.

4. Përsa i përket pretendimit se objektet me funksion hotelier nuk i nënshtrohen Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë ... ky projekt duhet detyrimisht të nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM, ose minimalisht duhet të merrej mendimi nga AKM për këtë rast, veprim të cilin bashkia Vlorë e ka anashkaluar. Komenti i subjektit të audituar nuk merret në konsideratë.

5. Përsa i përket ruajtjes së faqes kallkan në Veri me 1m distancë sic ka shpjeguar subjekti i audituar, por që është konstatuar edhe nga grupi i auditimit, bazuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, *për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të cfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës.* Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në veri, pa dhënë informacion mbi objektin përballë tij. Komenti i subjektit të audituar nuk pranohet.

6. Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar: Nuk plotësohen distancat në Jug (objekti 4 kt) largësia e propozuar 4.28m nga kufiri i pronës ndërkohë që distanca minimale e përcaktuar në ligj është nr.kateve + 1m, pra duhet të ishte minimalisht 5m. Komenti i subjektit të audituar nuk pranohet.

7. Për shkeljet e afateve të shqyrtimit të lejes, subjekti i audituar nuk ka dhënë asnjë shpjegim. Kjo leje është shqyrtuar për 247 ditë pune, ose 1 vit e dy muaj kalendarik. Shqyrtuesit e kësaj leje përvec shkeljeve të procedurave disiplinore, janë subjekt i Nenit 52 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar.

Për sa u sqarua më sipër, për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr.1002, datë 16/08/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Nr. 862, datë 05/06/2018 për “Magazinë Industriale 2 kate dhe 1 kat zyra” me adresë Lagjia “Kushtrimi” Vlorë, me zhvillues R. C. 2007 sh.p.k

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN240220180003 dhe nr.1631 prot. me datë 24.02.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 862, datë 05/06/2018 për objekt òMagazinë industriale 2 kate dhe 1 kat zyraò, u konstatua se:

- Objekti është miratuar pa dakortësinë e Ujësstellës Kanalizime Vlorë, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht neni 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò.

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion, mbi procedurën e miratimit të Vlerësimit paraprak mjedisor. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe nuk ka respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht neni 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në perëndim, ku largësia minimale për objekt 2 kate duhet të ishte 3m nga kufiri i pronësisë.

▪ Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri -tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të cfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në veri, jug dhe lindje pa dhënë informacion mbi pronën përballë, duke shkelur kështu përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 4 m nga kufiri i pronës, e si pasojë duke cënauar të drejtën për zhvillim të pasurisë kufitare.

▪ Objekti i miratuar nuk është pajisur me Leje zhvillimi, në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

▪ Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuria që merr pjesë në zhvillim ndodhet në njësinë strukturore VL.UB.14.1091 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar dyqane, shërbime personale, qendra lokale multifunkionale / Evente Edukative etj. Në lidhje me përcaktimet e PPV Vlorë, me miratimin e kësaj leje ndërtimi për këtë njësi strukturore janë shkelur:

-Përdorimi i miratuar Magazinë Industriale, është në kundërshtim me përcaktimet e njësisë strukturore dhe jo i lejueshëm.

-Parcela minimale e lejuar është 500 m², ndërkohë parcela e miratuar me këtë leje është 407 m².

-Leja e ndërtimit tejkalon koeficientin e shfrytëzimit të pronës duke shkelur përcaktimet e PPV Vlorë prej Ksht.max = 50%, duke miratuar një koeficient 54%.

-Leja e ndërtimit e tejkalon intesitetin e ndërtimit të lejuar I_{max}=0.8, ndërkohë I i miratuar = 1.4.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C. të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente, shpjegimet e mëposhtme janë sipas shkresës me 731/6 prot. datë 22.11.2021 si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN240220180003 dhe nr.1631 prot. me datë 24.02.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 862, datë 05/06/2018 për objekt òMagazinë industriale 2 kate dhe 1 kat zyraò subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Kërkesa me nr. Prot. 708 datë 23.01.2018 është pajisur me leje zhvillimi, miratuar me Nr. 719 datë 09.03.2018, ku në këtë çështje është edhe dakortësia e UK Vlorë.

2. Sipas dokumentacionit të uploaduar në e-leje, objekti është pajisur me VNM paraprake me nr. 186 Vendim nr.12, datë 20.03.2018.

3. Përsa i përket distancave, subjekti i audituar sqaron se në përfundim është ruajtur distanca 2.5 m, nga rruga jo e mirëformuar me gjerësi më pak se 7m, në Veri dhe Jug ruan 1m kallkan , në Lindje ruan 3m kallkan.

4. Përsa i përket konstatimeve se kjo leje është miratuar në kundërshtim me PPV Bashkia Vlorë, subjekti shpjegon se kjo leje ndërtimi është aplikuar para hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë, datë e cila konsiderohet ajo e publikimit në RKPT 27.02.2018.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN240220180003, është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për Mungesën e dakortësisë nga UK Vlorë, sqarohet se komenti nuk merret parasysh, duhet të merret mendimi i këtij institucioni edhe në fazë leje ndërtimi, pasi ndërkohë mund të ishin ndërruar veprime nga UKVlorë për investime në zonë.

2. Përsa i përket pajisjes me VNM Paraprake komenti merret në konsideratë.

3. Në lidhje me komentin për ruajtjen e faqeve kallkan, ky objekt duke qenë se është industrial, duhet detyrimisht të respektojë distancat sipas pikës 8 të Nenit 34 të VKM 408/2015

e ndryshuar, sipas së cilës: 8. *Distancat për ndërtimet industriale përcaktohen në përputhje me sigurinë e ndërtimit dhe nga aktiviteti që kryhet në to, sipas legjislacionit të posaçëm, dhe, në çdo rast, nuk duhet të jenë më të vogla se përcaktimet e pikave 2 e 3, të këtij neni.* Vlen të theksohet se në kto drejtim, ky objekt i miratuar nuk përballet me objekte me faqe pa carje, që të konsiderohej situatë e formuar ekzistuese. Për sa u sjarua komenti juaj nuk mund të merret në konsideratë.

Këto qëndrime nuk janë observuar me shkresën nr.781/25 datë 31.01.2022.

Sa u sjarua më sipër, për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr.862, datë 05/06/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi për shtesë me sipërfaqe më të madhe se 250m², miratuar me Nr. 470, datë 30/07/2019 për objekt “Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anesore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katëshe” me adresë Lagjia “Uji i ftohtë” Vlorë, me zhvillues P. H.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për shtesë me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN060720190020 dhe nr.377 prot. me datë 06.07.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 470, datë 30/07/2019 për Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anesore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katëshe, u konstatua se:

Në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Bashkia Vlorë ka tejkalluar kompetencat e vendimmarrjes pasi miratimi i lejes së ndërtimit në zonën e brezit bregdetar ku përfshihet pasuria nr. 45/301, ZK 8602, dhe pasuria me nr. 45/315/2 ZK.8602, si një zonë e rëndësisë kombëtare, është kompetencë e KKT-së, jo e Bashkisë Vlorë.

- Objekti i miratuar nuk është pajisur me leje zhvillimi në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

- Ky vendim miratimi bën edhe ndryshim destinacioni (funksioni) pa kryer procedurat e nevojshme për këtë qëllim, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN060720190020 dhe nr.377 prot. me datë 06.07.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 470, datë 30/07/2019 për Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anesore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katëshe, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore , harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar, sqarimi merret parasys.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit, subjekti i audituar pranon se duke qenë jo një parcelë ku propozohet zhvillim i ri por, është rikonstruksion me shtesë volumi mbi 250m², sqarimi merret parasysht.

3. Subjekti i audituar shpjegon në lidhje me zbatueshmërinë e PPV Bashkia Vlorë se: në zbatim të nenit 17 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, kategoria e përdorimit S_lejon edhe hotelet, dhe kjo kategori kategori përdorimi është e lejuar tek njësia strukturore VL.UB.1.1277.

4. Në bazë të ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2021, nga subjekti i audituar ristrukturimi i objekteve ekzistuese nuk bën pjesë në shtojcën që duhet të pajiset me velrësim mjedisor, megjithatë aplikuesi ka paraqitur raport të vlerësimit në mjedis.

5. Përsa i përket hartimit të PDV, në rregulloren e PPV Bashkia Vlorë, neni 54, pika 2 shpjegohet se si mund të kryhet ristrukturimi i banesave ekzistuese, edhe pa nevojën e hartimit të PDV.

6. Përsa i përket konstatimeve në akt konstatimin nr.21, për tejkallim të intensitetit maksimal të lejuar, subjekti i audituar shprehet se në zbatim të pikës 35 neni 3 të rregullores së ppv, sipërfaqja totale e katit nuk përfshin ballkonet etj.

7. Në zbatim të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, neni 54, objektet që rikonstruktohen behen pa nevojës e hartimit të PDV, si edhe sipas vkm 408/2015 e ndryshuar neni 54 pika 3d) kemi të bëjmë me një rikonstruksion me ndryshim vëllimi. Leja e zhvillimit është e panevojshme.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN060720190020 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 i cili Ju është vënë në dispozicion, është sqaruar shumë saktë se kompetenca për zonën e brezit bregdetar, i cili përfshihet në vendimin nr.1/2018 të KKT, si zonë me prioritet turizmin, zonë e rëndësisë kombëtare është e KKT.

2. Në lidhje me konformitetin nga AZHT në zbatim të legjislacionit në fuqi, subjekti i audituar pranon se duke qenë jo një parcelë ku propozohet zhvillim i ri por, është rikonstruksion me shtesë volumi mbi 250m².

3. Përsa i përket sqarimeve në lidhje me përdorimin e objektit, komenti i bërë nga subjekti i audituar pranohet.

4. Përsa i përket pretendimit se objektet rikonstruksion nuk i nënshtrohen Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë ky projekt duhet detyrimisht të nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM, ose minimalisht duhet të merrej mendimi nga AKM.

5. Bazuar shpjegimit se sipas nenit 54 pika 2 e rregullores së ppv procesi i ristrukturimit lejohet pa nevojën e hartimit të PDV. Ky koment pranohet.

6. Në zbatim të nenit 36 të rregullores së PPV pika 1: Sipërfaqe totale e ndërtimit është llogaritur për çdo njësi strukturore si produkt i sipërfaqes së ndërtueshme të zonës me intensitetin maksimal të lejuar. Pra, rrjedhimisht intensiteti matet si raport mes sipërfaqes totale të ndërtimit, me parcelën e ndërtueshme. Komenti juaj se sipërfaqes totale duhet të zbriten ballkone, taraca etj nuk qëndrojnë.

Sa më sipër, për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 1002, datë 16/08/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. F. D., ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlore me Nr.948, datë 30/07/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 660, datë 31/01/2018 për “Kapanon 1 kat, per vegla bujqësore” me adresë Fshati Mifol, Vlorë, me zhvillues E. J.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN130220180037 dhe nr.1281 prot. me datë 13.02.2018 për të cilën

është marrë vendimi për miratim me Nr.948, datë 30/07/2018 për objekt òKapanon 1 kat, per vegla bujqesoreò, u konstatua se:

- Është miratuar një përdorim jo i lejuar. Përdorimi i miratuar Kapanon për magazinim është në kundërshtim me përcaktimet e njësisë strukturore , pra me dokumentin e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

▪ Objekti është miratuar pa dakortësinë e Ujësjetllës Kanalizime Vlorë, pasi ky institucion ka kërkuar përcaktimin e pikës së lidhjes dhe nuk ka dhënë dakortësinë. Pas plotësimit të dokumentacionit, nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si edhe duke shkelur kushtet kryesore për ekzistencën e infrastrukturës në zbatim të nenit 45 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar.

▪ Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion, mbi procedurën e miratimit të Vlerësimit paraprak mjedisor. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe nuk ka respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

▪ Kjo leje ndërtimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 141 ditë pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit Nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C. të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente, por kanë dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë me shkresën 731/6 prot. datë 22.11.2021 si vijon:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN130220180037 dhe nr.1281 prot. me datë 13.02.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.948, datë 30/07/2018 për objekt òKapanon 1 kat, per vegla bujqesoreò, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Përsa i përket konstatimeve se ky objekt është miratuar në kundërshtim me PPV Bashkia Vlorë, subjekti i audituar sqaron se është aplikimi është kryer para datë së hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi me datë 28.02.2018 me publikimin në RKPT 27.02.2018.

2. Përsa i përket dakortësisë së UKVlorë, subjekti i audituar shpjegon se e ka marrë këtë dakortësi gjatë aplikimit me leje zhvillimi me nr.278 datë 14.01.2018.

3. Përsa i përket mungesës së VNM , subjekti i audituar sqaron se është pajisur me VNM paraprake nga AKM me Vendim 10 datë 05.03.2018.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për cështjen e audituar me nr. AN130220180037 është si vijon:

1. Shpjegimet tuaja se është marrë dakortësia nga UK Vlorë në fazën e miratimit të leje zhvillimi nuk pranohen, pasi në aplikimin për leje ndërtimi ky institucion ka kërkuar përcaktimin e pikës së lidhjes dhe nuk ka dhënë dakortësinë. Pas plotësimit të dokumentacionit, nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si edhe duke shkelur kushtet kryesore për ekzistencën e infrastrukturës në zbatim të nenit 45 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar. Shpjegimet nuk merren në konsideratë.

2. Sqarimet për pajisje me VNM paraprake pranohen, pas riverifikimit në sistemin e-leje.

3. Përsa i përket miratimit në kundërshtim me PPV Vlorë, aplikimi si për leje zhvillimi ashtu edhe për leje ndërtimi janë kryer pas miratimit në KKT të këtij instrumenti.
4. Për vonesat e shqyrtimit të aplikimit të lejes, subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime duke i marrë të mirëqena vonesat dhe duke shpërdoruar kështu detyrën në shkelje të procedurave administrative.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr.948, datë 30/07/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 981, datë 09/08/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 659, datë 31/01/2018 për “Kapanon 1 kat, për magazinimin e produkteve bujqësore” me adresë Rr. “Ismail Qemali”, Nj.A. Novoselë Vlorë, me zhvillues A. P.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN110220180005 dhe nr.1276 prot. me datë 11.02.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 981, datë 09/08/2018 për objekt “Kapanon 1 kat, për magazinimin e produkteve bujqësore”, u konstatua se:

- Është miratuar një përdorim jo i lejuar. Përdorimi i miratuar Kapanon për magazinim është në kundërshtim me përcaktimet e njësisë strukturore, pra me dokumentin e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

▪ Objekti është miratuar pa dakortësinë e Ujësjellës Kanalizime Vlorë, pasi ky institucion ka kërkuar përcaktimin e pikës së lidhjes, korigjimin e projektit, dhe nuk ka dhënë dakortësinë. Pas plotësimit të dokumentacionit, nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar si edhe duke shkelur kushtet kryesore për ekzistencën e infrastrukturës në zbatim të nenit 45 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar.

▪ Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion, mbi procedurën e miratimit të Vlerësimit paraprak mjedisor. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe nuk ka respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

▪ Kjo leje ndërtimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 137 ditë pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit Nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente , por kanë dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë me shkresën 731/6 prot. datë 22.11.2021 si vijon:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN110220180005 dhe nr.1276 prot., me datë 11.02.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 981, datë 09/08/2018 për objekt “Kapanon 1 kat, për magazinimin e produkteve bujqësore”, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Përsa i përket konstatimeve se ky objekt është miratuar në kundërshtim me PPV Bashkia Vlorë, subjekti i audituar sqaron se është aplikimi është kryer para datë së hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi me datë 28.02.2018 me publikimin në RKPT 27.02.2018.

2. Përsa i përket dakortësisë së UKVlorë, subjekti i audituar shpjegon se është ujësjellës kanalizime që duhej të plotësonte dokumentacionin me hartën për pikën e lidhjes.

3. Përsa i përket ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011, subjekti i audituar shpjegon se objektet bujqësore nuk janë në listën e aktiviteteve që pajisen me VNM.

4. Në lidhje me konformitetin nga AZHT, subjekti referon se është marrë në aplikimin për leje zhvillim e miratuar me Vendim 659 datë 3.01.2018 të kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Qëndrimet Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për cështjen e audituar me nr. AN110220180005 është si vijon:

1. Shpjegimet tuaja se është marrë dakortësia nga UK Vlorë në fazën e miratimit të leje zhvillimi nuk pranohen, pasi në aplikimin për leje ndërtimi ky institucion ka kërkuar përcaktimin e pikës së lidhjes, korigjimin e projektit, dhe nuk ka dhënë dakortësinë. Pas plotësimit të dokumentacionit, nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si edhe duke shkelur kushtet kryesore për ekzistencën e infrastrukturës në zbatim të nenit 45 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar. Shpjegimet nuk merren në konsideratë.

2. Sqarimet për pajisje me VNM paraprake nuk pranohen, pasi përsa i përket pretendimit se objektet bujqësore nuk i nënshtrohen Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë... ky projekt duhet t'ij nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM, ose minimalisht duhej të merrej mendimi nga AKM për këtë rast, veprim të cilin bashkia Vlorë e ka anashkaluar. Madje Bashkia Vlorë ka edhe rastin e cështjes AN130220180037, e cila është po kapanon për magazinim veglash bujqësore , dhe është pajisur me VNM paraprake, sic e ka konstatuar edhe vetë subjekti i audituar. Pra shpjegimet për mospajisjen me VNM, nuk pranohen.

3. Përsa i përket miratimit në kundërshtim me PPV Vlorë, aplikimi si për leje zhvillimi ashtu edhe për leje ndërtimi janë kryer pas miratimit në KKT të këtij instrumenti.

4. Përsa i përket konstatimit se nuk është pajisur me konformitet, subjekti sqaron se e ka marrë në fazë leje zhvillimi, sqarimi pranohet.

5. Për vonesat e shqyrtimit të aplikimit të lejes, subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime duke i marrë të mirëqena vonesat dhe duke shpërdoruar kështu detyrën në shkelje të proceduarve administrative dhe përcaktimeve të ligjit sektorial 105/2014 dhe vkm 408/2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 981, datë 09/08/2018 në kundërshtim me *përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT.*

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 861, datë 05/06/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 674, datë 16/02/2018 për "Magazine industriale 1 kat" me adresë Nartë, me zhvillues Ll. K.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me nr.1203 Prot. datë 07/02/2018, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 861, datë 05/06/2018 për objekt òMagazine industriale 1 katò, u konstatua se:

- ÒEshtë miratuar një përdorim jo i lejuar. Përdorimi i miratuar Industrial është në kundërshtim me përcaktimet e njësisë strukturore, pra me dokumentin e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

▪ Objekti është miratuar pa dakortësinë e Ujësjellës Kanalizime Vlorë, pasi ky institucion ka kërkuar korigjimin e projektit, dhe nuk ka dhënë dakortësinë. Bashkia Vlorë ka vijuar me miratimin duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si edhe duke shkelur kushtet kryesore për ekzistencën e infrastrukturës në zbatim të nenit 45 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar.

▪ Objekti nuk ka respektuar distancat e nevojshme nga kufiri i pronës në Veri, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore në pikën 8 të nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

▪ Objekti nuk respekton distancën nga objekti ekzistues 1 kat në brendësi të pronës, duke mos dhënë as informacion mbi këtë objekt, duke duke shkelur kështu përcaktimet e nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 4 m nga objekti 1 kat ekzistues.

▪ Bashkia Vlorë ka kaluar afatet ligjore për shqyrtim sipas përcaktimeve ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, duke shqyrtuar çështjen me 67 ditë pune.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente, por kanë dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë me shkresën 731/6 prot. datë 22.11.2021 si vijon:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me nr.1203 Prot. datë 07/02/2018, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 861, datë 05/06/2018 për objekt ÷Magazine industriale 1 katë, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Përsa i përket konstatimeve se ky objekt është miratuar në kundërshtim me PPV Bashkia Vlorë, subjekti i audituar sqaron se është aplikimi është kryer para datë së hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017, i cili konsiderohet se ka hyrë në fuqi me datë 28.02.2018 me publikimin në RKPT 27.02.2018. Subjekti pa miratuar ende Lejen e zhvillimit (miratuar me Vendim nr. 674 datë 16.02.2018), ka aplikuar për leje ndërtimi me aplikimin me nr.1203 prot. datë 07.02.2018.

2. Përsa i përket dakortësisë së UKVlorë, subjekti i audituar shpjegon se pasi është kërkuar ndryshim projekti, ujësjellës kanalizime Vlorë ka shprehur dakortësinë.

3. Përsa i përket ligjit Nr.10440 datë 07.07.2011, subjekti i audituar shpjegon se objektet bujqësore nuk janë në listën e aktiviteteve që pajisen me VNM.

4. Në lidhje me konformitetin nga AZHT, subjekti referon se është marrë në aplikimin për leje zhvillim e miratuar me Vendim 674 datë 16.02.2018 të kryetarit të Bashkisë Vlorë, me shkresën 458 prot. datë 14.02.2018, ku ka lënë edhe detyrimin e konvertimit nga arë në truall para miratimit të lejes së ndërtimit.

5. Përsa i përket distancës në Veri, subjekti i audituar shpjegon se ruan faqe kallkan 1m larg kufirit të vet të pasurisë.

6. Për distancën nga objekti brenda në pasuri, subjekti i audituar shpjegon se është brenda pasurisë së zhvilluesit e pa regjistruar.

7. Mbi afatet e tejkaluara të shqyrtimit subjekti i audituar shpjegon se kjo çështje ka kaluar edhe në statusin ÷Plotësim dokumentacioni edhe në statusin ÷Ndryshim projekti duke u zgjatur afatet.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar me nr. 1203 prot datë 07.02.2018 është si vijon:

1. Shpjegimet tuaja se është marrë dakortësia nga UK Vlorë pas ndryshimeve në projekt, komenti merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

2. Sqarimit se aplikimi është kryer para hyrjes në fuqi të PPV Bashkia Vlorë, pranohet.

3. Sqarimet për mungesën e konformitetit të AZHT, pranohen

4. Përsa i përket shpjegimit për ruajtjen e faqes kallkan në Veri, të një objekti industrial nga kufiri i pronës, kjo bie ndesh ashtu sic edhe është shpjeguar në aktkonstatimin nr.21, me pikën 8 të nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar. Shpjegimi juaj nuk merret në konsideratë.

5. Shpjegimi për mosruajtjen e distancës nga objekti 1kt. që ndodhet brenda kufirit të pasurisë që zhvillohet, se është brenda pasurisë së zhvilluesit, nuk pranohet. Pasi nuk respektohen distancat objekt-objekt në kundërshtim me nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 4 m nga objekti 1 kat ekzistues.

6. Në lidhje me afatet e tejkaluara, kalimi i të gjithë fazave të shqyrtimit është i përfshirë në afatin ligjor 60 ditor, në zbatim të ligjit 107/2014 i ndryshuar, VKM 408/2015 e ndryshuar si edhe bazuar në kodin e procedurave administrative.

Për sa u sgarua më lart, për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 861, datë 05/06/2018 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.E. A. ish drejtues i DPKZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me lëndë: “Njoftim për vlerësim pozitiv të projektit dhe pagesë të taksës së ndikimit në infrastrukturë”.

Titulli gjetjes-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 dhe leje zhvillimi Nr.196, datë 24/04/2019 për objekt “Godinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokë” me adresë Lagjia “Pavarësia” Vlorë, me zhvillues “H. P.”sh.p.k.

Situata -Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN050720190022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 630, datë 10/10/2019 për Godinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokë, u konstatua se:

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në jug (objekti 4-7-10) largesi e propozuar 1.62m nga kufiri i pronës dhe në Veri, pasi distanca minimale e përcaktuar në ligj është nr.kateve + 1m.

- Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në përfundim dhe pjesërisht në jug, pa dhënë informacion mbi objektet përballë tij, apo duke cënuar dhe mohuar mundësinë e zhvillimit të pasurisë kufitare, duke shkelur edhe përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 11m nga kufiri i pronës.

- Nuk plotësohen distancat në jug nga rruga me gjerësi 7-15m duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar pasi sipas pikës 3b) të këtij neni për rrugë deri 15m gjerësi së bashku me trotualet, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit duhet të jetë minimalisht 3.0 m. Leja e miratuar këtë distancë e ka 1.62m duke shkelur kështu dispozitat ligjore për sifurinë rrugore dhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore VL.UB.7.1607 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime, zonë tregtare dhe biznesi dhe shtëpi të dyta, pasi është shkelur intensiteti i lejuar prej I=3.5, duke tejkuluar sipërfaqen e ndërtuar të lejueshme. Në planvendosje sipërfaqja totale mbi tokë e ndërtimit është shënuar më e vogël se ajo faktike e cila përkon me 2945.87m².

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të

Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN050720190022 për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 për òGodinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokëo subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësisve strukturore , harta me kodin 18i është përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket zonës me rëndësi kombëtare ku përfshihet edhe brezi bregdetar i miratuar me Vendim nr.1/2018 të KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk është njohur zyrtarisht me hartën ku përcaktohet ky brez, deri me datën 27.04.2020.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit, subjekti i audituar shpjegon se me shkresën nr.1993/2 datë 24.09.2019 AZHT shpreh dakortësinë për vijimin e procedurave të shqyrtimit të lejes, sipas PPV Bashkia Vlorë.

3. Në lidhje me distancat e objektit në drejtimin Jugor dhe Verior projekt propozimi ka ruajtur distancat me kufirin e rrugëve. Në Jug ka rrugë me gjerësi 7m, dhe ka ruajtur edhe vijën e ndërtimit ekzistuese, dhe në Veri ka rrugë 6m , të propozuar në PPV dhe ka ruajtur distancën 2.5m. Objekti ka ruajtur edhe vijat e ndërtimit ekzistuese.

4. Mbi ruajtjen e faqes pa carje (Kallkan) në perëndim , subjekti i audituar shpjegon se është bazuar tek neni 72 i Rregullores së PPV Bashkia Vlorë sipas të cilit Pika 1- *kur territori i propozuar për zhvillim ballafaqohet me struktura ekzistuese me faqe kallkan, për të kryer mbylljen e zhvillimit (duke qenë se kallkani ka krijuar konceptin e vazhdimësisë në terren të situatës urbane) lejohen të drejta zhvillimi të njëjta me ato ekzistuese për realizimin e konsolidimit urban në territor.*

Në këto kushte, edhe pse kufitari është parcelë e pazhvilluar, vetëm duke ruajtur kallkan parcelat do arrin të plotësonin treguesit zhvillimorë sipas PPV.

5. Përsa i përket konstatimit se objekti i miratuar ka tejkalluar intensitetin maksimal të lejuar, subjekti i audituar shpjegon se sipërfaqja 2945.87m², është sipërfaqja totale mbi tokë së bashku me ballkonet, dhe se sipërfaqja pa ballkone është më e vogël.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN050720190022 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 shpjegimi juaj mund të merret në konsideratë

2. Në lidhje me konformitetin nga AZHT në zbatim të legjislacionit në fuqi, nga ky institucion është dhënë dakortësia për vijimin me shqyrtimitme shkresën nr.1993/2 datë 24.09.2019 të AZHT-së, sqarimi merret në konsideratë.

3. Përsa i përket sqarimeve në lidhje me distancat nga rrugët, sipas planvendosjes së miratuar rruga në jug të objektit nuk ka gjerësi 7m, pasi ka dhe trotuarë, dhe distanca në drejtimin Jugor nga trotuari (me vijë jeshile) është ruajtur 1.62m, ndërkohë që duhej të ishte minimalisht 3m largësi. Në drejtimin Verior, në planvendosje është shkruar rrugë në studim, e cila i bie në brendësi të pasurisë së propozuar për zhvillim, Për rrjedhojë një pjesë e madhe e kësaj sipërfaqe do të shkojë për kefcient KSHR, duke u zbritur nga sipërfaqja e parcelës së ndërtueshme. Duke cuar kështu tejkallimin e Intensitetit edhe më shumë. Përsa i përket distancave nga rruga e propozuar, në planvendosje përvec emërtimit, nuk është vendosur asnjë kontur që tregon trupin e rrugës. Sqarimi i subjektit të audituar për distancat nga rrugët nuk mund të merret në konsideratë.

4. Shpjegimet mbi ruajtjen e faqes kallkan në pjesën perëndimore të objektit të miratuar, si vijimësi e situatës së formuar urbane, nuk ka arësytim as ligjor dhe as logjik, pasi në perëndim ndodhet një parcelë bosh, e koncepti i vijueshmërisë nuk ekziston. Komentet tuaja për këtë pikë nuk mund të merren në konsideratë. Objekti duhej të ruante distancën nga kufiri i pasurisë.

5. Në lidhje me intensitetin maksimal të lejuar, i cili në gjetjet tona është konstatuar i tejkaluar, shpjegimet tuaja se sipërfaqja totale e kateve është më e ulët, sqarojmë se ballkonet e këtij objekti janë në brendësi të kontureve të faqeve të ndërtimit dhe jo konsol. Pra në këtë rast sipërfaqja është 2945.87 m². Gjithashtu, ashtu sic u përmend edhe në pikën 3, duke qenë se në veri një pjesë e pasurisë shkon për rrugë, pra e merr KSHR, parcela e ndërtueshme ka sipërfaqe më të vogël, si rrjedhim edhe sipërfaqja e ndërtueshme ulet, bazuar kjo në rregulloren e PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, *neni 37 Intensiteti maksimal i lejuar për zonën Instensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për cdo njësi strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e intensitetit për njësinë nuk përfshihen rrugët (KSHR) dhe hapësirat publike (KSHP). Komenti juaj në lidhje me këtë pikë, nuk mund të merret në konsideratë.*

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M., z.F. D. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Nr. 748, datë 06/12/2019 dhe Leje Zhvillimi Nr. 682, datë 06/11/2019 për “Objekt 3 kate me 1 kat parkim me funksion hoteleri” me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues Hotel R. G.

Situata -Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN051220190016 dhe nr.741 prot. me datë 06.07.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 470, datë 06.12.2019 për Objekt 3 kate me 1 kat parkim me funksion hoteleri, u konstatua se:

- Objekti është miratuar pa dakortësinë e Ujësllës Kanalizime Vlorë, institucion i cili ka shprehur mosdakortësinë me shkresën e tyre me datë 06.12.2019.

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit paraprak mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion, por nga aplikuesi është ngarkuar shkresa me nr.826/1 prot. datë 04.12.2019, e ardhur nga AKM në drejtim të R. G. shpk, shkresë e cila nuk zëvendëson procedurën e miratimit të Vlerësimit paraprak mjedisor. Bashkia Vlorë ka shkelur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe duke mos respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në Lindje, ku largësia minimale për objekt 3 kate duhej të ishte 4m nga kufiri i pronësisë.

- Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri- tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të cfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në Veri dhe në Jug pa dhënë informacion mbi pronën përballë, duke shkelur kështu përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 4 m nga kufiri i pronës, e si pasojë duke cënuar të drejtën për zhvillim të pasurisë kufitare.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje propozon punime ndërtimore në pronësi të të tretëve (pasazh i pishinës) duke shkelur Ligjin për òPronat e paluajtëshme të shtetit.

- Vendimi i miratimit të kësaj leje propozon punime ndërtimore në një objekt në proces legalizimi, si edhe ndryshimin e destinacionit të objektit, në kundërshtim kjo me ligjin 107/2014 i ndryshuar dhe aktet nënligjore të tij.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuria që merr pjesë në zhvillim ndodhet në njësinë strukturore OR.UB.6.1460 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime, zonë tregtare dhe biznesi dhe shtëpi të dyta. Në lidhje me përcaktimet e PPV Vlorë, me miratimin e kësaj leje ndërtimi për këtë njësi strukturore janë shkelur:

Leja e ndërtimit e tejkalon intesitetin e ndërtimit të lejuar, duke miratuar sipërfaqe më të lartë ndërtimi se ajo e miratuar.

Leja e ndërtimit tejkalon koeficientin e shfrytëzimit të pronës duke shkelur përcaktimet e PPV Vlorë prej $K_{sht.max} = 30\%$, pasi nuk janë llogaritur sipërfaqet e objekteve ekzistuese.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN051220190016 dhe nr.741 prot. me datë 06.07.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 470, datë 05.12.2019 për objekt 3 kate me 1 kat parkim me funksion hotelerië subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësisive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket aktit të konformitetit Bashkia Vlorë ka kërkuar nëpërmjet e-lejeve përputhshmërinë dhe AZHT në shkresën e saj me nr.3009 prot. datë 06.12.2019 ka shprehur dakortësinë për vijimin e shqyrtimit të aplikimit nga Bashkia Vlorë.
2. Në lidhje me mosdakortësinë e UK Vlorë, subjekti i audituar shpjegon se shkresa me dt.06.12.2019 shprehet se debitor është aplikuesi dhe jo subjekti zhvillues. Gjithashtu ky është një objekt ekzistues, i cili e ka lidhjen me UKV.
3. Përsa i përket mospajisjes me Vlerësim Mjedisor paraprak, subjekti i audituar shpjegon se ky zhvillim është rikonstruksion dhe shtesë anësore, për këtë arsye nuk kërkon pajisje me VNM paraprake, gjithsesi subjekti aplikues ka depozituar nëpërmjet e-lejeve Raportin e Vlerësimit në Mjedis dhe shkresën e aplikimit pranë AKM me nr.826/1 prot. datë 04.10.2019.
4. Në lidhje me konstatimet se objekti nuk plotëson distancat në drejtimin Lindor, është sqaruar se kjo distancë është ruajtur nga kufiri i pronës me 4m, për objekt të ri 3Kt.
5. Përsa i përket ruajtjes si faqe pa carje kallkan në pjesën Jugore, subjekti i audituar shpjegon se objekti ekzistues 1 kat është kallkan situatë ekzistuese.
6. Punimet e konstatuara në pronë shtet, konsistojnë në riparime dhe e strukturës, si pjesë ekzistuese e vetë hotelit, dhe përdoret nga ky hotel.
7. Për objektin që rikonstruktohet nuk propozohet shtim vëllimi apo sipërfaqe ndërtimore, dhe është i pajisur me certifikatë pasurie për pasurinë 139/6 nd me sip.696 m², si dhe pasuria 139/25 nd. me sip.381m² dhe 159 m².
8. Përsa i përket konstatimeve se është shkelur Intesiteti maksimal i lejuar dhe Ksht maximale e lejuar sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Vlorë, për njësinë strukturore OR.UB.6.1460 me kategori kryesore S_Shërbime dhe treguesit janë përlllogaritur në zbatim të nenit 37 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, ndërsa për KSHT, në llogaritje janë marrë vetem objekti A dhe B, të propozuar dhe jo ato ekzistueset.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN051220190016, është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, sqarimi merret parasysh.
2. Në lidhje me konformitetin nga AZHT në zbatim të legjislacionit në fuqi, shpjegimet e subjektit të audituar merren në konsideratë.
3. Përsa i përket pretendimit se objektet rikonstruksion nuk i nënshtrohen Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarojmë se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë ky projekt duhet të nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM, ose minimalisht duhet të merrej mendimi nga AKM për këtë rast, veprim të cilin bashkia Vlorë e ka anashkaluar. Kjo vërtetuar edhe me shkresën 826/1 prot. datë 04.12.2019 nga AKM, e cila shprehet se: *Veprimtaria "Objekt 3 kate me një kat parking me funksion hoteleri në Radhimë Vlorë" përfshihet në listën e aktiviteteve që i nënshtrohen procedurave të VNM dhe është në proces, shqyrtimi dhe miratimi të punimeve.*
Gjithashtu nga projekti i propozuar, vihet re objektet 1kat ekzistuese janë prishur dhe është rindërtuar objekt plotësisht i ri.
4. Në lidhje me sqarimet se në drejtimin lindor është ruajtur distanca 4m, nga kufiri i pronës, sipas planvendosjes së miratuar kjo distancë është ruajtur mesatarisht, por jo në të gjithë faqen e strukturës.
5. Për distancën 1m si faqe kallkan me objektin në Jug, shpjegimi i subjektit të audituar pranohet, por bashkia Vlorë duhet të mbajë në konsideratë, se ky informacion (faqet kallkan te objekteve kufitare) duhet të jepet në fazën e lejes së zhvillimit, kur hartohet edhe plan rievimi nga topografi i licensuar, si dokument ky që pasqyron saktë gjendjen ekzistuese në terren.
6. Përsa i përket punimeve të pasazhit në pasuri shtet, sqarimi se pasazhi është ekzistues, nuk pranohet, pasi nuk figuron i paraqitur në fragmentin e relievit i hartuar nga topograf i licensuar E. D. me lic. Nr. T.1124/1, dokument i cili shërben si bazë për hartimin e planvendosjes e cila miratohet.
7. Për shpjegimin mbi konstatimin se në objektet ekzistuese, ky propozohet rikonstruksion, shpjegimi se janë të pajisura me certifikatë pasurie nuk pranohet, pasi për këto objekte është paraqitur leje genplan i Lejes së legalizimit në dokumentin me emërtim **Pronat legalizim_compressed.pdf*. Punimet e këtij objekti janë propozuar në një objekt në legalizim.
8. Në lidhje me dakortësinë e UK Vlorë, ku subjekti i audituar pretendon se UK është shprehur për aplikuesin, sipas dokumentit që ndodhet në e-leje, UK Vlorë në shkresën e saj kthim përgjigje me datë 06.12.2018 shprehet se: *Ujesjelles Kanalizime Vlore ne portalin e-Leje, ne baze te dokumentacionit te vene ne dispozicion nga ana juaj, ju bejme me dije se: aplikanti Z.F. Xh. dhe zhvilluesi Hotel R. G. figurojne debitor ndaj Ujesjelles Kanalizime Vlore. Institucioni sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore, nuk eshte dakort.* Pra shpjegimet tuaja nuk merren në konsideratë.
9. Përsa i përket shpjegimeve mbi Intensitetin maksimal të lejuar sqarojmë se: Në zbatim të nenit 36 të rregullores së PPV pika 1: *Sipërfaqe totale e ndërtimit është llogaritur për cdo njësi strukturore si produkt i sipërfaqes së ndërtueshme të zonës me intensitetin maksimal të lejuar. Pra, rrjedhimisht intensiteti matet si raport mes sipërfaqes totale të ndërtimit, me parcelën e ndërtueshme.* Komenti juaj se sipërfaqes totale duhet të zbriten ballkone, taraca etj. nuk qëndrojnë. Gjithashtu ashtu sic edhe është konstatuar në akt konstatimin nr.1 të audituesve, për përlllogaritjen e KSHT dhe përlllogaritjen e Imax të lejuar nuk janë përfshirë sipërfaqet e ndërtimit të objektit ekzistues që përfshihet në parcelën në zhvillim. Shpjegimet tuaja nuk mund të konsiderohen, dhe gjetjet e auditimit qëndrojnë.
Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim nr.748, datë 06/12/2019 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.F. D. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar në emër të aplikantit N. J., zhvillues M. Ç. me datë aplikimi 04.06.2019, është miratuar leje për rikonstruksion objekt banimi 1 kat dhe shtesë në lartësi në Lgj Pavarësia, Rr. Andon Z. Çajupi, ZK 8603, pasuria me nr. 29/333, pasuria me nr. 29/629, pasuria me nr. 29/337-ND dhe pasuria me nr. 29/337-T, NJS VL.UB.7.1010.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit rezulton se sipas preventivit të aplikantit në sistemin e lejeve, vlera totale e tij është **47,507,378 lekë**. Nga kjo vlerë, duke llogaritur me 3% taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se aplikanti duhej të paguante shumë prej **1,425,221 lekë**. Personi përgjegjës për llogaritjen e kësaj takse, ka shumëzuar sipërfaqen totale të ndërtimit prej 984.5 m² x 32,508 lekë çmimi sipas entit kombëtar të banesave, për të nxjerrë vlerën prej **32,004,126 lekë** x 3% taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe i është kërkuar aplikantit pagesa në shumë **960,123 lekë**. Diferenca prej **465,098 lekë**, është e ardhur e munguar me dëm ekonomik për Bashkinë Vlorë, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 46 pika 1 *o*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të ligjit nr. 107/2014 *o*Për Planifikimin e Territorit, i ndryshuar.

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi z. K. M. me detyrë Kontrollues dokumentacioni dhe z. F. D. me detyrë Drejtor i DPZHT Vlorë.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 23/07/2019 për objektin “Kompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dyta” në Radhimë - Vlorë, me zhvillues “E.”shpk.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN120920190035 , për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 79, datë 11/02/2020 për objekt *o*Kompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dyta" është konstatuar se:

- Kjo leje është lëshuar pa miratimin e UKV, e cila nuk ka dhënë pëlqimin për miratimin e këtij objekti, pasi subjekti zhvillues *o*E. shpk është debitor ndaj kësaj ndërrmarjeje.
- Për objektin nuk është siguruar kushti i infrastrukturës, pasi nuk janë dhënë shpjegime mbi aksesin për zhvillimin e propozuar.
- Formulari i lejes dhe të dhënat e paraqitura në planvendosjen e objektit nuk janë të sakta, pasi sipërfaqja e ndërtimit mbi tokë është 2666.4 duke realizuar në I=1.82.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkuluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN120920190035, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 79, datë 11/02/2020 për objekt *o*Kompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dyta" subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Për konstatimin se objekti nuk ka marrë aktin e konformitetit nga AZHT, subjekti i Audituar shpjegon se AZHT ka sjellë mendim për plotësim dokumentacioni dhe kur është ridërguar për mendim institucioni i AZHT e ka lënë në heshtje. Ndërsa për gjetjen se objekti ndodhet brenda zonës së brezit bregdetar, subjekti i audituar shprehet se ka PPV në fuqi dhe objekti nuk ndodhet në zonën e brezit bregdetar sipas hartës së njësive strukturore me kodin 18i.
2. Për Konstatimin se nuk është marrë dakortësia nga UK Vlorë, subjekti i audituar shpjegon se Përgjigja e UK Vlorë dhënë nëpërmjet e-lejeve është gabimisht për subjektin aplikues dhe jo zhvillues.
3. Në lidhje me kushtin për ekzistencën e infrastrukturës, shpjegohet se në fazën për miratim të lejes së Zhvillimit, aksesin sigurohet nga rruga kryesore Vlorë-Orikum.
4. Përsa i përket llogaritjes së gabuar të intensitetit të ndërtimit, subjekti i audituar shpjegon se në zbatim të nenit 3 pika 35 e rregullores së PPV Bashkia Vlorë shpjegohet përkufizimi

siperfaqe kati, ku nuk futen ballkonet, podrumet taracat gjysem te mbuluara, duke mos u perputhur siperfaqja e kateve me siperfaqen totale te objektit mbi tokë.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për cështjen e audituar me nr. AN120920190035 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar dhe marrjes së konformitetit nga AZHT shpjegimet qëndrojnë duke mos u marrë në konsideratë.
2. Përsa i përket problematikës së dakortësisë së UK Vlorë, shpjegimi juaj merret në konsideratë.
3. Kushti për aksesin në infrastrukturë, merret në konsideratë pas shpjegimit të dhënë nga ana e subjektit të audituar.
4. Llogaritja e siperfaqes së objekti është kryer e saktë, pasi objekti nuk ka ballkone konsol apo taraca gjysëm të mbuluara. Pra shpjegimet për të dhëna të pasakta nuk merren në konsideratë dhe do jenë subjekt i auditimit. Intesiteti i ndërtimit e tejkalon intensitetin maksimal të lejuar për njësinë strukturore OR.UB.6.1459 $I_{max}=1$, duke miratuar një $I=1.82$.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M. dhe z.F. D.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 dhe leje zhvillimi nr. 689, datë 14/11/2019 për objektin “Godinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë”, në adresën Rruga “Dhimitër Konomi”, me zhvillues “E. K.”.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN070320200020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 300, datë 02/07/2020 për objekt Godinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë është konstatuar se:

- Leja është lëshuar edhe në mungesë të aktit të kontrollit të konformitetit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), duke shkelur kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar, sipas së cilave kemi:

Neni 21 pika 6: Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

- Kjo leje është miratuar mbi pasurinë 35/73/3 e cila është e vendosur në favor të një subjekti tjetër, pa u revokuar këto marrdhënie kontraktuale të mëparshme, duke u bërë shkas për lindje konfliktesh.

- Kjo leje është në kundërshtim me PPV të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi sipas përcaktimeve të njësisë strukturore ku propozohet zhvillimi VL.UB.1386 me kategori A.banim, nënkategori A3, me lloj ndërhyrje Dendësimë në zbatim të rregullores së PPV Bashkia Vlorë pika 20_2a, kjo lloj ndërhyrje lejon shprehimisht:

Për Bashkinë Vlorë kjo lloj ndërhyrje i referohet tipeve të ndërhyrjes si më poshtë:

Tokë e lirë brenda qytetit të Vlorës (A3) dhe ish tokë industriale (IE) Zona të pambushura me ndërtime gjatë Rivierës së bregdetit të Vlorës me shërbime...

Ndërkohë, sipas kësaj leje, toka nuk ishte e lirë, por janë prishur edhe dy objekte me nr.pasurie 35/144/nd sip.390m² dhe 35/73/nd me sipërfaqe 700m², duke mos iu përmbajtur llojit të ndërhyrjes së përcaktuar në njësinë përkatëse strukturore sipas dokumentit të planifikimit të Bashkisë Vlorë.

- Objekti i miratuar nuk plotëson distancën nga rruga Dhimitër Konomi e cila sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Vlorë, është rrugë e kategorisë D Urbane Kryesore. Në drejtim të kësaj rruge është ruajtur distanca me vijë ndërtimi, në kundërshtim kjo me përcaktimet e PPV neni 46 pika 9, sipas të cilës nëse zona nuk është me prioritet zhvillimi, vija e ndërtimit respekton rregulloren e miratuar me VKM. Në këtë rast, kjo distancë nuk është respektuar.

▪ Objekti ka tejkaluar intensitetin e ndërtimit $I=3$, të përcaktuar në PPV Vlorë, pasi sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është më e lartë se ajo e paraqitur në treguesit në planvendosje.

▪ Po kështu koeficienti i shfrytëzimit të tokës është më i lartë sipas projekt-zbatimit, se ai i paraqitur në planvendosje dhe i shënuar në dokumentin e lejes së ndërtimit.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkaluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit:-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, për këtë çështje subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit me AN070320200020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. 300, datë 02/07/2020 për objekt òGodinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë, nga ana e subjektit të audituar janë dhënë këto shpjegime:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, ka një hartë ku është përcaktuar brezi bregdetar, konkretisht ajo me kodin 18i) Harta e Njësive Strukturore, ku sipas legjendës përcaktohet brezi bregdetar. Sipas kësaj harte, propozimi i miratuar nuk bën pjesë në këtë brez. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Vlorë, shpjegon se bazuar në Vendimin nr.1 datë 30.07.2015 të KKT òPër përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore, brezi bregdetar i përcaktuar si kufi me Vendimin nr.1 datë 08.10.2013 òPër masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të Planit të Integruar Sektorial për brezin bregdetar nuk merret parasysh me miratimin e PPV Bashkia Vlore me Vendim nr.01. datë 16.10.2017. Gjithashtu subjekti i audituar pretendon se nuk ka patur dijeni për kufirin e brezit bregdetar, si zonë me përparësi turizmin dhe për ndryshimet ligjore miratuar me VKM nr. 693, datë 2.10.2019 òPër disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit.

2. Gjithashtu subjekti i audituar shpjegon se në zbatim të nenit 45/2 dhe duke qenë se ka PPV në fuqi, kërkon konformitet nga AZHT-ja vetëm për objektet me lartësi mbi 9 kate.

3. Subjekti i pretenduar jep një sqarim për terminologjinë òDendësimò, duke shpjeguar që edhe pse janë shembur dy objekte, parametrat e zhvillimit janë sipas rregullores së PPV Bashkia Vlorë për zonat S2, si zona të pambushura me ndërtime.

4. Përsa i përket gjetjes se nuk është respektuar distanca nga rruga òDhimitër Konomiò sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Vlorë si rrugë D Urbane kryesore, subjekti i audituar shpjegon se sipas nenit 47 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, si vijë ndërtimi është ruajtur vija e ndërtimit ekzistuese me objektet shumë katëshe ekzistuese.

5. Përsa i përket gjetjes për tejkalim të intensitetit maksimal të lejuar $I_{max}=3$ sipas PPV Bashkia Vlorë, subjekti i audituar shpjegon se sipas pikës 35 përcaktohet kush është sipërfaqja e katit, në të cilën nuk përfshihen ballkonet, taracat gjysëm të mbuluara, podrumet, ndërtimet e përkohshme.

6. Për gjetjen ku theksohet se është tejkaluar koeficienti i shfrytëzimit i përcaktuar në PPV Vlorë, shpjegohet se elementet si kollona të hapura pa volum ndërtimi, nuk janë llogaritur si sipërfaqe e zënë e parcelës, duke e bazuar argumentin tek neni 3 òPërkufizimeò te rregullores së PPV Bashkia Vlorë, pika 8: *“Hapësira të hapura”, janë hapësira të pandërtuara ndërmjet*

strukturave, sipas rastit rrugë për hyrje në strukturë, ose hapësira me një mbulesë vegjetacioni, sheshe parkimi, vendqendrim dhe hapësira të gjelbra në funksion të strukturës së ndërtuar dhe pjesë e parcelës së ndërtueshme.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Përsa i përket observimeve të mbajtura për auditimin e aplikimit AN070320200020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 300, datë 02/07/2020 për objekt òGodinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë, sqarojmë se:

1. Qëndrimet të subjektit të audituar se në zbatim të hartës së njësive strukturore të PPV Vlorë, objekti nuk bën pjesë në brezin bregdetar, ky shpjegim është irilevant, pasi tek pika 1 e Akt Konstatimit nr.21 është sqaruar moskompetenca e lëshimit të lejes në zbatim të Vendimit nr.1/2018 të KKT si një zonë e rëndësisë kombëtare. Më tej në zbatim të:

Pika 3ç të Nenit 19 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar

Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës për miratimin e lejeve të ndërtimit për: ç) Objektet si dhe veprat e infrastrukturës brenda zonës së brezit bregdetar, të miratuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Gjithashtu sic është sqaruar edhe më lart, me Vendimin nr. 693, datë 2.10.2019 òPër disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të VKM, òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, të ndryshuar, në nenin 1 të këtij vendimi përcaktohet se:

Neni 1, Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. *Në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje: “ç) Objektet si dhe veprat e infrastrukturës brenda zonës së brezit bregdetar, të miratuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.”*

Sqarimet e dhëna për miratimin jashtëkompetencës, pranohen.

2. Sic u shpjegua më lart, edhe mungesa e marrjes së konformitetit nga AZHT, si autoritet përgjegjës për miratimin dhe mbikqyrjen e zhvillimit të territorit në zonën e brezit bregdetar, përbën shkelje ligjore në zbatim të Nenit 19 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar dhe në zbatim të nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Ky shpjegim nga ana e subjektit të audituar merret në konsideratë.

3. Për sa shpjegohet në lidhje me terminologjinë òdendësim, risqarojmë se sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pika 20_2a, kjo lloj ndërhyrje lejon shprehimisht:

Për Bashkinë Vlorë kjo lloj ndërhyrje i referohet tipeve të ndërhyrjes si më poshtë:

Tokë e lirë brenda qytetit të Vlorës (A3) dhe ish tokë industriale (IE)

Zona të pambushura me ndërtime gjatë Rivierës së bregdetit të Vlorës me shërbime...

Ndërkohë, sipas kësaj leje, toka nuk ishte e lirë, por janë prishur edhe dy objekte me nr.pasurie 35/144/nd sip.390m2 dhe 35/73/nd me sipërfaqe 700m2, duke mos iu përmbajtur llojit të ndërhyrjes së përcaktuar në njësinë përkatëse strukturore sipas dokumentit të planifikimit të Bashkisë Vlorë. Lloji i ndërhyrjes nuk ka shkuar në përputhje me përcaktimet e PPV Bashkia Vlorë, sqarimi nuk mund të merret në konsideratë.

4. Në sqarimin e kryer nga subjekti i audituar, shpjegohet se ka një vijë ndërtimi të formuar në drejtim të rrugës kryesore, e krijuar nga objekte shumëkatëshe. Bazuar në dokumentacionin e ndodhur në e-leje në çështjen me nr.AN070320200020, dokumenti *11_rilEvim topografik, nuk vërehen objekte shumëkatëshe në afërsi të objektit të miratuar, përveç objekteve 1-2 kate. Pra objekti nuk ka respektuar distancën e nevojshme nga rruga òDhimitër Konomiò. Observimi për këtë pikë, nuk mund të merret në konsideratë.

5. Objekti e tejkalon Intensitetin e lejuar maksimal $I_{max}=3$, pasi sipas nenit 37.1 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017 kemi shprehimisht: *Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit në cdo njësi strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e intensitetit nuk përfshihen rrugët dhe hapësirat publike.* Nisur nga llogaritjet e paraqitura edhe në planvendsojen e miratuar sipërfaqja e parcelave në zhvillim për zbatim intensiteti sipas ppv është 2448.13 m², ndërsa sipërfaqja

totale e ndërtimit është 9852.1 m² nga ku 6333.1 m² banim; 3003 m² hoteleri; 516 m² shërbime, sipërfaqe ku nuk janë përfshirë 728.2 m² hoteleri nëntokë. Por, gjithsesi $9852.1/2448.13 = 4.02$. Projekt propozimi e ka tejkalluar intensitetin maksimal të lejuar, sa më sipër shpjeguar, komenti juaj nuk mund të merret në konsideratë.

6. Përsa i përket shpjegimit tuaj se nuk është tejkalluar koeficienti maksimal i shfrytëzimit të pronës, pasi nuk mund të futen në llogaritje hapësirat e mbuluara me kollona të hapura, sqarojmë se në zbatim të nenit 38 pika 1 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, miratuar me Vendim nr.1 datë 16.10.2017 kemi shprehimisht: *Raporti i shfrytëzimit të parcelës. Sipërfaqe e shprehur në m² që një strukturë zë në një parcelë ndërtimi. Hapësira gjysëm të mbuluara që përfshijnë elementët e strukturës së ndërtesës (sic janë taracat e mbuluara) përfshihen brenda sipërfaqes së zënë të parcelës.*

Sa më sipër, qëndrimi juaj se hapësirat në kat përdhe me kolona të hapura, nuk mund të merren në llogaritje për koeficientin e shfrytëzimit, të cilat faktikisht janë plotësisht të mbuluara në katet e sipërme tek ky projekt propozim, nuk mund të merren në konsideratë, shkelja e koeficientit maksimal të shfrytëzimit, qëndron.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M. dhe z.F. D. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin “Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë”, në adresën rruga "Irakli Pylli", Bashkia Vlore, me zhvillues “M. C.AL” sh.p.k

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN211220200044, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Nr. 678, datë 30/12/2020 për objekt Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë, është konstatuar se:

- Ndërmjet Zhvilluesit dhe Bashkisë Vlorë është nënshkruar një marrëveshje për përdorimin e intesitetit me kusht, marrëveshje kjo që nuk plotëson kriteret ligjore, pasi nuk është përcaktuar se sa do të rritet intensiteti dhe numri i kateve, si edhe është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e PPV Vlorë neni 49, pika 3k pasi nuk ka asnjë referencë për rregulloren vendore sipas këtij rasti. Këshilli Bashkiak Vlorë ka miratuar me Vendim nr.58 datë 05.08.2020 "Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit" e cila nuk është një rregullore dhe sipas pikës 7 të këtij vendimi, kate shtesë mund të miratohen vetëm 2 kt+papafingo. Ndërkohë që objektit i janë shtuar 3 kate.

Neni 49, pika 3k e PPV Bashkia Vlorë: Procedura për miratimin e Intesitetit me Kushte do të përcaktohet me rregullore të vecantë nga autoritetet vendore të planifikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkalluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë për Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë, si vijon:

1. Janë dhënë shpjegime mbi miratimin e intensitetit me kushte, sipas nenit 49 pika 2d e PPV Bashkia Vlorë, dhe sipas kreut 2, të rishikimit të dokumentit të PPV me Vendim nr.03 datë 03.12.2020. Në zbatim të ketyre dy hapësirave përcaktuese është miratuar VKB me nr.58 datë 05.08.2020 "Për miratimin e kritereve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit", ku mund të miratohen 2 kate + papafingo. Për këtë arsye shtesat 3 kate mbi 10 kate që lejon njësia strukturore janë të ligjëruara në zbatim të marrëveshjes Bashki-Zhvillues për përfitimin nga programi i intensitetit me kushte.

2. Subjekti i audituar ka dhënë shpjegime se kati i 12-të edhe pse është gjysëm kati, në distanca hyn në llogaritje, dhe për këtë arsye emërtimi òGodinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë është konsideruar i pranueshëm.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për cështjen e audituar me nr. AN211220200044 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve mbi përfitimin e subjektit M. C. Al. nga instrumenti i intensitetit me kushte, llogjika dhe rruga e ndjekur ligjore konsiderohet se është e saktë, përveç faktit se leja e ndërtimit është miratuar 13 kate, duke tejkaluar lartësinë max të lejuar shtesë prej 2.5 kate. Leja duhej të miratohej maksimalisht 12 kate + gjysmë kati.

Edhe sipas sipërfaqeve të cituara nga Ju në këtë observim, konkretisht kati i trembëdhjetë 296.7m², dhe sipërfaqja kat tip 568m², vihet re se kati 13 nuk është gjysmë kati. $568 \div 2 = 284$ m².

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 me numër katesh 13 dhe jo 12 + papafingo, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M. dhe z.J. Ç. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 770, datë 16/12/2019 për objektin "Kapanon për rritje dhe mbarështim shpendësh", në adresën fshati Shushicë, Njësia Administrative Bashkia Vlorë, me zhvillues B. K.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN201220190002, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 25, datë 22/01/2020 për objekt òKapanon per rritje dhe mbareshtim shpendeshò është konstatuar se:

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore SH.B.444 me kategori Bujqësi, lloji i ndërhyrjes konservim bujqësor dhe përdorim të lejuar bujqësi-kultivim ara me Ksht = 0%. Përdorimi i objektit të miratuar, prodhim dhe rritje shpendësh, nuk përputhet me përdorimin e përcaktuar në dokumentin e planifikimit të Bashkisë Vlorë.

- Plani i rilevimit nuk paraqet pasuritë e përfshira në zhvillim, gjithashtu edhe planvendosja nuk paraqet situatën faktike, mungon objekti kufitar me nr.pasurie 281/18/2 ND, dhe atë të pasurive me nr.281/19/2, nr.281/19/1 dhe nr.281/18/1 ZK 3446, duke mos përmbushur kështu kërkesat ligjore sipas nenit 15 pika c të VKM 408/2015 me ndryshimet përkatëse.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij.

Pretendimi i subjektit:-Në lidhje me keto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga si më poshtë për Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 770, datë 16/12/2019 për objektin òKapanon per rritje dhe mbareshtim shpendeshò, në adresën fshati Shushice, Njësia Administrative Bashkia Vlore, me zhvillues B. K.:

1. Në lidhje me konstatimin se kjo leje është lëshuar në kundërshtim me përcaktimet e PPV Bashkia Vlorë, ku kategoria e përdorimit është Bujqësi, subjekti i audituar ka shpjeguar se kjo leje ndërtimi është lëshuar në zbatim të VKM 12 datë 27.02.1019 *“Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyrore (N)”*. Gjithashtu subjekti i audituar shpjegon që ka marrë konformitet në aplikimin për leje zhvillimi me AN111220190003.

2. Përsa i përket gjetjes së auditimit se plan rilevimi i paraqitur, mbi të cilin është marrë vendimmarrja, subjekti i audituar shpjegon se gjendja faktike, nuk është detyrë e bashkisë Vlorë ta kontrollojë, por duhet ta paraqesë topografi i cili harton plan-rilevimin.

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, në lidhje me çështjen e audituar me nr.AN201220190002 është si vijon:

3. Në lidhje me sqarimin se ky objekt është miratuar në njësi strukturore B (bujqësi) pasi është bazuar te Vendimi nr.12 i KKT datë 27.02.1019 *“Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyrore (N)”*, sipas pikës 1a) të këtij vendimi të KKT, objektet e lejuara në këto sisteme janë specifikisht: *Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale sipas legjislacionit të posacem sektorial*. Por, referuar këtij vendimi, pika 6 e tij, bashkia Vlorë në kundërshtim me këtë vendim nuk ka kërkuar konformitet nga AZHT dhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë pajisjes me Leje Ndërtimi, duke anashkaluar detyrimet ligjore e duke miratuar kështu një leje në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, shpjegimi se është marrë konformitet në fazën e aplikimit për leje zhvillimi nga AZHT nuk mund të pranohet, pasi në shkresën me nr.3073 prot. datë 16.12.2019 AZHT ka dhënë përputhshmëri vetëm për procedurën e shqyrtimit të aplikimit për pajisje me Leje Zhvillimi, institucion që shprehet se:

.....sipas fushës së kompetencës, me vazhdimin e procedurave për shqyrtimin dhe vlerësimin e këtij projekt-propozimi për pajisjen me Leje Zhvillimi, në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara në Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit si dhe marrjen e konfirmimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të VKM-së Nr. 283, datë 01.04.2015...

MBZHR me shkresën nr.9547 prot. datë 13.12.2019, nuk ka dhënë konfirmim për zhvillimin në zbatim të Vendimit nr.12 i KKT datë 27.02.1019 *“Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB) , Bujqësor (B) dhe Natyrore (N)”,* e shprehet se:

....Referuar dokumentacionit tekniko-ligjor bashkëlidhur aplikimit online, certifikatës së pronësisë, vihet re se objekti që ju do të ndërtoni nuk është i parashikuar të ndërtohet mbi “tokë bujqësore”, por mbi tokë “truall”. Sa më sipër Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk do të shprehet për përputhshmërinë e projekt propozimit “Kapanon për rritje dhe mbarëshitim shpendësh” me vendndodhje në fshatin Shushicë

Pra shpjegimi se është marrë konfirmimi nga MBZHR nuk pranohet, pasi kjo Ministri nuk është shprehur për përputhshmërinë.

4. Përsa i përket shpjegimit se paraqitja e gjendjes faktike në fragmentin e rilevimit, si kërkesë ligjore e nenit 15 të VKM 408/2015, është detyrim i topografit, është detyrë e Drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit në cdo bashki të kryejë kontrollin e dokumentacionit dhe të kërkojë ndryshime, plotësime apo shpjegime sipas rastit, në zbatim kjo të Nenit 14 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar. Pra shpjegimi juaj se nuk është verifikuar gjendja faktike mbi të cilën hartohet më tej planvendoja e cila miratohet, pasi është detyrë e topografit, nuk mund të merret në konsideratë.

Për sa më sipër, miratimi i lejes së ndërtimit Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, pra mungesa e konformitetit nga MBZHR si edhe

miratimi me një fragment relievi të pasaktë në kundërshtim me VKM 408/2015 e ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi z.K. M. dhe z.F. D. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 583, datë 13/10/2020 për objektin “Rindërtim i volumnit 3 kate me shtim bodrumi, volumni anesor dhe shtese kati me funksion hoteleri” ne Lagjen "Uji i Ftohte", Vlorë me zhvillues S. A.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN290920200073, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Nr.583,datë 13/10/2020 për objekt òRindërtim i volumnit 3 kate me shtim bodrumi, volumni anesor dhe shtesë kati me funksion hoteleriò është konstatuar se:

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të Vlerësimit paraprak mjedisor, madje nuk i është kërkuar mendim institucionit të AKM nëpërmjet platformës elektronike të e-lejeve, gjithashtu dhe nuk është kërkuar mendimi i asnjë institucioni tjetër mendimdhënës, si OSHEE, UKV,ASHK nuk ka shprehur mendim etj., duke shkelur dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, si edhe kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuria që merr pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore VL.UB.3.1601 me kategori Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime sersonale, qendra lokale multifunkionale etj pasi madhësia minimale e parcelës për zhvillim sipas përcaktimeve të planit është 1000m2, ndërsa kjo leje nuk e plotëson këtë kusht, pasi sipërfaqja e parcelës për zhvillim është 472.5 m2.

- Objekti i miratuar nuk është pajisur me Leje zhvillimi, në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe Nenin 9 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

- Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor, lindor dhe verior duke mos përmbushur kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas së cilës distanca për volumnin 3 kt. duhet të ruante distancën nga kufiri i pronës 4m ndërsa për volumnin 4kt. duhet të ruajë distancën 5m nga kufiri i pronës.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkaluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, janë cënuar standardet mjedisore, rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN290920200073, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Nr.583,datë 13/10/2020 për objekt òRindërtim i volumnit 3 kate me shtim bodrumi, volumni anesor dhe shtesë kati me funksion hoteleriò subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Në lidhje me tejkalimin e kompetencës për miratimin e një leje rindërtimi me shtesë volumesh në zonën e brezit bregdetar si dhe mos marrjen e konformitetit nga AZHT është dhënë shpjegimi se sipas hartës së njërive strukturore me kodin 18i, pjesë përbërëse e PPV Bashkia Vlorë, ky objekt nuk është pjesë e brezit bregdetar dhe sa më sipër Bashkia Vlorë i kërkon mendim për dhënie konformiteti AZHT-së vetëm për objekte mbi 9 kate sipas Nenit 45/2 te VKM 408/205 e ndryshuar.

2. Në lidhje me marrjen e mendimeve të institucioneve mendimdhënëse, subjekti i audituar ka konsideruar se për objekte shtesa dhe rikonstruksione deri 250m² nuk duhet të kërkohet mendim.

3. Në lidhje me mungesën e VNM paraprake shpjegon se ndodhet raporti i vleresimit në e- leje i firmosur nga ekspert i licensuar, ndërsa për projektet e instalimeve dhe mendimin e tyre, subjekti i audituar shpjegon se në zbatim të nenit 15 të VKM 408/2015 i ndryshuar, për objekte me sip. deri ne 250m² nuk kërkohen dhe objekti ka qenë ekzistues.

4. Përsa i përket gjetjes së shkeljes së kriterit për parcelën minimale nuk plotësohet, subjekti i audituar shpjegon se objekti është rikonstruksion me shtesë volumesh, sipas nenit 54 pika 3e e dokumentit të rregullores së PPV Bashkia Vlorë.

5. Për gjetjen se leja e ndërtimit është miratuar pa pajisje me Leje Zhvillimi, subjekti i audituar i referohet nenit 54 të vkm 408/2015, duke e konsideruar këtë projekt propozim si rikonstruksion dhe jo rindërtim.

6. Përsa i përket respektimit të distancave nga kufiri i pasurisë, subjekti i audituar shpjegon se objekti 3 kat konsiderohet si ekzistues, ndërsa sqaron se volumi 4 kate respekton distancën në veri dhe perëndim. Në Jug volumi 4 kate ka ruajtur distancën nga rruga.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN290920200073 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo në zonën e rëndësisë kombëtare sipas Vendimit nr.1/2018 të KKT qëndrojnë dhe merren në konsideratë.

2. Përsa i përket llojit të projekt propozimit: është një shembje që shoqërohet me ndërtim të ri të një objekti me volum dhe pamje të ndryshme nga ai që ekzistonte, madje edhe me kat nëntokë, pra nuk kemi të bëjmë me rikostruksion me shtim volumi. Si rrjedhojë referimi nga ana e subjektit të audituar si objekt rikonstruksioni me shtim volumi, nuk është i saktë.

Sipas nenit 2 të VKM408/2015 e ndryshuar shpjegohen termat:

“Punime rikonstruksioni”, punimet që konservojnë, konsolidojnë apo transformojnë objektin ekzistues përmes punimesh sistematike, ku objekti që i nënshtrohet rikonstruksionit mund të pësojë ndryshime, ku përfshihen zëvendësimi, eliminimi, ndryshimi i pjesëve strukturore të tij dhe elementeve të reja. Pra objekti konservohet, nuk shembet tërësisht.

“Rindërtim”, punimet që konsistojnë në prishjen dhe rindërtimin me të njëjtin vëllim dhe formë të objektit të mëparshëm. Objekti i miratuar nuk ruan të njëjtin vëllim dhe formë, për sa më sipër nuk mund të konsiderohet rindërtim.

Sa u shpjegua , referimi si rikonstruksion nuk është i saktë, pra edhe shpjegimet për mosmarrjen e mendimit të institucioneve si OSHEE, UKV, MZSH, AKM nuk konsiderohen të sakta, e për pasojë nuk merren në konsideratë.

3. Përsa i përket pretendimit se objekti nuk i nënshtrohet Vlerësimit paraprak mjedisor, sqarohet se në zbatim të ligjit 10440/2011 neni 8 shtojca 2 pikën 10b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë ky projekt duhet detyrimisht të nënshtrohet këtij vlerësimi nga AKM.

4. Duke qenë një ndërtim i ri detyrimisht duhet të pajiset paraprakisht me Leje zhvillimi.

5. Në lidhje me respektimin e distancave, ato duhet të respektohen si një projekt propozim i ri, meqenëse objekti ekzistues është shembur.

Sa më sipër, shpjegimet nuk merren në konsideratë.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 583, datë 13/10/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.K. M. dhe z.F. D..

Titulli gjetjes-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 175, datë 14/04/2020 për “Objekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokë” me adresë Rruga “Dhimitër Konomi”, Vlorë, me zhvillues “H. P.”shpk.

Situata -Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN110820200059 , për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 540, datë 23/09/2020 për 8Objekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokë është konstatuar se:

▪ Objektet e miratuara nuk plotësojnë kushtet për distancat nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar :

Për objektin A nuk plotësohen distancat në lindje dhe në jug, pasi për objekt 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 9m dhe jo 0m e 2.5m në jug , si edhe $2.5m \div 4.6m$ në lindje.

Për objektin B nuk plotësohen distancat në perëndim dhe në jug, pasi për objekt 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 9m, dhe jo 0m e 2.89m në perëndim, si edhe $0m \div 3m$ në jug.

▪ Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri- tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është hartuar e miratuar me faqe kallkan për pjesën jugore të objektit A, pa asnjë informacion lidhur me çarjet në faqet e objektit 8 katësh në kufirin jugor të pronës, veprim ky totalisht i kundraligjshëm pasi nuk respekton përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 9m nga ky kufi.

▪ Objektet e miratuara nuk plotësojnë kushtet për distancat nga objektet kufitare në zbatim të Nenit 34 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar:

Për objektin A nuk plotësohen distancat në jug, pasi për 2 objekte me lartësi 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 16m dhe jo 0m.

Për objektin B nuk plotësohen distancat në perëndim, pasi për 2 objekte me lartësi 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 16m dhe jo 13.3m.

▪ Formulari i lejes dhe të dhënat e paraqitura në planvendosjen e objektit nuk janë të sakta, pasi sipërfaqja e ndërtimit mbi tokë është 10218 duke realizuar në $I=3.1$.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN110820200059, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 540, datë 23/09/2020 për òObjekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokëo, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket zonës me rëndësi kombëtare si Brezi bregdetar i miratuar me Vendim nr.1/2018 të KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk është njohur zyrtarisht me hartën ku përcaktohet ky brez, deri me datën 27.04.2020. Drejtoria e Planifikimit Bashkia Vlorë ka kërkuar konformitetet vetëm për ato objekte që ndodheshin brenda zonës së konsideruar bredetare sipas hartës 18i të PPV Bashkia Vlorë.

2. Si më sipër, në mungesë të marrjes dijëni për Vendimin nr.1/2018 si dhe në mungesë të marrjes dijëni për ndryshimet ligjore të VKM 408/2015 konkretisht VKM Nr. 693, datë 2.10.2019 òPër disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò, të ndryshuar, sipas së cilës cdo zhvillim i propozuar në zonën e brezit bregdetar është kompetencë e KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk ka kërkuar konformitetet për objekte me lartësi më të ulët se 9 kate.

3. Përsa i përket faqes kallkan të objektit A, është propozuar faqe kallkan në vijim të situatës urbane të krijuar, referuar Nenit 72 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë.
4. Përsa i përket distancave në drejtim të rrugës, është ruajtur distanca me trupin e rrugës dhe jo me objektet apo kufirin e pasurisë. Për objektin A në lindje dhe objektin B në perëndim ka propozim rruga Gjykatë-Akademia e Marinës-7 Pallatet , propozim ky ka gjerësi max 15m së bashku me trotuare, duke diktuar distancë 3m, nga trupi i rrugës.
5. Në drejtimin Jugor për objektin B është ruajtur distanca me objektet kufitare, sipas nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar, që të mos çenohej zhvillimi i parcelës së propozuar për ndërtim.
6. Përsa i përket koeficientit të shfrytëzimit të pasurisë, është ruajtur ajo që përcaktohet nga PPV Bashkia Vlorë, duke krijuar mundësi për hapësira publike. Duke shpjeguar që pronarët e tokës nuk kanë pranuar para për shpronësim, duke favorizuar hapësirat rekreative në investimin e rrugës òGjykatë-Akademia e marinës-7 pallatetö.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH:Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, shpjegimi juaj qëndron duke u marrë në konsideratë.
2. Përsa i përket faqes kallkan të objektit A, është propozuar faqe kallkan në vijim të situatës urbane të krijuar, referuar Nenit 72 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, ky koment do të merret në konsideratë.
3. Në lidhje me distancat e tjera, ligji është i krijuar i tillë që të krijohen sa më tepër hapësira të mirëshfrytëzuara gjatë zbatimit, për këtë arsye distanca duhet të ruhet me elementin më shtrëngues duke krahasuar atë me kufirin e pronës, apo atë me objektet e tjera. Pra komenti juaj se në jug objekti B ka ruajtur distancën me objektin kufitar, nuk mund të merret në konsideratë.
4. Distancat me rrugën në propozim janë ruajtur, pra komenti juaj merret në konsideratë.
5. Nga ana jonë si auditues, është gjetur se me këtë leje ndërtimi nuk është respektuar I_{max} i lejuar. Per sa më sipër ju nuk keni dhënë shpjegime për këtë çështje.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M. dhe z.F. D.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 584, datë 25/09/2019 për “Godinë banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me një kat parkim nën tokë” me adresë Rruga "Mustafa Bello", Vlorë, me zhvillues “A.”shpk., në pronësi të K. C., V. C., E. C., Sh. M.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN080720200016 dhe nr.1240 prot. datë 08.07.2020 , për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 578, datë 09/10/2020 për òGodinë banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me një kat parkim nën tokëö

▪ Kjo leje, është lëshuar në mungesë të miratimit nga ana e Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, e cila me shkresën e saj nr.1240 prot. Datë 12.08.2020 shprehet se: *Lutemi të ngarkoni në sistemin elektronik të lejeve brenda afateve të përcaktuara “Projektin e MKZ”-së sipas udhëzimit 425, datë 24.07.2015 dhe aktet që provojnë pagimin e taksës së Miratimit të Projektit të MKZ-së, në mënyrë që të procedojmë me dhënien e lejes dhe Miratimin e Projektit të MKZ-së.*

duke shkelur kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, si edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe shpëtimin, duke cënuar me këtë veprim sigurinë e banorëve në objekt.

▪ Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës dhe nga objektet ekzistuese, në zbatim të nenit 34 dhe 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në përfundim, pasi për objekt 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 9m nga kufiri i pronës, dhe jo 0.5m, 1.7m dhe 3.3m. Në përfundim gjithashtu nuk plotësohet distanca nga objekti ekzistues 4kate. Kjo distancë është miratuar 10m, ndërkohë duhet të ishte parashikuar 14m.

Nuk plotësohen distancat në veri nga kufiri i pasurisë si edhe nga rruga "Mustafa Bello" në zbatim të Nenit 35 dhe 36 të VKM 408/2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar pasi për objekt 8 kate kjo distancë nga kufiri i pronës duhej të ishte 9m dhe jo 0.2m dhe 1.0m. Ndërsa nga trupi i rrugës, ku përfshihen edhe trotuarët duhej të ishte minimalisht 3m nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e rrugës (konsoli). Në këtë projekt-propozim kjo distancë nuk është respektuar duke shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN080720200016 dhe nr.1240 prot. datë 08.07.2020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 578, datë 09/10/2020 për "Godine banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me një kat parkim nën tokë", subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket zonës me rëndësi kombëtare si brezi bregdetar i miratuar me Vendim nr.1/2018 të KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk është njohur zyrtarisht me hartën ku përcaktohet ky brez, deri me datën 27.04.2020.

2. Përsa i përket miratimit në mungesë të konformitetit të AZHT, sic ka sqaruar edhe në pikën 1, subjekti i audituar shpjegon se i është referuar miratimit të lejes sipas PPV Bashkia Vlorë dhe hartës me kodin 18i Harta e njësive strukturore. Dhe në zbatim të Nenit 45/2 kërkon mendim nga AZHT vetëm për objekte 8 kate.

3. Subjekti i audituar, në lidhje me mungesën e projektit të MKZ dhe pagesës së faturës për tarifën e këtij shërbimi, shpjegon se ka patur gabime në llogaritjen e faturës si rrjedhojë e ristrukturimit, Gjithashtu sqaron se projekti i MKZSH ndodhet i aplikuar dhe shpjegon se subjekti zhvillues do të njoftohet nga ana e Bashkisë Vlorë për shlyerjen e detyrimeve dhe marrjen e miratimit prej tyre.

4. Subjekti i audituar në lidhje me gjetjet e dala nga auditimi i kësaj çështje shpjegon se: Në përfundim janë ruajtur distancat nga rruga ekzistuese dhe jo objekt kufi prone. Gjithashtu edhe në veri në drejtim të rrugës "Mustafa Bello" është ruajtur distanca sipas Vijës së kuqe të ndërtimit, duke u bazuar në Nenin 47 Rregullores së PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim të KKT nr.1 datë 16.10.2017, për justifikimin e distancave nga konsolat, të cilat në zbatim të pikës 5 të Nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar shprehimisht: *5. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër, i referohen nenit 47 të PPV bashkia Vlorë, Vija e ndërtimit, pika 1, 2 dhe 3.*

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN080720200016 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21, i cili Ju është vënë në dipozicion, shpjegimi merret në konsideratë.

2. Shpjegimet tuaja në lidhje me mungesën e projektit të MKZ, e cila është kërkuar edhe nga Sektori PMNZSH Bashkia Vlorë nëpërmjet e-lejeve me shkresën e saj nr.1240 prot. datë 12.08.2020 ku shprehet se: *Lutemi të ngarkoni në sistemin elektronik të lejeve brenda afateve të përcaktuara "Projektin e MKZ"-së sipas udhëzimit 425, datë 24.07.2015 dhe aktet që provojnë pagimin e taksës së Miratimit të Projektit të MKZ-së, në mënyrë që të procedojmë me dhënien e lejes dhe Miratimin e Projektit të MKZ-së.* Për këtë arsye shpjegimi juaj mbi mangesinë e pagesës nuk mund të merret parasysh, pasi miratimi i lejes së ndërtimit pa konfirmim nga MZSH Bashkia Vlorë, përbën shkelje të procedurave ligjore të miratimit të një leje duke cuar në një vendimmarrje të jashtëligjshme. Nga ana juaj, në mungesë të aksesit te MZSH Vlorë në sistemin e e-lejeve, mund të kryhej një korespondencë shkresore brenda institucionit, për të mos penalizuar aplikuesin.

3. Përsa i përket gjetjeve mbi mosrepektimin e distancave në pjesën perëndimore dhe veriore dhe shpjegimi se këto distanca janë ruajtur nga trupi i rrugës, shpjegojmë se në zbatim të pikës 5 të Nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar shprehimisht: *5. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër,* distanca në pjesën veriore ku ju shpjegoni se është ruajtur nga trupi i rrugës dhe faqes së objektit, përsëri nuk është e plotësuar pasi nuk është ruajtur nga konsoli, në zbatim të nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar.

Në pjesën perëndimore ashtu sic edhe shpjegohet nga ju sipas pikës 3 të Nenit 36 shprehimisht thuhet se : *"...përcaktohen në bazë të gjendjes faktike të trupit të rrugës, por në çdo rast, jo më pak se përcaktimi ligjor në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme për trupin e rrugës dhe, nëse nuk përcaktohet ndryshe në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"*

Pra distanca 0.5 nga trupi i rrugës ku përfshihen edhe trotualet, është në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Kjo distancë duhej të ishte minimalisht 3m. Shpjegimet tuaja në lidhje me ruajtje e distancës nga trupi i rrugës, nuk pranohet, pasi edhe në këtë rast distancat janë shkelur si në drejtimin perëndimor, ashtu edhe në atë verior.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M. dhe z.F. D.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për "Godinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokë" me adresë Lagjia "Pavarsia" Rr."Gjergj Arianiti" dhe Rr."Faik Konica" Vlorë, me zhvillues H. M. dhe V. M.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN160420200036 dhe nr.984 prot. datë 16.04.2020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 508, datë 04/09/2020 për òGodinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokë, u konstatua se:

▪ Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në jug, pasi për objekt 8 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 9m nga kufiri i pronës. Objekti në anën jugore madje është propozuar jashtë konturit të pasurisë, në shkelje flagrante të ligjit.

Në Lindje gjithashtu nuk plotësohet distanca nga kufiri i pasurisë. Kjo distancë është miratuar 2m, ndërkohë duhet të ishte parashikuar 9m.

▪ Nuk plotësohen distancat në jug nga rruga òGjergj Arianitiò duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar

pasi sipas pikës 3c) të këtij neni për rrugë mbi 15m gjerësi së bashku me trotuaret, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit (konsoli) duhet të jetë minimalisht 4m. Leja e miratuar këtë distancë e ka 0m nga konsoli.

Nuk plotësohen distancat në lindje nga rruga òFaik Konicaò duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar pasi sipas pikës 3b) të këtij neni për rrugë 7m-15 m gjerësi së bashku me trotuaret, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit (konsoli) duhet të jetë minimalisht 3m. Sipas planvendosjes së miratuar kjo distancë është 0.0m nga konsoli, duke **shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike** dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës nr. 948, datë 27.08.2020, dërguar nga komisioni i llogaritjes të taksës së ndikimit në infrastrukturë, i përbërë nga znj. N. R. me detyrë llogaritare, z. K. M. me detyrë Kontrollues, z. F. D. me detyrë Drejtues, i janë drejtuar z. N. J. në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë brenda afatit prej 15 ditësh. Kjo taksë është paguar me mandate arkëtimi nr. 609, datë 27.08.2020 nga H.& V. M., në shumën 5,218,703.88 lekë (0.04*130,467,597 lekë), në degën e Tirana. Bank., Vlorë po në datën 27.08.2020. Referuar projektit arkitektonik, rezulton se sipërfaqja totale e godinës mbi tokë është 1,680.9 m² (kt1+kt2+kt3+kt4+kt5+kt6+kt7), Kati përdhe (shërbim) është 324.2 m², ndërsa kati nëntokë (parkim) është 295.7 m². Duke rillogaritur vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton:

1,680.9 * 61,800=103,879,620 lekë

324.2 * 92,700=30,053,340 lekë

295.7 * 43,260=12,791,982 lekë

Në total, vlera e të gjithë objektit është 146,724,942 lekë, ndërkohë llogaritja sipas taksës është bërë për vlerën 130,467,597 lekë, nga ku është paguar shuma prej 5,218,703.88 lekë. Sa më sipër duke kryer llogaritjet përkatëse do të kishim 146,724,942*0.04=5,868,998 Lek. Diferenca prej **650,294 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik.**

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për òGodinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokëò, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njërive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë cështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi.

2. Përsa i përket miratimit në mungesë të konformitetit të AZHT, sic ka sqaruar edhe në pikën 1, subjekti i audituar shpjegon se i është referuar miratimit të lejes sipas PPV Bashkia Vlorë dhe hartës me kodin 18i Harta e njërive strukturore, dhe nenit 45/2 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas të cilit : *Neni 45/2 _ Aktet e konformitetit nga KKT-ja Për çdo aplikim për leje ndërtimi për objektet mbi 9 kate, autoritetet vendore të zhvillimit në çdo rast duhet të marrin paraprakisht aktin e konformitetit nga KKT-ja. Procedura për dhënien e aktit të konformitetit përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.*

3. Subjekti i audituar ka dhënë shpjegime se bazuar në nenin 47 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, ka ruajtur distancat me vijë ndërtimi në drejtim të rrugëve òGjergj Arianitiò në Jug dhe òFaik Konicaò në Lindje, duke e justifikuar këtë zgjidhje me situatën e formuar urbane në terren. Gjithshtu sqarohet nga grupi i audituar se distancat nuk janë ruajtur nga konsoli si vijë

ndërtimi në drejtim të rrugës, por nga faqja e objektit duke e bazuar këtë qëndrim në nenin 47 të rregullores së PPV pika 2, ku *faqja e strukturës nënkupton trupin e përgjithshëm të strukturës dhe jo elementët pjesorë volumetrikë si konsolat e ballkoneve etj, me kushtin që mos tejkalojnë 50% të sipërfaqes totale të një faqe fasade.*

4. Për gjetjen mbi përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me vlerë 650,294 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik, në faqen 63 të observacionit është shpjeguar se në katet ku ka terheqje, aiperfaqet e taracave nuk janë marrë në konsideratë.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN160420200036 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 i cili Ju është vënë në dipozicion, është sqaruar shumë saktë se kompetenca për vendimmarrjen e kësaj leje është e KKT në zbatim të Pika 3ç të Nenit 19 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar, miratuar me VKM Nr. 693, datë 2.10.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar ku bëhet fjalë për zonën e brezit bregdetar , i cili prfshihet në vendimin nr.1/2018 të KKT, si zonë me prioritet turizmin, zonë e rëndësisë kombëtare. Shpjegimi juaj se i referoheni hartës me kod 18i, dhe legjendës së saj, e nuk i referoheni akteve ligjore eprore, pranohet.

2. Përsa i përket gjetjeve mbi mosrepektimin e distancave në pjesën Jugore dhe lindore, në drejtim të rrugëve òGjergj Arianitiò në Jug dhe òFaik Konicaò në Lindje, dhe shpjegimi se këto distanca janë ruajtur nga trupi i rrugës, merret në konsideratë. Por objekti i miratuar edhe duke konsideruar distancat me trup rruge (ku përfshihen edhe trotuaret) nuk kanë respektuar kërkesat sipas pikës 5 të Nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar shprehimisht: *5. Për ndërtimet gjatë rrugëve, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat e këtij neni elementet arkitektonike të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër.* Distanca e objektit nga rruga òGjergj Arianitiò ka shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar pasi sipas pikës 3c) të këtij neni për rrugë mbi 15m gjerësi së bashku me trotuaret, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit (konsoli) duhet të jetë minimalisht 4m. Leja e miratuar këtë distancë e ka 0m nga konsoli.

Nuk plotësohen distancat në lindje nga rruga òFaik Konicaò duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar pasi sipas pikës 3b) të këtij neni për rrugë 7m-15 m gjerësi së bashku me trotuaret, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit (konsoli) duhet të jetë minimalisht 3m. Sipas planvendosjes së miratuar kjo distancë është 0.0m nga konsoli. Shpjegimet tuaja, përsa i përket distancave të objektit dhe ruajtjes së kondicioneve urbane në përputhje me ligjin, nuk merren në konsideratë.

3. Për gjetjen mbi përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me vlerë 650,294 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik, dhe shpjegimet se sipërfaqet janë marrë sipas matjeve dhe llogaritjeve që ka bërë arkitekti, sqarojme së taracat që mbeten nga tërheja e volumit, janë sipërfaqe që shfrytëzohen nga banorët, dhe nuk janë të pashfrytëzueshme. Për sa shpjeguam, këto sipërfaqe duhet të merren në konsideratë në tanksën e ndikimit në infrastrukturë. Sqarimet e dhëna nga llogaritari N. R. nuk merren në konsideratë.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi zj. N. R., z.K. M. dhe z.F. D. drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetje: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për “Kompleks shtëpish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë” me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues “H. P.”sh.p.k.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN050220200041 dhe nr.984 prot. datë 16.04.2020, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 865 prot. datë 05/02/2020 për òKompleks shtëpish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë, u konstatua se:

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat nga kufiri i pronës, në zbatim të Nenit 35 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar:

Nuk plotësohen distancat në veri (objekti 3) largesi e propozuar 1m, ndërkohë që për objekt 3 kate kjo distancë duhej të ishte minimalisht 4m nga kufiri i pronës.

- Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri -tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdo lloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në perëndim, duke cënuar dhe mohuar mundësinë e zhvillimit të pasurisë kufitare, duke shkelur edhe përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 4m nga kufiri i pronës.

- Objekti i miratuar me këtë vendimmarrje nuk plotëson kushtet për distancat e objekteve në raport me njëri-tjetrin, të cilët duhej të distancoheshin minimalisht 8 m nga njëri-tjetri në zbatim të Nenit 34 të VKM 408/2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, duke shkelur kështu dispozitat ligjore dhe duke cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore VL.UB.1.1490 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime, zonë tregtare dhe biznesi dhe shtëpi të dyta, pasi është shkelur intensiteti i lejuar prej $I=1.6$, duke tejkuluar sipërfaqen e ndërtuar të lejueshme. Në planvendosje nuk janë shënuar të gjithë sipërfaqet e përdorura për banim dhe shërbime.

- Kjo leje është lëshuar në mungesë të oponentit teknik, duke shkelur nenin 6 të ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 òPer kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar, sipas të cilit: *ò...Oponenti teknik për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve....”.*

Vlera e preventuar e këtyre objekteve është 226,877,469.8 lekë.

Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës nr. 865 prot, datë 26.05.2020 i është drejtuar M. K. lidhur me pagesën e taksës në infrastrukturë për shumën 20,886,926.48 lekë, pagesë e cila është kryer nëpërmjet tre Bankave, konkretisht, në O. B. në shumën 6,190,000 lekë, datë 26.05.2020, B. B. në shumën 6,397,026 lekë, datë 26.06.2020 dhe C. B. në shumën 8,300,000 lekë, datë 26.05.2020. Referuar projektit arkitektonik, konkretisht sipërfaqeve të planimetrive të godinave, në kuotat -6.20, -3.30, +0.00, +3.30, +6.40, +6.60, +9.60, +9.90, rezulton si më poshtë:

Sip. totale banimi + Sip. totale banimi e përbashkët = 8,312 m².

Sip. totale parkim nëntokë = 1,101 m².

Sa më sipër duke kryer veprimet e nevojshme në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë do të kishim:

$8,312 * 61,800 = 513,681,600$ lekë

$1,101 * 43,260 = 47,629,260$ lekë

Sa më sipër, vlera totale e projektit të paraqitur për ndërtim është 561,310,860 lekë (kosto). Për taksën prej 4% për ndikimin në infrastrukturë, zhvilluesi duhet të kishte paguar shumën 22,452,434 lekë. Duke zbritur shumën 20,886,926.84 lekë, e cila është paguar nga zhvilluesi, rezulton një diferencë prej **1,565,508 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkuluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për oKompleks shtepish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësisë strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket zonës me rëndësi kombëtare ku përfshihet edhe brezi bregdetar i miratuar me Vendim nr.1/2018 të KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk është njohur zyrtarisht me hartën ku përcaktohet ky brez, deri me datën 27.04.2020.

2. Përsa i përket miratimit në mungesë të konformitetit të AZHT, sic ka sqaruar edhe në pikën 1, subjekti i audituar shpjegon se i është referuar miratimit të lejes sipas PPV Bashkia Vlorë dhe hartës me kodin 18i Harta e njësisë strukturore, duke zbatuar nenin 45/2 të Ligjit 107/2014 i ndryshuar, i kërkon mendim AZHT vetëm për objekte mbi 9 kate.

3. Për gjetjen se nuk plotëson distancën në anën veriore subjekti i audituar ka shpjeguar se kjo distancë është ruajtur nga një rrugë ekzistuese, interurbane dytësore, me gjerësi maksimale 10m. Duke iu referuar nenit 36 të VKM 408/2015. Gjithashtu ka marrë parasysh edhe trupin e rrugës së re në propozim oRikonceptim i rrugës Vlorë-Orikumö, ku kjo distancë është 12.33 m2 nga rruga ekzistuese.

4. Përsa i përket propozimit kallkan në perëndim, kjo shpjegohet me faktin se synohet zhvillimi i një faze të dytë e cila do zhvillohet po nga i njëjti zhvillues, dhe do ketë vijimësi objektsh.

5. Përsa i përket tejkalimit të intensitetit maksimal të lejuar $I_{max}=1.6$ sipas VL.UB.1.1490, është dhënë shpjegimi se në sipërfaqe kati nuk futen ballkonet, taracat etj, sipas nenit 35 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, dhe shpjegon se në llogaritjen e intensitetit në zbatim të nenit 37 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë,

6. Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë shkaktimin e të ardhurave të munguara, nga subjekti i audituar shpjegohet se janë 3062 m2 ndërtim parkim dhe 6304.72 m2 banim.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN050220200041 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 shpjegimi merret në konsideratë.

2. Në lidhje me mosrespektimin e distancës nga trupi i rrugës, konstatohet se kjo distancë është më pak se 2.5m nga një rrugë me gjerësi mbi 15 m (qoftë kjo rrugë e propozuar), pra shpjegimi juaj nuk mund të merret në konsideratë.

3. Në lidhje me tejkalimin e intensitetit maksimal të lejuar për njësinë strukturore VL.UB.1.1490, ku ju shpjegoni se nuk tejkalohe ky tregues, komenti juaj nuk merret në konsideratë, sepse:

Bazuar në rregulloren e PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, neni 37 Intensiteti maksimal i lejuar për zonën

Instensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për cdo njësi strukturore është i barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e

sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e intensitetit për njësinë nuk përfshihen rrugët (KSHR) dhe hapësirat publike (KSHP). Sipas nenit 39, KSHR është gjithmonë 10% e sipërfaqes totale të zonës Sipas nenit 40 KSHP është minimalisht 20% e sipërfaqes totale të zonës. Sa më sipër parcela e ndërtueshme është minimalisht 30% më pak se sipërfaqja totale e pronës. Në këtë kontekst intensiteti maksimal i lejes së miratuar, tejkalon intensitetin maksimal të lejuar. Shpjegimet tuaja nuk mund të konsiderohen të mirëqena.

4. Përsa i përket llogaritjeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga projekti arkitektonik, i aplikuar dhe i depozituar ne format elektronik se bashku me këtë observacion, nga pamjet e fasadës, vihet re se taracat janë plotësisht të shfrytëzueshme, arësye kjo që duhej të futeshin në llogaritje.

Komenti se sipërfaqja e katit nëntokë parkim nuk është 1011 pranohet. Nga matjet në *dëg kjo sipërfaqe është 3111m².

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A., z.K. M., z.F. D. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 108, datë 27/02/2020 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 651, datë 23/10/2019 për “Objekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifiniture” me adresë Nartë, Vlorë.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN061220190041 dhe nr.744 Prot. datë 06.12.2019, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 108, datë 27/02/2020 për Objekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifinitureö, u konstatua se:

▪ Në kundërshtim me nenin 45 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ðPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar Bashkia Vlorë ka tejkaluar kompetencat e vendimmarrjes pasi miratimi i lejes së ndërtimit në zonën e brezit bregdetar ku përfshihen pasuria nr. 105/19 dhe ZK 2765 si një zonë e rëndësisë kombëtare është kompetencë e KKT-së, jo e Bashkisë Vlorë.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë tejkaluar kompetencat nga ana e Bashkisë Vlorë, nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN061220190041 dhe nr.744 Prot. datë 06.12.2019, për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.108, datë 27/02/2020 për Objekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifinitureö, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Në zbatim të nenit 45/2 të VKM 408/2015 e ndryshuar, bashkia Vlorë kërkon konformitet për objekte mbi 9 kate.

2. Përsa i përket mungesës së përputhshmërisë nga AZHT, Subjekti i audituar nuk ka dhënë shpjegime. Por ka dhënë shpjegimin se Agjencia e Zonave të Mbrojtura ka pranuar në heshtje.

3. Subjekti i audituar shpjegon se përdorimi i objekti është magazinë , e cila është në përputhje me PPV Bashkia Vlorë, njësia strukturore QE.UB.13.1683 me kategori kryesore IE.Industri Ekonomi.

4. Subjekti i audituar ka shpjeguar se rruga Vlorë-Fier nuk bën pjesë tek zonat e mbrojtura , dhe nuk ka kërkuar mendimin e AZM. Sqaron edhe se ka marrë dakortësinë e ARRSH.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN061220190041 është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, tek akt-konstatimi nr.21, i cili Ju është vënë në dipozicion, pretendimi pranohet.

2. Në lidhje me konformitetin nga AZHT, subjekti i audituar ka shpjeguar se në zbatim të nenit 19, kjo nuk është një projekt propozim kompetence e KKT. Kompetenca e KKT rrjedh si pasojë e pozicionimit brenda brezit bregdetar në zbatim të Pika 3ç të Nenit 19 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar.

Sa më sipër për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim Nr. Nr. 108, datë 27/02/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.S. A., z.K. M. nëpunës, dhe z.F. D. ish drejtues i DPKZHT.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 676, datë 05/11/2019 për objekt Objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime me adresë Lagjia “Pavarësia” Vlorë, me zhvillues N. L.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me numër AN160120200054 nr.818 prot. datë 16.01.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 81, datë 13/02/2020 për objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime, u konstatua se:

- Treguesit e distancave të përcaktuara në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri -tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdojloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është propozuar kallkan në lindje, pa dhënë informacion mbi objektet përballë tij, apo duke cënuar dhe mohuar mundësinë e zhvillimit të pasurisë kufitare, duke shkelur edhe përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet minimalisht 4m nga kufiri i pronës.

- Nuk plotësohen distancat në përfundim nga rruga me gjerësi 7-15m duke shkelur përcaktimet e nenit 36 të VKM 408/2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar pasi sipas pikës 3b) të këtij neni për rrugë deri 15m gjerësi së bashku me trotualet, largësia e faqes më të afërt të ndërtimit duhet të jetë minimalisht 3.0 m. Leja e miratuar ka shkelur dispozitat ligjore për sigurinë rrugore dhe ka cënuar mundësinë e krijimit të hapësirave publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe garantimin e sigurisë individuale dhe shëndetësore.

- Kjo leje është miratuar jo në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim të KKT-së nr. 01, datë 16.10.2017, pasi pasuritë që marrin pjesë në zhvillim ndodhen në njësinë strukturore VL.UB.7.1233 me kategori kryesore A_Banim, me përdorim të lejuar banim dhe shërbime si dyqane, shërbime, zonë tregtare dhe biznesi dhe shtëpi të dyta për arsye se:

- Nuk është respektuar madhësia minimale e parcelës për zhvillim, e cila sipas përcaktimeve të PPV duhej të ishte 600 m², ndërkohë pasuria e cila zhvillohet me nr.28/562 vol.41, fq.86 ka sipërfaqe 365.5m².

- Nga kontrolli në terren, u konstatua se objekti ka përfunduar dhe është vënë në përdorim pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në kundërshtim të legjislacionit në fuqi, duke cënuar sigurinë e banorëve. Gjithashtu, objekti nuk ka zbatuar kondicionet urbane të përcaktuara në vendimmarrje (ka shtuar kat pa leje).

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit:-Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN160120200054 nr.818 prot. datë 16.01.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 81, datë 13/02/2020 për objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi, të përcaktuar në PPV Bashkia Vlorë.
2. Përsa i përket mungesës së përputhshmërisë nga AZHT, Subjekti i audituar shpjegon se kemi të bejmë me rikonstruksion dhe jo leje të re nga fillimi, për këtë nuk kërkohet konformiteti. Gjithashtu edhe fakti që ky objekt nuk propozohet brenda brezit bregdetar sipas hartës së PPV me kodin 18i Njësitë strukturore, nga ana e Bashkisë nuk është kërkuar përputhshmëria.
3. Në lidhje me distancën në lindje, shpjegon se ka marrëveshje me kufitarin që mund të qëndrojë kallkan 1.5 m larg me kufitarin.
4. Për distancën në lindje ka ruajtur 2.5 m për rrugë 7m gjerësi.
5. Objekti është pajisur me leje zhvillimi dhe nuk respekton kriterin e PPV për parcelën minimale të kërkuar, pasi është konsideruar si rikonstruksion me shtim volumi, bazuar kjo në nenin 54 të rregullores së ppv.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar me nr. AN160120200054, është si vijon:

1. Përsa i përket shpjegimeve për pozicionimin ose jo brenda brezit bregdetar, shpjegimi juaj merret në konsideratë.
2. Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri -tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloji në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Shpjegimi juaj se ka kontratë me kufitarin, i cili posedon një banesë me faqe kallkan në këtë drejtim, sqaron situatën. Për sa shpjeguar, komenti pranohet.
3. Objekti 1 kat ekzistues, rezulton se prishet dhe ndërtohet objekt i ri me sipërfaqe dhe vëllim të ndryshëm nga ai ekzistuesi. Sa më sipër, objekti është pajisur me Leje Zhvillimi, dhe duhet të respektohet kërkesat për parcelën minimale.
4. Për përdorimin e objektit pa pajisje me certifikatë përdorimi, si edhe për shtesën e kateve, nuk është dhënë ende një vendim IMT duhet ta ketë në vëmendje. Gjithashtu IMT dhe kryeinspektori janë përgjegjës për shtesën e katit që nuk kanë konstatuar dhe nuk kanë dhënë shpjegim në këtë observacion.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi zj.S. A., z.K. M., z.F. D.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi në emër të aplikantit M. K., me zhvillues L. 2...2 Shpk, me datë aplikimi 12.02.2020 dhe datë dërgimi nga Institucioni i Bashkisë Vlorë 12.05.2020, në Lgj. 11 Janari, me 2 kt mbi tokë dhe 1 kt nën tokë dhe sipërfaqe ndërtimi mbi tokë 5,608 m².

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit rezulton se: Referuar relacionit të paraqitur nga zhvilluesi L. 2...2 Shpk për repart prodhimi, magazinimi dhe shitje produktesh fasonerie, objekt i cili sipas PPV i përket NJS-VL.UB.12.575, Kategoria 1 (IE. Ekonomi dhe Industri), nënkategoria IE. Zona magazinimi dhe tregëtimi/Industri, përdorim i

lejuar IE.2, Zonë tregtare dhe biznesi, VL.UB.11.1174 Kategoria A. Banim, A.4 Zonë Banimi, VL.UB.12.562, Kategoria AR aktivitete sociale dhe rekreative. Sa më sipër, me vendimin nr. 624, datë 09.10.2019 është lëshuar leja e zhvillimit si dokumenti paraprak për dhënien e lejes së ndërtimit, e cila është dhënë me vendimin nr. 208, datë 12.05.2020. Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës 875-1 prot, datë 06.05.2020 i është drejtuar subjektit M. K. lidhur me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për shumën 4,990,092.57 lekë, pagesë e cila është bërë pranë I. S. P. B. në datën 08.05.2020. Referuar projektit arkitektonik, konkretisht sipërfaqeve të planimetrive të godinës në kuototat -5.20, +0.00, +5.40, rezulton se Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 5,608 m², ndërsa sipërfaqja e parkimit nëntokë është 2,720 m².

Duke rillogaritur pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton:

$5,608 * 61,800 * 0.5 = 173,287,200$ lekë

$2,720 * 61,800 * 0.7 = 117,667,200$ lekë

Sa më sipër, totali i ndërtimit (kosto) është 290,954,400 lekë, pra shumë më i lartë nga preventivi me të cilin është llogaritur taksa. Duke kryer veprimet kemi $290,954,400 * 3\% = 8,728,632$ lekë të cilat duhet të pagueshin si taksë ndikimi në infrastrukturë. Pra zhvilluesi ka paguar më pak në shumën **3,738,539 lekë, që përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë, me pasojë dëm ekonomik.**

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme, ngarkohet me përgjegjësi komisioni i llogaritjes të taksës së ndikimit në infrastrukturë, i përbërë nga znj. N. R. me detyrë Llogaritare, z. K. M. me detyrë Kontrollues dokumentacioni, z. F. D. me detyrë Drejtor i DPZHT Vlorë.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin “Objekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrum”, Lagjja Pavarësia, Vlorë me zhvillues “S.” sh.p.k

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN111220200058, për të cilën është marrë vendimi për miratim të lejes së ndërtimit me Nr.63, datë 08/02/2021 për objekt òObjekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumò është konstatuar se:

- Kjo leje, është lëshuar në mungesë të Vlerësimit paraprak mjedisor, madje nuk i është kërkuar mendim institucionit të AKM nëpërmjet platformës elektronike të e-lejeve, duke shkelur dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit si edhe kërkesat sipas nenit 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar.
- Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor, lindor dhe verior duke anashkaluar kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015, e ndryshuar.
- Objekti i miratuar nuk zbaton distancat nga rrugët me të cilat kufizohet në drejtimin jugor dhe lindor, duke anashkaluar detyrimin për zbatimin e Nenit 36 të VKM 408/2015 e ndryshuar, sipas së cilës për gjerësi rruge deri 15m duhej të ruhej distanca minimale prej 3m nga plani më i afërt me kufirin e rrugës (ku përfshihen edhe trotualet), që janë konsolat.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet mjedisore, rrugore dhe të sigurisë së ndërtesave si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë për Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin òObjekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumò, si vijon:

1. Përsa i përket miratimit pa VNM paraprake, subjekti i audituar sqaron se me shkresën 1555/1 datë 15.12.2020 ia ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet platformës e-leje dhe me datë 05.01.2020 ky dokumentacion është plotësuar.

2. Në lidhje me distancat në drejtim të rrugës, subjekti i audituar e ka mbështetur miratimin në ate distancë, duke u bazuar tek Neni 47 pika 2 e Rregullores së PPV Bashkia Vlorë, sipas së cilës *Vija e ndërtimit përcakton pozicionimin e një strukture në raport me kufirin e trupit të rrugës ekzistuese apo të propozuar;*

Pika 3: Faqe e strukturës nënkupton trupin e përgjithshëm të strukturës dhe jo elementët pjesor volumetrik si konsolat e ballkoneve, me kushtin që të mos tejkalojnë 50% të sipërfaqes totale të fasadës.

Pika 4: Nuk lejohet që konsolat të tejkalojnë vijën e ndërtimit në lartësi më të ulët se 5 m nga kuota e trotuarit dhe 1.6m nga faqja e strukturës.

3. Përsa i përket konstatimit për mosrespektim të distancave urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor , ku gjendet nje objekt 8 kate janë respektuar distancat sipas PPV-së Vlorë. Në drejtimin verior ka një pasuri private midis rrugës së miratuar me bllokun e banimit dhe sheshit të ndërtimit, parcelë kjo e cila ka sip.54m2, dhe është përfshirë në zhvillim, me deklaratën noteriale Nr.rep1670 datë 27.05.2020.

Qëndrimet e Audituesve Shtetërorë të KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, në lidhje me çështjen e audituar me nr. AN111220200058 është si vijon:

1. Në lidhje me sqarimin se dokumenti i pajisjes me VNM paraprake është kërkuar dhe plotësuar, u riverifikua çështja në e-leje dhe dokumenti ishte plotësuar, ashtu sic ka sqaruar subjekti i audituar. Pra ky shpjegim do të merret i plotë.

2. Përsa i përket distancave nga trupi i rrugës, në zbatim të Nenit 47 pika 2,3,4 e Rregullores së PPV Bashkia Vlorë, u riverifikua projekti i miratuar arkitektonik, dhe shpjegimet merren në konsideratë.

3. Përsa i përket konstatimit për mosrespektim të distancave urbane nga kufiri i pronës në drejtimin jugor dhe verior nga ana e subjektit të audituar, shpjegimi për distancën në kufirin Jugor nuk pranohet. Ndërsa shpjegimi për distancën nga kufiri i pasurisë në drejtimin verior nuk pranohen, pasi konturi i pasurisë që futet në zhvillim, sipas planvendosjes së miratuar nuk e përfshin pasurinë 28/158 me sip.54m2. Pra, objekti i miratuar nuk i ka respektuar distancat urbane nga kufiri i pasurisë në drejtimin jugor dhe verior.

Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi zj.S. A., z.K. M. dhe z.F. D.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 274, datë 16/05/2019 për “Banese 4 kate dhe 1 kat nen tokë” dhe me Leje Zhvillimi miratuar me Vendim Nr. 1206, datë 20/11/2018 me adresë Lagjia Uji i ftohtë, Vlorë, me zhvillues “H. P.” sh.p.k.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m2, aplikuar me AN310120190001 dhe nr.891 prot. me datë 31.01.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 274, datë 16/05/2019 për objekt òBanese 4 kate dhe 1 kat nën tokë.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë:

Në lidhje me gjetjet e konstatuara nga auditimi i procedurës me AN310120190001 dhe nr.891 prot. me datë 31.01.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 274, datë 16/05/2019 për objekt òBanese 4 kate dhe 1 kat nën tokë, subjekti i audituar ka shpjeguar se:

1. Sipas PPV Bashkia Vlorë miratuar me Vendim nr.1 të KKT datë 16.10.2017, në hartën e njësisive strukturore, harta me kodin 18i është i përcaktuar brezi bregdetar. Sipas kësaj harte objekti i miratuar me këtë çështje të audituar, nuk ndodhet brenda këtij brezi. Përsa i përket zonës me rëndësi kombëtare ku përfshihet edhe brezi bregdetar i miratuar me Vendim nr.1/2018

të KKT, subjekti i audituar shpjegon se nuk është njohur zyrtarisht me hartën ku përcaktohet ky brez, deri me datën 27.04.2020.

2. Përsa i përket marrjes së konformitetit, subjekti i audituar shpjegon se ka marrë konformitet në aplikimin e leje zhvillimi me shkresën nr.2809 prot. datë 14.11.2018.

3. Në lidhje me distancat urbane nga kufiri lindor, subjekti i audituar ka shpjeguar më parë se në kufirin lindor, ka një rrugë të propozuar me gjerësi 7m. Për këtë arsye është ruajtur distanca minimale 2.5m

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar me nr. AN310120190001 është si vijon:

1. Në lidhje me konformitetin, është detyrim ligjor bashkërendimi për marrjen e përputhshmërisë nga AZHT në fazën e lejes së ndërtimit. Komentet tuaja për këtë pikë pranohen.

2. Komenti mbi distancën me rrugën, pranohet.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me VendimNr. 436, datë 11/06/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 335, datë 05/05/2021 për objektin “Ndertim Kompleks per mbareshtim lopesh”, në adresën Bunavi, Vlorë, me zhvillues “M. C. S.” shpk.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes të sipërcituar rezulton se:

▪ Kjo leje është lëshuar **me një përdorim jo të lejuar**, duke shkelur përcaktimet ligjore për kontrollin e zhvillimit të territorit në zbatim të Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të KKT për miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N) sipas të cilit në pikën 1 thuhet se:

1. Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore të miratuara, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N), për objektet e strukturat si më poshtë:

a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;

b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizimit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.

Përdorimi i këtij objekti është stallë për mbarështim gjedhi dhe jo përpunim produktesh bujqësore.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjësit të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente, por kanë dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë me shkresën 731/6 prot. datë 22.11.2021për Leje ndërtimi miratuar me VendimNr. 436, datë 11/06/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 335, datë 05/05/2021 për objektin “Ndertim Kompleks per mbareshtim lopesh”, si vijon:

1. Përsa i përket mungesës së konformitetit nga AZHT, subjekti i audituar shpjegon se ky konformitet është marrë në fazën për leje Zhvillimi, me shkresën nr.1459 prot, e cila është vendosur bashkëlidhur me observimin e subjektit.

2. Përsa i përket mangësisë për pajisje me VNM paraprake, subjekti i audituar shpjegon se ky dokument ndodhet në sistemin e-leje, dhe e bashkëlidhur në këtë observim.

Qëndrimet e Audituesvetë KLSH:-Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar është si vijon:

1. Në lidhje me sqarimin se ky objekt ka marrë konformitetin nga AZHT në fazën e pajisjes me Leje zhvillimi, në zbatim të Vendimit nr.12 i KKT datë 27.02.1019 për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit , në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyrore (N)ö, konformiteti duhej marrë edhe në fazën e aplikimit për leje ndërtimi.

2. Pasi u verifikua VNM paraprahe, shpjegimi për mungesën e këtij dokumenti, merret në konsideratë.

Sa më lart, për miratimin e lejes së ndërtimit nr. 436, datë 11/06/2021 në kundërshtim me procedurat ligjore të sipërcituara, moszbatimi i Vendimit të KKT nr.12/2019 dhe mosrespektimi i procedurës së shqyrtimit të një çështje sipas nenit 21 të VKM nr. 408/2015 e ndryshuar, ngarkohet me përgjegjësi z.D. H. dhe z.J. Ç.

Titulli gjetjes: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 447, datë 15/06/2021 dhe Nr. 184, datë 11/03/2021 për objektin “Objekt banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate parkim nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kate”, në adresën lagje “Hajro Cakerri”, Vlorë, me zhvillues “L. 2.....2”.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN160420210031 dhe nr.1871 prot. datë 16.04.2021 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 447, datë 15/06/2021 për objekt òObjekt banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate parkim nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kateö, është konstatuar se:

- **Objekti i miratuar tejkalon intensitetin e lejuar maksimal** sipas skedës së njësisë strukturore që është $I_{max}=3.5\%$, ndërkohë e miratuar është $I=3.72$.

- Objekti i miratuar **nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës** në drejtimin lindor duke anashkaluar kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 35 të VKM 408/2015 e ndryshuar, ku distanca për volumin 10 kate duhej të ishte minimalisht 11m larg kufirit të pasurisë.

- Objekti i miratuar **nuk plotëson distancat urbane nga objektet kufitare** në drejtimin lindor dhe juglindor duke anashkaluar kështu detyrimin për zbatimin e Nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar, ku distanca mes objektit 10kt dhe obj.1kt duhej të ishte minimalisht 13m largësi, si edhe distanca mes obj.9kt dhe obj. Ekzistues 6kt duhej të ishte 17m minimalisht.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj leje janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, planifikimit dhe zhvillimit të kontrolluar urban të tij, si dhe nuk është siguruar bashkërendimi i autoriteteve për të nxitur zhvillimin e kontrolluar e harmonizuar të territorit.

Pretendimi i subjektit:-Në lidhje me këto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituar punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me **cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente por kanë dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë me shkresën 731/6 prot. datë 22.11.2021** si vijon për Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 447, datë 15/06/2021 dhe Nr. 184, datë 11/03/2021 për objektin òObjekt banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate parkim nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kateö, si vijon:

1. Përsa i përket gjetjes se objekti nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar $I_{max}=3.5$, ndërsa I_{max} e miratuar $=3.72$. Sipas shpjegimit të subjektit të audituar, në zbatim të Nenit 3 òPërkufizimeö në pikën 35 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, sipërfaqja e të gjithë kateve, nuk është e njëjtë me sipërfaqen totale të ndërtimit, pasi në sipërfaqe kati nuk përlllogariten ballkonet.

2. Përsa i përket respektimit të distancave nga kufiri i pronës, subjekti i audituar shpjegon se ka marrëveshje e shprehur nëpërmjet deklaratës noteriale me nr.297 nr.kol 37 datë 01.02.2021 midis òL. 2....2ö shpk dhe E. Sh., ku ky i fundit nuk paraqet pretendime në lidhje me distancat nga pasuritë e tij kufitare me pronën në zhvillim.

3. Përsa i përket distancave në lidhje me objektet kufitare, subjekti i audituar shpjegon se objektet kufitare nuk janë konform kërkesave ligjore në lidhje me kufirin e tyre të pasurisë, e për rrjedhojë, në zbatim të nenit 34 të VKM 408/2015 e ndryshuar, ka ruajtur distancat nga kufiri i vet i pasurisë.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar është si vijon:

1. Duke u bazuar në pikën 35 të rregullores së PPV Bashkia Vlorë, sipërfaqet e ballkoneve nuk llogariten në sipërfaqe kati, sa më sipër rillogaritja e intensitetit del brenda kërkesave të PPV Bashkia Vlorë. Komenti i subjektit të audituar merret në konsideratë.

2. Në lidhje me distancat nga kufiri i pasurisë në drejtimin lindor, ku subjekti i audituar e justifikon me deklaratën e kufitarit, ky shpjegim nuk mund të merret në konsideratë, pasi në zbatim të ligjit për planifikimin e territorit dhe rregulloreve në zbatim të tij, deklarata apo marreveshje të cilat çenojnë rregullat e planifikimit dhe urbanizimit, nuk janë të ligjshme dhe nuk mund të merren si të vlefshme për kontrollin e zhvillimit. Pra objekti i miratuar me këtë leje ndërtimi nuk respekton distancat me kufirin lindor të pasurisë, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore.

3. Distancat në lidhje me kufirin e pasurisë në drejtimin lindor dhe juglindor nuk plotësohen në dy pika. Komenti juaj se është ruajtur distanca me pasurinë dhe jo me objektet kufitare nuk qëndron, si rrjedhojë nuk merret në konsideratë!

Për sa më sipër, për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi znj.S. A. dhe z.J. C.

3/1/2Kontrolli dhe zhvillimi i territorit/ Certifikatat e përdorimit

Nga auditimi me zgjedhje i ushtruar në sistemin elektronik lidhur me certifikatat e përdorimit, rezultoi se për 62 certifikata përdorimi (*lista e plotë është paraqitur në anekset e këtij Projekraporti të auditimit, pika 2.9*) të dhëna për periudhën objekt auditimi, ***në asnjë rast nuk janë mbajtur aktet e kontrollit që vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*** Sa më sipër është në shkelje të ligjit nr. 107/2014 *ōPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritō*, neni 3 *ōPërkufizimeō*, pika 6, neni 29 *ōPërgjegjësitë e kryetarit të bashkisëō*, germa c), neni 42 *ōCertifikata e përdorimitō*, etj.

Kriteri:Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, neni 3, neni 29, neni 42, neni 44, pika 1, 2, neni 46, pika 1, neni 52, etj; Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Vlorë, miratuar me vendimin nr. 1, datë 16.10.2017 të KKT-së; Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 *ōPër vlerësimin e ndikimit në mjedisō*, Shtojca II, pika 10, germa (a, b); Ligji nr. 90/2012 *ōPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreō*, Kreu I, neni 2, neni 3 pika 6; Ligji nr.10273, datë 29.04.2010 *ōPër dokumentin elektronikō*, i ndryshuar, neni 6, neni 16 pika 1, neni 17 pika 4; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ōPër sistemin e taksave vendoreō*, i ndryshuar, Kreu I, neni 1, neni 2, Kreu II, neni 9, pika 4, neni 27; Ligji nr.10221, datë 4.02.2010 *ōPër mbrojtjen nga diskriminimiō*, Kreu I, neni 1, neni 2, neni 3, pika 1, neni 7; Ligji nr.139/2015 *ōPër vetqeverisjen vendoreō*,Kreu I, neni 1, neni 3, germa b, ç, e, Kreu III, neni 9, pika 1, germa c, Kreu VI, neni 15, pika 1, neni 19, neni 36 germa b; Ligji nr. 10296, *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollinō*, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 datë 23.10.2015, Kreu I, neni 4 pika (6,9,12,14,15), Kreu II, neni 17; Ligji nr. nr.9131, datë 08.09.2003 *ōPër rregullat e etikës në administratën publikeō*, neni 1, neni 2, neni 3, pika 1, germa a, d, e, neni 10, neni 12; Ligji nr. 44/2015 *ōKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëō*, Kreu I, neni 1, neni 2, germa a dhe c, neni 3, pika 6, neni 5, neni 13, neni 15; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *ōPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritō*, i ndryshuar, neni 21, pika 1, neni 22 pika 3; VKM nr. 168, datë 27.03.2019 *ōPër disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministraveō*; VKM nr. 943, datë 28.12.2016 *ōPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014ō* lidhja 2, pika 3; Vendimi nr. 1, datë 30.07.2015 *ōPër përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendoreō* i ndryshuar, neni 3, pika 9, germa b, neni 3/1, neni 5; Rregullorja e Bashkisë Vlorë, neni 5, germa a, b, c, d, g, neni 120, germa a, b, m, neni 124, germa a, b, i, m, s, neni 126.

Ndikimi/Efekti: Sistem jo funksional i kontrollit të brendshëm, duke mos dhënë siguri titullarit për aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucionit. Rritje e nivelit të burokracisë, diskriminim dhe shkelje e të drejtave të taksapaguesve.

Shkaku: abuzim me detyrën, neglizhencë dhe papërgjegjësi e punonjësve.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: 1. Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në asnjë rast të mos miratojnë leje ndërtimi në shkelje të kufizimeve të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi, si në lidhje me lartësinë, ashtu edhe për kriteret e tjera.

2. Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që vlerësimi i aplikimeve për leje në çdo rast, qoftë miratim apo refuzim, të shqyrtohet dhe të shpallet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në çdo rast, Kryetari i Bashkisë, të respektojë afatin 5 ditor për miratimin e lejes në sistem pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga aplikuesi.

3. Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të bashkërendojnë punën, të vlerësojnë dhe të marrin në konsideratë mendimet e autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit, njëkohësisht të reflektojnë ndryshimet e kërkuara nga këto të fundit, përpara miratimit të lejeve.

Titulli gjetjes: **Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.226, datë 26/03/2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin “Godina banimi dhe shërbimi 1-9 kate me 1 kat nentoke” (objekti 4), në lagjen “28 Nëntori”, me zhvillues “G. K.” sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim të KKRT Vlorë nr.2/278 prot. datë 28.09.2011 dhe Vendim nr.86 datë 26.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 16.10.2018.**

Situata: Nga auditimi i procedurës me AN171220200042 datë aplikimi 17.12.2020 për pajisje me Certifikatë përdorimi, për objektin ÷Godina banimi dhe shërbimi 1-9 kate me 1 kat nentoke (objekti 4), në lagjen ÷28 Nëntori, me zhvillues ÷G. K. sh.p.k, miratuar me Vendim nr.86 datë 26.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, rezulton se:

▪ Kjo certifikatë përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar, pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, sic është:

- ÷Projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, janë paraqitur vetëm relacion për strukturat dhe muraturë.

- Certifikata e Eficencës së Energjisë.

- Vërtetim nga IMT Vlorë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.

- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, shoqëruar me licencën përkatëse.

- Foto të objektit në të gjitha drejtimet (nuk janë paraqitur të gjitha drejtimet).

▪ Kjo certifikatë përdorimi është shqyrtuar me afate të tejjgjatura prej 63 ditësh pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit Neni 27 të VKM 408/2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.

Certifikata e përdorimit është në kundërshtim me neni 42 ÷*Çertifikata e përdorimit*, pika 3, ku përcaktohet se ÷*Çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve...ö.*

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj certifikate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për mbikëqyrjen e territorit dhe kërkesat ligjore për pajisjen me certifikatë përdorimi, janë tejkaluar afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me këto gjetje është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe dhe projekt raporti me nr.731/26 prot. datë 29.12.2021, subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë,

konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., J. C., të cilët me shkresën me nr.781/25 datë 31.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë për Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.226, datë 26/03/2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Godina banimi dhe shërbimi 1-9 kate me 1 kat nentokeo (objekti 4), si vijon:

1. Përsa i përket mungesës së verifikimit nga ana e Bashkisë Vlorë, të akt kontrolleve të mbajtura gjatë zbatimit, në zbatim të nenit 42 të ligjit 107/2014 i ndryshuar, subjekti i audituar justifikon mosmbajtjen e tyre, pasi subjekti i ka depozituar te plota, se bashku me deklaratën e përgjegjësisë për zbatimin e punimeve. Gjithashtu drejtorja e planifikimit të territorit nuk ka patur ankesa apo informacion mbi shkelje në objekt.

2. Përsa i përket mangësive në informacion tek projekti i imirëmbajtjes, nga subjekti i audituar shpjegohet se ky raport shoqërohet me deklaratën e përgjegjësisë së hartuesit, e sa më sipër nuk mban përgjegjësi shqyrtuesit e aplikimit për certifikatë përdorimi, megjithatë gjetja do të mbahet në konsideratë në shqyrtimet e mëtejshme.

Përsa i përket mungesës së certifikatës së eficensës së energjisë në banesë, subjekti i audituar shpjegon se objekti është miratuar me leje ndërtimi para hyrjes në fuqi të ligjit 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave".

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar është si vijon:

1. Mbi mungesën e verifikimit të akt-kontrolleve sipas fazave të mbikqyrjes së zbatimit të objektit, kjo vërtet është konstatuar nga subjekti i audituar nuk është detyrim ligjor, por është një mjet ligjor që shërben për të shmangur problematika të cilat mund të lindin nga moszbatimi i saktë i objekteve në terren, të cilat mund të parashikojnë zgjidhje me penalitete ligjore dhe ekonomike. Për këtë arsye lihet detyrë drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimet e nevojshme të akt-kontrolleve sipas fazave të zbatimit të lejeve të miratuara nga bashkia Vlorë.

2. Mbi shpjegimin për projektin e imirëmbajtjes, **ai nuk mund të merret** në konsideratë, është detyrë funksionale e punonjësve të drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimin e dokumentacionit i cili depozitohet në aplikimet e ndryshme në e-leje. Lihet detyrë verifikimi me kujdes i dokumentacionit që aplikohet për certifikatë përdorimi.

3. Përsa i përket mangësisë në dokumentacion si: Certifikatë për performancën e energjisë, sqarimi juaj se leja e ndërtimit është miratuar para hyrjes në fuqi të ligjit 116/2016, **ky shpjegim nuk merret në konsideratë**, pasi sipas nenit 17 të këtij ligji "*Dispozita kalimtare e kemi shprehimisht: Të gjitha ndërtesat e reja dhe njësitë e ndërtesave të reja, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenin 4, duhet të plotësojnë kërkesat minimale të performancës së energjisë, me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton kërkesat minimale të performancës së energjisë të ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave.*

Për mangësitë si vërtetim i IMT se objekti nuk është vënë në shfrytëzim, foto të objektit në gjithë drejtimet, kontratë me mbikqyrësin e punimeve, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observim, pra këto janë mangësi që qëndrojnë .

Tejkalimi i afateve të procedurës për shqyrtim, përbën një shkelje e cila nuk ka marrë shpjegime nga subjekti i audituar. Është shpjeguar se nuk kanë ardhur vonesat nga një punonjës, por nuk kuptohet se kush është, pasi observacioni është firmosur nga të gjithë punonjësit.

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim Nr.226, datë 26/03/2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi zj.N. R., z.J. C.

Titulli gjetjes: Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Objekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hoteleri" Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar

me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 10.03.2019.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit aplikuar me numer ceshtje AN290620200066 dhe nr.1217 prot. me datë 29.06.2020 për të cilën është marrë vendimi për pajisje me certifikate me VendimNr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Objekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hotelerië Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S. u konstatua se:

1. Kjo certifikatë përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë i ndryshuar", pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, sic është:

- "Projektë për mirëmbajtjen e objektitë, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, janë paraqitur vetëm relacion për strukturat beton arme dhe muraturë.

- Vërtetim nga IMT Vlorë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.

- Foto të objektit në të gjitha drejtimet (nuk janë paraqitur të gjitha drejtimet).

2. Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, mban nr. rep 1572, nr.kol 603 me datë 20.02.2020, ndërkohëaktet e kontrollit të mbajtura për objektin datojnë 3 vite para lidhjes së kontratës. Këto veprime japin indicie për informacion të pavërtetë nga zhvilluesi "T. C.ö shpk dhe mbikëqyrësin D. Gj. i pajisur me licensë nr. MK2629.

3. Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, kjo e vërtetuar edhe me dokumentacion fotografik vihet re se nuk janë zbatuar shkallëzimet 3-5 sipas planvendosjes së miratuar dhe projektit të miratuar duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", IMT Bashkia Vlorë ka anashkalar përgjegjësitë e veta në drejtim të kontrollit të zhvillimit të territorit dhe duke mos konstatuar devijimin nga kushtet e lejes të objektit të ndërtuar, gjithashtu edhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Vlorë, ka konfirmuar punimet e jashtëligjme të kryera, madje duke miratuar edhe certifikatën e përdorimit.

4. Përsa i përket pagesës së tarifës për pajisje me certifikatë përdorimi, për këtë objekt është përlloritur pagesa me faturën nr.489 datë 22.07.2020 me vlerë tarifë për certifikatë përdorimi 85,680 lekë dhe është paraqitur mandati i B. K. T. me datë 23.07.2020 me vlerë 85680 lekë.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Vlorë vlera e tarifës për pajisje me Certificate përdorimi është 35 lekë/m². Përlloraritja për objektin me sip. 2448 m² (pa përfshirë shkallë dhe ballkonet etj), del 85,680 lekë. Pra nga Bashkia Vlorë ka arkëtuar saktë tarifën për pajisje me certifikatë përdorimi.

Sipas dokumentacionit të paraqitur ne platformën e-lejevlera e preventivuar e objektit është 78,846,423 lekë, ndërsa nga situacioni përfundimtar vlera përfundimtare e punimeve të objektit është 89,922,203 lekë.

Nisur nga legjislacioni në fuqi vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlloritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit.

Për diferencën $89,922,203 - 78,846,423 = 11,075,780$ lekë, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë. **Pra duhej të paguanin $4\% * 11,075,780 = 443,031.2$ lekë.**

Nga drejtoria e financës bashkia Vlorë kjo taksë në faturën me nr.489 datë 22.07.2020 nuk është përlloritur, duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Vlorë me vlerë 443,031.2 lekë.

Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit A. S. me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Vlorë, ngarkohet me përgjegjësi zj.N. R.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj certifikate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave, janë tjetërsuar dokumenta në kundërshtim me ligjin për kontrollin dhe disiplinimin e punimveve, nuk janë përlllogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë si diferencë e situacionit përfundimtar me preventivin, me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe për këtë çështje subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., të cilët me nr.781/25 datë 31.01.2022 nuk kanë bërë komente mbi këtë leje dhe të vetmet shpjegime për disa nga gjetjet si më poshtë janë dhënë me shkresën nr. 731/6 prot. datë 22.11.2021:

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit AN290620200066 për pajisje me certifikatë përdorimi, janë dhënë këto sqarime:

1. Përsa i përket mangësive në informacion tek projekti i mirëmbajtjes, nga subjekti i audituar shpjegohet se ky raport është hartuar nga A. C. dhe ndodhet në sistemin e-leje.
2. Per dokumentacionin fotografik shpjegon se ndodhet në aktin e kolaudit.
3. Përsa i përket mungesës së verifikimit nga ana e Bashkisë Vlorë, të akt kontrolleve të mbajtura gjatë zbatimit, në zbatim të nenit 42 të ligjit 107/2014 i ndryshuar, subjekti i audituar justifikon mosmbajtjen e tyre, pasi subjekti i ka depozituar te plota, se bashku me deklaratën e përgjegjësisë për zbatimin e punimeve.
4. Për diferencën situacion-preventiv është sqaruar se është kërkuar situacioni i saktësuar në fazën për plotësim dokumentacioni dhe situacioni i depozituar nuk paraqet nevojën e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë si rrjedhojë e diferencës Situacion përfundimtar-Preventiv punimesh. Gjithashtu nga subjekti i audituar janë marrë masa për të kërkuar informacion Drejtorisë së TatimTaksave me shkresën nr.161 prot. datë 12.01.2022, e cila ka kthyer pergjigje me shkresën 1175/2 prot. datë 18.01.2022, ku sipas Drejtorisë Rajonale të Tatimeve nuk mund të japë informacion mbi vlerën e situacionit përfundimtar, pasi shkelet parimi i konfidencialitetit. U njoftua edhe zonja A. S. me nr.161/2 datë 19.01.2022.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për çështjen e audituar është si vijon:

Mbi mungesën e verifikimit të akt-kontrolleve sipas fazave të mbikqyrjes së zbatimin të objektit, kjo vërtet ashtu edhe sic është konstatuar nga subjekti i audituar nuk është detyrim ligjor, por është një mjet ligjor që shërben për të shmangur problematika të cilat mund të lindin nga moszbatimi i saktë i objekteve në terren, të cilat mund të parashikojnë zgjidhje me penalitete ligjore dhe ekonomike. Për këtë arsye lihet detyrë drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimet e nevojshme të akt-kontrolleve sipas fazave të zbatimit të lejeve të miratuara nga bashkia Vlorë. Madje në këtë rast nga ana jonë si auditues është konstatuar shkelje e kushteve të lejes dhe moszbatim të projektit të miratuar me pasojë shtimin e sipërfaqeve dhe volumeve ndërtimore, shkelje për të cilat IMT Bashkia Vlorë nuk ka marrë asnjë masë, dhe gjithashtu nuk ka paraqitur observacion.

Certifikata e përdorimit është në kundërshtim me neni 42 *Çertifikata e përdorimit*, pika 3, ku përcaktohet se *Çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve....ö.*

1. Mbi shpjegimin për projektin e mirëmbajtjes, ai nuk mund të merret në konsideratë, është detyrë funksionale e punonjësve të drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimin e dokumentacionit i cili depozitohet në aplikimet e ndryshme në e-leje. Një projekt mirëmbajtje jo i plotë, duhej të kërkohej të plotësohej.
2. Për diferencën situacion - preventiv, meqenëse nga ana e Bashkisë Vlorë janë kryer veprimet rregulluese si verifikimi me Drejtorinë rajonale të tatimeve, si dhe është mbajtur

korespondenca me zhvilluesin, por shpjegimet nuk merren në konsideratë, pasi nuk ka veprime në drejtim të vlerës së munguar.

Për mangësitë si vërtetim i IMT se objekti nuk është vënë në shfrytëzim, kontratë me mbikqyrësin e punimeve, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observim, pra këto janë mangësi që qëndrojnë dhe do të merren në konsideratë gjatë auditimit.

Për shkeljet e kryera nga kolaudatori dhe mbikqyrësi të njoftohen dhe të japin shpjegimet e tyre në lidhje me gjetjet e kryera.

Përsa i përket shkeljeve të kryera në zbatim duke mos respektuar kushtet e lejes me pasojë shtimin e sipërfaqeve dhe volumeve ndërtimore, IMT Vlorë të japë shpjegimet e veta dhe të kryejë procedurat e nevojshme për këtë rast.

IMT Bashkia Vlorë është përgjegjëse për moskryerjen e detyrave funksionale të saj dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme.

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim Nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin “Objekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hoteleri” Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S. në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.K. M. kontrollues, znj.N. R. nëpunës dhe z.F. D., si dhe për informacion të pasaktë në dokumentacion mbikqyrësi D. Gj. i pajisur me licensë nr. MK2...9 dhe Subjekti ndërtues “T. C.” shpk.

Titulli gjetjes: Çertifikatë përdorimi miratuar me Nr.577 , datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin “Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtese anesore e kapanonit ekzistues 2 kat), në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues “A. P.” sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Situata:Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit, aplikuar me AN270820200071 dhe nr.1332 prot. me datë 27.08.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.577, datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtesë anesore e kapanonit ekzistues 2 kat), në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues A. P. sh.p.k u konstatua se:

1. Kjo certifikatë përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë i ndryshuar , pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, siç është:

- Vërtetim nga IMT Vlorë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.
- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe kolaudatorit të punimeve, shoqëruar me licencën përkatëse.
- Dokumentacion fotografik në të gjitha drejtimet.

1. Ky objekt nuk ka respektuar afatet e ndërtimit sipas Vendimit nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, pasi sipas pikës 2 të këtij vendimi, afati referuar grafikut është 3 muaj. Sipas njoftimit dhe aktit të kolaudimit punimet kanë filluar me datë 27.09.2018 dhe kanë përfunduar me datë 30.09.2019. Në sistemin e-leje është depozituar një shkresë me nr.1115/1 prot. datë 05.07.2018, ku konfirmohet një datë tjetër afati punimesh, në kundërshtim kjo me pikën 11 të Vendimit Nr. 430, datë 11.7.2018 për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve të KM, sipas së cilës: *Korrigjimi i të dhënave të hedhura gabim në sistemin elektronik do të kryhet, si më poshtë: a) Bashkitë apo institucionet, për të dhënat e hedhura gabim nga ana e tyre, i drejtohen me kërkesë zyrtare për korrigjimin Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.*

Deklarimi me shkresën nr.1115/1 prot. i zgjatjes së afatit të punimeve pa kryer veprimet ligjore përkatëse, përvec se është kundravajtje administrative, përbën edhe një veprim që nuk ka vlerë ligjore. Nisur nga kjo , subjekti A.P. sh.p.k ka patur afat 3 muaj për përfundimin e punimeve. Për sa më sipër IMT Bashkia Vlorë duhej të mbante procedurën përkatëse në zbatim të ligjit, e të mos lejonte ndërtimin jashtë afateve të lejes së ndërtimit.

2. Nga dokumentacioni fotografik i depozituar nga vetë subjekti në aplikimin për pajisje me certifikatë përdorimi me nr. AN270820200071, nuk janë zbatuar sipas projektit të miratuar hapjet në fasadë. Për këtë veprim nga ana e IMT Vlorë nuk është mbajtur asnjë proces verbal, duke anashkaluar përgjegjësitë e veta IMT Bashkia Vlorë. Gjithashtu për këtë objekt është mbajtur akt-kontroll (për përfundimin e fasadave dhe rifiniturave) i cili në kundërshtim me ligjin nuk ka asnjë datë për mbajtjen e tij, gjithashtu Subjekti Zbatues òA. P.ò shpk dhe mbikqyrësi òI. R. S.ò kanë deklaruar se fasadat kanë zbatuar projektin e miratuar, duke bërë një deklaram të rremë. Asnjë nga këto akt-kontrolle nuk është konfirmuar nga Bashkia Vlorë.

Certifikata e përdorimit është në kundërshtim me neni 42 ò*Certifikata e përdorimit*ò, pika 3, ku përcaktohet se ò*Certifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve*....ò.

3. Përsa i përket pagesës së tarifës për pajisje me certifikatë përdorimi, për këtë objekt është përlllogaritur pagesa me faturën nr.683 datë 05.10.2020 dhe është paraqitur mandati i B.. me datë 06.10.2020 me vlerë 51ò259.25 lekë.

Sipas VKB Vlorë vlera e tarifës për pajisje me Certificate përdorimi është 35 lekë/m2. Përlllogaritja për objektin me sipërfaqe 1464.55 m2 mbi toke është e saktë.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj certificate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, zhvillimit të kontrolluar urban të tij, për respektimin e legjislacionit për disiplinimin e punimeve.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe për këtë çështje subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., të cilët me shkresën 731/6 datë 22.11.2021 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për këtë gjetje si më poshtë:

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit AN270820200071 për pajisje me certifikatë përdorimi, janë dhënë këto sqarime:

1. Përsa i përket mungesës së verifikimit nga ana e Bashkisë Vlorë, të akt kontrolleve të mbajtura gjatë zbatimit, në zbatim të nenit 42 të ligjit 107/2014 i ndryshuar, subjekti i audituar justifikon mosmbajtjen e tyre, pasi subjekti i ka depozituar te plota, së bashku me deklaramen e përgjegjësisë për zbatimin e punimeve. Në këtë pikë, theksojmë si auditues se zhvilluesi ka depozituar akt-kontroll rifiniturash, ku deklaroi se ka zbatuar projektin e miratuar, në të vërtetë e vërtetuar edhe me dokumentacionin fotografik në dispozicion, nuk është zbatuar.

2. Për mangësitë si kontrata me kolaudatorin dhe vërtetim nga IMT që objekti nuk është vënë në shfrytëzim para miratimit të certifikatës së përdorimit, subjekti i audituar nuk ka dhënë sqarime.

Përsa i përket zbatimit jashtë afatit të punimeve, nga subjekti i audituar shpjegohet se afati i punimeve ka zgjatur 5 muaj, duke nisur nga data 27.09.2018.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar është si vijon:

1. Mbi mungesën e verifikimit të akt-kontrolleve sipas fazave të mbikqyrjes së zbatimin të objektit, kjo vërtet është ashtu edhe sic është konstatuar nga subjekti i audituar nuk është detyrim ligjor, por është një mjet ligjor që shërben për të shmangur problematika të cilat mund të lindin nga moszbatimi i saktë i objekteve në terren, të cilat mund të parashikojnë zgjidhje me penalitete ligjore dhe ekonomike. Për këtë arsye lihet detyrë drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimet e nevojshme të akt-kontrolleve sipas fazave të zbatimit të lejeve të miratuara nga bashkia Vlorë. Madje në këtë rast, nga ana jonë si auditues është konstatuar shkelje e kushteve të lejes dhe moszbatim të projektit të miratuar me pasojë ndryshimin e fasadave, shkelje për të cilat IMT Bashkia Vlorë nuk ka marrë asnjë masë, dhe gjithashtu nuk ka paraqitur observacion.

2. Në lidhje me afatin e punimeve, sipas formularit të lejes është shënuar 3 muaj, sipas sqarimeve të subjektit të audituar punimet kanë zgjatur 5 muaj. Për pasojë, subjekti përsëri është jashtë afateve të lejes.

3. Përsa i përket korigjimit të aktit, në këtë rast formulari i lejes së ndërtimit, kryhet me procedurë në zbatim të VKM Nr. 430, datë 11.7.2018 òPër krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve. Pra shpjegimet tuaja nuk mund të merren në konsideratë.

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim Nr.577, datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi zj.N. R. nëpunës, z.K. M. kontrollues dhe z.F. D. drejtues i DPKZHT; Ngarkohet me përgjegjësi IMT Bashkia Vlorë për lejim të punimeve jashtë afatit të lejes, si edhe lejim të punimeve jashtë projektit të miratuar (ndryshime në fasadë); Ngarkohet me përgjegjësi Subjekti zbatues "A. P." shpk dhe mbikqyrësi "I. R. S" kanë deklaruar se fasadat kanë zbatuar projektin e miratuar, duke bërë një deklaram të pavërtetë.

Në ligjin nr. 107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, neni 42 òCertifikata e përdorimitò, pika 3, përcaktohet se òCertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve....ò. Këto akte kontrolli nuk kanë lidhje me aktet e kontrollit të kryera nga mbikëqyrësit e punimeve, por janë akte kontrolli të posaçme, të cilat kryhen nga autoriteti i cili ka dhënë lejen e ndërtimit, për verifikimin e kritereve të përcaktuara në lejen e ndërtimit. Sa më sipër, pa paragjykuar kërkesat e VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò dhe deklaratat e subjekteve ndërtuese për konformitetin e punimeve të kryera prej tyre, administrata e Bashkisë Vlorë nuk mund të pretendojë se ka shkelur ligjin për të zbatuar VKM-në. VKM-ja është akt nënligjor, në funksion të ligjit të cilit i referohet.

Titulli gjetjes: Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 594, datë 19/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektinòKompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1-kat parkim nen toke (faza 1) në lagjen 1 maji" Vlore- Seksioni D (banim); E (hotel)ò me adresë në lagjen ò1 Majiò, paraqitur nga zhvilluesi K.R.A.K., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.3/102 datë 07.06.2010 të KRRT Bashkia Vlorë me afat deri më 21.12.2013,si dhe me zgjatje afati leje 4 herë, përkatësisht me Vendim nr.57 datë 29.04.2014 òPër zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimitò, me Vendim nr. 331 datë 30.06.2017 òPër zgjatje afati për lejen e ndërtimitò, Vendim nr.1240 datë 05.12.2017 òPër zgjatje leje afati ndërtimiò dhe Vendim nr. 442 datë 22.07.2020 me afat 22.01.2020, ndryshim të projektit gjatë zbatimit me Vendim nr. 602 datë 04.01.2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë òKompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "1 Maji" Vlorëò, si edhe me Vendim nr.543 datë 25.09.2020 për miratim ndryshim funksioni òKompleks Banimi dhe Shërbimesh 5-6 Dhe 7 Kate Me 1 Kat Parkim Nëntokëò, ku (Seksioni E) Ndryshon Destinacion Nga Banim, Ne Funksion te Turizmit, Hoteleri.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit, aplikuar me AN061020200166 dhe nr.1420 prot. me datë 04.10.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 594, datë 19/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorëpër objekt òKompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1-kat parkim nen toke (faza 1) në lagjen 1 maji" Vlore- Seksioni D (banim); E (hotel)ò me adresë në lagjen ò1 Majiò, paraqitur nga zhvilluesi K.R.A.K. u konstatua se:

1. Kjo certifikate përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar, pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, sic është:

- Vërtetim nga IMT Vlorë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.
- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, shoqëruar me licencën përkatëse.
- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe kolaudatorit të punimeve, shoqëruar me licencën përkatëse.
- Certifikata përfundimtare e Eficiencës së Energjisë.

- Policën e sigurimit të përgjegjësishë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar.

2. Kjo certifikatë përdorimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 73 ditësh pune, duke shkelur kështu në mënyrë flagrante afatet ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, konkretisht nenin Nenit 27 të VKM nr. 408/2015 oPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar.

3. Përsa i përket pagesës së tarifës për pajisje me certifikatë përdorimi, për këtë objekt është përlogaritur pagesa me faturën nr.700 datë 08.10.2020 me vlerë 449,984 lekë, ku 406,631.75 lekë janë tarifë për pajisje me certifikatë përdorimi, ndërsa 43,352.25 lekë janë taksë ndikimi në infrastrukturë për diferencën situacion përfundimtar ó preventiv punimesh. Janë paraqitur mandatet i B.K.T me datë 08.10.2020 me vlerë 406631.75 lekë dhe 43,352.25 lekë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur në aplikimin me AN061020200166 dhe nr.1420 prot. me datë 04.10.2020, për pajisje me certifikatë përdorimi, në dokumentin me emër

õSignEd_SignEdSignEdaktkolaudimikraal%20(1)20211109135246500.pdfö i cili paraqet akt-kolaudimin e hartuar nga K. K. me nr. Lic.MK.04...../2 në faqen 2 dhe 3 të këtij dokumenti i cili është firmosur nga mbikqyrësi dhe nga Investitorit vlera faktike e punimeve është paraqitur :

91,374,950.4 lekë objekti D me funksion Banim

681,721,999.5 lekë objekti E me funksion Hotel

Pra vlera faktike e punimeve është 773,096,949.9 lekë.

Nisur nga preventivi i paraqitur vlera e preventivuar e objektit është 297,430,885 lekë, ndërsa nga akti i kolaudimit të objektit vlera përfundimtare për të dy seksionet D dhe E është 773,096,949.9 lekë.

Nisur nga legjislacioni në fuqi vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit.

Për diferencën 773,096,949.9 ó 297,430,885 = 475,666,064.9 lekë, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Vlorë me faturën me nr.700 datë 08.10.2020 është përlogaritur 3% e vlerës 1,445,075, dhe jo 3% e 475,666,064.9 lekë, duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Vlorë me vlerë 14,269,981.947 lekë.

Pretendimet e subjektit të audituar: Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.21 datë 12.11.2021 dhe projekt raporti me nr.731/26 prot datë 29.12.2021 për këtë çështje subjektet e audituara punonjës të Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht E. A., F. D., S. A., D. H., K. M., A. Ç., N. R., R. H., të cilët me shkresën 731/6 datë 22.11.2021 dhe me shkresën 780 prot. datë 26.01.2022 kanë bërë komente dhe dhënë shpjegime për këtë gjetje si më poshtë:

Përsa i përket shqyrtimit të aplikimit AN061020200166 për pajisje me certifikatë përdorimi, janë dhënë këto sqarime:

1. Përsa i përket mungesës së verifikimit nga ana e Bashkisë Vlorë, të akt kontrolleve të mbajtura gjatë zbatimit, në zbatim të nenit 42 të ligjit 107/2014 i ndryshuar , subjekti i audituar justifikon mosmbajtjen e tyre, pasi subjekti i ka depozituar te plota, së bashku me deklaratën e përgjegjësishë për zbatimin e punimeve. Në këtë pikë, theksojmë si auditues se zhvilluesi ka depozituar akt-kontroll rifiniturash, ku deklaroi se ka zbatuar projektin e miratuar, në të vertetë e vërtetuar edhe me dokumentacionin fotografik në dispozicion, nuk është zbatuar.

2. Për mangësitë si kontrata me mbikqyrësin, kontrata me kolaudatorin dhe vërtetim nga IMT që objekti nuk është vënë në shfrytëzim para miratimit të certifikatës së përdorimit, nga subjekti i audituar nuk është dhënë sqarime.

3. Përsa i përket mungesës së certifikatës së eficensës së energjisë në banesë, subjekti i audituar shpjegon se objekti është miratuar me leje ndërtimi para hyrjes në fuqi të ligjit 116/2016 oPër performancën e energjisë së ndërtesaveö.

4. Për konstatimin tonë se mungon polica e sigurimit të përgjegjësive së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar, nga subjekti audituar është sqaruar se ky dokument ndodhet në brendësi të aplikimit.

Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë si pasojë e diferencës situacion - preventiv, llogaritësja e kësaj diference sqaron se i është referuar situacionit të depozituar i firmosur elektronikisht, gjithashtu shprehet se për faktin se ndodhen në aplikim dy akt-kolaudime me vlera të ndryshme situacioni, përgjegjësia është e specialistit të dosjes, në këtë rast e z.R. H. dhe K. M., të cilët kanë firmosur këtë observacion, pra janë dakort me shpjegimin e zj.N.R. Gjithashtu sqarohet se i është dërguar shkresë Drejtorisë Rajonale të tatimeve Vlorë me nr.160 prot. datë 12.01.2022, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr.1175/1 prot. datë 18.01.2022. Shkresa dërguar zhvilluesit K.R.A.K. mban nr.160/2 datë 19.01.2022.

Qëndrimet e Audituesve të KLSH: Qëndrimi në lidhje me shpjegimet e dhëna nga punonjësit e DPKZHT Bashkia Vlorë, për lidhje me çështjen e audituar është si vijon:

1. Mbi mungesën e verifikimit të akt-kontrolleve sipas fazave të mbikqyrjes së zbatimit të objektit, **kjo vërtet ashtu edhe sic është konstatuar nga subjekti i audituar nuk është detyrim ligjor**, por është një mjet ligjor që shërben për të shmangur problematika të cilat mund të lindin nga moszbatimi i saktë i objekteve në terren, të cilat mund të parashikojnë zgjidhje me penalitete ligjore dhe ekonomike. Për këtë arsye lihet detyrë drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të kryejë verifikimet e nevojshme të akt-kontrolleve sipas fazave të zbatimit të lejeve të miratuara nga bashkia Vlorë.

2. Përsa i përket mangësisë në dokumentacion si: Certifikatë për performancën e energjisë, sqarimi juaj se leja e ndërtimit është miratuar para hyrjes në fuqi të ligjit 116/2016, **ky shpjegim nuk merret në konsideratë**, pasi sipas nenit 17 të këtij ligji dispozita kalimtare e kemi shprehimisht: *Të gjitha ndërtesat e reja dhe njësitë e ndërtesave të reja, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenin 4, duhet të plotësojnë kërkesat minimale të performancës së energjisë, me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që përcakton kërkesat minimale të performancës së energjisë të ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave.*

3. Për mangësitë si vërtetim i IMT se objekti nuk është vënë në shfrytëzim, kontratë mes zhvilluesit dhe mbikqyrësit, **nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observim, pra këto janë mangësi që qëndrojnë dhe do të merren në konsideratë gjatë auditimit.**

4. **Tejkalimi i afateve të procedurës për shqyrtim, përbën një shkelje e cila nuk ka marrë shpjegime nga subjekti i audituar.**

5. Sqarimi se polica e sigurimit ndodhet në sistemin e-leje **merret në konsideratë.**

6. Për sqarimin se për përllogaritjen e diferencës situacion-preventiv nuk është marrë parasysh akti i kolaudimit, por dokumenti i ngarkuar në sistem, kur edhe dy aktet e kolaudimit me vlera të ndryshme janë po dokumente të ngarkuara në sistem dhe të firmosura nga të gjithë personat që kërkon ligji, sqarimi nuk merret në konsideratë, pasi në mungesë të qartësisë së dokumentacionit, duhej të bëhej verifikim me tatim taksat. Veprimet e ndërrmarra nga Bashkia Vlorë, tregojnë për seriozitet në shqyrtimit e problematikës, duke kërkuar detyrimet e prapambetura subjekteve. Përmbushja e këtyre detyrimeve do të jenë subjekt i auditimit të mëtejshëm.

Gjithashtu për këtë vlerë, duhet të paraqesin shpjegime edhe mbikqyrësi dhe kolaudatori i objektit K. K.me nr. Lic.MK.04...../2.

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim Nr. 594, datë 19/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.F. D. dhe zj.N. R.

2.3.2.Miratimi i lejeve të ndërtimit me vendim gjykatë.

Nga shqyrtimi i dosjeve të lejeve të ndërtimit me zgjidhje i disa praktikave të miratimit të lejeve të ndërtimit me vendim gjykatë u konstatua se:

-Me vendimin nr. 35, datë 10.10.2013 nr. 3313 prot date 10.10.2013 ish-Kryetari i Bashkisë Vlorë z. Sh. Gj. pasi u informua me relacionin e Drejtorisë së Planifikimit dhe kontrollit të Zhvillimit Vendosi:

Të revokoi lejet e ndërtimit të objekteve sipas listës bashkëlidhurí

1. Të revokohet sheshi dhe leja e ndërtimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/63 dhe 2/64 date 28.09.2011 te KRRT se Bashkise Vlore per objektin "Rezidence Banimi 5-7 kate, 1 katparkim pjeserisht nentoke, ne lagjen "Uji i Ftohte" me pronare trualli E. K. dhe me subjekt " L. 2.....2ö.

2. Te revokohet sheshi dhe e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/73 dhe 2/74 date 28.09.2011 te K.RRT se Bashkise Vlore per objektin Godine industriale 2-kt ne lagjen "11 Janariö me pronar trualli "C." shpk dhe me subjekt ndertues "T. K."

3. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/83 dhe 2/84 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbime 4-kat +atiko, me 1-2 kat parkim nen kuoten +0.00m ne rrugen e re ne lagjen "Uji i Ftohtëö me pronar trualli V. B. dhe me Subjekt ndertues "U."

4. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/85 dhe 2/86 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Ambjente sherbimi, rezidence banimi.2+5 kate + podrum + papafingo ne lagjen "Majiö me pronar trualli B. S. e subjektndertues "R.2....0".

5. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/91 dhe 2/92 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbime 8-kate, me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "Deshmoret" me pronare trualli V. M., H. F.,K. F. dhe me subjekt ndertues "D."

6. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/111 dhe 2/112 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Pike karburanti + autogaz ne lagjen "Maji" me pronar trualli A. dhe E. D. dhe subjekt ndertues "S.ö.

7. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/113 dhe 2/114 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Shtese anesore dhe ngritje kati mekonstruksion te lehte ne objektin ekzistues 4 kate ne lagjen " Isa Boletiniö me pronar trualli A. D. me subjekt ndertues "B. 2....8 V."

8. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/131 dhe 2/132 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Ngritje kati i dyte mbi objektin ekzistues ne lagjen "Deshmoret" me pronar trualli Th. V. dhe subjekt ndertues "A."

9. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/135 dhe 2/136 date 28.09.2011 te K.RRT se Bashkise Vlore per objektin Banese 5- kate me 2 katesherbime ekzistues dhe ngritje 3- kate banim ne lagjen "Lef Sallata" me pronar trualli A. H. dhe subjekt ndertues "B."

10. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/143 dhe 2/144 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Kompleks banimi 3 -kate me 1 katparkim nentoke ne lagjen "Uji i Ftohte" me pronar trualli familja Xh. dhe subjekt ndertues "K."

11. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/145 dhe 2/146 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Kompleks banimi 3 kate me 1 katparkim nentoke ne lagjen "Uji i Ftohte" me pronar trualli familja Xh. dhe subjekt ndertues "K."

12. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/151 dhe 2/153 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banesa 7-8-9 dhe 8-9-10 me 1-2 kate dyqane dhe parkim ne lagjen "Majiö me pronar familja D. dhe subjekt ndertues "E.E."

13. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/163 dhe 2/164 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin banim dhe sherbime 5-6-8-9 kate me 1 kat parkim nen toke ne lagjen "Lef Sallata" me pronare trualli bashkepronesi Sh.

14. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/163 dhe 2/164date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin banim dhe sherbime 5-6-8-9 kateme 1 kat parkim nen toke ne lagjen "Lef Sallatao me pronare trualli bashkepronesi Sh.
15. Te revokohet sheshi dhe loja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/167 dhe 2/168date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbime 6-8- kate me l-kat parkim nentoke ne Lagjen o!l Majjo me pronare trualli A. R. dhe subjekt ndertues U. P."
16. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/169 dhe 2/170date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 5-6-7 kate me 1- kat parkim nentoke ne lagjen o!l Majjo me subjekt ndertues "E. P."
17. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/171 dhe 2/172date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Kapanon 1 -kat + rikonstruksion IBaneses 2-kt ekzistuese me çati) ne lagjen "Deshmoret" Vlore me pronare trualli E. dheA. R.
18. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/175 dhe 2/176date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 3-kate + papafingo me l-2 kate pjeserisht nentoke ne lagjen o!lUji i Ftohte" Vlore me pronar trualli I. P. dhe subjekt ndertues "A."
19. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/177 dhe 2/178date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 3-4 kate me 1 kat pjeserisht nentoke ne lagjen o!lUji i Ftohte" Vlore me pronar trualli L. P. dhe subjekt ndertues "A."
20. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/187 dhe 2/188date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbimesh 12- kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen o!l Majjo me pronar trualli A. dhe E.D. e subjekt ndertues "E.V."
21. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/189 dhe 2/190date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbimesh7-8 kate me 1-kat nentoke ne lagjen o!l Maji" me pronar trualli A. dhe E. D. esubjekt ndertues "S."
22. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/191 dhe 2/192date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 1-8-9 kate me 1 kat dyqane dhe 1 kat parkim nentoke ne lagjen o!lPavaresia" me pronar trualli K., P., T., M., L., Xh., Z. e subjekt ndertues "H.P."
23. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/197 dhe 2/198date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 9-10 kate me 1- kat dyqane dhe 1- kat parkim nentoke ne lagjen "Pavaresia" me pronar trualli K., P., T., M., L., V., Xh., M., I. e subjekt ndertues "R. G."
24. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/195 dhe 2/196date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 8-10 kate me 1 kat dyqane dhe 1 kat parkim nentoke ne lagjen o!lPavaresia" me pronar trualli K. P., T., M., L., T., Sh., H., H. e subjekt ndertues "H.P."
25. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/197 dhe 2/198date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 9-10 kate me 1-kat dyqane dhe 1-kat parkim nentoke ne lagjen o!lPavaresia" me pronar trualli K., P., T., M., L., V., Xh., M., S. e subjekt ndertues o!lR. G."
26. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/199 dhe 2/200date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banesa 8- 9-10 kate me I kat dyqane dhe 1 kat parkim nentoke ne lagjen o!lPavaresia" me pronar trualli K., P., T., M., L., Xh., Xh. e subjekt ndertues "E. E."
27. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/201 dhe 2/202 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 10- kate me l-kat

dyqane dhe 1- kat parkim nentoke ne lagjen òPavaresiaö me pronar trualli K., P., T.,E., M., L., T., G., M.,D., F., A., C. e subjekt ndertues " E.E.ö.

28. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/211 dhe 2/212 date 28.09.2011 te K.RRT se 'Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbimesh 10 kate, me 1 kat nentoke, me pronare trualli G. D., A. Gj. dhe K. P. e subjekt ndertues ò T. K.".

29. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/215 dhe 2/216 date 28.09.2011 te K.RRT se Bashkise Vlore per objektin Objekt polifunksional 4 - kate, me 1- kat nentoke ne lagjen ò11 Janariö ne perendim te superstrades Fier-Vlore me pronare trualli A., P. A., D. dhe R. S. e subjekt ndertues "M. K.".

30. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/225 dhe 2/226 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 4-6-8 kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen òPavaresia" Vlore me pronar trualli I. B. me subjekt ndertues "B.".

31. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/235 dhe 2/236 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin 1-6-7 kate me 1-kat dyqane me 1 kat parkim nentoke ne lagjen ò1 Majiö me pronar F. L. dhe subjekt ndertues "A. P.".

32. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/237 dhe 2/238 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin hanim e sherbime 8-kate + 1 kat parkim nen toke me 2-kate sherbime ne lagjen òKushtrimiö ne rrugen "Deshmoret" me pronar trualli A. G., E. G., dhe M. G.

33. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.1/9 date 24.03.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine polifunksionale 3-15 kate +observator me 2-kate parkim nen toke me pronar E. T., A. H., S. N., K. G. H. dhe subjekt "L. 2....1".

34. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/245 dhe 2/246 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Banese 10-11-12 kate me 2 kate dyqane dhe 1- kat parkim nentoke prane rruges "Gjergj Araniti" Vlore me pronare Z. H., R. B., F. G., M., B. A.

35. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/263 dhe 2/264 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Rikonstruksion i baneses ekzistuese 1-kat dhe ngritje kati i dyte dhe i trete pjeserisht ne lagjen ò1 Maji" me pronar trualli Th. Gj.

36. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/269 dhe 2/270 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbime 8- kate me lkat sherbime, 1 kat nentoke ne lagjen òPavaresiaö me pronar trualli Trashegimtarete e J. M. e subjekt ndertues "A. K.".

37. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/275 dhe 2/276 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin polifunksional ne sherbim te Plazhit 3-kate ne lagjen òUji i Ftohte me pronar trualli A. Sh. e subjekt ndertues "L.S" sh.p.k.

38. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/279 dhe 2/280 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin 8 kate, 1 kat dyqane, 7 kate banim + 1-kat parkim nentoke ne lagjen òUji i Ftohte" me pronar trualli N. H. dhe subjekt ndertues "Xh.".

39. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/285 dhe 2/286 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin banim dhe sherbime 8-9 kate me 1-kat parkim nentoke ne lagjen òUji i Ftohteö me pronar trualli Sh., Sh., R., K., C. , D. e subjekt ndertues "D.".

40. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.2/287 dhe 2/288 date 28.09.2011 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin rezidenca banimi 4- kate me 1-kat parkim nentoke ne dagjen òUji i Ftohteö me pronar trualli M. V., M. M. e K. M. e subjekt ndertues "D.H.K".

41. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.1/8 date 24.03.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Kompleks vilash 2-kate (A.B.C.D.E.F.G) ne lagjen "Uji i Ftohte" me pronar truall "O. V." sh.p.k dhe subjekt ndertues "O.V." sh.p.k.
42. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.1/9 date 24.03.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine polifunkionale 3-15 kate +observator me 2-kate parkim nen toke me pronar E. T., A. H., S. N., K., G. H. dhe subjekt "L. 21 .1".
43. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.1/10 date 24.03.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin Godine banimi dhe sherbimesh 8-9-10 kate + 1 kat nentoke rruga David Sclenica me pronar R. M. dhe subjekt "S. T.".
44. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.5/71 date 17.08.2010 dhe Nr.7/69 date 07.09.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin godine banimi dhe sherbime 6-8-10 -kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "24 Maji" me pronare truall A. Rr. dhe subjekt "M.G".
45. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.7/21 date 07.09.2010 dhe Nr.7/56 date 07.09.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin godine banimi 5 kate ne rrugen Nr.5 me pronare truall V. D. dhe A. D.
46. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.7/38 date 07.09.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin godine banimi dhe sherbime 3-7-8 - kate me 1-kat parkim nentoke (Fazal-3 kate, Faza 2 -5 kate, faza 3 -8 kate) ne lagjen "11 Janari" me pronare truall H. Xh., A. Xh., Z. Xh., A. Xh. dhe subjekt ndertues "N. C.".
47. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.7/33 date 07.09.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin 3-4-6-8 kate me 1-kat dyqane, 2-4-5-6-7 kate banim, 1 kat parkim nentoke ne lagjen "10 Korriku" me pronare truall Xh., M., Xh. dhe H. K., M. K., B. Xh., N. A., T. B., B. K., Z. B. dhe subjekt ndertues "M.".
48. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.6/11 date 31.08.2010 dhe Nr.6/13 date 31.08.2010 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin godine banimi dhe sherbimesh 2-8-10 kate me 2 kate nentoke ne Lagjen "Pavaresia" me pronare truall R. Gj. dhe subjekt ndertues "D.H.Kö.
49. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.3/115 date 23.10.2009 dhe 3/168 date 23.10.2009 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin kompleks turistik (Hotel) 2-9-10-11 kate me kat nentoke ne lagjen "Uji i Ftohte" me pronar truall A. Sh.
50. Te revokohet sheshi dhe leja e ndertimit miratuar perkatesisht me vendim Nr.3/119 date 23.10.2009 dhe Nr.3/172 te K.RR.T se Bashkise Vlore per objektin banese 7 kate me 2 kate dyqane dhe 1 kat parkim nentoke ne lagjen "15 Tetori" me pronar truall R. Xh. me verejtje te perputhet me SUP e zones dhe me subjekt ndertues "J. K.ö.
- Një pjesë e këtyre lejeve të revokuara ju kanë drejtuar Gjykatës për anullim akti administrativ dhe zbardhje leje ndërtimi.
- Nga dosjet vëna në dispozicion u audituan me zgjedhje 4 leje ndërtimi nga ku u konstatau diferenca në pagësën e taksës së infrastrukturës me efekt negativ në buxhetin e bashkisë Vlorë.

1 Titulli i Gjetjes: Leje ndërtimi nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin "D.öshpk me nr. Lic NZ. 5296/1 me objekt "Godinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen "Dëshmorët" Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019.

Situata: Nga auditimi u konstatau se kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/91 dhe nr. 2/92, date 28.09.2011 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Nga ana e bashkisë Vlorë për subjektin ndërtues nuk është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pasi subjekti ndërtues nuk ka likuaduar detyrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe ndërtimeve të reja duke tejkualuar çdo afat të parashikuar ligjorë.

-Ne bazë të nenit 51 të ligjit nr. 8404, date 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i cili ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, parashikohet se; Personi fizik dhe Juridik, përpara

marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit , duhet të paguaj 1 % të vlerës së investimit që do të kryej sipas preventivit të objektit dhe 3% taksë e ndikimi në infrastrukturën.

Ky fond depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor. Paga behet menjëherë në seksionin e financës sekeshillit të qarkut apo qytetit të kategorisë së parë me autorizim të sekretarisë teknike të KRRT-së. Dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet personit fizik apo juridik jo më vonë se 1 ditë punë pas datës së depozitimit të dokumentit të pagesës në dosjen e objektit.

Në rast se kerkuesi nuk kryen pagesën brenda 30 ditëve punë nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo ditë vonese i **llogaritet kamate 0,2 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë**, deri në 60 ditë punë. Nëse në përfundim të këtij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet **1 për qind në ditë deri në 30 ditë punë të tjera**. Në rast të kundërt, KRRT-ja vendosmasa të tjera të pershtatshme, **deri në anulimin e vete /lejes së miratuar"**.

Në vijim të këtij parashikimi, në nenin 53 të këtij ligji përcaktohet se: "Leja e ndërtimit i jepet kerkuesit të saj sipas formularit nr. 4, pjesë e ligjit.

Në bazë të nenit 59 të Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin e territorit" parashikohet: "Lejen e zhvillimit të ndërtimit të miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji zbatohen në përputhje me kushtet e lejes perkatese. Dorezimi i lejes së ndërtimit për lejet e miratuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të perfundojë brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Me shkresën nr. 10389/1 prot., datë 19.01.2017 të Bashkisë Vlorë informohet paditesi se nuk mund të zbardhen sheshi i ndërtimit dhe leja e ndërtimit të miratuar me vendimet nr.2/91 dhe nr. 2/92, datë 28.09.2011 të K.Rr.T., Bashkia Vlorë, pasi këto vendime janë revokuar me vendimin nr. 35/5, datë 10.10.2013 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë. Bashkelidhur shkresës është paraqitur edhe vendimi nr. 35/5, datë 10.10.2013 i Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Për këtë leje është marrë vendimi I gjykatës nr. 546 akti nr. 522 vendimi datë 13.04.2017 me objekt: Detyrimin e të paditurve të pajisin shoqërinë ëD.ëshpk me dokumentin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit sipas vendimit nr. 2/91 dhe nr. 2/92, datë 28/09.2011 të këshillit të rregullimit të territorit, Bashkia Vlorë.

Kundërshtim i vendimit nr. 35/5, datë 10.10.2013 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Pas shqyrtimit të provave dhe fakteve dhe arsyetimit ligjorë Gjykatësi K. Dh.**vendosi**:

1. Pranimin e kërkespadiës së bazuar në prova dhe në ligj.
2. Detyrimin e të paditurve Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit pranë Bashkisë Vlorë të pajisin palen paditese dhe nderhyresin kryesor shoqërinë "D." sh.p.k. me dokumentin e sheshit dhe të lejes së ndërtimit, të miratuar sipas vendimeve nr.2/91 dhe nr. 2/92, datë 28.09.2011 të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Vlorë.
3. Anullimin e aktit administrativ vendim nr. 35/5, datë 10.10.2013 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë si akt i nxjerre në kundërshtim me Ligjin.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura solidarisht.
5. Ndaj këtij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.
6. Urdhërohet Zyra e Përmbarimit me ekzekutimin e këtij vendimi nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.
7. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmeja e shpalljes për palet e pranishme dhe nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit për palet në mungesë.

Për këtë vendim nga ana e Drejtorisë Juridike nuk është bërë ankimim pranë Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë duke çënuar interes të bashkisë Vlorë veprime në kundërshtim me: Ligj Nr. 49/2012 për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (ndryshuar me ligjet nr.100, datë 31.7.2014, nr. 39/2017, datë 30.3.2017, nr. 49/2021, datë 23.3.2021)

Neni 3 Parimet e gjyqimit administrativ

3. Organi i administratës publike, si rregull, **ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj** dhe në fakt të veprimeve të kryera prej tij.

Neni 26 Mosparaqitja e provave nga organi publik

1. Paraqitja e provave nga palët bëhet, në çdo rast, përpara seancës së parë gjyqësore. Me kërkesë me shkrim të motivuar të organit publik, të paraqitur brenda afatit të caktuar, sipas shkronjës òbò të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji, gjykata i cakton atij një afat të dytë, që duhet të mbarojë jo më vonë se 5 ditë përpara datës së seancës gjyqësore. Në rast të mosparaqitjes së provave edhe brenda afatit të dytë të caktuar, shqyrtimi i çështjes vazhdon vetëm mbi aktet e paraqitura.

2. Shkelja e pajustificuar e detyrimit për të paraqitur provat nga organi publik edhe brenda afatit të dytë të caktuar përbën shkak që gjykata, me kërkesë të palës, ose kryesisht, të caktojë gjobë ndaj titullarit të organit publik. Masa e gjobës është e barabartë me 20 për qind të pagesë minimale në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë.

3. Në rast se organi publik nuk i paraqet provat deri në datën e seancës gjyqësore, atëherë gjykata, duke vlerësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, mund të konsiderojë të provuar faktet e pretenduara nga pala tjetër, për provimin e të cilave janë kërkuar këto prova.

Neni 35 Barra e provës

1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

2. Organi i administratës publike ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi.

3. Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj. Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.

Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë

Neni 82 Barra e provës

1. Barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara pavarësisht nga detyrimi i administratës i parashikuar në paragrafin 1 të nenit 81.

-Në nenin 128 pika 1 dhe pika 3 të Kodit, ku përcaktohet se

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

3. Mjetet ligjore administrative janë:

a) ankimi administrativ, i cili përfshin:

Edhe pse është një faturë e prerë më 30.04.2014 sipas vendimit të Gjykatës fatura është likuajdua 15.10.2014, po sipas këtij vendimi në faqen 4 paragrafi 2 shprehet qart afatet e pagesës si më poshtë:

Ne rast se kerkuesi nuk kryen pagesen brenda 30 diteve pune nga njoftimi per detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atehere per cdo dite vonese i llogaritet kamate 0,2 per qind ne dite e shumes qe duhet te paguaje, deri ne 60 dite pune. Nese ne perfundim te ketij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet 1 per qind ne dite deri ne 30 dite pune te tjera. Ne rast te kundert, KRRT-ja vendos masa te tjera te pershtatshme, deri ne anulimin e vete lejes se miratuar".

Ne vijim te ketij parashikimi, ne nenin 53 te ketij ligji percaktohet se: "Leja e ndertimit i jepet kerkuesit te saj sipas formularit nr. 4, pjese e ligjit.

Në se i referohemi këtij neni drejtorja e planifikimit duhet te përllogariste vonesën në pagesën e taksës në masën :

Nga 01.05.2014-30.07.2014 (3,613,783lek x 0.2% x 60 ditë = 433,654 lekë

Nga 31.07.2014-30.08.2014 (3,613,783lek x 1% x 30 ditë = 1,084,135 lekë

Total = 1,517,789 lekë

-Në rast mos pagesë KRRT-ja vendos masa te tjera te pershtatshme, deri ne anulimin e vete /lejes se miratuar".

Edhe pse në këto kushte nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit nuk janë llogarit penalitetet dhe nga ana e Drejtorisë Juridike nuk është bërë ankimi në shkallat e tjera të gjyqësorit.

2 Titulli i Gjetjes: Leje ndërtimi nr. Prot. 3667/1 datë 11.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin òB.ò shpk me nr. Lic NZ. 6....3 me objekt òBanesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntok në lagjen "10 korriku" Vlorë me afat zbatimi deri më 11.05.2022.

Situata: Nga auditimi u kostatua se kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/49 dhe nr. 2/50, date 28.09.2011 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Nga ana e bashkisë Vlorë për subjektin ndërtues nuk është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pasi subjekti ndërtues nuk ka likujduar detyrimin e taksës së ndikimit në infrastructure dhe ndërtimeve të reja duke tejkaluar çdo afat të parashikuar ligjorë.

-Ne bazë të nenit 51 të ligjit nr. 8404, date 17.09.1998 òPër Urbanistikënò, i cili ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, parashikohet se; Personi fizik dhe Juridik, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit, duhet të paguaj 1 % të vlerës së investimit që do të kryej sipas preventivit të objektit dhe 3% taksën e ndikimi në infrastrukturën sipas paketës fiskale të vitit 2010.

Ne rast se kerkuesi nuk kryen pagesen brenda 30 diteve pune nga njoftimi per detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atehere per cdo dite vonese i **llogaritet kamate 0,2 per qind ne dite e shumes qe duhet te paguaje**, deri ne 60 dite pune. Nese ne perfundim te ketij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet **1 per qind ne dite deri ne 30 dite pune te tjera**. Ne rast te kundert, KRRT-ja vendosmasa te tjera te pershtatshme, **deri ne anulimin e vete /lejes se miratuar"**. Me shkresen nr. 6125/1 prot., date 19.07.2017 te Bashkise Vlore informohetpaditesi se nuk mund te zbardhen sheshi i ndertimit dhe leja e ndertimit te miratuaram vendimet nr. 2/49 dhe nr. 2/50, date 28.09.2011 te K.Rr.T., Bashkia Vlore, pasi; Ne baze te nenit 59 te Ligjit nr. 107/2014 "Per planifikimin e territorit" parashikonse: "Lejen e zhvillimit ndertimit te miratuara perpara hyrjes ne fuqi te ketij ligji

zbatohen ne perputhje me kushtet e lejes perkatese. Dorezimi i lejes se ndertimit per lejet e miratuara perpara hyrjes ne fuqi te ketij ligji duhet te perfundoje brenda 15 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.

Për këtë leje është marrë vendimi I gjykatës nr. 1485 akti nr. 1391 vendimi date 30.10.2017 me objekt: Sigurimin e padisë. Vënien në ekzekutim të përkohshëm të lejës së ndërtimit miratuar me vendimet nr.2/49 dhe 2/50 datë 28.09.2011 të KRRT-së Bashkia Vlorë për ndërtimin e 4 objektëve Banesë 8 kate me 1 kat shërbim në lagjen ò10Korrikuò Vlorë me pronarë truall N. I., A. B., F. Gj. dhe K. V. Kundërshtimin e aktit administrativ shkresë me nr.6125/1 prot, datë 19.07.2017 e Bashkisë Vlorë.

Detyrimin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, Bashkia Vlorë për dorëzimin e dokumentit ligjor, konkretisht të Formularit "Leje ndërtimiò për 4 objekte "Banesë 8 kate me 1 kat shërbimò në lagjen ò10 Korrikuò Vlorë, miratuar me vendimet nr.2/49 dhe 2/50 datë 28.09.2011 të KRRT-së Bashkia Vlorë me pronarë truallN. I., A. B., F. Gj. dhe K. V.

Pas shqyrtimit të provave dhe fakteve dhe arsyetimin ligjorë Gjykatësi K. Dh.**vendosi:**

1.Pranimin e kërkespadisë si të bazuar në prova dhe në ligj.

2. Anullimin e aktit administrative shkresë me nr. 6125/1 prot, date 19.07.2017 të pales së paditur Bashkia Vlorë.

3. Detyrimin e pales se paditur Bashkia Vlore per dorezimin e dokumentit ligjor, konkretisht te Formularit "Leje ndertimi" per 4 objekte "Banesë 8 kate me 1 kat shërbimë në lagjen "10 Korriku" Vlorë, miratuar me vendimet nr.2/49 dhe 2/50 datë 28.09.2011 të KRRT-së Bashkia Vlorë me pronarë trualli N. I., A. B., F. Gj. dhe K. V. dhe subjekt ndertues "B.ö sh.p.k.
4. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.
5. Ndaj ketij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.
6. Ky vendim eshte i ekzekutueshem prej Zyres se Permbarimit menjehere pasi vendimi te marre forme te prere.
7. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesembedhete) diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane duke filluar ky afat nga dita e neserme e shpalljes se vendimit per palen e pranishme dhe nga dita e neserme e komunikimit per palen me mungese.

Për këtë vendim nga ana e Drejtorisë Juridike nuk është bërë ankimim pranë Gjykatën Administrative te Apelit Tirane duke cënuar interes e bashkisë Vlorë.

Edhe pse është një faturë e prerë më 17.04.2018 nr. 205 nënshkruar nga ark. A. B. dhe dr. E. A., taksa e llogaritur është në bazë të paketës fiskale 2011 në kundërshtim me vendimin nr. 100 datë 22.12.2017 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë" i cili në faqen 6 pika 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ku përcaktohet se taksa e ndikimit në infrastrukturë për zonën qendër është **8% e çmimit të shitjes**. Nëse i referohemi paketës aktuale fiskale drejtoria e planifikimit duhet të përllogariste taksën si më poshtë:

Objekti A sipërfaqe ndërtimi 9545.4 m² x 61,800 lekë = 589,905,720 lekë x 8% = 47,192,457 lekë

Objekti B sipërfaqe ndërtimi 10,491.4 m² x 61,800 lekë = 648,368,520 lekë x 8% = 51,869,481 lekë

Total = 99,061,938 lekë

Nga ana ark. A. B. dhe dr. E. A., taksa e llogaritur për këto dy objekte kap vlerën prej 19,916,497.79 lekë, me një diferenc negative prej 99,061,938 lekë - 19,916,497 lekë = **79,145,441 lekë Vlerë e cila përbën efekt finaciarë negative për buxhetin e bashkisë dhe duhet rilogaritur dhe mbajtur subjektit ndërtues.**

3 Titulli i Gjetjes: Leje ndërtimi nr. Prot. 4026/1 datë 22.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvillues subjektin "B.öshpk me nr. Lic NZ. 6313 me objekt "Godinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen "Pavarsia" Vlorë me afat zbatimi deri më 22.05.2022.

Situata: -Nga auditimi u kostatua se kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 3/66 dhe nr. 3/87, date 07.06.2010 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Nga ana e bashkisë Vlorë për subjektin ndërtues nuk është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pasi subjekti ndërtues nuk ka likujtuar detyrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe ndërtimeve të reja duke tejkaluar çdo afat të parashikuar ligjorë.

-Ne bazë të nenit 51 të ligjit nr. 8404, date 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i cili ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit, parashikohet se; Personi fizik dhe Juridik, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit, duhet të paguaj 1 % të vlerës së investimit që do të kryej sipas preventivit të objektit dhe 3% ta kushtë e ndikimi në infrastrukturën sipas paketës fiskale të vitit 2010.

Ne rast se kerkuesi nuk kryen pagesen brenda 30 diteve pune nga njoftimi per detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atehere per cdo dite vonese i **llogaritet kamate 0,2 per qind ne dite e shumes qe duhet te paguaje**, deri ne 60 dite pune. Nese ne perfundim te ketij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet **1 per qind ne dite deri ne 30 dite pune te tjera**. Ne rast te kundert, KRRT-ja vendosmasa te tjera te pershtatshme, **deri ne anulimin e vete /lejes se miratuar"**.

Me shkresen nr. 5164/1 prot., date 07.07.2017 te Bashkise Vlore informohet paditesi se nuk mund te zbardhen sheshi i ndertimit dhe leja e ndertimit te miratuara me vendimet nr. 3/66 dhe nr. 3/87, date 07/06.2010 te K.Rr.T., Bashkia Vlore, pasi;

Ne vendimet respektive miratuar nga ana e KRIT-it, Bashkia Vlore, si me lart, nuk eshte i percaktuar numri i objekteve apo te jene numertuar objektet qe perfshihen ne sheshin e ndertimit apo dhe ne lejen perkatese te ndertimit.

Sipas formulareve ligjore te sheshit dhe lejes se ndertimit, qe gjenden ne Drejtorine e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit rezultojne leje te zbardhura, vec e vec, 5 objekte me subjekt ndertues oB."

Gjithashtu ju bejme me dije se ne Drejtorine e Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit, **nuk evidentohet dokumentacion tekniko-ligjor per objekt 6.**

Ne baze te nenit 59 te Ligjit nr. 107/2014 "Per planifikimin e territorit" parashikonse: "Lejen e zhvillimit ndertimit te miratuara perpara hyrjes ne fuqi te ketij ligji zbatohen ne perputhje me kushtet e lejes perkatese. Dorezimi i lejes se ndertimit per lejet e miratuara perpara hyrjes ne fuqi te ketij ligji duhet te perfundoje **brenda 15 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.**

Për këtë vendim nga ana e Drejtorisë Juridike nuk është bërë ankimim pranë Gjykatën Administrative te Apelit Tirane duke cënuar interes e bashkisë Vlorë pas inga ana e Drejtorisë Juridike nuk është pare e arsyeshme.

Për këtë leje është marrë vendimi i gjykatës nr. 1484 akti nr. 1347 vendimi date 23.10.2017 me objekt: Sigurimin e padisë. Vënien në ekzekutim të përkohshëm të lejës së ndërtimit miratuar me vendimet nr.3/66 dhe 3/87 datë 07.06.2010 të KRRT-së Bashkia Vlorë për ndërtimin e objekteve banimi dhe shërbimi 1-10-12 kate me dyqane, 1 kat parkim nëntok, në lagjen oPavarsia o Vlorë me pronarë trualli N. B., P. B., S. B., F. B., D. P., L. H., etj dhe subjekt ndërtues oB. o shpk. Kundërshtimin e aktit administrativ shkresë me nr.5164/1 prot, datë 07.07.2017 e Bashkisë Vlorë.

Detyrimin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, Bashkia Vlorë për dorëzimin e dokumentit ligjor, konkretisht të Formularit "Leje ndërtimi o objekte banimi dhe shërbime 1-10-12 kate me dyqane, I kat parkim nëntok, në lagjen pavarasia Vlorë, miratuar me vendimet nr.3/66 dhe 3/87 datë 07.06.2010 të KRRT-së Bashkia Vlorë me pronarë trualli N. B., P. B., S. B., F. B., D. P., L. H., etj dhe subject ndërtyues oB. oshpk.

Pas shqyrtimit të provave dhe fakteve dhe arsyetimin ligjorë Gjykatësi K. Dh. **vendosi:**

1. Pranimin e kërkespadiës si të bazuar në prova dhe në ligj.

2. Anullimin e aktit administrative shkresë me nr. 5164/1 prot, date 07.07.2017 të pales së paditur Bashkia Vlorë.

3. Detyrimin e pales se paditur Bashkia Vlore per dorezimin e dokumentit ligjor, konkretisht te Formularit oLeje ndertimi o për objektin nr. 6 objekte banimi dhe shërbime 1-10-12 kate me dyqane, I kat parkim nëntok, në lagjen pavarasia Vlorë, miratuar me vendimet nr.3/66 dhe 3/87 datë 07.06.2010 të KRRT-së Bashkia Vlorë me pronarë trualli N. B., P., S. B., F. B., D. P., L. H., etj dhe subject ndërtyues oB. oshpk.

4. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.

5. Ndaj ketij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.

6. Ky vendim eshte i ekzekutueshem prej Zyres se Permbarimit menjehere pasi vendimi te marre forme te prere.

7. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 (pesembedhjete) diteve ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane duke filluar ky afat nga dita e neserme e shpalljes se vendimit.

Edhe pse fatura për arkëtim është prer më 30.09.2011 nr. 610 Subjekti ndërtues duke u mbështetur në vendimin e gjykatës të pa ankimuar dhe mbrojtur sic duhet në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, paguan takësën e ndikimit në infrastrukturë sipas mandatit pranë Bankës C. më 16.03.2018 pra rreth 7 vite më vonë, në kundërshtim me vendimin nr. 100 datë 22.12.2017 oPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë o viti

2018 I cili në faqen 6 pika 4. Taksa e ndikimit në infrastructure nga ndërtimet e reja ku përcaktohet se taksa e ndikimit në infrastructure për zonën qendër është **8% e çmimit të shitjes**. Nëse I referohemi paketës aktuale fiskale drejtoria e planifikimit duhet të Ri-llogariste taksën e ndikimit në infrastructure sipas paketës fisakle në fuqi si më poshtë:

Objekti me sipërfaqe ndërtimi 10,075,6 m² x 61,800 lekë = 622,672,080 lekë x 8% = **49,813,766 lekë**

Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të territorit duhet ti rillogarisin diferencën e krijuar në taksën e ndikimit në infrastructure në vlerën prej prej 49,813,766 lekë ó 13,275,477 lekë = **36,538,289 lekë, Vlerë e cila përbën efekt finaciare negative për buxhetin e bashkisë dhe duhet rillogaritur dhe mabjtur subjektit ndërtues.**

4 Titulli i Gjetjes: Leje ndërtimi nr. 95 datë 19.02.2020 për zhvilluesin **T.M.Z.B** òLeje për ndryshimin e subjektit zhvillues: ò**Godinë Banimi dhe shërbime 5 kate me 1 kat nëntok, në lagjen uji i ftohtë** miratuar me vendimin e KRRT të Bashkisë Vlorë nr. 5/95 datë 17.08.2010, me zhvillues subjektin òI.ò shpk me nr. Lic NZ. 4....1/1 me objekt Vlorë me afat zbatimi deri më 31.01.2014.

Situata: Leja e ndërtimit është miratuar në bazë të ligjit nr. 8405, date 17.09.1998 òPër Urbanistikën në një shesh ndërtimi prej 2780m² dhe sipërfaqe njolle objekti prej 1490m² me koeficient ndërtimi prej 53%. Volumi i ndërtimit për këtë object është miratuar 25,181 m² dhe lartësi mbi tokë prej 16.9m.

Taksa e ndikimit në infrastrukture për këtë objekt është paguar me 3 trasferta bankare nga I. S.B. në shumën 11,053,530 lek si më poshtë:

Trasferta nr. 004TRMF1103.....2 datë 01.02.2011 me vlerë 49,961 lekë

Trasferta nr. 004TRMF1103.....3 datë 01.02.2011 me vlerë 8,252,692 lekë

Trasferta nr. 004TRMF1103.....4 datë 01.02.2011 me vlerë 2,750,877 lekë

-Kjo leje ndërtimi është miratuar në pasurit private si më poshtë:

Z. V. S. i cili ka ne pronesi prone Truall me Siperfaqe 155 m², pasuri me nr. 20/92/2. Indeksi i Hartës VL-K-L-3-4, Zona Kadastrale: 8602, në bazë të vërtetimit hipotekor 27 datë 27/10/2006.

Z. F. B. i cili ka ne pronesi prone Truall me Siperfaqe 310 m², pasuri me nr. 20/92/4, Indeksi i Hartës VL-K-1-3-4, Zona kadastrale: 8602, në bazë të vërtetimit hipotekor 06 datë 11/01/2001;

Z. E. M. dhe "I." shpk bashkëpronar prones Truall me Siperfaqe Siperfaqe S 1540 m², pasuri me nr. 20/92/2, Indeksi i Hartës VL-K-L-1-2, Zona kadastrale: 8602, nga të cilat përkatësisht Z. E. M. ka në pronësi 633m² dhe shoqëria "I." shpk 907m² në bazë të vërtetimit hipotekor 307 date 03/09/2009;

Shoqëria òI.ò shpk e cila ka ne pronesi prone Truall me siperfaqe me siperfaqe 310 m², pasuri me nr. pasurie 20/92/5, Indeksi i Hartës VL-K-L-1-2, Zona kadastrale: 8602. Në bazë të vërtetimit hipotekor 243 datë 08.06.2009; me siperfaqe 310 m², pasuri me nr. 20/92/1, Indeksi i Hartës VL-K-L-1-2, Zona kadastrale: 8602. Në bazë të vërtetimit hipotekor 241 datë 08.06.2009; dhe pasuria me sipërfaqe 155 m², me nr. 20/92/2, Indeksi i Hartës VL-K-L-1-2, Zona kadastrale: 8602. Në bazë të vërtetimit hipotekor 242 datë 08.06.2009;

Sipërfaqja totale e truallit për ndërtim në bazë të Vërtetimeve hipotekore ndodhur në dosjen e lejes së ndërtimit është 2,780m².

-Objekti i miratuar me vendim të ish-KRRT së Bashkisë Vlorë me nr. 5/95 datë 17.08.2010 dhe zbardhur formulari nr. 4 I lejes së ndërtimit pas pagesës së tasksës më 15.02.2011, nuk ka filluar ndërtimin deri shkurt 2019. Duke u tejkualuar të gjitha afatet e ndërtimit i cili mban date 31.01.2014 si afat përfundimtarë punimesh. Por subjekti disponon vërtetimin e fillimit të punimeve , nga ku verifikohet dhë nëpërmjet pamjeve satelitore pregatitja e sheshit të ndërtimit.

-Për zgjatjen e afatit të punimeve Shoqëria òI.ò shpk ka aplikuar ne portalin e-lejenë date 25.11.2019 me kërkesën për shtyrje afati punimesh me agumentet si më posht:

Me marrjen e lejes se fillimit te punimeve nga Inspektoriati Ndertimor Urbanistik kane filluar punimet me organizimin e kantierit dhe germimin.

Duke qene se formacioni ne te cilen do te vendoseshin themelet rezultoi terren shkembor dhe ne te kalonin edhe tubat e ujesjellesit te qytetit, germimi zgjati pertej afatit te parashikuar nga ana jone.

Po ashtu, sic dihet ne vitin 2012 vendi yne hyri ne nje krize ekonomike ne te cilen u perfshi edhe oI.o shpk ne nuk mundem te ralizonim punimet. Ne ditet e soteme oI.o shpk ka shendoshur financat e saj ndaj ka mundesi financiare te realizoje punimet. Duke qene se lejes se ndertimit i ka mbaruar afati i punimeve kerkojme nga institucioni Juaj zgjatjen e afatit te punimeve sipas grafikut te ri te paraqitur.

Bashkangjitur në portal shoqëria ka paraqitur:

Vërtetim fillim punimesh nr. 550 prot date 01.03.2011

Formularin nr. 2 lejen e sheshit

Formularin nr. 4 lejen e ndërtimit

Planimetrin e sheshit të ndërtimit

Licencen etj.

Kontrat sipër marrje nr. 144 rep dhe nr. 98 kol date 03.02.2020

-Pas Shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit është marrë vendimi nr. 753 datë 17.08.2019 për: oMiratimi i këkesës së mësipërme për leje. Afati i përfundimit të zbatimit të lejes së ndërtimit shtyhet deri në date 10.12.2022

-Gjithashtu Shoqëria ka aplikuar ne portalin e-lejenë date 07.02.2020 me kërkesën leje për ndryshim subjekti zhvillimorë. Për të cilën është marrë vendimi nr. 95 datë 19.02.2020 për ndryshimin e subjektit zhvillues nga oI.o shpk tek oT.M.Z.B.o shpk.

-Për këtë subjekt nga ana e Inspektoriatit të mbrojtjes së territorit pranë bashkisë Vlorë është mbajtur procesverbali nr. 10 datë 28.06.2021 për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit pasi kati nëntok është ndërtuar mbi tokë.

-Nga I.M.T, me shkresën nr. 10224 prot. Datë 02.07.2021 ka bër Kallzim Penal për subjektin T.M.Z.B, pranë Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Vlorë.

-Me date 07.07.2021 nga Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit është marrë vendimi nr. 337 datë 07.07.2021 dënim me gjobë subjektin **T.M.Z.B 1,000,000 lekë.**

Me shkresën nr. 10487 prot. Date 09.07.2021 është bërë njoftimi I subjektit **T.M.Z.B** për dënimin me gjobë.

-Me date 13.08.2021 nga Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit është marrë vendimi nr. 386 datë 13.08.2021 oPër prishje e objektit të kundrligjshëm.

-Me shkresën nr. 12340 prot date 03.09.2021 Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë oLëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës nr. 337, date 07.07.2021 të I.M.T Bashkia Vlorë ndaj Subjekti oT.M.Z.B.o

Nga IMTV Vlorë është bërë me dije se subjektit "T.M.Z.B" i pajisur me Leje Ndertimi nr. 5/95 datë 17.08.2010 i ndryshuar i janë pezulluar punimet për shkak të shkeljes së kondicioneve të lejes, si dhe janë aplikuar penalitetet për punime pa leje.

Ndërtimi për këtë objekt është pezulluar.

2-Nga shqyrtimi i sistemit E-leje dhe auditimit me zgjidhje i disa praktikave të lëshimit të “Çertifikatës së përdorimit” për objekt e përfunduara dhe kolauduara u konstatua se:

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të Vendim të kshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 oPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit , në përfundim të procesit të zhvillimit subjekti zhvillues në zbatim të Kreut III, Neni 27 të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, paraqet kërkesën për t'u pajisur me certifikatë përdorimisë bashku me procesverbalin e kolaudit, pranë autoritetit të planifikimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

Subjekti aplikues i cili kërkon të pajiset me certifikatë përdorimi, duhet të depozitojë:

1-Kërkesën për pajisjen me certifikatë përdorimi, drejtuar pranë Autoritetit të Zhvillimit të Territorit;

2-Procesverbalin/aktin e kolaudimit të hartuar nga kolaudatori i licencuar, së bashku me licencën përkatëse, e cila duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë.

3-Deklaratën e përputhshmërisë të lëshuar nga subjekti ndërtues që ka kryer punimet, në të cilën konfirmohet kryerja e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë në fuqi.

4-Dokumentacionin shoqërues, i cili përfshin:

- Aktet e kontrollit për proceset e ndërtimit

Hapat e procedurës:

- Autoriteti përgjegjës, brenda 3 ditëve nga depozitimi i deklaratës së përputhshmërisë, kërkon, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, të gjitha opinionet, relacionet dhe aktet e konfirmimit, që janë të nevojshme për lëshimin e certifikatës së përdorimit të objektit.

- Autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje kryerjen e punimeve, kanë detyrimin të njoftojnë autoritetin përgjegjës, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, opinionet, relacionet dhe aktet e konfirmimit. Në mungesë të përgjigjes, brenda afatit 15-ditor, nga momenti i marrjes së kërkesës, pëlqimi apo miratimi konsiderohet i dhënë dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të vijojë me procedurat përkatëse.

- Brenda 5 ditëve, nga marrja e të gjitha përgjigjeve prej autoriteteve publike të specializuara apo miratimit në heshtje nga ana e tyre, sipas rastit, zyra/organi përgjegjës i planifikimit, pranë autoritetit vendor, apo Sekretariati i KKT-së, përgatit raportin e vlerësimit dhe e njofton atë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

- Brenda 7 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit, dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së deklaratës së përputhshmërisë, sipas rastit, kryetari i bashkisë apo Sekretariati i KKT-së vendos:

a) lëshimin e certifikatës së përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, si dhe zbatimin e kriterëve të dokumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;

b) në rastet kur konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera, për lëshimin e aktit të konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor, dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.

- Në rastin kur autoriteti përgjegjës, brenda afatit të përcaktuar, nuk lëshon certifikatën e përdorimit dhe aktet e kontrollit janë pa shkelje dhe është lëshuar akti i kolaudimit pa shkelje, atëherë kërkesa, konsiderohet, automatikisht, e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit gjeneron, menjëherë, vendimin e miratimit.

- Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik i lejeve edhe në regjistër. Vendimi i miratimit në heshtje, sipas kërkesës së paraqitur, përbën të vetmin dokument të nevojshëm, së bashku me aktet e kolaudimit, për regjistrimin e pronës në regjistrat e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Në sistemin E-leje për periudhën objekt auditimi u konstatuan 338 aplikime për pajisjen me çrtifikat përdorimi nga të cilat 126 janë miratuar dhe 212 kërkesa janë refuzuar, si më posht e ndarë në vite:

Viti	Aplikime	Miratuar	Refuzuar
2018	75	41	34
2019	119	66	53
2020	97	64	33
2021	47	34	13
Total	338	205	133

1 Titulli i Gjetjes:-"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 2214 u auditua në system ngarkimi I dokumentacioni I detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikat përdorimi për subjektin òM.ò shpk me object òBanesë 3-4 kat, me një kat dyqane , 2-3 kat banim, + 1 kat parkim nentok në lagjen òUji I ftohtëòVlorë, miratuar me vendim të ish-KRRT nr. 4/55 datë 14.12.2007.

Situata: Aktet e kontrollit janë të nënshkruar nga mbikqyrësi i punimeve òI.òshpk licec nr. MK.3331/1 datë 25.07.2019; I.T. lic. Nr. MK. 2523/1 datë 13.12.2018; ing. A. M. me lic. K.0855/1 datë 12.06.2018 si dhe shoqëria òM.òshpk.

Nënshkrimi i akteve të fillimit të punimeve deri në sistemimet e jashtme të sheshit mbajnë si periudhë vitin 2008 një periudhë që këto subjekte nuk dispononin licenca ërkatëse, Aktete e kontrollit janë hartuar në momentin e shfaqjes së interesit nga subjekti ndërtues për pajisje me certifikatë përdorimi dhe në përgjegjësinë e tyre kanë nënshkruar aktet si të ishin prezent gjatë fillimit të punimeve apo mbarimit të tyre. Madje kanë bërë dhe deklaratë që e kanë mbikqyrur objektin.

2 Titulli i Gjetjes -"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 2005, u auditua në system ngarkimi i dokumentacioni i detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikatë përdorimi për subjektin òF.ò shpk me object òLeje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250m2 Vlorë, miratuar nga bashkia Vlorë nr. 47 datë 28.01.2020.

Situata: Për këtë aplikim është marrë vendimi nr. 434 datë 11.06.2021 për refuzim pasi po shqyrtohet në aplikimin me nr. 2006 Prot., pasi subjekti ka dubluar aplikimet.

3 Titulli i Gjetjes:-"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 1671, u auditua në system ngarkimi I dokumentacioni I detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikatë përdorimi për subjektin òS. A.ò shpk me object òObjekt banimi individual 2 kate me një kat nëntok në Skrofotin, Njësia Administrative Novosel, Bashkia vlorë, miratuar nga bashkia Vlorë nr. 1150 datë 24.10.2018.

Situata: Bashkia vlorë me vendimin nr. 224 datë 26.03.2021 ka refuzuar kërkesën e subjektit për pajisjen me certifikatë përdorimi për mangësitë njoftuara në shkresën nr. 1671 datë 10.02.2021 të cilat aplikanti nuk i plotësoj mangësitë.

-Nga auditimi i në sistemin E-Leje në seksionin e Dokumenta të aplikantit për leje u verifikuan dokumentat e ngarkuar dhe u konstatua se:

-AktKolaudimi që nga an e drejtorisë së planifikimit të territorit cilësohet në mungese ekziston dhe është i nënshkruar nga Kolaudatori Xh. D. me datë 04.05.2020 me vulë elektronike, në seksionin Akte Kolaudimi të objektit nga kolaudatori i licencuar.

-Aktet e kontrollit ekzistojnë por nuk janë të vulosura nga inxhinieri vetëm nga subjekti zhvillues.

4 Titulli i Gjetjes:-"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 138 u auditua në system ngarkimi I dokumentacioni I detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikatë përdorimi për subjektin òS.ò shpk me object òGodin Banimi dhe shërbime 8-9-10 kate +1 kat nëntok, Lagjen pavarësia Vlorë, miratuar me vendim të Kryetarit të bashkisë Vlorë nr. 47 datë 18.06.2015.

5 Titulli i Gjetjes: -"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 8659 u auditua në system ngarkimi I dokumentacioni I detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikatë përdorimi për subjektin òA.Pò shpk me object òGodin Banimi 7-8 kate +1 kat nëntok, në lagjen Uji I ftohtë Vlorë, miratuar me vendim të ish KRRT të bashkisë Vlorë nr. 8/54 datë 15.10.2010.

Situata: Subjekti ka paraqitur:

-Deklaratën e përputhshmërisë e nënshkruar dhe firmosur nga subjekti òA. P.ò.

-Aplikimin për certifikatë përdorimi që mban datën 07.10.2018 sipas nënshkrimit elektronik në formularin standard të aplikimit.

-Formularin nr. 4 të lejes së ndërtimit miratuar me vendimin nr. 8/54 datë 15.10.2010 dhe zbardhur më 29.09.2014.

-Formularin 3/1 të lidhjes së objektit me infrastrukturën Inxhinierike, sheshi i ndërtimit

-Kontratën e sipërmarrjes nr. 5064 rep. Dhe nr. 1762 kol datë 11.12.2007

-Vërtetim nr. 3683 prot datë 11.05.2016 nga Inspektoriati Mbrojtjes së Territorit për fillim punimesh.

Relacioni i Supervizorit nënshkruar elektronikisht nga aplikuesi datë 14.06.2018.

-Akt kontrolli piketim objekti datë 22.05.2011

-Akt kontrolli përfundim themelesh datë 22.05.2011

Edhe këto dy aktkontrolle që në dukje duken të nëshkruara dhe vulosura nga Mbikqyrësja, nga forma dhe pozicionimi i vulave dhe firmës të lind një dyshim i arsheshëm për vërtetësinë e tyre.

-Akt kontrolli përfundim karabinaje datë 21.06.2014 **Pa nënshkruar dhe vulosur nga Mbikëqyrësi i punimeve.**

-Akt kontrolli Përfundim Fasade datë 15.09.2016 **Pa nënshkruar dhe vulosur nga Mbikëqyrësi i punimeve.**

-Akt kontrolli Sistemi i jashtëm i sheshit datë 20.05.2016 **Pa nënshkruar dhe vulosur nga Mbikëqyrësi i punimeve.**

-Mungon dhe deklara e përgjegjësis së Mbikëqyrësit

-Akt kolaudimi i objektit korrik 2018

-Vertetim Ujësllësi Vlorë nr. 698 prot datë 13.07.2018

-Certifikat sigurie nga mbrojtja nga zjarri nr. 7190 prot. Dat 15.08.2018

-Shkresa nga OSHEE nr. 1207/1 prot. datë 02.03.2018 për furnizimin me enegji elektrike

-Bashkia Vlorë ka dërguar shkresë në mënyrë elektronike aplikimit nr. 8659 prot datë 12.10.2018 ky i kërkon:

-Plotësoni brenda 15 ditëve kalendarike kërkesën Tuaj si më sipër, duke dorëzuar elektronikisht, përmes llogarisë suaj në portalin e-Albania, dokumentacionin vijues:

ÉKopje e lejes së ndërtimit ekzistuese,

ÉAktet e kolaudimit të objektit nga kolaudatori i licensuar, të korrigjohet

Bashkia Vlorë nëprmet Drejtorit të Planifikimit të Territorit E. A. ka dërguar shkresë datë 08.11.2018 në mënyrë elektronike aplikimit nr. 8659 duke i konfirmuar:

-Dokumentacioni i dorëzuar elektronikisht është i plotë dhe, për pasojë propozohet të vijohet me shqyrtimin në themel të kërkesës për leje.

Për këtë aplikim është marrë vendimi nr. 1234 datë 03.12.2018 për Lëshimin e Certifikate Përdorimi për objektin "GODINË BANIMI 7-8 KATE, ME 1 KAT PARKIM NENTOKË NË LAGJEN "UJI I FTOHTE" VLORË, ndërtuar nga subjekti zbatues shoqëriaöA. P.ö, sipas zgjatjes së afatit të Lejes së Ndërtimit Nr.8/54, datë 15/11/2010, për zhvilluesin shoqëriaöA. P.ö, dhe investitor shoqëriaöA. P.ö Vlorë.

Pra edhe pse me mangësitë e sipërcituara nga ana e Drejtorit të Planifikimit të territorit është kaluar për miratim lëshimi i certifikatës së përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar si Vendim të kshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 öPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritö, Kreut III , Neni 27.

6 Titulli i Gjetjes: -"Çertifikatë përdorimi", me nr. regjistri/protokolli nr. 215 u auditua në sistem ngarkimi i dokumentacioni i detyrueshëm dhe ai plotësues për pajisjen me certifikat përdorimi për subjektin öV. C.ö shpk me objekt öBanesa 8-9 kat me dyqane ne katin perdhe ne lagjen "PAVARESIA" Vloreö, miratuar me vendim të ish KRRT të bashkisë Vlorë nr. 3/2 datë 13.11.2007.

Situata: -Akt kolaudimi i objektit **nuk gjendet e ngarkuar elektronikisht, që është dhe dokumenti bazë për miratimin e certifikatës së përdorimit.**

Për këtë aplikim është marrë vendimi nr. 463 datë 26.07.2019, për Lëshimin e kësaj çertifikate përdorimi për objektin banesa 8-9 kat me dyqane ne katin perdhe ne lagjen "PAVARESIA" VLORE , ndërtuar nga subjekti zbatues, sipas Lejes së Ndërtimit Nr.3/2, datë 13/11/2007, me zhvillues H. V.

Nga ana e Drejtorit të Planifikimit të Territorit është kaluar për miratim lëshimi i certifikatës së përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar si VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 öPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritö, Kreut III , Neni 27.

Pretendimet e Subjektit/Observacionet

Në përgjigje të projekt raportit të auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Vlorë është paraqitur observacioni nga Z. A.B. me pretendimet si më posht:

A1-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Arkitetk A. B. në bazë të kontratës së punës dhe detyrave të ngarkuara si nga titullarët dhe nga rregullorja e brendshme ka për detyrë llogaritjen e sipërfaqeve hartimin e projekteve dhe punë të ndryshme të aspektit arkitektonik dhe jo financiare ashtu si jam ngarkuar me përgjegjësi.

BI-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, në asnjë rast nuk të ka ngarkuar me përgjegjësi për problematika të konstituara nga ne por të pa shkaktuara nga Ju, dhe në këtë rast duke pare emrin në mandat u ngarkuat me përgjegjësi. Nisur nga observacioni dhe detyra funksionale e jaaja dhe në këtë rast është përcaktimi i sipërfaqes, Observacioni merret në konsiderat.

7. Titulli i gjetjes: Mos mbajtje penaliteti për vonesën e pagesës.

Situata: Nga auditimi i lejes së ndërtimit nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin òD.ò shpk me nr. Lic NZ. 5296/1 me objekt òGodinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntokë, në lagjen “Dëshmorëtò Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/91 dhe nr. 2/92, date 28.09.2011 të ish-K.Rr.T Bashkia Vlorë. Edhe pse është një faturë e prerë më 30.04.2014 sipas vendimit të Gjykatës fatura është likuajduar 15.10.2014, pra rreth 5 muaj me vonesë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlllogarisnin vonesën në pagesën e taksës në masën:

Nga 01.05.2014-30.07.2014 (3,613,783lek x 0.2% x 60 ditë = 433,654 lekë

Nga 31.07.2014-30.08.2014 (3,613,783lek x 1% x 30 ditë = 1,084,135 lekë

Total = 1,517,789 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negative për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Kriteri: Situata është në kundërshtim me ligjin nr. 8404, date 17.09.1998 òPër Urbanistikënò (shfuqizuar), i cili ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të lejes së ndërtimit , i cili parashikon në nenin 51 se; Personi fizik dhe Juridik, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit , duhet të paguaj 1 % të vlerës së investimit që do të kryej sipas preventivit të objektit dhe 3% taksë në ndikimi në infrastrukturën.

Ne rast se kerkuesi nuk kryen pagesën brenda 30 diteve pune nga njoftimi përdetyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atehere për çdo ditë vonese i llogaritet kamate 0,2% në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 60 ditë pune.

Nese neperfundim të ketij afati kerkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kamata llogaritet 1përqind në ditë deri në 30 ditë pune të tjera. Ne rast të kundert, KRRT-ja vendosmasa të tjera të pershtatshme, deri në anulimin e vete /lejes së miratuar".

Ndikimi: Munges të ardhurash.

Shkaku: Nuk është zbatuar legjislacioni.

Rëndësia: E lart .

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast përpara nxejrrjes së mandate pagesës për subjektet e interesuara të përlllogariten sakt sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit detyrimet e subjekteve privatë qofshin këto përleje e ndërtimit apo fardo lloj takes apo tatimi tjetër.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subject, përpara dhe nisjes së certifikatës së përdorimit të rlllogariten taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si penalitet në vlerën 1,517,789 lekë për pagesë me vonesë subjektit “D.”shpk.

8. Titulli i gjetjes: Mos mbajtje e sakt e taksës së ndikimit në infrastrukturë .

Situata: -Nga auditimi I Lejes së ndërtimit nr. Prot. 3667/1 datë 11.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin òB.òshpk me nr. Lic NZ. 6313 me objekt òBanesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntokë në lagjen

“10 korriku” Vlorë me afat zbatimi deri më 11.05.2022 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/49 dhe nr. 2/50, date 28.09.2011 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Nga ana e bashkisë Vlorë për subjektin ndërtues nuk është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pasi subjekti ndërtues nuk ka likujtuar detyrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe ndërtimeve të reja duke tejkualuar çdo afat të parashikuar ligjorë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlogarisnin taksën ndikimit në infrastrukturë në momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën e vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Jo sipas taksave e tarifave vendore të vitit 2011:

Nga ana ark. A. B. dhe dr. E. A., taksa e llogaritur për këto dy objekte kap vlerën prej 19,916,497.79 lekë, me një diferencë negative prej 99,061,938 lekë - 19,916,497 lekë = **79,145,441 lekë Vlerë e cila përbën efekt financiarë negative për buxhetin e bashkisë dhe duhet rilogaritur dhe mbajtur subjektit ndërtues.**

Kriteri: Situata është në kundërshtim me LIGJ Nr. 107/2014 për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.

-Si dhe me vendimin nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë vitit 2018 I cili në faqen 6 pika 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ku përcaktohet se taksa e ndikimit në infrastrukturë për zonën qendër është **8% e çmimit të shitjes.**

Ndikimi: Efekt financiar negativ.

Shkaku: Nuk është zbatuar legjislacioni.

Rëndësia: E lart .

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast përpara nxejrrjes së mandate pagesës për subjektet e interesuara të rilogariten sakt detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve privatë qofshin këto për leje ndërtimi apo fardo lloj taksash apo tatimi tjetër.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, përpara dhënies së certifikatës së përdorimit të rilogariten taksat për të verifikuar dhe saktësuat detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si mos mbajtje e saktë taksash në vlerën **79,145,441 lekë subjektit “B.”shpk.**

9. Titulli i gjetjes: Mos mbajtje e saktë taksash ndikimit në infrastrukturë .

Situata: -Nga auditimi I Lejes së ndërtimit nr. Prot. 4026/1 datë 22.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvilluesin subjektin B.öshpk me nr. Lic NZ. 6....3 me objekt **Godinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen pavarësia Vlorë** Vlorë me afat zbatimi deri më 22.05.2022 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 3/66 dhe nr. 3/87, date 07.06.2010 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Nga ana e bashkisë Vlorë për subjektin ndërtues nuk është zbardhur formulari nr. 4 i lejes së ndërtimit pasi subjekti ndërtues nuk ka likujtuar detyrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe ndërtimeve të reja duke tejkualuar çdo afat të parashikuar ligjorë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlogarisnin taksën ndikimit në infrastrukturë në momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën e vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë në vonesën në pagesën e taksës në masën :

Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të territorit duhet të rilogarisnin diferencën e krijuar në taksën ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej prej 49,813,766 lekë ó 13,275,477 lekë =

36,538,289 lekë, Vlerë e cila përbën efekt financiarë negative për buxhetin e bashkisë dhe duhet rillogaritur dhe mbajtur subjektit ndërtues.

Kriteri: Situata është në kundërshtim me LIGJ Nr. 107/2014 për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Neni 46 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

2. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit.

-Si dhe me vendimin nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorëviti 2018 I cili në faqen 6 pika 4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ku përcaktohet se taksa e ndikimit në infrastrukturë për zonën qendër është **8% e çmimit të shitjes.**

Ndikimi: Efekt financiar negativ.

Shkaku: Nuk është zbatuar legjislacioni.

Rëndësia: E lart .

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast përpara nxejrrjes së mandate pages për subjektet e interesuara të rillogariten sakt detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve privatë qofshin këto për leje ndërtimit apo fardo lloj taksash apo tatime të tjera.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subject, përpara dhe nis së certifikatave të përdorimit të rillogariten taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të rillogaritur si mos mbajtje e sakt e taksave në vlerën **36,538,289 lekë subjektit "B."shpk.**

Titulli i gjetjes: Mos ankimim i vendimeve Gjyqësore.

Situata: -Nga auditimi me zgjedhje procedurave të lejeve të ndërtimit të fituara me vendim gjyqësor u konstatua se në 4 raste lejet e ndërtimit janë zbardhur vetëm me vendimin e shkallës së parë të gjykatës administrative Vlorë pa u ankimuar në shkallë të tjera të gjyqësorit. Fenomeni i cili ka sjellë dhe pasojat financiare për buxhetin e bashkisë Vlorë .

Gjithashtu këto pasajoa kanë ardhur dhe nga interpretimi i gabuar i vendimit të gjykatës pasi në asnjë rresht gjykata nuk është shprehur që për mënyrën e mbajtjes së taksave së ndikimit në infrastrukturë për këto subjekte, por vetëm për zbardhjen e lejes.

Kriteri: Situata është në kundërshtim me ligjin nr. 49/2012 datë 03.05.2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative, Neni 3 për parimet e gjykimit administrativ, Neni 26 për mosparaqitja e provave nga organi publik, Neni 35 për barrat e provës, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 për kodin e procedurave administrative të republikës së shqipërisë,

Neni 82 për barrat e provës dhe në nenin 128 pika 1 dhe pika 3 të Kodit, ku përcaktohet se

1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

3. Mjetet ligjore administrative janë:

a) ankimimi administrativ

Ndikimi: Mungesa të ardhurash.

Shkaku: Nuk është zbatuar legjislacioni.

Rëndësia: E lart .

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Juridike në do rast dhe situatat krijuar dhe agaravuar për të zgjidhur në Gjykatë duhet të bëhet mbrojtja e nevojshme dhe e domosdoshme e organit publik, për menjanimin e efekteve të tilla financiare, juridike dhe administrative.

Drjetoria Juridike p rpara do seace apo p rpra dhe gjat hartimit t k rkes padis apo mbrojtjes s nevojshme t ezauroj juridikisht do hapsir ligjore p r t b r nj p rfaq sim sa m dinjitoz n gjykat dhe menjanuar humbjet e gjyqjeve.

Titulli i gjetjes: Pasakt si n miratimin e ertifikatave t p rdorimit.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje procedurave t lejeve t nd rtimit t fituara me vendim gjykate u konstatua se n 4 raste ertifikatat e p rdormit jan l shuar me mang si. Edhe pse gjat verffikimit paraprak nga an e drejtoris s planifikimit t territorit sht njoftuar subjekti p r mang sit , pas riaplikimit pa asnj document shtes drejtoria e palnifikimit t territorit kal shuar ertifikant n e p rdorimit t mirataur nga Kryetari i Bashkis .

Kriteri: Situata është n kundërshtim Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò , në përfundim të procesit të zhvillimit subjekti zhvillues në zbatim të Kreut III , Neni 27 të VKM Nr. 408, datë 13.5.2015.

Ndikimi: Shmangie ligjore.

Shkaku: Nuk është zbatuar legjislacioni.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit t Territorit n do rast p rpara nxejrrjes s ertifikatave t p rdorimit dhe do dokumenti tjet r apo akti administrative t verifikohen rast pas rasti dokumentacioni I ngarkuar n sistemin E-Leje n se jan n p rputhje me k rkesat e legjislacionin n fuqi. T hartohen procesverbalet p rkat se dhe t informohen subjektet e interesuara.

N do rast n momentin e paraqitjes s k rkes s p r pajisjen me ertifikat p rdorimi nga ana e drejtoris s planifikimit t territorit t verifikohet situacionit p rfundimtar me prevntivin fillestar dhe t mbahen diferencat n se dalin.

2.3.3.Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin e ndërtimitò i ndryshuar. Struktura aktuale është miratuar me vendimin nr. 62 datë 31.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë dhe përbëhet nga 17 punonjës, nga të cilët 1 Kryeinspektor, 1 jurist, 13 inspektor, 1 manovrator dhe 1 punonjës transporti. Gjatë periudhës objekt auditimi, IMT është drejtuar nga 3 k/inspektorë dhe respektivisht nga z. K. R., i diplomuar për drejtësi, për periudhën 10.01.2018 deri më 22.05.2018, nga znj, R. M. e diplomuar për inxhinieri hidroteknike, për periudhën 22.05.2018 deri më 17.07.2018 (e komanduar), si dhe nga z. Z. S. i diplomuar për drejtësi, për periudhën 17.07.2018 e në vazhdim. Arsimimi i K/inspektorëve është në përputhje me nenin 11 të ligjit për òPër inspektimin e ndërtimitò. Sa i përket inspektorëve, rezulton se nga 13 inspektorë që janë aktualisht, vetëm 1 prej tyre është inxhinier, ndërsa pjesa tjetër janë juristë. Territori i Bashkisë Vlorë rezulton i ndarë në 9 rajone inspektimi, nga të cilat 5 rajone janë të qytetit Vlorë, dhe 4 rajone janë sipas Njësave Administrative që ka Bashkia Vlorë.

Veprimtaria e IMTV Vlorë, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se janë mbajtur 533 procesverbale konstatimi. Në zbatim të tyre janë vendosur 370 gjoba në vlerë totale 77,000,000 lekë, si dhe janë nxjerrë për zbatim 406 vendime për prishjen e objekteve. Nuk ka asnjë masë të vendosur për pezullimin e punimeve.

a) Për vitin 2018, janë mbajtur 225 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 129 vendime me gjobë në vlerën 24,500,000 lekë nga të cilat 34 gjoba me vlerë 500,000 lekë, për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, 52 gjoba me vlerë 50,000 lekë, për punime për të cilat kërkohet deklaratë paraprake e punimeve, 4 gjoba me vlerë 1,200,000 lekë, për punime që konsistojnë për shkelje të lejes së ndërtimit, 20 gjoba me vlerë totale 1,250,000 lekë, vendosur

në zbatim të rekomandimeve të KLSH si dhe 19 gjoba me vlerë 100,000 lekë, për punime jashtë afatit të përfundimit të lejes ose për mangësi dokumentacioni të subjekteve ndërtuese.

Për të njëjtën periudhë, IMT ka nxjerrë 173 vendime për prishje objektsh, nga të cilat rezulton se 75 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 98 vendime për prishje objektsh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.

Për të njëjtën periudhë, rezulton se nuk ka asnjë vendim për pezullim të punimeve për objektet në të cilat janë konstatuar ndërtime punimi në proces.

b) Për vitin 2019, janë mbajtur 224 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 166 vendime me gjobë në vlerën 34,100,000 lekë nga të cilat 51 gjoba me vlerë 500,000 lekë, për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, 82 gjoba me vlerë 50,000 lekë, për punime për të cilat kërkohet deklaratë paraprake e punimeve, 30 gjoba me vlerë 100,000 lekë, për punime jashtë afatit të përfundimit të lejes ose për mangësi dokumentacioni të subjekteve ndërtuese, 1 gjobë me vlerë 1,000,000 lekë, për vazhdim i punimeve pa leje, 1 gjobë me vlerë 300,000 lekë, për punime jashtë lejes së ndërtimit si dhe 1 gjobë me vlerë 150,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit.

Për të njëjtën periudhë, IMT ka nxjerrë 171 vendime për prishje objektsh, nga të cilat rezulton se 147 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 24 vendime për prishje objektsh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.

Për të njëjtën periudhë, rezulton se nuk ka asnjë vendim për pezullim të punimeve për objektet në të cilat janë konstatuar ndërtime punimi në proces.

c) Për 6 mujorin e parë të vitit 2020, janë mbajtur 84 procesverbale konstatimi, dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 75 vendime me gjobë në vlerën 18,550,000 lekë nga të cilat 29 gjoba me vlerë 500,000 lekë, për punime në të cilat kërkohet leje ndërtimi, 34 gjoba me vlerë 50,000 lekë, për punime për të cilat kërkohet deklaratë paraprake e punimeve, 10 gjoba me vlerë 100,000 lekë, për punime jashtë afatit të përfundimit të lejes, 1 gjobë me vlerë 1,000,000 lekë, për vazhdim punimesh si dhe 1 gjobë me vlerë 300,000 lekë, për punime në shkelje të projektit.

Për të njëjtën periudhë, IMT ka nxjerrë 62 vendime për prishje objektsh, nga të cilat rezulton se 58 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 4 vendime për prishje objektsh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve publike.

Për të njëjtën periudhë, rezulton se nuk ka asnjë vendim për pezullim të punimeve për objektet në të cilat janë konstatuar ndërtime punimi në proces.

Nr.	Emërtimi	Periudha 01.01-31.12.18	Periudha 01.01-31.12.2019	Periudha 01.01-30.06.20	Totali
1	Procesverbale Konstatimi	225	224	84	533
2	Vendim Pezullim Punimesh	0	0	0	0
3	Vendim Gjore	129	166	75	370
4	Vendim Prishje Objekti	173	171	62	406

Titulli i Gjetjes: Mbi auditimin e inspektimit të territorit vendor, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve.

Situata:1 Kryeinspektori i IMT, rezulton se nuk ka ekzekutuar vendimet për prishje të objekteve për të cilat është sanksionuar masa e vendimit për prishje.

2. Kryeinspektori i IMT dhe Juristja e institucionit, nuk kanë aplikuar në asnjë rast masën administrative për nxjerrjen e vendimit për pezullim të punimeve për ndërtimet e konstatuara pa leje.

3. Kryeinspektori i IMT, nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 mujor për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për masat e marra.

3. Kryeinspektori i IMT, nuk ka miratuar planet mujore të punës së institucionit.

5. Në shumicën e procedurave të mbajtura, nuk disponoheshin fotot e konstatimit të firmosura nga inspektorët, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e kundërvajtjes së kryer.

6. Të gjitha procedurat e mbajtura, nuk ishin administruar si dosje e veçantë, por mbaheshin nëpër blloqe të veçuara.

7. Juristi i institucionit, në të gjitha rastet e audituara, rezulton se nuk ka përmbushur detyrën e tij funksionale, për të dhënë përgjigje për bazueshmërinë ligjore të akteve administrative të nxjerra nga IMT. Nuk janë mbajtur relacionet apo ndonjë formë tjetër e përshtatshme ku juristi ti përcjellë kryeinspektorit mendimin juridik mbi vijimin e procedurës.

8. Në 12 procedura, u konstatua mos nxjerrja e vendimeve për ndërtimet pa leje. Në 10 raste mungon vendimi për prishje të ndërtimit pa leje.

Procedura pa vendimet përkatëse:

- F. Ç., me kundërvajtje *ōKonstruksion hekuri 8 m²ō*: Saka vendim për prishje.
- D. M., me kundërvajtje *ōMur betoni dhe platformë betoniō*: Saka vendim për prishje.
- S. B., me kundërvajtje *ōKonstruksion metalik 15 m²ō*: Saka vendim për prishje.
- A. C., me kundërvajtje *ōKonstruksion metalik mbi tarracēō*: Saka vendim për prishje.
- A. M., me kundërvajtje *ōTendë me konstruksion metalikō*: Saka vendim për prishje.
- A. H., me kundërvajtje *ōPunime në objekt 2-3 kate, vendosje armature për solete 19 m²ō*: Saka vendim për prishje.
- M. V., me kundërvajtje *ōKonstruksion druri 20 m², pedanë 10 m²ō*: Saka vendim për prishje.
- R. M., me kundërvajtje *ōTendë me konstruksion metalik dhe kolona hekuri 30 m²ō*: Saka vendim për prishje.
- A. M., me kundërvajtje *ōObjekt me konstruksion druri 14 m²ō*: Saka vendim për prishje dhe nuk ka vendim gjobe.

9. Inspektorët e IMT për objektet e konstatuara pa leje, nuk kana pasqyruar me procesverbale vijimin e punimeve, dhe trajtimin e tyre me gjobë.

Objekte të përfunduara, për të cilat nuk është ekzekutuar vendimi i prishjes:

Nr	Subjekti	Situata
1	A.V. (H. N.)	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes. Vazhdojnë punimet
2	M. V.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
3	E. M.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
4	P. B.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
5	A. R.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
6	I. N.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
7	A. Gj.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
8	S.Sh.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
9	R. R.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
10	K. S.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
11	A. Gj.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
12	G. K.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
13	I. K.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
14	Ç. D.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
15	C. Shpk	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
16	B. H.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
17	B. M.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
18	F.I 2...9 Shpk	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
19	A. M.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
20	A.S.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
21	A.H.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
22	F. M.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
23	L. D.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
24	V.Sh.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
25	L. K.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.
26	A.K.	Nuk është ekzekutuar Vendimi i Prishjes.

10. Nga auditimi, rezulton se me përjashtim të 1 inspektorit që është inxhinier hidroteknik, të gjithë inspektorët tjerë janë me arsimim në fushën e drejtësisë. Pavarësisht se ligji e përcakton se për të punuar inspektor pranë IMT-ve mund të jesh edhe jurist, duke qenë se ky institucion ka rëndësi të madhe në fushën e kontrollit të territorit, dhe disiplinimit të punimeve në fushën e ndërtimit, inspektimi me juristë e bën jo cilësor ushtrimin e kontrollit, dhe njëkohësisht pothuajse të pamundur mbajtjen e akteve të kontrollit në subjektet e pajisura me leje ndërtimi.

11. Kryeinspektorin nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi.

12. Në lidhje me kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, rezulton se juristi i institucionit ka bërë kërkesat drejtuar gjykatës në një periudhë shumë të gjatë kohore nga 5 muaj deri në 19 muaj nga nxjerrja e gjobës. Vonesa të tilla, kanë kushtëzuar Zyrën Përmbartimore Vlorë për të bërë ekzekutimin e vendimit dhe arkëtimin e gjobave, pasi siç rezulton nga shkresa Nr. 982 prot., datë 09.11.2020, kjo zyrë bën me dije IMT se pothuaj të gjithë titujt ekzekutivë janë parashkuar ose janë në prag të parashkrimit për shkak të kalimit të afatit 2 ó vjeçar.

Kriteri: Ligji Nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritë* i ndryshuar, nenet 39 pika 1 *“Leja e ndërtimitë*, neni 41 *“Deklarata paraprake për kryerjen e punimeveë*, neni 51 *“Inspektimië*, neni 52 *“Kundërvajtjet Administrativeë* pika 1 germa (e, g), neni 53 *“Ekzekutimi i dënimeveë* pika 6; Ligji Nr. 9780, datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeë* i ndryshuar, neni 4 *“Përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendoreë*, neni 5 *“Detyrat e inspektorit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendoreë”* germa (a, b, c, d, f), neni 11 *“Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territoritë*, neni 12 *“Ushtimi i kontrollitë*, neni 13 *“Dhënie e vendimeve administrative dhe afatetë* germa (a, b, c, ç); Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 *“Për inspektimin në Republikën Shqipërisëë* neni 41 germa (a); Ligji 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrativeë* neni 46; VKM Nr. 408 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritë* i ndryshuar, neni 7, neni 11 pika 1; VKM Nr. 894 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreë* pika 1 germa b/ii, pika 2, pika 5; Rregullore e Brendshme e Bashkisë Vlorë, neni 181 germa (a), neni 182 pika d/3.

Ndikimi/Efekti: Zhvillimi i territorit të Bashkisë Vlorë në mospërputhje me ligjin dhe planin rregullues, ndërtime informale në zonën e rëndësisë kombëtare siç është zona bregdetare e Vlorës.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor përkatës për planifikim e territorit, dhe inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime:1. Juristi i institucionit, të administrojë në dosje të veçanta çdo procedurë të nisur, ku të përfshihet procesverbali i konstatimit, vendimet e nxjerra në zbatim të tij, fotografitë e konstatimit të firmosura nga inspektorët, si dhe relacion bashkëlidhur ku të shprehet mendimi i juristit në lidhje me vijimin e procedurës.

2. Kryeinspektori dhe juristi i institucionit, të marra masa të menjëhershme, që në kalim të afatit 1 muaj, të përcjellë pranë gjykatës administrative vendimet e dënimeve me gjobë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, si dhe të dorëzojë gjobat pranë zyrës së financës për kontabilizimin e tyre.

3. Kryeinspektori, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e vendimeve për prishje të objekteve për të cilat kanë dalë vendimet përkatëse.

4. Kryeinspektori i IMT, të miratojë akte kontrolli dhe të ngrëjë grupe pune me specialistët përkatës për kontrollin dhe zbatimin e punimeve për objektet e pajisura me leje ndërtimi.

5. Kryetari i Bashkisë Vlorë, të vlerësojë mundësinë e rekrutimit të inspektorëve me profile të inxhinierisë për të rritur cilësinë e inspektimit.

6. Inspektorët e IMT, të marrin masa për kontroll të plotë të territorit, dhe të evidentojnë dhe marrin masa konkrete për parandalimin e vijimit të punimeve deri në përfundim të objekteve të konstatuara pa leje ndërtimi, ose në shkelje të saj.

Për sa është trajtuar në projektraportin dërguar me shkresën nr. 731/26, datë 28.12.2021, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 1158 prot., datë 07.02.2022, protokolluar në KLSH me nr. 731/38, datë 09.02.2022, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Së pari: Për vendosjen e gjobës në masën 50,000 lekë dhe jo 500,000 lekë sqarojmë se ato janë objekte jo thelbësore, të ndërtuara me konstruksione të lehta, pa themele, të çmontueshme, me funksion të përkohshëm, kundërvajtje e cila trajtohet sipas nenit 52 germa (d) si punime që

përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje, sipas nenit 41 të këtij ligji dhe dënohen me gjobë na 50,000 lekë deri 150,000 lekë. Neni 41 i ligjit 107/2014 përcakton punimet për të cilat kërkohet **deklarata paraprake për kryerjen e punimeve**, si dhe neni 7 i VKM-së Nr. 408.

Për disa nga rastet e trajtuara në pikën a) IMT sqaron se, për vitin 2018 subjekti G. K. është trajtuar me gjobë 500,00 lekë dhe jo 50,000 lekë, për subjektin A. H., procedura e mbajtur ndaj tij është rrëzuar nga Gjykata Administrative Vlorë, për vitin 2019 për subjektin F. M., procedura është rrëzuar nga Gjykata Administrative Vlorë si të pambështetura në ligj, për subjektin A. H., shtresa e betonit 360 m² është riparim i shtresës ekzistuese dhe jo shtrim i ri, për subjektin A. B., shtesa anësore që përmendet nuk objekt ekzistues duke u suvatuar dhe punimet janë vetëm konstruksion metalik, për vitin 2020 ndaj subjektit A. V. janë konstatuar 12 kollona hekuri dhe pas vijimit të punimeve është mbajtur 2-fishi gjobës.

2. Në lidhje me pikën b) për mos marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve për prishje, IMT sqaron se ka hasur vështirësi në ekzekutimin e këtyre vendimeve për mungesë mjete, për të cilin ka kërkuar vazhdimisht të pajiset me mjet nga Bashkia Vlorë. Në shumë raste objektet me vendimet prishjeje janë ekzekutuar nga vetë qytetarët.

3. Në lidhje me pretendimin për mos aplikimin e masës administrative vendim për pezullim punimesh sqarojmë se vendimi i IMT ka qenë i menjëhershëm, pra dënim me gjobë dhe vendim prishje ndërtimi. Në kushtet kur ndërtuesit nuk kanë disponuar asnjë dokument, pra nuk ka qenë e nevojshme marrja e masave pezulluese.

4. Në lidhje me pikën e) për mungesën e fotografive, IMT sqaron se në të gjitha rastet ato janë mbajtur nga inspektorët dhe kanë shërbyer për vijimin e procedurës, por mungesa aktuale e disa prej tyre ka ndodhur për shkak të problemeve në arkivën elektronike që disponojmë dhe mos mbajtjes së tyre fizike.

4. Në lidhje me pikën g) për mos marrjen e vendimeve përkatëse për disa procedura, IMT sqaron se për për F. Ç., D. M., S. B., S. K., A. C., A. M., A. H., M. V., R. M., pasi për çdo rast është vetëekzekutuar vullnetarisht nga kundërvajtësi, I paidentifikuar me pv. Nr. 000031, datë 24.06.2018 nuk na rezulton me këto të dhëna, për H. Ll. nuk ka vendim gjobe pasi objekti ka qenë ekzistues por pa dokumentacionin përkatës, për S. K. s'ka VP dhe VGJ pasi procedura është në emër të H. K. dhe jo S. K., për A. H. nuk ka VGJ pasi objekti është ekzistues, për I. H. s'ka vendim gjobe pasi objekti ka qenë ekzistues dhe inspektimi është kryer pasi ankesave të pronarit të tokës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacioni i IMT se objektet janë jo thelbësore, të çmontueshme etj, dhe trajtimi i tyre bëhet sipas nenit 41 të ligjit 107/2014 dhe neni 7 i VKM-së Nr. 408, pretendim/sqarimi qëndron duke u marrë parasysh dhe duke mos u bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit.

Në lidhje me rastet specifike, pranohet observacioni juaj për subjektet A. V. (vendosur gjobë) dhe F. M. (vendimi gjyqësor nr. 898, datë 12.09.2019), pasi keni paraqitur sqarime të mjaftueshme për pretendimet tuaja.

2. Në lidhje me arsyet e mos marrjes së masave për prishjen e ndërtimeve pa leje, observacioni juaj pranohet pjesërisht në lidhje me mungesën e një mjete për prishjen e tyre, ndërkohë që një numër i madh objekteve nuk kanë nevojë për mjete të rënda për prishjen e tyre, pasi do mjaftonte përdorimi i mjeteve prerëse (sharrë ose gur fersibel) për të ekzekutuar prishjen e tyre.

3. Në lidhje me pretendimin për mos aplikimin e masës administrative vendim për pezullim punimesh pretendimi dhe sqarimi i bërë nga ana juaj është marrë në konideratë duke mos u bërë pjesë e raportit të auditimit.

4. Në lidhje me mungesën e fotografive, observacioni pranohet pjesërisht, pasi fotot e kundërvajtjeve duhet të jenë pjesë e dosjes se procedurës, dhe të firmosura nga inspektorët përgjegjës. Ashtu si dhe ju është sqaruar më parë mungesa e tyre është element i rëndësishëm i procedurës pasi paraqet situatën e konstatimit, dhe çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen.

4. Në lidhje me mungesën e vendimeve të prishjes dhe ato të gjobës, sqarojmë se pretendimet nuk qendrojnë pasi nuk keni paraqitur prova për ekzekutimin vullnetar nga ana e subjektit

kundërvajtës (të dokumentohej me procesverbal dhe fotografi), është marrë parasysh për ndërtimet e pretenduara si të ngritura më parë në kohë dhe po ashtu është marrë në konsideratë edhe procedura e ndjekur për rastin e veprimit si rezultat i një ankese duke mos u bërë pjesë e raportit të auditimit.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, sqarojnë se pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura, ndërsa pjesa tjetër nuk pranohen pasi janë të pabazuara.

III.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin publik”i ndryshuar , VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017, Udhëzimin i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2 , datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimit të KB.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

- Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Vlorë, për asnjë rast nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.*

- Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Vlorë, për asnjë rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF *“Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”*, i ndryshuar.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Vlorë (*regjistrat e parashikimit dhe realizmit*), për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01.01.2018 - 30.06.2020	Nr.	VI. Fond limit në lekë	VI.Kontrate në lekë
Gjithsej	79	2,431,663,984	2,492,242,308
-Të hapura	28	914,762,566	1,491,192,600
- Hapura me lote	9	29,516,358	811,547,368
- Kërkesë me propozim	42	47,042,573	189,502,340

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Vlorë

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2021, janë realizuar gjithsej **79** procedura me fond limit 2,431,664 mijë lekë dhe vlerë kontrate 2,492,242 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 60,579 mijë lekë nga e cila: në **vitin 2018** janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 264,771 mijë lekë dhe vlerë kontrate 245,310 mijë lekë, për **vitin 2019** janë realizuar **23** procedura me fond limit 982,907 mijë lekë dhe vlerë kontrate 952,490 mijë lekë, p r vitin 2020 janë realizuar **19** procedura fond limit 266,353 mijë lekë dhe vlerë kontrate 237,724 mijë lekë, dhe për periudhën Janar ó Qershor 2021 janë realizuar **14** procedura me fond limit 917,631 mijë lekë dhe vlerë kontrate 1,042,293 mijë lekë

1-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje ushqime për vitin 2018”**, konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje ushqime për vitin 2018		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 34 Prot., datë 19.02.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 34 Prot., datë 19.02.2018 P. Th., kryetar, jurist H. H., anëtar, ekonomist M. Z., anëtar, ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 35 Prot., datë 19.02.2018 J. P. kryetar T. Z. anëtar F. D. anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur ó Mallraó E ndarë në 5 lote		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 25,278,600 lekë REF-49175-02-19-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) óE.ó 21,302,630 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,975,970 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 16.03.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK- Sçka; APP-sçka;KPP-sçka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Sçka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: sçka

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE.

Llogaritja e fondit limit: Prokurimi është i ndarë në 5 lote, me fond limit 25,278,600 lekë në total. Oferta fituese ka qenë në vlerën totale 21,302,630 lekë, me diferencë nga fondi limit 3,975,970 lekë, si më poshtë:

Loti 1: *óBlerje bukë për vitin 2018*ó me fond limit 2,046,000 lekë. Oferta fituese ka qenë në vlerën 1,977,800 lekë, me diferencë nga fondi limit 68,200 lekë.

Loti 2: *óBlerje vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij për vitin 2018*ó me fond limit 6,107,980 lekë. Oferta fituese ka qenë në vlerën 5,957,780 lekë, me diferencë nga fondi limit 150,200 lekë.

Loti 3: *óBlerje fruta, perime për vitin 2018*ó me fond limit 3,900,520lekë. Oferta fituese ka qenë në vlerën 3,839,400 lekë, me diferencë nga fondi limit 61,120 lekë.

Loti 4: *óBlerje mish dhe nënprodukte të tij për vitin 2018*ó me fond limit 8,225,200 lekë. Oferta fituese ka qenë në vlerën 8,214,930 lekë, me diferencë nga fondi limit 10,720 lekë.

Loti 5: *óBlerje ushqime koloniale për vitin 2018*ó me fond limit 4,998,900 lekë pa TVSh. Oferta fituese ka qenë në vlerën 4,768,180 lekë, me diferencë nga fondi limit 230,720 lekë.

Fondi limit është përcaktuar me PV nr. 1376/1, datë 19.02.2018, nga përgjegjësi i qendrës ekonomike, H. H., anëtar i NJP.

Zhvillimi i procedurës: Në këtë procedurë prokurimi ka marrë pjesë vetëm një OE, E..

OE fitues nuk vërteton se është i licencuar për të gjitha lotet për të cilët oferton. Licenca që ai ka paraqitur (e lëshuar nga QKL) është e vlefshme vetëm për shitje me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të mjetit, u konstatua se mjete i paraqitur nuk është frigoriferik dhe nga verifikimi i çertifikatës së pronësisë, në seksionin *ótë dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të mjetit*ó u konstatua se mjete është për përdorim vetjak.

Raporti përmbledhës nr. 2464 prot., datë 28.03.2018, nuk është sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *óPër miratimin e rregullave të prokurimit publikó*, i ndryshuar, neni 68 *óRaporti përmbledhësó*.

Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE óE.ó Shpk dhe nuk duhet tó kishte propozuar titullarit për shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret të cilat mund të kenë ndikuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve.

Formularët për njoftimin e fituesit janë me nr. 2465-6-7-8-9 Prot., datë 28.03.2018.

Njoftimet e nënshkrimit të kontratës janë me nr. 2570-1-2-3-4 Prot., datë 03.04.2018.

Kontratat janë lidhur sipas njoftimeve për nënshkrimin e tyre, me nr. 2570-1-2-3-4 Prot., datë 03.04.2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se në dosje nuk disponohet formulari i sigurimit të kontratës.

Titulli i gjetjes: **Kualifikim i padrejtë**

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Ushqime p r vitin 2018 me fond limit 25,278,600 lek,nga ana e KVO është kualifikuar OE i vtet m pjesmarr s ðE.ö shpk në kundërshtim Ligjin e prokurimit publik, duke mos plotësuar kriteret e vendosura, QKL e pa plot dhe mjete i transportit nuk sht frigoriferik .

Kriteri: *Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201, . Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 66 si dhe Dokumentat standarte të tenderit.*

Ndikimi: Munges sigurie ne mallrat e furnizuara

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: KVO të marr masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur panshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikim në respect të frymës së ligjit.

2-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburant për vitin 2018*”, konstatohet:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje karburanti, viti 2018		
1. Urdhër Prokurimi nr. 32 (1374), dt. 19.2.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 32 (1374), dt. 19.2.2018 P. Th. (Jurist) M. Z.(ekonomist) H. H. (ekonomist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave <i>Urdhër nr. 33 (1375), dt. 19.2.2018</i> J. P. - kryetar F. D.- anëtar T. Z. - anëtar
2. Lloji i Procedurës ðE hapur, mallra me loteö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,299,307 lekë. REF-49438-02-20-2018 Loti I me fond 9,299,307 lekë. Loti II me fond 1,566,931 lekë.	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðF.ö me marzh fitimi 3.7 % (nafta) dhe 4.7% (benzinë), dhe ofertë ekonomike 9,299,307 lekë me kontratë 2916 dhe 2916/1, datë 16.4.2018, me afat deri me datë 31.12.2018.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0.0 % 10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 4/5 OE/B. b) Skualifikuar 0/1 OE/BOE., c) Kualifikuar 4/4 OE/BOE.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.03.2018 ndryshuar për datë 21.3.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	
11. Ankimime AK- sçka; KPP/APPösçka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK sçka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; sçka

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE.

Me procesverbal nr. 1374/1, datë 19.02.2018, nga NJHDT është përlloritur fondi limit p r sasinë 71332 litra naftë dhe 12273 litra benzinë në vlerën 10,866,238 lekë pa TVSH. Në përcaktimin e çmimeve NJHDT është mbështetur në buletin e APP nr. 6, datë 12.02.2018 dhe

si marzh kontratat e mëparshme të vitit 2017. Në përcaktimin e sasinë NJHD është mbështetur në kërkesat e Drejtorive/Sektorëve të Bashkisë Vlorë në varësi të mjeteve që ato kanë, të volumit të punës dhe normativës së harxhimit për 100/km ose orë/pune.

Hartimi i kritereve: Me procesverbal nr. 1374/2, datë 19.02.2018, NJHDT ka hartuar dhe miratuar kriteret për zhvillimin e procedurës.

3-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe institucionet”**, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe institucionet”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapurë, Urdhri nr 27 datë 29.01.2021	2 Njësia e Prokurimit P. Th. A. L. F. D.	3.1 KVO Urdhri nr 28 datë 29.01.2021 J. C. T. Z. V. Z.	3.2 KSHA Urdhri nr 69 datë 26.03.2021 D. Z. A. P. V. C.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 11,645,300 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 7,400,000 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,245,300lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 08.03.2021,	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 12 b) S kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 9 OE	
7/2 Kohezgjatja e e procedurës, 1 vit.			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i Bashkisë Vlorë z. D. L. me shkresën nr. 1087 prot datë 29.01.2021 ka nxjerr Urdherin e prokurimit nr. 27 datë 29.01.2021 për kryerjen e procedurës së prokurimit **“Blerje materiale elektrike për ndriçimin publik dhe institucionet”** me fond limit 11,645,300 lek, pa marrë marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës, Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germ; a) një përshtkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Gjithashtu në dosje nuk gjindet asnjë relacion apo procesverbal sqarues për gjendjen e ketyre mallarave ne magazinë, domosdoshmërinë e blerjes së tyre, nevojën e zëvendësimit etj. Kjo e vërtetuar dhe nga Inventari i dosjes së prokurimit..

-Pas nxjerrjes së urdhërit të prokurimit nga ana e Njesisë së prokurimit në një kohë rekord janë hartuar;

procesverbali 1087/1 datë 29.01.2021 “llogaritja e fondit limit”,

Preventivi nga Drejtoria e ifnrastrutures datë 29.01.2021,

Specifikimet teknike datë 29.01.2021

Procesverbal nr. 1087/2 datë 29.01.2021 hartimi i kritereve per kualifikim

Nga ana e njesis së prokurimit nuk ka të dokumentuar anjehkresë apo doumentacion për pëellogaritjen e fodnit limit duke vënë në dyshim vlerën e llogaritur.

Madje njësia e prokurimit i referohet nenit 9 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër prokurimin Publikò në hartimin e fondit limit.

Në bazë të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 òPër prokurimin Publikò i ndryshuar neni 9 pika 1 shpreht qartazi; **Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit...**

Në rastin konkret Bashkia vlorë harton Urdhër prokurimin me nr. 1087 prot datë 29.01.2021 pastaj nxjerr procesverbalin e perllogaritjes së fondit limit me nr. 1087/1 datë 29.01.2021.

Në dukej Titullari i Autoritetit kontraktor e ka të parapërcaktuar fondit limit, Njesis së prokurimit i duhet vetëm ta shpërndajë nëpër zëra. Ky element përforcohet dhe nga oferta e ardhura që janë dukshëm më të ulta se fondi limit.

-Me shkresën nr. 1088 prot. Datë 29.01.2021 titullari i AK ka nxjerr urdhërn nr. 28 datë 29.01.2021 për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga:

J. C. Kryetar

T. Z. Anëtarë

V. Z. Anëtar.

Pas vlerësimit në sistem dhe renditjes përfundmtare në Institucion kanë ardhur ankesat për procesin e vlerësimit të KVO. Nga ana e titullarit është nxjerrë urdhëri nr. 69 datë 26.03.2021, nr. 4710 prot. Datë 26.03.2021 për pezullimin e procedurës dhe dhe ngritjen e Komisionit të shqyrtimit të ankesave të përbërë nga;

D. Z. Jurist

A. P. Juriste

V. C. Inxhiniere

Pas shqyrtimit të ankesës KSHA hartoi shkresën nr.4710/1 prot. Datë 16.03.2021 ku janë refuzuar ankesate e OE aknikmues òM.D.òshpk dhe òL. B.òshpk.

Fondi limit llogaritur nga titullari Ak 11,645,300 lekë

E. L. 7,400,000 lekë

M. D. 8,368,250 lekë

G. H. 8,578,750 lekë

L. B. 8,672,000 lekë

H. 8,887,750 lekë

Z. 9,280,000 lekë

V. 9,660,000 lekë

G. P. 10,701,000 lekë

R. C. 10,849,496 lekë

OE òM.D.òshpkò shpk, ka paraqitur ankesë pranë KPP ku kjo e fundit ka paraqitur vendimin nr. 580/1 datë 09.04.2021 për pzullim procedure dhe vënin nëpozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Pas shqyrtimit nga KPP të ankesës së OE òM.D.ò shpk, KPP ka marr vendimin nr. 182/2021 dhe ka vendosur refuzimin e ankesës dhe lënë në vendimit të KSHA.

Pas për fundimit të afatit ankimues KVO ka hartuar raportin përmbledhës për titullarin e AK me nr. 7505 prot datë 07.05.2021 i miratuar nga titullari i AK.

Kontra nr. 8564 prot datë 28.05.2021.

4-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt **“Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund – Beshisht”**, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund ó Beshisht”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapurò, Urdhri nr 32 datë 29.01.2021	2 Njësia e Prokurimit P. Th. V. Z. J. C.	3.1 KVO Urdhri nr 33 datë 04.02.2021 F. D.j T. Z. E. J.	3.2 KSHA
4. Fondi Limit (pa tvsh) 54,820,172 lekë	5. Oferta fituese (pa tvsh) 50,574,872 lekë	6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,245,300lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 18.03.2021,	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë	9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 12 b) Sòkualifikuar 3 OE,	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i Bashkisë Vlorë z. D. L. me shkresën nr. 1380 prot datë 04.02.2021 ka nxjerr Urdherin e prokurimit nr. 32 datë 04.02.2021 për kryerjen e procedurës së prokurimit për Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund ó Beshishtó me fond limit 54,820,172 lekë, pa marrë marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës, Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germ; a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Pas nxjerrjes së urdhërit të prokurimit nga ana e Njesisë së prokurimit janë hartuar; procesverbali 1380/1 datë 04.02.2021 për hartimin e dokumentave të tenderit,

procesverbali 1380/2 datë 04.02.2021 për hartimin e kriterëve për kualifikim,

-Në shkresën nr. 4269 prot. Date 16.03.2021 titullari I Ak z. D. L. nxjerr shkresën me lëndë: Shtojcë për ndryshim në dokumentet e tenderit sipas shkresës 4269/1 datë 16.03.2021 të Përgjegjësit të Njesisë së prokurimit Z. P. Th. í Me shkresën nr. 4269 prot datë 16.03.2021, është vendosur kryerja e disa modifikimeve, për të plotësuar kriterin e makinerive. Ky procesverbal bëhet për efekt të dokumentimit dhe argumentimit modifikimit që është kryer.

Madje njësia e prokurimit i referohet nenit 9 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për prokurimin Publikë në hartimin e fondit limit.

Në bazë të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 për prokurimin Publikë i ndryshuar neni 9 pika 1 shpreh qartazi; Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhërit të prokurimit..

-Nga analiza e kriterëve për kualifikim u kosntatua se:

-Në lidhje me kriterin për fabrikën e asfaltit se duhet të ketë një largësi jo më shumë se 30 km nga vendi punimeve të këtij projekti, është i ndërvarur dhe gërshetuar me kriteret e mësipërme të kualifikimit, sqarojmë se nga perlllogaritjet e kryera referuar VKM Nr.629 dt. 15/07/2015 "Për miratimin e manualëve teknike të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre, si dhe VKM Nr.628 dt. 15/07/2015 për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugeve. specifike", midis të tjerave parashikon se:

Perzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjehere në kantierin e ndërtimit. E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes së perzierjes nuk lejohet të jete më shumë se 2 (dy) ore.

Temperatura e lejuar e shtrimit 130-150 °C

Per 70 min temperatura ulet me rreth 30°C

Duke patur parasysh se një kamion të transporton, sipas rregullave të qarkullimit rrugor qarkullon me shpejtësi mesatare 45-50 km/ore dhe duke patur parasysh plotësimin e kushtit prej 2 orësh përpermblylljen e procesit të shtrimit nga perlllogaritjet rezultojn:

Prodhimi i asfaltit	40 minuta
Mbushja e kamionit referuar fabrikave min 100ton/ore	10.4minuta
Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit	50 minuta
Koha e mbetur për transport materialit	19.6 minuta

Ulja e temperaturës së tij me 1°C për çdo 2-3 minuta gjatë transportit do të sillte formimin e njështresë të ftohtë sipërfaqësore e cila sa më e lartë të jetë shkalla e ftohjes së perzierjes, aq më e trashëdo të jetë e për rrjedhojë aq më të mëdha do të jenë problemet e vendosjes në terren. Ftohja e madhe e perzierjes (asfaltit) gjatë transportit ose gjatë pritjes për shkarkim çon në formimin e një shtresë tetrashë. Kjo do të shkaktonte një teksturë jouniforme në shtrimin e shtresës. Nëse Autoriteti Kontraktordë lejonte sjelljen nga çdo lloj distance apo edhe nga 60-80 km larg, koha nga momenti i ngarkimit deri në objekt, referuar edhe shpejtësive të lejuara, do të ishte 90-120 minuta.

Koha prej 60; 90 apo 120 minuta vetem per transport do te thote nje ftohje e perzierjes nga 25-40°C ne nje siperfaqe te konsiderueshme te saj, por edhe do te cenoje kushtin e percaktuar sipas VKM Nr628 date 15.07.2015 qe: **E gjithë procedura e prodhimit, transportit, vendosjes dhe ngjeshjes seperzierjes nuk lejohet te jete me shume se 2 (dy) ore.**

Duke patur parasysh temperature ne momentin e prodhimit qe varion nga 145-165°C dhe temperaturen ne momentin e shtrimit qe duhet te jete 130-150°C, ftohja prej kaq shume gradesh, efektivisht do e bente perzierjen pothuajse te papershtatshme dhe jashte kushteve teknike te percaktuara ne standartet e miratuara me VKM nr 628 date 15.07.2015. Theksojme edhe njehere se sanksionimi i afatit maksimal te lejuar per perfundimin e te gjithë proceseve te prodhimit, transportit dhe shtrimit, prej jo me shume se 2 oresh eshte treguesi me i qarte i rëndesise qe ka ky proces per cilesine e vepres. Ky afat nuk eshte orientues, por nje afat maksimal i lejuar dhe mosrespektimi i tij perben shkak per reklamim dhe mospranim te njeperzierjeje te tille.

-Me shkresën nr. 1381 prot. Datë 04.02.2021 titullari i AK ka nxjerr urdhërn nr. 33 datë 04.02.2021 për ngritjen e Komidionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga:

F. D. Kryetar

T. Z. Anëtarë

E. J. Anëtar.

-Hapaj e tenderit bëhet më 22.03.2021 dhe në referenc të Neni 66 të VKM nr. 914 òPër miratimin e rregullave të prokurimit public pika 2 shprehet:

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

c. Vertetim se i ka shlyer taksat vendore per vitin 2020 ne cdo vend te ushtrimit te aktivitetit.

A. shpk ka paraqitur vertetimin e leshuar nga Bashkia vlore me nr. 3073 prot. Date 09.04.2020 të lëshuar nga titullari i këtij Institucioni ku shprehet: í Ka likujduar detyrimet tatimore në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave vendore, Bashkia Vlore.

Nga auditimi rezultoi se Fatura për arkëtim e lëshuar nga Drjetoria e Taksave dhe Tarifave vendore mban vlerën 83,708 lek ndërsa mandate pagesa pranë R. B. mban vlerën prej 80,000 lekë.

Ky subject mbetet debitorë në vlerën 3,708 lekë.

Ne rast se oferta paraqitet nga bashkim operatorësh ekonomike bazuar ne nenin 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014

OE A.shpk ka paraqitur aktmarëveshje bashkëpunimi nr. 422 rep dhe nr. 147 kol date 22.03.2021 me shoqërinë A.L.A. për pjesmarrjen në procedurën e prokurimit òRehabilitimi dhe riasfaltimi I rrugës llakatund -Beshishtò nga ku 45% të punimeve i mbulon òA.ò shpk dhe 55% të punimeve òA.L.A.ò shpk kjo e përpjestuar në mënyrë të drejtë për çdo zë punimi sipas aneksit bashkangjitur dhe përfaqësuar nga shoqëria òA.òshpk sipas procures nr. 423 dhe nr. 148 kol. Date 22.03.2021.

Kontrtanë e furnizimit me asphalt e disponon vetem shoqëria A. shpk ndërsa OE tjetër I bashkimit nuk disponon kontrat furnizimi me asfaltobeton duke e bër të pamundur kualifikimin pas inga kontrata e bashkëpunimit zërat janë të ndarë të gjithë në mënyrë të barabart 55% me 45% , si gërmimi deri Tek Asfaltobetoni.

2. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit **nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë**, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

Pra më 06.04.2021 KVO duhet të përfundonte vlerësimin e ofertave dhe të hartonte raportin përmbledhës. Por nga ana e KVO nuk është bërë kështu por është pritur shkresa e OE B. X., me date 15.04.2021 me nr. 88 prot e cila ka paraqitur deklartën për prishje të një anshme të kontratave të furnizimit me OE pjesamrës:

N. shpk me ofert 40,335,282.5 lekë

L. shpk me ofert 45,580,986 lekë

K. shpk me ofert 48,253,429 lekë

Në çdo rast KVO vlerëson një ofertë vetëm nga dokumentacioni elektronik I hedhur në SPE, pas vlerësimit dhe renditjes në sistem mund të bëjë ndryshime nëpërmjet dokumentave fizik.

Neni 58 Komisioni i vlerësimit të ofertave

-Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Sa më sipër OE, BO A.shpk & A.L.A nuk mund të kualifikohen.

Titulli i Kualifikim i padrejte

gjetjes:

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund ó Beshishtë me fond limit 54,820,172 lek, nga ana e KVO është kualifikuar BO ekonomik òA.ò shpk dhe òA.L.A.ò shpk në kundërshtim Ligjin e prokurimit publik, duke mos plotësuar kriterin e shlyerjes së të gjithë detyrimeve dhe OE A.L.A. i BOE nuk ka kontrat furnizimi me asfaltobeton .

Kriteri: *Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr.131/2012, Ligjin Nr. 182/201, Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 si dhe me Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (Ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 74 pika 3, 3 si dhe Dokumentat standarte të tenderit.*

Ndikimi: Mundësia e punimeve jo cilësore

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: KVO të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur panshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kriterëve për kualifikim në respect të frymës së ligjit.

5-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “**Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga Blv Ismail Qemali, Rruga Kosova, Rruga Gjergj Araniti dhe Blv Gjergj Kastrioti**”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Vazhdim punimesh në objektin “Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga Blv Ismail Qemali, Rruga Kosova, Rruga Gjergj Araniti dhe Blv Gjergj Kastrioti”</i>		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 9147 Prot., datë 23.10.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 5767 Prot., datë 05.07.2018 P. Th. jurist/kryetar M. Z. anëtar/ekonomist E. A. anëtar/ing. ndërtimi	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 9148 datë 23.10.2018 G. Sh. kryetar F. D. anëtar T.Z. anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur ó Punë Publikeó		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,870,787 lekë REF-91808-10-29-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) òG.ò 16,795,258 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 75,529 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 30.11.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Vlorë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime: AK- saka; APPósaka; KPP- saka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Ska	13. Përgjigje Ankesës nga KKP: saka;

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE.

Situata: Fondi Limit, Kriteret e Kualifikimit dhe Specifikimet Teknike: Nga auditimi u konstatua se dosjet e dokumenteve të tenderit dhe dokumenteve të OE nuk janë të inventarizuara.

Fondi për këtë investim është miratuar me VKB nr. 107, datë 28.12.2017, *ōPër miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2018ō*.

Për fillimin e procedurës së prokurimit, në dosje nuk disponohet kërkesa për shpenzim, e cila paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të nivelit përkatës të njësisë, nuk disponohet miratimi paraprak nga struktura e thesarit, si dhe nuk është kontabilizuar kontrata brenda tre ditëve nga nënshkrimi i saj.

Në dosje nuk ka asnjë argument apo procesverbal në lidhje me fondin limit dhe mënyrën e përcaktimit të tij, nuk ka detyrë projektimi, nuk gjenden urdhrat për ngritjen e strukturës e cila duhet të hartojë projektin, preventivat, etj.

Urdhri i prokurimit është me nr. 9147 prot., datë 23.10.2018, ku përcaktohet edhe NjP dhe lloji i procedurës që do të ndiqet. Bashkëlidhur është formulari i njoftimit të kontratës, i cili është i pa prokokolluara dhe pa datë.

Për hartimin e DST është mbajtur procesverbali nr. 9147/1, datë 23.10.2018, i nënshkruar nga NjP, ku përcaktohen disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit, të cilat janë të paargumentuara.

Me të njëjtin nr. Protokoli, (9147/1, datë 23.10.2018) është mbajtur procesverbali për hartimin e kriterëve të kualifikimit, nga E. A. në cilësinë e grupit të projektimit.

-Ndërmjet të tjerave, për kapacitetin ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar që OE konkurrues të paraqesin vërtetime për shlyerjen e taksave vendore për vitet 2016 dhe 2017. Meqenëse tenderi zhvillohet në muajin nëntor, nga AK duhet të ishte kërkuar së paku vërtetimi për shlyerjen e taksave të vitit 2018, pasi periudha e pagesës së taksave vendore është maksimumi muaji shtator.

Për aftësinë teknike e profesionale është kërkuar *ōa) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i vlerës limitō*.

Duke ndryshuar kërkesat, nga më e vogël në më e madhe, AK ka ulur pjesëmarrjen në prokurim, duke diskriminuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

Në DST, pika 3 e shtojcës 12 kërkohet disponimin i një **gjeologu** dhe një inxhinieri agrar, **profili hortikulturë**, gjë që nga grupi i auditimit konsiderohet e tepërt, pasi në preventiva nuk parashikohen punime të thella toke apo shpime, për të cilat të nevojitet studimi i strukturës gjeologjike të tokës, ndërsa për hortikulturën, e cila ka të bëjë me lulishtet dhe kopshtet, konsiderohet i panevojshëm disponimin i një inxhinieri të specializuar, vetëm për mbjelljen e disa dhjetëra pemëve.

Kërkesa për 2 manovratorë mjetesh të rënda dhe 1 drejtues automjetesh nuk është e saktë dhe e plotë, pasi sipas kërkesave të VKM-së nr. 514, datë 20.09.2017 *ōPër miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)ō*, e rishikuar, sipas të cilës specifikohet me kod të veçantë secili profesion, i detajuar. Ndërkohë që OE kërkon disponimin e më shumë se 6 automjeteve dhe mbi 4 makinerive, kërkesa për 2 manovratorë dhe 1 drejtues automjetesh është e papërshtatshme dhe nuk përputhet me kërkesën për automjetet apo makineritë.

Hapja dhe vlerësimi i ofertave:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Arsyet e kualifikimit apo të s'kualifikimit
1	G.	16,795,258	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Në lidhje me kualifikimin e OE G. SHPK, nga AK është dërguar kërkesë për sqarime me nr. 10512 prot., datë 06.12.2018, për stafin teknik, i cili pavarësisht kontratave të punësimit, nuk rezulton në listëpagesat për të gjithë periudhën. Nga OE janë paraqitur Listëprezencat e punonjësve, të cilat janë fotokopje të panoterizuara, në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 12 të DST.

OE G. nuk ka paraqitur bilance të konfirmuara rregullisht nga tatimet, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të *Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të automjeteve, u konstatua se:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Auto vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 18 ton	2	Kamioni me targë MK.....A në pronësi të vet rezulton në rregull Kamioni me targë TR.....E është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira.
Auto vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës dhe transportues deri 3,5 ton	2	Ka paraqitur kontratë qeraje për 3 kamionçina, të cilat janë për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira. Gjithashtu nuk ka të dhëna që janë mjete vetëshkarkuese. Mjeti në pronësi të vet, me targë TR.....S, është i llojit Pick-Up, me karroceri të mbyllur dhe nuk është vetëshkarkues.
Eskavator me zinxhir	1	Ka paraqitur kontratë qeraje për 4 eskavatorë, të cilët nuk kanë targa dhe dokumentacionin e kërkuar sipas DST.
Rul me vibrim	1	Disponon 1 rul me vibrim, por nuk është i pajisur me targa dhe dokumentacionin tjetër sipas DST
Kamion vinç	1	Ka paraqitur dokumentacion për 3 autovinça me qira, nga të cilët: Mjeti me targë TR.....T është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira. Për mjetin me targë AA.....T nuk ka dokumentacion bashkëlidhur Mjeti me targë DR.....F në lejen e qarkullimit është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira.
Eskavator me goma		Mjeti me targë AB.....66 është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira. Mjeti i paraqitur si i veti, ka kontratë shitblerje të vitit 2009, por nuk ka targa dhe nuk figuron në pasqyrën e inventarit fizik të AAM, bashkëlidhur bilancit.
Autobot	1	Autoboti me targë AA.....Y është për përdorim vetjak dhe nuk mund të jepet apo merret me qira.
Grejder	1	Grejderi i paraqitur si i veti, megjithëse nuk ka dokumentacionin sipas kërkesave të DST, por vetëm deklaratë doganore të vitit 1995 dhe është në emër të firmës A., Ballsh. Grejderi i marrë me qira ka vetëm deklaratë doganore dhe është pa targa dhe dokumentacionin e kërkuar sipas DST.
Gjenerator	1	Nuk disponon në pasqyrën e inventarit fizik të AAM, bashkëlidhur bilancit, megjithëse ka paraqitur fatura blerje.

Për disa nga materialet e kërkuara për zbatimin e kontratës, nga OE G. (NUIS K17.....05A) janë paraqitur disa fatura blerje nga A. SHPK, (NUIS K10.....02T) materialet të cilat pretendohet se janë blerë nuk disponohen në pasqyrën e inventarit fizik të AAM, bashkëlidhur bilancit.

- Fatura me nr. 14 mban datën 25.09.2001, me nr. serial 1269431;
- Fatura me nr. 15 mban datën 12.10.2001, me nr. serial 1269432;
- Fatura me nr. 18 mban datën 12.10.2001, me nr. serial 1269435;
- Fatura me nr. 22 mban datën 26.03.2002, me nr. serial 1269427;

Nga auditimi i ekstraktit historik, rezultoi se Shoqëria Alba në datën 15.05.2001 ka ndryshuar emrin në G., gjë që do të thotë se shoqëria A. nuk ka ekzistuar pas kësaj date. Duke qenë se këto fatura janë prerë në një kohë kur shoqëria A. nuk ka ekzistuar, rezulton se janë të falsifikuara. Gjithashtu, meqenëse shoqëria G. nuk i disponon në inventarin e saj fizik, rezulton se ka bërë deklaratim të rremë për disponimin e materialeve të nevojshme për zbatimin e kontratës.

Me nr. 10944 prot., datë 21.12.2018 është përpiluar Raporti Përmbledhës.

Me nr. 10943 prot., datë 21.12.2018 është hartuar Formulari i njoftimit të fituesit, ku shpallet fitues OE G.

Kontrata është lidhur me nr. 11053 prot., datë 26.12.2018, me afat 3 muaj.

Për sa më sipër, KVO duhet të kishte skualifikuar OE G. dhe duhet të kishte anuluar tenderin.

Titulli i gjetjes: **Kritere të tepërta**

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga Blv Ismail Qemali, Rruga Kosova, Rruga Gjergj Araniti dhe Blv Gjergj Kastrioti* me fond limit 16,870,787 lek, nga ana e NJP janë vendosur kritere kualifikuese të pa nevojshëm në krahasim me natyrën dhe madhësinë e veprës që mund të ngushtojnë konkurrencën.

Kriteri: Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko-ndryshuar; neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

Ndikimi: Zvogëlim konkurrence

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësit të prokurimit të marrë masa që në të ardhmen të vendosin kritere

konkurrese sa më të pranueshme duke mos cënuar realizimin e kontratës zvoglimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesmarrjes në procedurat e prokurimit.

6-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “: **Prishje dhe pastrim i objektit “Ish Frigoriferi Vlorë” dhe sistemim sheshi”**.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Prishje dhe pastrim i objektit “Ish Frigoriferi Vlorë” dhe sistemim sheshi		
1. Urdhër Prokurimi nr. 217 (8449), dt. 01.10.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 217 (8449), dt. 01.10.2018 P. Th. (Jurist) M. Z. (ekonomist) E. A. (ing. Ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 271/(8499/1, dt. 01.10.2018 G. Sh. - kryetar F. D. - anëtar T. Z. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur ó Punë Publikeó		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 15,000,116 lekë. REF-88508-10-04-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE ðl.ö me ofertë ekonomike 14,877,880lekë me kontratë nr. 2083, datë 21.3.2019, me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 123 mijë lekë ose 0.82 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 06.11.2018 ndryshuar për datë 12.11.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE. b) Skualifikuar 1OE/BOE., c) Kualifikuar 1 OE/BOE.
11. Ankimime AK- nr. ---, dt. 3.12.2018; KPP nr. ---, dt. 14.01.2019/APPó sçka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. sçka	13. Përgjigje Ankesës nga KPP nr. 33/2019, dt. 23.01.2019 Nga AKKP ; sçka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i fondit limit: Kjo procedurë nuk është miratuar me Vendim të KB, por është zhvilluar bazuar në shkresën nr. 14073/2 prot datë 20.08.2018 të MFE për transferimin e fondeve në zbatim të ligjit nr. 109/2017 ðPër Buxhetin e vitit 2018ó, të udhëzimit plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2018 ðPër zbatimin e buxhetit të vitit 2018ó, si dhe në vijim të shkresës Bashkisë Vlorë nr. 5576/1, datë 11.07.2018, të miratojë transferimin e fondeve, si vijon:

Pakësohet: aparati i MFE në kod 001/Llog 231/prog 06190/kap 01 në shumën **18,811,964 lekë** me objekt “*Rikonstruksion i godinave në pronësi të NJQV për strehimin*”.

Shtohet: Bashkia Vlorë kod 146/Llog. 231/prog 06190/kap/01 në shumën 18,811,964 lekë me objekt “*Investim për lirim të sheshit për ndërtim banesash me kosto të ulët*”.

Preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë ing. E. A., M. K., N. R., top. K. A.; art. S. A. për vlerën pa TVSH prej 15,000,116 lekë pa TVSh.

Nga Bashkia Vlorë është lëshuar leja e ndërtimit për prishjen e ndërtimit ekzistues nr. 1225, datë 26.11.2018, leje kjo e lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ðPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritó, i ndryshuar dhe shkronja (b)²³ e nenit 15 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ðPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritó, pasi nga Bashkia Vlorë nuk është paraqitur çertifikatë pasurie për objektin (ish- frigoriferi), që do i nënshtrohet procesit të shembjes dhe rindërtimit të objekteve sociale.

Referuar VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 ðPër miratimin e listës paraprake të pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohet në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorëó, konstatohet se pronat me nr. Rendor 626-628; 630 dhe 629, janë në përdorim të Bashkisë Vlorë dhe jo në pronësi.

Gjithashtu për këtë pronë nga Bashkia Vlorë nuk ka bërë regjistrimin në ASHK (ish- ZRPP) Vlorë me çertifikatë pronësie për vijimin e procedurave për dhënie leje ndërtimi dhe më pas

²³ dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;

zhvillimin e procedurës së prokurimit për prishje të objektit. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: *Titullarin e AK z. D. L., me funksion kryetar i Bashkisë Vlorë, z. F. D. me funksion Drejtor i PZHT, për lejen e ndërtimit pa certifikatë pronësie, znj. S. H. me funksion Drejtor i Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve, si dhe z. P. Th. me funksion përgjegjës i Sektorit të Procedurave, për vijimin e procedurat në objekte pa pronësi.*

Hartimi i kriterëve: Me procesverbalin nr. 8449/2, datë 03.10.2018, NJHDT ka hartuar dhe miratuar kriteret për zhvillimin e procedurës.

Me procesverbalin nr. 9430/1, datë 09.11.2018, nga NJHDT janë bërë ndryshim kriteresh, si vijon:

Ishte: OE duhet të ketë minimalisht 6 manovratorë të mjeteve të rënda të pajisur me leje/dëshmi përkatëse, si dhe 6 drejtues automjesh.

Bëhet: OE duhet të ketë minimalisht 4 manovratorë të mjeteve të rënda të pajisur me leje/dëshmi përkatëse, si dhe 6 drejtues automjesh.

Ishte: Mjeti “Auto vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues” mbi 30 ton copë 8.

Bëhet: Mjeti “Auto vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues” mbi 18 ton copë 8.

Afati i hapjes së procedurës shtyhet për datë 12.11.2018.

7-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt

“Rehabilitim dhe riasfaltim i disa akseve rrugore në qytetin e Vlorës, viti 2020”.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rehabilitim dhe riasfaltim i disa akseve rrugore në qytetin e Vlorës, viti 2020		
1. Urdhër Prokurimi nr. 105 (3514prot), datë 11.05.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 105 (3514prot), datë 11.05.2020 P. Th. (Jurist) V. Z. (ekonomist) F. D. (ing. Ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 107 (3516), datë 11.05.2020 J. Ç. - kryetar G. Sh. - anëtar T. Z. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Tender i Hapurö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 58,339,731 lekë REF-57775-05-11-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òSh.ö me ofertë ekonomike 49,500,007 lekë me kontratë 6058, datë 20.7.2020, me afat 2 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8,839 mijë lekë ose 15.1 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 15.06.2020, ndryshuar me datë 24.06.2020 (ndryshim kriteresh)	9. Burimi Financimit BASHKIA Financimi me 2 periudha, ku 30 milionë në vitin 2020 dhe diferenca viti 2020	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 3 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime. AK- nr. ----, dt. ----; KPP--/APPó sçka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE dhe hartimin e kriterëve.

AK Bashkia Vlorë me procesverbal nr. 4566/1, datë 12.06.2020, ka bërë modifikimin e kriterëve sipas sugjerimeve të APP, ku data e hapjes së ofertave, nga data 12.06.2020 shkon në datën 24.06.2020.

Nga shqyrtimi i kriterëve të aplikuar për këtë procedurë, konstatohet se një kriter nuk përputhet me zërat e preventivit, konkretisht është kërkuar “1 (një) ing/Makatronik për makineritë/pajisjet e subjekti”. Ky kriter është i paargumentuar, pasi gatishmëria e mjeteve është detyrë e subjektit dhe nuk ka lidhje me zbatimin e projektit.

Titulli i gjetjes: Kriteret të tepërta

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitim dhe riasfaltim i disa akseve rrugore në qytetin e Vlorës, viti 2020” me fond limit 58,339,731 lek, nga ana e NJP janë vendosur kriteret kualifikuese të pa

nevojshëm n krahasim me natyrën dhe madh sin e veprës q mund t ngushtojnë konkurenc n.

Kriteri: Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullavetë prokurimit publikòi ndryshuar; neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

Ndikimi: Zvog lim konkurence

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Vlor të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësit e prokurimit të marri masa që në të ardhmen të vendosin kriteret konkurrese sa më të pranuaeshme duke mos cënuar realizimin e kontratës zvoglimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesmarrjes në procedurat e prokurimit.

6-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt **“Rehabilitim dhe asfaltim i rrugës Cerkovinë – Skroftinë - Trevllazer”**.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Rehabilitim dhe asfaltim i rrugës Cerkovinë – Skroftinë - Trevllazer</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 106 (3515), datë 11.05.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 106 (3515), datë 11.05.2020 P. Th. (Jurist) V. Z. (ekonomist) F. D. (ing. Ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 108 (3517), datë 11.5.2020 J. Ç. - kryetar G. Sh.- anëtar T. Z. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Tender i Hapurò		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 46,542,895 lekë REF-57777-05-11-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) BE. òB. + R. C.ò me ofertë ekonomike 35,803,886 lekë me kontratë 6058, datë 20.7.2020, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 10,739 mijë lekë ose 23 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 15.06.2020, ndryshuar për me datë 22.6.2020	9. Burimi Financimit BASHKIA. Financim me dy periudha	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE b) Skualifikuar 4 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -----, dt. -----; KPP--/APPòsòka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në shpalljen fitues të OE dhe hartimin e kriterëve.

Me procesverbal nr. 3515/1, datë 11.05.2020, NJHDT ka miratuar kriteret e procedurës. Me shkresën nr. 4567, datë 12.06.2020, AK Bashkia Vlorë ka ndryshuar kriteret, duke shtuar si kriter që OE pjesëmarrës, duhet të disponojnë Licencë III.2.A, lidhur me ndikimin në mjedis, kjo në zbatim të neni 42 të LPP. Për këtë AK Bashkia Vlorë ka shtyrë datën e hapjes së tenderit me datë 22.06.2020.

Nga shqyrtimi i kriterëve të aplikuara për këtë procedurë, konstatohen kriteret të paargumentuara, konkretisht: *Nuk argumentohet vendosja si kriter”1 (një) ing/Makatronik për makineritë/pajisjet e subjekti”*. Ky kriter është i paargumentuar, pasi gatishmëria e mjeteve është detyrë e subjektit dhe nuk ka lidhje me zbatimin e projektit.

Zhvillimi i procedurës: Nga anëtarët e KVO, me datë 13.07.2020, nr. prot 5723, është mbajtur Raporti Përmbledhës. Sipas këtij raporti në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 7 OE/BOE. Në përfundim KVO nga 7 OE/BOE pjesëmarrës, janë skualifikuar 4 OE/BOE për mos plotësim kriteresh, duke kualifikuar 3 OE/BOE, të cila të cilat janë në pasqyrën sipër.

Referuar ofertave të paraqitura nga KVO është shpallur fitues shoqëria **“B. + R. C.”** SHPK me ofertë ekonomike prej 35,803,886 lekë pa TVSH.

Formulari i njoftim fituesit, shpallur në buletin APP me nr. 43, datë 20.7.2020.

Formulari i njoftimit të kontratës nr. 6059, datë 20.07.2020.

Ndërmjet investitorit Bashkia Vlorë dhe JV òB.ò + òR.C.ò, është lidhur kontrata nr. 6058, datë 20.07.2020 me afat 30 ditë nga data e lidhjes, për vlerën 35,803,886 lekë pa TVSH dhe vlerën 42,964,663 lekë me TVSH.

2.3 Per kapacitetin teknik:

- Fabrika e Asfaltit duhet te jete e pajisur me dokumentacionin e pronesise apo marrjes me qera, apo kontrate noteriale furnizimi, te shoqeruar me leje mjedisore te leshuar nga QKL Kodi:III.1.B, e pajisur me ISO 9001:2015, mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi, si dhe te shoqerohet me Raport Monitorimi nga Organe te akredituara prane Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit te pakten 12 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.
- Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155 °C deri në 170 °C, Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 40 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet se temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se 140°C, kusht teknik për ngjeshje referuar dhe V.K.M. Nr. 628, date 15.07.2015.

-Kriter kufizues në marrjen pjesë të OE ekonomik në procedurat e prokurimit

Titulli i Kriteve të tepërta

gjetjes:

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rehabilitim dhe asfaltim i rrugës Cerkovinë – Skrofotinë - Trevllazerò me fond limit 46,542,895 lek, nga ana e NJP jan vendosur kriteret kualifikuese t pa nevojshëm n krahasim me natyrën dhe madh sin e veprës q mund t ngushtojnë konkurrenc n.

Kriteri: Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullavetë prokurimit publikòi ndryshuar; neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

Ndikimi: Zvog lim konkurrence

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Vlor të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësit e prokurimit të marri masa që në të ardhmen të vendosin kriteret konkurruese sa më të pranuaeshme duke mos cënuar realizimin e kontratës zvoglimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesmarrjes në procedurat e prokurimit.

8-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt

“Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2019”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2019</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 283, datë 24.12.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 283, datë 24.12.2018 z. P. Th. - Kryetar z. H.H.- anëtar; z. M. Z.-anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 285, datë 24.12.2018 (prot 11014) z. J. P.-Kryetar; z. F. D.- anëtar z. T. Z. - anëtar.
2. Lloji i Procedurës - “HAPURò (Marrëveshje kuadër)		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 28,147,291 lekë Ref-01271-12-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òF.ò me ofertë 28,121,131 lekë me kontratë nr. 1164/2, dt. 11.02.2019 me afat deri 31.3.2019.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 26 mijë lekë ose 0.09 %
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Sçkualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE

Datë 25.01.2019 ndryshuar për datë 30.01.2019		
11. Ankimime AK- nr. Sëska, dt. ---; APP-ösëska/ka; KPP-sëska/ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. -----	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. . datë

Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Me procesverbal nr. 11015/2, datë 24/12/2018 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur në sistemin elektronik në faqen e APP.

Nga auditimi, konstatohet se nga NJHDT janë vendosur dhe kriterë jo në përputhje me procedurën, konkretisht: *Nga NJHDT është kërkuar vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm, kriter ky i pambështetur në ligj;*

-Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve ngarkon me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT: *z. P. Th. (Jurist) me funksion përgjegjës në NJP, z. M. Z. (ekonomist) me funksion ish-Specialist në qendrën Ekonomike, z. H. H., me funksion kontabilist në Qendrën Ekonomike.*

Titulli i Kriterëve të tepërta

gjetjes:

Situata:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2019”* me fond limit 28,147,291 lek, nga ana e NJP janë vendosur kriterë kualifikues të pa nevojshëm në krahasim me natyrën dhe madhësinë e veprës që mund të ngushtojnë konkurrencën.

Kriteri:

Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar; neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

Ndikimi:

Zvoglim konkurrence

Shkaku:

Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia:

E mesme.

Rekomandimi:

Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësitë e prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të vendosin kriterë konkurrues sa më të pranueshëm duke mos cënuar realizimin e kontratës zvoglimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

9-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt

“Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2020” negociim.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>Ruajtja e objekteve të Bashkisë Vlorë</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 77 (2732), datë 17.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 77 (2732), datë 17.03.2020 P. Th. (Jurist) V. Z. (ekonomist) H. H. (ekonomist)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 76 (2730), datë 17.03.2020 J. P.- kryetar F. D.- anëtar T. Z. - anëtar
2. Niveli i Procedurës “Me negociim pa shpallje”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,987,395 lekë REF-54542-03-18-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO of.ö me ofertë ekonomike 9,987,360 lekë me kontratë 2830, datë 25.03.2020, me afat 150 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0.0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 24.03.2020	9. Burimi Financimit	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE

	Të ardhurat e bashkisë	
11. Ankimime AK- nr. -----, dt. -----; KPP--/APPósa/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Hartimi i kriterëve: Me procesverbal nr. 2730/2, datë 17.03.2020, NJHDT ka hartuar dhe miratuar kriteret për zhvillimin e procedurës.

Në kriteret e aplikuara është kërkuar vërtetim që konfirmon shlyerjen e detyrimeve të maturuara të ujësjellës-kanalizimeve, nuk është e përshtatshme dhe del nga kornizat e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, pasi sipas kësaj VKM-je, neni dhe pika e përmendur më sipër, nga OE kërkohen vërtetime që ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike dhe jo të ujësjellës-kanalizimeve, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mos pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe ngarkon me përgjegjësi njësin e prokurimit.

Titulli i Kriteret të tepërta

gjetjes:

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2019”* me fond limit 28,147,291 lek, nga ana e NJP janë vendosur kriteret kualifikuese të pa nevojshëm në krahasim me natyrën dhe madhësinë e veprës që mund të ngushtojnë konkurrencën.

Kriteri: Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12 pika c dhe Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar; neni 57 pika 2, neni 61 pika 2.

Ndikimi: Zvoglim konkurrence

Shkaku: Interpretim i gabuar i ligjit

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe njësitë e prokurimit të marrin masa që në të ardhmen të vendosin kriteret konkurruese sa më të pranueshme duke mos cënuar realizimin e kontratës zvoglimin e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së Shërbimit me roje Private për muajt Janar -Maj 2020 u konstatua se:

-Në dosjen e zbatimit të kontratës nuk ka asnjë procesverbal, për marrjen në dorëzim të objekteve të Bashkisë Vlorë.

Nga **Titullari i Autoritetit Kontraktor nuk** është përcaktuar njësia përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës. Njësia përgjegjëse të kryejë lidhur me këtë kontratë, të gjitha veprimet e përcaktuara shprehimisht në VKM nr.914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, neni 77.

1. *“Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi”*

2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike Brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.

3. Për të siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara zbaton penalitetet e parashikuara në

kontratë. “Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi”

4. ÷Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund të vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

-Nga auditimi i dokumentacionit të në SPE për listapagesa dhe nga verifikimi i zbatimit të kontratës dhe stafit të deguar në shërbimin e vendroje sipas Listave em rore e punonjësve të spitalit Korçë për do muaj sipa librave të shërbimit; u konstatua se operatori ekonomik është në kushtet e realizimit të evazionit fiscal pasi: në ofertën e dërguar dhe kontratën e lidhur operatori ekonomik harton ofertën në përputhje me kodin e punës ligjin për shërbimin e rojeve private si dhe duke llogaritur gjitha kostot dhe vlerat në pozicion dhe duke nxjerr një kosto mujore për roje prej 52,939 lek në muaj, dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore mbi këtë vlerë. Ndërkohë që në listapagesat ESig operatori ekonomik i paguan koston mujore minimale të kësaj pozicioni në vlerë në 39,000 lek në muaj e për rrjedhojë dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore mbi këtë vlerë. Operatori ekonomik ÷F.ö SHPK ka përfituar padrejtësisht 13,939 lek në muaj nga secili punonjës shërbim dhe në total shumë në pagave bruto prej 3,484,750 lek për 5 muaj të marra në auditim Janar 2020-Maj 2020 papaguara ndaj punonjësve.

Për pasojë operatori ka shmangur detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetsore për pagat e papaguara në shumë në 581,953 lek, si dhe detyrimin për Tatimin mbi të ardhurat personale në shumë në 522,712 lek, vlerat cilat përmbajnë shmangiet e detyrimeve dhe dëmtimet ekonomike ndaj buxhetit të shtetit. Operatori ekonomik ÷F.ö SHPK ka përfituar padrejtësisht 13,939 lek në muaj nga secili punonjës shërbim në total 3,484,750 lek, vlerat e cila duhet të shpërndahej punonjësve sipas muajve përkatës.

Për sa është trajtuar në aktkostatimin nr. 20 nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.73/16, datë 22.11.2021, nga z.D. L., P. Th., T. Z., V. Z., J. C., F. D.j dhe H. H., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Titulli i gjetjes: **Kualifikim i padrejtë**

Situata: Nga auditimi i zbatimit të kontratës, me objekt shërbim me roje private për Bashkinë Vlorë, u konstatua se: Nga verifikimi i listave pagesave punonjësve të ofrimit të shërbimit të rojeve në Bashkinë Vlorë paguhen me 39,000 lek në muaj pagë bazë pa përfshirë shtesat e përcaktuara për këtë pozicion pune ku sipas ofertës dhe kontratës duhet të paguheshin me $(2,406.32 \text{ lek} \times 22 \text{ ditë pune}) = 52,939 \text{ lek}$ pagë në muaj. Operatori ekonomik ÷F. SHPK ka përfituar padrejtësisht 13,939 lek për roje në muaj (sipas Ofertës së ÷F. SHPK) përfitim i padrejtë nga paga e rojeve që mban OE ÷F. SHPK.

Kriteri: DST pika 2.1 Kapaciteti ligjorë *Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me neni 60 dhe 62 si dhe me Neni 77 pikat 3 dhe 4 të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” i Ndryshuar.*

Ndikimi: Përfitim i pagës së punonjësve nga OE

Shkaku: Mos zbatim i kontratës

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore kryerja sistemimi i pagës së punonjësve sipas ofertës së kontratës nënshkruar, duke i mbajtur detyrimet tatimore përkatëse, të cilat kanë kryer shërbimin e rojeve duke ndjekur të gjitha

procedurat e nevojshme administrative për përfitimin e drejt të pagës sipas kushteve të ofertës së tenderuar dhe kontratës së kontraktuar mes operatorit ekonomik dhe Bashkisë Vlorë.

10. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë”.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë”, u konstatua se çmimet e preventivit të punimeve dhe rrjedhimisht fondit limit, janë bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 dhe për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. P. Th., z. V.Z. dhe z. J. Ç., në cilësinë e specialistit të fushës.

- Titulli i gjetjes:** Kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
Në pikën 2.3.11, të dokumenteve të tenderit është përcaktuar: *“Mbështetur në kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 561-87, duke ditur se përgatitja e asfaltit realizohet në temperaturën 155° C, fabrika/impianti i prodhimit të asfaltit duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 30 kilometër nga vendndodhja e objektit të prokurimit. Kjo për arsye që të sigurohet që temperatura e domosdoshme për ngjeshjen e asfaltit jo më pak se 140° C, kusht teknik për ngjeshjen e referuar dhe VKM nr. 628, datë 15.07.2015.*
Në këtë procedurë, distanca më e largët e transportit të asfaltobetonit është përcaktuar 30 km, me përlllogaritjet dhe argumentimin si më poshtë:
- Situata:**
- Prodhim asfaltobetonit 40 minuta.
 - Mbushja e kamionit referuar fabrikave 100 ton/orë 10.4 minuta.
 - Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit 50 minuta.
- Koha e mbetur për transport materialit 19.6 minuta.
Për shpejtësi të kamionit 40 deri 50 km/orë, është përcaktuar distanca maksimale 14.7 km, megjithatë është vendosur distanca maksimale 30 km.
Sa më sipër sqarojmë se, bazuar në dokumentet e tenderit, është kërkuar disponimi ose marrja me qira e 5 automjeteve të transportit me tonazh mbi 18 ton. Nëse marrim në konsideratë një automjet me peshëmbajrje 20 ton, prodhimi i asfaltobetonit për fabrikë 100 ton/orë (kapaciteti i marrë në llogaritje nga njësia e prokurimit), rezulton për një periudhë 12 minuta, pra koha e mbetur për transport është 47.6 minuta dhe jo 19.6 minuta. Në këto kushte, distanca maksimale duhet të ishte 31.7 kilometër.
- Kriteri:** VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61.
- Ndikimi/Efekti:** Vendosja e kriterëve jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës kufizon pjesëmarrjen në procedurë të operatorëve ekonomikë.
- Shkaku:** Mos përcaktimi i saktë i kriterëve të nevojshme, të cilat duhet të kenë synim që të vërtetojnë aftësinë teknike të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës.
- Rëndësia:** E Lartë.
- Rekomandime:** Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe rishikimin e dokumentacionit të projektpreventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi z. J. Ç., në cilësinë e specialistit të fushës.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: "Rikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë".		
1. Urdhër Prokurimi nr. 1078, datë 28.01.2021	3. njësia e prokurimit P. Th. V. Z. J. Ç.(ing. ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 1079, datë 28.01.2021. F. D. T. Z. E. J.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit (E hapur)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 15,166,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 12,956,640 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,209,360 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 10.03.2021	9. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë 1. Shoqëria òA.ò me ofertë me vlerë 12,956,640 lekë. 2. B.O.E òC. Mò & òK.ò shpk me ofertë me vlerë 9,707,540. 3. Shoqëria òSHò me ofertë me vlerë 10,000,000 lekë 4. Shoqëria òB.Xò me vlerë oferte 14,862,080 lekë. b. Skualifikuar 03 OE
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Përgjigje ankesës nga KPP -
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës Nr. 5142, datë 06.04.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) - 15,547,968 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Titulli i gjetjes: Vlerësim i gabuar i dokumenteve të ofertës së paraqitur nga OE

Rezulton se në tender kanë marrë pjesë 4 ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 ofertuesit si më poshtë:

B.O.E òC.Mò & òK.ò SHPK, me argumentimin òFabrika/Impianti i prodhimit të asfaltit është në një distancë më të largët se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, sikurse përcaktohet në dstò.

OE òSh.ò SHPK, me argumentimin Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit është në një distancë më të largët se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, sikurse përcaktohet në dstò.

OE òB.Xò SHPK, me argumentimin òOperatori ekonomik ofertues nuk është i pajisur me licencë kategoria III.2.B për òGrumbullim dhe transport i mbetjeve nga ndertimet ose prishjet" si dhe òOperatori ekonomik nuk ka te punesuar ne stafin e shoqerise 1 (një) Inxhinier Infrastruktura Transporti, per te cilin duhet te paraqese kontratë pune, diplomë, CV, te jete ne listepagesa ne periudhen e kerkuarò.

Situata:

Në këtë tender ka qenë pjesëmarrës OE òSh.ò SHPK, i cili është skualifikuar vetëm për mos plotësim të kriterit të distancës së fabrikës së asfaltobetonit. Fabrika e paraqitur nga ky OE ndodhet në kilometër 1, të aksit rrugor Fier-Patos. Nga verifikimi i distancës së vendndodhjes së fabrikës së asfaltobetonit të paraqitur nga ky OE, rezulton se distanca nga fabrika në vendzbatimin e punimeve deri në objektin që do rikonstruktohet (Hoshtime) është më e vogël se 30 kilometër, konkretisht 28.8 kilometër (bashkëngjitur harta e printuar).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues òA.ò SHPK, rezulton se dokumentacioni për mekanizmin ekskavator me zinxhirë, i përket një mekanizmi me goma. Sa më sipër, duhet të kualifikohet OE òSh.ò.

Kriteri:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, pika 1.

Ndikimi/Efekti: Vlera **2,956,640 lekë**, e cila del nga diferenca e ofertës së OE fitues òA.ò

SHPK me ofertën e paraqitur nga OE òSh.ò SHPK, konsiderohet dëm ekonomik.

Shkaku:

Mos verifikim i saktë i dokumentacionit të ofertave të paraqitur nga OE, kryesisht për përcaktimin e distancës së fabrikës së asfaltobetonit.

Rëndësia:

E Lartë.

Rekomandime:

Bashkia Vlorë të shqyrtojë vlerësimin e ofertave për këtë procedurë, duke kërkuar dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar nga KVO e përbërë nga z. F. D., z.T. Z. dhe z. E. J.

Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga z. F. D., z.T. Z. dhe z. E. J..

Për sa është trajtuar në aktkonstatimin përkatës, nga subjekti i audituar z. F. D., z. J. Ç., z. E.J. dhe z. T. Z., është paraqitur observacioni me shkresë nr.15068/2 prot, datë 18.11.2021, protokolluar në KLSH me nr. 731/18, datë 18.11.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

11. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurës së prokurimit “Blerje shtylla elektrike ndriçimi, viti 2021.

Për përlllogaritjen e fondit limit janë hartuar analiza çmimesh sipas komponentëve përkatës, pa asnjë referencë për çmimet e materialeve, për kohën dhe pagesën e punëtorisë apo çmime të zërave të ndryshëm të punimeve si, lyrje me bojë, galvanizim, saldime etj. Analiza e çmimeve për blerjen e materialeve është hartuar nga z. A. L. Çmimi sipas analizave përkatëse është më i vogël se ai i reflektuar në çmimin për çdo zë në hartimin e fondit limit si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi sipas fondit limit	Çmimi i analizës së çmimit (lekë)	Vlera sipas analizës së çmimeve lekë	Vlera e fondit limit (Lekë)
1	F. shtyllë metalike profil drejtkëndor 120 x 80 x 3 mm, e zinkuar në të nxehtë dhe e lyer me bojë me pjekje H=4.6 m, me dy ndriçues led 100 V dhe 50 V.	65	73,850	65,240.8	4,240,652	4800250
2	F. shtyllë metalike profil drejtkëndor 120 x 80 x 3 mm, e zinkuar në të nxehtë dhe e lyer me bojë me pjekje H=4.5 m, me një ndriçues led 50 V.	28	47,916	37,395.8	1,047,082	1341648
3	F. shtyllë metalike cilindrike me dy diametra dekorative, H=7 m, me ndriçues D750mm, formë obrelle led induksion 150.	76	63,791	53,700	4,081,200	4848116
4	F. shtyllë metalike cilindrike me dy diametra dekorative, D1=130 mm dhe D2=90mm, H=5 m, e zinkuar në të nxehtë, led 70 V, me trup alumini të anodizuar D=500 mm.	35	62,167	55,192	1,931,720	2175845
5	F. Shtyllë metalike cilindrike D.130 mm, H=4 m, e zinkuar në të nxehtë dhe e lyer me bojë me pjekje, me një ndriçues cilindrik led 30 V, L 500 mm	5	39,167	33,130	165,650	195835
6	F. Shtyllë metalike cilindrike dekorative, H=4.5 m, e zinkuar në të nxehtë dhe e lyer me bojë me pjekje, me një ndriçues cilindrik led 100 V.	35	48,975	39,880	1,395,800	1714125
7	F. shtyllë metalike profil drejtkëndor 120 x 80 x 3 mm, e zinkuar në të nxehtë dhe e lyer me bojë me pjekje H=6 m, me një ndriçues led 100 V.	3	43,900	40,537	121,611	131700
8	F. Shtyllë metalikë konike H=9 m, e zinkuar në të nxehtë, me krahë me dy ndriçues në formë këmbanë led 100 V, me një sinjalizues me ngjyrë blu...	11	72,650	67,800	745800	799150
9	Kabëll CU 4G4	1000	204	204	204,000	204000
10	Kabëll CU 4G6	600	302	302	181,200	181200

11	Elektrodë tokëzimi 1.5 m	258	725	725	187,050	187050
12	Pusetë plastike 30 x 30	86	745	745	64,070	64070
13	Tub fles D.63 mm me dy shtresa	250	86	86	21,500	21500
	Shuma:				14,387,335	16,666,114

Sa më sipër, fondi limit duhet të ishte llogaritur me vlerë 13,729,515 lekë dhe jo 16,666,114 lekë, nga ku rezulton se është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 2,936,599 lekë. Kontrata e furnizimit është nënshkruar me vlerë 12,978,134 lekë, më të ulët se fondi limit i rillogaritur në shumën 751,381 lekë (13,729,515 lekë ó 12,978,134 lekë).

Paraqitja e fondit limit me rritje të pa argumentuar është në kundërshtim me LPP.

1. Titulli i gjetjes: Fondi limit nuk është përlogaritur në mënyrë të saktë.

Fondi limit duhet të ishte llogaritur me vlerë 13,729,515 lekë, ndërkohë që nga përlogaritjet rezulton se duhet të jetë 16,666,114 lekë. Vlera e fondit limit rezulton më e lartë me vlerë 2,936,599 lekë. Kontrata e furnizimit është nënshkruar me vlerë 12,978,134 lekë, më të ulët se fondi limit i rillogaritur në shumën 751,381 lekë (13,729,515 lekë ó 12,978,134 lekë).

Situata:

Kriteri:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 46, pika 1.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e konkurrencës, ka rezultuar me ulje të çmimit të kontratës nën vlerën e fondit limit të rillogaritur, në këtë mënyrë nuk konsiderohet se veprimi ka dhënë efekt.

Shkaku:

Mos përcaktimi i saktë i çmimeve për disa zëra punimesh, të cilat nuk kanë referenca.

Rëndësia:

E mesme.

Rekomandime:

Bashkia Vorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit.

b. Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

1. Urdhër Prokurimi nr. 2710, datë 23.02.2021	3. njësia e prokurimit P. Th. J. Ç. A. L.	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 2711, datë 23.02.2021. F. D. T. Z. V. Z.
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit (E hapur)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 16,666,624 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 12,978,134 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,688,490 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 29.03.2021	9. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender 1. OE ðE.C.ö SHPK, me vlerë oferte 12,978,134 lekë. 2. OE ðR.C.ö SHPK me vlerë oferte 13,295,900 lekë. b. Skualifikuar ó 0 OE
11. Ankimime OE ðR.C.ö, me shkresë nr. 5395 prot., datë 09.04.2021.	12. Përgjigje e ankesës nga AK Shkresë nr. 5395/1 prot., datë 09.04.2021.	13. Përgjigje ankesës nga KPP -
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës Nr. 8408/5, datë 26.05.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) - 15,573,760 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: - lekë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. A. L. dhe z. J. Ç.

12. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i ujësjellësit në 15 fshatrat e Njesisë Administrative Novoselë".

Nga verifikimi i përlllogaritjes së fondit limit nuk u konstatuan mangësi. Në përgjithësi referencat e çmimeve janë bazuar në manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit.

Mbi hartimin e dokumenteve të tenderit.

Procesverbali i hartimin e dokumenteve standarde është mbajtur nga komisioni i përbërë nga z. P. Th., z. V. Z. dhe z. F. D., me datë 06.01.2021, ndërsa procesverbali për hartimin e kriterëve të kualifikimit është mbajtur me nr. 79/2 prot., datë 06.01.2021 nga z. F. D.. APP me Email të datës 01.02.2021, ka paraqitur disa rekomandime në lidhje me hartimin e kriterëve për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi. Nga ana e AK janë bërë përmirësimet, por jo sa i përket pikës 2.3.14, të kapacitetit teknik, në lidhje me mjete gjermimi, mjete transporti dhe mjete tërheqëse. Sa më sipër në kriteret për kualifikim është kërkuar, po ashtu nuk është marrë për bazë rekomandimi sa i përket licencimit dhe makinerive.

Titulli i gjetjes: Kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

-Është kërkuar disponimi të licencës për kategorinë **NP – 4 C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale), NP – 12 E (Punime të inxhinierisë së mjedisit)**

Objekti i kontratës është rikonstruksion ujësjellësash dhe nuk ka lidhje me punimet sipas kategorive NP-4 C öRruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportualeö, me kategorinë NP-12 E öPunime të inxhinierisë së mjedisitö.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencat e leshuara nga QKB si me poshte:

Është kërkuar disponimi i licences per grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte qe mund te krijohen,Kodi III.2.Bö, ndërkohë që kjo veprimtari mund të kryhet nga ofertuesit të cilët mund të nënshkruajnë kontrata të posaçme me operatorë që disponojnë licencë për këtë aktivitet.

- 1 (një) **Inxhinier Mjedis** gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës ó të jetë i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

- 1 (një) **Inxhinier Elektronik/Elektrik** gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës.

Në lidhje me kërkesat e mësipërme theksojmë se kërkesa për inxhinier ndërtimi (profil strukturist) dhe inxhinier mjedisi është e pa argumentuar.

Situata:

Në dokumentet e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'ia vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, ndër të cilat edhe si më poshtë:

Mjetet	Njesia	Sasia	Gjendja
Eskavator me krahe te gjate mbi 15 m	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Terheqes	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Rimorkiator	Cope	2	Ne pronesi ose me qera
Autovetura kantieri	Cope	4	Ne pronesi ose me qera
Eskavator trencher per punime specifike (min 20 ton)	Cope	1	Ne pronesi ose me qera

Konstatohet se këto kriterë janë të pa argumentuara. Të gjithë zërat e parashikuar për gjermime janë përcaktuar në tokë të zakonshme me ekskavator me goma dhe në asnjë rast nuk përcaktohet gjermim për të cilin kërkohet ekskavator me zinxhirë, i cili të jetë i pajisur me çekiç. Në preventiv nuk përfshihen procese pune sipas të cilit nevojitet ekskavator me krahë të gjatë mbi 15 m, po ahtu nuk ka zë punimi i cili kërkon ekskavator trencher për punime specifike sidomos në lidhje me peshën e tij mbi 20 ton. Numri i autoveturave për kantier, ka të bëjë me organizimin e punës nga ana e kontraktorit dhe jo me proceset e punimeve.

Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61.
Ndikimi/Efekti:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje më natyrën dhe volumin e kontratës kufizon pjesëmarrjen në procedurë të operatorëve ekonomikë.
Shkaku:	Mos përcaktimi i saktë i kriterëve të nevojshme, të cilat duhet të kenë synim që të vërtetojnë aftësinë teknike të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës.
Rëndësia:	E Lartë.
Rekomandime:	Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe rishikimin e dokumentacionit të projektpreventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

Ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës z. F. D.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

1. Urdhër Prokurimi nr. 1, datë 06.01.2021	3. njësia e prokurimit P. Th. (jurist) V. Z. (ekonomist) F. D. (Ing. Ndërtimi)	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 2, datë 06.01.2021. J. C. G. Sh. T.Z.	
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit (E hapur)		7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 4,635,253 lekë	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 733,930,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 729,294,746.2 lekë	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender 1. BOE ÷G. + Rr.G.÷ SHPK, me vlerë oferte b. Skualifikuar 0 0 OE	
8. Data e hapjes së ofertave 22.02.2021	9. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë	13. Përgjigje ankesës nga KPP -	
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave			
14. lidhje e kontratës Nr. 9182, datë 09.06.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) - 784,700,215.4 lekë	16. Likuiduar - lekë Pa likuiduar: -784,700,215.4 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar 18 muaj	19. Zgjatja e kontratës me ditë -	
20. Mbikëqyrësi i punimeve - B. ÷I.D. A.÷ & ÷A. M.÷	Licencë ? MK.2892/4	Kontrata -	Likuiduar -
21. kolaudatori i punimeve -	Licencë -	Kontrata -	Pa likuiduar -
22. Akt Kolaudimi Datë-	23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshëm -	24. Fletë Hyrja nr: -	

Pretendimi i subjektit:

1. Procedura me objekt "Blerje Materiale Elektrike për Ndrëçimin Publik dhe Institucione" me REF-85744-02-03-2021, a. Në lidhje me realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me procedurën objekt auditimi, Drejtori i Shërbimeve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Ndrëçimit Publik, sipas detyrave funksionale të mësipërme të përcaktuara në nenet respektive të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë, janë të dy anëtarë të Njësisë së Prokurimit dhe kanë hartuar e nënshkruar preventivin që është prokuruar. Mjafton fakti i hartimit dhe i nënshkrimit të preventivit me sasinë që nevojiten për vitin kalendarik 2021, prej këtyre dy zyrtarëve që kanë sidetyrë funksionale shërbimin e ndricimit publik dhe të miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, dhe ky preventiv luan rolin e një shkrese/kërkese ku janë planifikuar edhe nevojat vjetore të shërbimit të ndricimit. Drejtori i Shërbimeve dhe Përgjegjësi i Sektorit të Ndrëçimit që

janë njëkohësisht edhe hartues të preventivit + specifikimeve teknike, por edhe anëtarë të Njesisë së Prokurimit, nuk mund ti bëjnë kërkesë sektorëve që drejtohen po prej tyre për nevojat e preventivimit apo prokurimit të këtyre mallrave, ndërkohë që në momentin e miratimit të fondeve në Buxhetin vjetor kanë paraqitur kërkesat për nevojën e planifikimit të këtyre fondeve.

Ky prokurim është kryer në vitin 2021, ndërkohë që buxheti është miratuar në dhjetor 2020, kurse kërkesa për planifikim është paraqitur disa muaj më parë gjatë hartimit të projekt buxhetit. Ky fakt argumenton edhe pasojën tjetër që fondi limit është i paracaktuar si vlerë në buxhet dhe këta dy zyrtarë duhet vetëm ta shpërndajnë zëra.

Në vlerë absolute del që i furnizuari do ta realizojë asfaltin në një vlerë prej 18%, 28%, 8% më të ulët se prodhuesi. Bazuar në këto shkaqe gjykojmë se vendimarrja e KVO bazuar në këto arsyetime është më e drejta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse do të nisemi nga konstatimi se shoqëria "B.X" ka dashur të bëhet person vendimarrës për tenderin "Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund - Beshisht", mund të ekzistojë natyrshëm edhe opsioni që ky operator lidh kontrata furnizimi me subjekte të ndryshëm, që më pas ta ketë të lehtë/kollajshme për ti skualifikuar duke kryer prishje të njëanshme të kontratës. Por edhe nëse ekziston ky opsion KVO nuk jaka dhënë mundësinë, pasi ka shpallur fitues një tjetër operator ekonomik me ofertë më të ulët. Në përfundim të argumentimeve për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të rishikohen edhe njeherekonstatimet dhe analizat e ngritura për grupin e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit apo anëtarëve KVO.

3. Procedura me objekt "Rehabilitimi dhe riasfaltimi i rrugës Llakatund - Beshisht" me REF-86852-02-12-2021

Në lidhje me procedurën objekt auditimi, Drejtori i Urbanistikës (Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Territorit) së bashku me specialistët e Sektorit të projektimit, sipas detyrave funksionale të përcaktuara në nenet respektive të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë. janë anëtarë të Njesisë së Prokurimit dhe kanë hartuar e nënshkruar projekt + preventivin që është prokuruar.

Mjafton fakti i hartimit dhe i nënshkrimit të preventivit me zërat e punimeve që do të kryhen, prej këtyre zyrtarëve që kanë si detyrë funksionale hartimin e projekteve publike ndërtimore dhe të miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, dhe ky preventiv luan rolin e një shkresë/kërkesë janë planifikuar edhe nevojat. Përveç kësaj në Buxhetin vjetor të Bashkisë miratohen prioritetet vitit buxhetor së bashku me fondet përkatëse.

Drejtori i Urbanistikës që është njëkohësisht edhe hartues/nënshkrues i preventivit + projektit të zbatimit, por edhe anëtar i Njesisë së Prokurimit, nuk mund ti bëjë kërkesë sektorëve që drejtohen po prej tij për nevojat e preventivimit apo prokurimit të punëve publike. Ky prokurim është kryer në vitin 2021, ndërkohë që buxheti është miratuar në dhjetor 2020, kurse kërkesa për planifikim është paraqitur disa muaj më parë gjatë hartimit të projekt buxhetit.

Procesi i asfaltimit nuk është një proces që kryhet në kohë të ndryshme, por pasi kanë përfunduar të gjitha shtresat e punimeve. Bazuar në preventivin e punimeve dhe në analizën e kryer gjatë vendosjes së kriterëve për zberthimin e orëve të punës të punëtorisë, makinerive, llojeve të mjeteve, kategorive të licencave, janë rreth 6497.745 ton materiale, asfalt+binder etj për tu transportuar ose e thënë ndryshe rreth 361 rrugë që duhet të kryejë një kamion 18t, ose rreth 60 rrugë që duhet të kryejnë 6 kamionat e parashikuar. Në analizën e grupit të auditimit kur është dalë në konkluzionin për distancën që është e paargumentuar, nuk është marrë parasysh edhe sistemi zinxhir që ka të bëjë me faktin e parashikimit të kohës të transportit të asfaltit që duhet të kalojë nga ngarkim - transport - shkarkim i njërit kamion tek kamioni tjetër, nëse transporti kryhet me 6 kamiona (sikurse e analizon grupi i auditimit të KLSH).

Në përmbledhje të argumenteve të mësipërm, jemi munduar të argumentojmë se në vendosjen e distancës së fabrikës së asfaltit nuk mund të merren të shkëputur minutazhet ose koha e nevojsh teknike për ciklet e prodhimit të asfaltit, ciklet e transportit, si dhe ciklin e shtrimit, të cilat duhet të jenë të ndërthurura me njëra tjetrën, që ndikojnë drejtpërdrejtë në uljen së tempereaturës së asfaltit dhe për pasojë në uljen e cilësisë së tij. Argumentimet e tjera që të

përdorim 1, 2 apo 3 asfaltoshtruese për ta shtruar shpejt, janë kritere që dalin jashtë natyrës së kontratës dhe normalitetit të shtrimit me asfalt të rrugës.

-Bazuar në nenin 53 pika 3 e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", përcaktohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji".

Referuar kësaj dispozitë prej anëtarëve të KVO është kryer kualifikimi për plotësimin e kriterit të kualifikimit sikurse përcaktohet "Vertetim se i ka shlyer taksat vendore per vitin 2020". Në lidhje me faktin e faturës së pagesës prej 80,000 lekë nga ky subjekt, Drejtori i Financës së Bashkisë si anëtar i KVO, por që ka edhe si detyrë funksionale mbikqyrjen e rakordimeve me Degën e Thesari dhe Drejtorinë, ka kryer verifikimet nevojshme dhe ka rezultuar se Bankat e nivelit të dytë për efekt të marrjes së komisionit të tyre bankar, i presin faturat e pagesës vecmas për cdo zë të faturës për arkëtim. Në rastin konkret shoqëria "A." ka paguar dy fatura faturën prej 80,100 lekë (80,000 lekë detyrimi dhe 100 lekë komisioni), si dhe një faturë prej 3,808 lekë (3.708 lekë detyrimi dhe 100 lekë komisioni).

Fakti që ky subjekt ka skanuar dhe ngarkuar në SPE së bashku me vërtetimin vetëm një faturë dhe jo të dyja, nuk përbën shkak për penalizim, pasi kriteri i kualifikimit e përcakton qartë "Vertetim se i ka shlyer taksat vendore per vitin 2020", të cilin e ka përmbushur.

-Bazuar në kontratën e bashkëpunimit të paraqitur, palët kanë rënë dakort që për efekt të kontabilizimit, si shlyerja e detyrimeve fiskale do të behet nga pala e parë dhe të gjithë detyrimet që rrjedhin nga ky bashkëpunim. Njëkohësisht këto palë kanë rënë dakort që volume e punëve do të kryhen në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit. Pra ndodhur përpara këtij parashikimi kontraktor, vetë palët kanë rënë dakort që pala e parë "A." shpk për efekt kontabilizimi do të lëshojë faturat tatimore, do të shlyejë detyrimet fiskale si dhe do të shlyejë edhe detyrimet e bashkëpunimit. Ndodhur përpara këtij formulimi kontraktual i marrë përsipër nga të dyja palët, prej KVO është interpretuar që pala e parë "A." shpk ka marrë përsipër edhe furnizimin e materialeve për sa kohë që ka marrë përsipër edhe kontabilizimin dhe shlyerjen e detyrimeve, kurse volumet e punimeve do të realizohen në përputhje me përqindjen e bashkëpunimit. KVO ka qenë e vëmendshme për kualifikimin e kësaj oferte që të jetë në përputhje me ligjin dhe kriteret e kualifikimit të përcaktuar në dst.

-Bazuar në nenin 68 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 përcaktohet se "Komisioni i vlerësimit 18 ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dergon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.". Duke qenë se bazuar në nenin 78 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 afatet e ankimit fillojnë nga e nesërmeja e shpalljes së klasifikimit, që do të thotë se edhe sikur klasifikimi të ishte kryer në datë 06.04.2021 sikurse përcakton grupi i auditimit, afati i ankimit fillon të nesërmen në datë 07.04.2021 dhe përfundon në datë 14.04.2021, KVO i lind e drejta që të hartojë Raportin Përmbledhës pas përfundimit të afateve të ankimit, ose e thënë ndryshe në datë 15.04.2021 që përkon edhe me datën e paraqitjes së shkresës për prishjen e njëanshme të kontratave. Edhe në këtë rast KVO nuk mund ta hartojë raportin përmbledhës.

Në tërësinë e veprimeve për vlerësimin e ofertave, nga ana e KVO është kryer shqyrtimi i ofertave duke vlerësuar shkresat që secili prej operatorëve ekonomikë ka paraqitur.

-4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Vazhdim punimesh në objektin "Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga Bly Ismail Qemali, Rruga Kosova, Rruga Gjergj Araniti dhe Bly Gjergj Kastrioti

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes materialin dhe duke I dhënë rëndësinë aksionale në një të observacioneve të dërguara reflektoi dhe në material duke hequr ato pjesë të materialit që mbas dërgimit të observacionit krijuan bindjen e arsyeshme që nuk qëndronin por për pjesën tjetër materialin nuk është arrë parasysh si mëjht:

Për sa i përket kufizimit të marrjes nga kriteret e aplikuar për disa kritere si numëri i punonjësve makineria e asfaltobetonit etj , nisur nga pjesmarrja e disa operatorëve ekonomik në procedurën e prokurimit merret në konsiderat gjithashtu mbështetur dhe në legjislacionin referues që ju cilësoni.

-Nuk merret në konsiderat likuidimi i detyrimeve të taksave bashkiake me një faturë tjetër e cila nuk gjendet në sistemin SPE por e kontrolluar sipas Jush nga njëri nga antarët e KVO në sistem, pasi KVO vlerëson dokumentacionin e hedhur në sistemin SPE asnjë letër tjetër, nëse ka paqartësi i lind e drejta të kërkoj informacion shtes POR për dokumentacionin e ndodhur në sistem jo dokumentacion tjetër.

-Nuk merret në konsiderat afati i tejkualuar në vlerësimin e OE pjesmarrës pasi në dosje nuk u gjend asnjë procesverbal për dokumentimin e nevojës së kohës shtes sic parashikohet në VKM.

-Nuk merret në konsiderat furnizimi me asfaltobeton nga operatori i BO A. A. pa kontrat furnizimi.

Për sa i përket rojeve private nuk ka asnjë ngatërres, Grupi i auditimit ka marrë në analiz për thjeshtësi pune vendrojen me 1 turn 8 oraresh. Sic e shikoni dhe preventivin e keni me 365 ditë kalendarike dhe keni koston nëë për këtë vend roje, por kur numëroni 365 ditë keni brenda dhe rojen zëvendësues pasi një punonjës paguhet për 22 dit punë , më posht keni referencën ligjore, detajet për ti kalkuluar diferencat Ju takojnë Juve meqe për 42 dit nuk ka faturuar, Grupi i auditimit Ju ka referuar Librit të planëzimit për muajin janar duke parë Rojet që kanë ofruar shërbim pranë Bashkisë Vlorë dhe sa janë ato në procedurën e mëvonshme ku OE ka hedhur në sistem Listpagesat për kualifikim, nese duhen më shume detaje Ju a bashkëngjisim në fazën tjetër.

Paga bazë për një roje në muaj është= 39 000 lekë në muaj për roje/ 174 orë pune në muaj= 224.13 lekë për orë. Në nenin 81 të "Kodit të Punës" është parashikuar: "Çdo ore pune e kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 20 % çdo ore pune e kryer midis intervalit 22:00 dhe 06:00 jep të drejtën e një shtese mbi page jo më pak se 50 %" Shtesa Turni II 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 3 ore Turni II-të (ora 19°00 -22°00 sipas Nenit 81 të Kodit të Punës) x 224.13 lekë/roje x 20% (shtesa sipas Nenit 81 të Kodit të Punës)x 1 vendroje./ 3.32 roje = 1231.76 lekë në muaj për roje 30.41 ditë mesatarisht në muaj x 2 orë Turni II-të (ora 22:00 - 24:00 sipas Nenit 81 të Kodit të Punës)x 224.13 lekë/ roje x 50% (shtesa sipas Nenit 81 të Kodit të Punës) x1 vendroje/ 3.32 roje = 2052.94 lekë në muaj për roje. Numri i rojeve është i mjaftueshëm për të mbuluar shërbimin e kërkuar, për ditët e pushimit javor dhe ditët e festave zyrtare. Total paga + shtesat = 39000 lekë + 1231.76) lekë + 2052.94 lekë = 42 284.7 lekë në muaj për roje. Referuar pikës Ill.3 të VKM-së nr.1114, dt.30.07.200 "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, dt.11.05.199 "Për sigurimet shoqërore në RSH", Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit të jetë 16.7 % dhe pjesa e të punësuarit 11.2%". Sigurimet = 42 284.7 lekë x 16.7 %= 7061.54 lekë në muaj për roje Total paga + shtesat + sigurimet = 49 346.24 lekë për roje/muaj **pa Tvsh.**

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017," Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".

- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,) rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Në auditimin e regjistrimit të parashikimit dhe të realizimit të fondeve rezultoi se, në fillim të vitit **2018**, janë parashikuar në regjistrin e parashikimit të fondeve për prokurim me procedurë òblerje me vlera të vogla në sistemin elektronik të APP-së, 220 objekte prokurimi me fond limit 72,742,977 lekë. Për periudhën 2018-Qershor 2021 janë realizuar 328 procedura prokurime me vlerë 119,803,984 lekë, nga të cilat janë audituar 87,900,374 lekë, ose 73% e tyre.

-Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, u konstatua se:

Titulli i Gjetjes:Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

Situata: Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

-Komisioni i Blerjeve të Vogla (KBV), nuk ka argumentuar përllogaritjen e fondit limit. KBV ka hartuar preventive duke vendosur çmimet pa specifikuar nëse janë çmime INSTAT-i, çmime tregu apo bazuar në kontrata të mëparshme.

-KBV nuk ka mbajtur procesverbal për asnjë nga fazat e vlerësimit të ofertës/ofertave, për të dokumentuar procesin e vlerësimit dhe refuzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë deri në vendin e 10 të klasifikimit.

-Në të gjitha procedurat e audituara, KBV nuk ka firmosur faturën e TVSH-së për blerjen e mallit apo shërbimit.

-Në 9 raste për prokurime të së njëjtës natyrë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, u konstatua copëzim i fondeve, dhe konkretisht 3 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt òkomodim pjesëmarrësish në evente të ndryshme me fond limit **1,224,000 lekë pa tvsh**, 3 urdhra prokurimi me objekte të ngjashme si òbatanije, çarçafë dhe peshqirë me fond limit **2,250,000 lekë pa tvsh**, 3 urdhra prokurimi me objekt òblerje enë guzhinë me fond limit **1,500,000 lekë**, 13 urdhra prokurimi me objekt òblerje pjesë këmbimi dhe riparime mjeteve të bashkisë me fond limit **4,419,600 lekë**, 13 urdhra prokurimi me objekt òblerje dhe shërbime të ndryshme për aktivitete kulturore me fond limit **7,760,000 lekë**, 8 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt òblerje pjesë këmbimi dhe riparim të mjeteve të bashkisë me fond limit **4,685,400lekë pa tvsh**, 2 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt òblerje enë guzhinë me fond limit **1,300,000 lekë pa tvsh**, 13 urdhra prokurimi me objekt òblerje dhe shërbime të ndryshme për aktivitete kulturore me fond limit **7,309,112 lekëpa tvsh**, 3 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt òblerje pjesë këmbimi dhe riparim i mjeteve të bashkisë me fond limit **2,200,000 lekë pa tvsh**.

(Pasqyruar praktikat e audituara në Kapitullin “Anekse – nr.2.4 – Tabela nr.2.4.3 – 2.4.5”)

-Në 26 raste të praktikave të mësipërme, u konstatua se, nuk është respektuar afati 30-ditor, për likuidimin e faturës tatimore lëshuar nga OE.

(Pasqyruar në Kapitullin “Anekse – nr.2.4 – Tabela nr.2.4.6”)

Kriteri:Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 52.

VKM nr.914, datë 29.12.2014 òMbi miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, pikat 1, 5, 7 dhe 8 të nenit 40, pika 2 në nenin 59, neni 60.

Udhëzimi nr. 3 datë 08.01.2018 i APP òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar, pikat 3, 5, 6, 14, 17, 19 dhe formati nr.2 òurdhri i prokurimit.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme, që Komisioni i Blerjeve të Vogla, të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

III.2.5. Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin

Auditimi u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nësesistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të njaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Vlorë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 *“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”:*

- Bashkia Vlorë nuk ka Kod të Etikës, por në nenin 20 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë 8 rregulla të etikës, në të cilat përcaktohen dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, por në Rregulloren e Brendshme në nenin 19 dhe 20 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil. Për Policinë Bashkiake janë parashikuar të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes dhe masat disiplinore. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e informacionit), duke iu adresuar Kryetarit të bashkisë, në strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat, strukturë e cila nuk është përcaktuar. Kjo procedurë është përcaktuar në nenin 18 të Rregullores së Brendshme.

- Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Në lidhje me parimin 2 *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”:*

- Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregullore e brendshme dhe vepohet në bazë të tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetoredhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në kreun II neni 12 të Rregullores së Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore 6mujore. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafine lartë menaxherial. Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikqyrëse janë mbajtur procesverbale.

- Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.
 - Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 4 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbyshjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ndërsa nga UKsha Vlorë, Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen këshillit drejtues, pasi bashkia është aksionari kryesor, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.
 - Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.
 - Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.
- Në lidhje me parimin 3** *Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë:*
- Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Vlorë me Vendimin e Kryetarit nr. 101 datë 11.09.2018, me shkresën nr. prot. 7813 datë 11.09.2018.
 - Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Bashkia Vlorë ka të hartuar Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me VKB.nr. 64 datë 31.08.2017. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
 - Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetsorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rrumbullakta me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjuesat me publikun.
 - Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike, por nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë.
 - Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri me njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, të strukturave për funksione të deleguara të atashuar si Sektori i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, (MZSH-së), sektorë këta të cilat nuk janë përfshirë në Rregulloren. Ndërsa Ndëmmarrja e Shërbimeve Publike nuk kishte një rregullore të brendshme të funksionimit
 - Ekzistojnë plan veprimet për menaxhimin financiar për vitin 2019 me shkresën nr. prot. 1831 datë 21.02.2019 dhe për vitin 2020 me shkresën nr. prot. 2027 datë 26.02.2020 për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën janë përfshirë, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
 - Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Organigrama e Bashkisë Vlorë është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 3 nënkryetarët dhe 13 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e NJA e Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale dhe jo vertikale. Strukturat organike sipas viteve janë: **Për vitin 2018** struktura është miratuar me Vendim të Kryetarit Nr. 2, datë 18.01.2018 *Është miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2018* ndryshuar me VK nr. 21, datë 28.02.2018 me VK nr. 76, datë 13.06.2018 me VK nr. 100, datë 24.08.2018 me 346 punonjës në plan dhe në fakt 326 punonjës me 18 Drejtori 17 Sektorë dhe Kabineti.

Për vitin 2019 struktura është miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 132 datë 31.12.2018 *ōPër miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara 2019*ō ndryshuar me VK nr. 3 datë 04.02.2019, me VK nr. 6 datë 26.02.2019, me VK nr. 15/1 datë 15.05.2019, me VK nr. 41 datë 12.09.2019, me VK nr. 50 datë 04.11.2019 me 315 punonjës në plan dhe në fakt 295 punonjës.

Për vitin 2020 me Vendim të Kryetarit nr. 62 datë 31.12.2019 *ōPër miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara 2020*ō i ndryshuar me VK nr. 12 datë 11.02.2020, me VK nr. 26, datë 08.06.2020 me 315 punonjës në plan dhe në fakt 296 punonjës.

- Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar misioni, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Vlorë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore nuk janë paraqitur të plota.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 *ōNjësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave*ō:

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Në 3 raste të testuara të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin. masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Vlorë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila të dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojnë të dhënat për trajnime jashtë institucionit)

- Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. Nga NA ka dalë Urdhri nr. 8800 datë 09.10.2019 i ngritjes së Ekipeve të menaxhimit të programeve.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 *ōPër auditimin e brendshëm në sektorin publik*ō

neni 13 *ō*Komitetit të Auditimit të Brendshëm*ō* i cili përcakton se: “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm”.

- Nēpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.
Në lidhje me parimin 5 *ō*Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale*ō*:

Në Rregulloren e Brendshme në pikën (d) të nenit 23 është parashikuar *ō*Delegimi i kompetencave*ō* në zbatim të ligjit 44/2015 *ō*Kodi i Procedurave Administrative*ō* si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollit i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 *ō*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ō* dhe udhëzimit të MFE nr. 23, datë 30.07.2018 *ō*Për procedurat standarde për përgatitjen e PBA të njësisë të Qeverisjes Vendore*ō*, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2018 ka dalë urdhri i datës 25.01.2018 *ō*Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve*ō*. Në fakt në urdhër është ngritur vetëm GMS me 11 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA), pra nuk janë ngritur EMP.

Për vitin 2019 ka dalë urdhri i datës 19.01.2017 *ō*Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve*ō*. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 11 anëtare dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 14 Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2020-2022.

Për vitin 2020 me shkresën nr. prot. 1283 datë 04.03.2020 ka dalë urdhri i titullarit nr. 31 datë 04.03.2020 *ō*Për ngritjen GMS dhe ekipeve të menaxhimit të programeve*ō*. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 11 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë (NA) dhe 14 ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA 2021-2023.

Në rregulloren e Brendshme në Kreun IV nenet 88-96 *ō*Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë*ō* nuk është përfshirë ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), detyrave dhe përgjegjësitë e tij.

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk e kryer detyrat si:

- Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar
- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: *ō*Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva*ō*.

Bashkia Vlorë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Vlorë. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: *ō*Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*ō*:

Në Bashkinë Vlorë ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Ka dalë Urdhri i Titullarit me shkresën nr. 3780/1 datë 15.05.2018 për përcaktimin e kordinatorit të riskut, ku NA ia ka deleguar Përgjegjësit të Sektorit të Buxhetit z. V. Z. në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve në nivel drejtorie, por jo për të gjitha drejtoritë si dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: *ōNjësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrimeō*

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e kordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirës.

Në lidhje me parimin 9: *ōNjësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëmō*

Bashkia Vlorë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: *ōNjësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolliō*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA). Struktura e Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit përbëhet nga 20 punonjës, 1 drejtor, 3 përgjegjësia Sektori dhe kontabilist, magazinier e punonjës mirëmbajtës.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Ngritja e këtyre komisioneve është parashikuar edhe në nenin 190-191 të Rregullores së Brendshme.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim fletë-hyrjet etj. të vulosura nga

dega e Thesarit, e cila konfirmon me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël

- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun I neni 23 *õHyrja trajtimi dhe mbajtja e dokumentacionit* në nenin 53 *õSektori i Protokoll-Arkivës* pikat (d) dhe (c) përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshme në detyrat e drejtorisë Ekonomike nenet 75,76,77, por për menaxhimin e tyre veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 *õPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik* i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: *õNjësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë:*

- Bashkia Vlorë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme në nenin 57 pika 3 përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, firewall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Vlorë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12: *õNjësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave:*

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

- Në nenet 62-94 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

- Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe Drejtoria të Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 136 dhe 172 të rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryer nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditareve, hartimine PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimine listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.08.2018 *ōPër hartimin e PFō*). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: *ōNjësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësorō:*

Drejtuësit në Bashkinë Vlorë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe MFE. Stoku u detyrimeve të prapambetura për vitin 2018 është në vlerën 380,681 mijë lekë, për vitin 2019 është në vlerën 285,742 mijë lekë. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

- Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vlorë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program Excel dhe jo me program kontabiliteti, pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimi apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare sëbashku me dokumenta shoqërues kryhet nga specialistet e Drejtorisë së Buxhetit, Kontabilitetit dhe Financës. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë TAIS të cilin e menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Vlorë për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Ujësjiellësi, AKSH etj. mbahen evidenca inventarizimi për aktivet dhe lëvizjet e tyre si dhe kryhen procedura për nxjerrjen jashtë përdorimi të AAGJM.

Në lidhje me parimin 14: *ōNjësia publike përdor komunikimin e brendshëm sistemin elektronik dhe shkresorō:*

Në lidhje me parimin 15: *ōNjësia publike përdor komunikimin e jashtëm, ka faqen zyrtarēō*

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet 15 *ōMarrëdhëniet ndërmjet strukturave të Bashkisēō*, neni 16 *ōMarrëdhëniet me Këshillin bashkiakō*, neni 17 *ōMarrëdhëniet me institucionet e tjeraō* neni 18 *ōMarrëdhëniet me publikunō* neni 26 *ōInformacioni dhe komunikimi me medianō*, neni 23 *ōHyrja, trajtimi dhe mbajtja e dokumentacionitō*.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo 3 muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Përdorimin e email-it zyrtar e kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe

nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe me të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale. Në faqen e Bashkisë Vlorë janë të publikuar dokumentet Kryesore, broshura, planet strategjike, raporte periodike, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve anë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut

- Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”:*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

- Për vitin 2018 me shkresën nr. prot. 1925, datë 21.02.2019 dhe për vitin 2019 me shkresën nr. prot. 2027 datë 26.02.2020 është dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave *“Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Vlorë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.*

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit të zbatimit të buxhetit, sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave.

Në kapitullin *“Vlerësimi i sistemit të MFK”* janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu janë paraqitur masat e marra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe plan-veprimi për të ardhmen për përmirësimin e performancës organizative dhe financiare të njësisë nga puna për arritjen e synimeve përkatëse të: Drejtorisë Ekonomike, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Njesisë së Prokurimit, Drejtorisë e planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Drejtorisë e Shërbimeve Publike, Drejtorisë e

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Kulturës Sportit Arsimit dhe Turizmit, Administrata e Njësive Administrative.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të *ogjurmës së auditimit* që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

- Në Bashkinë Vlorë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP për vitin 2018, ndërsa nga Auditimi i brendshëm nuk ka rekomandime.

- Në Bashkinë Vlorë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditimi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara

Në lidhje me parimin 17: *ōNjësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë:*

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raporte apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditimi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të vecantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Vlorë funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* ò i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

“Menaxhimi i Riskut”

Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Vlorë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (*back-up*) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin e testimit etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk ka qenë fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar. Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të bashkisë Vlorë.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Titullari i Bashkisë Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS e të Nëpunësit Autorizues si dhe Kordinatori i Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

III.2.6. Mbi auditimin e brendshëm

Bashkia Vlorë, ka miratuar Njësinë e Auditit të Brendshëm në strukturën organike të saj me VKB nr. 2, datë 18.01.2018, në strukturën organike me VKB nr. 132, datë 31.12.2018 si dhe strukturën organike me VKB nr. 62, datë 31.12.2019 të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Vlorë, për të konstatuar e evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik, Kodin Etik, dhe Kartën e Auditimit, miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 176, datë 29.08.2019, i përditësuar. Për periudhën objekt auditimi, Planet Strategjike janë përgatitur dhe dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm, si dhe planifikimet vjetore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2.

- Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, NJAB gjatë periudhës objekt auditimi ka në përbërjen e saj 3 punonjës, përkatësisht 1 drejtues dhe 2 specialistë auditimi, me profil arsimor diplomuar në fushën e ekonomisë (2 punonjës) dhe në fushën e drejtësisë (1 punonjës), të cilët janë të certifikuar. Struktura e kësaj njësie auditimi, në forme tabelore për periudhën e audituar 2018 - 2020, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Nga data e krijimit deri 30.06.2020	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në pune	Vjetërsi në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1.	L. G.	Përgj/AB	U. Tiranë, Financë. M. Kontabilitet	12	12	Po/2011	40 orë në vit MFE
2.	E. Gj.	Inspektore Auditit	U. Vlorë, Adm. Biznes. M. Administrim Publik	12	10	Po/2013	40 orë në vit MFE
3.	L. D.	Inspektore Auditit	U. Vlorë, Fakulteti Drejtësisë	22	8	Po/2004	40 orë në vit MFE

Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm

Për vitin 2018:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin **2018**, janë planifikuar për të kryer 9 auditime, nga të cilat janë realizuar 7 auditime (në masën 77 %), dhe konkretisht është audituar Klubi shumësportesh òFlamurtariò, Qendra e Kulturës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor si dhe Analiza e Situatës së Institucionit lidhur me detyrimet e prapambetura. Auditimi i planifikuar për tre mujorin e fundit i Shtëpisë së Foshnjës, nuk është kryer si angazhim, pasi ky institucion ishte subjekt auditimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në të njëjtën periudhë të planifikuar. Ndërsa planifikimi për auditim i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, u konsiderua si pjesë e auditimit të planifikuar dhe të realizuar me objekt Analizë e Situatës së Institucionit në lidhje me Detyrimet e Prapambetura. Ky argument nuk mund të qëndrojë, pasi përtej auditimit që është kryer nga AB për *analizën e situatës së detyrimeve të prapambetura* si një zë i veçantë në pasqyrat financiare, duhet të ishte kryer auditim i plotë për pjesën e aseteve, pronave, aktiveve afatgjata të pasqyruara në kontabilitet, kontabilizimi i borxhit tatimor, paraqitja në bilanc të gjobave të vendosura nga IMTV etj. Për këtë shkak ne gjykojmë se nuk mund të qëndrojë si arsye, mbulimi me auditim i Drejtorisë së Financës vetëm me detyrimet e prapambetura.

Për vitin 2019:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për vitin **2019** sipas planifikimit vjetor (i ndryshuar) janë parashikuar për të kryer 9 auditime gjithsej, prej të cilave janë realizuar 7 të planifikuara (në masën 77% të auditimeve të planifikuara) si dhe 1 auditim jashtë planifikimit (DHAB njoftuar me shkresën Nr. 7478 prot., datë 10.09.2019). I janë nënshtruar këtij procesi Qendra e Kulturës Teatri Petro Marko, Parku Urban (i ndryshuar), Shtëpia e Foshnjës, Drejtoria e Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimit Social si dhe Emergjencat Civile. Nuk është audituar sipas planifikimit Qendra e Zhvillimit PAK, për arsye se godina është në rikonstruksion, ndërsa nuk argumentohet arsyeja për mos auditimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për 6 – mujorin e parë të vitit 2020:

Për vitin 2020 janë planifikuar për të kryer gjithsej 9 auditime, dhe për 6 mujorin e parë janë realizuar 4 auditime, konkretisht Klubi Shumësportësh Flamurtari, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe Drejtoria e Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit òFirma D.ø

Vlerësimi i procedurave dhe zbatimi i standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 ò*Për auditimin e brendshëm në sektorin publikò*, ò*Manuali i Auditimit të Brendshëmò* (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, janë mbajtur letrat e punës si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si projekt-raportet edhe raportet finale të auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual.

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik.

Situata: Nga audituesit e brendshëm, nuk është hartuar planifikimi i angazhimit.

2. Disa nga subjektet e audituara pavarësisht se kanë pranuar rekomandimet e lëna, nuk kanë paraqitur Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
3. Drejtuesja e Njesisë së Auditit të Brendshëm, nuk ka kryer sigurimin e cilësisë së punës.
4. NjAB, pavarësisht pranifikimit për auditim të drejtorive me risk të lartë siç është Drejtoria e

Financës apo Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, angazhimi nuk është kryer. Gjithashtu, NjAB nuk ka planifikuar në asnjë rast në Planin Strategjik për vitet në vijim auditimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe auditimin e Njësive Administrative të Bashkisë Vlorë.

Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi përgjegjësi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, znj. L. G.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *ōPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikō*; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *ōPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikō*; Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 *ōPër Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikō*, Kapitulli IV, pika 4.1.1 *ōPlaifikimi i një angazhimi auditimiō*, Kapitulli IV, pika 4.1.12 Hapi 11, Kapitulli VII, pika 7.1.1 *ōVlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet vetë nga NjABō*.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucionin. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.

Shkaku: Nga neglizhenca, dhe mos përbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit të bërë.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryej procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

III.2.7. Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, u audituan rekomandimet e dërguara në Bashkinë Vlorë me shkresën nr. 1005/74, datë 20.12.2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 17 masa me vlerë 85,863,005 lekë. Është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 30.11.2020, janë arkëtuar 172,365 lekë, ndërsa shuma 85,690,640 lekë nuk është arkëtuar.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej **85,871,776lekë**

- Deri në datën 30.11.2020 është arkëtuar 172,365 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej 85,690,640lekë

Nga të cilat:

- Janë në procese gjyqësore 12 rekomandime në vlerën **54,981,287 lekë.**

- Janë nisur njoftimet për 3 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet ose proceset gjyqësore në vlerën **1,404,980 lekë.**

- Janë audituar nga Auditit Brendshëm sipas rekomandimit të KLSH, dhe janë konsideruar dëme të paargumentuara 4 rekomandime në vlerën **26,286,015 lekë.**

- Nuk është marrë asnjë masë për 2 rekomandime **2,770,926 lekë.**

2.7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve

Nga verifikimi rezultoi se KLSH ka dërguar në Bashkinë Vlorë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 1005/74 prot, datë 20.12.2018, ndërsa nga Bashkia Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor, **veprim për të cilin mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. D. L.**

Ishte hartuar *ōPlan veprimi për zbatimin e rekomandimeveō* me shkresën nr. 10960/2 prot., datë 10.01.2020 në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

2.7.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor

Nga verifikimi rezultoi se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Vlorë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1005/74 prot, datë 20.12.2018 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2019 (referuar nenit 30, pika 2 e

ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 *ËPër funksionimin dhe organizimin e KLSH-së*, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA)
Nga Bashkia Vlorë nuk është bërë raportimi brenda 6 mujorit, **veprim për të cilin mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. D. L.**

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Vlorë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve me shkresën Nr. 10960 prot., datë 10.01.2020, ndërkohë nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*, Neni 50, *ËAuditimi i jashtëm*, pika 5, **veprim për të cilin mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z. D. L.**

2.7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Titulli i Gjetjes: Realizimi i Rekomandimeve për masa shpërblim dëmi, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimit e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimit nuk janë pranuar.

Situata: Në përgjithësi Bashkia Vlorë, krahas urdhrave dhe njoftimeve e dëmeve dërguar subjekteve, ka ngritur paditë në gjykatë për shpërblimin e dëmit. Në disa raste, paditë u ngritën gjatë periudhës së auditimit. Pavarësisht nga puna e bërë për disa raste administrata është mjaftuar vetëm me njoftimin për subjektet pa bërë padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara.

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve, u konstatua se:

B/1. Masa për shpërblim dëmi.

1. Nuk janë zbatuar masat e mëposhtme:

a) 3.3.2 Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të rinjoftojë MFE në zbatimin e VKB nr. 60, datë 31.10.2016 për modifikimin e kushteve të kontratës pasi sjelle efekte financiare për vlerën e qirasë mujore sipas sipërfaqes së sanksionuar me procesverbal datë 27.01.2016 prej 14690 m², për të cilën ka rënë dakort dhe subjekti òl.1ò.

b)3.3.3. Rekomandimi:Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me MFE, të marrë masa që shoqëria òl. 1ò të derdhë garancinë e kontratës në emër të subjektit òBashkia Vlorë sipas pikës 6.3 të kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002.

c)6.6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,158,300 lekë**, nga anëtarët e grupit të punës për hartimin e preventivit në mënyrë të barabartë: **Ing. N. B. dhe ing. E. I.**

ç)10.10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur procedurat administrative për shpërblimin e dëmit në vlerën **196,680 lekë**, ndaje ish-punonjësve si vijon:

- **vlera 13,520 lekë** nga z. Xh. H. me detyrë ish- specialist në Zyrën e Bujqësisë;

- **vlera 8,450 lekë** nga z. Th. T. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Taksave;

- **vlera 8,450 lekë** nga z. H. F. me detyrë ish- Jurist;

- **vlera 65,910 lekë** nga z. F. B. me detyrë ish- Kryetar Komune;

- **vlera 25,350 lekë** nga z. Z. M. me detyrë ish- specialist në Zyrën e Shërbimeve, për sa kanë tërhequr karburant nga magazina sipas fletë daljes nr. 31, datë 30.06.2015 sipas planit të shpërndarjes dhe nuk kanë paraqitur dokumente justifikues (fletë udhëtime).

d)12.12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **50,000 lekë**, nga subjekti òSH.ALò.

dh)14.14.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Tatimeve e Taksave, të marrë të gjitha masat duke kryer të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e

detyrimeve prej **2,675,500 lekë** të lindura nga mos shlyerja dhe mos përmbushja e detyrimeve kontraktore, procedura në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 dhe kontratave respektive.

2. Janë në proces zbatimi masat e mëposhtme:

a) 1.1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte në **vlerën 23,837,435 lekë**.

- **vlera 8,186,306 lekë**, ndaj subjektet “SH.” SHPK, në objektin “Rikonstruksion rruga Ura tek varrezat - Fshati Risili, L=3 km”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 2180 prot., datë 20.03.2017.

- ndaj subjektit “C.” SHPK, për 4 objekte në vlerën **10,759,833 lekë**, respektivisht:

- **vlera 835,350 lekë**, ndaj subjektit “C.” SHPK, në objektin “Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2016”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve 3897 prot., datë 18.05.2016.

- **vlera 411,220 lekë**, ndaj subjekti “C.” SHPK, në objektin “Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2017”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 5828 prot., datë 29.06.2016.

- **vlera 2,173,433 lekë**, ndaj subjektit “C.” SHPK, në objektin “Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët “Tasim Jonuzi”, “Demokracia”, “Janaq Kilica”, “Rruga e Paqes”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 749, Datë 30.01.2017.

- **vlera 7,339,830 lekë**, ndaje subjekteve “C.” SHPK dhe “F.” SHPK, në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme Ali Demi”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 9762 prot., datë 18.11.2016.

Është në proces gjyqësor

-**vlera 1,688,863 lekë**, ndaj subjektet “A.” SHPK, në objektin “Rikonstruksion i Rrugëve Xhebro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut te banimit mbas CONAD - it, faza I”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.

Është në proces gjyqësor

- **vlera 1,937,337 lekë**, nga e cila penalitet në vlerën 1,613,760 lek, ndaj subjektit “C. R.2....8” SHPK, në objektin “Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa rrugëve kryesore të qytetit të Vlorës”, sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.

Është në proces gjyqësor

-**vlera 881,745 lekë**, ndaj subjekti òL. K.ò SHPK, në objektin òRikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 837 prot., datë 06.08.2014.

Është në proces gjyqësor

b) 2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 9,920,000 lekë** nga operatori ekonomik “C. P.” SHPK.

Është në proces gjyqësor

c) 3.3.1. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e **vlerës 6,983,486 lekë** ndaj subjektit “I.1”.

Është në proces gjyqësor

ç)4.4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 6,570,350 lekë** nga shoqëria òD.ò SHPK.

Është në proces gjyqësor

d)5.5.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për kërkimin dhe arkëtimin e **vlerës 5,688,000 lekë**, shkaktuar nga ish-Kryetari i Komunës Novoselë **z. K. Sh.** dhe përdoruesi i pasurisë sipas

kontratës N. S., si dhe të bëj përditësimin e kontratës me subjektin, sipas referencës ligjore aktuale.

Është në proces gjyqësor

dh)7.7.1. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,312,791 lekë** nga subjekti “M.ö.

Është në proces gjyqësor

e)8.8.1 Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **567,632 lekë** ndaj subjektit òL. K.ö .

Është në proces gjyqësor

ë)9.9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **484,944 lekë**, ndaj operatorit ekonomik òC.ö SHPK, të përfituar tepër për punime të pakryera dhe për përfshirjen e TVSH-së për pajisjet e stacionuara në zbatimin e kontratës me objekt òRikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Rilindja”.

Është në proces gjyqësor

Kriteri:Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 15, òTë drejtat e KLSHò, germa j), Shkresa Nr. 1005/74, datë 20.12.2018 òPër zbatimin e rekomandimeve në auditimin e kryer në Bashkinë Vlorëò.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën 4,175,906 lekë.

Shkaku: Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e strukturave drejtuese.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1005/74, datë 20.12.2008 òPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Vlorëò, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre.

III.2.8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.8.1. Në zbatim të pikës 8, të programit të Auditimit “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, u auditua kërkesa e shtetasit P.T., protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 465 prot., datë 16.04.2021.

Ky shtetas, në kërkesën e tij drejtuar KLSH, kërkon anulimin e detyrimit tatimor të prapambetur, njoftuar nga Bashkia Vlorë, me shkresën nr.4323, datë 18.03.2021.

Bazuar në këtë shkresë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njofton subjektin òA.G.ö për të paguar detyrimet tatimore të prapambetura.

Me shkresën nr.748/1, datë 23.03.2021 subjekti òA.G.ö argumenton se taksat vendore të kësaj periudhe janë paguar dhe nuk ka detyrime të tjera, duke kërkuar anulimin e detyrimit. Bashkia Vlorë me shkresën nr.5157, datë 06.04.2021, ka sqaruar subjektin òA.G.ö se detyrimi është bazuar në shkresën nr.1029/16, datë 11.06.2018 me lëndë “Raporti i Auditimit dhe rekomandimet e KLSH”, ku është konstatuar se subjekti òA.G.ö ka detyrime ndaj Bashkisë Vlorë për vitin 2017.

Subjekti òA.G.ö pretendon se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2017, me faturë arkëtimi nr.9418, datë 12.10.2017 dhe transfertën e bankës datë 16.10.2017 me vlerën e kërkuar nga Bashkia.

Ankesa është shoqëruar me dokumentacion si mëposhtë:

- 1.Shkresa nr.4323, datë 18.03.2021, nga Bashkia Vlorë njoftim për pagesën e detyrimeve.
- 2.Fatura për arkëtim nr.extra, datë 16.03.2021.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të veprimeve të kryera nëpërmjet bankës pranë sektorit të kontabilitetit në Drejtorinë e Taksave Vendore, rezulton se:

-shuma prej 30,000 lekë është kontabilizuar si detyrim ndaj subjektit òA.G.ò.

-referuar evidencave të pranimit, u konstatua se Subjekti òA.G.ò me NIPT K3.....20N dhe përfaqësues ligjor z.P. T. me aktivitet òMbjellje fidanëò ka shlyer detyrimin e vitit 2017 ndaj Bashkisë Vlorë, për ngarkesën me taksa vendore në shumën 27,500 lekë në datën 16.10.2017. Pagesa është kryer nëpërmjet Bankës òP. C.ò (sipas dokumentacionit justifikues bashkëlidhur).

Bashkia Vlorë, në analizën e kryer dhe marrjen e masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të kryente verifikimet në lidhje me detyrimet e paraqitura për subjektet, me qëllim shmangien e faturimit të detyrimeve debitore nga mospërputhja në kohë midis periudhës së auditimit dhe evidentimin e pagesave në sistemin e taksave vendore.

III.2.8.Në zbatim të pikës 8 të programit të Auditimit “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, u auditua kërkesa e shtetasit K. P., protokolluar në KLSH me shkresën nr. 509 prot., datë 05.05.2021.

Ky shtetas, në kërkesën e tij drejtuar KLSH, deklaroi se: prej 5 vjetësh nuk kam përfituar dëmshpërblim për asimilimin e dy pronave në zonën kadastrale 8602 dhe nr.pasurie 41/229 dhe 42/230. Jemi pronar prej vitit 1935, shpronësuar në vitin 1994 që është njoftuar deri më sot 14,238,228 lekë. Investimi në pronën tonë është kryer nga FSHZH në zonën e lungomares. Kërkoj prej 2 vjetësh pranë Bashkisë Vlorë dhe FSHZH skicat e projektit të zbatuar në 2 pronat tona.

Ankesa është shoqëruar me shkresat si më poshtë:

1. Shkresa datë 25.02.2021 drejtuar z.E. B. (pa përgjigje)
2. Shkresa 22.03.2021, drejtuar MIE
3. Shkresa datë 22.03.2021 drejtuar z.D. L.(pa përgjigje)
4. Shkresa nr.4270/1, datë 08.04.2021 Përgjigje nga Bashkia Vlorë.
5. Shkresa nr.5239, datë 30.06.2021 drejtuar FSHZH (pa përgjigje)
6. Shkresa datë 14.08.2021 drejtuar FSHZH
7. Shkresa nr. 1828/1, datë 11.09.2020 drejtuar Bashkisë Vlorë
8. Shkresa nr.8266, datë 25.09.2021 drejtuar FSHZH (pa përgjigje)
9. 2 certifikatat e pronësisë datë 13.01.2015.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se në Bashkinë Vlorë nga z.K. P., është paraqitur shkresa nr.4270, datë 11.03.2021, ku është kërkuar një kopje e projekt zbatimit të objektit *òNdërtimi i segmentit rrugor Skelë - Uji i Ftohtë”*.

Me shkresën nr.4270/1, datë 08.04.2021, të Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit është kthyer përgjigje se objekti *“Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë - Uji i Ftohtë”* nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia Vlorë dhe Projekti *“Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë-Uji i Ftohtë”* i vihet në dispozicion Bashkisë Vlorë së bashku me dosjen teknike të objektit, pasi merret në dorëzim nga Bashkia.

Me shkresën nr.8266, datë 25.09.2020, të Kryetarit të Bashkisë z.D. L. drejtuar FSHZH, në vazhdimësi të korrespondencës sonë si ju kemi informuar me shkresën nr.5239.prot, datë 30.06.2020, lind e nevojshme të na sqaroni nëse në territorin e vijëzuar në fragmentin e hartës bashkëlidhur shkresës përcjellëse, është kryer investim nga ana juaj, bazuar në Projektin e Vijës Bregdetare të qytetit të Vlorës, miratuar me Vendimin nr.1, datë 30.07.2014 dhe Vendimin nr.1, datë 25.04.2016, dhe venien në dispozicion të fletë projektit përkatës të konfirmuar për këtë territor.

Në lidhje sa më sipër, Drejtoresha e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, znj. S. H., na ve në dispozicion dokumentacionin shkresor si më poshtë:

-Me shkresën e nr.2340/1, datë 10.11.2016, Kryetari Bashkisë z.D. L. i është drejtuar familjes P. ku sqaron se zbatimi i projektit *òVija bregdetare e qytetit Vlorës, Faza e Iò* rezulton se pasuritë e paluajtshme me nr.pasurie 41/230 dhe 41/229, ndodhur në zonën kadastrale 8602 òUji

i ftohtë, preken plotësisht nga ky projekt. Në kërkesën për shpronësim dërguar në Ministrinë e Zhvillimit Urban, përkatësisht me shkresat Nr.6497, datë 30.12.2015 dhe Nr. 326, datë 18.01.2016 me lëndë *“Kërkesë për shpronësim për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti: “Vija bregdetare e qytetit Vlorës, Faza e I”, janë përfshirë edhe këto 2 pasuri të paluajtshme për të cilat ende nuk është miratuar shpronësimi.*

-Me shkresën e nr.1082, datë 07.02.2018, Kryetari Bashkisë z.D. L. drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me kërkesën për shpronësim për pasuritë e paluajtshme pronë private, që janë prekur nga zbatimi i projektit *“Vija bregdetare e qytetit Vlorës, Faza e I”, sqaron se komisioni i ngritur për këtë qëllim pranë Bashkisë Vlorë, me shkresat nr.6497, datë 30.12.2015, nr.326, datë 18.01.2016 dhe nr.3148, datë 25.04.2016, ju ka dërguar dokumentacionin dhe tabelat përkatëse për pasuritë e cituara për të cilat nuk është kthyer asnjë përgjigje nga ana juaj. Pranë Bashkisë Vlorë, në vazhdimësi kanë paraqitur ankesa pronarët e pasurive të prekura nga projekti *“Vija bregdetare e qytetit Vlorës, Faza e I”, të cilët kërkojnë vijimin e procedurave për shpronësim.**

-Me shkresën nr.1465, datë 20.02.2019, Kryetari Bashkisë z.D. L. i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me kërkesën për shpronësim për pasuritë e paluajtshme pronë private të cilat janë prekur nga zbatimi i Projektit *“Vija bregdetare e qytetit Vlorës, Faza e I”, por nuk janë përfshirë në VKM Nr.661/2014 (shoqëruar me relacionin përkatës ku përfshihen edhe pasuritë e paluajtshme me nr.pasurie 41/230 dhe 41/229. Kërkesa është bazuar në ligjin nr.139/2015 për vetëqeverisjen vendore ligji nr.8561, datë 22.12.1999 për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik, i ndryshuar, subjekti kërkuar Bashkia Vlorë, kërkon vijimin e procedurës së shpronësimit për këto pasuri.*

-Me shkresën nr.8415, datë 01.10.2019, Në përgjigje të shkresës nr.6790, datë 30.07.2019, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, informon Drejtorinë e Pronave dhe Menaxhimit të Aseteve se lulishtja tek trekëndëshi tek Rapi në Ujë të Ftohtë ka qenë në shërbim të Bashkisë Vlorë si lulishte dhe vazhdon të shërbehet si lulishte me sipërfaqe 1128m.

-Me shkresën nr.1905/2, datë 30.10.2019, Në përgjigje të shkresës nr.3561/2, datë 24.07.2019, protokolluar pranë Bashkisë Vlorë me shkresën nr.1905/1, datë 25.07.2019, me lëndë *“Kërkesë për plotësim dokumentacioni drejtuar MIE, informon se Bashkia Vlorë është në proces inventarizimi për të gjitha pasuritë që janë transferuar në bazë të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore, i ndryshuar, si dhe VKM nr.500, datë 14.08.2001 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njesitë e qeverisjes vendore. Për sa më sipër, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve me shkresën nr.8415, datë 01.10.2019, informon se: Lulishtja tek trekëndëshi tek Rapi në Ujë të Ftohtë ka qenë në shërbim të Bashkisë Vlorë si lulishte dhe vazhdon të shërbehet si lulishte me sipërfaqe 1128m.*

-Me shkresën nr. 1828/1, datë 11.09.2020, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) drejtuar përgjigje kërkesës së familjes Papajorgji dhe për dijeni Bashkisë Vlorë, sqaron se: FSHZH, është agjenci zbatuese e projekteve të paraqitura nga Njësitet e Qeverisjes Vendore. Në këtë kuadër nuk disponon informacion të detajuar mbi pronat respektive. Gjithashtu bazuar në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Vlorë, neni 14 specifikon se *“Drejtoria e Planifikimit të Territorit harton instrumentat e planifikimit të territorit dhe kontrollit të zhvillimit vendor”:*

1. politikat planet dhe rregulloret vendore;
2. projektet e zhvillimit të infrastrukturave publike;
3. planet e detajuara vendore për interes publik.

Për sa më sipër për kompetencë dhe informacion më të detajuar drejtoheni pranë Bashkisë Vlorë.

-Me shkresën nr.775, datë 04.05.2021, në vijim të shkresës së Bashkisë Vlorë nr.640, datë 15.01.2021, protokolluar pranë MIE me nr.645, datë 18.01.2021, nëpërmjet së cilës është dërguar dokumentacion plotësues për pasuritë me nr.41/236, 41/229,41/23, 42/6 dhe 41/228, zk

8602, ju bëjmë me dije se: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Bashkia Vlorë, Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit i ngritur në MIE, midis të tjerave trajton edhe pasurinë me nr.41/230 (lulishte) ku citohet se për këtë pasuri nuk ka ardhur konfirmimi nga Bashkia Vlorë nëse ndodhet apo jo në regjistrin e pronave të Bashkisë.

Objekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë - Uji i Ftohtë” nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia Vlorë dhe Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë- Uji i Ftohtë” i vihet në dispozicion Bashkisë Vlorë së bashku me dosjen teknike të objektit, pasi të merret në dorëzim nga Bashkia.

Nga korrespondenca e mësipërme, konstatojmë se ka munguar bashkëpunimi midis institucioneve dhe prej vitit 2018, Bashkia Vlorë nuk ka dërguar përgjigje në lidhje me inventarin e pasurive, pra nëse këto pasuri janë ose jo në regjistrin e pronave të Bashkisë. Përveç sa më lart evidentohet se Bashkia Vlorë nuk ka ende të azhurnuar regjistrin e pasurive pronë të saj, në kundërshtim me ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 òPër transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore, i ndryshuar, Kreu IV òProcedurat e transferimit nëni 18 òDokumentacioni i transferimit, Kreu VI òDispozita të fundit nëni 20 dhe ligjin nr. 20/2020 òPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nëni 36 òParimet dhe kriteret e përditësimit të pronës shtetërore dhe 37 òPërditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore.

Objekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë - Uji i Ftohtë” nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia Vlorë dhe Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Skelë- Uji i Ftohtë” i vihet në dispozicion Bashkisë Vlorë së bashku me dosjen teknike të objektit, pasi të merret në dorëzim nga Bashkia.

2.8.3. Ankesa e shtetasit D. H., protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1225 prot., datë 15.12.2020.

Në kërkesën e tij drejtuar KLSH-së, ky shtetas deklaron se është posedues i pasurisë me nr. 14/104-Nd, ZK 8603 Vlorë, me sipërfaqe ndërtimi 166.5 m². Kjo pasuri është shpronësuar me VKM nr. 277, datë 02.05.2019 në funksion të projektit publik òRikonstruksion i oborrit të shkollës “Ali Demi”, Vlorë. Vlera e shpronësimit është në shumën **8,796,650 lekë** dhe sipas pikës 4 të VKM-së së mësipërme, kjo shumë do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë. Ky shtetas deklaron se pasi është njohur zyrtarisht me kërkesën për shpronësim si dhe me VKM-në nr. 277, datë 02.05.2019 “Për shpronësim për interes publik”, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë Bashkisë Vlorë, tek Sektori i Shpronësimeve. Në lidhje me likuidimin e vlerës, ky shtetas deklaron se i është drejtuar Bashkisë Vlorë në mënyrë të vazhdueshme, por nuk ka pasur trajtim. Shkresa e fundit drejtuar Bashkisë Vlorë mban nr. 4593 prot., datë 15.06.2020, por vlera e shpronësimit, rezulton e pa kredituar në llogarinë e tij bankare.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se në Bashkinë Vlorë është protokolluar shkresa òNjoftim për shpronësim publik” me nr. 2722/4 prot., datë 31.01.2018 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, që mban firmën e Zv. Ministrisë z. A. Sh., sipas së cilës z. D. H. është posedues i pasurisë nr. 14/104-Nd, ZK 8603 Vlorë sipas hartës së regjistrimit, si dhe ndërtim me sipërfaqe 70 m² sipas certifikatës së pronësisë dhe 166.05 m² sipas sheshit të lejës së ndërtimit. **Vlera totale e shpronësimit është 8,796,650 lekë.**

Me datë 06.02.2018 është publikuar në Fletoren Zyrtare kërkesa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me objekt *Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i oborrit të shkollës “Ali Demi”, Vlorë”.*

Me shkresën nr. 1589 prot., 26.02.2018 òNjoftim për shpronësim publik”, IMT Bashkia Vlorë, ka njoftuar shtetasin D. H. në lidhje me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për shpronësimin e pasurisë së mësipërme për shkak të investimit.

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 277, datë 2.5.2019 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i oborrit të shkollës “Ali Demi”, Vlorë”, ka vendosur shpronësimin në interes

të Bashkisë Vlorë të pronës së mësipërme, pasurisë ndërtesë, në vlerën 8,796,650 lekë, e cila do përballohet nga Bashkia Vlorë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, me shkresën nr. 4593 prot., datë 15.06.2020, është depozituar pranë Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë Vlorë kërkesa e z. D. H. për kreditimin e vlerës së shpronësimit.

Në lidhje sa më sipër, Drejtoresha e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, znj. S. H., deklaroi se shtetasit D. H., me vendimin e KKT Bashkia Vlorë, i është miratuar leja e ndërtimit Nr. 5/89, datë 17.08.2010 me objekt *“Ndërtim të një objekti polifunksional 4 kate me 1 kat nëntokë në lagjen “Dëshmorët” dhe do zhvillohej mbi truallin me nr. pasurie 14/104-ND, ZK. 8603 me sipërfaqe 200 m²ö.* Me vendimin nr. 992 datë 6.9.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë, këtij shtetasi i është hequr e drejta e pronësisë mbi truallin me nr. pasurie 14/104, ndërsa me vendimin nr. 68, datë 23.01.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është shpallur e pavlefshme kërkesa e tij për shtyrjen e afatit të lejes zhvillimore.

Nga audituesit e KLSH-së, pasi u kërkua informacion nga Drejtoria e Pronave dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Ekonomike rezultoi se:

- Bashkia Vlorë, nuk e ka kryer investimin e planifikuar, për të cilin kërkoi edhe ndërhyrjen me VKM për shpronësimin. Sa më sipër, bazuar në nenin 26 të ligjit 8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të pasurive pronë private për interes publikë*, Bashkia Vlorë nuk ka kryer kreditimin e vlerës ndaj z. D. H.

- Rezulton se Bashkia Vlorë, ka kryer 2 urdhra shpenzimesh në emër të z. D. H., urdhër shpenzimi nr. 51, datë 30.01.2020 në shumën 2,000,000 lekë, me përshkrimin *shpronësim për oborrin e shkollës Ali Demi*, si dhe urdhër shpenzimit nr. 704, datë 23.07.2020, me përshkrimin *kthim shume takse ndikimi në infrastrukturë për oborrin e shkollës Ali Demi*. Sipas urdhrit të brendshëm nr. 165, datë 21.07.2020 rezultoi se vlera prej 2,400,000 lekë është bërë në zbatim të vendimit nr. 992, datë 26.09.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë si rikthim i vlerës së truallit.

2.8.4. Ankesa e shtetasit M. K., protokolluar në KLSH me shkresën nr. 883 prot., datë 14.09.2020.

Ky shtetas, në ankesën e tij, deklaroi se në vitin 2010 ka vënë në dispozicion të firmës I. Shpk, një sipërfaqe toke për zhvillim për bërjen e një godine banimi shumëkatëshe. Kontrata e sipërmarrjes mban këto të dhëna: **N=2321 rep., dhe N=1184 kol, datë 11.11.2010**. Sipas ankuesit, nëpunësit e Bashkisë Vlorë që kanë detyrimin për përgatitjen e këtyre dosjeve, kanë abuzuar me ligjin duke bërë ndryshim destinacioni të këtij objekti (nga godinë banimi, në godinë banimi, hotel dhe shërbimi).

Ky shtetas, kërkon të verifikohet gjithë procedura e ndjekur nga ana e K.RR.T. për këtë vendimmarrje, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e paraqitur nga pronari.

1. Kontratën e sipërmarrjes me palën ndërtuese.
2. Kopje të konfirmuar të kërkesës për miratimin e destinacionit të ndërtimit paraqitur nga pronari M. K.
3. Studimin urbanistik pa të cilin kërkesa për leje sheshi nuk merret në konsideratë.
4. Kopje të konfirmuar të planimetrisë së sheshit të ndërtimit të objektit të ndërtuar nga shoqëria I. Shpk mbi pronën e M. K. (asnjë cm ndërtim jashtë kësaj prone) në të cilën kanë miratuar ndërtimin institucionet përkatëse Ndërmarrja Komunale, Ndërmarrja Elektrike, etj. (Jo planimetrinë e sheshit të konfirmuar nga kryetari i K.RR.T).
5. Të kërkohet procesverbali i mbledhjes së K.RR.T së Bashkisë Vlorë, datë 28.09.2011 me të cilin janë pasqyruar marrja e vendimit nr. 2/47, datë 28.09.2011 për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe vendimi nr. 2/48, datë 28.09.2011 për miratimin e lejes së ndërtimit.
6. Të verifikohen procesverbalet e kontroleve periodike të bëra nga urbanistika si detyrim ligjor i saj. (A ka konstatuar kontrolli ndryshimet e destinacionit gjatë ndërtimit të këtij objekti?).
7. Këto të ballafaqohen me ndërtimin që është realizuar në fakt. (me lejen e zbardhur nga urbanistika).

Informacioni i mësipërm ju kërkua zyrës së urbanistikës, e cila vuri në dispozicion nga dosja e

ndërtimit të kësaj lejeje, *kontratën e sipërmarrjes, kopjet e kërkesave të bëra nga pronari i truallit dhe firma ndërtuese si dhe kopje të planimetrisë së sheshit të ndërtimit*. Në dosje mungonte studimi urbanistik, mungonte procesverbali i mbledhjes së K.RR.T-së i datës 28.09.2011 ku është miratuar leje e ndërtimit dhe leje e sheshit të ndërtimit. Në dosje nuk kishte asnjë procesverbal për kontrole periodike të detyrueshme gjatë fazave të ndërtimit të objektit. Objekti rezultoi pa leje shfrytëzimi, dhe është i pajisur me çertifikatë përdorimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se mes palëve ka një marrëveshje sipërmarrjeje (referencat e saj trajtuar më sipër), ku shtetasi M. K. vë në dispozicion të firmës I. Shpk truallin e tij prej 693.75 m², me objekt kontrate, ndërtimin e një objekti shumë katësh (pallat) me kontributin financiar dhe kapacitetet ndërtuese të palës investitore ndërtuese.

Është paraqitur kërkesa për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit nga pronari truallit z. M. K., ku në objekt kërkohet *Godinë banimi dhe shërbimi 2-9 kate, me 1 kat parkim nën tokë, me dyqane dhe garazhe në katin përdhe, zyra dhe banim në katin e parë*. Ky dokument mban firmën e këtij shtetasi. (Formulari Nr. 1)

Gjithashtu, në dosje është kërkesa e firmës që merr përsipër kryerjen e punimeve të ndërtimit, e cila në kërkesën për miratimin e lejes së ndërtimit në objekt, është shtuar edhe paragrafi *hoteleri në lagjen "Pavarësia", rruga "Gjergj Arianiti", Vlorë*. (Formulari Nr. 2)

Në vendimin e K.RR.T të Bashkisë Vlorë me nr. 2/47, datë 28.09.2011 është vendosur miratimi i lejes së ndërtimit me objekt *Godinë banimi, hoteleri, dhe shërbimesh 2-9 kate me 1 kat parkim nëntokë në lagjen Pavarësia, rruga Gjergj Arianiti me pronar truallit M. K. dhe F. R.*

Në vendimin e K.RR.T të Bashkisë Vlorë me nr. 2/48, datë 28.09.2011 është vendosur miratimi i sheshit të ndërtimit me objekt *Godinë banimi, hoteleri, dhe shërbimesh 2-9 kate me 1 kat parkim nëntokë në lagjen Pavarësia, rruga Gj. A. me subjekt I. Shpk*.

Pas zbardhjes nga Urbanistika të lejeve të mësipërme, nga ana e subjektit ndërtues ka nisur ndërtimit i objektit për të cilin ishte pajisur me lejen përkatëse.

Gjatë procesit të ndërtimit, siç deklaroi edhe ankuesi, është bërë ankesë nga z. M. K., i cili është njëri nga pronarët e truallit, i cili ka ngritur pretendimin se ai nuk ka qenë në dijeni se objekti që do ndërtohej do ishte pjesërisht hotel dhe pjesërisht banim.

Sipas Urbanistikës, depozitimi i dokumentacionit teknik dhe ligjor për miratimin e lejes së sheshit dhe asaj të ndërtimit, është detyrim i palës pronare të truallit, dhe subjektit ndërtues, i cili në rastin konkret është edhe pronar i një pjese të truallit.

Në formularin e firmosur dhe dorëzuar nga z. M. K. (Formular nr. 1), përcaktohet për objekt banimi dhe **shërbimesh**.

Ky shtetas, me pretendimin se janë kryer falsifikime të projektit dhe të lejes së ndërtimit duke ndryshuar objektin nga banim në pjesërisht banim + hotel, ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë ndaj drejtueses së shoqërisë òI.ò Shpk, shtetases Gj. R. dhe përfaqësuesit të Drejtorisë së Planifikimit Urban, z. D. H.

Nga informacioni i disponuar, i konfirmuar edhe nga ankuesi, rezultoi se Prokuroria pranë kësaj Gjykate, pas përfundimit të hetimeve, ka vendosur pushimin e çështjes me vendimin nr. 309 të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke mos vërejtur elementë të veprës penale.

Ky vendim është kundërshtuar nga ankuesi, dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 295, datë 09.09.2014 ka vendosur *Mos pranimin e ankimit nga ankuesi M. K.* Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. 104, datë 01.07.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe dërgimin e akteve për rigjykim në po atë gjykatë, me trup tjetër gjykes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka kryer detyrën procedurale të përcaktuara në vendimin nr. 104, datë 01.07.2014 nga Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur me vendimin nr. 371, datë 01.12.2014 mos pranimin e ankimit të ankuesit M. K., me objekt kundërshtim i vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. 309 të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Ky vendim është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. 66, datë 27.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 371, datë 01.12.2014 të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Sipas argumentimit të gjykatës, ky shtetas ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. 0313 rep., datë 20.01.2012 para noterit, pjesë përbërëse e të cilit janë edhe vendimet e K.RR.T Bashkia Vlorë nr. 2/47 dhe nr. 2/48, datë 28.09.2011 në të cilën përcaktohet destinacioni banim + hotel, në të cilën ankuesi është shprehur gjatë hetimit paraprak, se i ka firmosur pa i vënë re. Ky shtetas ka qenë në dijeni, dhe me vullnet ka disponuar një marrëveshje noteriale për përcaktimin e pjesëve përfituese sipas kontratës së sipërmarrjes. Në këto kushte, Gjykata çmon se prokuroria me të drejtë ka arritur në konkluzion se fakti i kallëzuar nga shtetasi M. K. nuk parashikohet si fakt penal nga analiza e marrëdhënieve kontraktore mes palëve, dhe çdo mosmarrëveshje që mund të kenë palët janë të karakterit civil që lidhen me përmbushjen e detyrimeve për të cilat palën kanë rënë dakord.

Fakti që ankuesi nuk ka vënë re që në planimetrinë e sheshit të ndërtimit dhe planimetrinë e lejes së ndërtimit ka qenë parashikuar edhe ÷hoteleri÷, nuk hedh dyshime që këto akte janë të falsifikuara.

- Konkulzioni i audituesve të KLSH-së:

Referuar ankesës së z. M. K., dhe dokumentacionit të shqyrtuar sa më sipër, rezulton se ankesa e z. M. K. ka qenë objekt hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka pushuar hetimet pasi nuk ka vërejtur elementë të veprës penale, dhe përfundimisht ky vendim pushimi është lënë në fuqi me vendimin nr. 66, datë 27.04.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 371, datë 01.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në këto kushte, pretendimi i ankuesit se është falsifikuar kërkesa e tij, nuk mund të auditohet nga audituesit e KLSH-së, pasi organet kompetente hetimore janë shprehur më parë në lidhje me këtë pretendim dhe kanë konkluduar se nuk jemi në kushtet e falsifikimit të firmës, hetim i cili është mbyllur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2.8.5. Ankesa e shtetasit R. R., protokolluar në KLSH me shkresën nr. 52 prot., datë 14.01.2021.

Ky shtetas, në ankesën e tij drejtuar KLSH-së, paraqet problematikën e shkaktuar nga një servis në rrugën ÷Gjergj Arianiti÷, i cili sipas tij: ÷...është bërë gangrenë e komunitetit që jeton aty. Ky servis shkakton ndotje të ambientit, ndotje akustike, përhap helme gjatë ditës, si dhe përbën rrezik për fëmijët dhe të moshuarit me manovrimet e rrezikshme të punonjësve. Ky servis gjithashtu ka bllokuar të gjitha parkimet publike të ndodhura në dy anët e rrugës dhe përgjatë trotuareve, duke paralizuar njësitë e tjera të shërbimeve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në atë rrugë. Në lidhje me këtë ankesë, jemi drejtuar edhe organeve tjera ligj zbatuese, por ka munguar reagimi tyre në lidhje me ankesën tonë.÷

Sa më sipër, rezulton se çështja objekt ankese, është kompetencë e Policisë Bashkiake të Autoritetit Vendor, Bashkia Vlorë, veprimtaria e së cilës rregullohet me ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake÷, neni 8, pikat 2, 5, 6 dhe 7. Nga audituesit e KLSH-së, pasi u kërkua informacion nga Policia Bashkiake në lidhje me situatën faktike, u dhanë menjëherë rekomandimet për zgjidhjen e kësaj shtate dhe u monitorua trajtimi i kësaj problematike. Në përgjigje të kësaj ankese, përfaqësuesit e policisë bashkiake shkuan menjëherë në aktivitetin Person Fizik M. M., ÷Riparime mekanike÷ me NUIS L46.....1S, ku mbajtën një Akt Kontrolli për kundërvajtjen ÷Zënie e Hapësirës Publike÷, në bazë të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake÷, neni 8, dhe kërkuan nga ana e subjektit:

1. Lirimin e menjëhershëm të trotuarit dhe lulishtes;
2. Në rast rikonstatimi marrjen e masave që parashikon ligji;
3. Mbajtjen në monitorim të zonës nga shërbimet e policisë bashkiake.

Personit Fizik M. M. i është lënë afat kohor 1 ditë për zbatimin e detyrave të lëna.

Nga audituesit e KLSH-së, krahas lirimit të hapësirave publike të zaptuara në mënyrë të paligjshme, u la detyrë të merren masa edhe për ndalimin e ndotjes dhe zhurmave që shkaktohen nga ky lloj aktiviteti. Përveç sa më sipër, lihet detyrë verifikimi i dokumentacionit në bazë të së

cilit ky P.F. ushtron profesionin e mekanikut, sipas kërkesave të nenit 4, *Regjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimi* pika 4 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 *ËPër autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to, i ndryshuar.*

➤ **Kryerja e auditmit në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë**

III.2.9. Mbi auditimin e ushtruar për konsumin e karburantit (mjetet motorike apo gjeneratorët) që disponon Bashkia Vlorë, në zbatim të normativave të harxhimit të karburanteve, për secilin tip mjeti.

“Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike; Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme), mbi përdorimin e karburantit”.

Auditimi dhe analiza e shpenzimit mbi menaxhimin të karburantit në NSHP- Bashkia Vlorë është e shtrirë në afatin kohor 01.01.2018 ó 30.06.2020, periudhë 2.5 vjeçare.

Dokumentacioni i përdorur për auditim:

-Ditari i hyrjeve/ daljeve në magazinë;

-Pasqyra e konsumit të karburantit sipas mjeteve dhe aggregateve që ka dispozicion NSHP- Bashkia Vlorë;

-Pasqyra e daljeve të karburantit sipas mjeteve;

-Fletë-Udhëtimet e paraqitura nga Sektori i Financës.

Titulli i Gjetjes:	-Për konsumin e karburantit (mjetet motorike apo gjeneratorët) që disponon NSHP- Bashkia Vlorë, zbatimi i normativave të harxhimit të karburanteve, për secilin tip mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve dhe urdhrin e titullarit																																
Situata:	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Financës, Magazina dhe Dega Teknike në NSHP- Bashkia Vlorë, <i>si dhe kundërshtive të subjekti paraqitur</i>, në lidhje me sasinë e karburantit të bërë hyrje/ dalje dhe gjendje për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, ku pas auditimit të dokumentacionit mbi hyrjet e mallit, shpërndarje sipas mjeteve dhe gjendjes në fund të periudhave, rezulton se:</p> <p>a- Për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, në përfundim të procedurave të prokurimit, për të cilat është mbajtur akt me vetë, NSHP- Bashkia Vlorë për furnizimet e kryera paraqiten sipas Tabelës 1, bashkëlidhur.</p> <p>Tabela 1. Të dhënat mbi hyrjet e mallit</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>EMËRTIMI</th> <th>Sasia gjendje mall</th> <th>Vlera lekë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1.</td> <td>Gjendje 31.12.2017</td> <td>32,453</td> <td>5,280,153</td> </tr> <tr> <td>2.</td> <td>Hyrje viti 2018</td> <td>46,605</td> <td>7,862,263.5</td> </tr> <tr> <td>3.</td> <td>Hyrje viti 2019</td> <td>73,106</td> <td>12,002,286</td> </tr> <tr> <td>4.</td> <td>Hyrje 01.01.2020-30.6.2020</td> <td>51,573</td> <td>7,844,214</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Shuma 01.01.2018 – 30.06.2020</td> <td>203,737</td> <td>32,988,916.5</td> </tr> </tbody> </table> <p>Burimi: Nga Sektori i financës dhe magazina</p> <p>Nga magazina janë bërë dalje në Sektorin Teknik me përgjegjës ing. E. H., mbi shpërndarjen e karburantit sipas mjeteve që NSHP- Bashkia Vlorë, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, të dhëna sipas pasqyrës së vijon:</p> <p>Tabela 2. Mbi shpërndarjen e karburantit sipas fletë daljeve.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>PERIUDHA</th> <th>HYRJE</th> <th>DALJE</th> <th>DIFERENC</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>VITI 2018</td> <td>79,058</td> <td>76,688</td> <td>2,370</td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	EMËRTIMI	Sasia gjendje mall	Vlera lekë	1.	Gjendje 31.12.2017	32,453	5,280,153	2.	Hyrje viti 2018	46,605	7,862,263.5	3.	Hyrje viti 2019	73,106	12,002,286	4.	Hyrje 01.01.2020-30.6.2020	51,573	7,844,214	Shuma 01.01.2018 – 30.06.2020		203,737	32,988,916.5	PERIUDHA	HYRJE	DALJE	DIFERENC	VITI 2018	79,058	76,688	2,370
Nr.	EMËRTIMI	Sasia gjendje mall	Vlera lekë																														
1.	Gjendje 31.12.2017	32,453	5,280,153																														
2.	Hyrje viti 2018	46,605	7,862,263.5																														
3.	Hyrje viti 2019	73,106	12,002,286																														
4.	Hyrje 01.01.2020-30.6.2020	51,573	7,844,214																														
Shuma 01.01.2018 – 30.06.2020		203,737	32,988,916.5																														
PERIUDHA	HYRJE	DALJE	DIFERENC																														
VITI 2018	79,058	76,688	2,370																														

VITI 2019	73,106	75,225	-2,119
6/MUJORI/2020	51,573	50,568	1,005
SHUMA	203,737	202,481	1,256

Në mënyrë analitike për çdo vit, paraqitet në pasurën Aneks 9.1, bashkëlidhur Raport Auditmit (Tabela 1, 2 dhe 3).

Kështu sipas të dhënave e mësipërme, të paraqitur nga vetë NSHP- Bashkia Vlorë për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020 dhe atyre të dërguara me observacion, konstatohet se janë bërë hyrje gjithsej 203,737 litra (nafte/benzinë) dhe bërë dalje në adresë të ing. E. H. sasia prej 202,481 litra (naftë/benzinë), me një diferencë të paargumentuar prej **1256 litra**.

Sipas deklarimit të Magazinieres znj. A. B., deklarohet se nuk ka gjendje malli në magazinë as në formë lëngu dhe as në formë tollone.

Mos dokumentimi i sasisë së mallit prej **1256 litra** (karburantit) me dokumentacion, as gjendje dhe sa dalje, janë veprime financiare **me efekt financiar negativ me vlerë 211,887 lekë (1256 litra x 168.7 lekë/litri, çmim mesatar), duke ngarkuar me përgjegjësi: zj. A. B. me funksion magazinierë për shpërblim dëmi dhe zj. T. D. me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës për mos kryerjen e inventarit dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.**

- Referuar të dhënave të paraqitura nga zj. A. B., me funksion magazinierë mbi hyrjen dhe daljet e karburantit (gazoil/benzinë), konstatohet se janë bërë dalje z. E. H. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit Teknik, të dhëna sipas pasqyrës, si vijon:

Tabela 3. Tabela e krahasimit të sasive të karburantit dalje nga magazina dhe hyrje/ dalje nga Sektori Teknik sipas mjeteve.

Nr.	PERIUDHA	Sasia dalje	Sasia sipas mjeteve	Diferenca
1.	Viti 2018	76,687	79,518	-2,831
2.	Viti 2019	75,225	72,143	3,082
3.	01.01.2020-30.6.2020	50,568	47,306	3,262
Shuma	01.01.2018 - 30.06.2020	202,480	198,967	3,513

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave nga grupi i KLSH, nga dokumentacioni i paraqitur gjatë auditmit dhe me observacion. Në mënyrë analitike paraqitet në pasurën Aneks 9.2, bashkëlidhur aktit.

Kështu sipas të dhënave të pasqyrave të mësipërme, të paraqitur nga vetë NSHP- Bashkia Vlorë për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, janë bërë hyrje gjithsej 202,480 litra (nafte/benzinë) dhe janë bërë dalje sipas mjeteve sasia prej 198,967 litra (naftë/benzinë), me një diferencë të paargumentuar prej **3513 litra**.

Mos dokumentimi i sasisë së mallit prej 3513 litra (karburantit) me dokumentacion, as gjendje dhe sa dalje nga personi i ngarkuar për shpërndarjen ing. E. H., janë veprime financiare **me efekt financiar negativ me vlerë 592,643 lekë (3513 litra x 168.7 lekë/litri, çmim mesatar), duke ngarkuar me përgjegjësi: ing. E. H. me funksion Përgjegjës i Sektorit Teknik.**

Kriteri:

Në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* dhe pikat 35/b, 36, 34 ó 41 dhe 52-60, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e Aktiveve në Njësitë*

	e Sektorit Publikë, me ndryshime.
Ndikimi/Efekti:	Mos kryerja e inventarëve fizik dhe mos dokumentimi i mallit të bërë hyrje dhe dalje, janë verime me efekt financiar negativ në shumën Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën 804,530 lekë .
Shkaku:	Mos dokumentimi i mallit gjendje dhe mungesa e kryerjes së inventarit fizik nga personat përgjegjës.
Rëndësia;	I lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, me grup pune të analizojë situatën mbi gjendjen e karburantit të bërë hyrje- dalje dhe gjendje në magazinë dhe në përfundim të procesit të inventarizimit për diferencën e konstatuar të kërkohet shpërblimi ki dëmit në shumën 804,530 lekë , duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët në ngarkim të personave përgjegjës, konkretisht: - vlera 211,887 lekë , duke ngarkuar me përgjegjësi: zj. A. B. me funksion magazinierë . - vlera 592,643 lekë , duke ngarkuar me përgjegjësi: ing. E. H. me funksion Përgjegjës i Sektorit Teknik .

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689, datë 24.01.2022 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. A. B. dhe ing. E. H., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me diferencat e konstatuara nga ana Juaj, sqarojmë se ato janë dhënë në një periudhë pandemie ku disa nga punonjësit kanë qenë të sëmurë, duke mos rakorduar me njëri tjetrin, si magazina, financa dhe inxhinieri.

Qëndrim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni, sqarojmë se pretendimet nuk merret në konsideratë, pasi kur sqaroni rakordimet në lidhje me furnizimet flisni me vlera, ndërsa dale në sasi, veprime të cilat nuk sqarojnë diferencat.

- **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2018 – 30.06.2020.**

-Auditim mbi zbatimin e strukturës dhe organikës së miratuar

Për periudhën objekti auditimi (01.01.2018 - 30.06.2020), struktura dhe organika është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak (këtu e vijim VKB), respektivisht:

- VKB nr. 99, Datë 22.12.2017 *“Miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë – 2018*ö, dhe shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të KB Vlorë nr. 11729 prot., datë 27.12.2017.
- VKB nr. 133, datë 20.12.2018 *“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2019”* dhe shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të KB Vlorë nr. 10995/1 prot., datë 27.12.2018.
- Vendim nr. 56 datë 30.05.2019 *“Për shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 133, datë 20.12.2018 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2019ö*
- VKB nr. 108, datë 27.11.2019 *“Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2020ö* dhe shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të KB Vlorë nr. 11454 prot., datë 26.12.2019.

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit	Kontrata/Status
2018	43,422	6	83	Kontrate
2019/1	80,854	10	139	Kontrate
2019/2		11	209	Kontrate

Viti	Buxheti Faktik në 000/lekë	Nr. i Sektorëve	Nr. i stafit	Kontrata/Status
2020	52,246	11	209	Kontrate

Në lidhje me largimet dhe emërimet sipas periudhave (nëse ka), pasqyra

PERIUDHA	Largimet	Arsyeja	Emërimet	Procedura e ndjekur
VITI 2018	15	Me dëshirë, pension, etj	17	Kod Pune
VITI 2019	7	Me dëshirë, pension, etj	29+51(sek. sherb. Nj.A.)	Kod Pune
VITI 2020	11	Me dëshirë, pension, ne KEMP, humbje jete, etj	22	Kod Pune

Janë hapur librat e pagave për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, si dhe janë plotësuar me të gjithë elementet, page bruto dhe ndalesat përkatëse për secilin punonjës.

Listëpagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (*listëprezencat të cilat janë të firmosura nga përgjegjësit e zyrave*), specialisti i pagave, përgjegjësi i financës dhe nga Drejtori i NSHP.

Për periudhën e vitit 2020, rezulton se listëpagesat nuk janë nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës, me pretendimin se nuk ka qenë dakord me pagesat e kryera gjatë pandemisë të orëve jashtë orarit dhe se nga specialisti i pagave nuk i vihet në dispozicion Listëpagesat dhe dokumentacioni i plotë ligjorë mbi të cilën ato llogariten dhe plotësohen, veprime këto në kundërshtim me pikat 34, 35 dhe 36 të VKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike”, me ndryshime dhe piken 157 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, ku thuhet se:

Pas konstatimit të transaksionit të shpenzimit në kontabilitet nga nëpunësi zbatues i njësisë, dhe marrjes në administrim të aktivitetit, urdhër-shpenzimi dërgohet menjëherë tek struktura përgjegjëse për thesarin së bashku me:

- faturën e operatorit ekonomik në rast të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve, ose të pagesave të pjesshme apo përfundimtare të lidhura me investimet;*
- listë pagesat për llojet e tjera të shpenzimeve.*
- dokumentin ligjor për pagesa specifike si rastet e pagesave të vendimeve të gjyqit, të shpronësimeve, të të përndjekurve politikë, etj. .*

Titulli i Gjetjes :	<i>Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve.</i>
Situata:	<p>Nga grupi i auditimit u audituar Listëpagesat e periudhës 01.01.2018 ó 30.06.2020, nisur nga fakti se në NSHP kryheshin shumë pagesa për punë jashtë orarit, ku janë paguar dhe persona të cilat nuk e përfitojnë atë.</p> <p>Listëpagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari. Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.</p> <p>Pagesat janë kryer sipas urdhrorit të lëshuar nga Drejtori i NSHP dhe procesverbali të hartuar nga përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve z. P. A. Sipas të dhënave të listpagesave, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020</p>

janë paguar gjithsej **3,008,347 lekë**, nga e cila: për vitin 2018 në shumën 1,269,440 lekë, për vitin 2019 në shumën 1,283,607 lekë dhe për periudhën Janar – Qershor 2020 në shumën 455,300 lekë, pasqyra:

MUAJ	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
JANAR		7,930	765
SHKURT	112,145	70,380	127,886
MARS	102,615	40,840	168,678
PRILL	88,894	74,410	0
MAJ	71,948	99,360	65,938
QERSHIOR	102,366	164,371	92,033
KORRIK	106,766	84,224	
GUSHT	113,890		
SHTATOR	77,948	66,904	
TETOR	85,282	90,285	
NENTOR	100,126	479,259	
DHJETOR	307,460	105,644	
SHUMA	1,269,440	1,283,607	455,300

Nga auditimi i dokumentacionit mbështetës në lidhje me pagesën e këtyre orëve jashtë orarit, rezulton se:

- Në dosje nuk ka asnjë dokument justifikues, mbi punën që ato kanë kryer, arsyen e kryerjes së kësaj pune dhe dokumenti i saj, pasi mungojnë procesverbalet mbi evidentin e punës së kryer sipas përcaktimeve ligjore (ditar punimesh, koha etj), kërkesa për kryerjen e këtyre punëve jashtë orarit të punës, foto që tregojnë se është kryer kjo punë.

- Në asnjë rast nuk është parë mundësia për kompensimin e këtyre ditëve pune me ditë pushimi, pasi për të gjithë këta punonjës është e mundur një gjë e tillë, sepse janë një numër i konsiderueshëm punonjësish, dhe jo të gjithë punonjësit janë të angazhuar në punë jashtë orarit.

- Në kontratat individuale të punës të lidhur me këta punonjës nuk është përcaktuar se kryerja e punëve jashtë orarit të punës.

- Në asnjë rast nuk ka miratim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, për orët jashtë orarit.

- Gjithashtu, është konstatuar se dhe në periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrorë në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së COVID-19, nga NSHP janë kryer punë për orët jashtë orarit, **por që nga verifikimi i dokumentacionit (urdhrat e titullarit)**, konstatohet se nuk janë shërbime/ punë të cilat shkonin për përballimin e nevojave të situatës së pandemisë, por janë kryesisht punime për pastrim plazhi, pastrim të rrugëve, kur dihet se ka një firmë pastrimi të rrugës etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 3,008,347 lekë, duke ngarkuar me përgjegjësi:

z. G. Sh., me funksion ish- Drejtor i NSHP, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

Kriteri:

Nenin 9 dhe 64, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.01.2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò;
 Nenet 88 dhe 90, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i punës në Republikën e Shqipërisëò, me ndryshime;
 Pikës 5, tëVKM nr. 511, datë 24.10.2002 òPër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreò i ndryshuar;
 Pika 23 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò me ndryshime;
 VKM nr. 591, datë 23.07.2010 òPër disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetoreò pika 1/c, UMF nr.19, datë 10.07.2008 òPër vendosjen e disa

	standardeve në planifikimin e shpenzimeve për personelinë pika 5 në zbatim të ligjit organik të buxhetit, si dhe të kontratës individuale të punonjësve.
Ndikimi/Efekti:	Kryerja e pagesave për orë jashtë orarit dhe mos dokumentimi me dokumentacion përkatës ligjorë, kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 3,008,347 lekë.
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave drejtuese të NSHP.
Rëndësia;	I lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, nuk duhet të kryer pagesa për punë jashtë orarit nëse ato nuk janë miratuar më parë nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe të këtë gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjorë për dokumentimin e punës së kryer.

Titulli i Gjetjes:	<i>Kryerja e pagesave të orëve jashtë orarit të administratës</i>																																																						
Situata:	<p>Nga auditimi i listpagesave për orët jashtë orarit, konstatohet se janë paguar dhe punonjës të administratës në shumën 235,435 lekë, veprime me efekt financiar negativ në dëm të fondeve buxhetore, pasi këto punonjës nuk përfitojnë orë jashtë orarit, pasi nuk janë punëtor direkt, si dhe nuk janë të reflektuara në procesverbalet e hartuara nga Përgjegjësi i shërbimeve z. P. A., të dhëna të cilat paraqiten në tabelën 1:</p> <p>Gjithashtu një pjesë e stafit drejtues të NSHP- Bashkia Vlorë, janë paguar me orë jashtë orarit/ dhe ditë festash dhe në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme nga situata COVID-19, dhe lëvizjet kanë qenë të kufizuara dhe vetëm me leje nga e-Albania, për shumën 50,150 lekë, veprime financiare me efekt negativ në buxhetin e NSHP, konkretisht peronat:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Emri Personit</th> <th>FUNKSIONI</th> <th>Shkurt 2020</th> <th>Mars 2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>E. H.</td> <td>Përgj. Sektori Teknik</td> <td>1,516</td> <td>20,408</td> </tr> <tr> <td>E. L.</td> <td>Përgj. Sek. Gjelbërimi</td> <td>4,128</td> <td>3,096</td> </tr> <tr> <td>P. A.</td> <td>Përgj. Sek. Shërbimi</td> <td>4,169</td> <td>12,128</td> </tr> <tr> <td>Z. M.</td> <td>Përgj. Shërbime NJA Qendër</td> <td>2,352</td> <td>2,353</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma</td> <td>12,165</td> <td>37,985</td> </tr> </tbody> </table>	Emri Personit	FUNKSIONI	Shkurt 2020	Mars 2020	E. H.	Përgj. Sektori Teknik	1,516	20,408	E. L.	Përgj. Sek. Gjelbërimi	4,128	3,096	P. A.	Përgj. Sek. Shërbimi	4,169	12,128	Z. M.	Përgj. Shërbime NJA Qendër	2,352	2,353		Shuma	12,165	37,985																														
Emri Personit	FUNKSIONI	Shkurt 2020	Mars 2020																																																				
E. H.	Përgj. Sektori Teknik	1,516	20,408																																																				
E. L.	Përgj. Sek. Gjelbërimi	4,128	3,096																																																				
P. A.	Përgj. Sek. Shërbimi	4,169	12,128																																																				
Z. M.	Përgj. Shërbime NJA Qendër	2,352	2,353																																																				
	Shuma	12,165	37,985																																																				
Kriteri:	Në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 òPër kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore o i ndryshuar, dhe Nenet 88 dhe 90, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i punës në Republikën e Shqipërisë, me ndryshime.																																																						
Ndikimi/Efekti:	Kryerja e pagesave për orë jashtë orarit për punonjës të administratës, janë veprime financiare me efekt negativ në shumën 285,585 lekë.																																																						
Shkaku:	Përgjegjësi e strukturave drejtuese të NSHP.																																																						
Rëndësia;	I lartë																																																						
Rekomandimi:	<p>Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, nuk duhet të kryer pagesa për punë jashtë orarit të punonjësve të administratës, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 285,585 lekë, në ngarkim të punonjësve sipas tabelës:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Emri Mbiemri</th> <th>Pozicioni</th> <th>Viti 2018</th> <th>Viti 2019</th> <th>Viti 2020</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>G. Sh.</td> <td>Drejtor</td> <td>15,890</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>E. H.</td> <td>ing. Sek Teknik</td> <td>32,218</td> <td>46,660</td> <td>21,924</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>M. K.</td> <td>Inxhinier</td> <td>0</td> <td>9,483</td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>A. M.</td> <td>Tekin Sek. Teknik</td> <td>13,516</td> <td>18,288</td> <td></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>A.H.</td> <td>Llog. Pagash</td> <td>23,985</td> <td>8,494</td> <td></td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>A. B.</td> <td>Magaziniere</td> <td>16,350</td> <td>2,243</td> <td></td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>E. B.</td> <td>arkivist</td> <td>10,900</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>J. H.</td> <td>Ekonomiste</td> <td>10,240</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nr.	Emri Mbiemri	Pozicioni	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	1	G. Sh.	Drejtor	15,890			2	E. H.	ing. Sek Teknik	32,218	46,660	21,924	3	M. K.	Inxhinier	0	9,483		4	A. M.	Tekin Sek. Teknik	13,516	18,288		5	A.H.	Llog. Pagash	23,985	8,494		6	A. B.	Magaziniere	16,350	2,243		7	E. B.	arkivist	10,900			8	J. H.	Ekonomiste	10,240		
Nr.	Emri Mbiemri	Pozicioni	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020																																																		
1	G. Sh.	Drejtor	15,890																																																				
2	E. H.	ing. Sek Teknik	32,218	46,660	21,924																																																		
3	M. K.	Inxhinier	0	9,483																																																			
4	A. M.	Tekin Sek. Teknik	13,516	18,288																																																			
5	A.H.	Llog. Pagash	23,985	8,494																																																			
6	A. B.	Magaziniere	16,350	2,243																																																			
7	E. B.	arkivist	10,900																																																				
8	J. H.	Ekonomiste	10,240																																																				

	9	F. Xh.	P/Sektor	8,125		
	10	J. H.	Inxhinier	9,695		
	11	P. A.	Përgjegjës	9,348		16,297
	12	E. L.	Përgj. Sek.Gjelbrimi			7,224
	13	Z. M.	Përgj. Shërbime NJA Qendër			4,705
			Shuma	150,267	85,168	50,150

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 prot KLSH nr. 731/28, datë 26.01.2022) “Mbi Projektraporti i Auditimit” nga znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*Në lidhje me konstatimet e bërë nga grupi i KLSH, jam dakord dhe unë si shefe finance vazhdimisht kam qenë kundërt kryerjes së pagesave për orët jashtë orarit. Kjo dokumentohet dhe me relacionin e datës 30.4.2020 adresuar ish- Drejtorit z. G. Sh., relacion i cili iu është paraqitur grupit të KLSH në fazën e akt-konstatimeve, duke këmgulur që të plotësohen me ditë pushimi si kompensim, bazuar kjo në nenin 91 pika 2 e kodit të punës.*

Por do të hartoheshin nga specialist z. A. H. dhe përgjegjësi i sektorit përkatës dhe të miratuar nga ish- Drejtori z. G. Sh., të cilat nuk më viheshin në dispozicion.

Nga ana ime si shefe finance është plotësuar vetëm urdhër shpenzimi i cili bashkëlidhur kanë listëpagesat, për mos të sjell pengesa në kryerjen e pagesave.

Oëndrim i grupit të KLSH-së:*Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nga personi përgjegjës nuk është paraqitur dokumentacion shtesë nga ato të akt-konstatimeve, duke pohuar faktin se gjetjet qëndrojnë dhe se nga vetë znj. T. D. janë kundërshtuar këto fenomene por që nuk janë marrë në konsideratë nga ish- Drejtori z. G. Sh.. Gjetjet e grupit të KLSH qëndrojnë.*

9.2. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj, për periudhën 01.01.2018 – 30.6.2020, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë.

Titulli i Gjetjes :	<i>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nga Autoriteti Kontraktor (AK) NSHP- Bashkia Vlorë, për asnjë rast nuk është bërë i mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës. - Të gjitha dosjet nuk janë të inventarizuara (numëruar) dhe dorëzuar në Zyrën e Protokoll/Arkivës. - Nga NJHDT nuk janë mbajtur procesverbalet e hapave të zhvillimit të procedurës (<i>hapjes dhe vlerësimit të procedurës</i>). - Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet përmbledhëse (<i>në rastet kur ato janë mbajtur</i>), nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit, arsyet e skualifikimit e tij. - <u>Llogaritja e fondit limit:</u> Nuk disponohen asnjë dokumentacion mbi mënyrën e llogaritjes dhe argumentimin e cimeve të përdorura, kërkesat e sektorëve, objekteve/segmenteve rrugore që do trajtohen, hartat e rrugëve ose trotuareve se ku do kryhet shërbimi, etj. <p>Gjithashtu, konstatohet se fondi limit është përcaktuar nga së prokurimeve (procesverbalet/raporti përmbledhës/njoftim fituesi, etj.), nuk janë protokolluar në protokollin e NSHP- Bashkia Vlorë.</p> <p>- Nga AK NSHP- Bashkia Vlorë, për periudhën e audituar institucioni nuk</p>

	<p>ka hartuar regjistrin vjetor të parashikimit të prokurimeve dhe për pasojë nuk është monitoruar e raportuar realizimi i tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në një pjesë të procedurave, në dosje mungojnë urdhër e Titullarit të ngritjen e komisionit të NJHDT dhe KVO. - Në një pjesë të praktikave, nga anëtarët e NJHDT dhe KVO nuk janë plotësuar dhe nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit. - Realizimi i procedurave të prokurimit, pa miratim me VKB dhe të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për rastet e investimeve, ku për vitin 2019 NSHP ka kryer procedurën me vlerë të vogël për blerje makine (investim), pa miratim në vlerën 900 mijë lekë. - Në procedurën me objekt: <i>“Riparimi i pompës Ganz ne hidrovorin e Qytetit Vlore”</i>, mefond limit 1,983 mijë lekë ku fitues është shpallur shoqëria òR.M.Kò me ofertë 1,560 mijë lekë, kontrata nr. 407/1, datë 12.11.2018 është lidhur më shpejt se procedura të shpallet në buletin e APP. <p>Sipas sistemit SEP ajo është shpallur me datë 14.05.2019, pra afërsisht me 6 muaj vonesë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga NSHP- Bashkiak Vlorë në rastet e procedura të prokurimit të shërbimit të rojeve private, nuk ka zbatuar VKM nr. 177, datë 04.04.2019 òPër krijimin e shoqërisë òI. G.ò sha, për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronarò.
Kriteri:	<p>Në kundërshtim me VKB nr. 141, datë 27.12.2018, kapitulli I, pika 10, si dhe nenet 50 ó 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19/01/2018 të MF òPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2018ò, i ndryshuar; ligjin nr. 9154, datë 6/11/2003 òPër Arkivatò; nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08/07/2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27/12/2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu III, òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, pika 36 dhe pika 37; pika 2 të nenit 59 <i>“Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës”</i>, neni 61, neni 68- <i>Raporti përmbledhës</i>²⁴, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; nenin 12 pika 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 òPër Prokurimin Publikò të ndryshuar, nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10/09/1998 <i>“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”</i>, i ndryshuar; pika 1 dhe 4 të Udhëzimit të APP nr. 2, datë 27/01/2015 òPër hartimin e Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikò.</p>
Ndikimi/Efekti:	Parregullsi në procedurat e prokurimit
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore nga personat përgjegjës.
Rëndësia;	I lartë
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për vitet 2018 dhe 2019 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. - Në të gjitha rastet e hapjes së procedurave të prokurimit, Titullari i AK të

²⁴Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/ mallrave/ shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/ vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsytet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave”

	<p>nxjerrë Urdhër Prokurimi i cili duhet të miratohet në Degën e Thesarit Vlorë për garantimin e fondeve për zbatimin e kontratës, të nxirren urdhër për ngritjen e Njësisë së Hartimit të DST dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.</p> <p>Për rastet e investimeve të mos hapen procedura pa miratim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.</p> <p>-Për raste e zhvillimit të procedurave për shërbimin e ruajtjes së objekteve, fillimisht të kërkohet lidhja e kontratës me shoqërinë òl. G.ò sha, që përfaqëson shtetin si pronar dhe në rast mos përgjigje nga kjo e fundit të zhvillohen procedurat standarte të prokurimeve.</p>
--	---

Titulli i Gjetjes:	<i>KLSH-ja, konstatoj së në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2018 30.06.2020, janë konstatuar kritere jo në përputhje me procedurën dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja</i>
Situata:	<p>Referuar të dhënave të regjistrit të procedurave për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, nga NSHP Bashkia Vlorë janë realizuar gjithsej 35 procedura me vlerë kontrate 93,445,950 lekë, nga e cila: në vitin 2018 janë realizuar gjithsej 11 procedura me vlerë kontrate 27,108,218 lekë, për vitin 2019 janë realizuar 18 procedura me vlerë kontrate 55,238,660 lekë dhe për periudhën Janar ó Qershor 2020 janë realizuar 6 procedura me vlerë kontrate 11,099,950 lekë.</p> <p>Ulja nga fondi limit paraqitet në vlerën 14,130 mijë lekë ose 13.4%.</p> <p>Pjesëmarrës në procedura janë gjithsej 77 OE nga të cilët janë skualifikuar 20 OE.</p> <p>Grupi i KLSH-^{së}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga 35 procedura me vlerë kontrate 93,445,950 lekë ka vlerësuar për auditim 25 procedura ose 87.5% me vlerë kontrate 82,415,343 lekë ose 88% të vlerës së kontratave të lidhura, nga e cila: për vitin 2018 nga 11 procedura me vlerë kontrate 27,108,218 lekë janë audituar 7 procedura me vlerë kontrate 23,384,051 lekë, për vitin 2019 nga 18 procedura me vlerë kontrate 55,238,660 lekë janë audituar 13 procedura me vlerë kontrate 48,559,900 lekë dhe për periudhën Janar ó Qershor 2020 nga 6 procedura me vlerë kontrate 11,099,072 lekë janë audituar 5 procedura me vlerë kontrate 10,471,392 lekë.</p> <p>Nga auditimi i 25 procedura me vlerë kontrate 82,415,343 lekë, rezulton se të gjitha procedurat janë në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në 15 procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura ose në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme; - Në 7 procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën 37,318,194 lekë; - Në 3 procedura janë konstatuar veprime në paligjshmëri me pasoja negative në buxhetin e NSHP- Bashkia Vlorë në vlerën 2,272,019 lekë, në zbatimin e kontratave të lidhura midis sipërmarrësit dhe investitorit.
Kriteri:	<p>a- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, ku thuhet se: Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me

këto parime të përgjithshme:

- a) Mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;
- c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.

- **Neni 20, “Mosdiskriminim”,** ku thuhet se:

Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

- **Neni 24, “Anulimi i një procedure”,** ku theksohet se:

1. *Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:*

a) *për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik;*

b) *nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;*

c) *kur në fazën e parë të procedurës së kufizuar dhe me negociim me shpallje paraprake të njoftimit kualifikohen më pak se 2 kandidatë;*

ç) *nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;*

d) *nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për një kontratë të caktuar;*

dh) *kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji*

- **Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”,** pika 1, ku është përcaktuar se:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese: ...”.

- **Neni 47, “Kualifikimi i ofertuesve”,** ku është përcaktuar se:

“Autoriteti kontraktor s`kualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese. Autoriteti kontraktor për çdo s`kualifikim raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik për qëllimet e parashikuara në nenin 13 pika 3 të këtij ligji.

- **Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”,**ku është përcaktuar se:

“1. Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”.

- **Neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës”,** ku thuhet se:

2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

	<p>3. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm në baza teknike dhe ekonomike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 58, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, ku është përcaktuar se: <i>“1. Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit, që ka paraqitur ofertën më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji”.</i> <p>b- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 66, <i>“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”,</i> ku është përcaktuar se: <i>“1. Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</i> <p><i>Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 67, <i>“Klasifikimi i ofertave”,</i> ku është përcaktuar se: <i>“Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”.</i> - Neni 69, <i>“Njoftimi i fituesit”,</i> ku është përcaktuar se: <i>“Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e fituesit në përputhje me nenin 58 të LPP”.</i> - Neni 70 <i>“Lidhja e kontratës”,</i> ku është përcaktuar se: <i>“Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktorë.</i>
Ndikimi/Efekti:	Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve për vlerën 22,580,863 lekë, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Titullari i AK Bashkia Vlorë dhe anëtarët e NJHDT dhe KVO, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.
Shkaku:	Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.
Rëndësia;	I lartë
Rekomandimi:	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (<i>sipas llojit të procedurës</i>), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet. - Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

	<p>- Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik me vlerë 22,580,863 lekë.</p>
--	---

➤ **Procedurat e audituara sipas periudhave dhe problematikat e konstatuara për çdo procedurë.**

• **Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018**

1- Tenderi me objekt: “Blerje karburanti, viti 2018”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje karburanti, viti 2018</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 35, dt. 17.5.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 116, datë 15.5.2018 J. H. - Kryetar J. Gj.- anëtar F. Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “HAPURÖ		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 10,083,000 lekë (Sasia 70798 litra naftë dhe 232 litra benzol) REF-70514-22-05-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðB.ö me marzhë fitimi 7.5%, me kontratë nr. 184, datë 16.7.2018 dhe ofertë ekonomike 10,083,000 lekë me kontratë nr. 184, datë 16.7.2018 me afat 12 muaj nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0.0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 31.5.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APP ósaka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

- Nga NjHDT **nuk** është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës, në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014, i ndryshuar.

Nga auditimi i kriterëve të aplikuara, rezulton e paargumentuar kërkesa **për mjek**, pasi referuar kushteve të procedurës nuk është sipas kërkesa të VKM nr. 742, datë 6.11.2003.

-Me datë 15/06/2018 është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, *konkretisht*:

1. Shoqëria ðB.ö me marzh fitimi 7.5%
2. Shoqëria ðK.ö me marzh fitimi 9.7 %.
3. Shoqëria ðA.ö me marzh fitimi 14.8%
4. Shoqëria -F.ö me marzh fitimi 6.9%

Me datë 18/06/2018, KVO ka mbyllur procedurën dhe bërë vlerësimin e dokumentacionit teknik/ligjor. Pas vlerësimit KVO nga 4 OE pjesëmarrës ka skualifikuar 2 OE, *konkretisht*:

1. **Shoqëria “F.”** me marzhë fitimi 6.9%, *pasi*:
 - a- Vërtetimi i taksave vendore i përkiste periudhës së vitit 2017.
 - b- Nuk dispononte PMZH për zjarrin.
 - c- Nuk dispononte mjek sipas VKM nr. 742;

2. **Shoqëria “A.”**, me marzh fitimi 14.8%, pasi:

a- *Nuk kishte objektin e prokurimit.*

Midis dy OE të mbetur, KVO duke vlerësuar kriterin kryesorë, duke shpallur fitues shoqërinë òB.ò me marzhë fitimi 7.5%.

Me datë 16/6/2018 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Me datë 28/06/2018, KVO ka shpallur fitues shoqërinë òB.ò me marzhë fitimi 7.5%.

Ndërmjet investitori NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë fituese òB.ò, është lidhur kontrata nr. 184, datë 16.07.2018 nga data e lidhjes, me marzhë fitimi 7.5 %, me vlerë totale 10,080,000 lekë pa TVSH.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: *zj. J. H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NHDT dhe anëtarët e NJHDT dhe z. F. Xh. me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit të Kullimit, dhe anëtarët e KVO; z. M. K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj. T. D. me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe z. J. Ç., me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit të Territorit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prezantimi i subjektit:*Në lidhje me konstatimet e bërë nga grupi i KLSH, nga subjekti janë paraqitur dokumentacion mbi mënyrën e përllogaritjes së fondit limit për sasinë e karburantit që do blihet.*

Qëndrim i grupit të KLSH-së:*Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se merret në konsideratë fakti mbi përcaktimin e fondit limit për sasinë e karburantit që prokurohet. Ndërsa për pjesët e tjera nuk ka kundërshti.*

2- **Tenderi me objekt:** “Rehabilitim i trotuareve të rrugës Demokracia, faza 2”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitim i trotuareve të rrugës Demokracia, faza 2”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 87, dt. 15/4/2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 87, dt. 16/4/2018 J. Gj. F. Xh. J. H. (juriste)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 86, dt. 16/4/2018 M. K.- Kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimò		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,184,936 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òC.ò me ofertë ekonomike 2,771,200 lekë me kontratë nr. 146, datë 11/6/2018, me afat 30-61 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 413 mijë lekë ose 12.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 27/4/2018	9. Burimi Financimit Bashkia Vlorë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 4 OE/BOE
11. Ankimime: sòka	12. Përgjigje Ankesës nga AK SKA	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP ; SKA

-**Hartimi i kriterëve:** Nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbal mbi argumentimin e kriterëve të aplikuar për këtë procedurë dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NHDT.

- **Zhvillimi i procedurës.** Nga anëtarët e KVO, me datë 27/4/2018 është mbajtur PV i hapjes së procedurës, ku konstatohet se kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
-----	--------------------	------------------	--------------------------

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	T.D	2,707,500	Kualifikohet
2.	C.	2,771,200	Kualifikohet
3.	Z.	3,084,500	Kualifikohet
4.	C.	3,157,600	Kualifikohet

Sipas PV datë 30.04.2018 në këtë procedura kanë marrë pjesë 4 OE.

KVO ka kualifikuar të 4 OE pjesëmarrës dhe nuk ka skualifikuar asnjë, duke shpallur fitues shoqërinë òT.Dò me ofertë 2,707,500 lekë pa TVSH, me ofertë më të leverdishme se operatorët e tjerë pjesëmarrës.

Me datë 30/04/2018 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim. Konstatohet se ky Raport përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitorit NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òC.ò SHPK me ofertë 2,771,200 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 31, datë 10.09.2019me afat 30-40 ditë nga data e lidhjes.

- Mangësitë e konstatuara.

1. *Dosja është e pa inventarizuar dhe numëruar për çdo vlerë;*
2. *Nga anëtarët e NJHDT dhe KVO, nuk janë mbajtur PV e hartimit të kriterëve dhe raporti përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve ligjore;*
3. *Procedura nuk është miratuar në buxhetin e vitit 2018;*
4. *Nuk janë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesit nga asnjë nga anëtarët e NJHDT dhe KVO;*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi; anëtarët e NJHDT; zj. J. H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NHDT dhe anëtarët e NJHDT, dhe z. F. Xh. me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit të Kullimit, dhe anëtarët e KVO; z. M. K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj. T. D.me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe z. J. Ç., me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit të Territorit.

Titulli i Gjetjes:	Mos zbatimi i punimeve në afat.
Situata:	<p>Referuar pagesave të kryera nga NSHP-Bashkia Vlorë, rezulton se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Me USH nr.132, datë 23/7/2018 është likuiduar shuma 1,300,140 lekë, sipas faturës nr. 1, datë 9/7/2018, bërë hyrje me FH nr. 28, datë 9/7/2018, për të cilën është hartuar dhe situacione datë 9/7/2018;</i> 2. <i>Me USH nr. 100, datë 9/5/2019 është likuiduar për diferencë vlera 499,518 lekë, sipas faturës nr. 12, datë 17.10.2018 dhe FH nr. 46, datë 17.10.2018 dhe situacione progresiv datë 16/10/2018 për shumën 1,499,715 lekë;</i> 3. <i>Me USH nr. 101, datë 9/5/2019 është likuiduar shuma 476,493 lekë, sipas faturës nr. 26, datë 29/11/2018 dhe FH nr. 53, datë 29/11/2018 dhe situacionit progresiv datë 28/11/2018 në shumën 1,896,793 lekë;</i> 4. <i>Me USH nr. 272, datë 24/9/2020 është likuiduar fatura nr. 27, datë 18/12/2018 në shuma 1,049,288 lekë dhe FH nr.62, datë 18/12/2018.</i> <p>Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve (afateve), të përcaktuar prej 30-61 ditë dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim nuk janë zbatuar penalitete për mos mbyllje në afat të kontratës në vlerën 538,196 lekë pas TVSH, veprime financiare me</p>

	<p>dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi ing. M. K., E. H., A. M. dhe P. A., si vijon.</p> <p>Sipas kontratës punimet duhet të mbyllën në afatin 30 - 61 ditë ose nga datë 11/06/2018 deri me datë 11/08/2018. Nga të dhënat objekti nuk është mbyllur sipas këtyre afateve.</p> <p>Kështu situacione nr. 2 me vlerë 397,077 lekë është paraqitur me 79 ditë vonesë, kjo sipas faturës nr. 26, datë 29/11/2018 dhe detyrimi i përlogaritur për kamatëvonesën paraqitet: $397,077 \times 4/1000 \times 97 \text{ ditë} = \mathbf{125,476 \text{ lekë}}$ pa TVSH.</p> <p>Ndërsa situacione nr. 3 me vlerë 874,407 lekë pa TVSH është paraqitur me 118 ditë vonesë, kjo sipas faturës nr. 27, datë 18/12/2018, ku detyrimi për kamatëvonesë paraqitet: $874,407 \times 4/1000 \times 118 \text{ ditë} = \mathbf{412,720 \text{ lekë}}$ pa TVSH.</p> <p>Gjithsej detyrim kamate pa llogaritur paraqitet në shumën 538,196 lekë pa TVSH (125,476 + 412,720), vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Vlorë, duke për shpërbllim dëmi shoqërorinë "C."</p>
Kriteri:	Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes kryesore dhe kontrata nr. 31, datë 10.09.2019
Ndikimi/Efekti:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt financiar negativ me vlerë 538,196 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP
Rëndësia;	<i>I lartë</i>
Rekomandimi:	Drejtori i NSHP Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Sektorin e Financës të marrë të gjitha masat administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerën prej 538,196 lekë në ngarkim të shoqërisë oC."

3- Tenderi me objekt: "Shërbimi i sigurisë së rojeve private", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Shërbimi i sigurisë së rojeve private</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 7, dt. 5.3.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. ---, dt. --- J. Gj. - Kryetar J. H. - anëtar F. Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. --, dt. ----- M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Negocim pa shpallje te kontratës"		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,345,695 lekë REF-	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO oS. S.ö me ofertë ekonomike 2,316,680 lekë me kontratë ---, datë 23.03.2018 me afat 2 muaj nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 29 mijë lekë ose 1.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 21.3.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. 19.3.2018 dt. -----; KPP--/ APPócka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 65 dt. 21.3.2018	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në aplikimin e kriterëve, konstatohen kriterë të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, konkretisht:

a- *Është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim mbi detyrimet e papaguara Bashkia Vlorë, kriter i paargumentuar, pasi ka subjekte të cilat nuk kanë aktivitet me Bashkinë Vlorë dhe ky vërtetim është i panevojshëm dhe identifikon pjesëmarrësit.*

Veprimet ngarkojnë me përgjegjësi: Komisionin e HDT, **zj. J. H.**, me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NHDT dhe anëtarët e NJHDT dhe **z. F. Xh.** me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit te Kullimit.

-Zhvillimi i procedurës.

Me datë 21.03.2018 është hartuar procesverbali i mbylljes së procedurës. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht::

5. Shoqëria òS. S.ò ShPK me ofertë ekonomike 2,136,680 lekë pa TVSH
6. Shoqëria òF.ò ShPK me ofertë ekonomike òòò lekë pa TVSH
7. Shoqëria òI.ò ShPK me ofertë ekonomike òòò lekë pa TVSH

Pas vlerësimit KVO ka vendosur që nga 3 OE pjesëmarrës të skualifikojë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqërinë òF. ò me ofertë ekonomike 0 lekë pa TVSH, pasi:
 - a- *Nuk paraqet formularin e ofertës.*
 - b- *Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e energjisë elektrike*
2. Shoqërinë òI. ò me ofertë ekonomike 0 lekë pa TVSH, pasi:
 - c- *Nuk paraqet formularin e ofertës.*

KVO ka klasifikuar në vend të parë shoqërinë òS. S.ò SHPK me ofertë ekonomike 2,136,680 lekë pa TVSH.

Me datë 23.03.2018 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.** Njoftimi i kontratës nr. 68, datë 23.03.2018

- Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjekti, konstatohet se shoqëria òS. S.ò, NUK përmbushë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- a- *Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk përfshin periudhën e muajit janar 2018, kur sipas DST procedura zhvillohet me datë 20.03.2018. Vërtetimi i subjekti është me nr. 468, datë 24.01.2018 dhe përfshin periudhën deri në muajin Dhjetor 2017.*
- b- *Në plotësimin e vetëdeklaratës, sipas shtojcës 8, rezulton se, nuk përcakton të gjithë ortakët, administratorët. Në shtojcën 8 të DST përcaktohet se, OE deklaron “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, Aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik”. Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “S. S.” rezulton se ka administrator P. N. dhe Drejtues Teknik z. T. I. të padeklaruar në shtojcën 8, nëse janë në ndjekje penale ose jo.*

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òS. S.ò ShPK, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, duke argumentuar shkaqet dhe kërkuar zhvillimin e procedure tjetër me kriteret më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve për shmangien e paligjshmërisë së përdorimit të fondeve në vlerën **2,345,695lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M. K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj. T. D.me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe z. J. Ç., me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit te Territorit.**

Gjithashtu, konstatohet se:

- a- *Dosja nuk është e protokolluar dhe numëruar për çdo fletë.*
- b- *Mungojnë urdhrat e titullarit për ngritjen e komisioneve të NJHDT dhe KVO;*
- c- *Nga anëtarët e NJHDT nuk janë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit*
- d- *Nuk ka dokumentacioni mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit në vlerën 2,345,695 lekë.*
- e- *Konstatohet se nga NSHP- Bashkia Vlorë, nuk është zbatuar Vendimi i KM nr. 177,*

datë 04.04.2019 ðPër krijimin e shoqërisë “I. G.” sha dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronarë të aksioneve të kësaj shoqërie’.

- f- Nga anëtarët e NJHDT dhe KVO, nuk janë mbajtur PV e hartimit të kritereve, dhe raporti përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve ligjore;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NHDT dhe KVO, respektivisht:

zj. J. H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NHDT.

z. F. Xh. me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit të Kullimit, dhe

z. J. Gj., në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

z. M. K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike, në cilësinë e Kryetarit të KVO.

zj. T. D. me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe

z. J. Ç., me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me konstatimet e bërë nga grupi i KLSH, bashkëlidhur janë paraqitur deklaratat e konfliktit të interesit, procesverbali i hartimit të fondit limit, vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike dhe QKB e shoqëruar me shtojcën 5 të DST.

Qëndrim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, për faktin se:

a- Procesverbali mbi hartimin e kritereve është një dokument që mund të jetë prodhuar tani (kjo dhe për deklaratën e konfliktit të interesit), pasi ai nuk është nënshkruar nga gjithë anëtarët e NJHDT, **por vetëm nga znj. J. H.**, gjë e cila vë në dyshim atë, pasi gjatë fazës së auditimit nuk ndodhej në dosjen e procedurës.

b- Në lidhje me mos plotësimin e kriterit mbi vërtetimin e energjisë elektrike, argumenti nuk qëndron, pasi subjekti deklaroi se ka paguar deri në muajin Dhjetor 2017, ndërkohë që procedura zhvillohet në datë 21.3.2018. **Pra duhet të ishte brenda dhe muaj Janar 2018.**

c- Në lidhje me mos plotësimin e vetëdeklaratës, sipas shtojcës 8, rezulton se, nuk përcakton të gjithë ortakët, administratorët, argumenti nuk qëndron pasi nga subjekti është paraqitur shtojca 5, ndërkohë që nga KLSH është kërkuar shtojca 8.

4- Tenderi me objekt: “Pastrim i kanaleve ujitëse me krah pune”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Pastrim i kanaleve ujitëse me krah pune”,		
1. Urdhër Prokurimi nr. 107/1, dt. 23.3.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. ----- J.H. (juriste) F.Xh. (Jurist) A.H.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M.K.- Kryetar T.D.- anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimë”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 936,666 lekë pa TVSH REF-60568-06-04-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE ðE.Nö me ofertë ekonomike 920,400 lekë me kontratë 107, datë 3.5.2018, me afat 20 DITË.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 16 mijë lekë ose 1.7 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 20.04.2018	9. Burimi Financimit Bashkia Vlorë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime: sëska	12. Përgjigje Ankesës nga AK SKA	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP ; SKA

- **Hartimi i kritereve:**

Sipas dosjes së auditimit, nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbal mbi argumentimin e

kritereve të aplikuara për këtë procedurë. Në kriteret e aplikuara, konstatohet se ka kritere të cilat nuk përkojnë me procedurën, konkretisht:

- a- *Është i paargumentuar kriteri që OE të ketë paraqitur vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm.*

Veprimet që **ngarkojnë me përgjegjësi: znj. J. H.**, me funksion specialiste në Sektorin e Financës, **z. A. H.** me funksion llogaritar pagash në Sektorin e Financës dhe **z. F. Xh.** Me funksion Përgjegjës në Sektor I Bordit te Kullimit.

- **Hartimi i fondit limit:** Fondi limit është hartuar nga specialistët F. Xh., A. M. dhe M. K. për shumën 1,124,000 lekë me TVSH. Në dosjen e procedurës nuk gjejmë asnjë dokumentacion mbi nevojën e kryerjes së këtij shërbimi (kërkesën e sektorit përkatës). Ku është bazuar komisioni në përcaktimin e çmimeve të punimeve, cili kanal është për pastrim, etj.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Me PV nr. 101, datë 30.04.2018 është bërë hapja e procedurës, ku ka marrë pjesë vetëm shoqëria òE. N.ò me ofertë ekonomike 920,400 lekë.

Me datë 14/04/2018 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim.

Raport përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën.

Konstatohet se data e hartimit të raportit përmbledhës (14/04/2018) është më herët se procesverbali i mbylljesh së procedurës (30/04/2018), **veprime që ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: M. K., T. D. dhe J. Ç.**

Formulari i njoftim fituesit datë 30/04/2018.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar APP-Tiranë datë 10/04/2018

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òE. N.ò, është lidhur kontrata nr. 107, datë 03/05/2018 me afat 17 ditë nga data e lidhjes, për vlerën 920,400 lekë pa TVSH.

- **Auditimi i procedurës**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpalljen fitues të shoqërisë òE. N.ò për vlerën 920,400 lekë, u konstatua se kualifikimi NUK është në përputhje me kriteret dhe dispozitat e LPP, konkretisht:

- a- *Nuk paraqet Pasqyrat financiare të viteve 2015-2016- 2017, siç kërkohet në pikën 2.2.5 të DST;*
- b- *Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike nuk është i saktë, pasi nuk përfshin periudhën e muajt shkurt 2018, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 20.04.2018. vërtetimi nr. 858, datë 28/02/2018. Pika 2/b e DST;*
- c- *Nuk plotëson kriterin për numrin e punonjësve nga 15-20 punëtor, kjo për periudhën Nëntor- dhjetor 2017 dhe Janar 2018, siç kërkohet në pikën 2.3.3 të DST. Në këto periudha shoqëria paraqet numër punonjës 2-3 veta;*
- d- *Nuk disponon kategorinë e licencës NP12, siç kërkohet në pikën 2.3.4 të DST;*
- e- *Nuk paraqet 2 kamionë siç kërkohet në pikën 2.3.5 të DST. Shoqëria paraqet vetëm një kontratë shitje nr. 156/61, datë 21/02/2018 me shitës z. I. K., por të pashoqëruar me dokumentacion;*

Konkluzioni: Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òE. N.ò ShPK, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, duke argumentuar shkaqet dhe kërkuar zhvillimin e procedure tjetër me kritere më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve për shmangien e paligjshmërisë së përdorimit të fondeve në vlerën **936,666lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M. K., me funksion inxhinier në Sektorin Teknik dhe anëtarët znj. T. D. me funksion përgjegjëse e sektorit të financës dhe z. J. Ç., me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.**

Gjithashtu, konstatohet se:

- 1- Dosja nuk është e protokolluar dhe numëruar për çdo fletë.
- 2- Mungojnë urdhrat e titullarit për ngritjen e komisioneve të NJHDT dhe KVO;
- 3- Nuk argumentohet fondi limit,;
- 4- Procedura nuk është miratuar në buxhetin e vitit 2018;
- 5- Nuk janë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesit nga asnjë nga anëtarët e NJHDT dhe KVO;
- 6- Kriteret nuk janë në përputhje me procedurën dhe dispozitat ligjore/nënligjore të LPP;

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NHDT dhe KVO, respektivisht:

zj. J. H., me funksion specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT.

z. A. H. me funksion llogaritar pagash në Sektorin e Financës dhe

z. F. Xh. Me funksion Përgjegjës në Sektor I Bordit të Kullimit, në cilësinë e anëtarit të NHDT

z. M. K., me funksion inxhinier në Sektorin Teknik, në cilësinë e kryetarit të KVO.

znj. T. D. me funksion përgjegjëse e sektorit të financës dhe

z. J. Ç., me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Kërkesa për paraqitje vërtetim ujësjellësi, është ligjore pasi në si subjekt jemi institucion varësie dhe paguhemi nga taksat e ujit;

- Nuk paraqet Pasqyrat financiare të viteve 2015-2016- 2017, siç kërkohet në pikën 2.2.5 të DST, bashkëlidhur keni pasqyrat financiare ;

- Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike është i saktë, pasi përfshin dhe muajin shkurt. Ndërkohë që marsi likuidohet muajin prill;

- Nuk plotëson kriterin për numrin e punonjësve nga 15-20 punëtor, kjo për periudhën Nëntor-dhjetor 2017 dhe Janar 2018, siç kërkohet në pikën 2.3.3 të DST. Në këto periudha shoqëria paraqet numër punonjës 2-3 veta, pjesërisht e pranueshme dhe në gjykimin e KLSH

- Nuk paraqet 2 kamionë siç kërkohet në pikën 2.3.5 të DST. Shoqëria paraqet vetëm një kontratë shitje nr. 156/61, datë 21/02/2018 me shitës z. I. K., por të pashoqëruar me dokumentacion, sqaron se kamionët nuk janë problem për zbatimin pasi bëhen dhe punime me krahë;

Sqarim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se subjekti nuk është paraqitur asnjë shtesë nga ato të janë paraqitur në fazën e kundërshtive të akteve, për të cilat grupi i KLSH ka dhënë shpjegimet përkatëse pse nuk qëndrojnë.

5- Tenderi me objekt: “Asfalto beton + Praction”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Asfalto beton + Praction”,		
1. Urdhër Prokurimi nr. 78, dt. 26.3.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. --, dt. --- J. Gj. F. Xh. J. H. (juriste)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. --, dt. ---- M. K. - Kryetar T. D.- anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òC.ò me ofertë ekonomike 1,756,450 lekë me kontratë 146, datë 11/6/2018, me afat 30-61 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1 mijë lekë ose 0.056 %
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,757,577 lekë pa TVSH	9. Burimi Financimit Bashkia Vlorë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE
8. Data e hapjes së tenderit Datë 10.04.2018		

		b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime: saka	12. Përgjigje Ankesës nga AK SKA	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP ; SKA

- **Hartimi i kriterëve:** Sipas dosjes së auditmit, nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbal mbi argumentimin e kriterëve të aplikuara për këtë procedurë.

Në aplikimin e kriterëve, konstatohet kriteret të cilat nuk përputhen me procedurën e zhvilluar, konkretisht:

- a- Nga AK është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin inxhinier me licencë, kriter i panevojshëm, pasi kemi të bëjmë me blerje malli dhe FV;
- b- Certifikatë për punonjësit ose CV, kjo për 10 punonjës. Kriter i panevojshëm, pasi kemi të bëjmë me blerje mallra;
- c- Vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm në vendet e ushtrimit të aktivitetit.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi: znj. J. H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e Kryetarit të NHDT dhe anëtarët e NJHDT në NSHP dhe z. F.Xh. me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit të Kullimit.

- **Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 80, datë 26.03.2018, Titullari i AK z. G. Sh. është urdhëruar ngritja e komisionit për hartimin e fondit limit, nga ing. M. K.

Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve për rrugët e dëmtuara, sa nga këto rrugë janë në inventar të NSHP- Bashkia Vlorë, sa është e domosdoshme ndërhyrja në këto rrugë, sa është sasia e rrugëve të dëmtuara dhe në çmasë janë dëmtuar ato, sa bazë materiale duhet për riparimin e këtyre segmenteve rrugore dhe cilësia së materialit, etj. Nuk ka një projekt/ preventiv të saktë për riparimin e tyre dhe ngarkojnë me përgjegjësi ing. M. K.

- **Zhvillimi i procedurës.** Nga anëtarët e KVO, me datë 07.05.2018 është mbajtur PV i hapjes së procedurës, ku ka marrë pjesë vetëm shoqëria òC.ò me ofertë ekonomike 1,756,450 lekë pa TVSH. Me datë 07.05.2018 është mbajtur procesverbali i mbylljes së procedurës, duke kualifikuar të OE pjesëmarrës dhe shpallur fitues shoqërinë òC.ò me ofertë ekonomike 1,756,450 lekë pa TVSH.

Me datë 12.05.2018 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim. Ky Raport përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òC.ò SHPK me ofertë 1,756,450 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. ---, datë 11.06.2018 me afat 30-61 ditë nga data e lidhjes.

Konstatohet se kontrata nuk është nënshkruar nga shoqëria fitues "C." SHPK.

- **Auditimi i procedurës** Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se shoqëria òC.ò, NUK plotëson kriteret e DST, konkretisht:

- a- Nuk paraqet licencë për prodhim asfalto beton, sipas pikës 2.1 të DST;
- b- Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Vlorë për vitin 2017, pasi nga shoqëria është paraqitur për punime të ngjashme kontrata nr. 749, datë 30.01.2017 me Bashkinë Vlorë dhe objekt "Rikonstruksion i bllokut nga rruga Tasim Jonuzi, Demikracia, Janaq Kilica dhe rruga Paqes", për vlerën 17,595,826 lekë;
- c- Nuk paraqet punime të ngjashme, pasi kontrata e paraqitur është kontratë shërbimi dhe blerje "Beton + Piarmet"

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òC.ò SHPK, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, duke argumentuar shkaqet dhe kërkuar zhvillimin e procedure tjetër me kriteret më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve për shmangien e paligjshmërisë së përdorimit të fondeve në

vlerën 1,757,577lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M. K. me funksion Zv/Kryetar i Bashkisë Vlorë, zj. T. D. me funksion specialistë në Sektorin e Financës dhe z. J. Ç. me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prendim i subjektit: Kërkesa për paraqitje vërtetim ujësjellësi, është ligjore pasi në si subjekt jemi institucion varësie dhe paguhemi nga taksat e ujit, referuar nenit 28 të VKM nr. 914, datë 29.1.2014, i ndryshuar;

- Në lidhje me inxhinierin me licensë dhe numrin e punonjësve prej 10 veta, është kërkuar pasi kemi të bëjmë me FV dhe jo blerje malli.

- Në lidhje me mos paisje me licensë, sqarohet se OE ka kontratë me shoqërinë “S.” ShPK, ku ky i fundit paraqet leje sipas QKL.

- Në lidhje me mangësinë se OE nuk paraqet vërteti mbi pagesën e taksave lokale nga Bashkia Vlorë për vitin 2017, është paraqitur vërtetimi nr. 10500, datë 6.12.2018.

Oëndrim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë për faktin se:

- Procedura ka për objekt blerja mallrash dhe jo FV dhe në këto kushte aplikimi i kriterëve për inxhinier dhe 10 punonjës nuk është mirëargumentuara.

- Kërkesa që OE të paraqesin vërtetim mbi pagesat e ujit të pijshëm, nuk është e argumentuar dhe nuk ka bazë ligjore për vendosjen e tij.

- Në lidhje me faktin se OE ka kontratë për të argumentuar plotësimin e kriterit për fabrikë asfalto betoni, bashkëlidhur nuk është kontrata dhe ne si grup jemi shprehur se mungon licenca e prodhimit të asfalto beton;

- Në lidhje me pretendimin se për mos paraqitje të vërtetimit të pagesës së taksave keni marrë konfirmim në Degën e taksave Vlorë, argumenti nuk është bindës, pasi sipas DST kërkohet vërtetim dhe marrje informacioni;

- Në lidhje me pretendimin se kontrata e paraqitur plotëson kriterin e punimeve të ngjashme, sqarojmë se kontrata është shërbim punimesh, ndërsa procedura juaj është blerje malli, pra janë dy procese që ndryshojnë nga njëra tjetra. **Procedura mbetet e parregullt për kriteret dhe shpalljen fitues.**

6- Tenderi me objekt: “Riparimi i pompës Ganz ne hidrovorin e Qytetit Vlore”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Riparimi i pompës Ganz ne hidrovorin e Qytetit Vlore”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 49 dt. 6.8.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. --, dt. -- J. H. J. Gj. F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- J. Ç.- kryetar T. D. - anëtar M. K. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,983,333 lekë. REF-84082-29-08-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òR.M.K.ò me ofertë ekonomike 1,560,000 lekë me kontratë nr. 313/6 , datë 25.09.2020 me afat deri 20 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 423 mijë lekë ose 21 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.09.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 0OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPòsaka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV

për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre. Në kriteret e aplikuar evidentohen dhe kriterë që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- a- *Është kriter i papranueshëm dhe jo ligjorë, kërkesa që OE të paraqesin vërtetim mi pagesën e ujit të pijshëm në vendet e ushtrimit të aktivitetit;*
- b- *Është e paargumentuar kriteri për certifikatën ISO 14001/2015, pasi nuk përkon me objektin e prokurimit.*
- c- *Nuk argumentohet kriteri për ing. Mekanik të pajisur me certifikatë.*

ANKESË Nga të dhënat e protokollit, në lidhje me këtë procedurë subjekti òK.L.ò me datë 10.09.2018, ka paraqitur ankesë në lidhje me disa nga kriteret, si: certifikata ISO 9001/2015, ISO 14001/2015 dhe punime të ngjashme.

- **Hartimi i fondit limit:** Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve për riparimin e pompës së qytetit Vlorë (hidrovorit), sa është e domosdoshme ndërhyrja, etj., **dhengarkon me përgjegjësi anëtarët e NJHDT.**

- **Zhvillimi i procedurës.** Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se në këtë procedurë prokurim kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

1. *Shoqëria “R.M.K.”, me ofertë ekonomike 1,560,000 leke pa TVSh.*
2. *Shoqëria “L.” me ofertë ekonomike 1,834,200 leke pa TVSh*
3. *Shoqëria “S.”, me ofertë ekonomike 1,944,000 lekë pa TVSH*

KVO ka shpallur fitues shoqërinë òR.M.K.ò SHPK, me ofertën e paraqitur me vlerë **1,560,000 lekë pa TVSH.** Nga shoqëria òL.ò me datë 25.09.2018 është paraqitur ankesë, por që nuk është në praktikën e procedurës. Me datë 02.10.2018, AK e NSHP- Bashkia Vlorë është njoftuar subjekti në lidhje me ankesën.

Nga KVO është shpallur fitues shoqëria òR.M.K.ò SHPK, me ofertën e paraqitur me vlerë 1,560,000 lekë pa TVSH, për të cilën është lidhur kontrata nr. 407/1, datë 12.11.2018.

ANKESË Nga të dhënat e protokollit, në lidhje me këtë procedurë subjekti òL.ò me datë 24.09.2018, ka paraqitur ankesë në lidhje me zhvillimin e procedurës.

- **Auditimi i procedurës.**

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e prokurimit dhe sistemin SEP, kjo procedurë është e parregullt, konkretisht:

- 1- *Nuk praqet vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm nga Bashkia Tiranë;*
- 2- *Nuk praqet punimet e ngjashme, pasi kontrata që shoqëria ka paraqitur është blerje malli (depozita), sipas kontratës nr. 19061/7, datë 11.05.2018 më UK Bashkia Tiranë dhe objekt “Blerje depozita për nevojat e Shoqërisë”;*

Gjithashtu në këtë praktikë janë konstatuar dhe shkeljet e mëposhtëme:

- 1- *Në dosje mungojnë PV e hartimit të kriterëve dhe miratuara nga Titullari i AK;*
- 2- *Mungojnë PV e hapjes dhe mbylljes së procedurës, si dhe Raporti Përmbledhës i cili përcillet Titullarit të AK për miratim;*
- 3- *Në këtë praktika ka ankesë nga subjekti “L.”, por që nuk janë në dosje, si: ankesa e subjektit, urdhri i Titullarit për ngritjen e KSHA dhe pezullimin e procedurës, PV e vlerësimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes ndaj shoqërisë, si dhe shkresën për rihvillim të procedurës;*
- 4- **Konstatohet se kontrata nr. 407/1, datë 12.11.2018 është lidhur më shpjet se procedura të shpallet në buletin e APP, ku sipas sistemit SEP ajo është shpallur me datë 14.05.2019, pra afërsisht me 6 muaj vonesë.**

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i OE òR.M.K.ò SHPK, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **1,983,333 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: z. G. Sh., me funksion ish- Drejtor i NSHP, në cilësinë e Titullarit të AK zj. J. H., me funksion specialiste finance, zj. J. Gj. me funksion –Specialist**

Juriste, Dr. Juridike- larguar 06.03.2019 dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës Sektori në Bordin e Kullimit dhe anëtarët e KVO me përbërje: z. M. K. me funksion specialist në Sektorin Teknik, dhe zj. T. D. me funksion specialiste finance dhe z. J. Ç. me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: a- Kërkesa që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit argumenti është mbështetur në nenin 28 të CKM nr. 914, datë 29.1.014, i ndryshuar, për të vërtetuar që shoqëria ka mundësi financiare për të realizuar kontratën. Gjithashtu është vendosur në përputhje me legjislacionin tatimorë, ku subjektet duhet të kenë paguar detyrimet që kanë ndaje organeve tatimore.

b- Në lidhje me kriterin që OE duhet të paraqesin certifikatën ISO 14001/2015, pasi nuk përkon me objektin e prokurimit, sqarojmë se është kriter teknik dhe është vendosur nga ing. E. H. Gjithashtu i njëjti argumenti është dhe për ing. Mekanik.

c- Në lidhje me mungesën e procesverbalit të hartimit të kriterëve, hapjes dhe të raportit përmbledhës, bashkëlidhur është procesverbali.

d- Në lidhje me konstatimin se kontrata është lidhur më shpjet se procedura të shpallje në buletin, sqarojmë se fillimisht shpallet në buletin fituesi dhe më pak bëhet nënshkrimi i kontratës dhe më pak çohet për publikim në Buletin. Në momentin që titullari i AK dhe subjekti fitues nuk i ka ardhur fituesi në sistem dhe se njësia nuk ka vijuar me vijimin e publikimit për arsye të ndryshme, nuk ka sesi subjekti fitues dhe AK të çojnë në lidhjen e kontratës. Për lidhjen e shpejtë të kontratës është përgjegjësi e titullarit të AK dhe jo përgjegjësi e njësisë.

e- Në lidhje me mos paraqitjen e pagesës së ujit të pijshëm është parë i pajustificueshëm nga ajo jonë dhe subjektive;

f- Në lidhje me mos paraqitjen në QKB të llojit të aktivitetit, bashkëlidhur keni ekstraktin e QKR, ku tregohet lloj veprimtarisë.

Qëndrim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se NUK merren në konsideratë për faktin se:

a- Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e vërtetimit mbi pagesën e ujit të pijshëm, argumentet janë dhënë dhe në procedurat e tjera;

b- Në lidhje me mangësitë për aplikimin e kriterëve për certifikatë ISO 14001/2015 dhe ing. Mekanik nuk është paraqitur asnjë argument përveç faktit që këto janë hartuar nga ing. E. H.;

c- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit (PV hartim kriteresh, hapje dhe raport auditmit), janë paraqitur nga ana juaj, por janë dokumente që janë riprodhuar rishtazi dhe nuk kanë qenë në fazën e auditmit;

d- Në lidhje me faktin se kontrata është lidhur më shpjet se të shpallej fituesi është pranuar nga ana juaj, por që theksoni se nuk është përgjegjësi e njësisë por e titullarit të AK;

e- Në lidhje me argumentin mbi mungesën e vërtetimit të ujit të pijshëm, pranohet nga ana juaj. Është një kriter i vendosur nga NJHDT dhe KVO duhet që të plotësojë çdo kriter që ajo ka miratuar, pavarësisht nëse duhej ose jo. Gjithashtu nga ana juaj nuk është përgatitur asnjë relacion mbi kriteret. **Në këto kushte procedura mbetet e parregullt.**

7- Tenderi me objekt: “Pastrim kanali në Kallfet në krahun e majtë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Pastrim kanali në Kallfet në krahun e majtë”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 47 dt. 30.07.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 306, dt. 30.7.2018 J. H. J. Gj. F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- J. Ç.- kryetar T. D. - anëtar M. K. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimë”		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,166,667 lekë. REF-84146-29-08-2018	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òL.ò me ofertë ekonomike 4,155,988 lekë me kontratë nr. 414 , datë 05.11.2018 me afat deri 30 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 11 mijë lekë ose 0.26 %

8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.09.2018	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. prot. 281 date 25.09.2018;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 281/2 date 27.09.2018	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. --- -

-Hartimi i kriterëve: Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre.

Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- a- Është i paargumentuar kriteri që OE pjesëmarrës duhet të paraqesë ing. Elektrik dhe ing. Mekanik me IQT, ku referuar projekt/preventiv nuk janë të nevojshëm;
- b- Nuk duhet aplikimi i kriterit për mjek, pasi është në kundërshtim me VKM nr. 692, datë 13.12.2001, i ndryshuar, pasi nuk plotësohet numër i punonjësve dhe xhiro;
- c- Lidhur me vlerën e projekti, janë kërkuar një numër i lartë certifikatash ISO dhe që nuk kanë lidhje me objektin, si: certifikata BS-EN 13331-1/2002; ISO 1452-1/2019; ISO 50001/2005; ISO 39001/2015;
- d- Është kërkuar Ekskavator me goma, kur sipas zërave të preventivit kërkohet vetëm Ekskavator me zinxhir.
- e- Janë të paargumentuara kategoritë e licencave NP-3A-Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile, veshje fasadash; NP12A-Punime të inxhinierisë së mjedisit; NS-1A-Punime për prishjen e ndërtimeve; NS-20A-Shpime gjeologji-inxhinjerike, puse e shpime për ujë.

Veprime që ngarkon me përgjegjësi: zj. J. H., me funksion specialiste finance dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës Sektori në Bordin e Kullimit.

• **Procedurat e periudhës 01.01.2019 – 31.12.2019.**

1- Tenderi me objekt: “Rehabilitim i kanalit Kallfët dhe Babice Vlorë-Skema Ujitëse VLU9, Babicë dega majtas dhe djathtas”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Rehabilitim i kanalit kallfët dhe Babice Vlorë-Skema Ujitëse VLU9, Babicë dega majtas dhe djathtas”,		
1. Urdhër Prokurimi nr. 43/1, dt. 28.6.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 43/1, dt. 28.6.2019 J. H. (juriste) P.Th. (Jurist) F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K.- Kryetar T. D.- anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 4,391,333 lekë pa TVSH REF-24498-05-02-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òS.ò me ofertë ekonomike 4,027,799 lekë me kontratë 304, datë 10/9/2019, me afat 3 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 364 mijë lekë ose 8.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14/6/2019	9. Burimi Financimit Bashkia Vlorë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime: saka	12. Përgjigje Ankesës nga AK SKA	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP ; SKA

- **Hartimi i kriterëve:** Nga NJHDT nuk është mbajtur procesverbal mbi argumentimin e kriterëve të aplikuara për këtë procedurë.

Në kriteret e aplikuara, konstatohet se ka kriteret të cilat nuk përkojnë me procedurën, konkretisht:

- b- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqes vërtetim mbi pagesën e taksave, kjo shoqëruar me mandat pagesat. **Kërkesa për mandat pagesa është e panevojshme, pasi vetëm paraqitja e vërtetimit është mëse e mjaftueshme;**
- c- Kërkesa për ing. Mekanik është një kriter i panevojshëm për këtë procedura, pasi

nuk kemi të bëjmë me punime mekanike;

- d- *Kërkesa për mjek është i panevojshëm, pasi në zbatim të VKM nr. 692, datë 13/12/2001 “Për masat e veçanta për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndeti në punë” i ndryshuar, procedura nuk ka atë nivel numër punonjësit për vendosjen e këtij kriteri;*
- e- *Është i paargumentuar kategori e licencës NS/10-‘Shtresa dhe mbi struktura speciale”.*

- **Hartimi i fondit limit:** Në dosjen e procedurës nuk gjejmë asnjë dokumentacion mbi nevojën e kryerjes së këtij shërbimi (kërkesën e sektorit përkatës), kush e ka hartuar fondit dhe ku është mbështetur për përcaktimin e çmimeve për njësi dhe fondit total në përgjithësi.

Veprime që **ngarkon me përgjegjësi:** z. **G. Sh.** me detyrë ish- Drejtor i NSHP Bashkia Vlorë, në cilësinë e titullarit të AK, **znj. J. H.**, me funksion specialiste në Sektorin e Financës, z. **P. Th.** me funksion përgjegjës në NJP-Bashkia Vlorë dhe z. **F. Xh.**, me funksion Përgjegjës Sektori i Bordit të Kullimit Nd. Sherb. Pub.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Me procesverbal datë 19/06/2019, KVO ka hapur procedurën e prokurimit. Sipas këtij PV në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Kualifikuar/ Skualifikuar	ARSYET
1.	L.	3,911,691	JO	-Nuk paraqet licencë NS10; -Nuk paraqet ing. Gjeodet dhe librezë zbatim punimesh
2.	S.	4,027,779	PO	Kualifikohet
3.	S.	0	JO	-Nuk paraqet ofertë ekonomike

KVO ka skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar shoqërinë òS.ò me ofertë ekonomike 4,027,779 lekë pa TVSH. Me datë 24.06.2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim. Ky Raport përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve të LPP, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òS.ò SHPK me ofertë 4,027,799 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 304, datë 10.09.2019me afat 30-40 ditë nga data e lidhjes, për vlerën 4,027,799 lekë pa TVSH.

- **Auditimi i procedurës**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpalljen fitues të shoqërisë òS.ò SHPK me ofertë 4,027,799 lekë pa TVSH, në dosjen e paraqitur (e pa inventarizuar) dhe sistemin SEP, u konstatua se kualifikimi nuk është në përputhje me kriteret dhe dispozitat e LPP, *konkretisht:*

- *Pasqyrat financiare të viteve 2016, 2017 dhe 2018 nuk janë të certifikuara nga një organ i jashtëm, siç kërkohet në pikën 2.2 paragrafi parë i DST;*

- *Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pasi nuk paraqet deklaratat sipas shtojcave 1/1, 6, 7 dhe 10;*

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òS.ò ShPK, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, duke argumentuar shkaqet dhe kërkuar zhvillimin e procedure tjetër me kriteret më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve për shmangien e paligjshmërisë së përdorimit të fondeve në vlerën **4,391,333lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO;** z. **M. K.**, me funksion – *Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike dhe anëtarët znj. T. D.* me funksion Përgjegjëse Sektorit të Financës dhe z. **J. Ç.**, me funksion – *Protokolliste, Nd. Shërbimeve Publike.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur

objeksionet si më poshtë:

Prendim i subjektit:a- Nuk gjejmë arsye që të ngarkohet me përgjegjësi NJHDT, pasi kriteret janë vendosur dhe nënshkruar vetëm nga ish- Drejtori i NSHP z. G. Sh., sipas shkresës nr. 58/1, datë 20.9.2019 bashkëlidhur kundërshtive.

b- Në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “S.” ShPK, sqarojmë se gjetja juaj qëndron, por nuk është vënë re nga KVO. Ndërsa për mos paraqitjen e shtojcave 1/1.6, 7 dhe 10, janë marrë në konsideratë nga KLSH-ja.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a-Dokumentacioni që keni paraqitur bashkëlidhur nuk është i saktë, pasi nuk ka nënshkrimin e ish- titullarit të AK z. G. Sh. për të treguar se kriteret janë aplikuar nga ish- titullari i AK.

b- Në lidhje me mos plotësimin e kriterit për çertifikimin e pasqyrave financiare, mangësi e cila pranohet nga ana juaj, argumenti nuk qëndron dhe nuk merrte në konsideratë, pasi detyrë e KVO është që OE pjesëmarrës të plotësojnë kriteret e miratuara nga AK dhe jo të bëj interpretim të tyre.

c- Në lidhje me pretendimin se nga KLSH është pranuar fakti që subjekti nuk paraqet shtojca 1/1.6, 7 dhe 10, nuk qëndron, pasi në fazën e akt konstatimeve nuk keni paraqitur kundërshti mbi këtë konstatim, gjë e cila vërtetohet dhe nga Projektraporti i Auditimit ku nuk ka gjurmë.

Procedura mbetet me shkelje.

2- Tenderi me objekt: “Pastrim kanali tek përroi i Bushajve”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Pastrim kanali tek përroi i Bushajve		
1. Urdhër Prokurimi nr. 44, dt. 27/5/2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 44, dt. 27/5/2019 J. H.- Kryetar P.Th.- anëtar F.Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ---- M. K. - Kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Blerje vogëlë		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,000,000 lekë. REF-	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òL.ö me ofertë ekonomike 842,783 lekë me kontratë nr. 235/1, datë 25/7/2019, me afat 30-40 ditë kalendarike.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 158 mijë lekë ose 15.8 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14/6/2019 ndryshuar me datë 19/6/2019 (ndryshim kriteresh)	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPóska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në kriteret e aplikuar sipas DST të depozituar në SEP, evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- Është kërkuar 1 (një) mjek, ku sipas VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes në punë”, me ndryshimi, nuk është i nevojshëm, nisur kjo nga numri i punonjësve.;

- Janë kërkuar një mori certifikatës ISO të panevojshme si: OHSAS-18001-2007; PAS 99-2012 dhe ISO 39001-2012;

- Është kërkuar Ekskavator me goma copë 1 (një), ku sipas preventivit të punimeve kërkohet Ekskavator me zinxhir copë 1 (një);

- Është kërkuar betoniere copë 1 (një), ku sipas preventivit nuk ka punime me beton.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi: **Komisionin e HDT, z. J. H.- Kryetar dhe anëtarët z. P. Th.me funksion Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve Bashkia Vlorë dhe z. F. Xh.me funksion**

Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.

- **Hartimi i fondit limit:** Projektet/preventivat është hartuar nga studio projektues oR.ö për vlerën 1,000,000 lekë pa TVSH, **por që nuk është nënshkruar** nga projektuesi por vetëm nga Titullari i AK z. G. Sh.. Në dosjen e procedurës nuk gjejmë asnjë dokumentacion mbi nevojën e kryerjes së këtij shërbimi (kërkesën e sektorit përkatës).

- **Zhvillimi i procedurës.**

Nga anëtarët e KVO, me datë 19/6/2019 është bërë hapja e procedurës, nga ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 3 OE, *konkretisht:*

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Oferta paraqitur (marzhë)	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	L.	842,783	Kualifikuar
2.	S.	912,376	Kualifikuar
3.	S.	0	skualifikuar

Me datë 24.06.2019 është bërë mbyllja e procedurës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ ligjorë, KVO ka skualifikuar shoqërinë oS.ö SHPK pasi nuk kishte ofertë ekonomike dhe ka kualifikuar dy operatorët e tjerë që plotësonin kushtet.

Ndërmjet dy OE të kualifikuar KVO ka vlerësuar në vend të parë shoqërinë oL.ö SHPK me ofertë 842,783 lekë pa TVSH më te leverdishme se shoqëria oS.ö SHPK.

Me datë 24.06.2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim. Ky Raport përmbledhës **nuk** është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 oPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publiko i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë oL.ö SHPK me ofertë 842,783 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 235/1, datë 25/7/2019me afat 30-40 ditë nga data e lidhjes, për vlerën 842,783 lekë pa TVSH.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*a- Ne si NJHDT nuk mbajmë përgjegjësi, pasi kriteret për të cilat janë konstatuar si të parregullta janë kritere teknike dhe janë nga subjekti "R." dhe konfirmuara nga ish- titullari i AK z. G. Sh.;*

b-Kërkesa për 1 (një) mjek, bazohet në faktin se në këtë procedurë janë angazhuar 25 punonjës e cila lidhet bazuar në VKM nr. 692, datë 13.12.2002 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes në punë";

c- Certifikatat ISO: OHSAS-18001-2007; PAS 99-2012 dhe ISO 39001-2012, janë kërkuar sipas objektit dhe rëndësisë që ai ka;

d- Në lidhje me kërkesën për Ekskavator me goma copë 1 (një) dhe betoniere copë 1 (një), është kërkuar pasi sipas hartuesit të projektit ka punime që kërkohen.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a-Argumenti që paraqisni për 1 (një) mjek nuk qëndron, pasi Kërkesa për mjek është e tepërt dhe nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 15.07.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr. 108, datë 9.2.2011 Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, pika 1, ku përcaktohet se:

oPas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: o6. Punëdhënësit e grupeve oAö dhe oBö, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve oCö dhe oDö, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje

nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë;
b-Në lidhje me certifikatat ISO, si: *OHSAS-18001-2007; PAS 99-2012 dhe ISO 39001-2012, sqarimet nuk qëndrojnë, pasi nga KLSH-ja është theksuar se këto certifikata nuk kanë lidhje me objektin dhe janë të kaluara në kohë, pasi kanë dale certifikatë të reja;*
c-Në lidhje me kriterin për Ekskavator me gome dhe betoniere, dhe në këtë rast argumenti nuk qëndron, pasi sipas zërave të preventivit t cilat keni shoqëruar dhe kundërshtitë tuaja, nuk ka punime për këto kërkesa. **Procedura mbetet me shkelje.**

3- Tenderi me objekt: “Pastrim kanali ujitës Kallfet, krahu majtë pjesa II, km 2500-4+694”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Pastrim kanali ujitës Kallfet, krahu majtë pjesa II, km 2500-4+694”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 42/1, dt. 13/5/2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. ----- P. Th.(Jurist) E. H. (ing. Mekanik) M. M. (ing. Mekanik)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar K. M. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,885,740	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òL.ò me ofertë ekonomike 2,537,891 lekë me kontratë nr. 263, datë 25/7/2019, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 348 mijë lekë ose 12 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14/6/2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPòska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- a- Është kërkuar 1 (një) mjek, ku sipas VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes në punë”, me ndryshimi, nuk është i nevojshëm, nisur kjo nga numri i punonjësve.;
- b- Janë kërkuar një mori certifikatës ISO të panevojshme si: *OHSAS-18001-2007; PAS 99-2012 dhe ISO 39001-2012;*
- c- Është kërkuar Ekskavator me goma cope 1 (një), ku sipas preventivit të punimeve kërkohet Ekskavator me zinxhir copë 1 (një);
- d- Janë kërkuar pjesë ndihmëse të cilat nuk kanë lidhje me projektin, si: kokore copë 10, tabela sigurimi teknik copë 3, rripa sigurimi copë 5;

Veprime që ngarkon **me përgjegjësi Komisionin e HDT, znj. J. H., me funksion specialiste në Sektorin e Financës, z. P. Th.me funksion përgjegjës në NJP-Bashkia Vlorë dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës Sektori i Bordit të Kullimit Nd. Sherb. Pub.**

- **Hartimi i fondit limit:** Konstatohet se projektet/preventivat është hartuar nga studio projektuese òM.ò me ing. P.M. për vlerën 2,885,740 lekë pa TVSH, por që nuk është nënshkruar nga projektuesi por vetëm nga Titullari i AK z. G. Sh.

Në dosjen e procedurës nuk gjejmë asnjë dokumentacion mbi nevojën e kryerjes së këtij shërbimi (kërkesën e sektorit përkatës), si dhe ku është mbështetur në përcaktimin e çmimeve.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Nga anëtarët e KVO, me datë 19/6/2019 është bërë hapja e procedurës, nga ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

Nr.	OE/BOE pjesëmarrës	Oferta paraqitur (marzhë)	Kualifikuar/Skualifikuar
1.	L.	2,537,891	Kualifikuar
2.	S.	2,621,094	Kualifikuar
3.	S.	0	skualifikuar

Me datë 24.06.2019 është bërë mbyllja e procedurës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ ligjorë, KVO ka skualifikuar shoqërinë òS.ò ShPK pasi nuk kishte ofertë ekonomike dhe ka kualifikuar dy operatorët e tjerë që plotësonin kushtet.

Ndërmjet dy OE të kualifikuar KVO ka vlerësuar në vend të parë shoqërinë òL.ò ShPK me ofertë 2,537,891 lekë pa TVSH më te leverdishme se shoqëria òS.ò ShPK.

Konstatohet se sipas dokumentacionit në dosje **nuk është mbajtur** Raport përmbledhës, në kundërshtim me nenin 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òL.ò SHPK me ofertë 2,537,891 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 263, datë 25/7/2019 me afat 30-40 ditë nga data e lidhjes.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mos llogaritja e kamatëvonesa në zbatimin e kontratës nr. 263, datë 25.7.2019</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i dosjes së zbatimit dhe likuidimit të situacione, konstatohet se punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuar në nenin 4 të kontratës nr. 263, datë 25.07.2019, konkretisht:</p> <p>Referuar PV punimet ato kanë filluar me datë 25.07.2019 dhe përfundojnë me datë 25.08.2019.</p> <p>Sipas bankës janë kryer 2 pagesa, si vijon</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Me USH nr. 213, datë 20/9/2019 është likuiduar vlera pjesore 1,191,344 lekë me TVSH, sipas faturës nr. 41, datë 2/9/2019; 2. Me USH nr. 251, datë 15/10/2019 është likuiduar vlera e mbetur prej 1,854,125 lekë me TVSH, sipas faturës nr. 2, datë 24/9/2019. <p>Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve (afateve), të përcaktuar prej 20-30 ditë dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe mbikëqyrësi nuk janë zbatuar penalitete për mos mbyllje në afat të kontratës në vlerën 304,547 lekë pa TVSH, veprime financiare me dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi ing. M. K., I. Ç. dhe F. Xh., si dhe mbikëqyrësi shoqëria "I.18" me ing. I. S.</p> <p>Llogaritja: Sipas kontratës punimet duhet të mbyllen në afatin 20-30 ditë ose nga datë 25/7/2019 ó 25/8/2019.</p> <p><i>Referuar të dhënave që paraqisni në kundërshtitë tuaja, paraqitur me shkresën nr. S'ka, datë 23.2.2022 (prot KLSH nr. 731/44, datë 24.2.2022), nga shoqëria "L." ShPK, si dhe bazuar në dokumentacionin shoqëruar, rezulton se:</i></p> <p><i>Shoqëria "L." ShPK, ka paraqitur shkresë për mbyllje punimesh me nr. 3, datë 24.9.2019, ose 30 ditë me vonë se data e përfundim (datë 25.8.2019).</i></p> <p>Nga sa trajtuam më sipër për mos përfundim në afat të punimeve, nga mbikëqyrësi i punimeve nuk janë zbatuar penalitet në masën 304,547 lekë pa TVSh (2,537,891 x 4/1000 x 30 ditë vonesë), vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e NSHP- Bashkisë Vlorë, për shpërblim dëmi</p>

	shoqërinë “L.”. <i>Referuar dokumentacionit në dosje por dhe ato të paraqitura nga subjekti në kundërshtitë e tij, nuk konstatohet amendament shtesë për mos përfundimin e punimeve me datë 25.8.2019, por që në fakt ato janë mbyllur me datë 25.9.2019, pra me 30 ditë vonesë.</i>
Kriteri:	Nenin 4 të kontratës nr. 263, datë 25.07.2019 p r përfundim në afat të punimeve
Ndikimi/Efekti:	Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me efekt negativ në buxhetin e NSHP në shumën 304,547 lekë pa TVSH,
Shkaku:	Mos ndjekja e zbatimit të kontratës nga personat, për të cilat ngarkohen me përgjegjësi përgjegjës, si: Mbikëqyrësin e punimeve shoqërinë “I.18” ShPK me përfaqësues znj. I. S.
Rëndësia	I lartë
Rekomandim:	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 304,547 lekë në ngarkim të shoqërisë “L.”, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 263, datë 25.07.2019.

4- Tenderi me objekt: “Blerje rërë bituminoze dhe transport”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje rërë bituminoze dhe transport”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 36/1, dt. 13.5.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. EKX, DT. 20.5.2019 P. Th.- Kryetar F. Xh.- anëtar J. H.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- J. Ç. - kryetar T. D. - anëtar M. K. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 10,208,333 lekë REF-23564-05-23-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òD.Gò me ofertë ekonomike 7,924,714 lekë me kontratë nr. 219, datë 08.07.2019, me afat 120 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 2,284 mijë lekë ose 22.3 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 07/06/2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --- dt. ---; KPP--/ APPòscka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SòKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në kriteret e aplikuar evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim për pagesën e ujit nga “Ujësjellës Kanalizim” në vendet ku subjekti ka selitë. Një kërkesë e tillë nuk është lidhore dhe pakuptimë. Ky kriter është bërë shkak për skualifikim të OE me ofertë më të leverdishme

- Hartimi i fondit limit: Nga të dhënat konstatohet se projekt/preventivi është hartuar nga ing. M. K., pra nga një person i vetëm, veprime në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10/09/1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar. Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve p r rrugët e dëmtuara, sa nga këto rrugë janë në inventar të NSHP- Bashkia Vlorë, sa është e domosdoshme ndërhyrja në këto rrugë, sa është sasia e rrugëve të dëmtuara dhe

në çmasë janë dëmtuar ato, sa bazë materiale duhet për riparimin e këtyre segmenteve rrugore dhe cilësia së materialit, etj. Nuk ka një preventiv të saktë për riparimin e tyre, **dhe ngarkojnë me përgjegjësi ing. M. K.**

- Zhvillimi i procedurës.

Nga anëtarët e KVO, me datë 25/6/2020 është bërë hapja e procedurës, nga ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

1. Shoqëria "D.G" me ofertë ekonomike 7,924,714 lekë pa TVSH
2. Shoqëria "V.A.K.", me ofertë ekonomike 9,901,203 lekë pa TVSH.
3. Shoqëria "Z. K.", me ofertë ekonomike 9,378,360 lekë pa TVSH

Në dosje mungonin procesverbalet e hapjes dhe vlerësimit të procedurës, duke kaluar direkt në Raport Përmbledhës, veprime në kundërshtim me dispozitat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publiko i ndryshuar, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Pas vlerësimit të dokumentacionit, KVO ka skualifikuar shoqërinë "Z.K.", pasi mungon vërtetim nga ujësjellës kanalizim, mbi detyrimet e ujësjellësit, duke kualifikuar dy operatorët e tjerë të mbetur në garë.

Nisur nga kriteri kryesorë *Çmimi më i leverdishëm*, KVO ka shpallur fitues subjektin D.G me ofertë ekonomike 7,924,714 lekë pa TVSH, më të leverdishme se OE V.A.K. me ofertë 9,901,203 lekë pa TVSH.

Me datë 19/6/2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të Prokurimit Publiko i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë D.G SHPK me ofertë 7,924,714 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 219, datë 8/7/2019 me afat deri 120 ditë kalendarike.

- Shkeljet e konstatuara: -Në aplikimin e kriterëve, veprim i cili direkt ose indirekt ka çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës dhe me hartimin e fondit limit.

-Në llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët NHDT znj. J. H., me funksion specialiste në Sektorin e Financës, z. P. Th. me funksion përgjegjës në NJP-Bashkia Vlorë dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës Sektori i Bordit të Kullimit Nd. Sherb. Pub dhe anëtarët e KVO: z. J. Ç. me funksion Drejtor i PZHT, zj. T. D. me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe z. M. K.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M.K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:a- Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.

Në lidhje me mos paraqitjen e PV atë hartimit të kriterëve bashkëlidhur keni shkresën.

Oëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjellësit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë;

b-Në lidhje me PV e hartimit të kriterëve, konstatohet se ai është një dokument i prodhuar rishtazi dhe i panënshkruar nga të gjithë anëtarët e NJHDT, pasi një dokument i tillë nuk disponohet në dosje në fazën e punës audituese në terren dhe paraqitjes së kundërshtive në fazën e akt-konstatimeve. **Procedura mbetet me shkelje.**

5- Tenderi me objekt: “Blerje karburanti, viti 2019”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje karburanti, viti 2019</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 45, dt. 6.5.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. ----- J. H.- Kryetar P. Th.- anëtar F.Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave <i>Urdhër nr. -----</i> M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “HAPURÖ		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 13,450,000 lekë (Sasia 93708 litra naftë dhe 2500 litra benzol) REF-24502-05-29-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òB.ò me marzhë fitimi 9.9%, dhe ofertë ekonomike 13,450,000 lekë me kontratë 277, datë -----, me afat 12 muaj nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0.0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 26.6.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 2 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -----, dt. -----; KPP-- / APPòska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. -----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës.

- Zhvillimi i procedurës. Me datë 26/6/2020 është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1-Shoqëria “B.” me marzh fitimi 9.9%

2-Shoqëria “K.” me marzh fitimi 6.9 %.

Me datë 26/6/2019, KVO ka mbyllur procedurën dhe bërë vlerësimin e dokumentacionit teknik/ligjorë. Pas vlerësimit KVO ka kualifikuar të dy shoqëritë, duke renditur në vend të parë shoqërinë òK.ò me marzhë fitimi 6.9% më të leverdishëm se operatori tjetër në garë.

Me datë 26/06/2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Me datë 07/08/2019, KVO ka shpallur fitues shoqërinë òK.ò me marzhë 6.9 % më të leverdishme se OE òB.ò.

Me shkresën datë 05/07/2019 shoqëria “K.” është tërhequr nga procedura për shkak të angazhimeve të tjera.

Formulari i njoftimit fituesi datë 7/8/2019.

Ndërmjet investitori NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë fituese òB.ò, është lidhur kontrata nr. 2771, datë ----- nga data e lidhjes, me marzhë fitimi 9.9 %, me vlerë totale 13,450,000 lekë pa TVSH.

- Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjekti, konstatohet se kjo **procedurë është e parregullt**, pasi në rastin kur njëri nga OE pjesëmarrës tërhiqet nga gara pas shpalljes si fitues, si në rastrin konkret shoqëria òK.ò, OE i mbetur në garë shpallet fitues nëse diferencë midis dy ofertave është më e vogël ose baras me 2%. Në rastin konkret kjo diferencë është më e madhe se 2% (*shoqëria “K.” me marzhë 6.9% dhe shoqëria “B.” me marzhë 9.9%*). Në këtë rast procedura duhej anuluar, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me vlerën **13,450,000lekë**, në kundërshtim me pika 5 e nenit 58, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, nenet 2, 46 dhe 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M.K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj.**

T.D. me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe **z. J. Ç.**, me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit te Territorit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësi znj. T. D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:Në lidhje me vlerësimin e padrejtë të shoqërisë “B.” ShPK, pasi shoqëria “K.” ShPK me kërkesë është tërhequr nga gara, pasi është shpallur si fitues dhe diferenca me operatorin e mbetur është më madhe e 2%, qëndron dhe konstatuar, **por në komunikimin që patëm më ish- Titullarin e AK z. G. Sh. na është komunikuar se institucioni janë ka kosto të larta nëse kjo garë anulohet, ditët do zgjatëshin, pasi nevojat për karburant dhe lëvizje e mjeteve është e nevojshme.**

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

Nuk është titullari i AK, që në rastin konkret nuk ka asnjë dokument që vërteton pretendimet që ju paraqisni, por janë dispozitat e LPP nëse një procedurë duhet anuluar ose jo. **Procedura mbetet me shkelje.**

6- Tenderi me objekt: “Shërbimi i sigurisë së rojeve private”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Shërbimi i sigurisë së rojeve private</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 23/7, dt. 02.4.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. ---, dt. 3.4.2019 P. Th.- Kryetar J. H. -anëtar F. Xh- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,444,192 lekë REF-16519-04-03-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðS.ö me ofertë ekonomike 6,320,087 lekë me kontratë ---, datë --- me afat 12 muaj nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 124 mijë lekë ose 1.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 16.4.2019, ndryshuar dt. 23.4.20169 (ndryshim kriteresh	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APP ^o ska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në aplikimin e kriterëve, konstatohet kriteret të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, konkretisht:
a-Është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim mbi pagesat e ujit të pijshëm, kriter ky i pambështetur ne ligj;

b- Kërkesa për mjek, nuk është më mbështetje të VKM nr. 632, datë 15/7/2015, i ndryshuar.

Veprim që ngarkon me përgjegjësi Komisionin e HDT, **z. J. H.**, me funksion *Specialiste në Sektorin e Financës z. P. Th.* me funksion *P/Sektorit të Procedurave Bashkia Vlorë dhe z. F. Xh.*, me funksion *Përgjegjës i Bordit të Kulimit.*

ANKESË:Nga shoqëria ðA.S.ö me datë 08/04/2019 (*prot NSHP nr. 96, datë 9/4/2019*), është paraqitur ankesë në lidhje me kriteret.

Me shkresën kthim përgjigje nr. Ska, datë 11/04/2019, AK NSHP- Bashkia Vlorë informon subjektin se nga 5 kriteret për të cilat është bërë ankesë janë marrë në konsideratë 2 kriteret dhe nuk ndryshojnë 3 kriteret, konkretisht pikat (c,d,e).

-Zhvillimi i procedurës. Me datë 27/04/2019 është hartuar procesverbali i mbylljes së

procedurës. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria "M.K" me ofertë ekonomike 6,320,436 lekë pa TVSH
2. Shoqëria "S." me ofertë ekonomike 6,320,087 lekë pa TVSH

Pas vlerësimit KVO ka vendosur që nga 2 OE pjesëmarrës të skualifikojë 1 OE, konkretisht shoqërinë òM.Kø me ofertë ekonomike 6,320,436 lekë pa TVSH, **pasi nuk paraqet vërtetimin mbi pagesën e ujit të pijshëm.**

KVO ka klasifikuar në vend të parë shoqërinë òS.ö ShPK me ofertë ekonomike 6,320,087 lekë pa TVSH.

Me datë 27/04/2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publiko i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

*Nga NSHP- Bashkiak Vlorë në këtë procedura nuk ka zbatuar VKM nr. 177, datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "I.G." sha, për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqëria". Kjo shoqëria do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së objekteve në të gjitha institucionet shtetërore. Nga NSHP- Bashkia Vlorë nuk është kërkuar bashkëpunim me këtë shoqëri, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- Titullarin e AK të NSHP- Bashkia Vlorë z. G. Sh.***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjetllësisit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë. **Procedura mbetet me shkelje.**

7- Tenderi me objekt: "Rehabilitim i kanalit Kallfet dhe Babicë Vlorë, VLU-9 Babicë - Dega djathtas", me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Rehabilitim i kanalit Kallfet dhe Babicë Vlorë, VLU-9 Babicë - Dega djathtas</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 58/1, dt. 20.9.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 58/5, dt. 20.9.2019 P. Th. - Kryetar J. H - anëtar F. Xh- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 6,474,925 lekë REF-39410-10-14-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òS.ö me ofertë ekonomike 5,464,617 lekë me kontratë nr. 400/1, datë 15/11/2019 me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,020 mijë lekë ose 15.7 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 15.10.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPòsaka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NjHDT nuk është mbajtur

procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në aplikimin e kriterëve, konstatohen kriterë të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, konkretisht:

a- *Është i paargumentuar kriteri që OE të ketë ing. Mjedisi të certifikuar nga Ministria e Mjedisit, kriter ky eliminues për operatorët e tjerë;*

b- *Kërkesa për mjek është i panevojshëm, pasi në zbatim të VKM nr. 692, datë 13/12/2001 “Për masat e veçanta për sigurimin dhe mirëmbajtjen e shëndeti në punë” i ndryshuar, procedura nuk ka atë nivel numër punonjësit për vendosjen e këtij kriteri.*

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi hartuesin e specifikimeve teknik ing. R. N.

-Zhvillimi i procedurës.

Me datë 30/10/2019 është bërë hapja e procedurës, nga ku ka marrë pjesë vetëm shoqëria òS.ò me ofertë ekonomike 5,464,617 lekë pa TVSH.

Konstatohet se procedura nuk është hapur në afatin e caktuar por me 15 ditë vonesë, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.

Me datë 01/11/2019 është hartuar procesverbali i mbylljes së procedurës. **Konstatohet se dhe ky PV është tej afateve ligjore dhe në dosja nuk ka asnjë argument nga KVO për shpjegimin e këtij fenomeni.**

Sipas këtij PV, KVO ka kualifikuar shoqërinë òS.ò me ofertë ekonomike 5,464,617 lekë pa TVSH, pasi përmbush kriteret.

Me datë 01/11/2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò i ndryshuar.

Ndërmjet investitori NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë fituese òS.ò, është lidhur kontrata nr. 400/1, datë 15/11/2019 nga data e lidhjes, me vlerë totale 5,464,617 lekë pa TVSH dhe afat 60 ditë kalendarike.

- Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpalljen fitues të shoqërisë òS.ò SHPK me ofertë 4,027,799 lekë pa TVSH, u konstatua se kualifikimi është në përputhje me kriteret dhe dispozitat e LPP, konkretisht:

a- *Pasqyrat financiare të viteve 2016, 2017 dhe 2018 nuk janë të certifikuara nga një organ i jashtëm, siç kërkohet në pikën 2.2 paragrafi parë i DST;*

b- *Nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, pasi nuk paraqet deklaratat sipas shtojcave 1/1, 6, 7 dhe 10;*

Nga sa trajtuam mbi mangësitë, shoqëria “S.”, nuk plotëson kriteret e kualifikim

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òS.ò ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të anulonte procedurën, duke argumentuar shkaqet dhe kërkuar zhvillimin e procedure tjetër me kriterë më të favorshme për rritjen e numrit të pjesëmarrësve për shmangien e paligjshmërisë së përdorimit të fondeve në vlerën **5,464,617lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M. K.(kryetar KVO) dhe anëtarët znj. T. D.me funksion Përgjegjëse Sektorit të Financës dhe J. Ç., me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.**

Titulli i Gjetjes:	<i>Mos përfundimi në afat i punimeve të kontratës nr. 400/4, datë 15.11.2019</i>
Situata:	Referuar pagesave të bërë me bankë, u konstatua se punimet nuk janë mbyllur sipas afatit të përcaktuar në DST dhe kontratë, për 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës. Pra nga data 15/11/2019 deri me datë 15.01.2020. <i>1. Me USH 108, datë 26/3/2020 është likuiduar situacione i parë në vlerën 2,615,671 lekë me TVSH, kjo sipas situacionit të shoqëruar me faturën nr. 277, datë</i>

	<p>13/12/2019. Faturë e likuiduar brenda kushteve të kontratës.</p> <p>2. Me USH 176, datë 8/6/2020 është likuiduar situacione nr. dytë për vlerën 3,941,797 lekë me TVSH, kjo sipas situacionit të shoqëruar me faturën nr. 283, datë 28/2/2020. Faturë e likuiduar jashtë afatit.</p> <p>Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga AK NSHP-Bashkia Vlorë nuk janë llogaritur penalitete për mos përfundim në afat të punimeve për vlerën 564,991 lekë (3,284,831 lekë x 4/1000 x 43 ditë vonesë), si dëm ekonomik në buxhetin e NSHP-Bashkia Vlorë, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: Komisioni i marrjes në dorëzim sipas urdhrin nr. 149, datë 13/3/2020 i përbërë nga z. M. K., z. F. Xh. dhe A. M., si dhe subjekti “S.” për shpërblim dëmi.</p>
Kriteri:	Mos zbatim kontrate nr. 400/4, datë 15.11.2019
Ndikimi/Efekti:	Mos menaxhim I kontratës, veprime me efekt financiar negative me dëm në buxhet për vlerën 564,991 lekë.
Shkaku:	Përgjegjësi e personave përgjegjës në menaxhimin e kontratës, I përbërë nga komisioni i marrjes në dorëzim sipas urdhrin nr. 149, datë 13/3/2020 i përbërë nga z. M.K., z. F. Xh. dhe A. M., si dhe mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R.P.” ShPK me përfaqësues ing. R. N.
Rëndësia:	<i>I lartë</i>
Rekomandimi:	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrë të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e shumës prej 564,991 lekë , nga mos zbatimi i afatit të punimeve të kontratës nr. 400/1, datë 15/11/2019, ndaj subjekti “S.”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*a- Në lidhje me mos mbajtjen e procesverbali të hartimit të kriterëve, jemi mjaftuar me procesverbali e hartimit të specifikimeve teknike nga projektuesja ing. R. N., e cila ka hartuar dhe fondin limit;*

b- Në lidhje me kriterin që duhet Ekskavator dhe me goma dhe me zinxhir është bërë për faktin që gjatë fazës së zbatimit të kontratës mund të ketë reshje dhe ekskavatori me goma nuk është efektiv;

c- Në lidhje me kërkesën për mjek, argumentohet se gjatë zbatimit të kontratës mund të ndodh që të sëmuren punonjës;

d- Hapja e procedurës është me vonesë, pasi njëri nga anëtarët kish harruar kodin, duke bërë njoftimet verbale me procesverbale.

e- Në lidhje me mos paraqitjen e pasqyrave financiare, është sqaruar se do të ishte kontradiktore mënyra e mosparaqitjes, pasi dhe nëse nuk do ishin dërguar në sistem ato shikohen nga ekstraktin on-line dhe se ato janë të nënshkruara nga eksperti në çdo faqe.

- Deklaratat sipas shtojcave 1; 1/1; 2,3,4,7,8,9 dhe 10 janë bashkë me deklaratat gjyqësore;

- Detyrimi për kamat vonesën nuk është 564,991 lekë sipas grupit të KLSH, por është 564, 990 lekë, pasi afati i zbatimit është datë 28.2.2020

Sqarime grupi i KLSH: Për sa kundërshtoni sqarojmë se:

- Në lidhje me mos mbajtjen e procesverbali të hartimit të kriterëve, jemi mjaftuar me procesverbali e hartimit të specifikimeve teknike nga projektuesja ing. R. N., e cila ka hartuar

dhe fondin limit, **argument i cili merret në konsideratë;**

- Në lidhje me kriterin që duhet Ekskavator dhe me goma dhe me zinxhir është bërë për faktin që gjatë fazës së zbatimit të kontratës mund të ketë reshje dhe ekskavatori me goma nuk është efektiv, **merret në konsideratë;**

- Në lidhje me kërkesën për mjek, argumentohet se gjatë zbatimit të kontratës mund të ndodh që të sëmuren punonjës, **argument i cili nuk merret në konsideratë**, pasi kërkesa për mjek bazohet në VKM nr. 692, datë 13/12/2001 “Për masat e veçanta për sigurimin dhe mirëmbajtjen e shëndeti në punë” i ndryshuar dhe jo në faktin nëse sëmuren apo bëhet aksident gjatë punës;

- Hapja e procedurës është me vonesë, pasi njëri nga anëtarët kish harruar kodin, duke bërë njoftimet verbale me procesverbale, **argument i cili merret në konsideratë**

- Në lidhje me mos paraqitjen e pasqyrave financiare, është sqaruar se do të ishte kontradiktore mënyra e mosparaqitjes, pasi dhe nëse nuk do ishin dërguar në sistem ato shikohen nga ekstraktin on-line, **argumenti nuk merret në konsideratë**, pasi nga grupi i KLSH është theksuar se pasqyrat financiare nuk janë të certifikuara nga një organi i jashtëm. Nënshkrimi i tyre nuk është bërë nga eksperti por nga kontabilisti i shoqërisë dhe administratori.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 731/4, datë 14.2.2022 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit ing. M. K., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: Në lidhje me kamatëvonesën, sqarojmë se nuk qëndrojnë, pasi faktin se me datë 15.11.019 deri me datë 31.12.2019 nga subjekti “S.” ShPK është hartuar PV mbi ditët ku nuk është punuar në objekt, konfirmuar kjo nga mbikëqyrësi i punimeve “R.” ShPK, kjo për datat 3,10,11,12,13,14,15,16,19,20,21,22,23,24,,31.12.2019, shtuar këtu dhe ditët e festave, që gjithsej bëjnë 18 ditë kalendarike.

Qëndrim i grupit të auditimit: Për sa sqaroni në lidhje me ditëvonesat, sqarojmë se argumenti nuk qëndron, pasi nga ana juaj nuk është kërkuar shtyrje afati, **i cili më pas të miratohej nga titullari i AK**, kjo në zbatim të kushteve të kontratës, në të cilën nuk parashikohen ndërprerje për shkak të kushteve atmosferike dhe Udhëzimit nr. 3, datë 152.2001 për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar. **Pretendimi juaj nuk qëndron dhe nuk merren në konsideratë.**

8- Tenderi me objekt: “Furnizim pllaka granil bojë, 24/24/6, Rruga. Gjebrea”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Furnizim pllaka granil bojë, 24/24/6, Rruga. GJEBREA		
1. Urdhër Prokurimi nr. 49 dt. 20.08.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. (-), dt. - J. H. P.Th. F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- J.Ç. - kryetar T.D. - anëtar M. K. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimë		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,040,640 lekë. REF-35642-09-11-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE òC.ò me Ofertë ekonomike 1,395,000 lekë me kontratë nr. 356/1 , datë 15.10.2019 me afat deri 15 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 23 mijë lekë ose 2.2 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 27.09.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPóska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre. Në kriteret e aplikuar evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- Është kriter i papranueshëm dhe jo ligjorë, kërkesa që OE të paraqesin vërtetim mi pagesën e

ujit të pijshëm në vendet e ushtrimit të aktivitetit;

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi: znj. J. H., me funksion specialiste në Sektorin e Financës, z. P. Th. me funksion Përgj. Sektori Prokurimeve në Bashkinë Vlorë dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës në Sektor I Bordit te Kullimit.

- **Hartimi i fondit limit:** Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve për rrugët e dëmtuara, sa nga këto rrugë janë në inventar të NSHP- Bashkia Vlorë, sa është e domosdoshme ndërhyrja në këto rrugë, sa është sasia e rrugëve të dëmtuara dhe në çmasë janë dëmtuar ato, sa bazë materiale duhet për riparimin e këtyre segmenteve rrugore dhe cilësia së materialit, etj. Nuk ka një preventiv të saktë për riparimin e tyre, dhe **ngarkon me përgjegjësi anëtarët e NJHDT.**

- Zhvillimi i procedurës.

Në dosje nuk disponohet PV hapje procedure për të evidentuar se kur është hapur procedura, veprime në kundërshtim me nenet 64, të VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ò Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave, ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar.

Me datë 27.09.2019 është mbajtur PV i mbylljes së procedurës, nga ku evidentohet se ka marrë pjesë vetëm shoqëria òC.ò me ofertë ekonomike 1,395,000 lekë pa TVSH. Raporti përmbledhës nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM nr. 914, datë 29.12.2017, i ndryshuar.

Disponohet vetëm kontrata me subjektin nr. 356/1, datë 15.10.2019 për vlerën 1,395,000 lekë pa TVSH e lidhur midis NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òC.ò.

Nga shqyrtimi i dokumentacioni në sistem SEP, mbi plotësimin ose jo të kriterëve, konstatohet se shoqëria òC.ò SHPK, nuk plotëson disa nga kriteret, konkretisht:

- a- *Vërtetimi mbi pagesën e taksave vendore se nuk ka detyrime nuk është i saktë, pasi sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave Bashkia Vlorë, shoqëria është debitorë për shumën 145,133 lekë. **Deklarim i rremë;***
- b- *Nuk paraqet punime të ngjashme, pasi nga shoqëria është paraqitur kontrata nr. S;ka, datë 11.06.2018 me objekt “Rehabilitim i rrugës Demokracia Faza II”, pra nuk është shitje mallrash siç kërkohet në objektin e prokurimit;*
- c- *Nuk paraqet certifikatë ISO 9001/2015*

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë òC.ò SHPK, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **1,040,640lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO; z. M. K. me funksion specialist në Sektorin Teknik, zj. T. D. me funksion specialiste finance dhe z. J. Ç. me funksion Drejtor i PZHT Bashkia Vlorë.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh, z. M.K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prendim i subjektit:*a- Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.*

b- Në lidhje me konstatimin se shoqëria është debitorë ndaje Bashkisë Vlorë, KVO ka marrë për bazë vërtetimin e paraqitur dhe nënshkruar nga kryetari i bashkisë Vlorë nr. 8037, datë 19.9.2019 se nuk ka detyrime dhe nuk kemi ankesë në sistemin e taksave për të verifikuar nëse është i saktë ose jo;

c- Në lidhje me mungesën e certifikatës ISO 9001/2015, sipas dokumentit të hedhur në sistem SPE, ku disponon kontratë të lidhur me DPS si dhe paguar faturën. KVO-ja e ka vlerësuar si të vlefshme pasi ka kontrata dhe faturë;

d-Në lidhje me mos plotësimin e kriterit për punime të ngjashme, sqarojmë se kur OE është në gjendje të furnizojë me mall dhe ta vendosi në vend atë (vërtetuar kjo m kontrata të ngjashme Rruga Demokracia si konstatuar edhe nga grupoi i auditimit). OE është në gjendje edhe thjeshtë vetëm të furnizojë mallin pa vendosur atë.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjellësit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë;

b-Në me pretendimin se KVO nuk ka akses në sistemin e taksave mbi vërtetësinë e dokumentit, argumenti nuk qëndron, pasi nëse do ishte kërkuar me shpresë një informacion i tillë di merrej ky informacion;

c-Në lidhje me argumentin që paraqisni se shoqëria ka paraqitur faturën e pagesë mbi certifikatën, nuk merret në konsideratë, pasi në DST kërkohet që subjekti të jetë pajisur me certifikate dhe jo faturë pagese;

d-Në lidhje me mos plotësimin e kriterit për punë të ngjashme, sqarojmë se pretendimet nuk qëndrojnë pasi procedura është blerje malli dhe nga subjekti janë paraqitur situacion punimesh ku nuk përfshihen objekti i prokurimit. **Procedura mbetet me shkelje.**

9- Tenderi me objekt: “Riparimi i pompës Ganz ne hidrovorin e Qytetit Vlore, viti 2019”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Riparimi i pompës Ganz ne hidrovorin e Qytetit Vlore, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 51 dt. 3.9.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 51/1, dt. 18.9.2019 J. H. P. Th. F.Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- J. Ç.- kryetar T. D. - anëtar M. K. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1.500.000 lekë. REF-37098-09-24-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) BEO òS. + V. N.ò me ofertë ekonomike 1,492,400 lekë me kontratë nr. 386 , datë 8.11.20190 me afat deri 30 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 8 mijë lekë ose 0.5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 27.09.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPòsòka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre. Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- 1- Është i paargumentuar kriteri që OE të paraqesin licenca NP-11A dhe NS-12A, pasi kemi të bëjmë me punime mekanike dhe jo ndërtimi;
- 2- Nuk argumentohet kriteri që OE pjesëmarrës të paraqesë 1 saldator, 1 punonjës konstrukcion metalik dhe 1 montator;
- 3- Nuk argumentohet kriteri për një kamionçinë me kapacitet 3.5 ton dhe një kamion i mbuluar deri në 7 ton;

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi hartuesin e specifikimeve teknik ing. E. H.

- **Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 51/2, datë 18.9.2019 të titullarit të AK, është urdhëruar ing. E. H. për hartimin e fondit limit prej 1,500,000 lekë. Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve p r riparimin e pompës së qytetit Vlorë (hidrovorit), sa është e domosdoshme ndërhyrja, etj. Sipas procedurave, konstatohet se ky riparim është kryer dhe ne vitin 2018 për shumën 1,560,000 lekë

a TVSH, për të njëjtat riparime dhe nuk argumentohet riprurimi i këtij shërbimi, pasi nuk ka relacion shpjegues, **veprime në ngarkim me përgjegjësi ing. E. H.**

- Zhvillimi i procedurës.

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se në këtë procedurë prokurim kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. BOE “S.+ V. N.”, me ofertë ekonomike 1,492,400 leke pa TVSh.
2. Shoqëria “A.” me ofertë ekonomike (0) leke pa TVSh

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, KVO ka shpallur fitues BOE òS. + V.N.ò, me ofertë ekonomike 1,492,400 leke pa TVSh.

Nga AK e NSHP- Bashkia Vlorë është shpallur fitues BOE òS. + V. N. I.Sò, me ofertë ekonomike 1,492,400 leke pa TVSh, për të cilën është lidhur kontrata nr. 386, datë 8.11.2019.

-Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e prokurimit dhe sistemin SEP, kjo procedurë është e parregullt, konkretisht:

-Nga shoqëria “S.”, nuk paraqitet deklarata e disponimit të mjeteve;

-Shoqëria “S.”, nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e taksave lokale viti 2017, pasi sipas subjektit si punime të ngjashme është paraqitur kontrata e vitit 2017 në shumën 1,905 mijë lekë me NSHP- Bashkia Vlorë;

-Shoqëria “S.”, nuk paraqet licencë punimesh të kategorive NP-11A dhe NS-12A;

Referuar sa mësipërm, kualifikimi i OE òS.+ V. N. I.Sò ShPK, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST, trajtuar si mësipërm. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjera, AK duhet të anulonte procedurën dhe zhvilluar procedurë të re me kritere më të favorshme, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publike në vlerën **1,500,000 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi:z. M. K., me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj. T. D.me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe z. J. Ç., me funksion Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit te Territorit.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:- Në lidhje me konstatimin e KLSH për kritere të rënduara dhe jo të mirëargumentuara, sqarojmë se nuk është përgjegjësi e NJHDT, pasi kriteret janë specifike dhe të hartuara nga ing. E. H.

-Në lidhje me mungesën e PV të hartimit të dokumenteve të tenderit, të hapjes mbylljes dhe raportit përfundimtar ato janë dhe bashkëlidhur kundërshtive të paraqitura;

-Në lidhje me konstatimin se shoqëria ‘S.’ ShPK, nuk plotësin kategorinë NS-12/A, sqarojmë se këtë e disponon shoqëria ‘U.D.’ ShPK.

-Në lidhje me mangësinë që shoqëria “S.”, nuk është paraqitur deklarata sipas shtojcave 3, 5, 7 9, bashkëlidhur keni shtojcat e deklaratave;

-Në lidhje me konstatimin se shoqëria “V. N. I.S”, nuk paraqet pasqyrat e vitit 2017 – 2018, bashkëlidhur kopje të pasqyrave financiare 2017-2018;

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a- **Merret në konsideratë** fakti se kriteret janë hartuar nga ing. E. H., duke larguar nga përgjegjësi komisionin HDT, pasi janë kritere teknike;

b- **Merret në konsideratë** se në dosjen e procedurës janë PV të hartimit të dokumenteve të tenderit, të hapjes mbylljes dhe raportit përfundimtar;

c- **Nuk merret në konsideratë** se nga shoqëria òS.ò ShPK nuk plotëson kriterin e kategori NS-12/A, duke pretenduar se këtë e plotëson shoqëria tjetër, kjo për faksin se nga shoqëria òS.ò ShPK referuar marrëveshjes së bashkëpunimit janë marrë përsipër të realizohet nga kjo shoqëri.

Nuk ka asnjë pretendim në lidhje me mungesën e kategori së linccës NP-11/A

d- **Nuk parqet asnjë pretendim** në lidhje me mungesën e vërtetimit për pagesën e taksave lokale bashkia Vlorë nga shoqëria òS.ò ShPK. **Procedura mbetet me shkelje.**

10- Tenderi me objekt: “Blerje dhe transport betoni, marka 16/20”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje dhe transport betoni marka 16/20”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 25 dt. 28.03.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. --- dt. 4.4.2019 P. Th. J. H. F.Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- M. K. - kryetar T. D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,039,970 lekë. REF-16685-04-04-2019	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òC.ò me Ofertë ekonomike 1,008,700 lekë me kontratë nr. 124/3 , datë 14.06.2019 me afat deri 90 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 31 mijë lekë ose 0 .02%
8. Data e hapjes së tenderit Datë 13.05.2019 ndryshuar me datë 20.05.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPòsòka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve: Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre.

Me shkresën nr. ---, datë 04.04.2019, Titullari i AK ka urdhëruar NJHDT për përcaktimin e fondit limit. Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve p r nevojën e këtij investimi, ku ai duhet përdorur, sasia që kërkohet, etj. Nuk ka një preventiv të saktë p r riparimin e tyre.

- **Zhvillimi i procedurës.**

Nga verifikimi i procedurës në sistemin SEP, **pasi dosja e auditmit nuk ka asnjë dokument**, konstatohet se në këtë procedura ka marrë pjesë vetëm shoqëria òC.ò me ofertë ekonomike 1,008,700 lekë pa TVSH.

Nga AK e NSHP- Bashkia Vlorë është lidhur kontrata nr. 124/3, datë 14.06.2019 në shumën 1,008,700 lekë me shoqërinë òC.ò dhe afat zbatimi 90 ditë nga data e lidhjes.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë së shpallur fitues òC.ò, konstatohet se ajo nuk plotëson kriteret, konkretisht:

- a- *Nuk është plotësuar kriteri për punime të ngjashme, pasi sipas dokumenteve shoqëria ka paraqitur kontratës me Bashkinë Vlorë nr. 749, datë 30.01.2017 në shumën 17,590 mijë lekë me objekt “Rikualifikim bllokut të banimit nga rruga “Tasim Jonusi”, “Demokracia”, “Janaq Kilica” dhe rruga e “Paqes”. Sipas objektit të prokurimit kemi blerje mallra dhe jo punime.*

Në këto kushte shoqëria nuk plotëson kriteret dhe procedura duhej anuluar dhe zhvilluar procedurë tjetër, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me vlerë 1,039,970 lekë.

Gjithashtu konstatohet se.

- 1- *Dosja nuk është e inventarizuar dhe protokolluar sipas ligjit;*
- 2- *Në dosje mungojnë PV e hartimit të kriterëve, të hapjes, mbyllje dhe raporti përmbledhës;*
- 3- *Aktet janë të paprokokolluara;*
- 4- *Mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit për anëtarët e NJDT dhe KVO;*
- 5- *Mangësi në përcaktimin e fondit limit.*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT znj. J.H., me funksion specialiste në Sektorin e Financës, z. P. Th., me funksionP/Sektorit të Prokurimeve Bashkia Vlorë. Me funksion Përgjegjës në Sektor i Bordit te Kullimit dhe z. F. Xh..

Me funksion Përgjegjës në Sektor I Bordit te Kullimit, si dhe anëtarët e KVO; z. **M.K.**, me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike; zj. **T. D.** me funksion – Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike dhe z. **J. Ç.**, me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit te Territorit. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., z. M. K., J. Ç. dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit: - Nuk mundë të mbajë përgjegjësi NHDT për vlerësimin e procedurës nga KVO;

- Në lidhje me përcaktimin e fondit limit, ai është hartuar sipas situacionit të hartuar nga ing. Mandi Karrocieri në zbatim të manualit të çmimeve dhe miratim të Titullarit të AK;

- Në lidhje me mangësinë se nuk paraqet vërtetim gjykate dhe prokurorie që nuk janë të dënuar shoqëria, administratori dhe drejtuesi teknik, sqarojmë se këto vërtetime janë tek deklaratat shtojcë sipas udhëzimit plotësues;

- Në lidhje me punime të ngjashme, pasi sipas dokumenteve shoqëria ka paraqitur kontratës me Bashkinë Vlorë nr. 749, datë 30.01.2017 në shumën 17,590 mijë lekë me objekt “Rikualifikim bllokut të banimit nga rruga “Tasim Jonusi”, “Demokracia”, “Janaq Kilica” dhe rruga e “Paqes”;

Dosja nuk është e inventarizuar dhe protokolluar sipas ligjit, bashkëlidhur dosjen e plotë;

Në dosje mungojnë PV e hartimit të kriterëve, të hapjes, mbyllje dhe raporti përmbledhës, bashkëlidhur PV dhe deklaratat e konfliktit të interesit, por në fazën e auditimit për mungesë kohe dhe situatës së Covid-19, nuk është paraqitur;

Sqarim i grupit të KLSH: Nga sa ju kundërshtoni grupi i KLSH sqaron se:

a- Nuk merret në konsideratë argumenti që OE i shpallur fitues sipas grupit të KLSH nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme.

b- Merret në konsideratë mbi paraqitjen e deklaratës për mos ndjekje penale, pasi referuar dokumentacionit bashkëlidhur qëndron. **Procedura mbetet me shkelje.**

Titulli i Gjetjes 6:	<i>Mos zbatimin I kontratës nr. 124/3, datë 14.06.2019 në afatin e përcaktuar.</i>
Situata:	Referuar kontratës nr. 124/3, datë 14.06.2019, malli duhej dorëzuar brenda 90 ditë nga nënshkrimi i saj, ose nga datë 14.06.2019 deri me datë 14.09.2019. Referuar dokumenteve të bankës, malli është likuiduar me USH nr. 232, datë 04.10.2019 në shumën 1,210,440 lekë. Bërë hyrje me FH nr. 50, datë 03.10.2019, sipas faturës së subjektit òC.ò nr. 48, datë 03.10.2019 me nr. Seri 75881504. Nga sa trajtohet malli është bërë hyrje jashtë afatit të përcaktuar në kontratë për 19 ditë vonesë dhe nga NSHP- Bashkia Vlorë, nuk janë llogaritur sanksionet për mos dorëzim të allit në afat në masën 4/1000 ditë vonesë, konkretisht: 1,008,700 lekë pa TVSH x 4/1000 ditë vonesë x 19 ditë = 76,661 lekë pa TVSH , me dëm ekonomik në buxhetin e NSHP- Bashkia Vlorë.
Kriteri:	Kontrata nr. 124/3, datë 14.6.2019 me afat 90 ditë.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi në afat I kontratës, veprime në me efekt negative me dëm në vlerën 76,661 lekë dhe ngarkon me përgjegjësi shoqëria “C.” për shpërblim dëmi
Shkaku:	Mangësi e personave përgjegjës në zbatimin e kontratës, respektivisht: dhe ngarkon me përgjegjësi: komisioni i marrjes në dorëzim ing. E. H., P. A., A. M.
Rëndësia:	I lartë

Rekomandimi:	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrë të gjitha masat administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në shumën 76,661 lekë në ngarkim të shoqërisë òC.ò, nga mos mbyllja në afat e kontratës nr. 124/3, datë 14.06.2019.
---------------------	--

11- Tenderi me objekt: “Blerje dhe FV Tabela sinjalistikës, viti 2019”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje dhe FV Tabela sinjalistikës, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 48, DT. 27.5.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 11, dt. 02.05.2019 P.Th.- Kryetar E.H.- anëtar J. H.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M.K. - kryetar T.D. - anëtar J. Ç. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,500,000	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òI.K.K.ò me ofertë ekonomike 2,499,160 lekë me kontratë nr. 238/2, datë 15.7.2019, me afat 20-30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1 mijë lekë ose 0.04 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.06.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --- dt. ----; KPP--/ APPòsòka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SòKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve:

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës.

Në përcaktimin e fondit limit ing. Edurat Hila është bazuar në çmimet e tregut, por që në dosje nuk ka asnjë dokument që tregon se cilat subjekte janë testuar për aplikimin e këtyre çmimeve.

Sipas dokumentacionit në dosje, nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve për nevojën e vendosjes së këtyre tabelave sinjalistikës, harta e rrugëve ku ato janë planifikuar për vendosje, shoqëruar kjo me inventarin e rrugëve pronë e Bashkisë Vlorë, pasi tabelat për sinjalistikës rrugore vendosen nga Autoriteti Rrugore Shqiptar e Rrugëve, etj.

- Zhvillimi i procedurës.

Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se hapja e procedurës është bërë me datë 15.05.2019 për të cilën është mbajtur dhe PV përkatës. Sipas këtij PV në këtë procedura kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “I.K.K.”, me ofertë ekonomike
2. Shoqëria “A.” me ofertë ekonomike.

Me datë 15.05.2019 është mbajtur PV mbylljes së procedurës, ku nga 2 OE është skualifikuar njëri, konkretisht shoqëri òA.ò, për mos plotësim të kriterëve, si më poshtë:

Mungon dokumentacion ne lidhje me pikat 2.2.2.

Mungon bilanci i vitit 2016

2.3.1 Mungon dokumentacion qe vërteton Punë të ngjashme.

2.3.3 Inxhinier ndërtimi i trajnuar ne fushën e sigurisë rrugore – mungon vërtetim trajnimi ne fushën e sigurisë rrugore.

2.3.9 Mungon certifikata PASS 99

Ndërsa OE tjetër në garë shoqëria òI.K.K.ò, plotëson kriteret dhe shpallet fitues.

Me datë 15.05.2019 është mbajtur raporti përmbledhës, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68 të VKM VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Konstatohet se si PV e hapjes, mbylljes dhe raporti përmbledhës, nuk janë nënshkruar nga gjithë anëtarët e KVO, por janë nënshkruar vetëm nga znj. T. D.

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òI.K.K.ò SHPK me ofertë 2,499,160

lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 237/2, datë 15.07.2019 me afat 30-60 ditë nga data e lidhjes.

12-Tenderi me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e NSHP- Bashkia Vlorë, viti 2019”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pjesë këmbimi për mjetet e NSHP- Bashkia Vlorë, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 48, dt. 22.5.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. --, dt. --- J. H. J. Gj. (ish- Juriste ne Bashkia Vlorë) F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- J. Ç. M. K. T. D.
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðA.ö me ofertë ekonomike 899,800 lekë me kontratë nr. 221/2, datë 02.07.2019, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 101 mijë lekë ose 10 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 24.5.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --- dt. ---; KPP--/ APPôska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SôKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kritereve:

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kritereve të procedurës.

Nga auditimi mbi përlllogaritjen e fondit limit, konstatohet se nuk ka asnjë kërkesë nga strukturat e tjera për kryerjen e kësaj procedure, si dhe argumentim të këtij fondi në raport me numrin e mjeteve që janë gjendje për punë dhe nevojën që këto mjete kanë për shërbime. Nuk tregohet me dokumente se ku është mbështetur në përcaktim e çmimeve të artikujve sipas pjesëve.

- Zhvillimi i procedurës.

Nga dosja, konstatohet se KVO nuk ka mbajtur PV hapje dhe vlerësim të procedurës, veprim në kundërshtim me nenet 64 dhe 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, por është kaluar direkt në raport përmbledhës.

Me datë 24.05.2019 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikö i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Sipas këtij raporti, konstatohet se në këtë procedurë prokurim kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

1. Subjekti “A.H.” me ofertë ekonomike 1,100,000 lekë pa TVSH
2. Shoqëria “A. M.”, me ofertë ekonomike 899,800 lekë pa TVSH.
3. Subjekti “B.B.” me ofertë ekonomike 1,025,300 lekë pa TVSH

KVO ka skualifikuar shoqërinë ðA. H.ö, pasi nuk paraqet deklaratën e garancie së mallit, duke shpallur fitues subjektin ðA.M.ö me ofertë ekonomike 899,800 lekë pa TVSH.

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë ðA.M.ö SHPK me ofertë 899,800 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 221/2, datë 02.07.2019 me afat deri 60 ditë kalendarike.

- Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjekti, konstatohet se:

1. Dosja është e pa inventarizuar dhe numëruar për çdo vlerë;
2. Nga anëtarët e NJHDT dhe KVO, nuk janë mbajtur PV e hartimit të kritereve, të hapjes dhe mbylljes së procedurës;
3. Nuk argumentohet fondi limit, pasi nuk ka kërkesa të sektorëve ose drejtuesve të mjeteve për riparimet që kërkohen për vitin dhe ku është bazuar AK në përcaktimin e çmimeve për artikuj;
4. Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e KSHA në lidhje me ankesën e bërë nga

shoqëria “A.M.” për kriteret e aplikuara;

5. *Procesverbali i hapjes dhe vlerësimit të procedurës janë nënshkruar vetëm nga njëri prej anëtarëve të KVO, konkretisht znj. T. D. dhe jo nga anëtarët e tjerë dhe ngarkon me përgjegjësi: Titullarin e AK z. G. Sh., anëtarët e NJHDT; zj. J. H. me funksion specialiste në sektorin e financës, J. Gj. me funksion ish- juriste e Bashkisë Vlorë, z. F.Xh.me funksion - Përgjegjës Sektori i Bordit të Kullimit Nd. Sherb. Pub; anëtarët e KVO: z. J. Ç. me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit te Territorit, z. M. K. me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike dhe znj.T. D. me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës.*

13- Tenderi me objekt: “Preparate kimike, viti 2019”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Preparate kimike, viti 2019”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 41, dt. 20.05.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. --, dt. --- J. H. P. Th. F. Xh.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- J.Ç. M. K. T.D.
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,079,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òF.ò me ofertë ekonomike 1,074,000 lekë me kontratë nr. 221/2, datë 02.07.2019, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 5 mijë lekë ose 0.46 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 07.06.2019	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE/BOE b) Skualifikuar 2 OE/BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --- dt. ---; KPP--/ APPòsòka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SòKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve:

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës.

- Zhvillimi i procedurës.

Në këtë procedurë sipas të dhënave të sistemit kanë marrë pjesë 5 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “M.”, me ofertë ekonomike me vlerë 949,000 lekë;
2. Shoqëria “S. M.”, me ofertë ekonomike me vlerë 1,037,00 lekë;
3. Shoqëria “F.”, me ofertë ekonomike me vlerë 1,074,000 lekë;
4. Shoqëria “S.S.”, me ofertë ekonomike në vlerën 0 lekë;
5. Shoqëria “M.”, me ofertë ekonomike në vlerën 1,018,500 lekë.

Nga 5 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “S. S.”, pasi nuk paraqet ofertë ekonomike, dhe;
2. Shoqëria “M.”, pasi nuk paraqet listëpagesat e periudhës Janar-Mars 2019, nuk paraqet ISO 9001/2015, si dhe licenca “DDD” nuk paraqet në QKR

Në vend të parë është kualifikuar shoqëria òM.ò me ofertë 949,00 lekë, më të leverdishme se OE e tjerë të mbetur në garë, kjo duke vlerësuar kriterin kryesorë *òçmimin më të leverdishëmò*.

Me datë 24.06.2019 është shpallur në elektronik njoftim fituesi.

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se AK i NSHP- Bashkia Vlorë ka lidhur kontrate nr. 275, datë 08.08.2019 më shoqërinë òF.ò me vlerë kontrate 1,074,500 lekë pa TVSH.

ANKESANga të dhënat e protokollit, në lidhje me këtë procedurë subjekti òM.ò me datë 12.6.2019, ka paraqitur ankesë në lidhje me skualifikimin e padrejtë të kryer nga KVO, pasi sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, shoqëria ka argumentuar mangësitë e konstatuara.

Nga dosja e procedurës paraqitur nga personi i ngarkuar znj. J. H., nuk është depozituar as ankesa, as urdhri i Titullarit për ngritjen e KSHA, pezullimin e procedurës dhe përgjigje subjektit, nëse ankesa është marrë në analizë dhe si është konkluduar ajo.

Nga shqyrtimi i ankesës, konstatojmë se shoqëria òM.ò në pretendimet e paraqitura ka të drejtë, ku sipas dokumentacionit që ajo paraqet ka treguar se i plotëson kriteret. Fakti që nuk ka Listëpagesat, duhej marrë si devijim i vogël, pasi nga shoqëria është paraqitur vërtetimi nga sigurimet për numrin e punonjës. Në lidhje me certifikatën ISO 9001/2015 ku pretendohet se nuk është paraqitur, sipas DST është kërkuar ISO 9001/2008, ndërsa në lidhje me mos paraqitjen ose leximin e licencës òDDDò, nga AK duhej kërkuar subjekti të paraqitet dhe fizikisht për të lexuar më saktë.

- Auditimi i procedurës.

Nga auditimi i dokumentacionin në sistemin SEP dhe dosjen e subjekti, konstatohet se:

1. Dosja është e pa inventarizuar dhe numëruar për çdo vlerë;
2. Mungojnë urdhër e Titullarit të ngritjen e komisionit të NJHDT dhe KVO;
3. Nga anëtarët e NJHDT dhe KVO, nuk janë mbajtur PV e hartimit të kriterëve si dhe raportit përmbledhës;

Veprimet ngarkon me përgjegjësi: **z. G. Sh.** me detyrë ish- Drejtori i NSHPA Vlorë, **zj. J. H.** me funksion specialiste në sektorin e financës, në cilësinë e personit përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës dhe anëtarët e KVO: **z. J. Ç.** me funksion – Drejtor, Dr. Planifikimit Zhvillimit të Territorit, **z. M. K.** me funksion – Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike dhe **znj. T. D.** me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

• **Procedurat e periudhës 01.01.2020 – 30.06.2020**

- 1- Tenderi me objekt: “Sinjalistikës rrugore, tabela sinjalistikës, kone plastike, poli e shtrirë”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Sinjalistikës rrugore, tabela sinjalistikës, kone plastike, poli e shtrirë”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 26/03.07.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 249/9, dt. 3/7/2020 S. N.- Kryetar F. Xh. anëtar J.H.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar T.D. - anëtar S.D. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,500,000	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO òI.K.Kò me ofertë ekonomike 2,421,000 lekë me kontratë nr. 249, datë 25/9/2020, me afat 60-90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 79 mijë lekë ose 3.16 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 20/07/2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. 296 dt. 31/7/2020; KPP--/ APPòscka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SòKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve:

Nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht:

- Është kërkuar 1 (një) mjek, ku sipas VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes në punë”, me ndryshimi, nuk është i nevojshëm, nisur kjo nga numri i punonjësve.;

- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim për pagesën e ujit nga “Ujësjiellës Kanalizim” në vendet ku subjekti ka selitë. Një kërkesë e tillë nuk është lidhore dhe pakuptimë .

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Komisionin e HDT, znj. S. N., zj. J. C. dhe z. A.H.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH mbi kriteret, sqarojmë se ato nuk janë për NHDT pasi janë kritere specifike dhe hartuar nga ing. E. H. dhe miratuar nga ish- Drejtori i NSHP G.Sh.

Oëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projektraporti Auditmit, sqarojmë se argumenti nuk qëndron pasi mangësitë në kritere janë teknike dhe ligjore, që thotë se janë hartuar dhe nga specialist dhe nga anëtarët e tjerë të NHDT.

Merret në konsideratë fakti se NJP është ndryshuar shkresën nr. 249/2, datë 3.7.2020 të ish-Drejtorit G. Sh. është ndryshuar NJHDT, duke emëruar specialistët znj. S. N., zj. J. C. dhe z. A. H., duke mbyllur llogaritë tona dhe hapur llogaritë e personave të tjerë.

- Zhvillimi i procedurës.

Nga anëtarët e KVO, me datë 24.07.2020 është bërë hapja e procedurës, nga ku është konstatuar se ka marrë pjesë vetëm shoqëria òl.K.Kö.

Me datë 28.07.2020 është bërë mbyllja e procedurës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ ligjorë, KVO ka skualifikuar shoqërinë òl.K.K.ö, për mos plotësim kriteresh, konkretisht:

- a- Nuk paraqet vërtetim mbi pagesën e energjisë elektrike nga vendet e ushtrimit të aktivitetit Korçë dhe Skrapar;
- b- Nuk paraqet pasqyrat financiare të vitit 2019.

ANKESAMEMe shkresën (ankesë), shoqëria òl.D.K- Konstruksionö me datë 31.07.2020 ka paraqitur ankesë pranë AK ó NSHP Bashkia Vlorë, për skualifikim të padrejtë, duke argumentuar dhe mangësitë e konstatuara.

Me urdhër nr. 29, datë 03.08.2020, Titullari i AK ka ngritur KSHA i përbërë nga z. P. Th., J. H. dhe F. Xh.

KSHA me shkresën nr. 306/2, datë 5/8/2020 ka informuar Titullarin e AK se pas verifikimit të ankesës arsyeton se skualifikimi i shoqërisë òl.K.Kö është i padrejtë dhe duhej kualifikuar.

Me shkresën nr. 306/2, datë 5/8/2020, Titullari i AK urdhëron KVO për vijimin e procedurës dhe shpalljen fitues të shoqërisë òl.K.Kö me ofertë 2,421,000 lekë pa TVSH, sipas Vendimit të KSHA.

Me datë 07/08/2020 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikö i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òl.K.Kö SHPK me ofertë 2,421,000 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 249, datë 25/9/2020 me afat 30-60 ditë nga data e lidhjes.

- Auditimi i procedurës.

Në këtë procedura janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve, veprim i cili direkt ose indirekt ka çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës.

Sipas të dhënave të sistemit dhe dokumentacionit në dosje, konstatohet se kontrata është lidhur përpara njoftimit të kontratës dhe shpalljes në buletin. Kështu sipas të dhënave kontrata është lidhur me datë 25/09/2020, ndërsa njoftim i lidhjes së kontratës është bërë me datë 02/10/2020, veprime në kundërshtim me nenin 58 të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, òPër prokurimin publikö, i ndryshuar dhe neneve 6 dhe 21 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikö i ndryshuar, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: Titullarin e AK z. G. S., me funksion ish- Drejtor NSHP- Bashkia Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK.**

2- Tenderi me objekt: “Blerje pjesë këmbimi, goma, bateri”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pjesë këmbimi, goma, bateri”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 19, dt. 11.5.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 182/2, dt. 11.5.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. -----
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö	S. N.- Kryetar F. Xh.- anëtar J. H.- anëtar	M.K. - kryetar T. D. - anëtar S.D. - anëtar

5. Fondi Limit (pa TVSh) 2,083,333 <i>REF-59546-06-01-2020</i>	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðA.H.ö me ofertë ekonomike 2,049,167 lekë me kontratë nr. 182, datë 21.7.2020, me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 34 mijë lekë ose 1.6 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 20/7/2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. --- dt. ---; KPP--/ APPóðka/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. SòKA dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Hartimi i kriterëve:

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht *është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim për pagesën e ujit nga “Ujësjellës Kanalizim” në vendet ku subjekti ka selitë. Një kërkesë e tillë nuk është lidhore dhe pakuptimë. Ky kriter është bërë shkak për skualifikim të OE me ofertë më të leverdishme .*

- Zhvillimi i procedurës.

Nga anëtarët e KVO, me datë 25/6/2020 është bërë hapja e procedurës, nga ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

- Subjekti “A. H.” me ofertë ekonomike 2,049,167 lekë pa TVSH
- Shoqëria “K.R.C.”, me ofertë ekonomike 1,999,300 lekë pa TVSH.

Me datë 01.7/2020 është bërë mbyllja e procedurës, ku pas vlerësimit të dokumentacionit teknik/ligjorë, KVO ka skualifikuar shoqërinë ðK.R.C.ö, pasi mungon vërtetim nga ujësjellës kanalizim, mbi detyrimet e ujësjellësit.

KVO ka shpallur fitues subjektin ðA.H.ö me ofertë ekonomike 2,049,167 lekë pa TVSH.

Me datë 01/07/2020 nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës i cili i është paraqitur Titullarit të AK për miratim, raport i cili nuk është sipas përcaktimeve të nenit 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ðPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publiko i ndryshuar, pasi nuk përshkruan gjithë procedurën, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO.**

Ndërmjet investitori NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë ðA.H.ö SHPK me ofertë 2,049,167 lekë pa TVSH, është lidhur kontrata nr. 182, datë 21/7/2020 me afat deri 60 ditë kalendarike.

- Auditimi i procedurës.

Aplikimi i kriterëve të pa mbështetura në ligj dhe që nuk kanë lidhje me procedurën, ka çuar në mos pjesëmarrjen e OE në procedurë dhe keq menaxhim të fondeve me vlerë **2,083,333 lekë**, pasi nga KVO është skualifikuar OE me ofertë më të leverdishme dhe kualifikuar OE me oferta të lartë, veprime të cilat kanë ndikuar në keq menaxhim të fondeve publike dhe rendim të tyre, në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi Komisionin e HDT, **zj. S. N.- me funksion Juriste në NSHP, z. J. H., me funksion specialiste finance dhe F. Xh. me funksion Përgjegjës i Bonifikimit.**

3- Tenderi me objekt: “Blerje bojë fosforeshente”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : <i>Blerje bojë fosforeshente</i>		
1. Urdhër Prokurimi nr. 28, dt. 3.7.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 248/7, dt. 3.7.2018 S. N.- Kryetar J. H.- anëtar F.Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M. K. - kryetar T. D. - anëtar S. D. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimë		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 3,870,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðI.K.ö me ofertë ekonomike 3,728,200 lekë me kontratë ---, datë --- me afat 60-90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 124 mijë lekë ose 3.9 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 20.7.2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE

		b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -----, dt. -----; KPP-- / APPóská/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës. Në aplikimin e kriterëve, konstatohet kriterë të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, konkretisht:

- a- Është kërkuar numër punonjës 5 veta, kjo bie ndesh me procedurën, pasi kemi të bëjmë me blerë malli dhe jo FV.
- b- Janë kërkuar 2 kamionë vetë shkarkues dhe 2 kamionçina, kriterë të panevojshëm për llojin e procedurës.
- c- Është kërkuar vërtetim nga ujësjellësi, kriter i pambështetur në ligj.

Veprime që ngarkon me përgjegjësi Komisionin e HDT, z. J. H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës znj. S. N. me funksion Juriste dhe z. F. Xh., me funksion Përgjegjës i Bordit të Kulimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

a- Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.

b- Në lidhje me prezencën tonë si anëtarë të NJHDT nuk qëndron, pasi me datë 21.7.2020 me urdhër të ish- Titullarit të AK është ndryshuar duke emëruar J. C., A. H. dhe S. N.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

- a- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjellësit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë;
- b- Merret në konsideratë fakti i ndryshimit të NJHDT. **Procedura mbetet me shkelje.**

4- Tenderi me objekt: “Blerje dhe transport çakulli, viti 2020”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje dhe transport Çakull, viti 2019		
1. Urdhër Prokurimi nr. 05, dt. 3.3.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 111/1, dt. 3.3.2020 S. N.- Kryetar J.H.- anëtar F. Xh.- anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----- M.K. - kryetar T.D. - anëtar S.D. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,166,740 lekë REF-53046-03-05-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO öd.Gö me ofertë ekonomike 1,107,925 lekë me kontratë nr. 771/1 datë 17.6.2020 me afat 10-15 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 59 mijë lekë ose 5 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.3.2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) Skualifikuar 1 OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. -----, dt. -----; KPP-- / APPóská/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. -----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ----

-Kjo procedurë është zhvilluar me datë 11.05.2020, kohë në të cilën referuar njoftimit të APP nr. 2371prot, datë 31.03.2020, kërkohet pezullimi i të gjitha procedurat për shkak të situatës së COVID-19, duke lejuar vetëm procedurat për nevoja jetike dhe që kanë lidhje me situatën e

pandemisë, duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK z. G. Sh., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, zj. T. D. me funksion Përgj/Sektorit të Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe zj. J. H. me funksion Specialiste në Sektorin e Financës në NSHP, në cilësinë e personit përgjegjës për zhvillimin e procedurës.

-Hartimi i kriterëve:

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se nga NHDT nuk është mbajtur procesverbali i hartimit dhe dokumentimit të kriterëve të procedurës.

Në aplikimin e kriterëve, konstatohet kriterë të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP, konkretisht është kërkuar vërtetim nga ujësjellësi, kriter i pambështetur në ligj”.

-Zhvillimi i procedurës.

Me datë 28.07.2020 është hartuar procesverbali i mbylljes së procedurës. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Shoqëria “D.G” me ofertë ekonomike 1,107,925 lekë pa TVSH.

2. Shoqëria “C.” me ofertë ekonomike 1,157,390 lekë pa TVSH.

Sipas këtij PV, KVO ka skualifikuar shoqërinë òC.ò ShPK, pasi nuk paraqet vërtetim e pagesave të ujit të pijshëm, duke kualifikuar shoqërinë òD.Gò ShPK me ofertë ekonomike 1,107,925 lekë pa TVSH, më të leverdishme se operatori i skualifikuar.

- Auditimi i procedurës.

1- *-Kriteret nuk janë në zbatim të dispozitave ligjore të LPP;*

2- *-Dosja nuk është arkivuar;*

3- *Në llogaritjen e fondit limit, sipas dokumentacionit, konstatohet se nuk ka kërkesë nga sektor ose persona të tjerë mbi domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj procedura, pra e thënë ndryshe nuk evidentohen kërkesat se cilat janë rrugët që do shtrohen, harta e rrugëve që do shtrohen, volumi i punimeve që duhet për çdo rrugë, sasia e çakulli që duhet për çdo mbushje etj.,veprime në kundërshtim me Kreun VII “Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, pika 2 të nenit 59 “Përllogaritja e vlerës limit te kontratës” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJHDT: zj. J. H. me funksion Specialiste në Sektorin e Financës në NSHP, në cilësinë e personit përgjegjës për zhvillimin e procedurës znj. S. N. me funksion Juriste dhe F. Xh., me funksion Përgjegjës i Bordit të Kulimit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., dhe znj. T. D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

- Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.

-Në lidhje me zhvillimin e procedurës në periudhën kur sipas shkresës së APP kanë qenë të pezulluara, sqarojmë se referuar shkresës APP lejonte të zhvilloheshin procedura të cilat janë në shërbim të situatës së pandemisë COVID-19.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjellësit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë;

b-Në lidhje me konstatimin se procedura është zhvilluar në një kohë që ishin të pezulluara,

argumenti nuk qëndron, pasi blerje e cakullit dhe mbyllja e gropave nuk është një procedurë në shërbim të situatë së pandemisë ku parësorë kanë qenë shërbimet mjekësore, shërbim për dezinfektimin e ambienteve të ndryshme, etj. **Procedura mbetet me shkelje.**

5- Tenderi me objekt: “Beton C 16/20 me Çakull”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Beton C 16/20 me Çakull”		
1. Urdhër Prokurimi nr. 06 dt. 03.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve nr. 112/1, datë 03.03.2020 dt. ---- S.N. J.H. F. X.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. ----, dt. ---- M.K. - kryetar T.D. - anëtar S.D. - anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkesë me propozimö		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 1,165,864 lekë. REF-53041-03-05-2020	6. Oferta fituese (pa TVSh) EO ðC.ö me Ofertë ekonomike 1,165,100 lekë me kontratë nr. 112/1 , datë 21.07.2020 me afat deri 30-90 ditë nga data e kontratës.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 0 mijë lekë ose 0 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.03.2020	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE b) Skualifikuar 0OE/BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime AK- nr. ----, dt. ----; KPP-- / APPÓska/ka;	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. ----, dt. ---	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP ; Shkresa nr. ----, dt. ---

-Kjo procedurë është zhvilluar me datë 11.05.2020, kohë në të cilën referuar njoftimit të APP nr. 2371prot, datë 31.03.2020, kërkohej pezullimi i të gjitha procedurat për shkak të situatës së COVID-19, duke lejuar vetëm procedurat për nevoja jetike dhe që kanë lidhje me situatën e pandemisë, veprime në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ðPër Prokurim Publikö me ndryshime dhe urdhrin e APP nr. 2371, datë 31.03.2020, **duke ngarkuar me përgjegjësi Titullarin e AK z. G. Sh., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, zj. T. D.me funksion Përgj/Sektorit të Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe zj. J. H.me funksion Specialiste në Sektorin e Financës në NSHP, në cilësinë e personit përgjegjës për zhvillimin e procedurës.**

-Hartimi i kriterëve:

Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga NJHDT nuk është PV për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre.

Në kriteret e aplikuara evidentohen dhe kriteret që nuk janë në përputhje me procedurën, konkretisht është kriter i papranueshëm dhe jo ligjorë, kërkesa që OE të paraqesin vërtetim mi pagesën e ujit të pijshëm në vendet e ushtrimit të aktivitetit.

- Hartimi i fondit limit:

Me shkresën nr. 112/2, datë 03.03.2020, Titullari i AK ka urdhëruar ing. M.K. për përcaktimin e fondit limit. Në përcaktimin e fondit limit, sipas dokumentacionit në dosje nuk vërtetohet me dokument kërkesa e sektorëve për nevojën e këtij betoni, ku ai duhet përdorur, harta e rrugëve që do shtrohen, sasia që kërkohet, etj. Nuk ka një preventiv të saktë për riparimin e tyre, **dhengarkon me përgjegjësi ing. M. K.**

- Zhvillimi i procedurës.

Me datë 19.03.2020 është mbajtur PV i hapjes së procedurës, në të cilën konstatohet se ka marrë pjesë vetëm shoqëria ðC.ö.

Me datë 19.03.2020 është mbajtur PV i mbylljes dhe vlerësimit të procedurës, ku shoqëria ðC.ö është kualifikuar për ofertën e paraqitur prej 1,165,100 lekë.

Me datë 20.03.2020 është mbajtur Raporti përmbledhës, raport i cili nuk është sipas parketimeve të nenit 68 të VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ðPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, të ndryshuar.

Në përfundim KVO ka shpallur fitues shoqërinë e vetme pjesëmarrëse òC.ò.
Ndërmjet NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òC.ò është lidhur kontrata për shërbime (mallra) nr. 12/1, datë 21.07.2020 për vlerën 1,165,100 lekë pa TVSH.

- Problemet e konstatuara.

- 1- *Dosja nuk është e inventarizuar dhe protokolluar sipas ligjit;*
- 2- *Shpallja në buletin nuk është bërë brenda afatit 5 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës. Kështu në buletin shpallja është bërë me datë 04.08.2020, ndërsa kontrata është lidhur me datë 21.07.2020, veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 6 të VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*
- 3- *Procedura është zhvilluar me datë 19.03.2020, kohë në të cilën referuar njoftimit të APP nr. 2371prot, datë 31.03.2020, kërkohej pezullimi i të gjitha procedurat për shkak të situatës së COVID-19, duke lejuar vetëm procedurat për nevoja jetike dhe që kanë lidhje me situatën e pandemisë, veprime në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurim Publik” me ndryshime dhe urdhrin e APP nr. 2371, datë 31.03.2020.*
- 4- *Mungojnë deklaratat e konfliktit të interesit për anëtarët e NJDT dhe KVO;*
- 5- *Mangësi në përcaktimin e fondit limit.*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: ish- Titullari i AK z. Gentjan Sherifaj, anëtarët e NJHDT **znj. S. N., J. C. dhe A. H., si perona përgjegjës për procedurat e vitit 2020.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 689/4, datë 24.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit zj. J. H., z. F. Xh., dhe znj. T.D., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:- *Në lidhje me kërkesën që OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetim mbi pagesën e ujit të pijshëm, pasi është në zbatim të legjislacionit tatimorë ku subjekti ofertues duhet të kenë shlyer detyrimet. Ashtu siç kërkohet vërtetimi mbi energjinë elektrike, duhet të paraqitet dhe vërtetimi mbi pagesën e ujit të pijshëm.*

-Në lidhje me zhvillimin e procedurës në periudhën kur sipas shkresës së APP kanë qenë të pezulluara, sqarojmë se referuar shkresës APP lejonte të zhvilloheshin procedura të cilat janë në shërbim të situatës së pandemisë COVID-19.

-Në lidhje me mos paraqitjen e deklaratave të konfliktit të interesit, theksojmë se ato janë, duke ia bashkëlidhur kundërshtive;

-Në lidhje me mos publikimin në buletin brenda afatit 5 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës, sqarojmë se nuk është përgjegjësi e imja (zj. J. H.), por e personave të tjetër, pasi si administrator i veprimeve nuk kam pasur akses dhe me është hequr nga AK pa asnjë komunikim dhe shkresë, ku pjesë e veprimeve ka qenë zj. S. N., e cila ka bërë njoftimet bashkë më ish-titullarit e AK z. G. Sh. pa pasur nj tagër të tillë dhe pa urdhër.

Qëndrim i grupit të KLSH-së: Lidhur me sa kundërshtoni në fazën e Projekt Raport Auditimit, sqarojmë se nuk merren në konsideratë për faktin se:

a- Në analizën e kundërshtive të paraqitur, argumenti për vërtetimin e ujësjetillësit nuk bind grupin e KLSH, pasi në asnjë dispozitë të LPP, nuk kërkohet një dokument i tillë;

b- Në lidhje me konstatimin se procedura është zhvilluar në një kohë që ishin të pezulluara, argumenti nuk qëndron, pasi blerja e cakullit dhe mbyllja e gropave nuk është një procedurë në shërbim të situatës së pandemisë ku parësorë kanë qenë shërbimet mjekësore, shërbim për dezinfektimin e ambienteve të ndryshme, etj. **Procedura mbetet me shkelje.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 28/5, datë 22.01.2021 nga specialisti z. P. Th. janë paraqitur kundërshtitë në lidhje me përgjegjësinë si anëtar i NHDT në 12 procedura, respektivisht: “Rehabilitim i kanalit Kallfet dhe Babicë Vlorë-Skema ujitëse VLU0”; “Pastrim

kanali përroi i Bushajve”; “Pastrim kanali ujitës Kallfet, krahu i majtë”; “Blerje rërë bituminoze”; “Shërbim i sigurisë private”; “Blerje karburanti viti 2019”; “Rehabilitim kanali Kallfet dhe Babicë, VLU-9, djathtas”; “Furnizim pllaka granil bojë, 24/24/6, rruga Gjebrea”; “Riparim i pompës Ganz në hidrovorin e qytetin e Vlorës”; “blerje dhe transport betoni”; “Blerje dhe FV tabela sinjalistikës” dhe “Preparate kimike viti 2019”, pasi bazuar në nenin 57 të VKM nr. 914, me ndryshime, kriteret janë vendosur nga specialisti i fushës pavarësisht se emrin e kam në sistem.

Qëndrim i grupit të KLSH: Për sa shpjegoni në kundërshtitë e paraqitura nga ana juaj, por mos pasje përgjegjësi si anëtar i NHDT në **12** procedurat e lartpërmendura, ju bëjmë me dije se argumenti i paraqitur nuk është bindës për grupin e KLSH, për faktin se:

Në dosje mungon urdhri i Titullarit për ndarjen e punës midis anëtarëve të komisionit dhe PV i hartimit të kriterëve i cili të jetë i detajuar se cilat nga kriteret janë aplikuar nga specialisti përkatës dhe cili nga personat e tjerë pjesëtarë të komisionit. Në këto kushte kur nuk ka PV për argumentimin e kriterëve dhe kur në mangësitë e konstatuara nga KLSH janë teknike dhe të përgjithshme, përgjegjësia mbetet e gjitha anëtarëve të NJDT. **Argumenti juaj nuk qëndron dhe ju mbeteni përgjegjës në këto procedura.**

Titulli i Gjetjes 7:	Problematikat e konstatuara në procedurat me vlera të vogla, për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 – 31.12.2019																								
Situata:	<p>Nga Titullari AK është ngritur Komisioni i Blerjeve të Vogla, respektivisht: Për vitin 2018, me urdhër nr. 3, datë 07.02.2018, i përbërë nga z. A. H., me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, zj. A. V., me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe z. E. B., me funksion punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV.</p> <p>Për vitin 2019, me urdhër nr. 2, datë 11.01.2019, i përbërë nga z. A. H.j, me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, zj. A. V., me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe z. E. H., me funksion Përgjegjës i Sektorit teknik, në cilësinë e anëtarit të KBVV.</p> <p>Nga NSHP- Bashkia Vlorë janë kryer gjithsej 80 procedura me vlera të vogla me fondit limit prej 33,927 mijë lekë dhe kontratë të lidhur prej 32,801 mijë lekë, me një diferencë prej 1,125 mijë lekë ose 3.3%, nga e cila: në vitin 2018 janë zhvilluar 46 procedura me fond limit 19,279 mijë lekë dhe vlerë kontrate prej 18,437 mijë lekë, për diferencën prej 1,842 mijë lekë ose 9.5%. Ndërsa për vitin 2019 janë zhvilluar gjithsej 34 procedura me fond limit 14,467 mijë lekë dhe vlerë kontrate prej 14,364 mijë lekë, me një diferencë prej 283 mijë lekë ose 1.9%.</p> <p>Grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi, duke vlerësuar të dhënat e materialitetit dhe riskut të auditimit, ka vlerësuar për auditim, gjithsej 54procedura ose 67% e procedurave me vlerë kontrate 29,612 mijë lekë ose 90 % e kontratave.</p> <table border="1" data-bbox="478 1612 1404 1848"> <thead> <tr> <th>EMËRTIMI</th> <th>Nr. Proced</th> <th>Fond Limit</th> <th>Vl. Kontrate</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Procedura viti 2018</td> <td>46</td> <td>19,279,762</td> <td>18,437,044</td> </tr> <tr> <td>Procedura viti 2019</td> <td>34</td> <td>14,647,586</td> <td>14,364,378</td> </tr> <tr> <td>Totali 2018 + 2019</td> <td>80</td> <td>33,927,348</td> <td>32,801,422</td> </tr> <tr> <td>Vlerësuar për auditim</td> <td>54</td> <td></td> <td>29,612,092</td> </tr> <tr> <td>shprehur ne %</td> <td>67.5</td> <td></td> <td>90</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga auditimi i realizuar ne dokumentacionin e bankës, për pagesat e kryera dhe dokumentacioni ligjor dhe teknik bashkangjitur për blerje malli/ shërbimi me vlera te vogla, rezulton se: Nga ana e Autoritetit Kontraktor (NSHP- Bashkia Vlorë), për periudhën e audituar, nuk është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve</p>	EMËRTIMI	Nr. Proced	Fond Limit	Vl. Kontrate	Procedura viti 2018	46	19,279,762	18,437,044	Procedura viti 2019	34	14,647,586	14,364,378	Totali 2018 + 2019	80	33,927,348	32,801,422	Vlerësuar për auditim	54		29,612,092	shprehur ne %	67.5		90
EMËRTIMI	Nr. Proced	Fond Limit	Vl. Kontrate																						
Procedura viti 2018	46	19,279,762	18,437,044																						
Procedura viti 2019	34	14,647,586	14,364,378																						
Totali 2018 + 2019	80	33,927,348	32,801,422																						
Vlerësuar për auditim	54		29,612,092																						
shprehur ne %	67.5		90																						

publike.

Në përcaktimin e fondit limit për mallra/ shërbime, nga praktikat e audituara nuk u konstatuan se ku është mbështetur KBVV në përcaktimin e fondi limit, pasi nuk tregohet se cila nga mënyrat është përdorur, nuk disponohet hartave e rrugëve/trotuareve që në fillim se ku do kryhen punimet, volumi i punës që kërkojnë këto segmente dhe sasia e materialit që nevojitet për to, bazuar në manualet përkatëse, nuk ka kërkesa të sektorëve/ apo komunitetit në lidhje me nevojën e kryerjes së shërbimit të riparimit të rrugëve/trotuareve, etj, **konstatuar kjo në të gjitha praktikat e audituara sipas pasqyrës Aneks 1, bashkëlidhur.**

Në **disa raste** te blerjeve te realizuara, faturat e subjektit nuk janë plotësuar me te gjitha elementet qe kërkon fatura, kishte raste qe këto fatura nuk janë firmosur nga blerësi, apo te firmosura nga një person te vetëm dhe nuk janë firmosur nga komisioni i blerjeve me vlera te vogla.

Në **disa raste** mallrat e blera nuk janë bere hyrje ne magazinën e NSHP (kjo për pjesët e makinave), dhe se për këtë lloji procedure (blerje/shërbim pjesë makine/ekskavatori), nga NSHP janë kryer një numër i konsiderueshëm procedurash si me vlera të larta dhe të vogla, pa një studim të mirëfilltë se sa janë nevojat për kryerjen e shërbimit të mjeteve të NSHP, fondi për riparimin e tyre etj, konkretisht pasqyra:

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Periudha
1	Pjese te ndryshme te ekskavatorit ,zinxhira,etj	475,000	400,000	G.T. A.	2019
2	Vaj,Alkol,Graso,Antifriz (Nshp)	416,666	347,222	C .	2019
3	Vaj,Alkol,Graso,Antifriz (Nshp)	800,000	747,167	E.	2019
		1,691,666	1,494,389	0	
1	Shpenzime mirëmbajtje ekskavatorë	400,000	360,000	A.H.	2018
2	Riparim +sherbim+Fiat Hitachi	483,000	462,000	S.	2018
3	Vaj Lubrifikante,alkol,graso	685,000	594,000	A.H	2018
4	Riparim AUTOMJETE	750,000	695,000	A.H	2018
5	Lubrifikante për Ekskavatorët Vajra	570,833	495,000	A.H	2018
6	Mirëmbajtja e Ekskavatorit ne Tirane (Ekskavator I ri)	433,333	385,000	S.	2018
7	Mirëmbajtje Ekskavatori VOLVO	333,333	300,000	A.H	2018
8	Riparimi i Automjeteve (Nshp)	750,000	695,000	A.H	2018
9	Shërbim Mirëmbajtje Ekskavatori Fiat Hitachi	402,500	330,000	A.H	2018
		4,807,999	4,316,000	0	

Gjithashtu për vitet 2018 dhe 2019, përveç procedurave me vlerë të vogël, për riparimin e mjeteve janë kryer dhe procedura me vlerë të lartë, ku për vitin 2018 kemi **një** procedurë me fond limit 1,200 mijë lekë eh për vitin 2019 janë **2**procedura me fond limit 1,888 mijë lekë.

Nga tabela shihet që kemi dhe copëzim të fondeve, veprime të cilat kanë çuar në shmangien nga procedura me vlerë të lartë, pasi vlera e mallrave apo dhe grup mallrave qe janë blere apo dhe shërbimeve te realizuara kane tejkaluar vlerën e përllorgaritur gjate vitit kalendarik, prej 800,000 lekë pa TVSh.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. G.

	<i>Sh., me funksion ish- Drejtor i NSHP, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Nëpunësit Autorizues, znj. T. D., me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe anëtarët e KBVV.</i>
<u>Kriteri:</u>	Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 për prokurimin me vlera të vogla me ndryshimet; neni 40 procedura e prokurimit me vlera të vogla pika 7; Kreun VII <i>zënjehet e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave</i> , pika 2 të nenit 59 <i>për llogaritja e vlerës limit të kontratës</i> , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko ndryshuar; pikës 1 dhe 4, të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 27.01.2015 për hartimin e Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të prokurimit publiko, me ndryshime, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013, me nr. 1, datë 28.02.2014, si dhe pika 5 e Udhëzimit të APP nr. 3 datë 08.01.2018 mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike i ndryshuar; Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko, i ndryshuar, Kapitulli <i>Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve</i> pika 37, ku thekson: <i>Hyrja e aktiveve në magazine dokumentohen në çdo rast me flete hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Flete hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jene bere me pare verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit</i> .
<u>Ndikimi/Efekti:</u>	Paligjshmëri e përdorimit të fondeve me vlerë 10,138 mijë lekë.
<u>Shkaku:</u>	Përgjegjësi e strukturave drejtuese të NSHP në zbatimin e akteve ligjore të LPP.
<u>Rëndësia:</u>	<i>I lartë</i>
<u>Rekomandimi:</u>	Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa për eliminimin e praktikave të llogaritjes së fondit limit vetëm nëpërmjet një metode (<i>testimit të tregut</i>) dhe me dokumentacion jo të saktë ligjorë. Të eliminohen rastet e zhvillimit të procedurave të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve të të njëjtit lloj, ku vlerat e mallrave tejkalojnë vlerën e përlllogaritur gjatë vitit kalendarik prej 800,000 lekë pa TVSH.

• **Praktikat me shkelje të depozitave të LPP të procedurat me vlerë të vogël:**

1.Me USH nr. 58, datë 05.04.2018, është likuiduar shuma 810,000 lekë nga subjekti ÷C.÷, sipas faturës nr. 09, datë 05.04.2018 me objekt: *“Furnizim vendosje, sistemim i lulishtes pranë Pallatit të Kulturës”*.

Në kriteret e aplikuar, konstatohen kritere jo në përputhje me dispozitat e LPP, pasi është kërkuar që OE pjesëmarrës të paraqesin vërtetim se nuk kanë detyrime taksash Bashkia Vlorë (kriter identifikuese), të ketë kontrata të ngjashme 80% të vlerës, ku sipas dispozitave duhet 50%; në pagesën e taksave nuk viti i pagesës.

Sipas PV datë 03.04.2018, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 11 subjekt, ku pas vlerësimit që KVO i ka bërë dokumentacioni (*dokumentacion i cili në dosje nuk ekziston*). Nga 11 subjekt janë skualifikuar 9 dhe kualifikuar 2, konkretisht:

1. Subjekti ‘C.’ me ofertë 675,000 lekë

2. Subjekti ‘G. A.’ me ofertë 675,500 lekë.

Sipas këtij PV, por dhe nga vlerësimi në sistemin SEP, konstatohet se 11 OE pjesëmarrës janë skualifikuar pasi nuk plotësojnë fushën e prokurimit, nuk plotësojnë numrin e punonjësve prej 8-10 veta dhe nuk kanë pagesën e taksave viti 2017, kjo e fundit jo e saktë pasi në kritere nuk është përcaktuar viti.

Për këtë procedura nuk ka dosje të subjekteve që janë skualifikuar po ashtu dhe në sistem për të parë nëse pretendimet e KVO qëndrojnë ose jo.

Gjithashtu dhe operatori -C.ö nuk plotëson të gjitha kriteret, pasi nga dosja e paraqitur, nuk është depozituar punime të ngjashme, vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Vlorë, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët: z. **A. H.**, me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, zj. **A. V.**, me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe z. **E. H.**, me funksion Përgjegjës i Sektorit teknik, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit z. A. H., A. V. dhe E. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Për konstatuar nga grupi i KLSH në USH nr. 58, datë 5.4.2018, sqarojmë se kriteret janë aplikuar nga ing. ndërtimit dhe njësia e prokurimit dhe jo nga ana jonë si KVO.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë, pasi nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion se kriteret janë aplikuar nga NJP. Gjithashtu ju jeni ngarkuar me përgjegjësi për vlerësim të padrejtë të procedurës.

Referuar udhëzimit nr. 3 datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 7 është detyrë e KBVV për hartimit e kriterëve dhe vlerësimin e procedurës.

2. Me USH nr. 63, datë 17.04.2018 është likuiduar vlera 444,000 lekë në favor të subjektit òA.H.ö sipas faturës nr. 78, datë 10.04.2018 dhe FH nr. 6, datë 10.04.2018, për artikullin òBlerje Vaj lubrifikant + grasoö.

Sipas PV datë 06.04.2018 në këtë procedurë kanë marrë pjesë 19 OE, duke kualifikuar në vend të parë subjektin òA.H.ö me ofertë ekonomike 370,000 lekë më të leverdishme se OE e tjerë pjesëmarrës.

Mangësitë:

Në kriteret e aplikuara, konstatohet se ka kritere jo në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, konkretisht: është kërkuar që OE të paraqesin vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Vlorë (kriter identifikues), duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët: z. **A. H.**, me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, zj. **A. V.**, me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe z. **E. B.**, me funksion punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit z. A.H., A. V. dhe E. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*Për sa konstatuar nga grupi i KLSH në USH nr. 63, datë 17.4.2018, mbi paraqitjen e vërtetimit mbi pagesën e taksave nga bashkia Vlorë, pretendimi bie poshtë se subjekti nuk ka detyrime.*

Qëndrim i grupit të KLSH-së:Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë, pasi nga KLSH-ja është kërkuar se kriteri nuk është në përputhje me LPP dhe jo se nga subjekti nuk është paraqitur vërtetim mbi pagesë e taksave.

Referuar udhëzimit nr. 3 datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 7 është detyrë e KBVV për hartimit e kriterëve dhe vlerësimin e procedurës.

3. Me USH nr. 65, datë 17.04.2018 është likuiduar vlera 594,000 lekë në favor të subjektit òA.H.ö sipas faturës nr. 81, datë 14.04.2018 dhe FH nr. 7, datë 14.04.2018, për artikullin òBlerje Vaj lubrifikant + grasoö.

Sipas PV datë 13.04.2018 në këtë procedurë kanë marrë pjesë 21 OE. Në vend të parë është radhitur shoqëria òA.S.G.ø me ofertë më të leverdishme prej 475,000 lekë. Ky OE është tërhequr nga gara për shkak të llogaritjes gabim të fondit.

Nga dokumentacioni konstatohet se pagesa është kryer në favor të subjekti òA.H.ö i radhitur i

treti me ofertë ekonomie 495,000 lekë, pas asnjë dokumentacion argumentues, duke anashkaluar dy OE e renditur në vend të parë dhe dytë (shoqërinë òT.O.ò me ofertë 490,000 lekë). Bashkëlidhur USH janë dokumentet e shoqërisë òA.S.ò.

Mangësitë:

Në kriteret e aplikuar, konstatohet se ka kriteret jo në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, konkretisht: *është kërkuar që OE të paraqesin vërtetim mbi pagesën e taksave vendore Bashkia Vlorë (kriter identifikues), të paraqes licencë kategori VII.3.B.1.*

Nuk ka asnjë dokument që tregon nevojën e NSHP- Bashkia Vlorë për këtë procedurë dhe mënyra e përllogaritjes së fondit limit (çmimet artikujve).

Shpallja fitues e OE i renditur i treti në garë, pa argumentuar skualifikimin e dy vendeve të para, janë veprime me efekt financiar negativ në vlerën **20,000 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët: **z. A.H.** me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, **zj. A.V.**, me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe **z. E. B.**, me funksion punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit z. A. H., A. V. dhe E.B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Për konstatuar nga grupi i KLSH në USH nr. 65, datë 17.4.2018, sqarojmë se kriteret janë aplikuar nuk janë përgjegjësi e KBVV.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë, referuar udhëzimit nr. 3 datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" është detyrë e KBVV për hartimit e kriterëve dhe vlerësimin e procedurës.

4. Me USH nr. 222, datë 19.11.2018, është likuiduar vlera 331,920 lekë në favor të subjektit òG.T.A.ò sipas faturës nr. 18, datë 12.11.2018 me objekt "Transport dheu + transport Ekskavator".

Kjo procedurë është zhvilluar në elektronik sipas UP nr. 45, datë 21.09.2018 me objekt òTransport dhera me rreze deri 5km për sasinë 780 m³ + transport Ekskavator deri 40 km, gjithsej 10 rrugë. **Konstatohet se UP është pa përcaktuar vlerën e fondit limit.**

Sipas ftesës për ofertë, procedura do zhvillohet me datë 08.10.2018.

Nga të dhënat e sistemit, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE, konkretisht:

- 1- "H.G.", me ofertë 345,000 lekë, i kualifikuar në vend të parë.
- 2- "G.T.A.", me ofertë 398,200 lekë, i kualifikuar në vend të dytë.
- 3- "D. G.", me vlerë oferte 538,000 lekë, i skualifikuar pasi oferta e paraqitur ishte mbi fondin limit
- 4- "A.A.C.", me ofertë ekonomike 734,000 lekë, i skualifikuar pasi oferta e paraqitur ishte me fondin limit.

Sipas PV datë 08.10.2018, nga 4 OE pjesëmarrës, konstatohet se dy prej tyre (paraqitur me sipër), janë skualifikuar me vlerësimin se ofertat e paraqitura janë mbi fondin limit.

Me PV nr.1, datë 10.10.2018, komisioni ka shpallur fitues shoqërinë e renditur e dyta në garë òG.T.A.ò, me ofertë 398,200 lekë, pasi shoqëria òH.Gò, **nuk ka dërguar SMS për lidhje kontrate dhe kryerje shërbimi.**

Mangësitë: Nga të dhënat e sistemit të taksave Bashkia Vlorë, shoqëria òG.T.A.ò është debitor për vitin 2018 në shumën 3,515 lekë, duke mos plotësuar kriteret, **procedurë e cila duhej anuluar** dhe zhvilluar procedurë tjetër për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve me vlerë **488 mijë lekë.**

Nga punonjësit e NSHP Bashkia Vlorë (E. H., P. A. dhe E.G.), është mbajtur PV datë 13.11.2018, ku sqaron se shoqëria òG.T.A.ò, ka kryer këto punime:

- a- Me datë 20.09.2018 ka kryer 8 rrugë transport plehra dheu nga hidrovorin i qytetit;

- b- Me datë 12.10.2018 ka kryer 8 rrugë nga kanali i hapur i fushës së hidrovorin;
- c- Me datë 13.10.2018 ka kryer 10 rrugë nga kanali i hapur;
- d- Me datë 15.10.2018 a kryer 10 rrugë;
- e- Me datë 29.10.2018 ka kryer 8 rrugë; me datë 09.11.2018 ka kryer 5 rrugë dhe me datë 09.11.2018 ka kryer 3 rrugë. Gjithsej 54 rrugë.

Sipas të dhëna të mësipërme, procedura është paracaktuar, pasi subjekti ka kryer shërbimin më përpara se të zhvillohej procedura. Ka filluar transportin me datë 22.09.2018, ndërsa procedura është hapur me datë 08.10.2018, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët: **z. A. H.**, me funksion *Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit*, **zj. A. V.**, me funksion *Përgjegjëse e sektorit të DDD* dhe **z. E. B.**, me funksion *punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV*.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit z. A. H., A. V. dhe E. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*Për konstatuar nga grupi i KLSH në USH nr. 222, datë 19.11.2018, sqarojmë se mos eidenti se subjekti fitues ka detyrime për taksa vendore sipas të dhënave të DTTV Bashkia Vlorë, nuk qëndron, pasi ne jemi nisur nga vërtetim që ai ka depozituar dhe nuk kemi akses në sistemin e DTTV Bashkia Vlorë.*

Në lidhje me konstatimin se subjekti fitues është paracaktuar pasi ka kryer volum punimesh më përpara se të zhvillohej procedura, nuk ngarkojnë me përgjegjësi KBVV pasi urdhrat nuk përcaktohen nga ne si KBVV.

Qëndrim i grupit të KLSH-së:*Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë, pasi nëse do kishit kërkuar informacion në DTTV Bashkia Vlorë mbi listën e detyrimeve do mund të evidentonit një fakt të tillë.*

Në lidhje me pretendimin se nuk është përgjegjësia juaj që subjekti ka kryer më parë transporte dhe kjo nuk qëndron, pasi referuar udhëzimit nr. 3 datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” është detyrë e KBVV për hartimit e kritereve dhe vlerësimin e procedurës.

5. Urdhër shpenzimi nr. 161, datë 03.09.2018 në shumën 494,340 lekë, në favor të subjekti òC.ò, sipas faturës nr. 18, datë 22.08.2018 për shumën 494,340 lekë me TVSH.

Kjo procedurë është blerje me vlerë të vogël në kufirin 800,000 lekë.

Urdhër prokurimi nr. 35, datë 10.05.2018 për fondin limit 789,000 lekë dhe objekt òBlerje beton C 20/25 me zall për nevojat e NSHP- Bashkia Vlorë. Me datë 27.5.2018 është hapur procedura, ku evidentohet fakti se kanë marrë pjesë **13 OE**, nga të cilat janë kualifikuar 4 OE dhe janë skualifikuar 9 OE, por që nuk jepen argumente mbi arsyet e skualifikimit.

Me PV datë 29.05.2018 është bërë vlerësimi, ku fitues është shpallur shoqëria òA.C.ò me ofertë 780,000 lekë, e cila është skualifikuar pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, duke vlerësuar si fitues shoqërinë òC.ò i radhitur i dyti në garë me ofertë 788,000 lekë pa TVSH.

Mangësitë e procedurës.

Në vlerësimin e dokumentacionit të OE fitues, konstatojmë se nuk plotëson kriteret, pasi nga shoqëria òC.ò nuk është paraqitur punime të ngjashme. Kontratën që ka paraqitur nga subjekti datë 01.06.2015 me objekt òRikonstruksion i shkollës 9-vjecare ‘Rilindja Vlorë. Sipas situacionit nuk paraqet objektin e prokurimit, pasi në situacion nuk ka beton C 20/25 me zall. Në këto kushte shoqëria duhej skualifikuar. **Procedurë e parregullt**, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët **z. A. H.**, me funksion *Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit*, **zj. A. V.**, me funksion *Përgjegjëse e sektorit të DDD* dhe **z. E. B.**, me funksion *punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV*.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 “Mbi Projektraporti e Auditimit” nga punonjësit z. A. H., A. V. dhe E. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:*Për konstatuar nga grupi i KLSH në USH nr. 161, datë 3.9.2018, sqarojmë se gjetja nuk qëndron, pasi nuk është përgjegjësi e KBVV por komisionit të marrjes në dorëzim.*

Oëndrim i grupit të KLSH-së:*Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë, pasi referuar udhëzimit nr. 3 datë 8.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” është detyrë e KBVV për hartimit e kritereve dhe vlerësimin e procedurës.*

Gjithashtu ju keni kundërshtuar fakte që nuk kanë lidhje me gjetjen e KLSH-së.

6-Tenderi me objekt: “Blerje karburanti viti 2019”, me këto të dhëna:

Lloji i procedurës: “Blerje me vlera të vogla”, me fond limit deri në 800,000 lekë pa TVSH.

Urdhër prokurimi nr. 37, datë 17/05/2019, për sasinë 5000 naftë dhe 333 litra benzinë, me fond limit 800,000 lekë, nënshkruar nga ish- Drejtori z. G. Sh.

Me urdhër nr. 162/3 datë 21/05/2019, Titullari i AK të NSHP- Bashkia Vlorë ka ngarkuar ing. E. H. për llogaritjen e sasisë së karburantit dhe përcaktimin e fondit limit.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

1. Subjekti òR. C.ò me marzhë fitimi 6.5%;
2. Subjekti òA. Tò me marzhë fitimi 12%

Pas shqyrtimit të dokumentacionit KBVV ka kualifikuar si të rregullt të dy OE pjesëmarrëse.

Nisur nga çmimi më i leverdishëm, KVP ka shpallur fitues shoqërinë òR.C.ò me 6.5%;

Ndërmjet NSHP- Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òR. C.ò është lidhura kontrata nr. 182, datë 28/05/2019 për furnizimin me karburant.

- **Auditimi i procedurës:**

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit, rezulton se arsyeja për zhvillimin e kësaj procedure me objekt blerje karburanti me vlera të vogla, kur nga NSHP- Bashkia Vlorë është zhvilluar procedura me vlera të lartë është pasi me shkresën nr. 162, datë 16/05/2019 të hartuar nga specialistët ing. E. H., argumentohet fakti se për shkak të aktivitetit të shumtë që ka zhvilluar NSHP- Bashkia Vlorë për periudhën tetorónëntor 2018 dhe prill 2019 është konsumuar karburant më shumë se kontrata e lidhur. Në këto kushte ka lindur e nevojshme kryerja e kësaj procedure për plotësimin e nevojave.

Në këtë argumentim, i cili është shuma i vakët, nuk argumentohet se cilat janë aktivitet që janë kryer nga kjo njësi, mjete me volume pune dhe karburant të harxhuar. Ose e thënë ndryshe argumenti nuk është bindës për kryerjen e kësaj procedure, duke çuar në keq menaxhim të fondeve publike për sasinë e karburantit të blerë, duke ngarkuar me përgjegjësi: **z. G. Sh.** për nxjerrjen e urdhër prokurimit dhe komisioni mbi argumentimin e sasinë së karburanti i përberë nga **ing. E. H.** dhe funksion Përgj. Sektorit Teknik në NSHP.

7. Me urdhër shpenzimit nr. 200, datë 9.10.2019, është likuiduar vlefata prej 957,600 lekë, në favor të subjektit òS.ò për mallin òBlerje makineò, sipas faturës 26, datë 13.08.2019.

Me PV datë 15.08.2019, komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje: E. H., K. M. dhe Dh. V., mjeti është sipas specifikimeve teknike.

Me urdhër nr. 343, datë 5.10.2019, Drejtori i NSHP z. G. Sh. ka urdhëruar financës për likuidimin e faturës, ku nga financa është kundërshtuar fakti, pasi:

Dokumentet e mjetit janë në emër të shoqërisë òC.ò dhe jo të OE fitues òS.ò, i cili është dhe fitues i procedurës.

Kjo është shprehur në PV e mbajtur nga komisioni me datë 10.08.2019, i përberë nga zj. T. D. Sipas këtij PV, theksohet se fondi limit është hartuar nga vetë Drejtori i NSHP dhe pa miratim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe pa miratuar në buxhetin e vitit 2019, duke qenë se kemi të bëjmë me investim.

Në përcaktimin e fondit i cili është bërë nga një person dhe ky Titullari i AK, nuk ka asnjë dokumentacion mbi përcaktimin e çmimit.

Urdhër prokurimi nr. 48, datë 24.07.2019 me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Sipas të dhënave të sistemit, në këtë procedura kanë marrë pjesë 10 OE, ku 4 OE janë skualifikuar, duke kualifikuar 6 OE.

Në vend të parë është kualifikuar shoqëria òS. A.ò me ofertë 767,800 lekë, i cili është tërhequr për arsye objektive.

OE i renditur i dyti òM.M.ò me ofertë 768,000 lekë është tërhequr, për arsye objektive.

Pas tërheqjes së 2 OE të parë dhe dytë KVO ka shpallur fitues shoqërinë òS.ò me ofertë 798,000 lekë.

Kontrata e lidhur midis NSHP Bashkia Vlorë dhe shoqërisë òS.ò është nr. 276/1, datë 14.08.2019.

Mangësitë e konstatuara.

- Në përcaktimin e fondit limit, nuk ka asnjë dokument që tregon domosdoshmërinë e kryerjes së kësaj blerje, si dhe nuk ka konfirmim nga Kryetari i Bashkisë Vlorë në zbatim të VKB, pasi kemi të bëjmë me investim siç është blerje makinë.

- Fondi limit ka vetëm firmën e ish- Drejtorit të NSHP z. G. Sh.;

- Nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi zhvillimin e procedurës;

- Nuk janë bërë deklaratat e konfliktit të interesit.

- Procedura është e pasaktë, pasi mjeti nuk është në emër të shoqërisë òS.ò, por të shoqërisë òC.ò, subjekti i cili nuk është shpallur fitues, ndërkohë që në kritere kërkohet që mjeti të jetë në emër të shoqërisë fituese. **Procedurë e parregullt.**

Kontrata me firmën fituese është me nr. 276/1, datë 14.08.2019, ndërkohë që fatura e subjekti është me nr. 26, datë 13.08.2019, pra një ditë më përpara, veprime të cilat tregojnë se kjo procedurë është e paracaktuar fituesi.

- Procedura nuk është miratuar me VKB të vitit 2019, si investim dhe gjatë vitit nuk ka shtesa ose ndryshime të VKB, duke ngarkuar me përgjegjësi:

Titullarin e AK z. G. Sh. me funksion ish- Drejtor i NSHP, zj. J. H. me funksion specialiste financë, në cilësinë e personit përgjegjës për përgatitjen e procedurës dhe anëtarët e KBVV z. A. H., me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit, zj. A. V., me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD dhe z. E. H., me funksion Përgjegjës i Sektorit teknik, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur kundërshtitë me shkresë nr. 25/2, datë 22.01.2021 "Mbi Projektraporti e Auditimit" nga punonjësit z. A. H., A. V. dhe E. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Fondi limit është hartuar nga ish- Drejtori G. Sh. dhe jo nga KBVV. Gjithashtu e gjithë procedura është zhvilluar pa dijeninë e KBVV, ku mund të vërtetohet dhe nga dosja se nuk ka procesverbal mbyllje së ofertës në të cilën të renditet e gjithë OE.

Oëndrim i grupit të KLSH-së:

Lidhur me sa kundërshtoni sqarojmë se argumenti merret në konsideratë fakti që përgjegjës është dhe ish- Drejtori z. G. Sh.. Në lidhje me pretendimin se kush ka cekuar në sistem, kjo nuk mund të vërtetohet dhe nga ana jonë, pasi çdo person ka kodet e tij.

8. Pagesa pa procedura.

Me USH nr. 242, datë 10.10.2019, është likuiduar vlera prej 901,000 lekë, në favor të subjektet òA. H.ò, sipas faturës 290, datë 04.10.2019, me objekt òRiparim mjeti të transportiò me vlerë 270,000 lekë dhe òRiparim ekskavatori BORDò me vlerë 631,000 lekë.

Sipas dokumentacionit bashkëlidhur USH, konstatohet këto dokumente:

- 1- Urdhër pune datë 28.09.2018, për mjetin tip òESKAVATOR FIATò, **kur procedura është zhvilluar në vitin 2019;**
- 2- Procesverbal datë 28.09.2018, mbi domosdoshmërinë e kryerjes së punimeve, **kur procedura është e vitit 2019;**
- 3- Urdhër pune datë 30.07.2019 për riparim mjeti tip òESKAVATOR VOLVOò, kur UP

- është me datë 5.6.2019, pra më përpara se urdhri prej një muaj;
- 4- Procesverbal datë 30.07.2019, për riparim mjete tip ÷ESKAVATOR VOLVOö;
 - 5- Urdhër pune datë 10.09.2019 për riparim mjete tip ÷VOLVO ESKAVATORö, kur UP është me datë 05.06.2019, pra më përpara se urdhri afërsisht mbi 2 muaj;
 - 6- Urdhër pune datë 27.06.2019 për riparim mjete tip ÷SKREP FIATö, kur UP është me datë 05.06.2019, pra më përpara se urdhri prej 22 ditësh.
 - 7- Urdhër pune datë 06.08.2019 për riparim mjete tip ÷FORDT TRANZITö, kur UP është me datë 05.06.2019, pra më përpara se urdhri prej një muaj.

Nga të dhënat e sistemit SEP, por dhe dokumentacionit bashkëlidhur praktikës së likuidimit të faturave, konstatohet se këto procedura nuk janë zhvilluar në sistemin elektronik dhe se nuk ka asnjë dokument që tregon mënyrën e zhvillimit të tij, sa pjesëmarrës kanë marrë pjesë, ofertat e paraqitura, kriteret e aplikuar, mënyra e llogaritjes së fondit limit dhe procedura e ndjekur, kërkesa e sektorit ose shoferit për nevojën këtij shërbimi, etj, duke ngarkuar me përgjegjësi: *Titullarin e AK z. G. Sh. me funksion ish- Drejtor i NSHP dhe zj. J. H. me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e mbikëqyrësit të dosjes dhe zj. T. D., me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës, në cilësinë e Nëpunësit zbatues.*

IV. Gjetje DHE REKOMANDIME

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare të periudhës raportuese ushtrimore 2020.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Vlorë (Aparati), për vitin ushtrimor 2018, 2019 dhe 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar, i kundërt:²⁵

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705²⁶, dhe ISSAI 1200²⁷, pasqyrat financiare, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, pozitën financiare të Bashkisë Vlorë në datën 31 dhjetor 2020, referuar ligjit Nr. 25/2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare* dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, *pasi mbartin gabime materiale dhe të përhapura, të cilat janë trajtuar në Bazën për opinionin e kundërt.*

Baza për opinionin e modifikuar, të kundërt:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Vlorë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto

²⁵ **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

²⁶ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raport të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

²⁷ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 është 51,881 mijë lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2020, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2020 (materialiteti 51,881 mijë lekë), dhe janë gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve:

Llogaria nr. 231 *“Investime për aktive afatgjata materiale”*, është pasqyruar më pak për vlerën 80,188,890 lekë;

Llogaria nr. 212 *“Ndërtesa, konstruksione”*, është pasqyruar më pak për vlerën 56,276,416 lekë;

Llogaria nr. 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”*, është pasqyruar më pak për vlerën 11,594,723 lekë;

Llogaria nr. 215 *“Mjete Transporti”*, është pasqyruar më pak për vlerën 9,983,799 lekë;

Llogaria nr. 202 *“Studime dhe kërkime”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 7,776,000 lekë;

Llogaria nr. 101 *“Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 11,086,490 lekë;

Llogaria nr. 85 *“Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore”*, është pasqyruar më tepër për vlerën 90,697,230 lekë;

Llogaria nr. 26 *“Pjesëmarrje në kapitalin e vet”*, është pasqyruar më pak për vlerën 635,787,414 lekë;

Llogaria nr. 468 *“Debitorë të ndryshëm”*, është pasqyruar më pak për vlerën 75,218,827 lekë;

Llogaria nr. 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”*, është pasqyruar më pak për vlerën 130,042,284 lekë;

Llogaria nr. 467 *“Kreditorë të ndryshëm”*, është pasqyruar më pak për vlerën 130,042,284 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vlorë.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Vlorë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë

ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionit i auditimit mbi përputhshmërinë për periudhën 01.01.2018 - 30.06.2021

Konkluzion i Përgjithshëm:

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2018 ó 31.06.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit *Bashkinë Vlorë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë*, bazuar në analizën e riskut²⁸, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë të plotësuar, materiale të përhapura që janë baza për dhënien e *një opinionit të kundërt*²⁹, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë 854,109 mijë lekë.

Për drejtimin e Bashkisë Vlorë

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara, si dhe zbatimin e kontratave të realizuara, gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2018 - 30.06.2021, në Bashkinë Vlorë dhe në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike të Bashkisë Vlorë.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave, si dhe çdo dokument të ndodhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE). Në auditimin e prokurimeve me fonde publike, ne u mbështetëm në analizë risku, duke vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.

Opinion i modifikuar, i Kundërt³⁰:

Sipas mendimit tonë, ne kemi marrë siguri të arsyeshme, për të dhënë opinion se veprimtaria e subjektit të audituar, në këtë rast *Autoriteti Kontraktorë Bashkia Vlorë dhe NSHP*, në prokurimin e fondeve publike, nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative të fushës së prokurimeve), si dhe gabimet dhe shkeljet e evidentuara, janë të përhapura dhe materiale (kryesisht përsa i përket materialitetit cilësor).

Baza për opinionin e modifikuar, të Kundërt:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Raportit , ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Vlorë dhe NSHP, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

²⁸ Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

²⁹ Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

³⁰ **Opinionit i modifikuar, i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura.

Përshkrimi i çështjeve:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se *është konstatuar dëm ekonomik*, në subjektin e audituar Bashkia Vlorë dhe NSHP, për:

- Moslogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit/certifikatat e përdorimit në vlerën 21,258 mijë lekë;
- Moslogaritjen e saktë të detyrimit për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe biletave turistike në vlerën 3,175 mijë lekë;
- Shpenzime të pajustificuara në karburant në vlerën 3,007 mijë lekë;
- Shpalljen fitues të OE në mënyrë të padrejtë në vlerën 2,956 mijë lekë;
- Moszbatimin e punimeve sipas afatit të kontratës dhe për punime të pakryera në vlerën 1,497 mijë lekë;
- Shpenzime për paga në vlerën 285 mijë lekë, etj.

Është konstatuar përdorim i fondeve publike jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomicitetit, për:

- Moslogaritjen e saktë të taksës për tokën bujqësore, ndërtesës, ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit, tarifës së gjelbërimit, pastrimit, ndriçimit, ushtrimit të aktivitetit të shpërndarjes së karburantit, në vlerën 388,650 mijë lekë;
- Moslogaritjen dhe mosarkëtimin e saktë të tarifës së qirave për hapësirat e plazhit, thertore dhe parkun e lojrave, në vlerën 26,522 mijë lekë;
- Për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve fituese jo në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator të prokurimeve publike, në vlerën 91,258 mijë lekë;
- Për moslogaritjen e saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe të penaliteteve për rastet kur kjo taksë është paguar jashtë afatit, në vlerën 117,201 mijë lekë;
- Për pagesën e vendimeve gjyqësore me objekt shpërblim page, për largime të padrejta nga puna, në vlerën 144,177 mijë lekë, etj.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale dhe të përhapura (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vlorë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë dhe NSHP janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³¹, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin e skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

³¹ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimit prej afro 1,000,000 USD të bërë nga Bashkia Vlorë, në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, sipas kërkesë padisë të bërë nga subjekti òT. P.ò Shpk për prishjen e kontratës koncesionare *òPër shërbimin e sistemit dhe menaxhimin të parkimit në qytetin e Vlorës*, u konstatua se Avokatura e Shtetit, bazuar në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 *òPër Avokaturën e Shtetit*, neni 5, germa c), nuk ofron shërbim përfaqësimi për organet e qeverisjes vendor, por vetëm asistencë juridike. Gjithashtu, ligji me nr. 9643, datë 20.11.2006 *òPër prokurimin publik* neni 7, germa c), përcakton se për shërbimet në arbitrazh nuk zbatohen kontratat e shërbimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Duke qenë se organet e qeverisjes vendore, mbeten të papërfshira në përfaqësim nga Avokatura e Shtetit dhe nevojat për këtë natyrë specifike prokurimesh nuk rregullohen nga ligji për Prokurimin Publik, pasi në mënyrë specifike ndalohej procedura e prokurimit për përfaqësimin në arbitrazh, propozojmë ndryshimin e nenit 5, germa b) të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, *òPër avokaturën e shtetit* në të cilin Avokatura e Shtetit të përfaqësojë krahas organeve të administratës shtetërore, edhe ato të qeverisjes vendore, në bazë të kërkesës apo nevojës së tyre, duke rregulluar edhe mënyrat e pagesës.

Menjëherë

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë nuk ka likuiduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor, duke krijuar detyrime të prapambetura në vijimësi për të gjithë periudhën e audituar.

Vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të secilit vit buxhetor paraqitet: për vitin 2018 vlera 380,681 mijë lekë, për vitin 2019 vlera 285,741 mijë lekë, për vitin 2020 vlera 246,662 mijë lekë dhe për 6- mujorin e I të vitit 2021, vlera 148,941 mijë lekë.

Konstatohet se në buxhetin vjetor kryhet procesi i planifikimit të detyrimeve të prapambetura, por ky planifikim nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të buxhetit.

Për vitet 2018 dhe 2019 detyrimet e raportuara në MFE nuk përputhen me detyrimet kreditore sipas pasqyrave financiare (gjendjet e llogarive të klasës 4 të detyrimeve në pasiv të bilancit).

Respektivisht për vitin 2018 dhe 2019, kjo mos përputhje është në vlerën 80,046 mijë lekë dhe 33,764 mijë lekë, më pak në pasqyrat financiare.

Për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa jashtë afatit 30 ditor të faturave për shpenzime/shërbime/investime të mbërritura në institucion në 433 raste në vlerën 1,381,632 mijë lekë. Këto likuidime jashtë afateve ligjore kanë si shkak kryesor mos realizimin e të ardhurave, pra marrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e thesarit.

Nga auditimi janë konstatuar raste të copëzimit të vlerës së pagesës së faturave tatimore, ku për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 - 30.06.2021, paraqiten gjithsej 20 fatura me vlerë 199,436,542 mijë lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 *òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 *òPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit* i ndryshuar, pikat 253 dhe 354; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *òPër financat e Vetëqeverisjes Vendore* neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 *òPër menaxhimin e*

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 52. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që gjatë zbatimit të buxhetit, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Gjatë vitit buxhetor të mos merren angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, në mënyrë që të shmangët akumulimi i borxhit të ri. Për detyrimet e prapambetura, të hartohet një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar radhën e pagesave. Të paraqitet në mbledhjen e këshillit bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara si dhe plani për likuidimin e tyre.

Brenda vitit 2022

2. Gjetje nga auditimi: Niveli i realizmit të investimeve është shumë i ulët krahasuar me planifikimin. Për vitin 2018 në masën 49 %, për vitin 2019, në masën 67 %, për vitin 2020 në masën 86%, ndërsa për periudhën janar - qershor 2021, investimet janë realizuar në masën 44%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vlorë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime reale të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, të ligjit nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe nenin 47 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.**(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së të ardhurave dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigjohet edhe plani i shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në një pjesë të konsiderueshme të kontratave të lidhura për investimet publike midis Bashkisë Vlorë dhe kontraktorëve, nuk është zbatuar afati i përcaktuar në kontratë për likuidimin e vlerës së saj.

Ky fenomen vërehet si në kontratat me burim financimi FZHR dhe ministritë e linjës, ashtu edhe në kontratat që financohen nga të ardhurat e veta, në të cilat është konstatuar mos depozitimi i urdhrave të prokurimit në degën e thesarit për bllokim të fondeve. Mos alokimi në kohë i burimeve të financimit nga financuesit dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, është shkak kryesor i moslikuidimit në kohë të kontratave të investimeve, në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë dhe kontraktorit, duke krijuar detyrime të prapambetura, si dhe një rrisht të lartë për pagesa mbi vlerën reale të kontratës, për shkak të interesave që mund të kërkojnë kontraktorët, apo proceseve gjyqësore që mund të hapin për shkelje të afatit të pagesës të parashikuar në kontratë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet kontraktuale midis palëve, si dhe nenet 50-51 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 ËPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 ËPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ËPër miratimin e rregullave të prokurimit*

publiko, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Vlorë dhe kontraktorëve, sipas afateve të përcaktuar në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe mundësinë e kryerjes së pagesave mbi vlerën reale të kontratës, për shkak të interesave që mund të kërkojnë kontraktorët, apo proceseve gjyqësore. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit, do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri i prokurimit të depozitohet menjëherë në degën e thesarit përpara zhvillimit të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vlorë për vitin 2020, më konkretisht të llogarisë nr. 468 ÷ Debitorë të ndryshëm, u konstatua se, kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Vlorë për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak, për vlerën 75,218,827 lekë³². Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ÷ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, shkronja öö, pika 3, neni 12, Ligjin nr.25/2018 ÷ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, pika 1, neni 11, Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, kreu 3.1, pika 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët në llogarinë nr. 468 ÷ Debitorë të ndryshëm. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë nr. 1210 ÷ Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit të vitit në vazhdim.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vlorë për vitin 2020, më konkretisht të llogarisë nr. 467 ÷ Kreditorë të ndryshëm, me kundërparti llogarinë nr. 486 ÷ Shpenzime të periudhave të ardhshme u konstatua se, kjo llogari, e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë Vlorë për likuidim ndaj të tretëve (investime të kryera, vendime gjyqësore të formës së prerë, shpronësime), është kontabilizuar më pak, për vlerën 130,042,284 lekë. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1, Pika 3.3/c.d. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë Vlorë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 ÷ Kreditorë të ndryshëm me kundërparti llogarinë nr. 486 ÷ Shpenzime të periudhave të ardhshme. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vlorë për vitin 2020, më konkretisht të llogarisë nr. 231 ÷ Investime në proces, u konstatua se, nuk është bërë

³²Taksën e tokës bujqësore në vlerën 64,290,775 lekë, taksën e hapësirës së plazhit për kontrata të lidhura në vitin 2020 në vlerën 6,783,200 lekë, taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,615,972 lekë, parkun e lojrave në vlerën 2,913,840 lekë, thertore, pronë e dhënë me qera në vlerën 347,040 lekë, i pullave në vlerën 971,000 lekë dhe gjobave të IMT në vlerën 187,682,000 lekë.

kontabilizimi i vlerës 80,188,890 lekë në llogarinë nr. 231, si rrjedhojë e likuidimeve të kryera nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për shpronësimet në projektin “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë”³³. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Kreu 2, Klasa 2.(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 òInvestime në procesò dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces, në momentin e përfundimit të projektit “Rikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vlorë për vitin 2020, më konkretisht të llogarisë nr. 202 òStudime dhe kërkimeò, u konstatua se, është kontabilizuar si shtesë gjatë vitit 2020, 1 projekt, òProjekti Gjeohapësinorò në vlerën 12,960,000 lekë, projekt i cili nuk i përket shtesave të vitit 2020 këtij viti, pasi ky projekt është marrë në dorëzim nga Bashkia Vlorë më datë 28.12.2016, dhe duhej të kontabilizohej në këtë vit.

-Gjithashtu si rrjedhojë e këtij veprimi, për këtë projekt nuk është përlllogaritur vlera e amortizimit në masën 15%, nga data e marrjes në dorëzim deri më 31.12.2020 (4 vite-7,776,000 lekë), efektet e të cilit ndikojnë në pasqyrimin e saktë të vlerës së llogarisë nr.202, përkatësisht 68,386,778 lekë në pasqyrën F1.

-Nuk është bërë kontabilizimi i 2 projekteve òVazhdim punimesh, rikonstruksioni i shkollës së mesme Halim Xhelo, Vlorëò dhe òRehabilitim lere betoniò, për dy kontrata të lidhura, përkatësisht në datën 11.03.2019 dhe datën 21.10.2019.

-Nuk është kryer amortizimi në tërësi i llogarisë nr. 202 òStudime dhe kërkimeò.Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pika 26, 30 dhe 34, si dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, shkronja òbò e pikës 18 dhe pika 36.(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet regjistrimi në kontabilitet i projekteve të dhuruara në llogarinë nr. 202 òStudime dhe Kërkimeò duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (marrëveshja/akti i dhurimit), si dhe përlllogaritjen e amortizimit të tyre.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi:Në Bashkinë Vlorë, në vitet 2018, 2019 dhe 2020 për llogaritë nr. 210 òToka, troje, terreneò, nr. 211 òPyje Plantacioneò, nr. 212 òNdërtesa e Konstruksioneò, nr. 213 òRrugë, rrjete,vepra ujoreò, nr. 214 òInstalime teknike, makineri e pajisjeò dhe aktivitet afatshkurtra, nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar të amortizimit, koha e shërbimeve të

³³ VKM-në nr. 368, datë 20.06.2018 òPër shpronësimet, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit òRikualifikim në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorëò, pika 4 e vendimit për cakton se: òVlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë òruallò dhe òndërteseò, prej 152,930,608 lekësh, të përballohet në masën 50% nga Bashkia Vlorë dhe 50% nga llogaria e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisëò.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), referuar pikës 4 të VKM-së duhet të përballojë në masën 50% vlerën totale të shpronësimeve, pra 80,188,890 lekë e cila është likuiduar deri në 31.12.2019 (duke e arritur masën 50% të totalit sipas pikës 4).

mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.139/2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò. Kap III, pika 30.(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të krijohet dhe mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Në dy procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarit të imët dhe ekonomik, instalimeve teknike dhe veglave të punës, për vitet 2019 dhe 2020, u konstatua se:

-Një pjesë e konsiderueshme e mallrave³⁴ janë me profil metalik, **me kosto historike në vlerën 8,701,660 lekë**, të cilat duhet të ishin grumbulluar, të ishin bërë hyrje në magazinë dhe më pas të shiteshin me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë, me qëllim krijimin e të ardhurave nëpërmjet tyre.

-Në procedurën e vitit 2020, nga Titullari i Bashkisë Vlorë **nuk duhet të ishte nxjerrë urdhër për daljen jashtë përdorimit të aktiveve të mësipërme**, pasi institucioni **nuk ka qenë gjatë procesit të inventarizimit dhe/ose në përfundim të këtij procesi**.

-Nga komisionet e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave të mësipërm, nuk është dokumentuar plotësisht procedura e ndjekur për nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave të mësipërm, pasi në dosjet përkatëse nuk administrohen dokumente mbështetës të cilët, vërtetojnë nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimit/shkatërrimit si, dokumenti i transferimit të tyre për asgjësim/shkatërrim, mënyra e përdorur për asgjësimin/shkatërrim e tyre (djegie, groposje, etj), kontrata e shërbimit ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit/asgjësimit/transportimit të mallrave, si dhe foto të procesit asgjësimit të tyre.

-Nuk administrohet lista e mallrave që do të kalojnë për vlerësim, e cila përgatitet nga Nëpunësi Zbatues i Institucionit. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 òPër miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshmeò, i ndryshuar, Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 òPër lëndfillet e mbetjeveò, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pikat 95, 104, 106, 109 dhe 110.(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

9.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme që, të ngrejë një grup pune i cili të identifikojë institucionet ku janë nxjerrë jashtë përdorimit materialet me profil metalik (Administrata Bashkia Vlorë, Gjendje Civile, Qendra Ekonomike, Çerdhe, Kopshte, Njësi Administrative, etj), si dhe komisionet përkatëse, për vitet 2019-2020.

9.2. Rekomandimi: Në vijim nga grupi i punës të përlllogarit vlera e shitjes me ankand (peshë³⁵ * vlera e tregut për 1 kg) të materialeve të mësipërme me profil metalik, që janë nxjerrë jashtë përdorimit në vitet 2019 dhe 2020.

³⁴Kazan mbeturinash, Zgarë hekuri, Kazan inoksi, Raftë metalik, etj.

³⁵Specifikimet teknike të materialit, përmasa dhe peshë.

9.3. Rekomandimi: Në përfundim të procesit të identifikimit dhe vlerësimit, Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit, për arkëtimin në mënyrë përpjestimore, të vlerës së shitjes me ankand të materialeve me profil metalik.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë Vlorë për vitin 2020, më konkretisht të llogarisë nr. 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaö, u konstatua se, në këtë llogari nuk është bërë kontabilizimi i aksioneve që zotëron Bashkia Vlorë në òUjësjellës Kanalizime Vlorë SHA, me NUIS òK07.....4Aö, me vlerë 632,287,414 lekë, si dhe aksioneve në òF. F. C. SHA me NUIS òL17.....3Iö, me vlerë 3,500,000 lekë. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarö, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeö pika 55, 56, 57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeö, si dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, Kreu 3.1, pika 31, shkronja òbö. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 124-144, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të òUjësjellës Kanalizime Vlorëö SHA me vlerë kontabël 632,287,414 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të òF.F.C. SHAö me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë nr. 26 òPjesëmarrje në kapitalin e vetö dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, u konstatua se, Komisioni i Blerjeve të Vogla (KBV), nuk ka argumentuar përlllogaritjen e fondit limit, nuk ka mbajtur procesverbal për fazën e vlerësimit të ofertës/ofertave, për të dokumentuar procesin e vlerësimit dhe refuzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë deri në vendin e 10 të klasifikimit, nuk ka firmosur faturën e TVSH-së për blerjen e mallit apo shërbimit, si dhe copëzim i fondeve në 9 raste për prokurime të së njëjtës natyrë. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 òMbi miratimin e rregullave të Prokurimit Publikö, i ndryshuar, pikat 1, 5, 7 dhe 8 të nenit 40, pika 2 në nenin 59, neni 60, Udhëzimin nr. 3 datë 08.01.2018 i APP òMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, i ndryshuar, pikat 3, 5, 6, 14, 17, 19 dhe formati nr.2 òurdhri i prokurimitö. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, të marrë masat e nevojshme, që Komisioni i Blerjeve të Vogla, të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka lëshuar çertifikatën e përdorimit miratuar me vendimin nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òObjekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hotelieriö Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 10.03.2019.

Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, kjo e vërtetuar edhe me dokumentacion fotografik nga ku vihet re se nuk janë zbatuar shkallëzimet 3-5 sipas planvendosjes së miratuar

dhe projektit të miratuar duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, IMT Bashkia Vlorë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta në drejtim të kontrollit të zhvillimit të territorit duke mos konstatuar devijimin nga kushtet e lejes të objektit të ndërtuar, gjithashtu edhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Vlorë, duke konfirmuar punimet e jashtëligjme të kryera, madje duke miratuar edhe certifikatën e përdorimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues **A. S.**, mbikqyrësi **D. Gj.** i pajisur me licensë nr. MK2....9, Subjekti ndërtues **T. C.** shpk, dhe kolaudatori **N. J.** dhe trajtimin e ndërtimit të kundraligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmerisë në fazën fillestare.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka lëshuar certifikatën e përdorimit miratuar me vendim me nr. 577, datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtese anesore e kapanonit ekzistues 2 kat), në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues òA.P.ò sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë.

Ky objekt nuk ka respektuar afatet e ndërtimit sipas Vendimit nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, pasi sipas pikës 2 të këtij vendimi, afati referuar grafikut është 3 muaj. Sipas njoftimit dhe aktit të kolaudimit punimet kanë filluar me datë 27.09.2018 dhe kanë përfunduar me datë 30.09.2019. Në sistemin e-leje është depozituar një shkresë me nr.1115/1 prot. datë 05.07.2018, ku konfirmohet një datë tjetër afati punimesh, në kundërshtim kjo me pikën 11 të Vendimit nr. 430, datë 11.7.2018 për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve të KM, sipas së cilës: *Korrigjimi i të dhënave të hedhura gabim në sistemin elektronik do të kryhet, si më poshtë: a) Bashkitë apo institucionet, për të dhënat e hedhura gabim nga ana e tyre, i drejtohen me kërkesë zyrtare për korrigjimin Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.*

Deklarimi me shkresën nr.1115/1 i zgjatjes së afatit të punimeve pa kryer veprimet ligjore përkatëse, përveç se është kundravajtje administrative, përbën edhe një veprim që nuk ka vlerë ligjore. Nisur nga ky fakt, subjekti òA.P.ò SHPK ka patur afat 3 muaj për përfundimin e punimeve, dhe për shkak ligjor IMT Bashkia Vlorë duhej të mbante procedurën përkatëse në zbatim të ligjit, e të mos lejonte ndërtimin jashtë afateve të lejes së ndërtimit.

Nga dokumentacioni fotografik i depozituar nga vetë subjekti në aplikimin për pajisje me certifikatë përdorimi me nr. AN270.....071, nuk janë zbatuar sipas projektit të miratuar hapjet në fasadë. Për këtë veprim nga ana e IMT Vlorë nuk është mbajtur asnjë proces verbal, duke anashkaluar përgjegjësitë e veta. Gjithashtu për këtë objekt është mbajtur akt-kontroll (për përfundimin e fasadave dhe rifiniturave) i cili në kundërshtim me ligjin nuk ka asnjë datë për mbajtjen e tij, gjithashtu Subjekti Zbatues òA.P.ò shpk dhe mbikqyrësi òI.R.ò kanë deklaruar se fasadat kanë zbatuar projektin e miratuar, duke bërë një deklaram të pavërtetë. Asnjë nga këto akt-kontrolle nuk është konfirmuar nga Bashkia Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo

në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues “A.P.” shpk, dhe mbikëqyrësin “I. R.” shpk dhe trajtimin e ndërtimit të kundraligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në pikën 2.3.11, të dokumenteve të tenderit, sipas procedurës së prokurimit òRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë është përcaktuar distanca më e largët e transportit të asfaltobetonit 30 km, me përlllogaritjet dhe argumentimin si më poshtë:

- Prodhim asfaltobetonit 40 minuta.
- Mbushja e kamionit referuar fabrikave 100 ton/orë 10.4 minuta.
- Procesi i shkarkimit, vendosjes dhe ngjeshjes së materialit 50 minuta.

Koha e mbetur për transport materialit 19.6 minuta.

Për shpejtësi të kamionit 40 deri 50 km/orë, është përcaktuar distanca maksimale 14.7 km, megjithatë është vendosur distanca maksimale 30 km.

Sa më sipër sqarojmë se, bazuar në dokumentet e tenderit, është kërkuar disponimi ose marrja me qira e 5 automjeteve të transportit me tonazh mbi 18 ton. Nëse marrim në konsideratë një automjet me peshëmbajrje 20 ton, prodhimi i asfaltobetonit për fabrikë 100 ton/orë (kapaciteti i marrë në llogaritje nga njësia e prokurimit), rezulton për një periudhë 12 minuta, pra koha e mbetur për transport është 47.6 minuta dhe jo 19.6 minuta. Në këto kushte, distanca maksimale duhet të ishte 31.7 kilometër. Vendosja e distancave në mënyrë të pa argumentuar, ndikon në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në tender. Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e stafit i cili angazhohet me realizimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe rishikimin e dokumentacionit të projektpreventivave të cilat përgatiten nga konsulentët e përzgjedhur, për të përshtatur dokumentacionin sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit òBlerje shtylla elektrike ndriçimi, viti 2021, për përlllogaritjen e fondit limit janë hartuar analiza çmimesh sipas komponentëve përkatës, pa asnjë referencë për çmimet e materialeve, për kohën dhe pagesën e punëtorisë apo çmime të zërave të ndryshëm të punimeve si, lryje me bojë, galvanizim, saldime etj. Analiza e çmimeve për blerjen e materialeve është hartuar nga z. A. L. Çmimi sipas analizave përkatëse është më i vogël se ai i reflektuar në çmimin për çdo zë në hartimin e fondit limit. Sa më sipër, fondi limit duhet të ishte llogaritur me vlerë 13,729,515 lekë dhe jo 16,666,114 lekë, nga ku rezulton se është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerën 2,936,599 lekë. Kontrata e furnizimit është nënshkruar me vlerë 12,978,134 lekë, më të ulët se fondi limit i rillogaritur në shumën 751,381 lekë (13,729,515 lekë ó 12,978,134 lekë). Pavarësisht se nuk janë krijuar pasoja ekonomike negative, veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 59. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit të Rikonstruksionit të ujësjellësit në 15 fshatrat e Njësisë Administrative Novoselë, APP me Email të datës 01.02.2021, ka paraqitur disa rekomandime në lidhje me hartimin e kriterëve për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi. Nga ana e AK janë bërë përmirësimet, por jo sa i përket pikës 2.3.14, të kapacitetit teknik, në lidhje me mjete gërmimi, mjete transporti dhe mjete tërheqëse. Sa më sipër në kriteret për kualifikim është kërkuar, po ashtu nuk është marrë për bazë rekomandimi sa i përket licencimit dhe makinerive.

- Është kërkuar disponimi të licencës për kategorinë NP ó 4 C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale), NP ó 12 E (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Objekti i kontratës është rikonstruksion i ujësjellësash dhe nuk ka lidhje me punimet sipas kategorive NP-4C të Rruges, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, me kategorinë NP-12 E të Punimeve të inxhinierisë së mjedisit.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencat e leshuara nga QKB si me poshte:

Është kërkuar disponimi i licences për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte që mund të krijohen, Kodi III.2.Bö, ndërkohë që kjo veprimtari mund të kryhet nga ofertuesit të cilët mund të nënshkruajnë kontrata të posaçme me operatorë që disponojnë licencë për këtë aktivitet.

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës ó të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

- 1 (një) Inxhinier Elektronik/Elektrik gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës.

Në lidhje me kërkesat e mësipërme theksojmë se kërkesa për inxhinier ndërtimi (profil strukturist) dhe inxhinier mjedisi është e pa argumentuar.

Janë kërkuar tërheqës, rimorkiatorë, ekskavatorë trencher për punime specifike, ndërkohë që këto kërkesa nuk përputhen me përshkrimin e punimeve të kontratës. Vendosja e këtyre kërkesave, krijon vështirësi për pjesëmarrje për operatorët ekonomikë. Ky veprim është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 të Përmirësimit të Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, neni 26. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të kompetencës, me synim realizimin e procedurave të prokurimit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore si dhe krijimin e mundësive për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Kontrata të Shërbimit të Pastrimit në Qytetin e Vlorës, është nënshkruar me nr. 6229/1 prot., datë 03.07.2020, ndërmjet Bashkisë vlorë dhe kontraktorit të D.ö SHPK, me vlerë 581,685,822 lekë, për një afat 3 vjeçar. Nga auditimi konstatohet se situacionet e pagesave nga shtatori 2020 deri shkurt 2021, janë certifikuar nga supervizore znj. V. Ç. me vlerën e plotë, sipas parashikimit në kontratë. Për aktivitetin e pastrimit nga muaji mars 2021 deri në muajin qershor 2021, janë certifikuar situacione me reduktime të ditëve të shërbimit, si për shërbimin e heqjes së mbeturinave, ashtu edhe për pastrimin me mjete teknologjike apo fshesë. Për këtë periudhë situacionet janë certifikuar nga supervizore znj. V. Ç., përgjegjëse e kontratave të shërbimit z. Z. S. dhe administratorët e rajoneve 1, 2, 3, 4 dhe 5. Nga ana e kontraktorit, situacionet janë paraqitur me vlerë të plotë.

Për periudhën objekt auditimi (deri më 30.06.2021), në situacionet e pagesave është zbritur vlera 21,105,889 lekë me TVSH.

Shërbimi i pastrimit në Qytetin e Vlorës është shoqëruar me problematika të shumta, të cilat duken të reflektuara vetëm pas muajit shkurt 2021. Përjashtuar reduktimin e pagesave, nuk është ushtruar sanksion tjetër ndaj kontraktuesit në referencë të përcaktimeve kontraktore, për dëmin që është shkaktuar qytetarëve nuk mos realizimi periodik i shërbimeve të parashikuara për larjen e rrugëve, pastrimin apo largimin e kontenierëve. Mos realizimi i shërbimeve sipas kërkesave

kontraktore, shkakton dëm në shëndetin e qytetarëve, si dhe krijn probleme të rëndësishme mjedisore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për analizimin e arsyeve të mos realizimit të shërbimit të pastrimit sipas kërkesave në kontratën përkatëse, duke i kërkuar kontraktorit realizimin e tyre, aplikimin e penalteteve për rastet e mos realizimit të kontratës dhe përlogaritjen e dëmeve të shkaktuara si pasojë e mos realizimit të kontratës.

Në vijimësi

18. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, ende mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit” Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plani i menaxhimit për veprime korigjuuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive.

“Menaxhimi i Riskut” Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, duke penguar marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performances financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit” Bashkia Vlorë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT.

“Informimi dhe komunikimi” Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Vlorë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

“Monitorimi” Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 260-270, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Vlorë, me atributet e Kryetarit të GMS dhe Nëpunësit Autorizues bashkë me Kordinatorin e Riskut, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave

nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Vlorë për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, duke mos audituar drejtoritë që mbartin risk të lartë. Për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, si dhe nuk ka bërë kontrollin e cilësisë për çdo auditim, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.6, faqe 270-272, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Vlorë të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje procedurave të lejeve të ndërtimit të fituara me vendim gjykates u konstatua se në 4 raste lejet e ndërtimit janë zbardhur vetëm me vendimin e shkallës së parë të gjykatës administrative Vlorë pa u ankimuar në shkallë të tjera të gjyqorit. Ky fenomen ka sjell edhe pasoja financiare për buxhetin e Bashkisë Vlorë, gjithashtu këto pasoja kanë ardhur edhe nga interpretimi i gabuar i vendimeve të gjykatës pasi në asnjë rresht gjykata nuk është shprehur për mënyrën e aplikimit të taksës ndikimit në infrastrukturë për këto subjekte, por vetëm për zbardhjen e lejes. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Juridike në do rast dhe situatë krijuar dhe agravuar për tu zgjidhur në Gjykatë duhet të bëhet mbrojtja e nevojshme dhe e domosdoshme e organit publik, për mënjanimin e efekteve financiare të kësaj natyre, juridike dhe administrative.

Drejtoria Juridike përpara do seance, gjatë hartimit të kërkesë padisë dhe mbrojtjes së nevojshme, të zëbraj juridikisht do hapësirë ligjore për të bërë një përfaqësim sa më dinjitoz në gjykatë dhe mënjanojë humbjet e gjyqeve.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje procedurave të lejeve të ndërtimit të fituara me vendim gjykates u konstatua se në 4 raste certifikatat e Përdorimit janë lëshuar me mangësi. Edhe pse gjatë verifikimit paraprak nga ana e Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit është njoftuar subjekti për mangësitë, pas riaplikimit pa asnjë dokument shtesë është lëshuar certifikata përdorimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

21.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit në do rast përpara nxejrrjes së certifikatave të përdorimit dhe do dokumenti tjetër apo akti administrativ të verifikohen rast pas rasti dokumentacioni i ngarkuar në sistemin E-Leje nëse janë në përputhje me kërkesat e legjisllacionin në fuqi. Të hartohen procesverbalet përkatëse dhe të informohen subjektet e interesuara.

Në do rast në momentin e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me certifikatë përdorimi nga ana e drejtorisë së planifikimit të territorit të verifikohet situacionit përfundimtar me preventivin fillestar dhe të mbahen diferencat nëse dalin.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka lëshuar lejen e ndërtimit miratuar me vendimin nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin "Hotel 6 kate me 1 kat bodrumö, në adresën Lagjen "Uji i Ftohtë", me zhvillues T.Z. projektuar nga A. D. C. me

liçencë nr. A. 1358, dhe Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin òHotel 6 kate me 1 kat bodrumö me zhvillues T. Z.

Leja e ndërtimit është miratuar në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit 107/2014, pasi nuk ka respektuar kushtin për infrastrukturën, duke propozuar aksesin në katin nëntokë në cënim të pasurisë 38/157, e cila nuk është në pronësi të zhvilluesit.

Në aplikimin me nr. AN060.....05 për "Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit", nuk është paraqitur një relacion i mbikëqyrësit mbi fazën e punimeve në të cilën ndodhej objekti në momentin e aplikimit. Nga imazheria e vitit 2019, objekti është plotësisht i përfunduar në fazë karabina dhe muraturë, duke përcaktuar kështu që miratimi i ndryshimeve në projekt është kryer pasi janë përfunduar ndryshimet në zbatim, në kundërshtim kjo me nenin 48 të ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe me Ligji nr. 8402, Datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitö i ndryshuar.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeö, IMT Bashkia Vlorë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr. 453, datë 22.09.2017 dhe pa aplikuar penalitetet ligjore përkatëse, gjithashtu edhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Vlorë, duke konfirmuar punimet e jashtëligjme të kryera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

22.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*" të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeö, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritö të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për vendosjen e penaliteteve ligjore ndaj subjektit zhvillues **T. Z.**, mbikëqyrësin, subjektin ndërtues dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka **zbardhur** lejen e ndërtimit nr. 95 datë 19.02.2020 për zhvilluesin **T.Z.B** òLeje për ndryshimin e subjektit zhvillues: òGodinë Banimi dhe shërbime 5 kate me 1 kat nëntokë, në lagjen uji i ftohtëö, miratuar me vendimin e KRRT të Bashkisë Vlorë nr. 5/95 datë 17.08.2010, me zhvillues subjektin òI.ö shpk me nr. Lic NZ. 4691/1, me afat zbatimi deri më 31.01.2014, por nuk ka filluar ndërtimin deri shkurt 2019. Për zgjatjen e afatit të punimeve Shoqëria òI.ö shpk ka aplikuar në portalin e-leje për shtyrje afati punimesh, kërkesë për të cilën është marrë vendimi nr. 753 datë 17.08.2019 dhe shtyrë afatin e përfundimit të ndërtimit deri në datë 10.12.2022, si dhe aplikuar në portalin e-leje për ndryshim subjekti zhvillimor, kërkesë miratuar me vendimin nr. 95 datë 19.02.2020 duke u ndryshuar subjekti zhvillues nga òI.ö shpk në òT. Z.Bö Shpk.

Subjekti aktual òT.Z.Bö Shpk, rezulton se ka vepruar në shkelje të lejes ndërtimore duke u penalizuar nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Vlorë, referuar procesverbalit nr. 10 datë 28.06.2021, konkretisht për shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit pasi kati nëntokë është ndërtuar mbi tokë, si dhe bërë referuar çështja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. 10224 prot. datë 02.07.2021 (Kallzim Penal). IMTV rezulton se me vendimin nr. 337 datë 07.07.2021, ka vendosur për dënim me gjobë të subjektit òT.Z.Bö, në vlerën prej 1,000,000 lekë, si dhe njoftuar zyrtarisht me shkresën nr. 10487 datë 09.07.2021, është bërë njoftimi i subjektit për dënimin me gjobë.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit ka marrë vendimin nr. 386 datë 13.08.2021 òPër prishje e objektit të kundërligjshëmö dhe me shkresën nr. 12340 datë 03.09.2021 ka kërkuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë òLëshimin e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobës nr. 337, date 07.07.2021 të I.M.T Bashkia Vlorë ndaj subjekti òT.Z.Bö, si dhe

bërë me dije subjekti për pezullimin e punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkëlqe të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues T.Z.Bö shpk, dhe mbikqyrësin ÒA. M.ö dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

23.2. Rekomandimi: Referuar shkëlqeve, parregullsive dhe zhvillimit të ndërtimit në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor, Bashkia Vlorë, të paraqesë kopje të plotë të gjithë dosjes të subjektit (òl.ö shpk dhe òT.Z.Bö shpk) dhe akteve të mbajtuara nga strukturat përgjegjëse, të cilat do jenë objekt shqyrtimi dhe verifikimi pas vënies në dispozicion të tyre nga KLSH.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit në AK e NSHP- Bashkia Vlorë, janë konstatuar shkëlqe të akteve ligjore e nënligjore të LPP, konkretisht:

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) NSHP- Bashkia Vlorë, për asnjë rast nuk është bërë i mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës.

- Të gjitha dosjet nuk janë të inventarizuara (numëruar) dhe dorëzuar në Zyrën e Protokoll/Arxivës.

- Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga NJHDT nuk janë mbajtur procesverbalet e hapave të zhvillimit të procedurës (*hapjes dhe vlerësimit të procedurës*).

- Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet përmbledhëse (*në rastet kur ato janë mbajtur*), nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit, arsyet e skualifikimit e tij.

- *Llogaritja e fondit limit:* Nuk disponohen asnjë dokumentacion mbi mënyrën e llogaritjes dhe argumentimin e cimeve të përdoruara, kërkesat e sektorëve, objekteve/segmenteve rrugore që do trajtohen, hartat e rrugëve ose trotuareve se ku do kryhet shërbimi, etj.

Gjithashtu, konstatohet se fondi limit është përcaktuar nga një person i vetëm dhe jo grup pune.

- Nga AK NSHP- Bashkia Vlorë, për periudhën e audituar institucioni **nuk** ka hartuar regjistrin vjetor të parashikimit të prokurimeve dhe për pasojë nuk është monitoruar e raportuar realizimi i tij.

- Në një pjesë të praktikave, nga anëtarët e NJHDT dhe KVO nuk janë plotësuar dhe nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit.

- Realizimi i procedurave të prokurimit, pa miratim me VKB dhe të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për rastet e investimeve, ku për vitin 2019 NSHP ka kryer procedurën me vlerë të vogël për blerje makine (investim), pa miratim në vlerën 900 mijë lekë.

- Në procedurën me objekt: “*Riparimi i pompës Ganz në hidrovorin e Qytetit Vlorë*”, mefond limit 1,983 mijë lekë ku fitues është shpallur shoqëria òR.M.K.ö me ofertë 1,560 mijë lekë, kontrata nr. 407/1, datë 12.11.2018 është lidhur më shpjegime se procedura të shpallet në buletin e APP.

Sipas sistemit SEP ajo është shpallur me datë 14.05.2019, pra afërsisht me 6 muaj vonesë.

- Nga NSHP- Bashkia Vlorë në rastet e procedura të prokurimit të shërbimit të rojeve private, nuk ka zbatuar VKM nr. 177, datë 04.04.2019 për krijimin e shoqërisë “*I. G.*” sha, për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronarë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKB nr. 141, datë 27.12.2018, kapitulli I, pika 10, si dhe nenet 50 ó 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar; udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19/01/2018 të MF *“Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”*, i ndryshuar; ligjin nr. 9154, datë 6/11/2003 *“Për Arkivatë”*; nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08/07/2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27/12/2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36 dhe pika 37; pika 2 të nenit 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, neni 61, neni 68- Raporti përmbledhës, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar; nenin 12 pika 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar, **nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; pika 1 dhe 4 të Udhëzimit të APP nr. 2, datë 27/01/2015 “Për hartimin e Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***

24.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për vitet 2018, 2019 dhe 2020 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

Në të gjitha rastet e hapjes së procedurave të prokurimit, Titullari i AK të nxjerrë Urdhër Prokurimi i cili duhet të miratohet në Degën e Thesarit Vlorë për garantimin e fondeve për zbatimin e kontratës, të nxirren urdhër për ngritjen e Njesisë së Hartimit të DST dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

24.2. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, për raste e zhvillimit të procedurave për shërbimin e ruajtjes së objekteve, fillimisht të kërkohet lidhja e kontratës me shoqërinë òl. G.ò sha, që përfaqëson shtetin si pronar dhe në rast mos përgjigje nga kjo e fundit të zhvillohen procedurat standarte të prokurimeve.

Menjëherë dhe vazhdimësi

25. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 ó 31.12.2019), nga NSHP-Bashkia Vlorë janë kryer gjithsej **80** procedura me vlera të vogla me fondit limit prej 33,927 mijë lekë dhe kontratë të lidhur prej 32,801 mijë lekë, me një diferencë prej 1,125 mijë lekë ose 3.3%, nga e cila: në vitin 2018 janë zhvilluar **46** procedura me fond limit 19,279 mijë lekë dhe vlerë kontrate prej 18,437 mijë lekë, për diferencën prej 1,842 mijë lekë ose 9.5%. Ndërsa për vitin 2019 janë zhvilluar gjithsej 34 procedura me fond limit 14,467 mijë lekë dhe vlerë kontrate prej 14,364 mijë lekë, me një diferencë prej 283 mijë lekë ose 1.9%.

Grupi i auditimit për periudhën objekt auditimi, duke vlerësuar të dhënat e materialitetit dhe riskut të auditimit, ka vlerësuar për auditim, gjithsej **54** procedura ose 67% e procedurave me vlerë kontrate 29,612 mijë lekë ose 90% e kontratave.

Nga auditimi i realizuar në dokumentacionin e bankës, për pagesat e kryera dhe dokumentacioni ligjor dhe teknik bashkangjitur **për blerje malli/ shërbimi me vlera të vogla**, rezulton se:

e- Nga ana e Autoritetit Kontraktor (NSHP- Bashkia Vlorë), për periudhën e audituar, nuk është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike.

f- Në përcaktimin e fondit limit për mallra/ shërbime, nga praktikat e audituara nuk u konstatuan se ku është mbështetur KBVV në përcaktimin e fondi limit, pasi nuk tregohet se cila nga mënyrat është përdorur, nuk disponohet hartave e rrugëve/trotuareve që në fillim se ku do kryhen punimet, volumi i punës që kërkojnë këto segmente dhe sasia e materialit që nevojitet për to, bazuar në manualët përkatëse, nuk ka kërkesa të sektorëve apo komunitetit në lidhje me nevojën e kryerjes së shërbimit të riparimit të rrugëve/trotuareve, etj, konstatuar kjo në të gjitha praktikat e audituara.

g- Në disa raste të blerjeve të realizuara, faturat e subjektit nuk janë plotësuar me të gjitha elementet që kërkon fatura, kishte raste që këto fatura nuk janë firmosur nga blerësi, apo të firmosura nga një person i vetëm dhe nuk janë firmosur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla.

h- Në rastet e procedurave me objekt *“Blerje pjesë këmbimi”*, mallrat e blera **nuk** janë bërë hyrje në magazinën e NSHP dhe për këtë lloji procedure (blerje/shërbim pjesë makine/eksploratori), nga NSHP janë kryer një numër i konsiderueshëm procedurash si me vlera të larta dhe të vogla, pa një studim të mirëfilltë se sa janë nevojat për kryerjen e shërbimit të mjeteve të NSHP.

Gjithashtu për vitet 2018 dhe 2019, përveç procedurave me vlerë të vogël, për riparimin e mjeteve janë kryer dhe procedura me vlerë të lartë, ku *për vitin 2018* kemi **një** procedurë me fond limit 1,200 mijë lekë dhe *për vitin 2019* janë **2** procedura me fond limit 1,888 mijë lekë.

Nga tabela shihet që kemi dhe copëzim të fondeve, veprime të cilat kanë çuar në shmangien nga procedura me vlerë të lartë, pasi vlera e mallrave apo dhe grup mallrave që janë blerë apo dhe shërbimeve të realizuara kanë tejkaluar vlerën e përlllogaritur gjatë vitit kalendarik, prej 800,000 lekë pa TVSh.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* me ndryshime; nenin 40 *“Procedura e prokurimit me vlera të vogla”* pika 7; Kreu VII *“Zyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”*, pika 2 e nenit 59 *“Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* ndryshuar; Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 27.01.2015 *“Për hartimin e Regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrimit të realizimeve të prokurimit publik”*, me ndryshime, ndryshuar me Udhëzimet APP nr. 5 datë 16.07.2013 dhe nr. 1, datë 28.02.2014, pika 1 dhe 4, si dhe pika 5 e Udhëzimit të APP nr. 3 datë 08.01.2018 *“Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”*. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

25.1. Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të llogaritjes së fondit limit vetëm nëpërmjet një metode (*testimit të tregut*) dhe me dokumentacion jo të saktë ligjorë, si dhe të eliminohen rastet e zhvillimit të procedurave të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve të të njëjtit lloj.

Menjëherë dhe në vijmësi

26. Gjetje nga auditimi: Për vitin ushtrimor 2019 në pasqyrat financiare të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (NSHP) Vlorë, rezulton se nuk janë përfshirë vlera të konsiderueshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të trashëguara nga Ndërmarrja e gjelbërimit-bordi i kullimit, si dhe nuk i janë përfshirë vlerat e aktiveve nga ish Parku i Autobuzëve, për të cilat disponohen pasqyrat financiare të mbylljes në vitin 2018, por bilanci i tij nuk është përfshirë në bilancin e NSHP. Marrja në dorëzim e aktiveve nuk është bërë e plotë, pasi komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur nga titullari i NSHP, nuk ishte përbërë nga specialistë të fushës. Gjithashtu disa vlera në llogari të ndryshme të bilancit nuk dihet çfarë përfaqësojnë, pasi nuk janë të shoqëruara me analiza apo relacione shpjeguese. Pra pasqyrat financiare të NSHP nuk pasqyrojnë gjendjen reale financiare të gjithë Ndërmarrjes. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandim: Titullari i Ndërmarrjes së Shërbimeve publike, të autorizojë ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale të trashëguara nga Bordi i Kullimit dhe ish parku i Autobuzëve. Sektori i Financës të marrë masa për të kontabilizuar këto aktive materiale të trashëguara dhe përfshirjen e tyre në pasqyrat financiare të NSHP-së dhe nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Vlorë të bëhet sistemimi në kontabilitet dhe të përfshihen aktivitetet e trashëguara nga ish ndërmarrjet në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

27. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të NSHP, gjendja e llogarisë 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”* në mbyllje të vitit 2018 dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë që llogaria kundërpasiv në pasiv të bilancit 467 *“Kreditorë të ndryshëm”* paraqitet me gjendje në mbyllje të vitit 2018 në vlerën 10,477,577 lekë dhe në mbyllje të vitit

6,321,579 lekë, llogari këto të cilat duhet të rakordojnë. Për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve debitorhetllogaria 486 *Shpenzime të periudhave të ardhshme* në kredi të llogarisë 467 *Kreditorë të ndryshëm* (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandim: Nga sektori i financës së NSHP të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr. 486 *Shpenzime të periudhave të ardhshme* për shumën 6,321,579 lekë për vitin ushtrimor 2019 dhe për shumën 10,477,577 lekë për vitin 2018. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2020.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

28. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të NSHP, referuar analizës së llogarisë nr. 212 *Ndërtesa dhe Konstruksione* konstatohet se për këto aktive nuk janë kryer inventarë të plota dhe të jenë mbajtur regjistra aktivë për të evidentuar ekzistencën fizike të tyre, pasi ka një numër të konsiderueshëm të objekteve të llojit vend-strehime dhe tunele që arrijnë vlerën kontabël prej 22,100,846 lekë, por nga ndërtimet e reja një pjesë e tyre nuk ekzistojnë. Nuk paraqitet një relacion shpjegues në mënyrë të tillë që të evidentojë ekzistencë e këtyre aktiveve. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandim: Nga Ndërmarrja e Shërbimit Publik (nëpunësi autorizues), të marrë masa për ngritjen e një komisioni për evidentimin e aktiveve të cilat nuk paraqitet ekzistenca e tyre si pasojë e ndërtimeve të reja, hartimin e një relacioni shpjegues dhe rivlerësimin e tyre.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

29. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të NSHP, në gjendjen e llogarisë nr. 214 *Makinë dhe pajisje*, rezultojnë të jetë e përfshirë vlera kontabël e një kompjuteri të llojit "laptop", për të cilin është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 29, datë 02.12.2019, bazuar në faturën nr. 219, datë 02.12.2019 së furnitorit OE òM.ò. Fatura rezultojnë të jetë e pasqyruar në analitikun e llogarisë nr. 401 *Furnitorë e llogari të lidhura me toò*, si e pa likuaduar. Nga magazinierja e NSHP-së nuk është bërë dalje, duke mos prerë fletë dalje, si rrjedhojë presupozohet që laptop-i është gjendje në magazinë. Nga verifikimi rezultojnë se ky laptop nuk është më pjesë e aktiveve të NSHP-së, pasi i është kthyer furnitorit, ky veprim mbështetet nga procesverbali i datës 05.01.2020, i mbajtur ndërmjet përfaqësuesve të NSHP-së dhe administratorit të OE òM.ò, për marrjen në dorëzim nga ana e furnitorit të laptop si dhe mos pagesa për likuidimin e faturës deri në datën 15.01.2021, veprimet për shkarkimin e magazinës do të quhen të plota me prerjen e fletë-daljes nga magazina në emër të furnitorit si dhe momenti i anulimit të faturës në sistemin e tatim-taksave në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë, dhe konfirmimin nga ana e furnitorit. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1. Rekomandim: Sektori i Financës në NSHP-së Bashkia Vlorë, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet, duke e shkarkuar pajisjen të llojit òlaptopò, nga llogaritë e pagueshme 401 *Furnitorë e llogari të lidhura me toò*, në momentin e prerjes së fletë-daljes nga magazinierja në emër të furnitorit, si dhe të kërkohet konfirmim nga ana e furnitorit dhe anulimi i faturës në Drejtorinë Rajonale Tatimore.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

30. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të NSHP, gjendja e llogarisë nr. 4341 *Operacione me shtetin (detyrime)* paraqitet e pandryshuar në fund të vitit 2018 dhe në fund të vitit 2019 në vlerën 1,934,531 lekë, e cila nuk dihet se çfarë përfaqëson, duke qenë se kjo llogari paraqitet në pasiv të pozicionit financiar duhet të përfaqësojë detyrimin që NSHP-ja i ka Shtetit për të ardhurat e konstatuara dhe të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

Për këtë vlerë kontabël nuk ka analizë dhe relacion shpjegues, pasi kjo vlerë është trashëguar në vite dhe mungon informacioni nga dokumentacioni mbështetës. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1. Rekomandim: Nga Sektori i Financës së NSHP-së, të merren masa për të kryer analizimin e gjendjes që paraqitet në llogarinë nr. 4341 *Operacioni me shtetin (detyrime)*, duke kryer një relacion shpjegues për vlerën kontabël që paraqitet në vitet ushtrimore 2018 dhe 2019, se cilat janë detyrimet që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

31. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit, u auditua ankesa e z. D. H., i cili është posedues i pasurisë me nr. 14/104-Nd, ZK 8603 Vlorë, me sipërfaqe ndërtimi 166.5 m². Kjo pasuri është shpronësuar me VKM nr. 277, datë 02.05.2019 në funksion të projektit publik *“Rikonstruksion i oborrit të shkollës “Ali Demi”, Vlorë”*. Vlera e shpronësimit është në shumën **8,796,650 lekë**, dhe sipas pikës 4 të VKM-së së mësipërme, kjo shumë do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë. Ky shtetas rezulton se ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë Bashkisë Vlorë, tek Sektori i Shpronësimeve, dhe kërkon likuidimin e shumës së shpronësimit.

Bashkia Vlorë, ka kryer 2 urdhra shpenzimesh në emër të z. D. H., urdhër shpenzimi nr. 51, datë 30.01.2020 në shumën 2,000,000 lekë, me përshkrimin *shpronësim për oborrin e shkollës Ali Demi*, si dhe urdhër shpenzimi nr. 704, datë 23.07.2020, me përshkrimin *kthim shume takse ndikimi në infrastrukturë për oborrin e shkollës Ali Demi*. Sipas urdhrit të brendshëm nr. 165, datë 21.07.2020 rezulton se vlera prej 2,400,000 lekë është bërë në zbatim të vendimit nr. 992, datë 26.09.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë si rikthim i vlerës së trualli. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.8, faqe 276-282, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

31.1. Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrin masa për shpronësimin e vlerës së mbetur ndaj shtetasit D.H. Të parashikohet vlera e mbetur në Projekt Buxhetin e vitit 2022.

Menjëherë

32. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit, u auditua ankesa e z. R. R., i cili paraqet problematikën e shkaktuar nga një servis në rrugën *ogjergj Arianitiö*.

Sa më sipër, rezulton se çështja objekt ankese, është kompetencë e Policisë Bashkiake të Autoritetit Vendor, Bashkia Vlorë, veprimtaria e së cilës rregullohet me ligjin Nr. 8224, datë 15.05.1997 *öPër organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiakeö*.

Nga audituesit e KLSH-së, pasi u kërkua informacion nga Policia Bashkiake në lidhje me situatën faktike, u dhanë menjëherë rekomandimet për zgjidhjen e kësaj shtete dhe u monitorua trajtimi i kësaj problematike. Në përgjigje të kësaj ankese, përfaqësuesit e policisë bashkiake shkuan menjëherë në aktivitetin Person Fizik M. M., *öRiparime mekanikeö* me NUIS L467.....1S, ku mbajtën një Akt e Kontrolli (bashkëlidhur), për kundërvajtjen *öZënie e Hapësirës Publikeö*, në bazë të ligjit Nr. 8224, datë 15.05.1997 *öPër organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiakeö*, neni 8, dhe kërkuan nga ana e subjektit: *1. Lirim të menjëhershëm të trotuarit dhe lulishtes; 2. Në rast rikonstatimi marrjen e masave që parashikon ligji; 3. Mbajtjen në monitorim të zonës nga shërbimet e policisë bashkiake.* *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.8, faqe 276-282, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

32.1. Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Policia Bashkia, krahas lirit të hapësirave publike të zaptuara në mënyrë të paligjshme, të marrë masa të menjëhershme për të ndaluar edhe ndotjen dhe zhurmat që shkaktohen nga ky lloj aktiviteti. Përveç sa më sipër, të verifikojë dokumentacionin në bazë të së cilit ky P.F. ushtron profesionin e mekanikut, sipas kërkesave të nenit 4, *öRegjistrimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari autoriparimiö* pika 4 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 *öPër autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me toö* për tu pajisur me vërtetimin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vlorë nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar

tarifën pastrim-gjelbërim-ndricimit në masën prej 40,000 lekë/vit për 58 subjekte (adresë dytësore), të cilat kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë dhe NJA-ve për llogari të subjekteve private të pajisur me leje ndërtimi, për pasojë nuk është arkëtuar **vlera prej 2,320,000 lekë**. Gjithashtu nuk janë kryer veprimet për ngarkuesën me detyrime dhe faturimin për tarifën pastrim-gjelbërim-ndricimit në masën 30,000 lekë/vit për 19 subjekte ndërtimi që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të cilët janë operator fitues të tenderave në Bashkinë Vlorë për kryerje punimesh ndërtimi, për pasojë nuk është arkëtuar **vleraprej 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 2,890,000 lekë**.

Ndërsa, në **61 raste subjekte** me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit 4000lekë/vit, **por nuk janë arkëtuar në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore ò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, dhe meVKB nr.100, datë 28.12.2017 dhe VKB nr.109, datë 27.11.2019 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë ò pika 3, germa òcò nënpika 4 dhe 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

33.1.Rekomandimi:Strukturat drejtuese të Bashkisënëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Njësinë Prokurimit të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruarra për vitet 2018-2019-2020-2021, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësi Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës së kësaj tarife prej **2,890,000 lekë**si edhe marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve debitore në vlerën **2,280,000 lekë**.

Menjëherë

34.Gjetje nga auditimi: Në kohën e sezonit turistik për vitet 2018-2019 nga Kapiteneria e Portit Vlorë për 11 operatorët Turistikë që operojnë me mjete lundruese janë raportuar hyrje të 22733 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,546,600 lekë dhe për vitin 2019 janë raportuar hyrje të 29684 turistëve me tarifë bilete të pavjelur në vlerën 5,936,800 lekë, për vitin 2020 janë raportuar hyrje të 22939 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 4,587,800 lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2021 janë raportuar hyrje të 3932 turistëve me tarifë bilete të pavjelë në vlerën 589,800 lekë, **duke sjellë në total të ardhura të munguara me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

34.1.Rekomandimi:Bashkia Vlorë nëpërmjet DTTV të përcaktojë procedurën e menaxhimit të ardhurave të gjeneruara nga vizitorët turistikë në Parkun Kombëtar Sazan-Karaburun, duke përcaktuar agjentin tatimor për shpërndarjen e biletave dhe arkëtimin e vlerës së tyre nga operatorët turistikë nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes mes palëve.

Menjëherë

34.2.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë nxjerrjen njoftim-vlerësimin e detyrimeve si dhe ndjekjen e arkëtimin të kësaj tarife për periudhën 2018-2019-2021 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt i taksave dhe tarifave të tjera vendore. Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë nxjerrjen njoftim-vlerësimin e detyrimeve **për vlerën**

15,661,000 lekë, si dhe ndjekjen e arkëtimit të kësaj tarife për periudhën 2018-2019-2021 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt i taksave dhe tarifave të tjera vendore.

Menjëherë

35.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qiradhenies për tokat e pandara rezulton se, në 97 raste të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë dhe kamatëvonesë në vlerën **64,290,775 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë**, kështu:

Nga ish-Komuna Qendër për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie të tokave bujqësore të pandara, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjecar dhe 1 kontrate me afat 50 vite.Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **7,670,532 lekë gjithsej**.

Nga ish-Komuna Shushicë për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjecar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekë gjithsej**.

Nga ish-Komuna Novoselë për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Të dhënat e këtyre kontratave janë të paraqitura në tabelën në bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën prej **49,621,292 lekë**.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 dhe 5 të kontratave dhe me kërkesat ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 òPër tokat bujqësore të pandaraò VKM nr. 531, datë 21.08.1998 òPër tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 òPër tokat bujqësore të pandaraò. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

35.1.Rekomandimi:Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave të NJA-ve, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike të marrë masa për monitorimin dhe rishikimin e kontratave për subjektet private që janë debitorë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për anulimin e kontratave që nuk janë aktive si dhe ndjekjen e arkëtimit e detyrimeve debitorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

36.Gjetje nga auditimi: Me VKM nr. 433 datë 08.0.2016 òPër transferimin në pronësi të të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkiveò i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Vlorë pyjet dhe kullota që shtrihen në territorin e saj.

Për menaxhimin e këtyre pasurive nga Bashkia Vlorë nuk është përpiluar dhe miratuar plan i ri mbarështrimit të pyjeve e kullotave e për pasojë mungojnë dhe planet operationale vjetore. Sipas Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave shkaqet janë:

- a. Transferimi i pyjeve dhe kullotave nuk është realizuar në masën 100% si fond kadastral me VKM nr. 433 datë 08.0.2016, pasi ngastrat nga nr. 59 deri nr. 65, të ekonomisë pyjore Tragjas-Shëngjergj, kanë mbetur jashtë shtojcës nr. 61 të kësaj VKM-je.
- b. Gjithashtu procesi i transferimit shoqëruar me problematiken e konflikteve midis komunave

apo bashkive në lidhje me grup ngastrash pyjore/kullosore që shtriheshin në kufi të tyre, ka kushtëzuar dhe penguar regjistrimin e kësaj pasurie pranë ZRPP. Kështu duke mos qenë pronarë të këtyre pasurive pengohet edhe përgatitja e planeve të mbarështrimit të pyjeve në bazë të ligjit të ri nr. 57/2020 datë 30.4.2020 *oPër Pyjetë*.

Ngaish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, aktualisht strukturë e Bashkisë Vlorë (Sektori i Pyjeve dhe Kullotave) në këtë fond pyjor janë në fuqi 2 kontrata të dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, të ndodhura në Njësinë Administrative Shushicë me afat 10 vjet. Kontratat janë lidhur me subjektin V. N. dhe subjektin oB. S. shpkö. Subjekti oB. S. shpköme administrator Kastriot Bashaj, ***nuk janë paguar detyrimet kontraktore në vlerën 694,000 lekë*** për vitet 2018-2021 në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 5 *o*pagesaö dhe me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 *oPër përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotaveö*, pika 5/1.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 *oPër pyjet dhe shërbimin pyjorë i ndryshuar*, neni 11/ç ,neni 20, me ligjin nr.5/2016 datë 04.02.2016 *oPër shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisëö*neni 3 pika 1/a,c, me VKM nr.438, datë 08.06.2016 *oPër kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pjore e jo pyjorëö*Kreu II, Kreu III pika 16 dhe 18, Kreu VIII pika 36, me neni 5 të kontratës të datës 05.07.2013 të lidhur me subjektin oB. S.ö shpk dhe me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 *oPër përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotaveö*, pika 5/1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

36.1.Rekomandimi:Strukturat drejtuese të Bashkisë në mbështetje të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave të fillojnë procedurat për hartimin e planeve në mbrojtje të pyjeve, në zhvillimin e ankandeve për pastrimin e Pyllit të Sodës nga drurët e rrëzuar, thyer apo shkukur nga era apo prerja e drurëve si edhe ndërhyrje rigjeneruese higjieno-sanitare.

Menjëherë

36.2.Rekomandimi:Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës debitore **prej 484,000 lekë, nga subjekti “B. S.”** Shpk qiramarrës i parcelës pyjore 10b;11b me sipërfaqe 1.1 ha dhe nëse nuk plotësohen kushtet e kontratës për pagesën e tarifës së qirasë të merren masa deri në anulimin e kësaj kontrate.

Menjëherë

36.3.Rekomandimi:Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Sektori Pyjeve dhe Kullotave të marrë masa për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës debitore **prej 210,000 lekë, nga subjekti “N.”** Shpk.

Menjëherë

37.Gjetje nga auditimi:Aplikacioni TAIS dhe kodi në burim i tij nuk janë regjistruar si aset. Kodi në burim oTAIS VLORË Source Code FOBö dhe oTAIS VLORË Source Code Textö ju dha Bashkisë nga OE pas kërkesës grupit të auditimit për informacion. *(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

37.1.Rekomandimi:Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore të marrë masa për vlerësimin dhe regjistrimin si aset të sistemit TAIS dhe kodin në burim të tij.

Menjëherë

38.Gjetje nga auditimi:Prodhuësi i sistemit TAIS ka shoqëruar sistemin me rregullore dhe manuale për përdoruesit dhe administratorët të cilat nuk janë të miratuara nga ana e Bashkisë Vlorë. Në mbështetje të kërkesave kryen ndryshime të sistemit dhe zhvillime në përputhje edhe me ndryshimet e legjislacionit në fuqi ndryshimet nuk janë pasqyruar në këto manuale.Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 *oPër vetëqeverisjen vendoreö* (i ndryshuar), neni 64, *oKompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisëö*, pika j. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

38.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për miratimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të Rregulloreve dhe manualeve të Aplikacionit

39.Gjetje nga auditimi: Në kontratën e datës 14.05.2018 prot nr. 3733 *ōMirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit të taksave vendore* janë përcaktuar përfaqësuesit e palëve për mbarëvajtjen e kontratës, por nuk ka urdhër të titullarit për caktimin e personave të autorizuar për marrjen në dorëzim të shërbimeve. Nuk ka raporte periodike të marrjes në dorëzim të shërbimit,

Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (MNSH) me kompaninë I. B. S. sh.pk të datës 14.05.2018 prot nr. 3733 dhe ajo e datës 20.05.2019 prot nr. 4382 nuk janë caktuar tregues të matshëm të shërbimit.

Nga auditimi i këtyre procedurave rezultoi se Marrëveshjet e Nivel Shërbimit (Kontrata e datës 20.05.2019 prot nr. 4382 *ōMirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit të taksave vendore Bashkia Vlorë* dhe atë të datës 14.05.2018 prot nr. 3733 *ōMirëmbajtje e sistemit elektronik të menaxhimit të taksave vendore*), janë lidhur me afat 1 (një) vjeçar, në kundërshtim respektivisht me pikën 3 (*“Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e TIK-ut, detyrimisht, të parashikojnë MNSH-në, si pjesë të procedurës së realizimit të investimit për këto sisteme. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.”*) dhe pika 4 (për sistemet e ekzistuese të **lidhet jo me pak se 2 vjet**) të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 *ōPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimitō*, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se në të gjitha MNSH nuk përfshihen: *koha e raportimit; koha e përgjigjes; prioriteti; përshkallëzimi.*

Veprime në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit nr. 1159, datë 17.03.2014 *ōPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimitō*, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

39.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore në vijimësi të marrë masa për përfshirjen në kontratat e mirëmbajtjes së sistemit elementët e listuar në Udhëzimin nr. 1159, datë 17.03.2014 *ōPër hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimitō*, i ndryshuar, si dhe të dokumentojë shërbimin e marrë nëpërmjet raporteve periodike.

Në vijimësi

40.Gjetje nga auditimi:TAIS funksionon në një rrjet Lan me firewall, switch dhe mikrotik të pa konfiguruar.

firewall dhe mikrotiku ishin risetuar me konfigurimin e fabrikës pasi kredencialet i kishte një punonjës i larguar.

Nga auditimi u konstatua se Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Taksave Vendore të Bashkisë Vlorë nuk ka rregulla të shkruara për hapjen dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin TAIS

-Përdorimi i user Administrator në db e TAIS-it dhe mos konfigurimi i pajisjeve mbart riskun e hyrjes së pa autorizuar dhe gjetjen e passëordeve me skripte të automatizuara.

Përdorimi i pajisjeve të risetuara me konfigurimin e fabrikës mbartin riskun e aksesit të lehtë pasi rëndom prodhuesit e dhe rrjetet sociale japin kredencialet e hyrjes në to.

-Nuk ka raporte të problemeve/incidenteve dhe aksesit të paautorizuar.

-Nuk ka Politikat dhe Rregullat e shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit

-Konfigurimi i sistemit nuk dokumentohet

-Nuk ka Procedura formale për menaxhimin e risqeve dhe Regjistër të risqeve.

-Infrastruktura netëork në Sistemin e administrimit të taksave TAIS të bashkisë Vlorë funksionon pa *Active Directory* dhe *Domain Controller* për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet e praktikave të mira të fushës.

Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit). Politikat dhe procedurat formojnë një mjedis të qëndrueshëm menaxherial për komunikimet e brendshme dhe të jashtme. (Ref. ISO-27002, S15-IT control (Standardet e

ISACA-s), COBIT). ISO 9001 menaxhim, identifikimi i riskut mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

-Në sistemin e administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është konfiguruar back-up i DB periodik, çdo 1 muaj.

Sistemi i administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë nuk ka plan të miratuar emergjence dhe politika të vazhdimësisë së punës dhe rimëkëmbjes për proceset kritike, backup-i i bazës së të dhënave kryhet në të njëjtin ambient me bazën e të dhënave primare (ambienti i serverëve). *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

40.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) duke vlerësuar burimet të marrë masa për krijimin e Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendëruar të sigurt, kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për hartimin e regjistrit të risqeve që kërcënojnë infrastrukturën TI si dhe të ngrejë mekanizma për reduktimin në mënyrë efektive dhe eficiente të risqeve të rëndësishëm.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masat e nevojshme për hartimin e procedurave të menaxhimit të problemeve dhe incidenteve, si dhe procedurave për iniciimin, rishikimin dhe miratimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë për kryerjen e ndryshimeve.

-Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për konfigurimin firewall, switch dhe mikrotik të sistemit TAIS (dhe rruajtjen e konfigurimeve) në përputhje me rekomandimet e prodhuesve e standardet e praktikave më të mira të fushës.

40.2.Rekomandimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme të marrë masa për hartimin e Planit të Vazhdimësisë dhe Planit të Rikuperimit, duke përfshirë planet për backup dhe rimëkëmbjen nga katastrofat për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.

Menjëherë

41.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) nuk ka miratuar gjurmën e auditimit si dhe nuk ka asnjë dokumentim të rrjedhës së informacionit *ōworkflowō* për hapat që kryhen nëpërmjet sistemit informatik TAIS. Bashkia Vlorë, nuk ka dokumentuar gjurmën e auditimit për rrjedhën e transaksioneve financiare dhe të tjera, si një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së çdo procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë, jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për të verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Veprime në kundërshtim me Neni 4, pika 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollinō*, *ōGjurma e auditimitō*, Neni 16, pika 2 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollinō*, janë titullarët e njësive publike që miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

41.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë (Drejtoria e Tatimeve dhe Tarifave Vendore), të hartojnë, dokumentojnë dhe miratojnë gjurmën e auditimit të sistemit TAIS, ku të jenë identifikuar procedurat dhe operacionet që ndjek sistemi me qëllim qartësinë dhe kuptueshmërinë e mjedisit të kontrollit.

Menjëherë

42.Gjetje nga auditimi: Siguria sistemit të administrimit të taksave TAIS të Bashkisë Vlorë është e kompromentuar si rezultat i mungesës së Ambienteve të pa përshtatshme për zhvillimin e infrastrukturës IT.

Ambienti fizik i dhomës së rrjetit nuk është në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në Rregulloren për Ndërtimin e Dhomës së Serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit). *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

42.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe Tarifave Vendore) të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomave të serverave në përputhje me praktikat më të mira si dhe standardet e përcaktuara në bazë të VKM nr. 248, datë 27.04.2007 *“Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.*

- Me qëllim rritjen e efektivitetit dhe evidencës në administrimin e automatizuar të proceseve të regjistrimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve taksapaguesve në qytetin e Vlorë, sistemi TAIS ndërvepron me ëbservise me QKB dhe gjendjen Civile.

Ky ndërveprim është realizuar me qëllim që ndryshimet e të dhënave në lidhje me subjektet në këto sisteme të mund të merren me shpejt nga bashkia dhe të ngarkohen në sistemin e taksave të bashkisë.

Menjëherë

43.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (TAIS) në Bashkinë Vlorë rezultoi se për periudhën e auditimit nga data 01.01.2018 deri 30.06.2020 janë kryer veprime stornimi (Credit Note) nga specialistët e pranimit/vlerësimit në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem.

Këto veprime stornimi u kryqëzuan me procesverbalet e mbajtura për çdo veprim stornimi, nga të cilat rezultoi se nga **1302** stornime në sistemin TAIS nuk janë mbajtur procesverbale për **1097 stornime**. *(stornimet në total në mënyrë të detajuar paraqiten në CD.*

Për periudhën **01.07.2020 deri në 30.06.2021**, janë kryer **153 stornime** (credit note) nga specialistët e pranimit në lidhje me rivlerësimin tatimor të subjekteve fizik/juridik të rregjistruara në sistemin TAIS, nga të cilat **8 stornime janë kryer pa procesverbal**.

Për **205** stornime të mbajtura me procesverbale u konstatuan parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsyet e veprimeve.

- Gjithashtu krahas stornimeve të specialistëve u konstatua ndërhyrje edhe nga vetë user-i i ish Drejtuesit të DTTV-së për llogari të subjekteve që mbulohen nga vetë specialistët e rajoneve të ndryshme.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni nr. 4/26; Ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik, neni nr. 3; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 35 “Dokumente të kontabilitetit, pika nr. 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

43.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese të Bashkisë të marrin masa për të ngritur një komision për hartimin e një rregulloreje të brendshme ku të specifikohet mënyra e mbajtjes së dokumentave elektronikë dhe gjurma e auditimit të tyre për DTTV-në.

-të ngrihet një komision për verifikimin e stornimeve për secilin punonjës së DTTV-së dhe nxjerrjen e përgjegjësive për rastet ku ndryshimi i detyrimit financiar (stornimi) është i pa mbështetur në dokumentacion shkresor.

-Nga Titullari i Institucionit, të bëhet i mundur trajnimi i punonjësve të DTTV-së, gjatë vitit ushtrimor ekzistues me qëllim për të arritur përdorim korrekt, eficient dhe profesional të sistemit TAIS.

-Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, të merren masa që për rastet kur për ndryshimin e vlerës financiare (stornim), mungon dokumentacioni shkresor, të nxirren përgjegjësitë dhe të analizohet vlera financiare dhe dëmi i shkaktuar.

Menjëherë

44. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave të DTTV-së Vlorë me të dhënat e siguruar nga website zyrtar i QKB-së rezulton se:

Ka një diferencë të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të subjekteve aktivë të regjistruar nga DTTV e Bashkisë Vlorë me sistemin TAIS krahasuar me numrin e përgjithshëm të regjistruar në QKB.

Sipas të dhënave të QKB-së, në territorin e Bashkisë Vlorë deri në 30.06.2020 rezultojnë 6,000 subjekte ndërsa sipas sistemit TAIS rezultojnë aktiv 5210 subjekte, pra me një diferencë prej rreth **800 subjekte** të pa regjistruara në sistemin TAIS, si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal. Kjo vërteton mungesën e bashkëpunimit me institucionet, mungesën e përgjegjshmërisë dhe punën e pamjaftueshme të menaxhimit dhe punonjësve të DTTV-së Bashkia Vlorë.

Veprime në kundërshtim me ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni nr. 4 òZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 41 òIdentifikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregare pa u regjistruar, neni nr. 43 òPërditësimi i të dhënave të regjistrimit. òRregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 òDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimit tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 òSektori i pranimi dhe kontabilitetit tatimor, neni 106 òDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimit të detyrimit tatimor për biznesin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

44.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, sektori i kontrollit në terren të marrë masa për evidentimin dhe regjistrimin e të gjithë subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Vlorë, për evidentimin e subjekteve që deklarojnë mbyllje nëse është i saktë ose jo, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe pa regjistruar në QKB.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, në fund të periudhave ushtrimore të marrë informacion zyrtar nga QKB dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e saktë të subjekteve fizik/juridik që janë aktiv dhe mbi bazën e xhiros të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore sipas Vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Menjëherë

45. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe analizimi i raporteve të gjeneruara nga sistemi TAIS për periudhat ushtrimore 2018 dhe 2019 u konstatua se: Ka subjekte të cilat rezultojnë të ngarkuara me taksat dhe tarifa vendore gjatë vitit ushtrimor 2018 ndërsa në vitin 2019 edhe pse vazhdojnë të jenë aktive sipas sistemi TAIS nuk janë taksuar dhe tarifuar nga punonjësit e pranimi që kanë akses në sistem.

Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar një mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë si pasojë e keqmenaxhimit dhe punës së pa përgjegjshme të specialistëve pranimi/vlerësimit dhe specialistëve të kontrollit në terren. Nga përpunimi i këtyre të dhënave Grupi i Auditimit konstatoi se janë **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni nr. 4 òZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr. 9920

datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nenin nr. 41 ëIdenfitikimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregare pa u regjistruarë, nenin nr. 43 ëPërditësimi i të dhënave të regjistrimitë, ëRregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 ëDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimi tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 ëSektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimorë, neni 106 ëDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimi të detyrimit tatimor për biznesin. (Më hollësisht trajtuar në III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

45.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, sektori i vlerësimi të marrë masa për tarifimin me taksat dhe tarifave vendore, për të gjithë subjektet e pa ngarkuar për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020.

Menjëherë

46. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS u konstatua se ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë në disa raste edhe mbi dy vjet, ndërkohë që këto ngarkesa dhe njoftim vlerësimet/faturimet sipas VKB-ve të miratimit të paketave fiskale duhet të kryheshin deri në muajin prill të vitit ushtrimor. Për rrjedhojë kjo ka shkaktuar eliminimin e të drejtës së llogaritjes së kamatëvonesave për detyrimet e papaguara, përgjegjësi direkte e specialistëve dhe drejtorit të DTTV-së.

Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mërpashme për shkak sepse janë shkelur të gjitha afatet ligjore për rrjedhojë dhe pagesat e këtyre taksave dhe tarifave vendore.

Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 *ËPër sitemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni nr. 4 ëZbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë, Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ëPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni nr. 68 ëVlerësimi tatimorë, neni nr. 69 ëNjoftimi i vlerësimi tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimorë, neni nr. 114 ëMospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributitë, ëRregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104 ëDrejtori i Drejtorisë së Regjistrimit, vlerësimi tatimor, mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore, neni 105 ëSektori i pranimit dhe kontabilitetit tatimorë, neni 106 ëDetyrat dhe përgjegjësitë e Specialistit të vlerësimi të detyrimit tatimor për biznesin (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

46.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ngrihet një grup pune për të përlllogaritur efektin e dëmit të shkaktuar nga mos aplikimi i kamatëvonesave gjatë periudhës objekt auditimi si rrjedhojë e veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifa vendore jashtë periudhave ushtrimore dhe me vonesë nga specialistët e vlerësimi.

-Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa të kërkojë në formë shkresore shoqërisë që ka implementuar sistemin TAIS, të gjitha kamatëvonesat e gjeneruara nga sistemi për vitet objekt auditimit.

Menjëherë

47. Gjetje nga auditimi: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për periudhen objekt auditimi paraqitet me një performancë të dobët realizimi, kështu: *për vitin 2018*, të ardhurat nga 1,116,782 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 711,580 mijë lekë, ose në masën 63.7%. *Për vitin 2019*, të ardhurat nga 1,266,151 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 684,100 mijë lekë, ose në masën 54% *për vitin 2020*, të ardhurat nga 1,248,027 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 740,016 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 508,011 mijë lekë, ose realizuar në masën 59% dhe *për 6-mujorin e I të vitit 2021* të ardhurat nga 844,160 mijë lekë planifikuara, janë realizuar 503,035 mijë lekë, pra ka një mosrealizim në shumën 341,125 mijë lekë, ose realizuar në masën 60%. Në 6-mujorin e I të vitit 2021, niveli i realizimit paraqitet i

kënaqshëm krahasuar me vitet 2020, 2019 dhe 2018, ku të ardhurat vjetore janë realizuar përkatësisht 59%, 54% dhe 63.7%

Nga analiza e të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim, duke ndikuar negativisht në realizimin e tyre. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave, e konkretisht:

Taksë trualli për vitin 2018 realizuar në masën 145%, në vitin 2019 në masën 105% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 90%

Tarifë tregu për vitin 2018 realizuar në masën 100%, në vitin 2019 në masën 259% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 86%

Taksë table reklame për vitin 2018 realizuar në masën 19%, në vitin 2019 në masën 55% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 101%

Taksë parkimi për vitin 2018 realizuar në masën 78%, në vitin 2019 në masën 56% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 46%.

Taksë bujqësore për vitin 2018 realizuar në masën 36%, në vitin 2019 në masën 26% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 15%.

Taksë e fjetjes në hotel për vitin 2018 realizuar në masën 89%, në vitin 2019 në masën 45% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 11%.

Taksë e zënies së hapësirave publike për vitin 2018 realizuar në masën 74%, në vitin 2019 në masën 41% dhe në 6-mujorin e parë të vitit 2020 në masën 32%.

Nga krahasimi i të dhënave të akt-rakordimit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore me Drejtorinë e Buxhetit, Kontabilitetit dhe Financës dhe aktrakordimin me Degën e Thesarit rezulton se për disa taksa dhe tarifa si takse table dhe reklame, takse e fjetjes në hotel, takse trualli dhe tarife tregu, nuk rakordojnë, pasi të dhënat nga DTTV nuk janë të sakta, sepse evidentimi i taksave dhe tarifave vendore është mbajtur ekstra-kontabël.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, me udhëzimin i MFE nr.9 datë 20.03.2018 për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të Kreu IV, pika 200, me ligjin nr.68/2017 datë 27.4.2017 për Financat e Vetëqeverisjes Vendore të ndryshuar, nenet 5 dhe 54/ nenpika c, me udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të Kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a,b.

-Të ardhurat në DTTV mbahen ekstra-kontabël, thjesht në një program excel, referuar ditarit të të ardhurave të mbajtur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe bëhet rakordimi mujor me dy drejtoritë. Evidentohen vetëm arkëtimet për çdo debitor në Sistemin TAIS, dhe më pas Sistemi TAIS gjeneron debitorët, por për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë në kontabilitet, megjithëse nga specialistja e Kontabilitetit në DTTV është bërë relacion Drejtorit të DTTV në fund të vitit ushtrimor, ku ky i fundit nuk ia ka dërguar Qendrës Ekonomike për kontabilizim edhe përfshirjen e vlerës së debitorëve të shoqëruara me analizën e tyre në Pasqyrat Financiare të viteve 2018-2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

47.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë hartimit të projektplanit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale duke analizuar rezultatet dhe pritshmëritë, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë ndjekjen dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Drejtorisë së Buxhetit, Kontabilitetit dhe Financës.

Menjëherë

48.Gjetje nga auditimi: Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë, rezultoi se ka një sasi të konsiderueshme debitorësh nga biznesi,(për taksën e

ndërtesës, tabelës, hoteli, trualli, reklame, zënie hapësirë publike, tarife pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarife veterinarie e kamatëvonesë), **deri në 6-mujorin e parë të vitit 2021, numri i debitorëve është 3984 në vlerën 315,203,292 lekë.** Nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në momentin e krijimit të tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018 duke filluar nga viti 2011, janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektsh debitorë me shumë progresive të debisë deri në fund të 2017, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Kjo listë megjithëse është mbajtur në programin excel nuk përbën dokument vërtetues, sipas përcaktimeve në UMF 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë Kreu III dhe Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre në njësitë e sektorit publikë. Megjithëse e mbajtur jashtë kontabilitetit lista e detyrimeve debitorë nuk është e printuar, e nënshkruar nga personat përgjegjës dhe e volusor, e inventarizuar dhe arkivuar, duke lenë shteg për abuzim. ***Për kryerjen e këtyre veprimeve si nga specialistet e pranimit ashtu edhe nga specialisti i IT, nuk është marrë asnjë masë dhe konstatohet se kjo listë nuk është azhurnuar ende në sistemin TAIS.***

Gjatë periudhës 6-mujori i I, i vitit 2021, shihet qartë se është reflektuar ulje e numrit të subjekteve debitorë dhe është ulur edhe vlera e debisë për debitorët e kontabilizuar deri në datën 31.12.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

48.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me specialistin e IT, specialistët e pranimit dhe kontabilitetit, të marrë masa për evidentimin, pasqyrimin dhe azhurnimin në sistemin TAIS të subjekteve debitorë për vitet 2011-2018, si edhe duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizikë/juridikë për detyrimet e pambledhura ndaj **3984 subjekte** në vlerën prej **315,203,292 lekë.**

Menjëherë

49.Gjetje nga auditimi: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme **Vlera progresive në fund të 6-mujorit të I të vitit 2021, prej 315,203,292 lekë,** përfaqëson taksat dhe tarifave vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë Nga Sektori i Borxhit **për vitin 2018** janë bërë 1195 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 1107 njoftime për vendosje të masave siguroese, 1084 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 186 masa ekzekutuese (kalim gjendje llog, bankare në llog.Bashkisë). **Për vitin 2019** janë bërë 1192 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 968 njoftime për vendosje të masave siguroese, 968 masa shtrënguese e 119 masa ekzekutuese. **Për vitin 2020** janë bërë 872 njoftim-kërkesë të pagesës së debisë dhe 587 njoftime për vendosje të masave siguroese, 2319 masa shtrënguese në Banke, Zvrpp, Ksha dhe Qkb, si dhe 163 masa ekzekutuese. **Për 6 - mujorin e I të vitit 2021** janë bërë 1172 njoftim kërkesë për pagesë të debisë dhe 630 njoftime për vendosje të masave siguroese, 1310 masa shtrënguese në Bankë dhe Qkb, si edhe 79 masa ekzekutuese.

Nga DTTV për subjektet debitorë në asnjë rast nuk është bërë konfiskimin jo më pak se 50% e qarkullimit të realizuar ditore si dhe nuk janë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk ka Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë apo kallëzim penal për debitorët që nuk paguajnë me vite. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

49.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara nga subjektet fizikë/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 3984 subjekteve në vlerën 315,203,292 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 *“E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”*, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për Procedurat tatimore”* me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër procedurat tatimore Republikën e Shqipërisë me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, DPTTV të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana DTTV dhe Drejtoria Juridike Bashkia Vlorë, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Menjëherë

50.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe verifikimi i listave të subjekteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, pranë Drejtorisë së Taksave Vendore në lidhje me pajisjen e subjekteve që kanë aplikuar për pajisjen me leje për shfrytëzimin e veprimtarisë së hapësirave të plazhit, u konstatua se nga Bashkia Vlorë janë pajisur me kuponin për të nënshkruar kontrata 17 subjekte që rezultojnë me detyrime të papaguara në shumën 3,298,091 lekë për vitin 2020 dhe 17 subjekte në shumën 2,337, 534 lekë për 2021.

Referuar emrave të subjekteve konstatohet se janë pothuajse të njëjtët subjekte të pajisur me kuponin e pagesës për të 2 vitet, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr.171, datë 27.03.2019 òPër miratimin e rregullores òPër kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, neni 5 òKriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhitò pika3/d.

Pra, nga Drejtoria e mësipërme e ngarkuar për mbledhjen e të ardhurave nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, dokumentacioni i mbajtur nuk jep mundësinë për të gjeneruar situatën për detyrimet e subjekteve, kontratat e nënshkruara dhe dokumente të tjera të cilat përcaktojnë gjurmën për auditim. Veprime në kundërshtim VKM nr.171, datë 27.03.2019 òPër miratimin e rregullores òPër kushtet e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, neni 5 òKriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhitò pika3/d. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

50.1.Rekomandimi:Drejtorja e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve të bashkëpunojë me Drejtorinë e Taksave Vendore duke kryer verifikimet për çdo subjekt që aplikon për tu pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirave të plazhit dhe pasi të jetë marrë konfirmimi me shkrim të vazhdojë procedurat për kryerjen e pagesës dhe lidhjen e kontratës.

Menjëherë

51.Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Vlorë, KLSH ka njoftuar Bashkinë Vlorë me shkresën 1005/74, datë 20.12.2018. Bashkia Vlorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH, nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu nuk është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në shkelje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò. Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se: Nga 17 masa shpërblim dëmi për vlerën **85,871,776lekë** lekë, janë zbatuar plotësisht 2 masa në vlerën **172,365 lekë**, janë në procese gjyqësore 12 rekomandime në vlerën **54,981,287 lekë**, janë nisur njoftimet për 3 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet ose proceset gjyqësore në vlerën **1,404,980 lekë**, Janë audituar nga Auditi Brendshëm sipas rekomandimit të KLSH, dhe janë konsideruar dëme të paargumentuara 4 rekomandime në vlerën **26,286,015 lekë** dhe nuk është marrë asnjë masë për 2 rekomandime në vlerën **2,770,926 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.7, faqe 272-276, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

51.1.Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Vlorë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën 1005/74, datë 20.12.2018 *ōPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Vlorë*, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës. Të hartohet plan pune i veçantë e të marren të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

52.Gjetje nga auditimi: Nga struktura e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, vërehet se në strukturë nuk ka specialist kontabiliteti në DAV. Sektori i borxhit dhe kontrollit në terren, është i paplotësuar me inspektorë terreni në çdo rajon. Në një drejtori të rëndësishme sikurse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore (e cila luan rol të rëndësishëm në mbledhjen e të ardhurave) ka mungesë personeli në sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit.Për periudhën e auditimit, konstatohet se për 6-mujorin e I të vitit 2021, është shtuar Sektori i Taksës së Pasurisë me 16 persona.

Për këtë sektor nuk ka të përcaktuar me rregullore detyrat që do të kryejnë sipas emërtesës së vendit të punës dhe nuk evidentohet të jetë kryer punë konkrete për taksën e pasurisë për familjarët. Ndërkohë këta punonjës kanë punuar në terren si inspektorë terreni sipas planeve të punës miratuar nga kryetari i bashkisë për çdo muaj për DAV dhe urdhërat e dhëna nga drejtori i drejtorisë, në bazë të domosdoshmërisë për punonjës në mbarëvjetjen e punës për realizimin e të ardhurave, pra pa u përcaktuar detyrat funksionale të këtij sektori me rregullore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

52.1.Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë, Strukturat Drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e strukturës së Drejtorisë së të Ardhurave Vendore me specialistë të fushës në Sektorin e përpunimit të të dhënave dhe atë të pranimit, kryesisht me specialistë kontabiliteti tatimor si edhe për Sektorin e borxhit dhe kontrollit në terren me inspektorë terreni.

Menjëherë

52.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Strukturat Drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndryshimin e Rregullores së organizimit, funksionimit detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, përshtatjen e strukturës me detyrat që do të kryejnë punonjësit sipas emërtesës së vendit të punës, venien në koherencë të rregullores (e vitit 2018) me ndryshimet që kanë ndodhur në strukturë me qëllim mbarëvjetjen e mirë të punës, realizimin e të ardhurave dhe përcaktimin e saktë të detyrave funksionale të çdo punonjësi dhe pozicioni pune.

Menjëherë

D. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në Ligjin nr.44/2015 *ōKodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë*, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.30, datë 27.12.2011 *ōPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, nga Titullari i njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa dhe të nxirren aktet administrative përkatëse, si dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **32,180 mijë lekë**, si më poshtë:*

1.Gjetje nga auditimi: Këshilli i Bashkisë Vlorë ka miratuar me Vendimin nr.100 datë 22.12.2017 paketën fiskale e cila ka qenë në zbatim për vitin 2018-2019 në pikën 6 nënpika 11 të VKB nr.100 datë 22.12.2017 *parashikon: “nivele e tarifës Bilete Hyrje per vizite ne ishullin e Sazanit në vlerën 200lekë/personi. Çdo Drejtori kryen mbledhjen e tarifës përkatëse sipas shërbimit që kryen para ofrimit të tij”*. Për periudhën 7-mujore të vitit 2018 biletat menaxhoheshin nga vetë Bashkia, në bazë të dokumentacionit financiar hyrje-dalje dhe gjendje

magazine të vënë në dispozicion nga Qendra Ekonomike të dhënat për lëvizjet e biletave turistike, rezulton në këtë periudhë konstatohet se z.R. C. i ngarkuar për shitje biletash nuk ka shitur apo kthyer në magazinë 148 bileta, **duke mos justifikuar vlerën e pa arkëtuar prej 29,600 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Me VKB nr. 84 datë 26.07.2018 menaxhimi i biletave dhe arkëtimi i vlerës së tyre do të kryhej nga mjetet transportuese të operatorëve ekonomikë turistikë që operojnë në Portin e Vlorës. Referuar VKB nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë një Urdhër për përcaktimin e procedurave të pajisjes me bileta të subjekteve transportues dhe arkëtimin të të ardhurave si dhe mungon një marrëveshje mes palëve. Nga Drejtoria e Tatim-Taksave Vendore Vlorë nuk është ndjekur arkëtimi i kësaj tarife për periudhën 2018-2019 nga subjektet turistike, të cilat janë objekt edhe i taksave dhe tarifave të tjera vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të arkëtojë nga z. R. C., vlerën prej **29,600 lekë**, vlerë e 148 biletave (çmim 200lekë/personi) të pa shitura dhe të pa arkëtuara apo të pa kthyer në magazinë.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka lëshuar certifikatën e përdorimit nr. 594, datë 19/10/2020 për objektin "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1-kat parkim nen toke (faza 1) në lagjen 1 maji" Vlore- Seksioni D (banim); E (hotel)ö me adresë në lagjen 01 Majiö, paraqitur nga zhvilluesi K.R.K., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.3/102 datë 07.06.2010 të KRRT Bashkia Vlorë me afat deri më 21.12.2013,si dhe me zgjatje afati leje 4 herë, përkatësisht me Vendim nr.57 datë 29.04.2014 öPër zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimitö, me Vendim nr. 331 datë 30.06.2017 öPër zgjatje afati për lejen e ndërtimitö, Vendim nr.1240 datë 05.12.2017 öPër zgjatje leje afati ndërtimitö dhe Vendim nr. 442 datë 22.07.2020 me afat 22.01.2020, ndryshim të projektit gjatë zbatimit me Vendim nr. 602 datë 04.01.2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë öKompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "1 Maji" Vlorëö, si edhe me Vendim nr.543 datë 25.09.2020 për miratim ndryshim funksioni öKompleks Banimi dhe Shërbimesh 5-6 Dhe 7 Kate Me 1 Kat Parkim Nëntokëö, ku (Seksioni E) Ndryshon Destinacion Nga Banim, Ne Funksion te Turizmit, Hoteleri.

Sipas Aktit të kolaudimit të objektit hartuar nga K. K. me nr. Lic.MK.045...2, dokument i cili është firmosur edhe nga mbikqyrësi dhe nga Investitorit vlera faktike e punimeve është paraqitur:**91,374,950.4 lekë objekti D me funksion Banim dhe 681,721,999.5 lekë objekti E me funksion Hotel**, pra vlera faktike e punimeve është **773,096,949.9 lekë**.

Nisur nga preventivi i paraqitur vlera e preventivuar e objektit është **297,430,885 lekë**, ndërsa nga akti i kolaudimit të objektit vlera përfundimtare për të dy seksionet D dhe E është **773,096,949.9 lekë**.

Vlera reale dhe përfundimtare e investimit përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit, pra për **diferencën 773,096,949.9 ó 297,430,885 = 475,666,064.9 lekë**, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Bashkia Vlorë me faturën me nr.700 datë 08.10.2020 është përlllogaritur 3% e vlerës por jo mbi shumën **475,666,064.9 lekë, duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Vlorë me vlerë 14,269,981.947 lekë, dhe përfitimit të padrejtë të subjektit "K.R.K." shpk. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)**

2.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **14,269,981.947 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik "**K.R.K.**" shpk.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile òRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimëo, është nënshkruar ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe Kontraktorit òA.ò SHPK, me nr. 5142 prot., datë 06.04.2021, me vlerë 15,547,968 lekë.

Nga verifikimi i punimeve të kontratës së punimeve civile òRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimëo konstatohet se sipas zërit 5. An122 òVijëzim me shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, bojë bikomponente (sprajt)ò, është certifikuar sasia 1850 ml, me çmim 200 lekë/ml, ndërkohë që ky punim nuk është realizuar. Vlera 370,000 lekë (1850 ml x 200 lekë/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori òA.ò SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 4.An1 òShtresë asfaltobetoni me gur kave, 4 cm, me makineriò është certifikuar sasia 7585 m², me çmim 770 lekë/m². Sasia është përlogaritur duke marrë për bazë gjerësinë mesatare 4.1 m. Nga verifikimi në disa seksione të rrugës, rezulton se gjerësia fillon nga 3.5 m dhe gjerësi më të madhe se 4.1 (marrë për mesatare), në seksione të caktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për zbritjen nga garancisë e punimeve të vlerës **370,000 lekë**përfituar padrejtësisht nga Kontraktori òA.ò SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

3.2.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, përpara përfundimit të garancisë së punimeve, të analizojnë dhe të nxjerrin rezultatin e plotë të volumeve të shtresave asfaltike të realizuara, duke zbritur vlerat përkatëse nga garancia e punimeve, në rast të konstatimit të diferencave në sasi.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi:Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës òRikonstruksion i rrugës Llakatund-Beshishtösa i përket zërit òKonstruksione për urë metalike këmbësore + llamarinë e kodrinuar + bojatisjeò, megjithëse kontrata ka përfunduar me datë 30.07.2021, ato ishin në ndërtim e sipër. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve pretendohet se punimet e konstruksioneve metalike përkatëse kanë qenë realizuar me cilësi të dobët dhe është urdhëruar zëvendësimi i tyre. Nga verifikimi rezultoi se punimet për masat e sigurisë në urë nuk ishin realizuar, megjithëse është certifikuar sasia 1.58 ton, me çmim 241,760 lekë/ton. Në momentin e auditimit po punohej për vendosjen e tyre.

Me datë 12.11.2021, nga mbikëqyrësi i punimeve u paraqit dokumentacion mbi realizimin e punimeve për konstruksionet metalike, fotografi pas përfundimit (më hollësisht paraqitet në aneks).

Pavarësisht sa më sipër, kemi të bëjmë me punime të realizuara pas njoftimit për përfundimin e punimeve. Nga ana e grupit të auditimit nuk mund të konkludohet në lidhje me peshën e realizuar, apo sigurinë që ofrojnë punimet, të cilat nuk i janë nënshtruar kolaudimit. Nga dokumenti fotografik konstatohet se nuk është vendosur llamarinë e valëzuar (guardrail). Në këto kushte, deri në përcaktimin saktë nga një komision përkatës të përputhshmërisë së realizimit të punimeve me specifikimet teknike të përcaktuara në rishikimin e projektit, vlera 381,981 lekë (1.58 ton x 241,760 lekë/ton), konsiderohet se është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori òA.ò SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi:Bashkia Vlorë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të marrë masa për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së punimeve për realizimin e konstruksioneve metalike. Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të **vlerës 381,981 lekë**, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori òA.ò SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Financës, Magazina dhe Dega Teknike në NSHP- Bashkia Vlorë, në lidhje me sasinë e karburantit të bërë hyrje-dalje dhe gjendje për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, konstatohet se:

Për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, janë bërë hyrje gjithsej në sasinë 203,737 litra (naftë/benzinë) për vlerën 32,988,916 lekë, nga e cila: gjendje nga viti 2017 në sasinë 32,453 litra, në vitin 2018 janë bërë hyrje 46,605 litra, në vitin 2019 janë bërë hyrje 73,106 litra dhe në 6 mujorin e parë 2020 janë bërë hyrje 51,573 litra.

Nga magazina janë bërë dalje në Sektorin Teknik me përgjegjës ing. E. H., mbi shpërndarjen e karburantit sipas mjeteve që NSHP- Bashkia Vlorë, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, gjithsej sasia 202,481 litra, nga e cila: në vitin 2018 në sasinë 76,688 litra, në vitin 2019 në sasinë 75,255 litra dhe në 6 mujorin e parë 2020 në sasinë 50,568 litra.

Sipas të dhënave, konstatohet se janë bërë hyrje gjithsej 203,737 litra (naftë/benzinë) dhe bërë dalje në adresë të ing. E. H. sasia prej 202,481 litra (naftë/benzinë), me një diferencë të paargumentuar prej **1256 litra**.

Mos dokumentimi i sasisë së mallit prej **1256 litra** (karburantit) me dokumentacion, as gjendje dhe sa dalje, janë veprime financiare **me efekt financiar negativ me vlerë 211,887 lekë (1256 litra x 168.7 lekë/litri, çmim mesatar)**.

Gjithashtu, konstatohet se sasia e marrë nga z. E. H. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit Teknik, nuk rezulton të jetë bërë dalje mjeteve të NSHP ose të jetë gjendje.

Sipas magazinës është furnizuar me sasinë 202,480 litra dhe është bërë dalje mjeteve të NSHP sasia prej 198,967 litra, diferenca e paargumentuar në sasinë prej 3,513 litra (karburantit), janë veprime **me efekt financiar negativ me vlerë 592,643 lekë (3,513 litra x 168.7 lekë/litri, çmim mesatar)**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me **ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”** dhe pikat 35/b, 36, 34 ó 41 dhe 52- 60, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë, me ndryshime.(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, me grup pune të analizojë situatën mbi gjendjen e karburantit të bërë hyrje-dalje dhe gjendje në magazinë dhe në përfundim të procesit të inventarizimit për diferencën e konstatuar të kërkohet shpërblimi i dëmit në shumën **804,530 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët në ngarkim të personave përgjegjës, konkretisht:

- **vlera 211,887 lekë**, në ngarkim të punonjësës **znj. A. B.** me funksion magazinierë.
- **vlera 592,643 lekë**, në ngarkim të punonjësit **ing. E. H.** me funksion Përgjegjës i Sektorit Teknik.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga grupi i auditimit u auditua listëpagesat e periudhës 01.01.2018 ó 30.06.2020. Nisur nga natyra e veprimtarisë së NSHP- Bashkia Vlorë, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për punë jashtë orarit, pagesa këto të kryera sipas urdhrorit të lëshuar nga Drejtori i NSHP dhe procesverbali të hartuar nga përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve z. P. A.

Sipas të dhënave të listëpagesave, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, konstatohet se janë paguar dhe punonjës të administratës, pagesa këto të kryera dhe ditë festash dhe në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme nga situata COVID-19, dhe lëvizjet kanë qenë të kufizuara dhe vetëm me leje nga e-Albania, gjithsej për shumën **235,435 lekë, veprime me efekt financiar negativ në dëm të fondeve buxhetore**, në kundërshtim me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”* i ndryshuar, dhe nenet 88 dhe 90, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”*, me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë në

bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **285,585 lekë**, në ngarkim të punonjësve sipas tabelës:

Nr.	Emri Mbiemri	Pozicioni	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1	G. Sh.	Drejtor	15,890		
2	E. H.	ing. Sek Teknik	32,218	46,660	21,924
3	M. K.	Inxhinier	0	9,483	
4	A. M.	Tekin Sek. Teknik	13,516	18,288	
5	A.H.	Llog. Pagash	23,985	8,494	
6	A. B.	Magaziniere	16,350	2,243	
7	E. B.	arkivist	10,900		
8	J. H.	Ekonomiste	10,240		
9	F. Xh.	P/Sektori	8,125		
10	J. H.	Inxhinier	9,695		
11	P.A.	Përgjegjës	9,348		16,297
12	E.L.	Përgj. Sek.Gjelbrimi			7,224
13	Z.M.	Përgj. Sherbime NJA Qendër			4,705
Shuma			150,267	85,168	50,150

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “*Rehabilitim i trotuareve të rrugës Demokracia, faza 2*”, me fondi limit në shumën 3,184,936 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur shoqëria òC.ò me vlerë kontrate 2,771,200 lekë pa TVSH, u konstatua se:

Nga të dhënat e Sektorit të Financës mbi pagesat e kryera të kontratës nr. 146, datë 11.06.2018, rezulton se kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve (afateve), prej **30-61 ditë** dhe nga NSHP Bashkia Vlorë nuk janë zbatuar penalitete për mos mbyllje në afat të kontratës në vlerën **538,196 lekë** pas TVSH, veprime financiare me dëm ekonomik.

Sipas kontratës punimet duhet të mbyllen në afatin 30 - 61 ditë ose nga datë 11/06/2018 deri me datë 11/08/2018. Nga të dhënat objekti nuk është mbyllur sipas këtyre afateve.

Kështu situacioni nr. 2 me vlerë 397,077 lekë është paraqitur me **79** ditë vonesë, kjo sipas faturës nr. 26, datë 29/11/2018 dhe detyrimi i përlllogaritur për kamatëvonesën paraqitet: $397,077 \times 4/1000 \times 97 \text{ ditë} = \mathbf{125,476 \text{ lekë}}$ pa TVSH.

Ndërsa situacione nr. 3 me vlerë 874,407 lekë pa TVSH është paraqitur me **118** ditë vonesë, kjo sipas faturës nr. 27, datë 18/12/2018, ku detyrimi për kamatëvonesë paraqitet: $874,407 \times 4/1000 \times 118 \text{ ditë} = \mathbf{412,720 \text{ lekë}}$ pa TVSH.

Gjithsej detyrim kamate pa llogaritur paraqitet në shumën 538,196 lekë pa TVSH ($125,476 + 412,720$), vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Vlorë, duke për shpërblim dëmi shoqërorinë “C.”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Financës në NSHP, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **538,196 lekë** në ngarkim të shoqërisë “C.”, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 146, datë 11.06.2018.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës me objekt “*Pastrim kanali ujitës Kallfet, krahu majtë pjesa II, km 2500-4+694*”, me fondi limit në shumën 2,885,740 lekë pa TVSH, ku fitues është shpallur shoqëria òL.ò ShPK me vlerë kontrate 2,537,891 lekë pa TVSH, u konstatua se:

Nga auditimi i dosjes së zbatimit dhe likuidimit të situacione, konstatohet se punimet nuk kanë përfunduar sipas afateve të përcaktuar në nenin 4 të kontratës nr. 263, datë 25.07.2019, konkretisht:

Referuar PV punimet ato kanë filluar me datë 25.07.2019 dhe përfundojnë me datë 25.08.2019.

Sipas bankës janë kryer 2 pagesa, si vijon

1. Me USH nr. 213, datë 20/9/2019 është likuiduar vlera pjesore 1,191,344 lekë me TVSH,

sipas faturës nr. 41, datë 2/9/2019;

2. Me USH nr. 251, datë 15/10/2019 është likuiduar vlera e mbetur prej 1,854,125 lekë me TVSH, sipas faturës nr. 2, datë 24/9/2019.

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se kontrata nuk është zbatuar sipas kushteve (afateve), të përcaktuar prej 20-30 ditë dhe nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe mbikëqyrësi nuk janë zbatuar penalitete për mos mbyllje në afat të kontratës në vlerën **304,547 lekë** pa TVSH, veprime financiare me dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi **ing. M. K., I. Ç. dhe F. Xh., si dhe mbikëqyrësi shoqëria "I.18" me ing. I. S.**

Referuar të dhënave që paraqisni në kundërshtitë tuaja, paraqitur me shkresën nr. S'ka, datë 23.2.2022 (prot KLSH nr. 731/44, datë 24.2.2022), nga shoqëria "L." ShPK, si dhe bazuar në dokumentacionin shoqërues, rezulton se:

Shoqëria "L." ShPK, ka paraqitur shkresë për mbyllje punimesh me nr. 3, datë 24.9.2019, ose **30 ditë me vonë se data e përfundimit (datë 25.8.2019).**

Nga sa trajtuam më sipër për mos përfundim në afat të punimeve, nga mbikëqyrësi i punimeve nuk janë zbatuar penalitet në vlerën **304,547 lekë pa TVSh** (2,537,891 x 4/1000 x 30 ditë vonesë), vlerë e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e NSHP- Bashkisë Vlorë, për shpërbllim dëmi shoqërinë òL.ö(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Financës në NSHP, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **207,030 lekë** në ngarkim të shoqërisë "L." ShPK, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 263, datë 25.07.2019.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2021, janë arkëtuar të ardhura në formën e tarifave të qirasë nga 550 subjekte që shfrytëzojnë hapësirat e plazhit, mbi bazë kontratash, akt-marrëveshjesh dhe kërkesash të depozituara pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe të Menaxhimit të Aseteve dhe të aplikimit në sistemin elektronik të ngritur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në paketat fiskale të miratuara me VKB.

Për vitin 2018 janë faturuar për tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit 178 subjekte për një sipërfaqe prej 61534m², në bazë kontratash, aktmarrëveshjesh dhe kërkesash për shfrytëzim hapësira plazhi, duke mos lidhur kontrata sipas dispozitave ligjore në 93 raste, ku nga këto në 8 raste subjekteve në vlerën **prej 710,000 lekë në Radhimë – Orikum** dhe në 3 raste në plazhin **Zvërnec** në vlerën **162,400 lekë nuk kanë paguar tarifën e qirasë** për sipërfaqet e plazhit që kanë shfrytëzuar, të cilat në mungesë të kontratave, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, duke mos u klasifikuar në detyrime kontraktore për tu ndjekur ligjërisht për arkëtim. Gjithashtu nga shqyrtimi i dosjeve rezultoisë në 2 raste është bërë kontraktim i gabuar për sipërfaqe më të vogël se sipërfaqja sipas plan-rilevimit të paraqitur, duke sjellë **mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 778,000 lekë sipas kontratave të subjekteve:** M. M. për sip më në vlerën 768,000 lekë dhe V. N. në vlerën 10,000 lekë, për mospagesë në vlerë të plotë.

Nga kampionimi për auditim i 37 dosjeve për vitin 2018 dhe 46 dosjeve për vitin 2019 dhe nga testimi i tyre u konstatuan mangësi si:

Ka 93 raste moslidhje kontratash me subjektet, ndërsa në rastet e lidhjes së kontratave janë lidhur kryesisht në muajt korrik dhe gusht, dhe jo në fillim sezoni (në maj).Në disa raste subjektet nuk kanë paraqitur vërtetimet për detyrimet që kanë ndaj DPTR Vlorë dhe DTTV, ose në disa raste të vërtetimeve të paraqitura subjektet figurojnë debitorë. Në një pjesë të rasteve mungojnë ekstrakti i QKB apo Plan-bizneset. Në shumë raste në dosje mungonin faturimet apo pagesat e kryera. Në një pjesë të madhe kontratat nuk janë shoqëruar me planvendosje, por edhe kur ishin nuk evidentoheshin përmasat e parcelës dhe përcaktimet e largësive, nga vija e

bregdetit, mes cadrave hapësira publike. Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar. Mungonin aktet e verifikimit në terren për sipërfaqet sipas kontratës dhe nëse është ruajtur raporti 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publik.

Për vitin 2019 janë faturuar për tarifa për qira nga zënia e hapësirave publike në zonën e plazhit 212 subjekte për një sipërfaqe prej 63,648 m², në bazë kontratash, aktmarrë veshjesh, ku nga këto 2 subjekte paraqiten debitorë: A. K. në vlerën 20,000 lekë dhe Sh. G. në vlerën 50,000 lekë. Ndërsa nga shqyrtimi i dosjeve rezultuan diferenca në sipërfaqe nga ajo e kontraktuar referuar plan-rilevimeve si dhe faturime detyrimesh në vlera më të vogla se detyrimet kontraktore mbi bazën e të cilave janë kryer dhe pagesat më pak se vlera e kontratave, në vlerën 744,000 lekë për 4 raste kontratash sipas subjekteve: A. Xh. në vlerën 20,000 lekë, F. M. në vlerën 194,000 lekë, L. F. në vlerën 50,000 lekë, A. Z. në vlerën 480,000 lekë, **pra në total duke sjellë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 814,000 lekë.**

Për vitin 2020 nga autorizimet e miratuara për stacione plazhi rezulton se në 1 rast subjekti ÕI. P. Õ ka një sipërfaqe prej 3405 m² në shfrytëzim hapësirë plazhi në Zvërnec, i cili është faturuar me tarifën e qirasë prej 200 lekë/m² /sezoni dhe jo me 400 lekë/m², tarifë e përcaktuar në paketën fiskale për këtë zonë plazhi, **duke sjellë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 681,000 lekë.** Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 27.3.2019 për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit Õ i ndryshuar me VKM nr. 424 datë 27.05.2020 nëni 14 pika 10, nën-pika b. me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit Õ nëni 4 pika 3, nëni 5 pika 1, nëni 4 pika 8, me VKM nr. 321 datë 28.05.2014 për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore Õ i ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, Kreu III pika 9, Kreu IV pika 1 shtojca B-3, me VKB nr. 100, datë 22.12.2017, për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë Õ Kreu II, me kontratën nëni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit të marrë masa për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve në llogaritë debitore dhe nëpërmjet Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e Drejtorisë Juridike të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,145,400 lekë**, nga subjektet e individ privatë.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Referuar pagesave të bëra me bankë, u konstatua se punimet për “Rehabilitim i kanalit Kallfet dhe Babicë Vlorë, VLU-9 Babicë - Dega djathtas”, nuk janë mbyllur sipas afatit të përcaktuar në DST dhe kontratë, për 60 ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës. Pra nga data 15.11.2019 deri me datë 15.01.2020.

3. Me USH 108, datë 26/3/2020 është likuiduar situacione i parë në vlerën 2,615,671 lekë me TVSH, kjo sipas situacionit të shoqëruar me faturën nr. 277, datë 13/12/2019. Faturë e likuiduar brenda kushteve të kontratës.

4. Me USH 176, datë 8/6/2020 është likuiduar situacione nr. 2 për vlerën 3,941,797 lekë me TVSH, kjo sipas situacionit të shoqëruar me faturën nr. 283, datë 28/2/2020. Faturë e likuiduar jashtë afatit.

Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga AK NSHP - Bashkia Vlorë nuk janë llogaritur penalitete për mos përfundim në afat të punimeve për vlerën **564,991 lekë** (3,284,831 lekë x 4/1000 x 43 ditë vonesë), si dëm ekonomik në buxhetin e NSHP- Bashkia Vlorë, veprime në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 400/4, datë 15.11.2019 (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Financës në NSHP, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **564,991 lekë** në ngarkim të shoqërisë “S.” ShPK, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr.

11. Gjetje nga auditimi: Referuar kontratës nr. 124/3, datë 14.06.2019 me objekt “Blerje dhe transport betoni, marka 16/20”, malli duhej dorëzuar brenda 90 ditë nga nënshkrim i saj, ose nga datë 14.06.2019 deri me datë 14.09.2019.

Referuar dokumenteve të bankës, malli është likuiduar me USH nr. 232, datë 04.10.2019 në shumën 1,210,440 lekë. Bërë hyrje me FH nr. 50, datë 03.10.2019, sipas faturës së subjektit òC.ò nr. 48, datë 03.10.2019 me nr. Seri 75881504.

Nga sa trajtohet malli është bërë hyrje jashtë afatit të përcaktuar në kontratë për **19 ditë vonesë** dhe nga NSHP- Bashkia Vlorë, nuk janë llogaritur sanksionet për mos dorëzim të allit në afat në masën 4/1000 ditë vonesë, konkretisht:

1,008,700 lekë pa TVSH x 4/1000 ditë vonesë x 19 ditë = **76,661 lekë pa TVSH**, me dëm ekonomik në buxhetin e NSHP- Bashkia Vlorë, veprime në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 124/3, datë 14.6.2019. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Financës në NSHP, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **76,661 lekë** në ngarkim të shoqërisë “C.” ShPK, për mos zbatim në afat të punimeve sipas kontratës nr. 124/3, datë 14.6.2019.

12.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë ka lëshuar çertifikatën e përdorimitnr. 448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òObjekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hoteleriò Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 10.03.2019.

Sipas dokumentacionit të paraqitur ne platformën e-leje vlere e preventivuar e objektit është 78,846,423 lekë, ndërsa nga situacioni përfundimtar vlere përfundimtare e punimeve të objektit është 89,922,203 lekë. Referuar legjislacionit në fuqi vlere reale dhe përfundimtare e investimit përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit.

Për diferencën 89,922,203 – 78,846,423 = 11,075,780 lekë, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë, pra duhej të paguanin 4% * 11,075,780 = 443,031.2 lekë.

Nga Bashkia Vlorë kjo taksë në faturën me nr.489 datë 22.07.2020 nuk është përlllogaritur, duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Vlorë me vlerë **443,031.2 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **443,031.2 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “A. S.”

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlora ka lëshuar Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1002, datë 16/08/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 535, datë 08/11/2017 për objekt òHotel 3 dhe 4 kateò me adresë Lagjia òUji i ftohtëò Vlorë, me zhvillues A., P. dhe V. V.

Sipas preventivit të punimeve, vlere totale e tyre është **29,758,859 lekë**. Duke llogaritur vlerën 3% të taksës së ndikimit në infrastrukturë, shuma për tu paguar është **892,765 lekë**.

Llogaritarja ka kërkuar nga subjekti kryerjen e pagesës në shumën 766,921 lekë. Diferenca prej **125,844lekë**, përbën dëm ekonomik si pasojë e përlogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 46 pika 1 *oTaksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*, të ligjit nr. 107/2014 *oPër Planifikimin e Territorit*, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **125,844 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “A., P.dhe V. V.”.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlora ka lëshuarLeje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për *oKompleks shtepish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë* me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues *oH.P.ësh.p.k.*

Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës nr. 865 prot, datë 26.05.2020 i është drejtuar M.K. lidhur me pagesën e taksës në infrastrukturë për shumën 20,886,926.48 lekë, pagesë e cila është kryer nëpërmjet tre Bankave, konkretisht, në O. T. B. në shumën 6,190,000 lekë, datë 26.05.2020, B.K.B në shumën 6,397,026 lekë, datë 26.06.2020 dhe C. B. në shumën 8,300,000 lekë, datë 26.05.2020. Referuar projektit arkitektonik, konkretisht sipërfaqeve të planimetrive të godinave, në kuotat -6.20, -3.30, +0.00, +3.30, +6.40, +6.60, +9.60, +9.90, rezulton si më poshtë:

Sip. totale banimi + Sip totale banimi e përbashkët = 8,312 m².

Sip. totale parkim nëntokë = 1,101 m².

Sa më sipër duke kryer veprimet e nevojshme në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë do të kishim:

$8,312 * 61,800 = 513,681,600$ lekë

$1,101 * 43,260 = 47,629,260$ lekë

Sa më sipër, vlera totale e projektit të paraqitur për ndërtim është 561,310,860 lekë (kosto). Për taksën prej 4% për ndikimin në infrastrukturë, zhvilluesi duhet të kishte paguar shumën 22,452,434 lekë. Duke zbritur shumën 20,886,926.84 lekë, e cila është paguar nga zhvilluesi, rezulton një diferencë prej **1,565,508 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **1,565,508 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “H.P.” *shpk*.

Menjëherë

15.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlora ka lëshuarLeje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 624, datë 09.10.2019 është lëshuar leja e zhvillimit si dokumenti paraprak për dhënien e lejes së ndërtimit, e cila është dhënë me vendimin nr. 208, datë 12.05.2020, në emër të aplikantit M. K., me zhvillues L. Shpk, për *oRepart prodhimi, magazinimi dhe shitje produktesh fasonerie*.

Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës 875-1 prot, datë 06.05.2020 i është drejtuar subjektit M.K. lidhur me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për shumën 4,990,092.57 lekë, pagesë e cila është bërë pranë I. S. P. B. në datën 08.05.2020. Referuar projektit arkitektonik, konkretisht sipërfaqeve të planimetrive të godinës në kuotat -5.20, +0.00, +5.40, rezulton se Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është 5,608 m², ndërsa sipërfaqja e parkimit nëntokë është 2,720 m².

Duke rillogaritur pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton:

$5,608 * 61,800 * 0.5 = 173,287,200$ lekë

$2,720 * 61,800 * 0.7 = 117,667,200$ lekë

Sa më sipër, totali i ndërtimit (kosto) është 290,954,400 lekë, pra shumë më i lartë nga preventivi me të cilin është llogaritur taksa. Duke kryer veprimet kemi $290,954,400 * 3\% = 8,728,632$ lekë të cilat duhet të pagueshin si taksë ndikimi në infrastrukturë. Pra zhvilluesi ka paguar më pak në shumën **3,738,539 lekë, që përbën të ardhura të mungura me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **3,738,539 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “L.” shpk.

Menjëherë

16.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlora ka lëshuar Leje ndërtimi miratuar me nr. 352, datë 20.06.2019 si dokumenti paraprak për pajisjen me leje ndërtimore, e cila është dhënë me nr. 508, datë 04.09.2020 për òGodinë Babimi dhe Shërbimesh 1-3-6-7-8 kate dhe 1 kat nëntokë, ò me adresë në Lagjen Pavarësia, Rr. Gjergj Araniti dhe Rr. Faik Konica, me zhvillues òH. M.ò. Bashkia Vlorë nëpërmjet shkresës nr. 948, datë 27.08.2020, dërguar nga komisioni i llogaritjes të taksës së ndikimit në infrastrukturë, i përbërë nga znj. N. R. me detyrë llogaritare, z. K. M. me detyrë Kontrollues, z. F. D. me detyrë Drejtues dhe z. D. L. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, i janë drejtuar z. N. J. në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë brenda afatit prej 15 ditësh. Kjo taksë është paguar me mandate arkëtimi nr. 609, datë 27.08.2020 nga H.V.M, në shumën 5,218,703.88 lekë ($0.04 * 130,467,597$ lekë), në degën e T. B., Vlorë po në datën 27.08.2020. Referuar projektit arkitektonik, rezulton se sipërfaqja totale e godinës mbi tokë është $1,680.9 \text{ m}^2$ ($kt1+kt2+kt3+kt4+kt5+kt6+kt7$), Kati përdhe (shërbim) është 324.2 m^2 , ndërsa kati nëntokë (parkim) është 295.7 m^2 . Duke rillogaritur vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton:

$1,680.9 * 61,800 = 103,879,620$ lekë

$324.2 * 92,700 = 30,053,340$ lekë

$295.7 * 43,260 = 12,791,982$ lekë

Në total, vlera e të gjithë objektit është 146,724,942 lekë, ndërkohë llogaritja sipas taksës është bërë për vlerën 130,467,597 lekë, nga ku është paguar shuma prej 5,218,703.88 lekë. Sa më sipër duke kryer llogaritjet përkatëse do të kishim $146,724,942 * 0.04 = 5,868,998$ Lek. Diferenca prej **650,294 lekë përbën të ardhur të munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **650,294 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “H.M.”.

Menjëherë

17.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlora ka lëshuar Leje ndërtimi miratuar me nr. 352, datë 20.06.2019 si dokumenti paraprak për pajisjen me leje ndërtimore, e cila është dhënë me nr. 508, datë 04.09.2020 për òRikonstruksion objekt banimi 1 kt dhe shtesë në lartësiò me adresë në Lagjen Pavarësia, Rr. Andon Z. Çajupi, në emër të aplikantit N. J., me zhvillues òM. Ç.ò. Sipas preventivit të aplikantit në sistemin e lejeve, rezulton se vlera totale e tij është **47,507,378 lekë**. Nga kjo vlerë, duke llogaritur me 3% taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se aplikanti duhej të paguante shumën prej **1,425,221 lekë**. Personi përgjegjës për llogaritjen e kësaj takse, ka shumëzuar sipërfaqen totale të ndërtimit prej $984.5 \text{ m}^2 * 32,508$ lekë çmimi sipas entit kombëtar të banesave, për të nxjerrë vlerën prej **32,004,126 lekë** x 3% taksa e ndikimit në infrastrukturë, dhe i është kërkuar aplikantit pagesa në shumën **960,123 lekë**. Diferenca prej **465,098 lekë**, është e ardhur e munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë

Vlorë, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, veprim ky në kundërshtim me nenin 46 pika 1 *“Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*”, të ligjit nr. 107/2014 *“Për Planifikimin e Territorit*”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës **465,098 lekë**, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti **“M. Ç.”**.

Menjëherë

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Gjetje nga auditimi: Referuar akt-rakordimeve me Thesarin ***Taksa e tokës bujqësore*** për **vitin 2018** është realizuar në shumën 15,355 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 36%, për **vitin 2019** është realizuar në shumën 11,118 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara ose në masën 26%, për **vitin 2020** është realizuar në shumën 13,175 mijë lekë nga 42,455 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 31% dhe për 6 mujorin I të **vitit 2021**, është realizuar në shumën 4,792 mijë lekë nga 28,000 mijë lekë të planifikuara ose në masën 17%.

Nga auditimi i procedurave të faturimit dhe arkëtimin të taksës së tokës rezulton se nga specialistët e terrenit të DTTV që operojnë në NJA dhe nga specialistja e Sektorit të Menaxhimit të Tokës janë bërë faturime dhe janë kryer arkëtime vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë apo NJA. Pra nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat e NJA-ve apo të Sektorit të Menaxhimit të Tokës,

Referuar shkresës nr.1438/1 dt.12.03.2018 të Bashkisë Vlorë, për sipërfaqet tokave bujqësore dërguar Këshillit Qarkut Vlorë rezulton se, sipërfaqja e tokës bujqësore pronë private plus sipërfaqja e dhënë në përdorim sipas të dhënave të shkresës është më e lartë se baza e taksueshme e planifikuar në buxhetin e miratuar, me një sipërfaqe prej 1039 ha e shumëzuar me taksën për kategorinë VIII të tokës prej 1800 lekë/ha, është shkaktuar ***e ardhur e munguar në vlerën 7,480,800 lekë*** për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së rregjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi rregjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit të Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjeneroheshin nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzime pagesat i regjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës në Aparat për qytetin dhe NJA. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastër për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistra, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë apo NJA.

Regjistrat e familjeve fermere, nuk janë të azhurnuar dhe përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga ZVRPP Vlorë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *“Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24.

-Debitorë për taksën e tokës ***përvitin 2018*** rezultojnë 6571 familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, për **vitin 2019**, 6928 familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë**, për **vitin 2020**, 7872

familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për **6-mujorin e I të vitit 2021** janë 8627 familje fermere në vlerën **25,391,616 lekë**, vlerë e cilapërbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, të ngrëjë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ZVRPP dhe Qarku Vlorë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet me sipërfaqe 1039 ha lënë jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujori 2021, **për vlerën 7,480,800 lekë**.

Menjëherë

1.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë dhe Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për ndjekjen e debitorëve, të nxjerrë njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar nga familjet fermere dhe për mos kryerjen e pagesave të ndiqen procedurat e tjera administrative dhe ligjore.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Referuar aktrakordimeve të Bashkisë me UK-Vlorë, rezulton se për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, **detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar** për taksën e ndërtesës dhe **tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit**, rezulton në vlerën **148,587,530 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë e ndarë në taksë ndërtesë në vlerën **81,598,130 lekë** dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi në vlerën **66,989,400 lekë**.

Bashkia Vlorë, mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi -gjelbërim-ndriçimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet Agjentit Tatimor që në rastin konkret është UK Sha Vlorë, më të cilin nuk ka lidhur akt-marrëveshje me këtë Shoqëri në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar nëni 35 pika 2.

-Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Vlorë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se cilat viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe numrin e familjeve që janë të përjashtuara nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, taksës së ndërtesës, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi.

-Nga përlogaritjet për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, **detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar** për taksën e ndërtesës dhe **tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit**, rezulton në vlerën **148,587,530 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë e ndarë në taksë ndërtesë në vlerën **81,598,130 lekë** dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi në vlerën **66,989,400 lekë**.

-Në lidhje me mosrealizimet e taksës e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga agjenti tatimor UK sha, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjatësimin e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Nga Bashkia Vlorë nuk është lidhur kontratë me këtë Agjent Tatimor në mospërputhje me VKB për miratimet e paketave fiskale

-Nga krahasimi i numrit të banesave familjare për Bashkinë e Vlorës së bashku me NJA sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, duke hequr numrin e familjeve që kanë kontratë uji që janë

faturuar si dhe numrin e familjeve që kanë kontratë uji, por që janë përjashtuar nga taksat sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale të marra nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjiellit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

-Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të analizojë situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga UK SHA, Vlorë (në rolin e Agjentit tatimor), për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi - gjelbërim-ndriçimi nga abonentët familjarë dhe të nënshkruajnë një akt- marrëveshje me këtë shoqëri, me qëllim marrjen e përgjegjësive ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë

2.2.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë

2.3.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë, të marrin masa duke bashkëpunuar me UK-Vlorë si dhe të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **148,587,530 lekë**.

- Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të bashkëpunojë me UK sha, për evidentimin e vlerës së patarifuar prej **196,996,337 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor UK.sh.a.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, për zbatimin e vendimeve gjyqësore Bashkia Vlorë ka shpenzuar vlerën **144,177,487 lekë**, nga e cila vlera 3,816,764 i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim për largime nga puna të punonjësve, për 8 raste, ndërsa vlera 140,360,723 lekë i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. **Vlera 144,177,487 lekë** e shpenzuar për periudhën janar 2018 ó qershor 2021 nga Bashkia Vlorë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet**.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej Tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të

gabuarra të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Lejes së ndërtimi nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin òD.òshpk me nr. Lic NZ. 52.../1 me objekt ò**Godinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen “Dëshmorët”** Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/91 dhe nr. 2/92, date 28.09.2011 të ish-K.Rr.T Bashkia Vlorë. Edhe pse është një faturë e prerë më 30.04.2014 sipas vendimit të Gjykatës fatura është likuajuar 15.10.2014 pra rreth 5 muaj me vones. Nga mos llogaritja e penaltetit për pagesat vonuara të taksave ndikimit në infrastrukturë buxhetit të bashkisë ju ka shkaktuar një efekt financiar negativ në vlerë n **1,517,789 lekë**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit në do rast për pagesat mandate pagesat për subjektet e interesuara të përlllogariten sakt sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit detyrimet e subjekteve privat qofshin këto për leje ndërtimit apo fardo lloj taksat apo tatime të tjera.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, për pagesat dhe nis të certifikatave sipas përlllogarimit të përlllogariten taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si penaltitet në vlerë n **1,517,789 lekë për pagesë me vonesë subjektit “D.”shpk.**

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Lejes së ndërtimi nr. Prot. 3667/1 datë 11.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin òB.òshpk me nr. Lic NZ. 63.... me objekt ò**Banesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntok në lagjen “10 korriku”** Vlorë me afat zbatimi deri më 11.05.2022 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 2/49 dhe nr. 2/50, date 28.09.2011 të ish-K.Rr.T Bashkia Vlorë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlllogarisnin taksat në ndikimit në infrastrukturë në momentin e paraqitjes për zbardhjen të lejes në referencë të vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Jo sipas taksave dhe tarifave vendore të vitit 2011 kur sht marr leja ndërtimit; Nga ana ark. A. B. dhe dr. E. A., taksa e llogaritur për këto dy objekte kap vlerën prej 19,916,497.79 lekë, me një diferencë negative prej 99,061,938 lekë - 19,916,497 lekë = **79,145,441 lekë** Vlerë e cila përmbën efekt financiar negativ për buxhetin e bashkisë dhe duhet përlllogaritur dhe mbajtur subjektit ndërtues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast për pagesat mandate pagesat për subjektet e interesuara të përlllogariten sakt detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve privat qofshin këto për leje ndërtimit apo fardo lloj taksat apo tatime të tjera.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, për pagesat dhe nis të certifikatave sipas përlllogarimit të përlllogariten taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të llogaritur si mos mbajtje e saktë e taksave në vlerë n **79,145,441 lekë subjektit “B.”shpk.**

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Lejes së ndërtimi nr. Prot. 4026/1 datë 22.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvillues

subjektin òB.ò shpk me nr. Lic NZ. 6313 me objekt òGodinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen pavarësia Vlorë Vlorë me afat zbatimi deri më 22.05.2022 u kostatua se: kjo leje ndërtimi është miratuar me vendimin nr. 3/66 dhe nr. 3/87, date 07.06.2010 të ish-K.Rr. T Bashkia Vlorë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi drejtoria e planifikimit të territorit duhet të përlllogarisnin taksën ndikimi në infrastrukturë në momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën të vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Jo sipas taksave dhe tarifave vendore të vitit 2011 kur sht marr leja e ndërtimit:

Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të territorit duhet të rillogarisin diferencën e krijuar në taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej prej 49,813,766 lekë ó 13,275,477 lekë = **36,538,289 lekë, Vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë dhe duhet rillogaritur dhe mbajtur subjektit ndërtues.** (Më hollësisht trajtuar në pikën III. 2.3, faqe 144-232, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në do rast për rpara nxjerrjes së mandatit pagesës për subjektet e interesuara të përlllogariten sakt detyrimet sipas taksave dhe tarifave vendore në fuqi dhe duke ju përmbajtur legjislacionit për detyrimet e subjekteve privatë qofshin këto për leje e ndërtimit apo fardo lloj take apo tatimi tjetër.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit për do subjekt, për rpara dhe nis së certifikatës së përlllogaritimit të rillogaritimit taksat për të verifikuar dhe saktuar detyrimin dhe mbajtjen e diferencave nëse dalin.

Nga drejtoria e planifikimit të territorit të kërkohet mbajtja e detyrimit të rillogaritimit si mos mbajtje e saktë e taksës në vlerën **36,538,289 lekë subjektit “B.”shpk.**

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listëpagesat e periudhës 01.01.2018 ó 30.06.2020, rezultoi se:

Listëpagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto.

Nisur nga natyra e veprimtarisë së NSHP- Bashkia Vlorë, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për punë jashtë orarit, pagesa këto të kryera sipas urdhrat të lëshuar nga Drejtori i NSHP dhe procesverbalit të hartuar nga përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve z. P.A.

Sipas të dhënave të listëpagesave, për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020 janë paguar gjithsej **3,008,347 lekë, nga e cila: për vitin 2018 në shumën 1,269,440 lekë, për vitin 2019 në shumën 1,283,607 lekë dhe për periudhën Janar – Qershor 2020 në shumën 455,300 lekë.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbështetës në lidhje me pagesën e këtyre orëve jashtë orarit, u konstatua se:

- Në dosje nuk ka asnjë dokument justifikues, mbi punën që ato kanë kryer, arsyen e kryerjes së kësaj pune dhe dokumenti i saj, pasi mungojnë procesverbalet mbi evidentin e punës së kryer sipas përcaktimeve ligjore (ditar punimesh, koha etj), kërkesa për kryerjen e këtyre punëve jashtë orarit të punës, foto që tregojnë se është kryer kjo punë.

- Në asnjë rast nuk është parë mundësia për kompensimin e këtyre ditëve pune me ditë pushimi, pasi për të gjithë këta punonjës është e mundur një gjë e tillë, sepse janë një numër i konsiderueshëm punonjësish, dhe jo të gjithë punonjësit janë të angazhuar në punë jashtë orarit.

- Në kontratat individuale të punës të lidhur me këta punonjës nuk është përcaktuar se kryerja e punëve jashtë orarit të punës.

- Në asnjë rast nuk ka miratim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, për orët jashtë orarit.

- Gjithashtu, është konstatuar se dhe në periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së COVID-19, nga NSHP janë kryer punë për orët jashtë orarit, **por që nga verifikimi i dokumentacionit (urdhrrat e titullarit), konstatohet se nuk janë shërbime/punë të cilat shkonin për përballimin e nevojave të**

situatës së pandemisë, por janë kryesisht punime për pastrim plazhi, pastrim të rrugëve, kur dihet se ka një firmë pastrimi të rrugës etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë çuar në përdorim pa efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike për vlerën 3,008,347 lekë, në kundërshtim me nenet 9 dhe 64, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.01.2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendoreë*; Nenet 88 dhe 90, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i punës në Republikën e Shqipërisëë*, me ndryshime; Pikës 5, të VKM nr. 511, datë 24.10.2002 *“Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetëroreë* i ndryshuar; Pika 23 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë* me ndryshime; VKM nr. 591, datë 23.07.2010 *“Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetoreë* pika 1/c, UMF nr. 19, datë 10.07.2008 *“Për vendosjen e disa standardeve në planifikimin e shpenzimeve për personelinë* pika 5 në zbatim të ligjit organik të buxhetit, si dhe të kontratës individuale të punonjësve (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Bashkia Vlorë, nuk duhet të kryejë pagesa për punë jashtë orarit nëse ato nuk janë miratuar më parë nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjorë për dokumentimin e punës së kryer, për të eliminuar praktika e pagesave pa dokumentacion dhe shmangur keqmenaxhim e fondeve publike.

Menjëherë dhe vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrimit të procedurave për periudhën 01.01.2018 ó 30.06.2020, nga NSHP Bashkia Vlorë janë realizuar gjithsej **35** procedura me vlerë kontrate 93,445,950 lekë, nga e cila: në **vitin 2018** janë realizuar gjithsej **11** procedura me vlerë kontrate 27,108,218 lekë, për **vitin 2019** janë realizuar **18** procedura me vlerë kontrate 55,238,660 lekë dhe për periudhën Janar ó Qershor 2020 janë realizuar **6** procedura me vlerë kontrate 11,099,950 lekë.

Grupi i KLSH-^{së}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **35** procedura me vlerë kontrate 93,445,950 lekë ka vlerësuar për auditim **25** procedura ose 87.5% me vlerë kontrate 82,415,343 lekë ose 88% të vlerës së kontratave të lidhura, nga e cila: për **vitin 2018** nga **11** procedura me vlerë kontrate 27,108,218 lekë janë audituar **7** procedura me vlerë kontrate 23,384,051 lekë, për **vitin 2019** nga 18 procedura me vlerë kontrate 55,238,660 lekë janë audituar 13 procedura me vlerë kontrate 48,559,900 lekë dhe për periudhën Janar ó Qershor 2020 nga **6** procedura me vlerë kontrate 11,099,072 lekë janë audituar **5** procedura me vlerë kontrate 10,471,392 lekë.

Nga auditimi i **25** procedura me vlerë kontrate 82,415,343 lekë, rezulton se të gjitha procedurat janë në shkëlqje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, nga të cilat:

- Në **15** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura ose në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme;

- Në **7** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **37,318,194 lekë** pa TVSH;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publikë*, i ndryshuar nenet 2, *“Parimet e përzgjedhjeje”*, neni 20, *“Mosdiskriminim”*, neni 24, *“Anulimi i një procedure”*, neni 46, *“Kualifikimi i ofertuesve”*, pika 1, neni 47, *“Kualifikimi i ofertuesveë*, neni 53, *“Shqyrtimi i ofertave”*, neni 55, *“Kriteret e përcaktimit të ofertës”*, neni 58, *“Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”*, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë*, i ndryshuar, neni 66, *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveë*, neni 67, *“Klasifikimi i ofertave”*, neni 69, *“Njoftimi i fituesit”* dhe neni **70** *“Lidhja e kontratës”*. (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.9, faqe 282-343, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

8.1.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (*sipas llojit të procedurës*), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE, me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

8.2.Rekomandimi:Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

8.3.Rekomandimi:Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik me vlerë **37,318,194 lekë**.

Menjëherë dhe vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë, ka kryer një shpenzim prej afro **1,000,000 Euro**, për gjyqin në Arbitrazh në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë, ku rezultoi e paditur nga subjekti ÕT. P.ö Shpk, në lidhje me prishjen e kontratës koncesionare “*Për shërbimin e sistemit dhe menaxhimin të parkimit në qytetin e Vlorës*”. Bashkia Vlorë, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe në mungesë të stafit të specializuar për një përfaqësim të tillë, u është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit për të mundësuar përfaqësimin në arbitrazh, pasi pala paditëse ndër të tjera kërkonte dëmshpërblim në vlerën **24,703,072.90 USD**. Avokatura e Shtetit, në përgjigjen e saj, ka sqaruar se ligji nr. 10018 datë 13.11.2008 “*Për Avokaturën e Shtetit*”, neni 5 germa (c), përcakton se *ASH ofron asistencë juridike njësisive të qeverisjes vendore, sipas kushteve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshje të posaçme, të lidhura për këtë qëllim, ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore*. Sa më sipër, Avokatura Shtetit ka ofruar asistencë ndaj Bashkisë Vlorë për fazat paraprake deri në kontraktimin e avokatit/avokatëve të specializuar në këto çështje, duke dhënë orientimet për mënyrën se si procedohet për përfaqësimin në arbitrazh. Bashkia Vlorë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ðPër vetëqeverisjen vendore, neni 8 pika 2, neni 9.1 pika 1/a, pika 1/d, pika 1.6, neni 54 pika h dhe k, në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 ðPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 7 pika c, si dhe në kërkesë padinë e shoqërisë T. P. Shpk drejtuar DhNT Paris, në mungesë të stafit të specializuar në fushën juridike për procedura arbitrazhi në gjykata ndërkombëtare, Këshilli i Bashkisë me vendimin nr. 73, datë 17.07.2018, vendosi miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e Arbitrit si dhe të përfaqësuesit ligjor të Bashkisë Vlorë në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kërkesës së Bashkisë Vlorë, i janë përgjigjur 6 studio avokatuare europiane, të cilët kanë dhënë edhe ofertat e tyre, dhe në përfundim të vlerësimit, komisioni i ngritur për këtë procedurë, ka vlerësuar studion *B. M.K.* për të bërë përfaqësimin. Oferta e kësaj studio ishte me e favorshme. Në vijim, Këshilli i Bashkisë Vlorë, ka miratuar një sërë shpenzimesh të nevojshme për vijimin e gjykimit, duke përfshirë pagesa për trupën e arbitrazhit (26,000 mije lekë), pagesa për seancën gjyqësore në Tiranë dhe ekspertin (4,125 lekë) dhe pagesa për kundërpadinë (30,150 mije lekë). Në përfundim të gjykimit, Trupa e Arbitrazhit ka njoftuar Bashkinë Vlorë se Gjykata ka vendosur rrëzimin e gjithë kërkesës së subjektit T.P. Shpk kundër tyre, si dhe ka vendosur pagesën e kostove për Bashkinë në shumën **511,395 Euro dhe 124,200 USD**. Gjithashtu është vendosur edhe dëmshpërblimi për kundërpadinë e bërë nga Bashkia Vlorë, në shumën **10,000,000 lekë**. Në total, Bashkia Vlorë mund të përfitojë rreth **700,000 Euro** nga T. P. për gjykimin në arbitrazh. Me datë 1 Tetor 2020, Këshilli i Bashkisë

Vlorë, ka vendosur që të miratojë pagesën për S.B.M.K. në shumën 208,000 USD sipas marrëveshjes së arritur për kundërpadinë, me kusht që kjo shumë të paguhet nga shumat që më vendim të DhNT, T. P. i detyrohet Bashkisë Vlorë.

Referuar pikës 2 të këtij Vendimi, S.B.M.K Autorizohet të kryej procedurat përkatëse ligjore për të mundësuar arkëtimin e vlerës financiare të diferencës midis pagesës dhe kostove të Arbitrazhit si dhe vlerën e kundërpadisë si detyrime të shoqërisë T.P ndaj Bashkisë Vlorë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 28-46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, të marrë masat për të bërë të mundur arkëtimin e shumës prej **700,000 Euro** nga T.P në zbatim të vendimit të arbitrazhit. Të merret informacion nga pala e autorizuar S.B.M.K. për ecurinë e deritanishme të procedurave të ndjekura për arkëtimin e këtij detyrimi.

Menjëherë

10.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Subjekteve të liçencuara për ush trim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezultoi se në 17 raste të subjekteve, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Vlorë nuk janë rinovuar licencat, pavarësisht kryerjes së kontroleve, gjë që ka sjellë mosarkëtimin e të ardhurave nga tarifa e liçencimit në vlerën prej 17,000,000 lekë. Po kështu në 19 raste të lëshimit të autorizimit të liçencimit nuk është bërë aplikimi i saktë i tarifës me një diferencë në vlerë prej 15,200,000 lekë, e cila ka ardhur si pasojë e mosaplikimit të tarifës së miratuar të liçencimit prej 1,000,000 lekë. Vlera **prej 32,200,000 lekë e pa arkëtuar, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë.** Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa obö, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

Nga Bashkia nuk është vazhduar ndjekja e procedurave në Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe në Institucionet e tjera përkatëse deri në bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa liçencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Investimeve Publike, Strehimit dhe Transportit, të marrë masa që të pajisë 17 subjektet me liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, duke arkëtuar shumën **prej 17,000,000 lekë** si edhe të arkëtojë duke aplikuar tarifën e plotë për 19 subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për diferencën debitorë **prej 15,200,000 lekë.** Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për liçencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të tyre.

Brenda datës 30.08.2022

11.Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2016- 30.06.2021, nga auditimi i korespondencës shkresore të Bashkisë Vlorë me ALUIZNI-in Drejtoria Vlorë dhe databaze-s për lejet e legalizimit të përfituara nga individ dhe subjekte private, e krijuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) , u konstatua se janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m2 ndërtim me vlerë investimi 10,222,341,500 lekë, **pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.** Gjithashtu Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka faturuar 1961 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej **91,424,107lekë,** nga këto është likujduar vlera prej **88,073,725 lekë, duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Bashkia Vlorë nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ALUIZNI-t Drejtoria Vlorë, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në

infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit pranë Bashkisë, për objektet që përfitojnë nga legalizimi, veprim i cili ka sjellë të ardhura të munguara në **vlerën 51,111,707 lekë**.

Menjëherë

11.2.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet si dhe të vijojë me masa shtërnguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët me status odebitorë në **shumën 3,385,382 lekë**, bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Bazuar në VKB nr. 86, datë 26.07.2018 është lidhur kontrata me nr. prot. 7185, datë 15.08.2018 deri më 15.08.2019 (me afat 1 vit) ndërmjet Bashkisë Vlorë dhe subjektit oI. A.ö për dhënie me qira të objektit me sipërfaqe $231m^2 \times 200 \text{ lekë}/m^2 = 46,200$ lekë/në muaj dhe për truallin funksional me sipërfaqe $1082m^2 \times 20 \text{ lekë}/m^2 = 21,640$ lekë. Totali i tarifës mujore të qirasë është në vlerën 67,840 lekë neni 3 oQirajaö. Kjo përlllogaritje është bërë në bazë të plan-vendosjes dhe plan-rilevimit të punuar nga punonjësi i bashkisë inxh. K. A., pas verifikimit në terren të objektit dhe sipërfaqes funksionale të Thertores. Nga verifikimi i pagesave rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467,840 lekë nga 814,080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likujduar vlera prej 347,040 lekë** në kundërshtim me nenin 3 oQirajaö të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ**.

-Në VKB dhe në kontratën e nënshkruar, në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarit të imët, të cilat janë pjesë inventarin të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëm dhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjecare (15.08.2018 - 15.8.2019), duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ** për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshtim.

Nga Bashkia Vlorë nuk është aplikuar penalitet në masën 2% të vlerës së papaguar për çdo ditë vonesë, sipas nenit 7 të kontratës si dhe nuk është marrë asnjë hap ligjor për mospërmbyllje të kushteve të kontratës të përcaktuar në nenin 9 të kontratës.

-Me VKB nr.101, datë 03.10.2019 oPër miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselëö është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të të objektit oThertoreö, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44,740 lekë e përbërë nga: $231m^2 \text{ ndërtesë} \times 100 \text{ lekë}/m^2 = 23100$ lekë dhe $1082m^2 \text{ truall funksional} \times 20 \text{ lekë}/m^2 = 21,640$ lekë. Ky VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënie me qira të objektit. Si rrjedhojë $44,740 \text{ lekë}/\text{muaj} \times 24 \text{ muaj} = 1,073,760 \text{ lekë}$, **shumë e cila përbën të ardhura të munguara**. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 oPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitulli III, oTarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, pikat 5 Kreut VI pika 2 dhe me nenin 3,7 dhe 9 të kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të ndjekin procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit prej **347,040 lekë**, tarifë qiraje e pa paguar nga subjekti qiramarrës oI. A.ö.

12.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Vlorë të analizojnë situatën e krijuar dhe të marrin masa për vënien në zbatim të VKB nr.101, datë 03.10.2019 "Për miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë", miratuar me afat 5 vjet dhe vlerë qiraje 44,740 lekë/muaj, me qëllim shfrytëzimin e këtij ambienti dhe rritjen e të ardhurave të Bashkisë, pasi vetëm për periudhën 2 vjecare është shkaktuar një e ardhur e

munguar në shumën 1,073,760 lekë.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Në hartimin dhe zbatimin e aneks kontratës të datës 03.07.2013 si amendim e i kontratës fillestare nr.2496 rep.,nr.154kol, datë 04.06.2002 të dhënies me qira të objektit *“P.L.” të qytetit Vlorë*, e lidhur nga ish-METE me subjektin qiramarrës *Shoqërinë “I.I” shpk, Vlorë*, u konstatuan shkelje ligjore, me pasojë përcaktim të gabuar të tarifës së qirasë në vlerën 360,060 lekë/muaji, pasi sipërfaqja e përcaktuar në këtë AneksóKontratë nga 16112 m² sip. totale në kontratën fillestare zbretnë 11.890 m² sip totale, nga e cila 28 m² nën objekt, ndërkohë që, në bazë të VKB nr. 60, datë 27.10.2016, shoqëruar dhe me procesverbalin e mbajtur nga grupi i punës i verifikimit të sipërfaqes të shfrytëzuar në fakt sipas matjeve në terren konfirmon sipërfaqen prej 28m² sipërfaqe ndërtesë 14.932m² sipërfaqe truall funksional. Gjithashtu tarifat e qirasë për m² sipër ndërtesën dhe për truallin funksional kanë ndryshuar me ndryshimin e legjislacionit, kusht i përcaktuar në aneks-kontratën e datës 4 Qershor 2002 neni 6 *“Pagesa”, i cili duhej marrë në konsideratë për ndryshimin e tarifës së qirasë. Referuar sipërfaqes totale që shfrytëzohet në fakt prej 14.960m², nga e cila 14.932m² janë sipërfaqe truall funksional x 40lekë/m² = 597,280 lekë/muaj dhe 28m² sipërfaqe ndërtesë x 200lekë/m² = 5,600 lekë/muaj, rezulton që tarifa e qirasë mujore duhet të ishte 602,880 lekë/muaj dhe jo sa është në fakt, sipas kontratës në vlerën 360,060 lekë. Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit *“P.L.” të qytetit Vlorë*, u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:*

-Është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, **shuma 10,198,440 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHETTS**, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 09.12.2015 *“Për disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014”*.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, me ndryshime”*.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës.

-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 *“Zgjidhja e kontratës”* pika 7.2 germa *“ç”* përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, pikat 5, Kreut VI pika 2 dhe 6, me Aneks-Kontratën e datës 4 Qershor 2002, me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *“Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”* Pjesa V, Kreu I, neni 678. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në bashkëpunim me MZHETT-s referuar VKB nr. 60, datë 27.10. 2016 të rishikojë dhe të amendojë kontratën e datës 04.06.2002 dhe aneks-kontratën e datës 03.07.2013, duke bërë ndryshimet përkatëse në objektin e kontratës dhe në përcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren prej 14,932 m² janë sipërfaqe truall funksional dhe 28 m² sipërfaqe ndërtesë, e konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren në dakortësi me qiramarrësin, si dhe të aplikohen ndryshimet e tarifës së qirasë/m² truall funksional nga ndryshimi i legjislacionit, duke përcaktuar edhe periudhën e fillimit të detyrimit.

Menjëherë

13.2.Rekomandimi: Strukturat drejtuese, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin

përgjegjësitë administrative ndaj personave përgjegjës që kanë shkaktuar efekt negativ financiar **në shumën 10,198,440 lekë**, për mospërcaktimin e pagesës sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren si edhe mosaplikimin e tarifave të reja të qirasë/m² duke favorizuar subjektin òl. Iò Shpk.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të dhënieve me qira subjekteve apo individëve privat të hapësirave publike në zonën e plazhit dhe pagesave të kryera, u konstatuan se:

-Nga kjo drejtori grupi i auditimit ka hasur vështirësi në marrjen e dokumentacionit për kontratat e plazheve, listën e subjekteve edhe pasi janë rikërkuar disa herë.

Informacioni i kërkuar nuk plotësonte kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkruara në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve.

-Nga Drejtoria ekonomike dhe sipas aktrakordimeve me thesarin të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,063,700 lekë

Viti 2021 në shumën 32,269,660 lekë

-Nga Drejtoria e Aseteve të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,619,600 lekë

Viti 2021 në shumën 31,659,580 lekë

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezulton se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 6,783,200 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 8,120,240 lekë**.

-Nga Drejtoria e asetëve nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, nuk janë mbajtur aktrakordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, òDokumentimi i lëvizjes së aktiveveò pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 òPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 46-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Financë Kontabilitetit, të marrë masa për kryerjen e rakordimeve në lidhje me subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat për shfrytëzimin e hapësirave të plazheve dhe kanë shfrytëzuar këto hapësira për vitet 2018-2021, duke kryer arkëtimin e vlerës prej **14,903,440 lekë**.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit òRikonstrukcion i rrugës Panaja-Hoshtimeò, kanë marrë pjesë 4 ofertues, nga të cilët janë skualifikuar 3 ofertuesit si më poshtë:

B.O.E òC. Mò & òK.K ò SHPK, me argumentimin òFabrika/Impianti i prodhimit të asfaltit është në një distancë më të largët se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, sikurse përcaktohet në dstö.

OE òSh.ò SHPK, me argumentimin Fabrika/Impianti i prodhimit të Asfaltit është në një distancë më të largët se 30 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit, sikurse përcaktohet në dstö.

OE òB.ò SHPK, me argumentimin òOperatori ekonomik ofertues nuk është i pajisur me licencë kategoria III. 2.B për òGrumbullim dhe transport i mbetjeve nga ndërtimet ose prishjet" si dhe òOperatori ekonomik nuk ka të punësuar ne stafin e shoqërisë 1 (një) Inxhinier Infrastruktura Transporti, për te cilin duhet te paraqesë kontratë pune, diplomë, CV, te jete ne listepagesa ne periudhën e kërkuarö.

Në këtë tender ka qenë pjesëmarrës OE òSh.ò SHPK, i cili është skualifikuar vetëm për mos plotësim të kriterit të distancës së fabrikës së asfaltobetonit. Fabrika e paraqitur nga ky OE ndodhet në kilometër 1, të aksit rrugor Fier-Patos. Nga verifikimi i distancës së vendndodhjes së fabrikës së asfaltobetonit të paraqitur nga ky OE, rezulton se distanca nga fabrika në vend zbatimin e punimeve deri në objektin që do rikonstruktohet (Hoshtime) është më e vogël se 30 kilometër, nëse merret në konsideratë rruga më e shkurtër, por që kalon në segmente të cilat janë rrugë dytësore. Sipas rrugës standarde, një automjeti i duhet 33 minuta ta përshkruaj këtë distancë, ndërsa sipas rrugëve dytësore 39 minuta.

Nga ana e KVO duhet të merrej në konsideratë se transporti në rrugën standarde, megjithëse distanca është pak mbi 30 kilometër, të konsiderohej si devijim i vogël. OE òSh.ò SHPK, ka paraqitur ofertë anomalish të ulët dhe nga ana e KVO duhet të kërkoheshin sqarime për zërat e preventivit, nëse argumentohej apo jo mundësia e realizimit të kontratës. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se nga rruga standarde për të cilën është parashikuar realizimi i transportit, ka një distancë pak më të madhe se 30 kilometër, e cila mund të konsiderohej devijim i vogël, faktin se oferta është anomalish e ulët, për të cilën nuk janë kërkuar sqarime, si dhe faktin se nga OE përkatës nuk ka patur ankesë, **vlera 2,956,640 lekë**, e cila del nga diferenca e ofertës së OE fitues òA.ò SHPK me ofertën e paraqitur nga OE òSh.ò SHPK, konsiderohet efekt negativ financiar. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues òA.ò SHPK, rezulton se dokumentacioni për mekanizmin ekskavator me zinxhirë, i përket një mekanizmi me goma. Veprim në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 232-260, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Bashkia Vlorë të shqyrtojë vlerësimin e ofertave për këtë procedurë, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mangësitë e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit, nga KVO.

F. MASA DISIPLINORE

F/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 òLlojet e masave disiplinoreö, të ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin civilö, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilö dhe nenin 64 gërmat ògö dhe òkö të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreö, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Vlorë që t'aj kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 9 punonjësit e mëposhtëm:**

a-“Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “c” e nenit 58.

1. S. H., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, për:

-Dhënieve me qira subjekteve apo individëve privat për zënien e hapësirave publike në zonën e plazhit dhe pagesave të kryera.

-Për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit për kontratat e plazheve dhe listat e subjekteve përfituese.

Informacioni i dhënë nuk plotësonte kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkuara në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve.

-Nga Drejtoria ekonomike dhe sipas aktrakordimeve me thesarin të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,063,700 lekë

Viti 2021 në shumën 32,269,660 lekë

-Nga Drejtoria e Aseteve të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,619,600 lekë

Viti 2021 në shumën 31,659,580 lekë

-Nga kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezulton se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 6,783,200 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

-Nga kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezulton se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 8,120,240 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

Nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, nuk janë mbajtur aktrakordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, òDokumentimi i lëvizjes së aktiveve ò pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 òPër Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë.

-Objekti òThertore ò nga verifikimi i pagesave për rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467, 840 lekë nga 814, 080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likjduar vlera prej 347,040 lekë**, në kundërshtim me nenin 3 òQiraja ò të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**.

Në VKB dhe në kontratë në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarin e imët të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëmdhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjeçare të lidhjes së kontratës 15.08.2018 deri më 15.8.2019, duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe të ishte arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshpërblim**. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, òTarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, pikat 5³⁶,

Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2.

Me VKB nr.101 datë 03.10.2019 òPër miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore)

me qira në Njësinë administrative Novoselë është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të objektit òThertoreò, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44740 lekë e përbërë nga: $231m^2$ ndërtesë $\times 100$ lekë/ m^2 = 23100 lekë dhe $1082m^2$ truall funksional $\times 20$ lekë/ m^2 = 21,640 lekë. Kjo VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënien me qira të objektit. Si rrjedhojë $44,740$ lekë/muaj $\times 24$ muaj = **1,073,760 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara.**

- Objektin òP.ò, nga ku është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, **shuma 10,198,440 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS**, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 òPër disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014ò.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 òPër përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, me ndryshime.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratësò.

-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 òZgjidhja e kontratësò pika 7.2 germa òçò përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë.

-Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, në territor të NJA Qendër Vlorë pra nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Për rastet e subjekteve debitore nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë. Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezulton se në 97 raste të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë dhe kamatëvonesave **në vlerën 64,290,775 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Nga NJA Shushicë, për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjeçar dhe 1 kontrate me afat 50 vite. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **7,670,532 lekë gjithsej.**

-Për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjeçar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullësor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kontratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekë gjithsej.**

-Nga NJA Novoselë, për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjeçar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën prej **49,621,292 lekë gjithsej.**

Nga ish-Komuna Novoselë, për periudhën vitet 2008 ó 2015 janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën **prej 49,621,292 lekë gjithsej**.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kontratave dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

pikat 2 dhe 5 të kontratave, ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 òPër tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për tokat bujqësore të pandara”.

Ulje në nivelin e të ardhurave.

Mos menaxhimi dhe mosmonitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturat NJA.

2. T. Z., me detyrë Drejtor Ekonomik, për:

-Shkeljet e konstatuara në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, cilat janë trajtuar gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit. Anomalitë e konstatuara kanë ardhur si rezultat i mos zbatimit e kërkesave të: nenit 5, 47, pikat 82-91 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe nenin 40, 47, 48, 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 òPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ligjit nr. 10340, datë 28.10.2010 òPër pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe SHA në pronësi të pushtetit vendor, nenin 2 dhe 3, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

-Moszbatimin e kuadrit rregullator të fushës në hartimin e pasqyrave financiare për Bashkinë Vlorë, inventarizimin e aseteve të institucionit.

-Shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit miratuar me vendimin nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin òHotel 6 kate me 1 kat bodrum, në adresën Lagjen "Uji i Ftohtë, me zhvillues T. Z., dhe Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin òHotel 6 kate me 1 kat bodrum, nga ku ka rezultuar se edhe pse objekti ka qenë plotësisht i përfunduar në fazë karabina dhe muraturë, ka kërkuar miratim ndryshimi në projekt pas realizimit faktik të tyre, duke përcaktuar kështu që miratimi i ndryshimeve në projekt është kryer pasi janë përfunduar ndryshimet në zbatim, në shkelje të nenit 48 të ligjit 107/2014 i ndryshuar dhe ligjit nr. 8402, Datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar.

-Në cilësinë e anëtarëve të KVO pasi gjatë vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë, me fond limit 15,166,000 lekë, nuk kanë shqyrtuar në mënyrë korrekte ofertat dhe nuk kanë kërkuar shpjegime për ofertë anomalisht të ulët, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 2,956,640 lekë.

-Nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njërive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjetës, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendore i ndryshuar, neni 4 pika 7,

ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë o i ndryshuar, nenet 70 dhe 117, VKB nr. 100 datë 22.12.2017 i ndryshuar me VKB nr. 45, datë 26.04.2018 pika 6 dhe 8 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, pika 2 nënpika 7.

Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

3. O.B., me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për Keqmenaxhim dhe mosorganizim i mirë i punës, mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, si të ardhura të munguara **me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë**, në sezonin turistik nga anijet lundruese.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit, **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

Të ardhurat në DTTV mbahen ekstra-kontabël, thjesht në një program excel, referuar ditarit të të ardhurave të mbajtur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe bëhet rakordimi mujor me dy drejtoritë. Evidentohen vetëm arkëtimet për çdo debitor në Sistemin TAIS, dhe më pas Sistemi TAIS gjeneron debitorët, por për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë në kontabilitet, megjithëse nga specialistja e Kontabilitetit në DTTV është bërë relacion Drejtorit të DTTV në fund të vitit ushtrimor, ku ky i fundit nuk ia ka dërguar Qendrës Ekonomike për kontabilizim edhe përfshirjen e vlerës së debitorëve të shoqëruara me analizën e tyre në Pasqyrat Financiare të viteve 2018-2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme o kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a,b.

- Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave si dhe mbajtja e një pjesë të taksave dhe tarifave që menaxhohen nga DTTV jashtë kontabilitetit.

- Për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në nivele tejet të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet mbi planin, rezultat i cili paraqet se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva si në planifikim ashtu edhe në punën për mbledhjen e të ardhurave, duke ndikuar negativisht në realizimin e tyre. Pra ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave.

- nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në momentin e krijimit të tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2018 duke filluar nga viti 2011, janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektësh debitorë me shumë progresive të debisë deri në fund të 2017, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt. Kjo listë megjithëse është mbajtur në programin excel nuk përbën dokument vërtetues, sipas përcaktimeve në UMF 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò Kreu III òRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i tyre në njësitë e sektorit publikò. Megjithëse e mbajtur jashtë kontabilitetit lista e detyrimeve debitorë nuk është e printuar, e nënshkruar nga personat përgjegjës dhe e volusor, e inventarizuar dhe arkivuar, duke lenë shteg për abuzim.

Në lidhje me këtë veprim, referuar edhe materialeve të KLSH-së, specialistja e kontabilitetit tatimor me shkresën nr. 646 prot., datë 05.02.2020 për listën e debitorëve i është drejtuar specialisteve të pranimit dhe shkresën nr. 338 prot., datë 18.08.2020, ka dërguar listën e debitorëve prej vitit 2011-2018 specialistit të IT-së për tu hedhur në sistemin TAIS.

Për kryerjen e këtyre veprimeve si nga specialistet e pranimit ashtu edhe nga specialisti i IT, nuk është marrë asnjë masë dhe konstatohet se kjo listë nuk është azhurnuar ende në sistemin TAIS.

- Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Detyrime të pa arkëtuara nga subjektet fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **3984 subjekteve në vlerën 315,203,292 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat tatimoreò me ndryshime,

-Për periudhën 2018-2020 dhe 6-mujori I i vitit 2021, referuar numrit të familjeve pa kontratë me UK sh.a, **detyrimi i pa tarifuar dhe i pa arkëtuar** për taksën e ndërtesës dhe **tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit**, rezulton **në vlerën 148,587,530 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë** ndarë në taksë ndërtese në vlerën **81,598,130 lekë** dhe tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçimi në vlerën **66,989,400 lekë**.

-Procedurat për arkëtimin e taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjar, mosndjekja nga Agjenti tatimor UK dhe debitorët nga lënia jashtë skemës së taksimit të abonentëve familjar pa kontrata me ujësjellësin.

-Në lidhje me mosrealizimet e taksës e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga agjenti tatimor UK sha, Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtij agjenti tatimor me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura

-Debitorë për taksën e tokës për **vitin 2018** rezultojnë 6571 familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, për vitin **2019**, 6928 familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë**, për **vitin 2020**, 7872 familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për **6-mujorin e I të vitit 2021** janë 8627 familje fermere në vlerën **25,391,616 lekë**.

-Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) òTaksa mbi tokën bujqësore” të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2010 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Në Bashkinë Vlorë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë, pasi në VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 pika 2/b përcaktohet se: òNgarkohen për mbledhjen e kësaj takse b/1-7, Specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve për qytetin e Vlorës.ò

Pra, nuk përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NJA nga DTTV-ja

apo nga Sektori i Menaxhimit të Tokës për NJA në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Ndërsa sipas Rregullores së Brendshme neni 170 të Specialisti i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në pikën (f) përcaktohet: *“Përpilon listat e fermerëve që kanë tokë bujqësore dhe dërgon dokumentacionin pranë DTTV së Bashkisë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.”* Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit e Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistratit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat.

- Janë kryer ndërhyrje edhe nga vetë user-i i ish Drejtuesit të DTTV-së për llogari të subjekteve që mbulohen nga vetë specialistët e rajoneve të ndryshme.

Për veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105, 106, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 për dokumentin elektronik, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 35, 36.

- Në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme.

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- Nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsye të veprimeve.

4. J. C., Drejtori i Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për miratimin e lejeve të ndërtimit:

-Për procedurën e prokurimit të Rikonstruksionit të rrugës Panaja-Hoshtimë, me fond limit 15,166,000 lekë janë bërë llogaritje të gabuara për përcaktimin e distancës së fabrikës së asfaltobetonit.

-Në përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit të Blerjes së shtyllave elektrike ndriçimi, viti 2021, ka përllogaritur në mënyrë të gabuar, por pa efekte në fondin limit.

-Nuk ka marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Vlorë. Kështu për periudhën 2016-2020-30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m² ndërtim me vlerë investimi prej 10,222,341,500 lekë pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për **Bashkinë Vlorë.**

-Gjithashtu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 2916 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107 lekë, nga këto është likuajduar vlera prej 88,038,725 lekë, **duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore **në vlerën 51,111,707 lekë**nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin ÷Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë, në adresën rruga "I. P.", Bashkia Vlore, me zhvillues ÷M. C.ö sh.p.k.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 447, datë 15/06/2021 dhe Nr. 184, datë 11/03/2021 për objektin ÷Objekt banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate parkim nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kate, në adresën lagje ÷Hajro Cakerriö, Vlorë, me zhvillues ÷L.ö.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.226, datë 26/03/2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin ÷Godina banimi dhe shërbimi 1-9 kate me 1 kat nentokë (objekti 4), në lagjen ÷28 Nëntoriö, me zhvillues ÷G. K.ö sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim të KKRT Vlorë nr.2/278 prot. datë 28.09.2011 dhe Vendim nr.86 datë 26.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 16.10.2018.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 436, datë 11/06/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 335, datë 05/05/2021 për objektin ÷Ndertim Kompleks per mbareshtim lopeshö, në adresën Bunavi, Vlorë, me zhvillues ÷M. C. S.ö shpk.

5. S. A., me detyrë Specialiste pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit për kalimin për miratim të lejeve të ndërtimit:

-Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin ÷Hotel 6 kate me 1 kat bodrumö me zhvillues T. Z.

Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 dhe leje zhvillimi Nr.196, datë 24/04/2019 për objekt ÷Godinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokë me adresë Lagjia ÷Pavarësiaö Vlorë, me zhvillues ÷H.P.ösh.p.k.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 23/07/2019 për objektin ÷Kompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dytaö në Radhimë - Vlorë, me zhvillues ÷E.öshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 dhe leje zhvillimi nr. 689, datë 14/11/2019 për objektin ÷Godinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë, në adresën Rruga ÷Dhimitër Konomiö, me zhvillues ÷E. K.ö.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin ÷Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokë, në adresën rruga "I. P.", Bashkia Vlore, me zhvillues ÷M. C.ö sh.p.k

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 175, datë 14/04/2020 për ÷Objekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokë me adresë Rruga ÷Dhimitër Konomiö, Vlorë, me zhvillues ÷H. P.öshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 584, datë 25/09/2019 për ÷Godinë banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me një kat parkim nën tokë me adresë Rruga "Mustafa Bello", Vlorë, me zhvillues ÷A.öshpk., në pronësi të K. C., V. C., E. C., Sh. M.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për ÷Kompleks shtëpish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues ÷H.P.ösh.p.k, nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 1,565,508 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 108, datë 27/02/2020 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 651, datë 23/10/2019 për objekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifinitureo me adresë Nartë, Vlorë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 676, datë 05/11/2019 për objekt Objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime me adresë Lagjia Pavarësia Vlorë, me zhvillues N. L.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin Objekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumo, Lagjia Pavarësia, Vlorë me zhvillues S.ö sh.p.k

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 447, datë 15/06/2021 dhe Nr. 184, datë 11/03/2021 për objektin Objekt banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate parkim nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kateo, në adresën lagje H. C.ö, Vlorë, me zhvillues L.ö.

6. K. M., me detyrë Specialist pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit për kalimin për miratim të lejeve të ndërtimit:

-Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin Hotel 6 kate me 1 kat bodrumo me zhvillues T. Z.

-Leje ndërtimi për shtesë me sipërfaqe më të madhe se 250m², miratuar me Nr. 470, datë 30/07/2019 për objekt Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anesore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katësheo me adresë Lagjia Uji i ftohtëo Vlorë, me zhvillues P.H.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 dhe leje zhvillimi Nr.196, datë 24/04/2019 për objekt Godinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokëo me adresë Lagjia Pavarësia Vlorë, me zhvillues H.P.sh.p.k.

-Leje ndërtimi në emër të aplikantit N. J., zhvillues M. Ç. me datë aplikimi 04.06.2019, është miratuar leje për rikonstruksion objekt banimi 1 kt dhe shtesë në lartësi në Lgj Pavarësia, Rr. Andon Z. Çajupi, ZK 8603.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 23/07/2019 për objektin Kompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dytao në Radhimë - Vlorë, me zhvillues E.öshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 dhe leje zhvillimi nr. 689, datë 14/11/2019 për objektin Godinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokëo, në adresën Rruga Dhimitër Konomio, me zhvillues E. K.ö.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 678, datë 30/12/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 424, datë 10/07/2019 për objektin Godinë banimi dhe shërbime 5, 6, 12 dhe 13 kate, me 1 kat parkim nën tokëo, në adresën rruga "Irakli Pylli", Bashkia Vlore, me zhvillues M. C.ö sh.p.k.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 770, datë 16/12/2019 për objektin Kapanon për rritje dhe mbarështim shpendësho, në adresën fshati Shushicë, Njësia Administrative Bashkia Vlorë, me zhvillues B. K.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 583, datë 13/10/2020 për objektin Rindërtim i volumit 3 kate me shtim bodrumi, volumi anesor dhe shtese kati me funksion hoteleriö ne Lagjen "Uji i Ftohte", Vlorë me zhvillues S. A.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 175, datë 14/04/2020 për Objekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokëo me adresë Rruga Dhimitër Konomio, Vlorë, me zhvillues H.P.öshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 584, datë 25/09/2019 për Godine banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me nje kat parkim nën tokëo me adresë Rruga "Mustafa Bello", Vlorë, me zhvillues A.öshpk., në pronësi të K. C., V. C., E. C., Sh. M.

Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për Godinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokëo me adresë Lagjia Pavarësia Rr."Gjergj Arianiti" dhe Rr."Faik Konica" Vlorë, me zhvillues H. M. dhe V.

M., nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 650,294 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për òKompleks shtëpish të dyta me tre kate, dy kate nën tokë me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues òH.P.òsh.p.k, nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 1,565,508 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 108, datë 27/02/2020 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 651, datë 23/10/2019 për òObjekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panaresh) për materiale ndërtimi rifinitureò me adresë Nartë, Vlorë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 676, datë 05/11/2019 për objekt Objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime me adresë Lagjia òPavarësiaò Vlorë, me zhvillues N. L.

-Në emër të aplikantit M. K., me zhvillues L. Shpk, me datë aplikimi 12.02.2020 dhe datë dërgimi nga Institucioni i Bashkisë Vlorë 12.05.2020, në Lgj. 11 Janari, me 2 kt mbi tokë dhe 1 kt nën tokë dhe sipërfaqe ndërtimi mbi tokë 5,608 m², nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 3,738,539 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin òObjekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumò, Lagjia Pavarësia, Vlorë me zhvillues òS.ò sh.p.k.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òObjekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hoteleriò Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi 13 vite para lidhjes së kontratës, për shkelje të lejes së ndërtimit dhe diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 443,031 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Nr.577 , datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òKapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtese anesore e kapanonit ekzistues 2 kat), në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues òA. P.ò sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, nga ku është konstatuar shkelje e kushteve të lejes dhe moszbatim të projektit të miratuar me pasojë ndryshimin e fasadave.

7. N. R., me detyrë Specialiste pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit për kalimin për miratim të lejeve të ndërtimit:

Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për òGodinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokë me adresë Lagjia òPavarsiaò Rr."Gjergj Arianiti" dhe Rr."Faik Konica" Vlorë, me zhvillues H. M. dhe V.M., nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 650,294 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Në emër të aplikantit M. K., me zhvillues L. Shpk, me datë aplikimi 12.02.2020 dhe datë dërgimi nga Institucioni i Bashkisë Vlorë 12.05.2020, në Lgj. 11 Janari, me 2 kt mbi tokë dhe 1 kt nën tokë dhe sipërfaqe ndërtimi mbi tokë 5,608 m², nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 3,738,539 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.226, datë 26/03/2021 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òGodina banimi dhe shërbimi 1-9 kate me 1 kat nëntokë (objekti 4), në lagjen ò28 Nëntoriò, me zhvillues òG. K.ò sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim të KKRT Vlorë nr.2/278 prot. datë 28.09.2011 dhe Vendim nr.86 datë 26.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi leje 16.10.2018.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Objekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hotelerië Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi 13 vite para lidhjes së kontratës, për shkëlqje të lejes së ndërtimit dhe diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 443,031 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Nr.577 , datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtese anesore e kapanonit ekzistues 2 kat), në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues "A. P.ö sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, nga ku është konstatuar shkëlqje e kushteve të lejes dhe moszbatim të projektit të miratuar me pasojë ndryshimin e fasadave.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 594, datë 19/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1-kat parkim nen toke (faza 1) në lagjen "1 maji" Vlore- Seksioni D (banim); E (hotel)ö me adresë në lagjen "1 Majiö, paraqitur nga zhvilluesi K.R.K, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.3/102 datë 07.06.2010 të KRRT Bashkia Vlorë me afat deri më 21.12.2013,si dhe me zgjatje afati leje 4 herë, përkatësisht me Vendim nr.57 datë 29.04.2014 "Për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimitö, me Vendim nr. 331 datë 30.06.2017 "Për zgjatje afati për lejen e ndërtimitö, Vendim nr.1240 datë 05.12.2017 "Për zgjatje leje afati ndërtimitö dhe Vendim nr. 442 datë 22.07.2020 me afat 22.01.2020, ndryshim të projektit gjatë zbatimit me Vendim nr. 602 datë 04.01.2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "1 Maji" Vlorëö, si edhe me Vendim nr.543 datë 25.09.2020 për miratim ndryshim funksioni "Kompleks Banimi dhe Shërbimesh 5-6 Dhe 7 Kate Me 1 Kat Parkim Nëntokëö, ku (Seksioni E) Ndryshon Destinacion Nga Banim, Ne Funkcion te Turizmit, Hoteleri, për shkëlqje të lejes së ndërtimit dhe diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 14,269,981 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin "D.öshpk me nr. Lic NZ. 51 /1 me objekt "Godinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen "Dëshmorëtö Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019, për diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 1,517,789 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

Për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit, konkretisht ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" të ndryshuar, dhe VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" të ndryshuar, si dhe Vendimi i KKT-së Nr. 9, datë 17.02.2016 "Për zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga Autoritetet Vendore të Zhvillimit të Territorit", Vendimin Nr. 5, datë 29.12.2014 "Për identifikimin e zonave të urbanizuara në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyet në funksion të zhvillimit urban", Vendimin Nr. 01, datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore", Vendimin nr.Nr. 1, datë 26.07.2018 "Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e Turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë", Vendimin nr.23 datë 28.02.2020 të KKT "Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda zonës së Brezit Bregdetar", Vendimin nr.1 i KKT datë 16.10.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë", i rishikuar me Vendimin nr.4 datë 17.05.2019 të KKT "Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, i rishikuar me Vendimin nr.3 datë 03.12.2020 të KKT "Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë".

8. D. Z., në cilësinë e Drejtorit Juridik;

Për mos kryerjen cilësisht dhe profesionalisht të detyrës funksionale që mban, paraqitje jo profesionale në insitucionin e gjykatës në proceset gjysore me objekt rivendosjen në afat të lejeve apo detyrimin për zbardhje leje dhe bashkëpërgjegjës për shkaktimin e pasojave financiare për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 117,201,519 lekë, pasi në asnjë rast nuk ka bërë mbrojtjen e duhur të çështjes duke lenë mundësinë e përfitimit të subjektit ndërtues, fakt ky i cilësuar dhe në vendimin e gjykatës së Apelit ku shprehet:

23.1. Ky kolegji thekson se në kushtet kur ekzistenca dhe vlefshmëria e aktit administrativ, vendimit Nr. 2/46, datë 28.09.2011, të KRRT-së së Bashkisë Vlorë, nuk është vënë në diskutim në këtë gjykim nga asnjëra prej palëve në proces, atëherë çdo fakt që i ka paraprirë nxjerrjes së këtij akti administrativ (në të dy fazat e tij: a) procedimi për shqyrtimin administrativ të kërkesës dhe b) shqyrtimi dhe miratimi i lejes së ndërtimit nga organi kompetent, KRRT-ja vendore, sipas neneve 45-50 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar) do të konsiderohet i mirëqenë.

23.2. Në këtë pikë, Gjykata e Apelit e çmon të nevojshme që të sqarojë se pretendimet ngritura në ankimin e palës së paditur, Bashkia Vlorë, në lidhje me mungesën e dokumentacionin të paraqitur nga pala paditëse për marrjen e lejes së ndërtimit nuk do të merren parasysh, për sa kohë vlefshmëria e kësaj leje ndërtimi nuk u kundërshtua gjyqësisht nga kjo palë me kundërpadi.

Lejet e ndërtimit të zbardhura me vendime gjyqësore nuk kanë përcaktuar përlllogaritjen e taksës, kur duhet të përlllogarisnin taksën e ndikimit në infrastrukturën momentin e paraqitjes për zbardhjen e lejes në referencën e vendimit nr. 100 datë 22.12.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë dhe jo sipas taksave dhe tarifave vendore të vitit 2011 kur sht marr leja e ndërtimit për:

-Lejen e ndërtimit miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin D.ö shpk me nr. Lic NZ. 5.../1, me objekt Godinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen Dëshmorët me një efekt financiarë 1,517,789 lekë.

-Lejen e ndërtimit 2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin B.ö shpk me nr. Lic NZ. 6...3 me objekt Banesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntok në lagjen 10 korriku me një efekt negativ financiarë prej 79,145,441 lekë.

-Lejen e ndërtimit miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvillues subjektin B.ö shpk me nr. Lic NZ. 6...3 me objekt Godinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen pavarësia Vlorë me një efekt negativ financiarë prej 36,538,289 lekë.

b. Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, për punonjësit e mëposhtëm:

1. V. Z. me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit dhe Regjistrimit të të ardhurave për shkeljet e përbashkëta të konstatuara në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, cilat janë trajtuar gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit. Anomalitë e konstatuara kanë ardhur si rezultat i mos zbatimit të kërkesave të: nenit 5, 47, pikat 82-91 të ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe nenin 40, 47, 48, 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, nenet 50 - 51 të ligjit nr. 9936; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit me ndryshime, si dhe pika 1 e nenit 4 dhe neni 76 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ligjit nr. 10340, datë 28.10.2010 për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe

SHA në pronësi të pushtetit vendorë, nenin 2 dhe 3, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaö.

2. H. H., me detyrë Përgjegjës i Financës dhe Kontabilitetit, për:

-Moszbatimin e kuadrit rregullator të fushës në kryerjen e veprimeve kontabël, gjatë hartimit të pasqyrave financiare, kryesisht në kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave dhe detyrimeve të Bashkisë Vlorë ndaj palëve të treta.

3. D. H., me detyrë Specialist pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Planifikimit për kalimin për miratim të lejeve të ndërtimit, për:

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 436, datë 11/06/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 335, datë 05/05/2021 për objektin òNdertim Komplex per mbareshtim lopeshö, në adresën Bunavi, Vlorë, me zhvillues òM. C. S.ö shpk.

Për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit, konkretisht ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, si dhe Vendimi i KKT-së Nr. 9, datë 17.02.2016 “Për zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga Autoritetet Vendore të Zhvillimit të Territorit”, Vendimin Nr. 5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund të ndërhyet në funksion të zhvillimit urban”, Vendimin Nr. 01, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, Vendimin nr. 1, datë 26.07.2018 “Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e Turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë”, Vendimin nr.23 datë 28.02.2020 të KKT “Për përcaktimin e procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e aplikimeve, brenda zonës së Brezit Bregdetar”, Vendimin nr.1 i KKT datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë”, i rishikuar me Vendimin nr.4 datë 17.05.2019 të KKT “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë, i rishikuar me Vendimin nr.3 datë 03.12.2020 të KKT “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë”.

4. O. B., me detyrë juriste në Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në cilësinë e hartueses së kontratës, për:

-Objekti òThertorenö Nga verifikimi i pagesave për rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467, 840 lekë nga 814, 080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likjuar vlera prej 347,040 lekë**, në kundërshtim me nenin 3 òQirajaö të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**.

Në VKB dhe në kontratë në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarin e imët të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëmdhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjeçare të lidhjes së kontratës 15.08.2018 deri më 15.8.2019, duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe të ishte arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit të pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshtim për blim**. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 òPër përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreö, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, òTarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me

qira ose enfiteozë, pikat 5³⁷,

Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2

Me VKB nr.101 datë 03.10.2019 për miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselë është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të objektit Thertore, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44740 lekë e përbërë nga: 231m² ndërtesë x100 lekë/m² = 23100 lekë dhe 1082m² truall funksional x 20 lekë/m² = 21,640 lekë. Kjo VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënien me qira të objektit. Si rrjedhojë 44,740 lekë/muaj x 24 muaj = **1,073,760 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara.**

- Objektivin Parku, nga ku është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2018 - 30 Qershor 2021, **shuma 10,198,440 lekë, përbën të ardhur të munguar me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe MZHTETTS**, sipas përqindjeve, referuar procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka si dhe tarifave të ndryshuara me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 për disa ndryshime në VKM nr.54 datë 5.2.2014.

-Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, me ndryshime.

-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës.

-Nisur nga përcaktimet e kontratës fillestare në nenin 7 zgjidhja e kontratës pika 7.2 germa është përcaktuar se kontrata mund të zgjidhet para afatit, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate, veprim që nuk është kryer nga Bashkia Vlorë.

5. I.M., me detyrë me detyre specialist pranim-vlerësimi-terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

6. S.I., me detyrë specialist pranimie Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

7. Ll. M., me detyrë specialist kontrolli në terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

8. K. M., me detyrë specialist kontrolli në terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

9. D. I., me detyrë specialist kontrolli në terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

10. F. B., me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Orikum

11. H. G., me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Orikum

12. P.L., me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Qendër

13. M. L., me detyrë specialist kontrolli në terren në NJA Shushicë

14. A. L., me detyrë specialist kontrolli në terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, si të ardhura të munguara **me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë**, në sezonin turistik nga anijet lundruese.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimit-gjelbërim-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet e ndërtimit që janë pajisur me Leje Ndërtimi mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit-gjelbërim-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimiò, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimiò, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

15. E. C., me detyrë specialist pranimi e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për:

-Veprime në kundërshtim meligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105,106 , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 35, 36.

- Në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsytet e veprimeve.

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, si të ardhura të munguara **me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë**, në sezonin turistik nga anijet lundruese.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimim-gjelbërim-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet e ndërtimit që janë pajisur me òLeje Ndërtimiò mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të

ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

-Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit ***por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.***

-Nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit ***por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë***

-Nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

16. Xh. K., me detyrë specialist pranimie Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

17. R. P., me detyrë specialist pranimie Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

18. D. N., me detyrë specialist pranimie Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

19. O. M., me detyrë specialist pranimie Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, si të ardhura të munguara ***me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë***, në sezonin turistik nga anijet lundruese.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimim-gjelbërim-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet e ndërtimit që janë pajisur me òLeje Ndërtimi mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

-Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimi, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit ***por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.***

-Nuk janë faturuar dhe ***nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.***

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimiò, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.*por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë*

-Nuk janë faturuar dhe *nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.*

-Për veprimet në kundërshtim meligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105,106 , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 35, 36.

- Në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsye të veprimeve.

20. E. P., me detyrë specialist kontrolli në terren e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore Për veprimet në kundërshtim meligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105 ,106 , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 35, 36.

- në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsyet e veprimeve.

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, si të ardhura të munguara **me efekt negativ në vlerën 15,661,000 lekë**, në sezonin turistik nga anijet lundruese.

-Nga DTTV Bashkia Vlorë nuk është vepruar për ngarkimin në sistemin TAIS, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifën e pastrimit-gjellbërimit-ndriçimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet e ndërtimit që janë pajisur me òLeje Ndërtimiö mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit për 58 subjekte në vlerën 2,320,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019-2020 dhe 6-mujorin I 2021 në 48 raste subjekte me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimiö, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 1,920,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit për 25 subjekte me vlerën prej 750,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-Për vitet 2018-2019, 2020 dhe 6-mujorin I 2021, në 57 raste subjektsh me aktivitet ndërtimi të pajisura me òLeje ndërtimiö, mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektsh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit, **por nuk janë arkëtuar, në vlerën debitore prej 2,280,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**

-Nuk janë faturuar dhe **nuk është arkëtuar tarifa e pastrim-gjellbërimit-ndriçimit për 19 subjekte me vlerën 570,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

21. F. Ll., me detyrë specialiste e kontrollit në terren NJA Orikum në DTTV

22. M. L., me detyrë specialist i kontrollit në terren NJA Shushice në DTTV

23. E. P., me detyrës specialiste e kontrollit në terren NJA Novoselë në DTTV, për:

-Debitorë për taksën e tokës për vitin 2018 rezultojnë **6571** familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, për vitin 2019, **6928** familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë**, për vitin 2020, **7872** familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 janë **8627** familje fermere në vlerën **25,391,616 lekë**.

-Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) òTaksa mbi tokën bujqësoreö të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, me ligjin nr. 9632,

datë 30.10.20106 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Në Bashkinë Vlorë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë, pasi në VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 pika 2/b përcaktohet se: *òNgarkohen për mbledhjen e kësaj takse b/1-7, Specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve për qytetin e Vlorës.ò*

Pra, nuk përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NJA nga DTTV-ja apo nga Sektori i Menaxhimit të Tokës për NJA në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Ndërsa sipas Rregullores së Brendshme neni 170 òSpecialisti i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokësò në pikën (f) përcaktohet: *òPërpilon listat e fermerëve që kanë tokë bujqësore dhe dërgon dokumentacionin pranë DTTV së Bashkisë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.*” Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat.

24. H. G.me detyrë specialiste e kontrollit në terren NJA Orikum në DTTV.

Për veprimet në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregullore e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105,106 , me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 òPër dokumentin elektronikò, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, pika 35, 36.

- në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- Nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsyet e veprimeve.

-Debitorë për taksën e tokës për vitin 2018 rezultojnë **6571** familje fermere në vlerën **26,107,191 lekë**, për vitin 2019, **6928** familje fermere në vlerën **30,625,468 lekë**, për vitin 2020, **7872** familje fermere në vlerën **27,162,120 lekë** dhe për 6-mujorin e I të vitit 2021 janë **8627** familje fermere në vlerën **25,391,616** lekë.

-Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) të Taksa mbi tokën bujqësore të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2010 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore të ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore të ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Në Bashkinë Vlorë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë, pasi në VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 pika 2/b përcaktohet se: *“Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse b/1-7, Specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve për qytetin e Vlorës.”*

Pra, nuk përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NJA nga DTTV-ja apo nga Sektori i Menaxhimit të Tokës për NJA në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Ndërsa sipas Rregullores së Brendshme neni 170 të Specialistit të Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrotjes së Tokës në pikën (f) përcaktohet: *“Përpilon listat e fermerëve që kanë tokë bujqësore dhe dërgon dokumentacionin pranë DTTV së Bashkisë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.”* Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit të Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistratit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat.

25. K. Q., me detyrë Financiere e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, pasi:

Të ardhurat në DTTV mbahen ekstra-kontabël, thjesht në një program excel, referuar ditarit të të ardhurave të mbajtur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe bëhet rakordimi mujor me dy drejtoritë. Evidentohen vetëm arkëtimet për çdo debitor në Sistemin TAIS, dhe më pas Sistemi TAIS gjeneron debitorët, por për vitet 2018 dhe 2019 nuk janë përfshirë në kontabilitet, megjithëse nga specialistja e Kontabilitetit në DTTV është bërë relacion Drejtorit të DTTV në fund të vitit ushtrimor, ku ky i fundit nuk ia ka dërguar Qendrës Ekonomike për kontabilizim edhe përfshirjen e vlerës së debitorëve të shoqëruara me analizën e tyre në Pasqyrat Financiare të viteve 2018-2019, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a,b.

- Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave si dhe mbajtja e një pjesë të taksave dhe tarifave që menaxhohen nga DTTV jashtë kontabilitetit.

26. E. C., me detyrë Specialiste e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për:

- Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 4, ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 68, 69, 114, Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të Administratës së Bashkisë Vlorë, neni 104, 105, 106, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 4/26; me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 për dokumentin elektronik, neni 3; me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, pika 35, 36.

- Në raportet e gjeneruara nga sistemi TAIS ekzistonin raste të konsiderueshme të veprimeve të kryera për ngarkesat me taksa dhe tarifave vendore jashtë periudhave ushtrimore. Për rrjedhojë veprimet e mësipërme nga DTTV-së së pari kanë sjellë shmangien e aplikimit të kamatëvonesave duke shkaktuar një dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe së dyti rrezikun e mosnjohjes nga ana e subjekteve të detyrimeve të viteve të mëpasshme

- Nuk janë tarifuar dhe taksuar **264 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor **2019** dhe **300 subjekte** të cilat kanë statusin aktiv dhe nuk janë tarifuar dhe taksuar për vitin ushtrimor 2020, duke shkaktuar të ardhura të munguara. (për shkak të mungesës së të dhënave dhe databases në burim).

- nuk kanë regjistruar në sistemin TAIS rreth **800 subjekte** si rrjedhojë të pa ngarkuara me taksat dhe tarifave vendore, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe evazion fiskal.

- Kanë kryer **1097** veprime stornimi (Credit Note) në sistemin TAIS në lidhje me ngarkesat e taksave dhe tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik të regjistruara në këtë sistem, për të cilat nuk janë mbajtur procesverbale. Ndërsa për **205** stornime të mbajtura me procesverbale janë me parregullsi si: në disa raste nuk paraqiten veprimet; në disa raste nuk ka një përshkrim të qartë dhe të plotë të veprimit; në disa raste të tjera nuk jepen të qarta arsyet e veprimeve.

27. K. A., me detyrë Specialist i Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, për:

-Objekti ÷Thertorenö Nga verifikimi i pagesave për rezulton se janë kryer pagesa për një pjesë të kontratës në vlerën 467, 840 lekë nga 814, 080 lekë që është detyrimi sipas kontratës, **duke mbetur pa u likujduar vlera prej 347,040 lekë**, në kundërshtim me nenin 3 ÷Qirajaö të kontratës, **duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë**.

Në VKB dhe në kontratë në përlllogaritjen e tarifës së qirasë nuk është përfshirë tarifa e perdorimit të linjës së përpunimit/prodhimit dhe inventarin e imët të objektit, ku sipas të dhënave kontabile të inventarizimit të objektit është në vlerën prej 7,200,000 lekë, nga ku vetëmdhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900,000 lekë. Për periudhën 1 vjeçare të lidhjes së kontratës 15.08.2018 deri më 15.8.2019, duhet të ishte përfshirë në kontratë dhe të ishte arkëtuar për llogari të institucionit **shuma prej 720,000 lekë (7,200,000 x 1/10 vlerës x 1 vit), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimit e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshtëpërblim**. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 ÷Për përcaktimin e kriterëve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreö, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, ÷Tarifat dhe vlera dysHEME për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozëö, pikat 5³⁸,

Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës dhe konkretisht pikës 2

Me VKB nr.101 datë 03.10.2019 ÷Për miratimin e dhënies së pasurisë së palujtshme (Thertore) me qira në Njësinë administrative Novoselëö është miratuar fillimi i procedurës së dhënies me qira të të objektit ÷Thertoreö, ku është përcaktuar që afati do të jetë 5 vjet dhe vlera e qirasë prej 44740 lekë e përbërë nga: 231m² ndërtesë x100 lekë/m² = 23100 lekë dhe 1082m² truall funksional x 20 lekë/m² = 21,640 lekë. Kjo VKB nuk ka gjetur zbatim, pasi për periudhën e daljes së këtij vendimi nuk është kryer procedurë për dhënien me qira të objektit. Si rrjedhojë 44,740 lekë/muaj x 24 muaj = **1,073,760 lekë, shumë e cila përbën të ardhura të munguara**.

28. A.Xh., me detyrë Specialist i Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, për:

Për dhënien me qira subjekteve apo individëve privat për zënien e hapësirave publike në zonën e plazhit dhe pagesave të kryera:

Informacioni i dhënë nuk plotësonte kushtet e një dokumenti zyrtar dhe financiar për auditim, referuar listave të subjekteve të dorëzuara dhe të nënshkuara në lidhje me detyrimet dhe pagesat e kryera si edhe listat e gjeneruara nga Drejtoria e Financës (veprimet e bankës), rakordimeve nëpërmjet Degës së Thesarit, u krye verifikimi i listave të cilat nuk japin pamje të njëjtë për detyrimin dhe pagesën e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve.

-Nga Drejtoria ekonomike dhe sipas aktrakordimeve me thesarin të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,063,700 lekë

Viti 2021 në shumën 32,269,660 lekë

-Nga Drejtoria e Aseteve të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirave të plazheve janë:

Viti 2020 në shumën 28,619,600 lekë

Viti 2021 në shumën 31,659,580 lekë

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës, rezultojnë se për vitin 2020 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 168 subjekte, nga të cilat 130 subjekte kanë paguar detyrimin, 5 subjekte e kanë paguar pjesërisht dhe 33 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 6,783,200 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

-Nga auditimi dhe kryqëzimi i emrave të subjekteve që kanë aplikuar për leje dhe janë pajisur me kuponin për pagesë me pagesat e kryera nëpërmjet bankës rezultojnë se për vitin 2021 janë pajisur me leje për lidhje kontrate 181 subjekte, nga të cilat 138 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 43 nuk kanë paguar detyrimin **në shumën 8,120,240 lekë**. Sipas listave bashkëlidhur.

-Nga Drejtoria e Aseteve nuk janë kryer rakordimet me degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitore për çdo fund viti, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimin të Aseteve, nuk janë mbajtur aktraktordime me DTV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë Kreu III. Regjistri i Aktiveve dhe Dokumentimi i lëvizjes së tyre, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pikat 34, 35 dhe 36 dhe VKB nr.88, datë 24.12.2020 për Miratimin e Taksave dhe Tarifave vendore në Territorin e Bashkisë Vlorë.

F.II. Bazuar në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 11, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë, fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

“Vërejtje”, për Administratorët e Njësive Administrative:

I.M. K., me detyrë Administratore e Njësië Qendër Vlorë, pasi:

Nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimin të Aseteve si dhe NJA nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse individ apo subjekte private qiramarrës kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Për rastet e subjekteve debitore nuk ka prishje të kontratës për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës. Nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultojnë se në 97 raste të kontratave nuk janë respektuar kushtet e kontratës, në lidhje me pagesën e tarifës së qirasë dhe kamatëvonesave **në vlerën 64,290,775 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë Vlorë.**

-për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, për tokat bujqësore të pandara janë lidhur 57 kontrata për qiradhënie **të tokave bujqësore të pandara**, me afat 99 vjet, 10 kontrata me afat 30 vjetar dhe 1 kontratë me afat 50 vite. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezultojnë se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **7,670,532 lekëgjithsej**.

-Nga të dhënat e UK Sha Vlorë rezultojnë se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

-Ujje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

2. B.A., me detyrë Administratore e Njësië Shushicë, pasi:

-Për periudhën Janar 2008 - Dhjetor 2013 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 161 kontrata për qiradhënie, ku 154 kontrata me afat 99 vjecar nga fondi i tokave bujqësore të pandara dhe 7 kontrata nga fondi kullor me sipërfaqe prej 45,721 ha. Nga 154 kotratat e qiradhënies të fondit të tokave të pandara në 13 raste kontratat janë anuluar nga Bashkia Vlorë, në 2 raste kontratash janë në tatime dhe në 3 raste subjektet nuk ekzistojnë. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nuk janë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë, në vlerën prej **6,998,951 lekë gjithsej**.

-Nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësië Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet qe nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjetllësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

-Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

3. K.Sh., me detyrë Administrator i Njësië Novoselë, pasi:

Për periudhën vitet 2008 - 2015 në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, òPër tokat bujqësore të pandaraò janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet **mbështetur** në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën prej **49,621,292 lekë gjithsej**.

Nga ish-Komuna Novoselë, për periudhën vitet 2008-2015 janë lidhur 46 kontrata për qiradhënie, me afat 99 vjecar. Nga verifikimi i pagesave deri më 30.12.2020 për kontratat e lidhura rezulton se nga 46 kontrata në 2 raste subjektet nuk ekzistojnë rezultuar nga verifikimi, ndërsa në 44 raste qiradhënësit janë debitorë, të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore dhe penalitetet mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë në vlerën **prej 49,621,292 lekë gjithsej**.

-Për të gjitha rastet e kontratave ku subjektet qiramarrës janë debitorë nga Bashkia Vlorë nuk është bërë asnjë veprim për verifikimin për rishikimin e kontratave dhe ndryshimin e kushteve të kontratave apo anulimin e tyre, rimarrjen e parcelave që ato shfrytëzojnë si edhe nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për zgjidhjen e këtyre kontratave.

-Ulje në nivelin e të ardhurave, si dhe mos menaxhimi dhe mosmonitorimi i kontratave të qiradhënies së tokave të pandara dhe parcelave nga fondi pyjor-kullor nga strukturet NJA.

-Nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësië Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet qe nuk janë te lidhur me rrjetin e Ujësjetllësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

-Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

4. S. H., me detyrë Administrator i Njësië Orikum (viti 2020)

5. A.C., me detyrë Administrator Rajoni nr. 2 (viti 2020)

6. A. L., me detyrë Administrator Rajoni nr. 3

7. A. L., me detyrë Administrator Rajoni nr. 4

8. B. C. me detyrë Administrator Rajoni nr. 5, *pasi*:

-Nga të dhënat e UK sha Vlorë rezulton se, për të tre vitet objekt auditimi 2018-2019-2020 nuk është planifikuar dhe realizuar e ardhura nga taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërim-

ndriçimit për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sha Vlorë, pasi kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Rajoneve dhe të Njësisve Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjetës, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat.

Ulje e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën **148,587,530 lekë** dhe vlera e pa tarifuar prej **196,996,337 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

G. MASA ADMINISTRATIVE:

G.1 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike me vlera të larta dhe vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 òPër prokurimin publikò nenin 132, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (kapitulli 9.4 faqen xxxxxx), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò (me ndryshime), si dhe nenit 9 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative me gjobë ose masë disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për **12 (dymbëdhjetë) punonjës**, si më poshtë:

1. G.Sh., me detyrë ish-Drejtor i NSHP Bashkia Vlorë, në cilësinë e titullarit të AK.

2. J.H., me funksion Specialiste në Sektorin e Financës, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

3.F.Xh., me funksion Përgjegjës në Sektorin e Bordit të Kullimit, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

4. E.H., me funksion Inxhinier Mekanik Përgjegjës Dega Teknike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

5. S. N., me funksion Juriste në NSHP, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

6. J. C., me funksion Specialiste në Sektorin e Gjellbërimit, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, si dhe çojnë në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 òKualifikimi ofertuesvëò të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò (me ndryshime), neni 26 òKontrata për punë publikeò, pika (5); neni 61 òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika (2), paragrafi (2) . (Më hollësisht trajtuar në pikën 9.4, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. M.K., me funksion Inxhinier, Nd. Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO.

8. T.D., me funksion Përgjegjës Finance, Nd. Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO.

9. J.Ç., me funksion Drejtor i Planifikimit Zhvillimit të Territorit Bashkia Vlorë, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) òAnulimi një procedure prokurimiò, pika (1), germa (ç); neni (46) òKualifikimi i ofertuesvëò, pika (1); neni (53) òShqyrtimi ofertaveò, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) òKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseò, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643,

datë 20.11.2006 *ËPër prokurimin publikë (me ndryshime) dhe neni (66) ëShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveë, pika (3); neni (67) ëKlasifikimi ofertave; neni (68)ëRaporti përmbledhësë; Kreu (VIII) ëKushte të përgjithshme për zbatimë; neni (73) ëMungesa e konkurrencësë, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë, (me ndryshime) (Më hollësisht trajtuar në pikën 9.4, faqe xxxxxx, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10. A. H., me funksion Specialist Pagash, në cilësinë e Kryetarit të KBVV.

11. A.V, me funksion Përgjegjëse e sektorit të DDD.

12. E. B., me funksion punonjës Arkivës, në cilësinë e anëtarit të KBVV.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KBVV), mbi aplikimin e kriterëve në mënyrë të paargumentuar, shpalljen fitues të OE jo në kushtet e dispozitave të LPP, copëzimit të fondeve të prokuruar për artikuj të njëjtë, veprime të cilat kanë çuar në shmangieje nga procedurat me vlerë të lartë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 *ëPër prokurimin me vlera të voglaë me ndryshimet; neni 40 ëProcedura e prokurimit me vlera të voglaë pika 7; Kreun VII ëZyrtaret e prokurimit dhe zhvillimi i proceduraveë, pika 2 të nenit 59 ëPërlllogaritja e vlerës limit të kontratësë, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikëi ndryshuar; pikës 1 dhe 4, të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 27.01.2015 ëPër hartimin e Regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikë, me ndryshime, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013, me nr. 1, datë 28.02.2014, si dhe pika 5 e Udhëzimit të APP nr. 3 datë 08.01.2018 ëMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeë.(Më hollësisht trajtuar në pikën 4,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

D.2. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit për mos zbatimin e kontratave në afat, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vlorë të kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Vlorë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore me gjobë, për:

1. Znj. I. S. përfaqësues i shoqërisë *ëL.*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 263, datë 25.7.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë *ëL.ë ShPK*, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **207,030 lekë**.

2. Znj. R. N. përfaqësues i shoqërisë *“R.” ShPK*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për mos ndjekjen e kushteve të kontratës nr. 400/1, datë 15.11.2019 të lidhur midis institucionit NSHP Bashkia Vlorë ka lidhur me shoqërinë *ëS.ë ShPK*, për përfundimin në afat të punimeve, veprime me efekt negativ me dëm në vlerën **827,777 lekë**.

3. Shoqëria *“D.” SHPK*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin *ëRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimëë*, për certifikim të punime me vlerë 370,000 lekë, të cilat nuk janë realizuar.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për

fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 öPër Nëpunësin Civilö, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 öPër Nëpunësin Civilö, të ndryshuar.

***Shënim: Përpunonjësit e larguar.**

- Për punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, **largim nga shërbimi civil** për:

1. E. A., me detyrë ish-Drejtori i Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për miratimin e lejeve të ndërtimit:

-Nuk ka marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Vlorë. Kështu për periudhën 2016-2020-30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m² ndërtim me vlerë investimi prej 10,222,341,500 lekë pa u faturuar dhe arkëtuar taksë e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhura të munguar për Bashkinë Vlorë.

-Gjithashtu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 2916 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107 lekë, nga këto është likuajduar vlera prej 88,038,725 lekë, duke mbetur pa shlyer vlera 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksë e tarifa vendore **në vlerën 51,111,707 lekë** nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin öHotel 6 kate me 1 kat bodrumö, në adresën Lagjen "Uji i Ftohtëö, me zhvillues T. Z., projektuar nga A. D. C. me licencë nr. A. 1358.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 665, datë 05/02/2018 për objektin öStrukture me funksion turistik 4-5 kate me 1 kat nën tokëö në Radhimë Vlorë me zhvillues A. D. dhe Xh.F.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 718, datë 09/03/2018 për objektin öMagazine industriale 1 & 2 kateö me adresë Lagjia ö28 Nëntoriö, Bashkia Vlorë me zhvillues öT. C.ö shpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1129, datë 16/10/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 512, datë 26/10/2017 për objekt öGodinë hoteleri 3 kate me një kat nëntokëö me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues öD.ösh.p.k.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 803, datë 03/05/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 471, datë 10/10/2017 për objekt öKapanon Industrial 1 kat dhe zyra 2 kat (Shtesë anësore në kapanonin ekzistues 1 kat) me adresë Cerkovinë, Vlorë, me zhvillues öA.Pö shpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 1002, datë 16/08/2018 dhe leje zhvillimi Nr. 535, datë 08/11/2017 për objekt öHotel 3 dhe 4 kateö me adresë Lagjia öUji i ftohtëö Vlorë, me zhvillues A., P.dhe V. V.

-Leje ndërtimi miratuar me Nr. 862, datë 05/06/2018 për öMagazinë Industriale 2 kate dhe 1 kat zyraö me adresë Lagjia öKushtrimiö Vlorë, me zhvillues R.C sh.p.k

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr.948, datë 30/07/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 660, datë 31/01/2018 për òKapanon 1 kat, per vegla bujqësoreo me adresë Fshati Mifol, Vlorë, me zhvillues E. J.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 981, datë 09/08/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 659, datë 31/01/2018 për òKapanon 1 kat, për magazinimin e produkteve bujqësoreo me adresë Rr. òIsmail Qemaliò, Nj.A. Novoselë Vlorë, me zhvillues A. P.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 861, datë 05/06/2018 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 674, datë 16/02/2018 për òMagazine industriale 1 katò me adresë Nartë, me zhvillues Ll. K.

2. F. D., me detyrë ish-Drejtori i Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit, për miratimin e lejeve të ndërtimit:

-Gjatë hartimit të kriterëve teknike për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i ujësjetillësit në 15 fshatrat e Njësissë Administrative Novoselëo, janë vendosur kriterë të cilat nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës.

-Gjatë vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i rrugës Panaja-Hoshtimë, me fond limit 15,166,000 lekë, nuk kanë shqyrtuar në mënyrë korrekte ofertat dhe nuk kanë kërkuar shpjegime për ofertë anomalish të ulët, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 2,956,640 lekë.

-Nuk ka marrë masa të veçanta lidhur me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Vlorë. Kështu për periudhën 2016-2020-30.06.2021 janë dhënë 1766 leje legalizimi për 344543 m² ndërtim me vlerë investimi prej 10,222,341,500 lekë *pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 51,111,707 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Vlorë.*

-Gjithashtu për periudhën 2016-2020 deri 30.06.2021, nga Sektori i Planifikimit të Territorit janë faturuar 2916 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vlorë me një detyrim prej 91,424,107 lekë, nga këto është likuajduar vlëra prej 88,038,725 lekë, *duke mbetur pa shlyer vlëra 3,385,382 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Vlorë.*

-Ulje në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore *në vlerën 51,111,707 lekë*nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 566, datë 07.12.2017 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 22.09.2017 për objektin òHotel 6 kate me 1 kat bodrumò, në adresën Lagjen "Uji i Ftohtëo, me zhvillues T. Z., projektuar nga A. D. C. me liçencë nr. A. 1...8. Leje për Ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit miratuar me Vendim nr.158 datë 11.4.2019 për objektin òHotel 6 kate me 1 kat bodrumò me zhvillues T. Z.

-Leje ndërtimi për shtesë me sipërfaqe më të madhe se 250m², miratuar me Nr. 470, datë 30/07/2019 për objekt òRikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë anësore dhe shtesë katesh me funksion hoteleri në objektin 1 katësheo me adresë Lagjia òUji i ftohtëo Vlorë, me zhvillues P. H.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 630, datë 10/10/2019 dhe leje zhvillimi Nr.196, datë 24/04/2019 për objekt òGodinë Banimi dhe Shërbimi 4-7-10 kate me 1 kat parkimi nëntokëo me adresë Lagjia òPavarësiaò Vlorë, me zhvillues òH.P.òsh.p.k.

-Leje ndërtimi miratuar me Nr. 748, datë 06/12/2019 dhe Leje Zhvillimi Nr. 682, datë 06/11/2019 për òObjekt 3 kate me 1 kat parkim me funksion hoteleriò me adresë Radhimë, Vlorë, me zhvillues H.R.G.

-Leje ndërtimi në emër të aplikantit Nermin Jonuzi, zhvillues M. Ç. me datë aplikimi 04.06.2019, është miratuar leje për rikonstruksion objekt banimi 1 kt dhe shtesë në lartësi në Lgj Pavarësia, Rr. Andon Z. Çajupi, ZK 8603.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 79, datë 11/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 453, datë 23/07/2019 për objektin òKompleks "Shërbime turistike dhe shtëpi të dyta në Radhimë - Vlorë, me zhvillues òE.ëshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 300, datë 02/07/2020 dhe leje zhvillimi nr. 689, datë 14/11/2019 për objektin òGodinë banimi, shërbimesh dhe hoteleri 3-4-7 dhe 8 kate me 2 kate parkim dhe shërbime nëntokë, në adresën Rruga òDhimitër Konomiö, me zhvillues òE. K.ö.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, datë 22/01/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 770, datë 16/12/2019 për objektin òKapanon për rritje dhe mbarështim shpendëshö, në adresën fshati Shushicë, Njësia Administrative Bashkia Vlorë, me zhvillues B. K.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 583, datë 13/10/2020 për objektin òRindërtim i volumit 3 kate me shtim bodrumi, volumi anesor dhe shtese kati me funksion hoteleriö ne Lagjen "Uji i Ftohte", Vlorë me zhvillues S. A.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 540, datë 23/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 175, datë 14/04/2020 për òObjekte banimi dhe shërbimi 8 kate me 1 kat nëntokë me adresë Rruga òDhimitër Konomiö, Vlorë, me zhvillues òH.P.ëshpk.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 578, datë 09/10/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 584, datë 25/09/2019 për òGodine banimi dhe shërbimi 1,3,4,6,7,8 kate me nje kat parkim nen tokë me adresë Rruga "Mustafa Bello", Vlorë, me zhvillues òA.ö shpk., në pronësi të K.C., V. C., E. C., Sh.M.

Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 508, datë 04/09/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 352, datë 20/06/2019 për òGodinë banimi dhe shërbimesh 1-3-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokë me adresë Lagjia òPavarsiaö Rr."Gjergj Arianiti" dhe Rr."Faik Konica" Vlorë, me zhvillues H. M. dhe V. M., nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 650,294 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 258, datë 05/06/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 725, datë 26/11/2019 për òKompleks shtëpish të dyta me tre kate, dy kate nëntokë me adresë Lagjia Lagje "Uji i Ftohte" Vlorë, me zhvillues òH.P.ësh.p.k, nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 1,565,508 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë me Nr. 108, datë 27/02/2020 dhe Leje zhvillimi me Vendim Nr. 651, datë 23/10/2019 për òObjekt për magazinim, tregtim dhe organizim eventesh (panairesh) për materiale ndërtimi rifinitureö me adresë Nartë, Vlorë.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 81, datë 13/02/2020 dhe leje zhvillimi Nr. 676, datë 05/11/2019 për objekt Objekt 3 kate me funksion banim dhe shërbime me adresë Lagjia òPavarësiaö Vlorë, me zhvillues N. L.

-Në emër të aplikantit M. K., me zhvillues L. Shpk, me datë aplikimi 12.02.2020 dhe datë dërgimi nga Institucioni i Bashkisë Vlorë 12.05.2020, në Lgj. 11 Janari, me 2 kt mbi tokë dhe 1 kt nëntokë dhe sipërfaqe ndërtimi mbi tokë 5,608 m², nga ku llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është bërë në mënyrë të gabuar me diferencë prej 3,738,539 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.63, datë 08/02/2021 dhe leje zhvillimi Nr. 596, datë 20/10/2020 për objektin òObjekt banimi 5/8kt dhe 1kt bodrumö, Lagjia Pavarësia, Vlorë me zhvillues òS.ö sh.p.k.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr.448, datë 28/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òObjekt 3 dhe 5 kate, me një kat nëntokë, me destinacion hoteleriö Jonufër Plazh, Vlorë me zhvillues A. S., me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.134 datë 10.03.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, me afat përfundimi 13 vite para lidhjes së kontratës, për shkelje të lejes së ndërtimit dhe diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 443,031 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Nr.577 , datë 09/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin òKapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate (shtese anesore e kapanonit ekzistues 2 kat),

në adresën Cerkovinë, Bashkia Vlorë, me zhvillues òA. P.ò sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 803, datë 03/05/2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, nga ku është konstatuar shkelje e kushteve të lejes dhe moszbatim të projektit të miratuar me pasojë ndryshimin e fasadave.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 594, datë 19/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë për objektin "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1-kat parkim nen toke (faza 1) në lagjen 1 maji" Vlore- Seksioni D (banim); E (hotel)ò me adresë në lagjen ò1 Majiò, paraqitur nga zhvilluesi K.R.K, me leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.3/102 datë 07.06.2010 të KRRT Bashkia Vlorë me afat deri më 21.12.2013,si dhe me zgjatje afati leje 4 herë, përkatësisht me Vendim nr.57 datë 29.04.2014 òPër zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimitò, me Vendim nr. 331 datë 30.06.2017 òPër zgjatje afati për lejen e ndërtimitò, Vendim nr.1240 datë 05.12.2017 òPër zgjatje leje afati ndërtimiò dhe Vendim nr. 442 datë 22.07.2020 me afat 22.01.2020, ndryshim të projektit gjatë zbatimit me Vendim nr. 602 datë 04.01.2018 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë òKompleks banimi dhe shërbimesh 5-6 dhe 7 kate me 1 kat parkim nentoke ne lagjen "1 Maji" Vlorëò, si edhe me Vendim nr.543 datë 25.09.2020 për miratim ndryshim funksioni òKompleks Banimi dhe Shërbimesh 5-6 Dhe 7 Kate Me 1 Kat Parkim Nëntokëò, ku (Seksioni E) Ndryshon Destinacion Nga Banim, Ne Funksion te Turizmit, Hoteleri, për shkelje të lejes së ndërtimit dhe diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 14,269,981 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi nr. Prot. 5858 datë 04.07.2017 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 10 datë 04.07.2017, me zhvillues subjektin òD.ò shpk me nr. Lic NZ. 5í .6/1 me objekt òGodinë banimi dhe shërbime 8-Kat, me 1 Kat Parkim nëntok, në lagjen òDëshmorëtò Vlorë me afat zbatimi deri më 04.07.2019, për diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 1,517,789 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar me pasojë dëm ekonomik.

-Leje ndërtimi nr. Prot. 3667/1 datë 11.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 1 datë 11.05.2018, me zhvillues subjektin òB.ò shpk me nr. Lic NZ. 6...3 me objekt òBanesë 8 kat me 1 kat shërbime, dhe 1 kat nëntok në lagjen ò10 korrikuò Vlorë me afat zbatimi deri më 11.05.2022, për diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 79,145,441 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar për buxhetin e bashkisë.

-Leje ndërtimi nr. Prot. 4026/1 datë 22.05.2018 miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Vlorë nr. 3 datë 22.05.2018, me zhvillues subjektin òB.òshpk me nr. Lic NZ. 6í .3 me objekt òGodinë Banimi dhe shërbime 1-12 kate me 1 kat nëntok, në lagjen pavorsia Vlorëò Vlorë me afat zbatimi deri më 22.05.2022, për diferenca të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 36,538,289 lekë, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguar për buxhetin e bashkisë.

F.I.a. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës individuale të punës, neni 11, do të kishim kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

1. M. S., me detyrë ish-Administrator i Njësië Orikum (per vitet 2018-2019)

2. S.K.,me detyrë ish-Administrator i Rajonit nr. 2 (viti 2019)

3. P.B., me detyrë ish-Administrator i Rajonit nr. 1 (vitet 2018-2019)

4. I.A., me detyrë ish-Administrator i Rajonit nr. 2 (viti 2018)

5. V.P., me detyrë ish-specialist kontrolli në terren në NJA Shushicë (01.01.2018 -31.12.2019 larguar)

6. O. A., me detyrë ish-specialist kontrolli në terren në NJA Novoselë (periudha 01.01.2018 deri 05.02.2020)

7. A. Z., me detyrë ish-specialist në Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve

8. M.T., me detyrë ish-specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Tokës në Drejtorisë së Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve

9. B. H., në cilësinë e specialistes të taksave, për arsye se:

- Vlera e detyrimit për debinë e tokës bujqësore në asnjë nga Njësitë Administrative nuk është e kontabilizuar dhe e mbajtur sipas standardeve të kontabilitetit, duke mos pasqyruar situatën reale dhe lenë shteg për abuzime.

Procedura e ndjekur është në kundërshtim me pikën 2 nënpika (b) të Taksa mbi tokën bujqësore të VKB nr. 100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr. 109 datë 23.11.2019 pika 2, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Në Bashkinë Vlorë, menaxhimi dhe ndjekja e taksës së tokës nuk është përcaktuar saktë dhe qartë, pasi në VKB nr.100, datë 22.12.2017 dhe VKB nr.109 datë 23.11.2019 pika 2/b përcaktohet se: *“Ngarkohen për mbledhjen e kësaj takse b/1-7, Specialistët e Drejtorisë së Pronave Publike & Menaxhimit të Aseteve për qytetin e Vlorës.”*

Pra, nuk përcaktohet se kush duhet ta menaxhojë dhe ta ndjekë këtë taksë në NJA nga DTTV-ja apo nga Sektori i Menaxhimit të Tokës për NJA në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve. Ndërsa sipas Rregullores së Brendshme neni 170 të Specialistit i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në pikën (f) përcaktohet: *“Përpilon listat e fermerëve që kanë tokë bujqësore dhe dërgon dokumentacionin pranë DTTV së Bashkisë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.”* Sipas të dhënave zyrtare taksa e tokës nuk është menaxhuar si në aspektin e mbajtjes së regjistrave dhe kontabilizimit të saj nga DTTV-ja, pasi regjistrat i disponojnë agronomët specialistët në NJA e Sektorit të Menaxhimit të Tokës në Drejtorinë e Pronave Publike e Menaxhimit të Aseteve, faturimet janë kryer nga specialistët e kontrollit në terren të DTTV dhe pagesat e familjarëve janë kontabilizuar nga specialistja e të ardhurave në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit. Debitorët nuk gjenerohen nga kontabiliteti dhe sistemi i DTTV, por vetëm nga kryqëzimi i regjistratit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e Sektorit të Menaxhimit të Tokës me pagesat.

Shënim: *Shkelja e konstatuar nga z. A. L., në përcaktimin e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje shtylla elektrike ndriçimi, viti 2021, nuk ka dhënë efekte dhe nuk është e përsëritur, në këto kushte mendojmë për të mos propozuar masë disiplinore.*

-Mbikëqyrësi i shërbimeve të kontratës “Shërbimi i pastrimit në Qytetin e Vlorës”, znj. V. Ç., ka bërë ndalesa të pagesave për shërbimet e pa realizuara, në këto kushte mendojmë për të mos propozuar masë disiplinore.

- Për mbikëqyrësin e punimeve Shoqërinë “R” SHPK, për mangësinë e konstatuar në zbatimin e kontratës “Rehabilitim dhe riasfaltim i rrugës Llakatund-Beshisht”, mendojmë të mos propozojmë masë administrative, pasi është reflektuar gjatë periudhës së auditimit në terren për rregullimet e nevojshme.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT